

Bardhyl Mahmuti

MASHTRIMI I MADH

Ç A B E J
2015

MASHTRIMI I MADH

*Ky libër u shkrua në konsultim të përditshëm me politologun **Ramadan Avdiu**, të cilit i takon një meritë e veçantë për formën dhe përmbajtjen që ka marrë argumentimi në këtë libër.*

*Një ndihmë të jashtëzakonshme më ka dhënë **Rina Çela Grasset**, ideja e së cilës ishte që libri të titullohet «Mashtrimi i Madh».*

Falënderoj:

- Abaz Pllanën
- Adelina Badivukun
- Adnan Asllanin
- Agush Bujën
- Ajet Mahmutin
- Alban Ismailajn
- Arjeta Azemi Aliun
- Behxhet Gashin
- Bilall Sherifin
- Halil Selimin
- Ismail Kuçin
- Isuf Sherifin
- Izet Sylajn
- Ixhet Lutfiun
- Jakup Krasniqin
- Jusuf Osmanin
- Ngadhujim Beqirin
- Rrahman Jakupin
- Rexhep Pangjajn
- Rijat Abdullain
- Sabir Krasniqin
- Sabri Kijçmarin
- Xhelal Idrizin
- Xhevat Bislimin

Për ndihmën e madhe që më kanë dhënë në përkthimin dhe sigurimin e një pjese të materialeve që kam shfrytëzuar.

*Falënderoj **Fisnik Sopin** e «Select Studio» nga Prishtina që me përkushtim të madh dhe vullnetarisht përgatiti dizajnin e kopertinës së librit tim.*

*Në mënyrë të veçantë falënderoj **Avni Deharin**, që me gjithë dhembjen e madhe për humbjen e Arbnorit, gjeti kohë të më sugjerojë ide për librin.*

*Dhe së fundmi një falënderim bashkëshortes **Selvetes** e djemve të mi **Vatanit** dhe **Shpatit**, për mbështetjen e pafund dhe sakrificat, durimin dhe mirëkuptimin gjatë tërë kohës që punova me këtë vepër.*

*Me respekt,
Bardhyl Mahmuti*

Mirënjohje e përjetshme!

Personaliteteve që nuk lejuan realizimin e tërësishëm të Planit Serb për spastrimin etnik të Kosovës:

- *Bill Clinton*
- *Tony Blair*
- *Madeleine Albright*
- *Robin Cook*
- *William Walker*
- *Bob Doll*
- *Richard Holbrooke*
- *John Mc Cain*
- *Wesley Clark*
- *Joe Biden*
- *Javier Solana*
- *Tom Lantos*
- *Alfonse D'Amato*
- *Joseph DioGuard*
- *Christane Amanpour*
- *James Pettifer*
- *Tim Judah*
- *David Loyn*
- *Vaclav Havel*
- *Ullmar Quick*
- *Anders Wesman*
- *Nils Henrik Hooge*
- *Tue Magnussen*
- *Maria Fuglevaag Warsinski*
- *Pål Refsdal*
- *Gerhard Schröder*
- *Joschka Fischer*
- *Viktor Meier*
- *Adelheid Feilcke-Tiemann*
- *Jacques Chirac*
- *Lionel Jospin*
- *Bernard Kushner*
- *Daniel Cohn-Bendit*
- *Bernard-Henri Lévy*
- *Antoine Garapon*
- *Emma Bonino*
- *Olivier Dupuis*
- *Anne-Marie Lizin*
- *Ueli Leunberger*
- *Jean Ziegler*
- *Ruth Dreifuss*
- *Yves Laplace*
- *Bülent Ecevit*
- *Süleyman Demirel*
- *Janez Janša*
- *Jaša Zlobec*
- *Peter Božić*
- *Matjaž Hanžek*
- *Ervin Hladnik-Miharčić*
- *Stjepan Mesić*
- *Vlado Gotovac*
- *Ines Sabalić*
- *Vlado Šeks*
- *Anto Kovačević*

dhe të gjithë politikanëve e intelektualëve që u mobilizuan për t'i dhënë fund gjenocidit në Kosovë, përkundër divergjencave që kishin për çështje të ndryshme.

ISBN 978-9989-150-96-8
Shënimet per CIP katalogizimin
gjenden në BPU-Shkup

Të gjitha të drejtat janë të autorit. Publikimi i pjesshëm apo i plotë pa lejen e tij është i paligjshëm.

PËRMBAJTJA

HYRJA.....	8
PJESA E PARË – GJENOCIDI NË KOSOVË.....	15
KAPITULLI I PARË.....	17
PROLOGU I KAPITULLIT TË PARË	17
«Krematori gëlqeror»!.....	18
Nga «Krematori i Kleçkës» te «imazhet e kukullave»!	29
Avullimi i «Krematorit të Kleçkës»!	34
Civilë serbë me emra e pa mbiemra, madje edhe pa emra e pa mbiemra!	39
EPILOGU I KAPITULLIT TË PARË.....	46
Shpërtheu muri i heshjes serbe për krimet në Kosovë	46
KAPITULLI I DYTË.....	51
PROLOGU I KAPITULLIT TË DYTË	51
Te kafeneja «Panda»!.....	52
«Bombaşi»-t e UÇK-së!.....	54
Çka e mundonte ndërgjegjen e Milošević-it?	58
Kush urdhëroi vrasjen dhe kush ekzekutoi krimin?.....	59
EPILOGU I KAPITULLIT TË DYTË.....	65
Eskadronët e vdekjes	65
KAPITULLI I TRETË.....	73
PROLOGU I KAPITULLIT TË TRETË	73
Lufta dhe «gënjeshttra mediatike».....	75
Demaskimi dhe trysnia ndërkombëtare.....	89
Kriminelët kthehen në vendin e krimit!	91
Konferenca e Rambouillet-së	94
Plaçkitës me uniforma të UÇK-së!.....	101
Rezultatet e ekspertëve mjekoligjorë dhe Betimi i Hipokratit!	115

Manipulim mediatik apo mediatizim i manipulimit?	144
Manipulimi kronik i «Masakrës së Reçakut»	154
Protagonistët e krimit.....	162
EPILOGU I KAPITULLIT TË TRETË.....	178
KAPITULLI I KATËRT.....	183
PROLOGU I KAPITULLIT TË KATËRT	183
Dëshira për “pak bombardime”!.....	185
Të «drejtat e njeriut» dhe «parimi i sovranitetit të shteteve»	189
EPILOGU I KAPITULLIT TË KATËRT.....	206
«Edhe unë gjithashtu ndihem shqiptar»- Vaclav Havel	206
KAPITULLI I PESTË	209
PROLOGU I KAPITULLIT TË PESTË.....	209
Ujku në lëkurën e qengjit!	209
Spastrimi etnik i Kosovës dhe operacioni «Patkoi»	211
Kosova-Teatër me dyer të mbyllura!	235
Kush e farkoi «Patkoin»?	241
EPILOGU I KAPITULLIT TË PESTË	257
«Pranverën e Bartolemeut kosovar 1999»	257
KAPITULLI I GJASHTË.....	259
PROLOGU I KAPITULLIT TË GJASHTË	259
Masakër apo holokaust?	259
«Spastrimi etnik» dhe gjenocidi.....	260
EPILOGU I KAPITULLIT TË GJASHTË.....	303
«Në greminën e vdekjes»	303
KAPITULLI I SHTATË.....	307
PËRCAKTIMI I STATUSIT FINAL TË KOSOVËS.....	307
PROLOGU I KAPITULLIT TË SHTATË.....	307
Prania ndërkombëtare në Kosovë	308
«Standardet para statusit»	310
Kryeministri Haradinaj dhe Carla Del Ponte	313
Status quo-ja dhe statusi final i Kosovës.....	319
Negociatat e Vjenës.....	321
Dëjã vu në Rambuje: Vazhdimi i negociatave! Edhe 120	
ditë negociata!	333
Përfundimi i negociatave për statusin politik të Kosovës	336

Statusi final i një territori dhe qëndrimi restriktiv i Këshillit të Sigurimit.....	343
Shpallja e pavarësisë së Kosovës	347
Reagimet e Serbisë për vendimin e Kuvendit të Kosovës.....	353
Reagimet diplomatike të Serbisë	359
Reagimet e huaja ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	370
«Jeta përbëhet nga detajet, por një detaj mund të ndryshojë një jetë»	384
EPILOGU I KAPITULLIT TË SHTATË.....	390
PJESA E DYTË – KUMBARIA E «MAFIES SHQIPTARE».	395
KAPITULLI I PARË.....	397
PROLOGU I KAPITULLIT TË PARË	397
«Librat e bardhë» dhe strategjia e nxirjes së shqiptarëve!	399
UÇK-ja dhe «fondamentalizmi islamik»	403
UÇK-ja dhe “ideologjia marksiste-leniniste”	409
UÇK-ja dhe «krimi i organizuar»	413
UÇK-ja dhe «mafia shqiptare».....	420
Strukturat e mafies shqiptare sipas “Librit të Bardhë”	424
Kumbaria e «mafies shqiptare»	430
Carla Del Ponte dhe “trafikimi i organeve njerëzore në Kosovë”	446
EPILOGU I KAPITULLIT TË PARË.....	454
KAPITULLI I DYTË.....	455
PROLOGU I KAPITULLIT TË DYTË	455
“Dëshmitari okular i trafikimit me organet e serbëve të rrëmbyer nga UÇK-ja”	458
Raporti i Dick Marty-t	457
Dick Marty dhe trafikimi i paligjshëm me organet njerëzore	467
Reagimet lidhur me Raportin e Dick Marty-t	473
Në kërkim të provave për tregtinë me organe njerëzore.....	478
«Anatomia e krimit».....	482
Zemra rrihte ende.....	485
EPILOGU I KAPITULLIT TË DYTË.....	493
Marrëzja e Prokurorisë serbe për krime lufte.....	493

KAPITULLI I TRETË.....	499
PROLOG I KAPITULLIT TË TRETË.....	499
Vrasja, rrëmbimi dhe zhdukja e civilëve në luftën e Kosovës	504
«Gënjeshtër çmohet më shumë se e vërteta: pothuajse të gjithë janë gati ta besojnë» Paul Léautaud.....	514
E vërteta e plotë për këto ngjarje!.....	526
Në vend të përfundimit.....	550
Bibliografi e pjeshme	561

PARATHËNIE

Botimi i librit autobiografik të Carla Del Ponte-s, të titulluar «Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës» tri javë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës pati efektin e një bombe mediatike.

Nga libri i saj mediat veçuan thënien se gjoja Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një “ndërmarrje kriminale që kishte rrëmbyer më shumë se 300 serbë, romë, shqiptarë dhe pjesëtarë të grupeve tjera etnike, të cilëve u kishin hequr organet vitale për t'i shitur në klinika jashtë shtetit”!

Publikimi i kësaj teme në librin e Prokurores së Përgjithshme të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish–Jugosllavinë mobilizoi të gjitha qarqet që kishin qenë të përfshira në denoncimin e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër Serbisë.

Në librin tim do të përqendrohem në ndriçimin e kontekstit historik kur u sajua çështja e tregtisë me organe njerëzish, nga kush dhe për cilat qëllime u krijua kjo gënjeshtëri.

Hedhja dritë mbi këto aspekte do të na mundësojë të shohim motivet e vërteta të aktualizimit të kësaj çështjeje. Do të shohim pse këto motive nuk janë të ndara nga qëndrimet politike dhe ideologjike të atyre që ndërhyrjen ushtarake për ndërprerjen e politikës së gjenocidit në Kosovë e shohin si “pretekst të amerikaneve për të sunduar Evropën”! Përkundrazi, «antiamerikanizmi» si verbërim ideologjik bëri që një numër i konsiderueshëm komunistësh, socialistësh, social-demokratësh, të së djathtës të vjetër e të re, neonazistë dhe neofashistë, historianë e politologë, filozofë e sociologë, gazetarë e publicistë, të orientimit të djathtë e të majtë të mobilizohen në “mbrojtje të Evropës nga imperializmi amerikan.”

Zhvendosja e vëmendjes nga realiteti tragjik me të cilin ishin ballafaquar shqiptarët e Kosovës në rrafshin e krimit të organizuar

ishite e pandashme nga strategjia e fshehjes së gjurmëve të krimit të gjenocidit.

Për të demaskuar manipulimin që përdorin mohuesit e gjenocidit në Kosovë më është dashur të sjell për lexuesin konventat ndërkombëtare që përbëjnë bazën juridike të së Drejtës Penale Ndërkombëtare. Vetëm në këtë mënyrë sqarohet pse spastrimi etnik, dhuna seksuale dhe vrasjet që kishin për qëllim shkatërrimin e tërësishëm apo të pjesshëm, fizik ose biologjik të shqiptarëve të Kosovës, si të tillë, përbëjnë gjenocid. Kjo na mundëson të shohim pse fshehja e gjurmëve të krimeve dhe mohimi i qëllimit të pushtetit për të shkatërruar shqiptarët e Kosovës është pjesë e pandashme e sistemit që synon shkatërrimin e të vërtetës për gjenocidin.

I vetëdijshëm se vrasja e civilëve të pafajshëm gjatë konflikteve të armatosura mobilizon institucionet ndërkombëtare, ato regjionale si dhe mijëra organizata joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, regjimi i Milošević-it aplikoi një strategji të “re” në luftën e Kosovës!

Vrasjen e civilëve, të cilën nuk e mohonte askush, ua veshi shqiptarëve. Në funksion të kësaj strategjie Sigurimi Shtetëror i Serbisë përgatiti materialin e titulluar «Libri i Bardhë: Terrorizmi i separatistëve shqiptarë në Kosovë dhe në Metohi», të cilin e botuan të përkthyer në gjuhën angleze dhe në gjuhën frënge, në shtator të vitit 1998. Këtë material propagandistik Ministria e Punëve të Jashtme ua shpërndau falas institucioneve me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare, institucioneve shtetërore të shteteve anëtare të OKB-së, mediave ndërkombëtare, bibliotekave universitare dhe personaliteteve me peshë në fusha të ndryshme intelektuale.

Versioni i këtij «Libri të Bardhë» u ribotua nga regjimi i Milošević-it në vitin 1999 dhe në vitin 2000, ndërsa në vitin 2001 dhe 2003, në përputhje me ndryshimin e konteksteve politike ndërkombëtare, u publikua i plotësuar dhe i modifikuar nga regjimi i “ri” i Beogradit.

Si rezultat i kësaj strategjie lindën divergjenca të mëdha rreth temës se cilët ishin civilët e vrarë dhe kush i vriste ata.

Për këtë arsye, tri kapitujt e parë të Pjesës së Parë të librit tim që trajton çështjen e gjenocidit në Kosovë, i kushtohen tri rasteve me të mediatizuara të vrasjes së civilëve: «Rasti i Kleçkës», «Rasti në kafenenë Panda» dhe «Rasti i Reçakut».

Ndriçimi i këtyre tri rasteve dhe vrasjet gjatë operacionit «Patkoi» mundësojnë të shihen të gjitha pasojat e luftës në Kosovës si rezultat i politikës së gjenocidit që zbatoi shteti serb ndaj shqiptarëve.

Pjesa e Parë e librit tim ndriçon kontekstin shoqëror dhe historik që ndikoi në angazhimin e një numri intelektualësh të ndikuar nga këndvështrimi ideologjik i «antiamerikanizmit» që të hyjnë në procesin e shpërndarjes së «produkteve» të sajura nga shërbimet sekrete serbe.

Në Pjesën e Dytë të librit tim, që i kushtohet «kumbarisë» si formë e marketingut në shpërndarjen e propagandës serbe, një vend i rëndësishëm i kushtohet zhveshjes së tendencave për ta paraqitur shoqërinë shqiptare si shoqëri që funksionon sipas modelit feudal (klaneve). Përmes kësaj mënyre regjimi i Milošević-it përcaktonte modelin e interpretimit të asaj që ndodhte në Kosovë. Ngushtësisht e lidhur me cilësimin e shoqërisë shqiptare si «shoqëri klanore» u sajua nocioni «mafia shqiptare» si ndërlihdje e aspiratave politike me krimin e organizuar. Fatkeqësisht, kjo formë e stigmatizimit të UÇK-së si organizatë “mafioze” pati ndikimin e vet në qarqet e lartpërmendura intelektuale. Siç do të shohim, nga libri i Xavier Raufer-it «Mafia shqiptare: kërcënim për Evropën» i botuar në vitin 2000 e deri te libri i Pierre Péan-it i titulluar «Kosova: një luftë e “drejtë” për një shtet mafioz» i botuar në vitin 2013, miliona shkrime stigmatizojnë luftën e popullit shqiptar të Kosovës si të ishte “luftë për të kontrolluar rrugët e tregtisë së drogës, prostitucionit, veturave të vjedhura ... ndërsa serbët jepen si viktimat të agresionit imperialist amerikan.”

Ndikimi i «librave të bardhë» ishte i pakontestueshëm. Mjafton t'i hedhim një sy internetit dhe të shohim se vetëm në

gjuhën frënge mbi dhjetë milionë rezultate shfaqen ku Kosova paraqitet si “parajsë e mafies”!

Përmasat e kësaj propagande kanë shkuar deri në atë shkallë sa regjisori i njohur me origjinë serbo-muslimane Emir Kusturica, në një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Filozofik të Nishit, deklaroi se kohët e fundit “ishin xhiruar shumë filma për Serbinë dhe për serbët” dhe se “këta filma të këqij, të mbështetur mbi ngjarje të trilluara, kanë ndikuar që bota të ketë një imazh të keq për serbët, si popull gjenocidar. Kjo është propagandë e tmerrshme!”¹

Nga të gjithë filmat për këtë temë, Kusturica veçoi pjesëmarrjen e aktorëve të mëdhenj të Holliwood-it: Richard Gere-in, Penelope Cruz-in dhe Angelina Jolie. “Edhe pse janë yje shumë të mëdhenj të kinematografisë, filmat janë shumë të këqij, katastrofikë e të mos flas për filmin e Angelina Jolie-së «Në vendin e mjaltit dhe të gjakut». Janë filma të dështuar, sepse nuk bëhet vepër e madhe mbi bazën e materialeve të rrejshme!”²

Ky regjisor me famë botërore, laurat i dyfishtë i Festivalit të Filmit në Cannes, theksoi se Kosova është temë e denjë për letërsi e filma dhe se deri tani nuk ishte bërë asgjë. Ai paralajmëroi se do të xhirojë “një film për tregtinë me organet e njerëzve në Kosovë, si njërën nga temat më të mëdha të këtij shekulli, aktin më brutal dhe treguesin e fuqishëm të kthimit në periudhën pagane.”³

Kam bindjen e plotë se në fund të këtij libri lexuesi do të jetë në gjendje të shohë nëse janë të trilluara ngjarjet e filmave që Kosturica i apostrofon si “tepër të këqij” apo realiteti është shumë më tragjik se pasqyrimi në filmat e deritashëm.

¹ Vesti, «Kusturica planira film o trgovini organima na Kosovu» (Kosturica planifikon një film për tregtinë me organe në Kosovë), 2 prill 2013
<http://www.balkaninsight.com/rs/article/kusturica-planira-film-o-trgovini-organima-na-kosovu>

² Po aty

³ Alo.rs, «Kusturica: Narednih godina snimaću film o trgovinu organima!», 31 mars 2013
<http://www.alo.rs/vesti/aktuelno/kusturica-narednih-godina-snimacu-film-o-trgovinu-organima/14724>

Përshkrimi i ngjarjeve trishtuese dhe fotot e tmerrshme nuk janë sjellë për të ilustruar se sa të këqij ishin ata që aplikuan gjenocidin në Kosovë. Këto ngjarje janë përmendur në kontekstin e polemikave ndaj «negacionistëve» që mohojnë vërtetësinë e këtij gjenocidi. Emir Kusturica ka plotësisht të drejtë kur thotë se Kosova është një temë e denjë për letërsi e filma. Të gjithë të interesuarit për këtë çështje do të gjejnë në librin tim shtegun e materialeve për të shkruar vepra me vlerë. Nëse Kusturica lexon këtë libër, do të bindet se me tema të trilluara dhe materiale të rrejshme për tregtinë me organe njerëzish nuk bëhet vepër e madhe. Përkundrazi, me sajime të tilla përpiqet të mbajnë gjallë MASHTRIMIN E MADH me opinionin publik.

Çdokush që do ta lexojë këtë libër do të kuptojë se kush e sajoi gënjeshtren për “trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin kundërligjor me organe njerëzish në Kosovë”; do ta kuptojë se kush qëndron prapa vrasjes së civilëve në Kosovë dhe se çka përmbajnë listat e krimeve që i vishen UÇK-së...

Gjatë tërë librit, në argumentimet e mia u shmangem në maksimum referencave të burimeve shqiptare. Jo se këto burime janë më pak të besueshme në raport me burimet tjera, por për të shmangur mundësinë që kjo analizë të shihet si konfrontim i dy vizioneve: vizionit shqiptar për atë që ndodhi në Kosovë, përballë vizionit serb. Kam bindjen e plotë se lexuesi do të shohë zbulimin e së vërtetës duke zhveshur “të vërtetën serbe” për këtë rast. Për këtë arsye, një vend shumë i madh do t’u lihet interpretimeve serbe dhe konfrontimit të këtyre interpretimeve me dëshmitë dhe rezultatet e publikuara nga organizata joqeveritare serbe dhe nga intelektualë serbë që nuk u pajtuan me politikën e gjenocidit serb në Kosovë.

Autori

PJESA E PARË

GJENOCIDI NË KOSOVË

KAPITULLI I PARË

PROLOGU I KAPITULLIT TË PARË

“Terroristët e të ashtuquajturës Ushtri Çlirimtare e Kosovës shkëputën nga duart e nënës dhe të gjyshes së saj Jovana-n njëmbëdhjetëvjeçare. E dhunuan para syve të shumë serbëve të plagosur, të lidhur dhe që nuk kishin mundësi të bënin asgjë. E dhunuan në sy të nënës e të gjyshes së saj, e munduan tmerrësisht dhe në fund, Jovana-n e vogël, e dogjën në Furrën e Gëlqeres në Kleçkë!

Nëna e saj ulërinte nga tmërri! Ajo mbeti duke thirrur emrin e Jovana-s dhe vdiq me emrin e saj në gojë. Prandaj edhe kriminelët shqiptarë e kuptuan se si quhej kjo vogëlushe para se ta hidhnin në zjarr dhe ta digjnin të gjallë. Edhe gjyshes i pëlciti zemra nga mërzia dhe vdiq.

Kur mbërritëm në vendin e ngjarjes dora e Jovana-s ende nxirrte tym. Pjesa tjetër e trupit ishte karbonizuar tërësisht, ndërsa dora e saj e vogël sikur kërkonte ndihmë ose sikur përshëndeste nënën dhe gjyshen e saj.

Që nga ajo ditë e deri më sot jam duke kërkuar mbiemrin e saj, por më kot!”

Slavko Nikić, *Nulta Krvna Grupa*, f. 10-11

Shpresoj se në fund të këtij kapitulli lexuesi do të ketë mundësi të gjykojë për vërtetësinë e përshkrimit dramatik që i bën koloneli i Policisë së Serbisë, Slavko Nikić-i, njërit prej rasteve më të mediatizuara të luftës së Kosovës. Le të vlerësojë lexuesi: A ishin ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ata që vranë, që gjymtuan dhe që masakruan njerëz të pafajshëm apo shpërndarja e

interpretimeve të tilla u bë me qëllim që të fshihen gjurmët e krimin të vërtetë!?

«Krematori gëlqeror»!

Gusht 1998

Imazhe dhe lajme nga lufta në Kosovë janë në fokus të mediave më me influencë në botë. Vendbanime shqiptare në flakë, mijëra të vrarë, dhjetëra mijëra të plagosur, gra të dhunuara, qindra mijë civilë të zhvendosur... Skena të tmerrshme *déjà vu* në luftën e Bosnjës dhe në luftën e Kroacisë! Skena që bënë të dëgjoheshin gjithnjë e më tepër kërkesat “për t’i dhënë fund makinerisë vrastare të Milošević-it”, kërkesa “për të dënuar politikën nacional-socialiste të tipit hitlerian të Milošević-it”, kërkesa “për të ndërhyrë urgjentisht me ndërhyrje ushtarake të NATO-s”, si masë parandaluese për të shmangur përsëritjen e «Gjenocidit të Srebrenicës»...

Më 26 gusht, ndërmjet fshatrave Topillë e Grejçec, në një traktor, që ishte duke ikur nga zona e luftimeve, forcat e armatosura serbe vranë 11 anëtarë të familjes Asllani nga fshati Rancë e Komunës së Shtimes, ndërsa tre persona u plagosën. Nga 11 të vrarët, tetë persona ishin fëmijë të moshës që shkonte nga gjashtë muaj deri në trembëdhjetë vjeç (Albiona Asllani, e lindur në vitin 1998, Antigona Asllani - 1997, Xhafer Asllani - 1995, Shpend Asllani - 1993, Luljeta Asllani - 1991, Ejup Asllani - 1988, Lumnije Asllani - 1986, Burim Asllani - 1985) dhe tri gra (Ajshe Asllani - 1971, Halide Asllani - 1968, Jalldyze Asllani - 1934)¹.

Kjo masakër pati jehonë të madhe në shtypin botëror dhe nuk munguan reagimet e institucioneve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë kapitull po kufizohem vetëm në reagimin e UNICEF-it.

¹ Përkujtohen anëtarët e familjes Asllani të Rancës
<http://kk.rks-gov.net/shtime/News/PËRKUJTOHEN-ANËTARËT-E-FAMILJES-ASLLANI-TË-RANCËS.aspx>

Zyrtari i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e fëmijëve - UNICEF, Patrick McCormick deklaroi se "masakra mbi njëmbëdhjetë anëtarët e një familjeje shqiptare, në mesin e të cilëve ishin tetë fëmijë, shkaktoi pezëm dhe indinjatë të thellë në organizatën tonë..."¹

Përballë implikimeve diplomatike, që mund të kishin për pasojë reagimet e institucioneve ndërkombëtare ndaj dhunës në Kosovë, dhe "me qëllim të neutralizimit të revoltës së opinionit publik ndërkombëtar, një ditë pas kësaj vrasjeje makabre, propaganda serbe plasoi "krimin e vëllezërve Mazreku"². Ky konstatim i Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë vuri theksin në kontekstin politik dhe mediatik të inskenimit të njërit nga proceset e montuara gjyqësore që pati jehonë shumë të madhe.

Më 27 gusht, gazetarët serbë dhe ata ndërkombëtarë, të shoqëruar nga forca policore dhe nga gjykatësja hetuese e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Danica Marinković-i, vizituan "repartin ushtarak të UÇK-së" në fshatin Kleçkë, që e kishin marrë në duart e veta forcat serbe.

Zëdhënësi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Božidar Filić-i, tha në mënyrë ironike se gjatë kësaj vizite gazetarët patën mundësi të shihnin "strehimoret dhe depot e UÇK-së të mbushura me ushqime të konservuara *made in USA* dhe me veshmbathje, që kishin ardhur si ndihmë humanitare për civilët shqiptarë të rrezikuar nga kriza humanitare."³

Pas vizitës së "strehimoreve" dhe të "depove të armatimit", për të cilat ironia shkoi deri në atë shkallë sa u tha se nuk e dinin nëse kishin ardhur në Kosovë s"si ndihma humanitare nga shtetet perëndimore"⁴, gazetarët u orientuan drejt epilogut të spektaklit: «Krematorit të Kleçkës»!

¹ Qendra për Informim e Kosovës – Kosova Information Center, Prishtinë, 31 gusht 1998, Informatori ditor nr. 2167 B.

² *NUNS-ova krivična prijava protiv novinara*, në:

<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=875112&print=yes>, f.11

³ Glas Javnosti, «Svedočenje Bekima Mazreku», (Dëshmia e Bekim Mazrekut) shih artikullin në online: <http://www.glas-javnosti.rs/clanak/glas-javnosti-20-04-2008/krematorijum-u-klecki>;

⁴ Po aty

Gjykatësja Marinković u sqaroi gazetarëve, se “pasi ishin mbajtur në kushte çnjerëzore, në stalla kafshësh, të lidhur me zinxhirë, të keqtrajtuar mizorisht civilët e rrëmbyer serbë u transferuan nga njëri kamp në tjetrin, nga «Llogori i Krajmirovcit», në «Llogorin e Llapushnikut», për të përfunduar në «Kampin e Kleçkës».”¹

“Pas mundimeve të shumta, civilët e rrëmbyer janë ekzekutuar, ndërsa trupat e tyre janë hedhur në gropë gëlqereje brenda furrës për të vetmen arsye se ishin serbë apo shqiptarë besnikë ndaj regjimit të Serbisë! (...) Disa civilë të rrëmbyer, pas mizorive të përjetuara, janë hedhur të gjallë në gropë gëlqereje...”² - vazhdoi fjalimin e vet Danica Marinković-i.

“Një sasi eshtrash, kryesisht të mëdhenj, që nuk kishin mundur të digjeshin as nga vala e nxehtë e gëlqeres që shuhej bashkë me jetën e civilëve serbë, u gjetën të groposur në afërsi të furrës (...) Mbetje eshtrash dhe telat me të cilat terroristët shqiptarë i kishin lidhur dhe tërhequr serbët deri në furrën e gëlqeres, u gjetën edhe në gropë të «furrës – kremator»³- sqaroi gjykatësja hetuese në këtë konferencë gazetarësh të pazakontë!

Fjala është për një furrë ku shuhej gëlqerja⁴ në afërsi të së cilës policia serbe kishte ekspozuar mbetje të eshtrave të “civilëve serbë të djegur”.

Forma e njëjtë e ironisë që u përdor për armët e “konfiskuara” u përdor edhe për prejardhjen e “gëlqeres së krematorit shqiptar”. Konkretisht u tha se “nuk e dinin nëse ishte gëlqerja prodhim vendor apo ishte sjellë si ndihmë humanitare!”⁵

¹ Večernje Novosti, «Dželati sa Klečke», (Xhelatët e Kleçkës), shih artikullin në: <http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/dosije/aktuelno.292.html:211412-Dzelati-sa-Klecke>;

² Злочини албанских терориста 1995-1998, Приштина, 1999, f.73-76 (Krimet e terrorizmit shqiptar 1995-1998)

³ По ату,

⁴ Në atë pjesë të Kosovës mund të gjenden me qindra furra të tilla sepse shitja e gëlqeressë shuar ishte profesioni kryesor i shumë fshatarëve të këtyre fshatrave.

⁵ По ату



Furrë gëlqereje që u prezantua si “kremator”



Mbetje eshtrash të personave të vrarë

Për të qenë bindëse në informatat që u jepeshin gazetarëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë, kjo gjykatëse hetuese informoi se “krahas provave materiale të gjetura në vendin e krimit, ishin arrestuar dy ushtarë të UÇK-së (Luan dhe Bekim Mazreku), të cilët konfirmonin detajet e këtij krimi të përbindshëm!” Në këtë kontekst, hetuesja Marinković improvizoi marrjen në pyetje të Bekim Mazrekut në prani të gazetarëve, sepse ”Luani nuk kishte mundur të vinte për shkaqe shëndetësore”.

Gjatë marrjes në pyetje drejtpërsëdrejti para kamerave dhe mikrofonave të gazetarëve¹, Bekim Mazreku deklaroi se grupi i tij i përbërë prej rreth 20 ushtarësh të UÇK-së kishin pushkatuar dy fëmijë të moshës 7, 8 deri 11-vjeçarë, tri gra të moshës 28-32-vjeçare, dy djem të ri dhe tre burra, që paraprakisht i kishin rreshtuar në varg dhe i kishin pushkatuar. Këtë e kishin bërë me urdhër të Fatmir Limajt, Gani Krasniqit dhe Ismet Kilajt. Në pyetjen e hetueses Marinković se kush ishte Fatmir Limaj, Bekim Mazreku ishte përgjigjur se “Fatmir Limaj ishte komandant i Kleçkës (sic!)², ndërsa dy të tjerët komandantë të Malishevës!”

¹ Një pjesë të kësaj forme të marrjes në pyetje nga gjykatësja hetuese serbe ka mbetur në KOSOVO NWOCCUPATION, <http://www.youtube.com/watch?v=5BjZVM8r4a4>

Deklaratat e mëposhtme të Bekim Mazrekut janë nxjerrë nga ky incizim.

² Fatmir Limaj ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së e jo komandant i një fshati. Kjo dëshmon se sa pak kanë qenë të informuara strukturat e pushtetit serb për organizimin e UÇK-së.

Duke mos ditur se si të përgjigjej lidhur me pyetjen për fatin e kufomave të civilëve që pretendohet se ishin ekzekutuar, Bekim Mazreku deklaroi se “nuk dinte se çka kishte ndodhur më pas, sepse ata na përzunë nga vendi i ngjarjes.”¹

Bekim Mazreku dukej tejet i hutuar para gazetarëve dhe nuk ishte aq bindës sa dëshironte organizatorja e kësaj “konference për shtyp”. E pakënaqur nga përgjigjet e Bekim Mazrekut, gjykatësja Marinković ndërpreu marrjen në pyetje të të akuzuarit!



Bekim Mazreku dhe gjykatësja hetuese Danica Marinković gjatë rikonstruktimit të ngjarjes

¹ KOSOVO NWO OCCUPATION



„Seancë hetuese“ publike: Bekim Mazreku, me duar të lidhura prapa shpine, në konferencën për gazetarë, merret në pyetje nga Danica Marinković

Për të përmirësuar lëshimet e deklaratave të para publike, në të njëjtën ditë, Bekim Mazreku i dha një intervistë ekskluzive gazetarit për çështje ushtarake, Milovan Drecun-it, që u përgatit me kujdes nga kameramani Tomislav Magoč-i dhe u transmetua në televizionin shtetëror të Serbisë, më 29 gusht 1998.

Sikur nuk mjaftuan dy prezantimet e mëparshme publike, qendra mediatike e kontrolluar nga pushteti i Milošević-it «Media Centar» organizoi paraqitjen e tretë të Bekim Mazrekut para gazetarëve vendës dhe të atyre ndërkombëtarë.

Pas këtyre paraqitjeve të “dëshmitarit që pranonte se kishte kryer krime kundër civilëve serbë”, Bashkimi i Gazetarëve të Serbisë u drejtoi një letër organizatave të gazetarëve të shteteve të ndryshme të botës, përmes të cilës “kërkohej nga gazetarët që të vinin menjëherë në Kleçkë dhe t’u dërgonin raporte agjencie të tyre për atë se çka bënin shqiptarët e uniformuar dhe të armatosur deri në dhëmbë, për çka luftojnë ata, kush i armatos, kush i përgatit, kush i ushqen dhe kush i mbështet që me krematorë, me

thika, me plumb dhe me gëlqere të realizojnë gjenocidin ndaj serbëve në Kosovë.”¹

Krahas manipulimit me deklaratën e “dëshmitarit” propaganda serbe manipulonte edhe me numrin e viktimave. Fillimisht u propagandua për qindra civilë të vrarë, por, deklarata publike e Bekim Mazrekut për 10 të vrarë e relativizoi numrin e të vrarëve sa edhe mediat shtetërore u shtrënguan të përmendnin shifra më të vogla se shifrat e publikuara më parë. Pas disa ditë manipulimesh, Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, me një komunikatë, përmbylli rezultatin e hetimeve dhe shpalli shifrat përfundimtare për “22 civilë serbë të vrarë dhe të djegur në krematorin gëlqeror.”²

Përveç propagandës për raste të veçanta të “aksioneve terroriste të separatistëve shqiptarë”, siç ishte rasti për të ashtuquajturin «Kremator i Kleçkës», në të gjitha vendet me peshë në skenën politike ndërkombëtare misionet diplomatike të Jugosllavisë kishin shpërndarë materialet e përgatitura nga Shërbimi Sekret Serb. Përmes këtyre materialeve, UÇK-ja stigmatizohej si organizatë “terroriste dhe me pikëpamje të fundamentalizmit islamik.”

Madje, për të mbështetur tezat e lartpërmendura, në materialet propagandistike silleshin “prova dhe fakte”! Sipas të dhënave të shpërndara nga ky shërbim “në Konferencën e 18-të Islamike” të mbajtur në Pakistan në vitin 1998, separatizmi shqiptar në Kosovë ishte cilësuar si “xhihad”, dhe se gjoja nga kjo konferencë ishin ftuar të gjitha “vendet myslimane për çlirimin e territoreve të pushtuara myslimane!”³

¹ Владислав Б. Сотировић, «Prvi krematorijum u Evropi nakon Aušvica» (Krematoriumi i parë në Evropë pas Auschwitz-it)
<http://www.krajinaforce.com/forum/index.php?/topic/4128-prvi-krematorijum-u-evropi-nakon-au%C5%A1vica/>

² Vepra e cituar *Злочини албанских терориста ...*, f.73-76

³ Vlada Srbije: Bela knjiga o albanskom terorizmu
<http://fr.scribd.com/doc/63883383/Vlada-Srbije-Bela-knjiga-o-albanskom-terorizmu-2003-opsti-deo>
Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji
<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

Sipas kësaj propagande, “një numër islamikësh fanatikë nga Afganistani, Algjeria, Egjipti, Çeçenia, Irani dhe nga vende të tjera u përfshinë në shtabet e njësisve komanduese të UÇK-së në Kosovë dhe ishin angazhuar si instruktorë për stërvitje speciale ushtarake të disa formacioneve të UÇK-së.”¹

Në përputhje me kontekstin e ri të krijuar pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, Qeveria e Serbisë i rishpërndau materialet e lartpërmendura të Shërbimit Sekret Serb të plotësuar edhe me “të dhëna” të reja dhe të titulluar “Libri i bardhë - Terorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar në Kosovë dhe Metohi.”²

Kjo temë do të trajtohet hollësisht në pjesën e dytë të këtij libri. Tani për tani po kufizohem vetëm në faktin se propaganda e tillë e regjimit të Beogradit për “instruktorë të fundamentalizmit islamik, që stërvitnin ushtarët e UÇK-së”, nuk gjeti mbështetjen e atyre që synonin përpiluesit e kësaj strategjie. Pos në disa raste të shkrimeve gazetareske, ku shihet ndikimi i kësaj propagande, përpjekjet për të paraqitur UÇK-në si “organizatë terroriste me pikëpamje të fundamentalizmit islamik” kishin dështuar tërësisht. Zhgënjimin serb për këtë dështim e shprehu publikisht ministri i Informacionit të Republikës së Serbisë, Goran Matić-i. Në gazetën «Medjunarodna politika»³ ai deklaroi se “është e pabesueshme se si fundamentalistët islamikë cilësohen si terroristë vetëm kur vrasin amerikanë. Ndërsa kur vrasin qytetarë të pafajshëm të Jugosllavisë ata kualifikohen si luftëtarë të drejtësisë.”⁴

Më 29 gusht 1998 agjencia e lajmeve «Reuters», botoi artikullin e gazetares së vet Julijana Mojsilović nga Beogradi, në të cilin theksohet se “ministri i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë i cilësoi vrasjet në Kleçkë si krimet më të rënda dhe më mizore të kryera nga UÇK-ja. Ai u bëri thirrje qeverive të shteteve perëndimore që ta dënonin rastin...”⁵ Korrespondenti i «Agjencisë

¹ Po aty

² Pjesët e sipërme që stigmatizojnë UÇK-në janë marrë nga kapitulli për “faktorin panislam” f. 40-44 të kësaj përmbledhjeje.

³ Përkthimi shqip: Politika ndërkombëtare.

⁴ Radio Yugoslavia, «Double standard?», <http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-2.html>

⁵ «Kosovo Albanian rebel says killed Serb civilians» <http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-3.html>

France Presse» njoftonte nga Beogradi se jo vetëm ministri i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, por të gjithë zyrtarët jugosllavë e përshkruanin “masakrën e Kleçkës” si “një nga krimet më të rënda të bëra ndaj serbëve në Kosovë, duke tentuar ta përdorin si çështje të mundshme që duhej të trajtohej edhe nga Gjykata për Krime Luftë e Kombeve të Bashkuara.”¹

Krahas ministrave dhe zyrtarëve të lartë shtetërorë, edhe organizatat “joqeveritare” të kontrolluara nga qeveria serbe dolën me qëndrime të ashpra kundër këtij “krimi”. Kështu, Shoqata serbe e Robërve të Luftës së Dytë Botërore, anëtarët e së cilës kishin kaluar nëpër kampet naziste, “dënoi krimet e tmerrshme të kryera në Kleçkë nga terroristët shqiptarë.”² Sipas kësaj shoqate “për të humbur gjurmët e këtij akti çnjerëzor terroristët shqiptarë dogjën trupat e 22 civilëve serbë në një kremator të improvizuar. Në çmendurinë e tyre kriminale ata aplikuan recetat e nazistëve të Auschwitz-it, Buchenwald-it, Dachau-t, Mauthausen-it, Bergen-Belsen-it (...) dhe të mijëra kampeve të tjera të Rajhut të Tretë.”³

Si kundërpërgjigje ndaj kërkesës së institucioneve ndërkombëtare që të dënohej gjenocidi në Srebrenicë, kërkesa të shumta i vërshuan mediat serbe, nëpërmjet të cilave kërkohej që këto institucione të merrnin në shqyrtim «Krematorin e Kleçkës».

“Ekzistojnë fakte të panumërta, që askush nuk mund t’i hedhë poshtë, lidhur me funksionimin e krematorit të parë dhe deri tani të vetëm në Evropën e pas Auschwitz-it gjerman! I takon Parlamentit Evropian të zgjohet nga gjumi dhe me anë të një rezolute, qoftë edhe në mënyrë simbolike, të dënojë Auschwitz-in shqiptar. Të miratojë së paku një rezolutë me të cilën 27 gushti të shënohet si dita evropiane e krematorit gëlqeror!”⁴

¹ «Kosovo Albanian brothers sentenced to 20 years for terrorism» AFP, 18 April, 2001

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-Verdict.html>

² «A crime equal to those of the Nazis», 31 gusht 1998

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-reaction-3.html>

³ Po aty

⁴ Artikulli i cituar: «Prvi krematorijum u Evropi...»

Edhe mediat ndërkombëtare i kushtuan një vëmendje të rëndësishme asaj që nga propaganda serbe paraqitej si «Kremator i Kleçkës». Kështu, «BBC-ja» njoftonte se “autoritetet serbe dënuan masakrën e civilëve serbë, që e përshkruante si të kryer në stilin e nazistëve.”¹ Misha Savić-i i «Associated Press-it», në shkrimin e tij dedikuar ngjarjeve në Kosovë, informoi se “ekspertët mjekoligjorë serbë nxorën nga një kremator mbetje eshtrash të dhjetë civilëve serbë, në mesin e të cilëve ishin dy fëmijë.”² Edhe «The New York Times»³ sjell të njëjtat lajme të shpërndara nga Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë. Ndërsa «The Washington Times» tërhoqi vërejtjen se “në rast se ekspertët ndërkombëtarë të Mjekësisë Ligjore vërtetonin saktësinë e një krimi të tillë, kjo do të kishte pasoja shumë të mëdha për luftën e UÇK-së.”⁴

Propaganda serbe lidhur me «Krematorin e Kleçkës» pati ndikim edhe në rrafshin politik. Ndër reagimet e para politike ishte ajo e nënkryetarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ukrainasit Boris Olevnik-ut. Ai deklaroi se kjo ngjarje e kishte shokuar atë *week-end*. Sipas pohimeve të tij, gjatë vizitës në Kosovë, Boris Olevnik-u “kishte parë vetë se thëniet për fushatën shkatërrimtare serbe në Kosovë ishin gënjeshtër. Terroristët shqiptarë të Kosovës i kishin shtrënguar bashkëkombësit e tyre t’i braktisnin shtëpitë dhe të shkonin në pyll ose në ndonjë vend të largët, me qëllim që këto veprime t’u visheshin forcave serbe.”⁵ Në të njëjtën frymë, më 17 shtator 1998, deputetja holandeze e

¹ «Serbs condemn Nazi-style massacre of civilians»

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-4.html>

² «Police: Albanians Burned 22 Serbs», By Misha Savic, Associated Press writer, 29 August, 1998

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-5.html>

³ «Le New York Times SERBS ACCUSE separatists of Kosovo Mass killings», Sunday, 30 Aug 1998

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-6.html>

⁴ The Washington Times, Sunday, 30 Aug 1998, by Philip Smucker, « Police accuse KLA rebels of executing Serbian civilians Remains shown to reporters as prof»

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-7.html>

⁵ «I saw for myself...»,

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-reaction-2.html>

Parlamentit Evropian, Leonie Godefrieda Louisa van Bladel, shtroi pyetjen lidhur me fatin e “pengjeve” në Kosovë. Krahas pyetjes që i interesonte, ajo i informoi të pranishmit se “ndërkohë kemi kuptuar nga mediat ndërkombëtare, që raportuan të shtunën më 29 gusht, se UÇK-ja, në fshatin Kleçkë afër Prishtinës, kishte vrarë 22 persona (veçanërisht gra dhe fëmijë) dhe pastaj i kishte djegur në furrën e gëlqeres.”¹ Edhe Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial i Kombeve të Bashkuara kërkoi nga qeveria jugosllave ta informonte lidhur me situatën në Kosovë.

Në raportin, të cilin Qeveria e Jugosllavisë ia dorëzoi këtij organi të OKB-së më 26 janar 1999, në pikën 31 theksohej se “forcat serbe zbuluan një varrezë masive që përmbante trupat e civilëve serbë të rrëmbyer. Më 27 gusht 1998, në fshatin Kleçkë (Komuna e Lipjanit), policia gjeti hirin e 22 civilëve serbë të rrëmbyer, trupat e të cilëve terroristët shqiptarë i kishin djegur në një furrë gëlqereje pasi që i kishin vrarë. Dy terroristët që u burgosën (vëllezërit Luan dhe Bekim Mazreku) treguan në detaje dhe pranuan se i kishin kryer të gjitha krimet e lartpërmendura.”²

Krahas këtyre reagimeve, Agjencia serbe “Beta” njoftoi se gjatë vizitës së tij në Beograd, i dërguari special për Jugosllavinë, ambasadori amerikan, Christopher Hill-i, dënoi krimin që kishte ndodhur në Kleçkë. “Jemi të shokuar nga kjo që ka ndodhur dhe ne e dënojmë këtë formë të dhunës. Përgjegjësit duhet të arrestohen dhe të nxirren para drejtësisë”³ - u prononcua ai përpara gazetarëve. Krahas këtij diplomati amerikan, edhe Robert Doll-i⁴ u shpreh lidhur me këtë çështje. Gjatë vizitës që ato ditë i bëri Kosovës, Robert Doll-i kërkoi t’u lejohej ekspertëve të pavarur ndërkombëtarë që të hetonin se si kishte ardhur deri te ky krim i

¹ Question écrite E- 2797/98, posée par Leonie van Bladel (UPE) à la Commission, (17 septembre 1998).

² Kombet e Bashkuara, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial, CERD/C/364, 26 janar 1999, shih: [http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/\(Symbol\)/CERD.C.364.Fr?Opendocument](http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/(Symbol)/CERD.C.364.Fr?Opendocument)

³ «We are shocked and we condemn...»

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-reaction-1.html>

⁴ Kryetar i Komisionit Ndërkombëtar për Çështjen e Personave të Zhdukur në Territorin e ish-Jugosllavisë.

shëmtuar, kush e kishte kryer, sa ishte numri i të vrarëve etj. Reagimet në këtë frymë dhe kërkesat për të formuar një komision ekspertësh të pavarur për të hetuar këtë krim ishin të shumta. Por, gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i, ishte kategorikisht kundër! Nuk e pa të udhës një gjë të tillë, sepse “vendi i krimit, dy kriminelët e UÇK-së, armët e krimit, mjetet e krimit, mbetjet e viktimave ishin aty...”¹ Aty ishte edhe “Furra e gëlqeres - Krematori i Kleçkës”!

Nga «Krematori i Kleçkës» te «imazhet e kukullave»!

Mbështetja e propagandës serbe në dezinformata, si armë për manipulimin e opinionit publik, nuk mundi të fshihte realitetin tragjik të luftës në Kosovë. Për të pasur një pasqyrë vizuale të asaj se çka ndodhte në Kosovë në këtë kohë lexuesi mund të ndërpresë leximin dhe të shohë reportazhin² televiziv në gjuhën angleze. Brenda 6 minutash do të krijojë një ide për tmerret që zgjatën me muaj të tërë në Kosovë.

Nuk do ta lodh lexuesin me kronologjinë e tmerrit që përjetuan shqiptarët e Kosovës gjatë atyre muajve të luftës dhe nuk do t'i citoj të dhënat e detajuara që publikoi Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë. Do të kufizohem në sintezën tejet të shkurtër, që Joël Hubrecht i bëri kësaj periudhe. Në veprën e tij për Kosovën ai shkruan se “nga muaji shkurt e deri në shtator të vitit 1998 vlerësohen rreth 1000 civilë të vrarë, 800 të zhdukur dhe përafërsisht 380.000 të zhvendosur. Më 6 shtator, në Polluzhë të Rahovecit identifikohen 11 shqiptarë të vrarë (5 femra dhe 4 fëmijë). Më 26 dhe më 27 shtator, në dy ekzekutime: 32 viktima shqiptare. Në Gollubovc serbët ndanë nga një grup refugjatësh 14 burra dhe i ekzekutuan, ndërsa në malin afër fshatit Obri e Epërme/Gornje Obrinje, në një strehimore të improvizuar,

¹ Vepra e cituar *Злочини албанских терориста...* f. 75-76

² «The Gornje Obrinje massacre» (Masakra në Obri të Epërme)
<http://www.youtube.com/watch?v=feLTgvSSypg>

18 anëtarë të familjes Delija, të gjithë civilë, në mesin e të cilëve ishin 6 gra, 4 fëmijë dhe një foshnjë, u gjetën të ekzekutuar, secili me nga një plumb në kokë...”¹ Vazhdon përshkrimi i tmerreve të shumta!

Nga të gjitha krimet e kësaj periudhe, masakrimi i familjes Deliu nga Obria e Epërme pati jehonë shumë të madhe në mediat ndërkombëtare. Për të fshehur këtë krim të përbindshëm, propaganda zyrtare e Beogradit shpërndau gënjeshtren se gjoja imazhet e masakrës në Obri të Epërme ishin “montazh”.

Në mbështetje të kësaj ideje të regjimit të Beogradit doli edhe gazetari belg, Michel Collon-i. Sipas tij “si lajm kryesor i gazetës së pavarur shqiptare «Koha Ditore», ishte një foto e paqartë e një bebeje të përgjakur, që u gjet e vrarë në një pyll. Gjysmën e fytyrës e kishte të mbuluar me një kapuç, por një gazetar serb analizoi nga afër këtë imazh dhe vërejti se bëhej fjalë për një... kukull! Çmisticimi i kësaj gënjeshtre u transmetua edhe në televizionin shtetëror të Beogradit, por, jo edhe në mediat e shteteve perëndimore. Unë e kam këtë video”² – u përpoq të bindte lexuesin Michel Collon-i.

Ky publicist shprehu pakënaqësinë e tij pse në mediat e shteteve perëndimore nuk u shpërnda versioni serb për “montazhin me kukulla” por flisnin për fëmijë të masakruar! Nuk do të merrem me atë se çka realisht përmban video-incizimi që posedonte ai, e as me “marionetat” e Milošević-it që kësaj tragjedie i japin karakter lodrash me kukulla!

¹ Joël Hubrecht, *Kosovo 1981-1989-1999-2001, Etablir les faits*, Editions Esprit, 2001, f.47.

Për këtë masakër më gjerësisht mund të informoheni në: «Gornje Obrinje: Massacre in the forest»:

<http://www.hrw.org/reports/1999/kosovo/Obrinje6-02.htm>

² Michel Collon, *Monopoly- l'OTAN à la conquête du monde*, Editions Epo, Bruxelles, 2000, f. 24-25.



*Valmir Deliu i ekzekutuar, që marionetat
e Milošević-it e paraqitën si “kukull”!*

Për informimin e lexuesve që nuk kanë pasur mundësi të njihen me këtë masakër do të citoj vetëm burimet serbe. Nuk do t'i përmend burimet shqiptare, jo për arsye se propaganda serbe dhe mbështetësit e tyre në shtetet e perëndimit i konsiderojnë si të njëanshme, por, për të vetmen arsye sepse pas kaq vitesh nga përfundimi i luftës, realiteti mund të ndriçohet vetëm duke u bazuar në organizatat joqeveritare të Serbisë dhe në qëndrimet publike të intelektualëve të ndryshëm serbë që nuk pajtoheshin me aplikimin e politikës së gjenocidit në Kosovë.

Dymbëdhjetë vjet pas kësaj akti të gjenocidit, organizata joqeveritare serbe «Fondi për të Drejtën Humanitare»¹, e udhëhequr nga humanistja Nataša Kandić, përmes një shkrimi të titulluar «Si i vrau Serbia gratë, fëmijët dhe pleqtë»², përkujtoi krimin e forcave

¹ Fond za humanitarno pravo, Dečanska 12, 11000 Beograd, Srbija.

² E-novine, «Kako je Srbija ubijala žene, decu i starce», 24.09.2010, shih: <http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/40863-Kako-Srbija-ubijala-ene-decu-starce.html>

serbe në Obri të Epërme dhe ngriti zërin e protestës për faktin se ende askush nga kriminelët nuk u ballafaqua me drejtësinë. Me këtë shkrim, u aktualizuan strukturat e aparateve represive serbe të implikuara në këtë krim. Gjatë këtij aksioni kishin marrë pjesë “Detashmenti i Tretë i Forcave të Veçanta Policore, Çeta e Forcave të Veçanta Policore të Mitrovicës së Kosovës dhe Njësi të Operacione Speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, që vepruan në aksion të përbashkët me Batalionin e Parë të Brigadës 125 të motorizuar të Ushtrisë së Jugosllavisë.”¹ “Më 26 shtator 1998, në Obri të Epërme, forcat serbe vranë 27 civilë.” - vazhdon shkrimi. Fotografia, që instrumentet propagandistike të regjimit të Milošević-it e paraqitën si imazh të një “kukulle”, është e Valmir Deliu, i lindur më 21 shtator 1996, që ende nuk i kishte mbushur 2 vjet, kur u vra së bashku me babanë e tij Ademin (1965) dhe nënën Mihanen (1973). Pos tyre, atë ditë “pjesëtarët e forcave serbe vranë edhe pleqtë Pajazitin² dhe Aliun³ dhe plakat Hamide Deliu dhe Hava Elshanin; ata vranë gruan Lumnie Deliu; djalin e saj, Jetonin 11 vjeçar dhe vajzën katërvjeçare, Menduhien; vranë gruan tjetër Zahide Deliu dhe vajzën e saj të adoptuar, Donjetën shtatëvjeçare; vranë edhe Gentianën tetëvjeçare dhe Luljeta Deliu, që ishte shtatzënë në muajin e nëntë...”⁴

Përballë kësaj dhune të tmerrshme dhe të përsëritur për disa herë rresht në hapësirat e ish-Jugosllavisë, institucionet e ndryshme politike dhe joqeveritare në botë kërkonin ndërhyrjen energjike për të parandaluar përshkallëzimin e situatës. Në këtë kontekst, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, me anë të Rezolutës 1199⁵, tërhoqi vëmendjen në mënyrë të veçantë lidhur me rrezikun e një katastrofe humanitare në Kosovë. Dhuna e ushtruar nga forcat policore serbe dhe nga Ushtria Jugosllave pati për pasojë zhvendosjen e 230 mijë personave, që kishin qenë të detyruar t'i

¹ Po aty.

² Pajazit Deliu (68 vjeç).

³ Ali Deliu (68 vjeç).

⁴ E-novine, «Kako je Srbija ubijala žene...»

⁵ Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, S/RES/1199 (1998), 23 shtator 1998.

braktisnin shtëpitë e tyre. Për shkak të kësaj dhune, fluksi i refugjatëve në Shqipëri, në Bosnjë dhe në vendet e tjera evropiane ishte shumë i madh. Sipas Komisariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara, nga ata që ishin zhvendosur në brendësi të Kosovës, 50 mijë persona ishin pa çati mbi kokë dhe në mungesë të gjërave elementare. Fakti se dimri po afrohej shtonte brengosjen deri në përmasa alarmuese¹.

Në rezolutën e 23 shtatorit 1998 anëtarët e Këshillit të Sigurimit shprehën shqetësimin e tyre të thellë për degradimin e situatës në Kosovë dhe alarmuan për rrezikun potencial të një katastrofe humanitare. Në të njëjtën kohë u kërkua nga të gjitha shtetet anëtare që të angazhohen maksimalisht për ta parandaluar këtë katastrofë.

Krahas brengosjes dhe shqetësimeve të shprehura, Këshilli i Sigurimit dënoi ashpër dhunën e ushtruar dhe kërkoi që të ndërpritej çdo formë dhune në Kosovë, të respektohej armëpushimi dhe të fillonte dialogu i mirëfilltë ndërmjet autoriteteve të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe udhëheqësve shqiptarë, për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për problemin e Kosovës².

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara tërhoqi vërejtjen se nëse nuk ndërmerreshin masa konkrete në përputhje me këtë rezolutë dhe me rezolutën paraprake të datës 31 mars 1998³, atëherë do të pasonin veprime të tjera dhe do të propozoheshin masa shtesë për të ruajtur ose për të vendosur paqen në rajon.

Duke pasur përvojën e hidhur nga e kaluara, Këshilli i Sigurimit i OKB-së kërkoi që Serbia të pranonte Misionin Verifikues të OSBE-së për të mbikqyrur respektimin e kushteve të vendosura me anë të kësaj rezolute.

Fakti që as Rusia e as Kina nuk mundën ta pengonin Këshillin e Sigurimit të dilte me kërkesat e lartpërmendura dhe kërcënimi i Këshillit të NATO-s me sulme ajrore në rast të

¹ Tekstualisht shpreheshin "të alarmuar për rrezikun e katastrofës humanitare".

² Në rezolutë theksohet autonomia e zgjeruar dhe autonomi e vërtetë administrative për Kosovën.

³ Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, S/RES/1160 (1998), 31 mars 1998.

mosrespektimit të këtyre kërkesave e detyruan Milošević-in që të nënshkruante marrëveshjen për armëpushim¹. Tri ditë më vonë, më 16 tetor, u nënshkrua marrëveshja me OSBE-në për vendosjen e 2000 pjesëtarëve civilë dhe të paarmatosur të shteteve anëtare të OSBE-së për Misionin e Verifikimit në Kosovë².

Qeveria e Serbisë krijoi një Komision të veçantë qeveritar për bashkëpunim me këtë mision të OSBE-së dhe në krye të tij emëroi zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Serbisë, Nikola Šainović-in, ndërsa për zëvendës të Šainović-it, që do të qëndronte në Prishtinë, u caktua gjenerali në pension i Armatës Jugosllave, Dušan Lončar. Përkundër asaj se ishte në pension, gjenerali Lončar u emërua në këtë funksion sepse njihej me William Walker-in, që nga Kroacia.

Avullimi i «Krematorit të Kleçkës»!

Tri vjet më vonë, në prill 2001, Gjykata e Qarkut në Nish³ hapi seancën kundër Luan dhe Bekim Mazrekut. «Furra e gëlqeres - Krematori i Kleçkës» u aktualizua përsëri në mediat serbe!

Gjatë këtij procesi gjyqësor pala mbrojtëse solli dëshmi të shumta që provonin se Luan dhe Bekim Mazreku ishin arrestuar më 30 korrik 1998⁴, d.m.th. 27 ditë para se të “zbulohej publikisht” me anë të një spektakli mediatik se ata kishin ekzekutuar civilë serbë! Pala mbrojtëse solli dëshmi të shumta që tregonin se Luan dhe Bekim Mazreku nuk kishin pasur lidhje me UÇK-në, por ishin arrestuar si civilë gjatë kohës kur ishin duke kërkuar ushqime për familjarët e tyre. Luan dhe Bekim Mazreku e shpalosën para gjykatës tmerrin që kishin përjetuar për tri javë rresht, tmerr që i detyroi të thoshin atë që ishin porositur të pohonin publikisht.

¹ E njohur si Marrëveshja Holbrooke – Milošević e 13 tetorit 1998,

² Në krye të këtij misioni u emërtua diplomati amerikan William Walker-i

³ Nish (në gjuhën serbe Niš), Qytet në Serbi.

⁴ Sipas burimeve të Asociacionit të Gazetarëve të Pavarur të Serbisë arrestimi ishte bërë me 2 gusht. (shih:

<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=875112&print=yes>)

Trupi gjykues nuk mori parasysh asnjë dëshmi të palës mbrojtëse. I vetmi ndryshim në raport me atë që kishte bërë akuza, lidhej me mbetjet mortore të prezantuara publikisht si provë për «Krematorin e UÇK-së». Gjatë ekspertizave të mëvonshme u vërtetua se eshtrat e prezantuara më 27 gusht nuk ishin eshtra as të “Jovana-s së vogël”, së cilës nuk i dihej mbiemri (!), as të nënës dhe të gjyshes së saj, që nuk u përmendej as emri (!), e as të grupit të 100 civilëve që pretendohet se ishin likuiduar në fshatin Kleçkë. Gjatë seancës gjyqësore u pohua se bëhej fjalë për eshtra të civilëve të tjerë serbë të ekzekutuar në tjetër vend, të cilëve nuk ua dinin as emrat e as mbiemrat, por, e dinin se ishin “civilë serbë”!

Më 18 prill 2001, Gjykata e Qarkut në Nish dënoi Luan dhe Bekim Mazrekun me nga 20 vjet burgim. Ky dënim do të jetë “argument” për të vazhduar me të njëjtin qëndrim si gjatë luftës. Ndër reagimet e rralla kundër cilësimeve të përmendura më lart vlen të përmendet reagimi i drejtorit të Spitalit Ushtarak në Beograd, Zoran Stanković-it.

Më 24 janar 2002, për rastin në fshatin Kleçkë, gjeneral-majori serb, Zoran Stanković-i, tërhoqi vëmendjen se “nuk është aspak mirë që kanë filluar me lloj-lloj tregimesh, si në rastin që mbështeten vetëm në faktin se janë gjetur eshtra njerëzish, për të dëshmuar saktësinë e tregimeve. Reagoj ndaj kësaj dukurie me qëllim që të ulen pasionet dhe t’u lihet organeve hetuese të ndriçojnë tërësisht këtë rast. Është e papranueshme që të dalë atje një zëdhënës dhe të flasë për disa gjëra dhe të japë kualifikime ose deklarata, për të cilat jam i bindur se nuk mund të na ndihmojnë. Çdo gabim në vlerësim mund të na kthehet si bumerang, siç ndodhi edhe me rastin e dyzet fëmijëve të Vukovarit, që ishte një shuplakë për ne kur për disa muaj rresht u ndërpre publikimi i informatave tona në vendet e jashtme.”¹

Zoran Stanković-i pati frikë se propagandës serbe lidhur me «Krematorin e Kleçkës» mund t’i ndodhte e njëjta gjë si me “rastin e dyzet fëmijëve të Vukovarit”. Po bëj një digresion të vogël me

¹ Vreme, «Liki Delo-Zoran Stanković» (Imazhi dhe vepra e Zoran Stanković-it) <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=306212>

qëllim që lexuesi të ketë mundësi të kuptojë brengën e këtij mjeku dhe analogjinë që ai e bën midis të dy rasteve. Pas bombardimeve 86 ditësh të qytetit kroat të Vukovarit, forcat serbe pushtuan këtë vend të shndërruar në gërmadhë¹.

Me qëllim të neutralizimit të reagimeve të opinionit publik ndërkombëtar për mizoritë e ushtrisë dhe të policisë serbo-jugosllave, propaganda e Beogradit shpërndau gënjeshtren për gjoja “zbulimin e dyzet fëmijëve serbë, të therur! Lajmin e shpërndau RTS-ja,² por për shkak se nuk kishin asnjë provë në këtë drejtim u detyruan ta përgënjeshtrojnë. Madje edhe vetë RTS-ja u detyrua të deklaronte se kishte qenë një gabim.”³

Dy muaj pas deklaratës së Zoran Stanković-it dhe një vit pas shpalljes së dënimit kundër Luan dhe Bekim Mazrekut, Gjykata Supreme e Serbisë shqyrtoi ankesat e dy të rinjve shqiptarë të depozituara nga avokatët⁴ e tyre. Kjo gjykatë mori në konsideratë të gjitha faktet dhe e shpalli të pavlefshëm vendimin e Gjykatës së Qarkut të Nishit. Luan dhe Bekim Mazreku u liruan nga akuza si të pafajshëm. Më 26 mars 2002, Luan e Bekim Mazreku, u kthyen të lirë në Kosovë. Vendimi i Gjykatës Supreme të Serbisë për pafajësinë e Luan dhe të Bekim Mazrekut bëri të “avullohej” propaganda serbe për «Krematorin e Kleçkës».

Lirimi i Luan dhe i Bekim Mazrekut nuk përbënte lajm sensacional! Asnjë nga mediat me peshë për opinionin publik ndërkombëtar, që kishin publikuar lajmin e «Krematorit të Kleçkës», madje as ato media, që lajmin e shoqëruan me rezerva për vërtetësinë e tij, nuk publikuan epilogun e këtij procesi: pafajësinë e dy civilëve shqiptarë të akuzuar në një proces të montuar gjyqësor! Asnjë nga personalitetet e dikurshme që reagojnë ndaj asaj që propagandohej si “krimi më i rëndë në Evropën e pas Auschwitz-it gjerman” nuk reagoi! Së paku për të përshëndetur

¹ Shih dokumentarin e shkurtër: «La bataille de Vukovar»
<http://www.youtube.com/watch?v=055RFNUHCjA>

² Radio Televizioni i Serbisë.

³ E-Novine, «Slučaj Brajović», (Rasti Brajović),

<http://www.e-novine.com/index.php?news=19158>

⁴ Marina Klajić e Ćedomir Nikolić.

frymën e re që u shfaq në Gjykatën Supreme të Serbisë! Askush nuk kërkoi hetime për të nxjerrë në shesh se eshtrat e kujt u ekspozuan në të ashtuquajturin «Krematori i Kleçkës»! Heshtje e plotë! Sikur nuk kishte ndodhur asgjë! Kjo heshtje e inkurajoi propagandën serbe që të vazhdojë me avazin e vjetër.

Të gjithë ata që kanë pasur mundësi ta përcjellin procesin gjyqësor kundër Milošević-it janë bindur se struktura të tëra shtetërore ishin vënë në shërbim të mbrojtjes së tij. Ai gjatë këtij procesi ishte i pajisur me informacione të detajuara për secilin dëshmitar që kishte ftuar akuza, për çdo deklaratë publike të tyre në cilindo qoftë media botërore. Për këtë arsye, jam i bindur se Milošević-i ka qenë në dijeni të plotë të faktit se Gjykata Supreme e Beogradit hodhi poshtë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Nishit dhe liroi nga akuza vëllezërit Mazreku. Megjithatë, në seancën e 14 qershorit të vitit 2002, ai iu drejtua gjeneralit gjerman, Klaus Naumann-it¹, me pyetjen nëse ishte “në dijeni të informatave që UÇK-ja kishte djegur serbë, civilë serbë, në Krematorin e Kleçkës?”²

Çështjen e «Krematorit të Kleçkës» Milošević-i e ngriti gjatë procesit të tij gjyqësor në Hagë për të vazhduar manipulimin me telespektatorët serbë, që përcillnin gjykimin drejtpërsëdrejti nëpërmjet TV Beogradit dhe kanaleve të ndryshme televizive në Serbi dhe në Kosovë.

Megjithatë, propaganda serbe për këtë çështje do të bjerë në intensitet dhe «Krematori i Kleçkës» u la në heshtje për vite të tëra. Por, botimi i librit të Carla Del Ponte-s «*Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës*» mobilizoi strukturat e vjetra të regjimit të Milošević-it që të lëshoheshin në një betejë të re. E para që reagoi ishte ish-gjykatësja hetuese e «Rastit të Kleçkës», Danica Markinković-i³. Jo vetëm që theu heshtjen disavjeçare lidhur me këtë sajim politik, hetimor dhe gjyqësor, por u bë tepër e zhurmshme me kërkesa për rigjykimin e vëllezërve Mazreku.

¹ Kryetari i Këshillit të NATO-s para dhe gjatë vendimit për të sulmuar ushtarakisht Serbinë.

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Klaus Naumann, seanca e 14 qershorit 2002, f. 751

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

³ Tani gjyqtare në Gjykatës e Lartë të Kragujevcit

Libri i lartpërmendur i Carla del Ponte-s pati efektin e nxitësit për aktualizimin e kësaj çështjeje. Madje, raporti i senatorit zviceran, Dick Marty-t, i titulluar «Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi kundërligjor i organeve njerëzore në Kosovë», i inkurajoi tej mase mbështetësit e Milošević-it.

Në një intervistë për gazetën «Vesti» Danica Marinković-i tha se “në këtë rast ishin djegur rreth 30 civilë serbë¹, se vëllezërit Mazreku ishin dënuar me nga 20 vjet burg, por se Gjykata Supreme e anuloi këtë vendim...”² Duke konsideruar se tani ishte krijuar “një klimë e favorshme për të kuptuar krimet e UÇK-së”, ajo kërkoi që rigjykimi i Luan dhe i Bekim Mazrekut të bëhej edhe një herë në Nish.

Në të njëjtën frymë edhe Zëvendësprokurori i Serbisë për Krime Luftë, Bruno Vekarić-i, disa herë nguli këmbë që të kthehej procesi i rigjykimit të Luan dhe i Bekim Mazrekut në Gjykatën e Nishit. Mirëpo, kryetari i Gjykatës së Lartë të Nishit Zoran Krstić-i deklaroi: “Është i pamundur të mbahet rigjykimi i tyre sepse mungojnë procesverbali origjinal i marrjes në pyetje gjatë procesit hetimor dhe dokumentet thelbësore për këtë rast, që sipas tij ndodhen në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e që kjo gjykatë refuzon t’ua japë!”³

Madje, Zëvendësprokurori Bruno Vekarić-i u ishte drejtuar zyrtarisht autoriteteve të EULEX-it në Kosovë që tërësinë e dokumenteve lidhur me këtë rast t’ia dorëzonin gjykatës në Nish, me qëllim që të vihej drejtësia në vend! As UNMIK-u e as Gjykata e Qarkut të Prishtinës, nuk u kursyen nga akuzat për “zhdukjen eventuale të provave dhe të dëshmive”!⁴

¹ I paska harruar shifrat zyrtare për 22 civilë të vrarë, të cilat vet i shpalli në vitin 1998!

² Vesti, «Ubio i spalio 30 serba» (I vrau dhe i dogji 30 serbë)
<http://www.vesti-online.com/Stampano-izdanje/18-03-2011/Dogadajdana/124379/Ubio-i-spalio-30-Srba-/print>

³ Politika, «Zločinci iz Klečke nisu na Kosovu»
<http://www.politika.rs/rubrike/Hronika/Zlocinci-iz-Klecke-nisu-na-Kosovu.lt.html>

⁴ Po aty

Kjo makineri propagandistike ishte e vetëdijshme se kishte njerëz që ende nuk kishin harruar faktin se Luan dhe Bekim Mazreku ishin marrë si pengje nga makineria vrastare e Milošević-it dhe mbi bazën e dokumentacionit të montuar prej tyre, më 18 prill 2001, në Gjykatën e Qarkut në Nish, u dënuan me nga 20 vjet burg! Por, instrumentet e kësaj makinerie propagandistike janë plotësisht të vetëdijshme se dezinformata është armë e fuqishme për manipulimin e opinionit publik, dhe se përgënjeshtrimi nuk mund t'i fshijë efektet e dezinformatës!

Pas shpalljes së pafajësisë së Luan dhe të Bekim Mazrekut nga ana e Gjykatës Supreme të Serbisë dhe pas lirimit të tyre më 26 mars 2002, nëse realisht janë zhdukur dosjet e këtij procesi të montuar mbi bazën e propagandës ideologjike të regjimit të Milošević-it, atëherë bëhet tepër e qartë se përpos falsifikatorëve dhe montuesve të dosjeve gjyqësore kundër civilëve shqiptarë, askush tjetër nuk ka pasur interes t'i asgjësojë gjurmët e krimit të institucioneve hetimore, gjyqësore, politike dhe propagandistike të Serbisë. Megjithatë, sado paradoksale të duken kërkesa të tilla, ata e dinë se në çmënyrë i detyruan Luan dhe Bekim Mazrekun t'i pranonin veprat që nuk i kishin bërë dhe të dëshmonin rrejshëm kundër personave që gjoja u kishin dhënë urdhër të kryenin krime. Nuk e përjashtoj hipotezën se prapa insistimit për rigjykimin e vëllezërve Mazreku mund të fshihet shpresa e qarqeve të regjimit të vjetër serb për të gjetur “dëshmitarë” edhe për “trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja”.

Civilë serbë me emra e pa mbiemra, madje edhe pa emra e pa mbiemra!

T'i kthehemi propagandës për “Jovana-n 11-vjeçare”, të cilën, sipas kolonelit të policisë serbe, Slavko Nikić-it, “Luan dhe Bekim Mazreku e kishin dhunuar para syve të nënës, të gjyshes dhe të serbëve të plagosur e të lidhur”!¹ Edhe pse nuk e kishte gjetur

¹ Slavko Nikić, *Nulta Krvna Grupa*, Botimi Rad, Beograd, 2013, f. 10-14

mbiemrin e Jovana-s, e as emrat e nënës dhe gjyshes së saj, Slavko Nikić-i e shpalli “heroinë të popullit serb!”¹

Propaganda për gjoja civilë të vrarë nga ana e UÇK-së, të cilëve shteti serb nuk u gjeti emrat ose mbiemrat, e nganjëherë as emrat e as mbiemrat, është propagandë që ka dominuar që nga periudha e luftës së Kosovës e deri në ditët e sotme. Këtë aspekt do ta trajtoj në kapitullin e fundit të këtij libri dhe lexuesi do të bindet se kjo formë e manipulimit nuk është karakteristikë e disa personave, si Milovan Drecun-i e Slavko Nikić-i, por, politikë zyrtare e institucioneve shtetërore të Serbisë.

Të ndalemi pak dhe të shohim se kush është në të vërtetë Slavko Nikić-i, i cili shpreh “keqardhjen e madhe” për humbjen e jetëve të civilëve serbë?

Nuk e shoh të domosdoshme që të zgjatem rreth biografisë së tij. Po përmend faktin se ky kolonel i Policisë së Serbisë ka tri nënshtetësi². Këto nënshtetësi i ka marrë falë “meritave të mëdha për çështjen serbe”! Është interesant se ky polic, i cili merret dhe me shkrime e publikon në veprën e vet se “nga personalitetet më të shquara të skenës politike, policore dhe ushtarake serbe, lidhur me qëndrimin ndaj jetës, më së shumti çmon gjeneralin Ratko Mladić.”³



Slavko Nikić-i ekspozon para kamerave letërnjoftimet e tri nënshtetësive që posedon

¹ Po aty, f. 11

² Ka nënshtetësinë e Serbisë, të Malit të Zi dhe Republikës Serbska në Bosnjë. Në foto publikon me mburrje tri letërnjoftimet me të cilat disponon ai.:

³ Slavko Nikić, vepra e cituar, *Nulta Krvna Grupa*, f. 8



*Slavko Nikić-i ekspozon para kamerave
librin e idhullit të tij, Ratko Mladić-it*

Ratko Mladić-i është “njëri ndër kriminelët më të mëdhenj të Ballkanit, i akuzuar për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.”¹ Qëndrimi i Ratko Mladić-it për jetën u dëshmuua në veçanti gjatë «Masakrës së Srebrenicës»! Po rikujtoj se “më 13 korrik 1995, forcat serbe në Bosnjë, nën komandën e Ratko Mladić-it, masakruan për afërsisht 8000 burra dhe adoleshentë myslimanë në Srebrenicë. Pas Luftës së Dytë Botërore krimet në Srebrenicë janë krimet më të tmerrshme në Evropë, të cilat drejtësia ndërkombëtare i kualifikoi si gjenocid.”²

Gjashtëmbëdhjetë vjet pas kësaj masakre dhe kërkesave të vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare drejtuar Serbisë, Ratko Mladić-i u arrestua dhe u ekstradua në Hagë! Ky kriminel është në pritje të gjyqimit për veprat më të rënda të kryera pas Luftës së Dytë Botërore në Evropë.

¹ France 24, «L'ancien général serbe Ratko Mladic a été arrêté» (U arrestua ish-gjenerali serb, Ratko Mladić-i)

<http://www.france24.com/fr/20110526-serbie-bosnie-herzegovine-tadic-arrestation-ratko-mladic-srebrenica-sarajevo-tpiy-crimes-guerre/>

² Euro news, «Srebrenica: hommage aux victimes du 13 juillet 1995», 13.07.2013 (<http://fr.euronews.com/2013/07/13/srebrenica-hommage-aux-victimes-du-13-juillet-1995>)

Slavko Nikić-i pohon publikisht se ishte mik shumë i ngushtë i tij dhe se “për kontributin që kishte dhënë për serbët e matanë lumit Drina¹, gjenerali Ratko Mladić i kishte dhënë mirënjohje të veçantë. Madje, me udhëzimet e tij, si kolonel lufte, ishte dërguar në luftën e Kosovës në krye të Njësitit për Detyra të Veçanta!”² – deklaroi me mburrje Slavko Nikić-i.

Çdo lexues që i njeh zhvillimet e tmerrshme në Bosnje, ku operonin forcat serbe të komanduara nga Ratko Mladić-i, mund ta imagjinojë se cili ishte kontributi i tij në Bosnje për të cilin i kishin dhënë mirënjohje. Në kontekstin e këtij kapitulli po kufizohem vetëm në qëndrimin e kolonelit të policisë serbe, të cilin e kishte dërguar Ratko Mladić-i në Kosovë. Ai shpreh revoltën për vendimin e Gjykatës Supreme dhe akuzon “administratën shtetërore të shtetit të Serbisë për krim edhe më të rëndë ndaj serbëve në Kleçkës sepse me vendim ligjor i liroi të gjithë terroristët shqiptarë.”³ Krahas akuzave kundër institucioneve të Serbisë Slavko Nikić-i shpreh një revoltë të veçantë kundër Fondit për të Drejtën Humanitare të Serbisë. Madje, këtë organizatë humanitare ky polic e bën përgjegjëse për lirimin e shqiptarëve që mbaheshin në burgjet serbe. “Banditët shqiptarë u liruan me ndërmjetësimin e një shoqate serbe, që e ka ditur fare mirë se çka kishin bërë vëllezërit Mazreku me Jovana-n e vogël, dhe vazhduan t’i mbronin këta dy kriminelë dhe 1800 keqbërës, hajdutë, dhunues, kriminelë lufte dhe vrasës të tjerë shqiptarë... vetëm e vetëm që të merrnin një pjesë nga fitimi i shitjes së çdo organi të serbëve, që mbaheshin në llogoret shqiptare.”⁴

Krahas kësaj revolte, në përpjekjet për t’u paraqitur si “viktimë” ai shpalos fakte domethënëse për problematikën tonë.

“Gjatë luftës zura 64 banditë shqiptarë, që pranuan se kanë kryer krime”- tregon me fodullëk Slavko Nikić-i në emisionin special të TV Novi Sadit. “Në vend të mirënjohjes nga shteti serb,

¹ Figurativisht simbolizon kufirin midis Bosnjës dhe Serbisë

² Cirilica - Joca Jovanovic, Zoran Petrovic, Slavko Nikic 4/7
<http://www.youtube.com/watch?v=ID1k3TKVfQo>

³ Slavko Nikić, vepra e cituar, *Nulta Krvna Grupa*, f. 12

⁴ Po aty, f. 98.

Opozita Demokratike e Serbisë, pas vrasjes së Zoran Đinđić-it, në operacionin «SABLJA»¹ më arrestoi dhe më akuzoi si anëtar i Klanit të Zemunit. Unë nuk e kam urryer Zoran Đinđić-in, por e kam dashur Milošević-in. Edhe tani e dua, edhe të vdekur. Unë mburrem që më ka arrestuar Opozita Demokratike e Serbisë e do të më vinte turp sikur të më avanconin. Madje, Ratko Mladić-i më ka përshëndetur në mënyrë të veçantë edhe nga Burgu i Hagës ku mbahet i pafajshëm.»²

Shpresoj se qëndrimet e lartpërmendura të Slavko Nikić-i për Slobodan Milošević-in dhe Ratko Mladić-in si dhe mirënjohjet për kontributin e tij në krimet e kryera në Bosnje dhe në Kosovë janë domethënëse që të krijohet një pasqyrë orientuese se për çfarë personi bëhet fjalë.

Ndërsa, përsa i përket kontributit të Milovan Dracun-it në mediatizimin e «Krematorit të Kleçkës», e shoh të udhës që në këtë pjesë të analizës të sjell vetëm një fakt³, që do t'i ndihmojë lexuesit të kuptojë se për çfarë gazetari bëhet fjalë.

Fakti, për të cilin dua ta njoftoj lexuesin, lidhet me një veprim të rrallë të ndërmarrë nga një shoqatë gazetarësh në Ballkan. Më 1 korrik 2009, në Gjykatën për Krime Luftë në Serbi, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë dorëzoi padinë kundër gazetarëve të «Radio Televizionit të Beogradit», të «Radio Televizionit të Novi Sadit» si dhe kundër gazetarëve të gazetave «Politika», «Večernje Novosti» dhe të gjithë atyre që gjatë shpërbërjes së Federatës Jugosllave u vunë në shërbim të propagandës luftënxitëse.

Me këtë padi penale, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë akuzoi gazetarët, që i shërbyen kësaj propagande, se duke manipuluar me mediat, ndikuan në përhapjen e urrejtjes ndërnacionale dhe ndërfetare, në nxitjen e diskriminimit dhe të armiqësive, me çka kanë krijuar parakushtet psikologjike për dhunën dhe për krimet më brutale.

¹ Po aty, f.171

² Slavko Nikić - «Emisija Secanja 1/2»

<http://www.youtube.com/watch?v=9XZcv3-A5nM>

³ Faktet tjera do t'i sjell në vazhdim.

Për këtë arsye, ky asociacion kërkoi nga Gjykata për Krime Luftë në Serbi që në përputhje me nenin 145 të Kodit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë të dënoheshin këta gazetarë për vepër penale të organizimit dhe të nxitjes së kryerjes së gjenocidit dhe të krimeve të luftës.

Në mesin e gazetarëve, që u paditën për manipulime mediatike në funksion të nxitjes së krimeve në Kosovë, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë akuzoi edhe Milovan Dracun-in, gazetarin e çështjeve ushtarake e politike të Radio Televizionit të Serbisë, ndër të tjera edhe për manipulimin me «Krematorin e Kleçkës» përmes “intervistës” me Bekim Mazrekun¹.

Jo vetëm që Milovan Dracun-i nuk pësoi asgjë për implikimin e tij në nxitjen e kryerjes së krimeve të gjenocidit në Kosovë, por përkundrazi, ai pati vetëm privilegje! Për këtë çështje do të flas më poshtë.

Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë nuk është e vetmja shoqatë serb që reagoi për mosndëshkimin e kriminelëve dhe nxitësve të krimeve. Në kontekst të këtij kapitulli dhe me qëllim që të shihet roli i hetuesisë serbe në zinxhirin e krimeve të organizuara në Kosovë po përmend shkrimin e humanistes serbe, Nataša Kandić-it lidhur me qëndrimet e gjykatëses hetuese, Danica Marinković-it.

Në artikullin e botuar në mars të vitit 2002 dhe të titulluar «E vërteta shqetësuese»,² duke u mbështetur në pohimet e pjesëtarëve të Njësive Speciale të Policisë së Serbisë, Nataša Kandić-i e akuzoi Danica Marinković-in për rastin e vrasjeve në fshatin Likoshan.

“Nga këta policë kam mësuar se Danica Marinković-i ka urdhëruar likuidimin e disa meshkujve të plagosur të familjes Ahmeti, më 28 shkurt 1998 në fshatin Likoshan. Në shikimin e

¹ Tërësia e padisë së Asociacionit të Gazetarëve të pavarur mund të konsultohet edhe në këtë faqe interneti:

Vreme, «NUNS-ova krivična prijava protiv novinara»

<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=875112&print=yes>

² Nataša Kandić, «Uznemiravajuća istina» (E vërteta shqetësuese), 8 mars 2002 <http://www.b92.net/feedback/misljenja/kandic/print-kandic.html>

vendit të krimit kishte ardhur e shoqëruar nga Zëvendës-prokurori i Qarkut, Jovica Jovanović-i dhe punëtorë të policisë kriminalistike. Para shtëpisë së Ahmetajve ndodhej grumbulli i trupave. Disa meshkuj jepnin shenja jete. Në prezencën e tridhjetë pjesëtarëve të Njësitë Speciale Antiterroriste gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i, haptazi kishte thënë: «unë këta nuk i marr me vete, vrisni!» I vranë me Heckler¹. Rezultatet e hetimeve nga vendi ku ishte kryer krimi nuk u publikuan asnjëherë. Më 1 mars 1998, katërmbëdhjetë kufoma u transferuan në spitalin e Prishtinës. Gjykatësja hetuese nuk dha urdhër që të bëhej autopsia, kështu që kufomat, pas identifikimit, iu dorëzuan familjeve. Pjesëtarët e policisë që kishin marrë pjesë në aksionin e Likoshanit tregojnë se pushkët dhe bombat ishin vendosur më vonë pranë trupave të të vrarëve dhe ky falsifikim shërbeu për informin e opinionit.

Edhe sot, gjykatës, prokurorë dhe udhëheqës policie asgjësojnë letrat e mbetura që mund t'i zbulojnë, i falsifikojnë dokumentet dhe e verifikojnë qëndrueshmërinë e heshtjes për Kosovën. Udhëheqësit e moçëm të policisë kosovare dhe të Partisë Socialiste të Serbisë brengosen nga ajo se çka mund të ndodhë nëse 'tradhtarët' nga radhët e tyre flasin. Brengosja është e arsyeshme. Muri i heshtjes seriozisht ka pëlçitur. Gjithnjë e më tepër njerëzit flasin se çka ka ndodhur në Kosovë."²

Shpresoj se nga ajo që u tha më lart lexuesi ka mundur sadopak të krijojë opinionin e tij rreth gërshetimit të strategjive të pushtetit politik me atë policor, institucionet e drejtësisë dhe gazetarëve në funksion të shpërndarjes së gënjeshtreve për gjoja vrasjen e civilëve serbë nga ana e UÇK-së. Në Kosovë vriteshin civilë shqiptarë, serbë dhe pjesëtarë të grupeve tjera etnike. Por, muri i heshtjes që kishte imponuar regjimi mbrojti nga përgjegjësia penale organizatorët dhe ekzekutuesit e vërtetë të këtyre krimeve.

¹ Pistoletë e prodhimit gjerman me të cilat ishin të pajisur Njësitë Speciale të policisë serbe.

² Nataša Kandić, artikulli i cituar «Uznemiravajuca istina»

EPILOGU I KAPITULLIT TË PARË

Shpërtheu muri i heshtjes serbe për krimet në Kosovë!

"Kam qenë vazhdimisht në Kosovë si polic, por viti 1998 ishte i tmerrshëm. Masakër e paparë nga ana e policisë dhe e ushtrisë!"¹ - rrëfen Slobodan Stojanović-i, komandanti në pension i stacionit policor në Černa Trava, ish-anëtar i Çetës IV, të Detashmentit të 37-të të Njësisë të Veçanta të Policisë serbe.



Polici serb Slobodan Stojanović rrëfen publikisht për krimet në Kosovë

“Kur anëtarët e njësitit tonë shkuan në Kosovë ishin në pozita të vështira financiare (...) Atje pashë plaçkitje të pronave, grabitje të traktorëve, vjedhje të veturave, të sharrave motorike, të kultivatorëve (...) Me një fjalë, gjithçka që shihte syri, duart nuk e linin pa marrë! Madje kanë prerë edhe gishtërinj për t’ua marrë unazat. I kam parë me sytë e mi. U kthyen në vendlindje me

¹ Fond za Humanitarno Pravo, «Svedočenje Slobodana Stojanovića (1): Pravili su lampe od albanskih lobanja» (Dëshmi e Slobodan Stojanović-it: kanë bërë llamba nga kafkat e shqiptarëve),
në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=25433>

zinxhirë të trashë ari dhe me unaza për gratë e tyre. Ata nuk kanë pasur asnjë pasojë dhe sot të gjithë janë pasuruar (...)

Që pesë vjet kam dalë në pension e ata policë na mbrojnë! Më vjen turp t'i shoh!....

Gjatë tre muajve në Kosovë kam parë tmerre. Para nesh ecte ushtria dhe që në mëngjes gjuante me raketa shumëtytëshe në drejtim të fshatrave kodrinore të Gllogovcit dhe vrisnin gjithçka që lëvizte.

Një koleg imi i kërkoi para një civili shqiptar të moshuar mbi 70 vjeç. E pyeta nëse ishte normal dhe pse e bënte një gjë të tillë. Ai e vrau atë, sepse kishte vetëm 10 marka!¹ Ai polic ende punon. Unë me të vërtetë nuk e kuptoj...

Në Gllogovc, pas pastrimit të terrenit, pashë një grup prej 400-500 shqiptarë (gra, fëmijë dhe pleq). Dikush deshi të shtinte, por e ndërpreva. Më vonë pashë tmerrin! Kufoma të copëtuara, shtëpi të djegura nga shpërthimet.



Ushtari serb numëron paratë që u ka plaçkitur shqiptarëve

¹ Monedha e Gjermanisë parase të aderojnë në monedhën unike të BE-së, në euro.



Vendbanime shqiptare në flakë dhe të rrënuara

Nuk kisha mundësi ta paramendoja se një gjë e tillë kishte mundur të ndodhte... Në Prekazin e Epërm dhe të Poshtëm u vranë gra, fëmijë, kafshë dhe çdo gjë që lëvizte atje. Drenica digjej (...)

Më kujtohet kur u vranë çobanët e paarmatosur, që nuk kishin as thikë për të prerë bukën. Komandanti Radoslav Mitrović-i dha urdhër që 't'i linim të rrezitëshin!'. Kjo, në gjuhën tonë të koduar, donte të thoshte, t'i vritnim me gjakftohtësi!

¹ Fond za Humanitarno Pravo «Svedočenje Slobodana Stojanovića (2): Ubijali su decu, žene, starce, čobane, ovce» (Dëshmi e Slobodan Stojanović-it: kanë vranë fëmijë, gra, pleq, çobanë, dhen....) në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=25448>

Për të gjitha këto dinte komandanti Nenad Stojković-i. Ai ishte personalisht i pranishëm kur policët e njësitit tonë në fshatin Bajgorë, te miniera 'Trepça', vranë një fëmijë me të meta mendore dhe nënën e tij, në shtëpinë e të cilëve kemi kaluar natën. Kur pyeta përse e bënë një gjë të tillë, më thanë se nuk kishim nevojë për dëshmitarë!



*Komandanti Nenad Stojković pranë tankut:
Obri, shtator 1998*

Në shtator 1998 luftuam në fshatrat mbi Prizren, në të ashtuquajturin pastrim terreni. Unë nuk do të përmend emrin e policit, që ende është gjallë e pensionist, që për pikë qejfi ka vranë fëmijën në djep, që nuk kishte as katër muaj. Sipas tij, 'më i mirë është shqiptari i vdekur se shqiptari i gjallë'. Doja ta vrisja atë...

Një anëtar i Çetës së Pirotit, që i takonte Sektorit 87 të Njësive Speciale të Policisë, i kishte prerë kokën një shqiptari të vdekur. Pastaj, për ditë të tëra e ka zier në një tenxhere. Nga ajo i nxori katër dhëmbë prej ari, pastaj ka shkuar në shtëpi, kafkën e ka lyer me llak dhe nga ajo ka bërë një llambë tavoline (...) Të njëjtën gjë e ka bërë edhe me një grua të vranë. Edhe asaj ia ka prerë kokën, në të njëjtën mënyrë e ka zier, e çoi në shtëpi dhe bëri llambë tavoline. Fliste se dëshironte të kishte një çift llambash.

Njerëzit normalë ishin të tmerruar. Edhe komandanti i kompanisë, edhe komandanti i çetës, edhe 80 % e policëve ishin në dijeni të këtij tmërri!...

Doktor Branimir Đokić-i, që ishte në çetën tonë që nga themelimi i saj, i tha Nenad Stojković-it, se 'kur të kthehej do të tregonte për çdo gjë që kishin bërë'. Atë e vrau polici Goran Stamenković – Stamenko, vetëm pse doktori dinte shumë për krimet në Kosovë. Jo vetëm që nuk u bënë hetime korrekte për vrasjen e dr. Branimir Đokić-it, por u shpall se ai ishte vrarë nga UÇK-ja!

Ndaj një numri prej tyre u ndërmorën procedura hetimore, por u ndërprejnë. Prokuroria e Serbisë për Krime Lufte dhe konkretisht zëvendësprokurori i saj, Dragoljub Stanković-i, në vend të akuzës ka përgatitur mbrojtjen e serbëve të akuzuar nga Gjykata e Hagës.

Unë me të vërtetë nuk e kuptoj, por m'u bë e qartë se në Kosovë nuk kisha shkuar me policë të mirëfilltë, por me një grup, që nuk di si ta përkufizoj, se ata nuk ishin as kriminelë. Isha me sadistë, me të sëmurë, me kanibalë... vetëm mish njeriu nuk kanë ngrënë. Ishin një grup banditësh, të gatshëm për të vjedhur dhe për të vrarë dhe nuk i jepnin llogari askujt. Edhe sot e kësaj dite nuk më është e qartë se kush nga kreu i shtetit ua lejoi një gjë të tillë..."¹

¹ Pjesë nga dëshmitë publike të policit serb. Slobodan Stojanović-it:
«Kanë bërë llamba nga kafkat e shqiptarëve»
(<http://www.hlc-rdc.org/?p=25433>)
«Kanë vrarë fëmijë, gra, pleq, çobanë, dhen...»
(<http://www.hlc-rdc.org/?p=25448>)

KAPITULLI I DYTË

PROLOGU I KAPITULLIT TË DYTË

Papritmas, pak pas orës 20 dëgjova përplasje të frikshme të derës dhe pas saj krisma armësh. Shokët e mi rrëzoheshin si duaj njëri pas tjetrit. Te dyert qëndronin dy terroristë, të veshur me të zeza, me kapela në kokë dhe pamëshirshëm gjuanin kundër nesh. Plumbi i parë e goditi Ivan-in, që u rrëzua mbi mua (...) sjell kujtimet e veta Nikola Rajović-i për mbrëmjen e 14 dhjetorit të vitit 1998 në kafenenë «Panda» në Pejë¹.

Nga 13 persona që kishin qenë të pranishëm në këtë kafene, që frekuentohej kryesisht nga të rinjtë malazez dhe serbë, gjashtë persona humbën jetën: Ivan Obradović-i (14 vjeç), Vukota Gvozdenović-i (16 vjeç), Svetislav Ristić-i (17 vjeç), Zoran Stanojević-i (17 vjeç), Dragan Trifović-i (17 vjeç) dhe Ivan Radević-i (25 vjeç), ndërsa tre persona u plagosën rëndë.²

Slavica Obradović-i, nëna e Ivan-it, dhe të gjitha nënat e të vrasurve të tjerë, edhe sot e kësaj dite kërkojnë ta dinë se kush i vrau dhe kush dha urdhër për vrasjen e tyre³.

Të shpresojmë se pas këtij kapitulli lexuesi do të ketë edhe një mundësi më shumë të dalë nga grackat e propagandës së regjimit të Milošević-it dhe ta shohë këtë tragjedi nga një këndvështrim tjetër.

¹ Qytet në Kosovën Perëndimore

² Vepra e cituar *Zločin albanskih terorista...*, f.106

³ “Svet”, «DA SENE ZABORAVI: Ovi mladići su ubijeni pre 14 godina u Peći, krivci nikada nisu nađeni!»

(Të mos harrohet: këta djelmossa u vranë para 14 vitesh në Pejë, fajtorët nuk u gjetën asnjëherë)

<http://www.smedia.rs/spress/vest/2090/Srpski-mladici-ubijeni-u-kaficu-Panda-Kosovo-Ubijeni-srpski-mladici-Zlocin-u-Pandi-DA-SE-NE-ZABORAVI-Ovi-mladici-su-ubijeni-pre-14-godina-u-Peci-krivci-nikada-nisu-nadjeni-VIDEO.html>

Te kafeneja «Panda»!

Pejë, 14 dhjetor 1998

Ngjarja e tmerrshme që ndodhi atë natë dhjetori të vitit 1998, në qytetin kufitar të Kosovës me Malin e Zi, tronditi si asnjë ngjarje e mëparshme serbët dhe malazeztë e Kosovës, të Serbisë dhe të Malit të Zi.

Lajmi i shoqëruar me fotografitë e të rinjve të vrarë përshkoi të gjitha mediat e vendit. Kjo ndikoi që të organizoheshin protesta që në mëngjesin e 15 dhjetorit.



Fotografi e masakrës në kafenenë «Panda»

Mobilizime dhe protesta masive anekënd Kosovës, Serbisë dhe Malit të Zi shprehnin revoltën e qytetarëve për këtë krim. Në të njëjtën kohë kërkohet arrestimi sa më i shpejtë i vrasësve, sjellja e tyre para drejtësisë dhe dënimi i merituar i kriminelëve.

Në të gjitha nivelet e arsimit, nga shkollat fillore e deri te universitetet, serbët dhe malazeztë ndërprejnë mësimin dhe mbajtën tubime protestuese. Me anë të këtyre tubimeve “kërkohet

nga organet shtetërore që të merreshin aksione efikase për shkatërrimin e terrorizmit.”¹

Vlen të theksohet se që nga ardhja e Milo Đukanović-it në krye të Malit të Zi, më 15 janar 1998, kjo republikë mbante distancë ndaj regjimit të Milošević-it. Mirëpo, vrasja e të rinjve malazez dhe serbë ngjalli një revoltë të madhe në Mal të Zi dhe ndjenjën e fuqishme të solidaritetit me viktimat dhe me familjet e tyre.

Këtë ndjenjë solidariteti me viktimat e aksionit terrorist të 14 dhjetorit regjimi i Beogradit u përpoq ta shfrytëzonte për të forcuar edhe solidaritetin politik midis dy republikave që kishin mbetur nga Federata e përparshme jugosllave: “Të bashkuar përballë terrorizmit shqiptar!”²

Në kuadër të mobilizimeve, të peticioneve dhe të letrave publike që botonte shtypi serb, një vend të veçantë iu dha letrës së nënave serbe dhe atyre malazeze të Komunës së Pejës, adresuar publikisht kryetarit të Republikës Federative të Jugosllavisë, Slobodan Milošević-it. Në këtë letër emocionuese të 15 dhjetorit 1998, ndër të tjera theksohej: “Mbrëmë në Pejë, terroristët na kanë vranë 6 djelmoha. Më i riu, Ivan Obradović-i, nuk i kishte mbushur as 15 vjeç, ndërsa më i moshuari midis tyre ishte studenti Ivan Radević-i, 25 vjeç. Katër të tjerët nuk i kishin as nga 17 vjeç ... Duke besuar te Ju, dhe vetëm te Ju, kemi mbetur të jetojmë këtu në vatrat stërgjyshore. Këtu kemi lindur dhe kemi bërë fëmijët tanë, tani edhe i varrosim këtu (...) Besimi i plotë që kemi te Ju si Kryetar, si patriot dhe si prind Ju obligon të na i mbron fëmijët dhe të mos lejoni të njollosen varret e djemve, të vëllezërve, të baballarëve dhe të burrave tanë, që u vranë gjatë aksioneve antiterroriste në mbrojtje të lirisë së qytetarëve dhe të integritetit të vendit. Nga rënkimet e nënave rrëzë Bjeshkëve të Nemuna³, Ju

¹ Vepra e cituar *Zločin albanskih terorista...*, f.107

² Moto kryesore e shumë tubimeve protestuese në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi

³ Bjeshkët e Nemuna janë vazhdimësi e Maleve Dinarike, që shtrihen në veri të Shqipërisë, në perëndim të Kosovës dhe në juglindje të Malit të Zi. Qyteti i Pejës është rrëzë këtyre bjeshkëve.

lusim që pa kompromis të çrrënjosni terrorizmin, se zullumi nuk mund të durohet më!”¹

William Walker-i në emër të 54 shteteve të OSBE-së dënoi me ashpërsi dhunën që ndodhi në Kosovë².

Nëpërmjet përfaqësuesit të saj politik, Adem Demaçit, UÇK-ja dënoi aktin terrorist kundër të rinjve serbë dhe malazez dhe hodhi poshtë çfarëdo implikimi të pjesëtarëve të saj në këtë vrasje.”³

Edhe në ditën e varrimit, më 16 dhjetor, u organizuan tubime anekënd Kosovës me kërkesa që të arrestoheshin përgjegjësit e kësaj vepre kriminale, të dënoheshin me dënime të merituar dhe të mbroheshin qytetarët nga terroristët shqiptarë⁴.

Kush i vrau këta të rinj? Në interes të kujt ishte vrasja e civilëve të pafajshëm? Interes i shqiptarëve? Interes i UÇK-së? Apo i atyre që përpiqeshin t'i jepnin luftës së popullit shqiptar karakter terrorist?

«Bombaşi»-t e UÇK-së!

Me arsyetimin se kërkoheshin autorët e sulmit terrorist në kafenenë «Panda» në Pejë, Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë publikoi se nga data 14 dhjetor e deri më 17 dhjetor 1998 kishte arrestuar Gazmend Bajramin (20 vjeç), Vllaznim Përgjegjajn (19 vjeç), Xhevdet Bajramin (21 vjeç), Beqir Loxhajn (27 vjeç), Agron Kollçakun (26 vjeç) dhe Behar Bajrin (18 vjeç). Krahas tyre, edhe 34 shqiptarë ishin arrestuar në këtë interval kohe dhe akuzoheshin si pjesëmarrës në sulmin terrorist në kafenenë e lartpërmendur⁵.

¹ Vepra e cituar *Zločin albanskih terorista...*, f. 106.

² Po aty, f.107

³ Vreme, nr. 427, «Kontrolisano krvarenje» (Gjakderdhje e kontro-lluar), 26. 12. 1998

Në: http://www.vreme.com/arhiva_html/427/3.html

⁴ Vepra e cituar *Zločin albanskih terorista...*, f. 108

⁵ Po aty, f. 108

Ndjekja e personave të tjerë të “implikuar” në këtë aksion terrorist vazhdoi gjatë tërë muajit dhjetor. Gjatë klimës së terrorit që u krijua në ofensivën e “ndjekjes së terroristëve” më se 100 shqiptarë u torturuan për të “gjetur” autorët e krimin!

Vetëm ata të cilët kanë kaluar nëpër duart e hetuesisë serbe mund ta imagjinojnë tmerrin që kanë përjetuar këta persona për të pranuar veprën që nuk e kishin bërë. U torturuan barbarisht derisa pranuan të nënshkruajnë deklaratat e përpiluara nga hetuesia.

Edhe pse kësaj radhe nuk u nxor asnjë nga “terroristët” e arrestuar që të “pohonte” para gazetarëve vrasjen, siç ndodhi me Bekim Mazrekun për rastin e “ekzekutimit të civilëve serbë në Kleçkë”, mediat serbe vazhdonin të manipulonin me “rezultatet” e hetimeve. Publiciteti i madh iu dha një “terroristi shqiptar”, anonim për publikun gjoja për të mos i rrezikuar rrjedhat e hetimeve, i cili “ishte arrestuar para se të kryhej ky aksion terrorist, por, që nuk kishte folur deri në orën 21 e 30 minuta! Ai ka treguar për këtë krim vetëm atëherë kur kishte kaluar koha e paraparë për aksion dhe kur kishte qenë i bindur se aksioni kishte përfunduar.”¹

Mëse 100 shqiptarë iu nënshtruan “hetuesisë” serbe për “ndriçimin” e vrasjes në kafenenë «Panda». Ndër ta përzgjedhën gjashtë të rinj, që “pranuan” se “si pjesëtarë të UÇK-së kishin krijuar një grup të veçantë të emëruar «Bombaşi» dhe kishin vrarë shumë policë në fshatrat Prilep dhe Carrabreg të Komunës së Deçanit. Në fund kishin kryer vrasjen e gjashtë të rinjve serbë dhe malazez në kafenenë «Panda».”²

Jo vetëm veprat që u ngarkoheshin të akuzuarve, por edhe emërtimi i grupit me një fjalë jo shqipe, «Bombaşi», dëshmon se ky rast ishte shpikur tërësisht në laboratorët politikë, hetimorë dhe gjyqësorë të regjimit të Beogradit.

Më 16 qershor 1999, pas gjashtë muaj torturash në Burgun e Qarkut në Pejë, ditën kur forcat e KFOR-it erdhën në këtë qytet, forcat serbe në largim morën me vete si pengje të gjithë të burgosurit e këtij burgu. Në mesin e tyre ishin edhe Gazmend

¹ Vreme, nr. 427, artikulli i cituar

² Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Leskovc, K.br 41/99 të 09.11.1999

Bajrami, Vllaznim Përgjegjaj, Xhevdet Bajrami, Beqir Loxhaj, Agron Kollçaku dhe Behar Bajri. Në këtë datë, kur Peja shënoi ditën e çlirimit nga forcat serbe, për këta gjashtë të rinj shqiptarë filloi akti i dytë i tragjedisë. Xhelatët mbetën të njëjtë! Vetëm “skena” ndryshoi vendin!

Të transferuar fillimisht në Burgun e Qarkut të Leskovcit¹, të arrestuarit iu nënshtruan sërish torturave. Pastaj u transferuan në Burgun e Zajçarit², për t’u kthyer sërish në Burgun e Leskovcit.

Më 18 tetor 1999, në Gjykatën e Qarkut të Leskovcit filloi gjykimi i gjashtë të akuzuarve për vrasjen e të rinjve malazez e serbë në kafenenë «Panda» dhe për vrasjen e policëve serbë në fshatrat e Komunës së Deçanit.

Gjykimi për këtë rast zgjoi interesim të jashtëzakonshëm të mediave dhe të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Që në hapje të procesit gjyqësor të gjithë të akuzuarit hodhën poshtë akuzat dhe u deklaruan të pafajshëm. Ata sqaruan se kishin qenë të detyruar të nënshkruanin deklaratat me të cilat pohonin vrasjet e lartpërmendura dhe se realisht nuk kishin qenë pjesëmarrës në asnjë vrasje. Të akuzuarit zhveshën këmishët në prani të atyre që ishin në sallën e gjykatës dhe treguan shenjat e plagëve nga torturat. Shenjat e prerjeve me thika dhe djegieve me zjarr, si në kohën e inkuizicionit, i tmerruan të pranishmit në sallën e Gjykatës së Qarkut në Leskovc. Përballë kësaj situate të paparashikueshme gjykatësi ndërpreu gjykimin.

Ndërprerja e procesit gjyqësor ishte tregues se edhe në Serbi kishte gjykatës që nuk mund të kapërdinin turpin e proceseve të montuara gjyqësore mbi bazën e deklaratave të nxjerra me dhunë.

Tri javë më vonë, më 9 nëntor 1999, rifilloi gjykimi i gjashtë shqiptarëve të grupit «Bombaši». Të gjithë të akuzuarit u njoftuan se ishin liruar nga akuza për vrasjen e gjashtë të rinjve serbë dhe malazez në kafenenë «Panda». Shfajësimi për akuzat lidhur me vrasjen e 14 dhjetorit 1998 ishte një goditje e madhe për Slobodan

¹ Qytet në jug të Serbisë

² Qytet tjetër në Serbi, në kufi me Rumaninë.

Milošević-in, gjatë periudhës kur ende ishte në pushtet. Mirëpo, ata nuk u liruan si të pafajshëm!

Akuza për vrasjen e shumë policëve në fshatrat Prilep dhe Carrabreg të Komunës së Deçanit mbeti!

Me vendimin¹ e Gjykatës së Qarkut të Leskovcit, si anëtarë të këtij “grupi terrorist” dhe si “pjesëtarë të UÇK-së që kishin vrarë shumë policë në fshatrat Prilep dhe Carrabreg të Komunës së Deçanit, Gazmend Bajrami, Vllaznim Përgjegjaj, Xhevdet Bajrami, Beqir Loxhaj, Agron Kollçaku dhe Behar Bajri u dënuan me nga një vit burg!

Ndoshta dënimi me nga një vit burg ishte “kompromisi” që gjykata bëri me hetuesinë gjatë tri javëve të ndërprerjes së procesit gjyqësor. Ndoshta mbajtja edhe nga një muaj në burgjet serbe kishte të vetmin qëllim që të mos shfajësoheshin tërësisht! Këtu mund të shtrohen shumë hipoteza, pa përgjigje të sigurta. E vetmja gjë që është e sigurt në këtë rast konsiston në faktin se nuk ka asnjë vend në botë që vrasësit e “ruajtësve të rendit” t’i dënojnë aq pak! “Humanizëm” i paparë i gjykatave serbe! “Terroristë të UÇK-së”, që “kishin vrarë shumë policë” u dënuan vetëm me nga një vit burg! Apo dëshmi e kulluar e procesit të montuar gjyqësor? Le të vlerësojë lexuesi!

Një muaj më vonë, pas përfundimit të qëndrimit njëvjeçar në burg, më 15 dhjetor 1999, të gjashtë shqiptarët, të shoqëruar nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, u transferuan në Kosovë.

Për secilin lexues është e qartë se shpallja e pafajësisë së plotë e këtyre gjashtë shqiptarëve të rinj implikonte përgjegjësinë e hetuesisë serbe, që kishte përdorur tortura të tmerrshme për t’i detyruar të pranonin vepra që nuk i kishin bërë. Për çdo njeri është e qartë se të detyrosh dikë me dhunë të pranojë veprën që nuk e ka bërë, nënkupton që nëpërmjet këtij akti, ushtruesi i dhunës fsheh kriminelët e vërtetë! Kush ishin ata që duhej të fshiheshin dhe kush përpiqej të fshihte gjurmët e kriminelëve të vërtetë?

¹ K.br 41/99 të 09.11.1999

Çka e mundonte ndërgjegjen e Milošević-it?

Në shikim të parë, vrasja në kafenenë «Panda» nuk kishte asnjë lidhje me procesin gjyqësor kundër Slobodan Milošević-it. Së paku ai nuk ngarkohej për vrasjen e këtyre gjashtë të rinjve. Megjithatë, edhe pse kishte dështuar përpjekja që t'u ngarkohej shqiptarëve një krim i tillë, Milošević-i solli disa herë dëshmitarë që të tregonin përjetimet e tyre për këtë rast. Me anë të dëshmitarëve të Mitar Balević-it¹, Dragan Jašović-it², Radovan Paponjak-ut³ dhe të dëshmitarëve të tjerë, të ftuar nga mbrojtja e tij, Milošević-i përpigjej të “dëshmonte se sa brutalë, sa të pashpirt dhe sa shtazarakë, ishin ata që vrisnin fëmijë të pafajshëm!”⁴

Milošević-i flet për “brutalitetin e vrasjes së fëmijëve të pafajshëm”! Është e habitshme! Ai që orkestroi masakrat e shumë familjeve kroate dhe boshnjake në luftërat e mëparshme, gjatë të cilave u vranë me mijëra fëmijë, flet për “brutalitetin e vrasjes së fëmijëve”! Ai që urdhëroi vrasjen e familjes Jashari në Prekaz, të familjes Delia në Obri të Epërme, si dhe vrasjen e më se 1300 fëmijëve në Kosovë, që me anë të “marionetave” të propagandës së tij i quajti “inskenime me kukulla”, flet për vrasje fëmijësh! Sado paradoksal që është një qëndrim i tillë ajo që është me interes të dihet ka të bëjë me enigmën se çka e shtyu Slobodan Milošević-in të fliste për “brutalitet të vrasjes së fëmijëve”? A e bëri një gjë të tillë vetëm për faktin se fëmijët e vrarë kësaj here ishin serbë dhe malazez apo atë e vriste ndërgjegjja për diçka tjetër lidhur me këtë rast? Këtë nuk mund ta marrim vesh asnjëherë, sepse, edhe nëse

¹ Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, Dëshmitar Mitar Balević, seanca e 8 shkurtit 2005, f. 334-338
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, Dëshmitar Dragan Jašović, seanca e 27 prillit 2005, f. 184-187
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

³ Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, Dëshmir Radovan Paponjak, seanca e 5 majit 2005, f. 345-346
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

⁴ Dëshmia e cituar e Dragan Jašović-it, 27 prill 2005, f. 187
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

dalim para drejtësisë vrasësit e të rinjve në kafenenë «Panda», kufoma e Milošević-it është kalbur, së bashku me sekretet e “ndërgjegjes” së tij. Njerëzit e «kasapit të Ballkanit», që zbatuan urdhrat e tij, nuk do të flasin për këto krime. Pos në rastet kur presin ndonjë privilegj për vete. Vetëm ata që dëshirojnë t’i japin fund sekreteve të një mentaliteti të kalbur të nacionalizmit, mund t’i hapin dyert e «kasaphanës jugosllave» për të parë tmerret e një politike, që civilët e pafajshëm i shndërroi në “lëndë të parë”!

Kush urdhëroi vrasjen dhe kush ekzekutoi krimin?

Së paku në çdo përvjetor të tragjedisë së 14 dhjetorit 1998 familjarët e gjashtë të rinjve ngrinin zërin pse “askush nuk u dënua, asnjëherë askush nuk u përgjigj për këtë krim”. Ata dëshirojnë të dinë se kush urdhëroi dhe kush e ekzekutoi urdhrin.

Me gjithë faktin se aparatet e regjimit të Milošević-it kishin dështuar tërësisht në përpjekjet për t’ua hedhur fajin gjashtë shqiptarëve, mediat serbe nuk e ndalën spekulimin rreth kësaj tragjedie edhe pesëmbëdhjetë vjet më vonë! Pesëmbëdhjetë vjet pas kësaj ngjarjeje, gazeta beogradase «Politika», iu drejtua autoriteteve të EULEX-it në Kosovë për të mësuar nëse ishin duke u zhvilluar hetime lidhur me këtë rast. Gazeta njoftonte opinionin dhe lexuesit e vet se kishte mbetur pa përgjigje!¹

Kjo formë e mediatizimit të problemeve tanimë është e njohur. Nuk përjashtohet mundësia që në fazën e ardhshme, njësoj si në rastin e vëllezërve Mazreku, dirigjentët politikë dhe mediatikë të regjimit të vjetër të Serbisë, të orkestrojnë akuza të reja kundër misionëve ndërkombëtare në Kosovë dhe kundër gjykatësve të Gjykatës së Qarkut në Pejë, për gjoja humbjen e dosjeve dhe të dokumenteve lidhur me këtë rast!

Krahas përpjekjeve për të hedhur fajin jashtë Serbisë, si në rastin e «Krematorit të Kleçkës», gazetarët shprehën revoltë për

¹ Politika, «Ko je ubijo moje dete», (Kush e vrau fëmijën tim), 14.12.2013
<http://www.politika.rs/rubrike/Drustvo/Ko-je-ubio-moje-dete.lt.html>

faktin se “arrestimet e atëhershme të një numri të madh njerëzish, nuk dhanë asnjë rezultat.” Por gazeta «Politika» nuk u ndal me kaq. Ajo hapi dilema të reja se gjoja “që nga ajo periudhë ka mbetur e paverifikuar informata se gjithçka ishte organizuar nga Dauti, vëllai i Ramush Haradinajt!¹ Është interesant të theksohet se për herë të parë gazetatat serbe i dhanë hapësirë qëndrimeve të përfaqësuesit të përgjithshëm të UÇK-së Adem Demaçit² i cili “këtë krim ia ngarkoi Shërbimit Sekret Serb.”³

Familjarët e viktimave nuk lanë dyer pa trokitur për të zbuluar të vërtetën për këtë vrasje tragjike. Kështu, Ljubiša Ristić-i, babai i Svetislav-it të vrarë në kafenenë «Panda», është shprehur: “Gjatë gjithë këtyre viteve nuk ka mbetur asnjë adresë që nuk i jemi drejtuar për të marrë përgjigje se kush i vrau fëmijët tanë? Kemi kërkuar që të fillojnë hetimet atë vit që ndodhi krimi, kemi vazhduar edhe më vonë, kur bashkësia ndërkombëtare mori drejtimin e Kosovës. Këtë e kemi kërkuar edhe nga pushteti ynë në Beograd, që të bëjë gjithçka që është në mundësinë e tij, që të kemi një përgjigje (...) Të gjithë e bënë veshin e shurdhër. Askush nuk ka treguar as gatishmërinë më të vogël që të bëhen hapa konkretë për gjetjen e vrasësve dhe për ballafaqimin e tyre me drejtësinë. Unë e përjetoj këtë sikur të na vriteshin fëmijët për së dyti”⁴ - u shpreh ky princ i mbushur me dhembje dhe zhgënjim.

¹ Akuza kundër Ramush Haradinajt ishte përgatitur nga hetuesia e regjimit të Milošević-it. Akuzë identike u përpilua edhe nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, por Ramush Haradinaj u shpall i pafajshëm dhe u lirua nga të gjitha akuzat. Këtë rast do ta trajtoj në kapitullin kushtuar negociatave për përcaktimin e statusit final të Kosovës.

Politika, artikulli i cituar «Ko je ubijo moje dete»

² Adem Demaçi shkrimtar shqiptar nga Kosova, që ka vuajtur 28 vjet burg nën regjimin komunist jugosllav. Konsiderohet si Mandela i Evropës. Më 1991, Parlamenti Evropian i dha Cmimin Saharov. Gjatë luftës në Kosovë ka qenë përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së.

³ Politika, artikulli i cituar «Ko je ubio moje dete»

⁴ Svet, «Krvavi pir: Deceniju i po od stravičnog masakra u Peći još uvek se ne zna ko su ubice šestorice mladića »
<http://www.svet.rs/hronika/krvavi-pir-deceniju-i-po-od-stravicnog-masakra-u-peci-jos-uvek-se-ne-zna-ko-su-ubice-sestorice-mladica>

Cilat janë arsyet e vërteta që autoritetet e Beogradit bënë veshin e shurdhër dhe nuk hodhën asnjë hap konkret për të ndriçuar këto vrasje?

Në epilogun e kapitullit të parë solla pjesë nga dëshmia publike e policit serb, Slobodan Stojanović-it, ndër të tjera edhe për vrasjen e doktorit serb, Branimir Đokić-it në vitin 1998. Atë e vrau polici serb Goran Stamenković – Stamenko, vetëm pse dinte shumë për krimet serbe në Kosovë dhe kërcënoi se do të tregonte. Pikërisht për këtë e vranë dhe, për të fshehur gjurmët e krimit, u shpall se e kishin vranë “terroristët e UÇK-së”!

Pesëmbëdhjetë vjet pas këtij krimi, familjarët e Branimir Đokić-it e kuptuan se kush ishte në të vërtetë vrasësi i doktorit. Sado e hidhur t’u duket fakti se ai nuk është vranë nga “terroristët shqiptarë”, por nga një polic serb, vetëm e vetëm nga shkaku se ai nuk është pajtuar me krimet kundër civilëve të pafajshëm, kjo duhet të jetë një ngushëllim për ta. I takon Gjykatës për Krime Luftë në Serbi të ngrejë padinë kundër policit Goran Stamenković – Stamenko dhe kriminelëve të tjerë përreth tij. Dënimi i ekzekutorëve që bënë krime në Kosovë, në mesin e të cilëve edhe vrasësi i këtij doktori serb, do të kontribuonte që drejtësia të vihet në vend!

Më 26 korrik të vitit 2000, Gjykata Ushtarake në Nish shqiptoi dënimin me 7 vjet burg kundër Miroslav Filipović-it, gazetarit serb të gazetës beogradase «Danas», i cili, në të njëjtën kohë ishte gazetar i «Agjencisë France-Presse» dhe analist i «Institutit Raportues për Luftën e Paqen»¹. Ky gazetar serb u dënua për të vetmin “krim” sepse ngriti zërin kundër krimeve serbe në Kosovë. Rreth këtij procesi do të flas më gjerësisht në kapitullin kushtuar situatës në Kosovë gjatë bombardimeve të NATO-s.

Në këtë pjesë të librit tim po kufizohem vetëm në një të dhënë, që mund të ndihmojë në hapjen e shtegut për të parë edhe nga një këndvështrim tjetër shumë raste që mbetën të pasqaruara e që regjimi i Milošević-it ua atribuoi “terroristëve të UÇK-së”.

¹ *Institute for War and Peace Reporting.*

Në shkrimin e tij të titulluar «Rrugëtimi i gjatë për të vërtetën e krimeve»¹, Miroslav Filipović-i thekson se “prapa shpinës së Qeverisë formale të Serbisë u formuan eskadronët e përbërë nga serbë që sulmonin serbët dhe pronat e tyre në Kosovë dhe kështu i ngritën tensionet ndëretnike.”²

Serbë që sulmonin pronat e serbëve dhe për këtë akuzonin “terroristët e UÇK-së”! Serbë që përdhosnin varrezat e serbëve dhe akuzonin “terroristët e UÇK-së” për këto vepra të shëmtuara! Serbë që vrisnin serbë dhe akuzonin “terroristët e UÇK-së” për këto vrasje! Sado paradoksale që duket, ky ishte realiteti që imponoi regjimi i Milošević-it në fundin e shekullit XX-të! Ambicjet politike të këtij regjimi totalitar zhvlerësuan në përmasa të paimagjinueshme vlerat njerëzore në përgjithësi dhe jetën e njeriut në veçanti!

Sa i përket “qëndrimin ndaj jetës”, në kapitullin e parë lexuesi pati mundësi të njihet edhe me deklaratën e kolonelit të policisë serbe, Slavko Nikić-it, i cili për këtë çështje më së shumti e çmonte qëndrimin e Gjeneralit serb, Ratko Mladić-it!³

Të gjithë ata që kanë lexuar sadopak për luftën në Bosnjë janë në dijeni se emri i Ratko Mladić-it është bërë sinonim i kriminelit më të tmerrshëm dhe më të pamëshirshëm të kësaj lufte, pikërisht për shkak të qëndrimit të tij mospërfillës ndaj jetës së civilëve të pafajshëm! Me udhëzimet e tij Slavko Nikić-i erdhi në luftën e Kosovës. Erdhi në Kosovë për të zbatuar qëndrimet e Ratko Mladić-it për jetën!

Në ballinën e librit «Rrëfim: Ndoshta», autor i të cilit është Slavko Nikić-i, është fotografia e këtij koloneli të policisë serbe i veshur me uniformë të UÇK-së dhe me kapelë të zezë!

¹ Republika, Miroslav Filipović, «Dugi marš ka istini o zlocinima», Nr. 263
http://www.yuope.com/zines/republika/arhiva/2001/263/263_16.html

² Po aty

³ Slavko Nikić, vepra e cituar *Nulta Krvna Grupa*, f. 8.

Në emisionin televiziv «Ćirilica», të udhëhequr nga gazetari Milomir Marić-i, Slavko Nikić-i u pyet për këtë fotografi. Slavko Nikić-i pohoi se është uniformë e UÇK-së, që e ka veshur në raste të caktuara dhe të cilën ia ka dhënë një shok i tij, oficer i policisë serbe. “Për momentin nuk dëshiroj t’ia përmend emrin, por mund të bëjmë emisione të tjera, ku mund të sqarohen shumë gjëra”¹ - deklaroi Slavko Nikić-i.



Slavko Nikić i veshur me uniformën e UÇK-së

Gazetari e orientoi bisedën rreth emrit të oficerit serb që ia kishte dhënë këtë uniformë Slavko Nikić-it. Për t’i bindur telespektatorët se ishte në dijeni për këtë çështje, gazetari ngulte këmbë duke iu drejtuar Slavko Nikić-it: “Ai që ta ka dhënë uniformën në atë kohë quhej Šumadinac?”²

“Nuk e di si është quajtur në atë kohë”, - u përgjigj me sarkazëm koloneli i policisë serbe, - “por Milomir Marić-i e di saktësisht se kush ma ka dhënë.”³ Pra, në mënyrë të tërthortë ai e pranon se e ka marrë uniformën e UÇK-së nga oficeri serb me nofkën “Šumadinac”!

Për problematikën tonë, çështja se nga e ka marrë Slavko Nikić-i uniformën e UÇK-së është dytësore. Ajo që është më e rëndësishme për të sqaruar lexuesin lidhet me çështjen se çka ka bërë i veshur me këtë uniformë? Në cilat aksione ka marrë pjesë i

¹ Ćirilica - Joca Jovanovic, Zoran Petrovic, Slavko Nikic 4/7
<http://www.youtube.com/watch?v=ID1k3TKVfQo>

² Po aty

³ Po aty

maskuar si ushtar i UÇK-së? Për çfarë qëllimi e ka bërë një gjë të tillë? Me sa uniforma ka operuar në Kosovë? Sa kapela ka ndërruar gjatë operacioneve të ndryshme?

Gjatë operacionit «SABLJA» të ndërmarrë për arrestimin e personave të implikuar në vrasjen e ish-Kryeministrit serb, Zoran Đinđić-it, në mesin e pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Sigurimit Shtetëror të Serbisë u arrestua edhe Slavko Nikić-i, si “anëtar i Klanit të Zemunit.”¹

Po përmendim shkurtimisht për lexuesin se në atë kohë, kjo organizatë kriminale udhëhiqej nga koloneli serb, Milorad Ulemek-Legija², i cili është dënuar me dënimin maksimal³ prej 40 vjet burg, për shkak të implikimit në vrasjen e politikanit serb, Ivan Stambolić-it, të vrasjes së Kryeministrit serb, Zoran Đinđić-it, të vrasjes së katër anëtarëve të Partisë së Rilindjes Serbe, për tentim vrasjen e Vuk Drašković-it dhe shumë krimeve tjera.

Pyetjet e mësipërme, si dhe shumë pyetje të kësaj natyre, mund të kenë përgjigje në formë hipotezash. Këtë çështje mund ta sqarojë vetëm një proces hetimor që do të kishte për qëllim ndriçimin e rasteve të pandriçuara deri tani.

Nuk mund të jem i sigurt nëse ka marrë pjesë Slavko Nikić-i në vrasjen e gjashtë të rinjve serbë dhe malazez në kafenenë «Panda» të Pejës! Vetëm një gjë është e sigurt: i maskuar me këtë uniformë ai nuk ka marrë pjesë në luftime kundër ushtarëve të UÇK-së.

¹ Slavko Nikić, vepra e cituar, *Nulta Krzna Grupa*, f.171

² Vepra “Legija i Zemunski Klan” e autorit Marko Lopušina sjell informata të shumta për veprat e këtij kriminel.

³ Dënimin maksimal që parasheh Kodi Penal i Serbisë,

EPILOGU I KAPITULLIT TË DYTË

Eskadronët e vdekjes

Dy javë pas përkujtimit të 15 vjetorit të vrasjes në kafenenë «Panda», kryeministri aktual i Serbisë, Aleksandar Vučić-i, në atë kohë ishte zëvendëskryeministri i Qeverisë serbe, deklaroi në emisionin «Teška reč» në TV Pink se:

“Në Serbi pushteti vriste edhe ata që mendonin ndryshe, edhe kundërshtarët e vet. Ky është një problem i tmerrshëm për vendin tonë. Fjala është për pushtetin, pjesë e të cilit kam qenë edhe unë, por në gjëra të tilla nuk kam marrë pjesë (...) Ka shumë gjëra të tmerrshme, me të cilat duhet të ballafaqohemi. Për shembull vrasjen e gjashtë të rinjve serbë në kafenenë «Panda» të Pejës në vitin 1998. Nuk ka fakte se këtë krim e kanë kryer shqiptarët, ashtu siç është besuar.”¹

Një deklaratë e tillë e thënë nga zëvendës-kryeministri i Qeverisë serbe pati efektin e bombës dhe ngjalli shpresat se më në fund do të hapet një mundësi e re për ndriçimin e krimeve të shumta që kishin mbetur pa u sqaruar. Megjithatë, përgënjeshtrimi se prapa kësaj masakre qëndronin “terroristët shqiptarë” dhe drejtimi i gishtit tregues në institucionet shtetërore serbe mobilizoi strukturat e regjimit të vjetër që të bëjnë përpjekjen e fundit për t’i fshehur gjurmët e krimit. Në funksion të kësaj, gazeta beogradase «Nedeljnik» shpërndau “informatat nga burimet e veta të ‘sigurta’ se këta gjashtë të rinj serbë i kishte vrarë Shërbimi i fshehtë britanik, MI-6, me qëllim që të provokoheshin konfliktet në Kosovë, të shpërnguleshin serbët dhe të nxitej lufta kundër Jugosllavisë.”²

Me qëllim që të vazhdonin të manipulonin opinionin publik të Serbisë, mediat serbe i kushtuan një rëndësi të veçantë “zbulimit” të «Nedeljnik»-ut. Nëse i hedhim një vështrim mediave kryesore serbe do të shohim dominimin e artikujve lidhur me këtë “zbulim”.

¹ Radijo-televizija Srbije, «Vučić: Država je ubila Čuruviju», 29.12.2013
<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1482926/Vu%C4%8Di%C4%87%3A+Dr%C5%BEava+je+ubila+%C4%86uruviju.html>

² Nedeljnik, «Engleska služba M-6 najverovatno ubila dečake u Peći»
<http://www.nedeljnik.co.rs/sr/dnevni-magazin/nedeljnik-saznaje-engleska-služba-m-6-najverovatnije-ubila-dečake-u-peći>

«Shërbimi britanik MI-6 vrau djelmoshat serbë në Pejë»¹, «Tronditëse: Shërbimi i fshehtë britanik MI-6 vrau djelmoshat në Pejë»², «Hyrje në dëbimin e serbëve: Shërbimi britanik MI-6 vrau djelmoshat serbë në Pejë?!»³ janë vetëm disa nga titujt e shumtë që u vunë në funksion të kërkimit të fajtorëve për këtë vrasje jashtë Serbisë.

Sipas pohimeve të gazetave serbe “perëndimi mundohet ta heshtë këtë masakër, por, Raporti i Helena Hant⁴ përmend se katër pjesëtarë të këtij shërbimi ishin në Reçak!”



Fotoja që ilustronte shkrimet e lartpërmendura⁵

¹ Vestinet, Britanska služba MI6 ubila srpske dečake u Peći, da isprovocira pogrom Srba i rat
<http://www.vestinet.rs/u-fokusu/britanska-sluzba-mi6-ubila-srpske-decake-u-peci-da-isprovocira-pogrom-srba-i-rat>

² Srbinfo, «ШОКАНТНО: Британска тајна служба МИ6 убила српске дечаке у Пећи»
<http://srbinfo.info/2014/01/08/sokantno-britanska-tajna-sluzba-mi6-ubila-srpske-decake-u-peci-video/>

³ Kurir, «Uvod Za Pogrom Srba: Britanska služba MI6 ubila srpske dečake u Peći?!»
<http://www.naslovi.net/2014-01-08/kurir/uvod-za-pogrom-srba-britanska-sluzba-mi6-ubila-srpske-decake-u-peci/8512586>

⁴ Kurir, artikulli i cituar «Uvod Za Pogrom Srba:»
Për çfarë raporti bëhet fjalë dhe për personin të cilit as mbiemrin nuk ia dijnë ata që bënë këtë «zbulim» do të flas gjërësisht në kapitullin e ardhshëm

⁵ Shih ndër të tjera artikullin:
Vestinet, «Britanska služba MI6 ubila srpske dečake u Peći, da isprovocira pogrom Srba i rat»

Për ta përforcuar mundësinë e manipulimit të opinionit publik, shumica e shkrimeve shtuan edhe një foto ku mund të “shiheshin katër pjesëtarët e Shërbimit MI-6”! Madje, me fytyra të fshehura për publikun! Mund t’i duket dikujt si më e besueshme!

Kjo formë e manipulimit mediatik u ndërpre shumë shpejt sepse nuk hasi në mbështetjen e institucioneve shtetërore të Serbisë. Jo vetëm që nuk gjeti mbështetjen e duhur, por, përkundrazi, Aleksandar Vučić-i, në cilësinë e Zëvendëskryeministrit të Serbisë në atë kohë, reagoi lidhur me këto gënjeshtra dhe hodhi poshtë çfarëdo implikimi të Shërbimit Sekret Britanik në vrasjen e gjashtë të rinjve serbë e malazez në kafenenë «Panda»¹. Krahas reagimit tij, edhe mjaft personalitete të tjera të jetës politike dhe intelektuale të Serbisë u prononcuan dhe dolën në mbështetje të Vučić-it për t’i shkuar deri në fund sqarimit të vrasjeve nga regjimi i Milošević-it.

Me një fjalë, qëndrimi i Aleksandar Vučić-it hapi jo vetëm «kutinë e Panda-s», por «kutinë e Pandorës» së krimeve të regjimit të Slobodan Milošević-it, që kishin mbetur enigmatike².

Për një kohë të shkurtër doli në shesh se këtë krim e kishte bërë kreu i shtetit serb. Sado tronditëse të duket një lajm i tillë, kjo nuk ishte befasuese për disa familjarë të viktimave të kësaj tragjedie.

Nëna e Dragan Trifunović-it, Ljubica, në intervistën ekskluzive për gazetën «Vesti» deklaroi se “Jemi të pezmatuar nga shteti ynë.”³ Kjo nënë që nuk kishte lënë derë pa trokitur për të mësuar se kush ia vrau djalin sqaroi në këtë intervistë: “*Dyshimet që fëmijët tanë nuk i kishin vrarë shqiptarët u shfaqën jo shumë kohë pas vrasjes. Atë e them haptazi si nënë dhe le të më dënojnë. Shteti i ka vrarë dhe shpresoj se nuk do të kalojë shumë kohë dhe do ta marrim*

<http://www.vestinet.rs/u-fokusu/britanska-sluzba-mi6-ubila-srpske-decake-u-peci-da-isprovocira-pogrom-srba-i-rat>

¹ Blic, «Vučić: MI6 nije učestvovao u ubistvu srpskih mladića u Peći»

<http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/434579/Vucic-MI6-nije-ucestvovao-u-ubistvu-srpskih-mladica-u-Peci>

² Për vrasjen e gazetarit Slavko Ćuruvija, që u zbulua në të njëjtën kohë, do të flas në kapitullin e pestë.

³ Vesti, «Masakr dece je srpska sramota» (Masakrimi i fëmijëve është turpi i serbëve)

<http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/375876/Masakr-dece-je-srpska-sramota>

vesh se kush pati guximin t'ia ngrehte çarkun. Të vriten nga shteti dhe askush të mos flasë për 15 vjet mendoj se është njëra nga fshehtësitë më të mëdha shtetërore. Është koha që të ndriçohen gjërat përfundimisht. Së paku shpirtit tonë, shpirtit të prindërve do t'u bëhet më e lehtë. Me të vërtetë jemi të pezmatuar në shtetin dhe kërkojmë të zbulohet kush i bëri shoshë me 60 plumba këta të rinj të pafajshëm."¹

Në një shkrim² të datës 17 janar 2014, gazeta beogradase «Kurir» solli hollësira rreth asaj se kush qëndron konkretisht prapa këtij krimi të përbindshëm. Duke u bazuar në burimeve qeveritare të Serbisë, bëhet e ditur se informatat për masakrën në kafenenë «Panda» i kishte dhënë “ish Shefi i Sigurimit Shtetëror serb, Radomir Marković-i.” Sipas pohimeve të Radomir Marković-it, “Milorad Ulemek-Legija kishte organizuar likuidimin e djelmoshave serbë në kafenenë «Panda».”³

Përballë kësaj situate ku e vërteta filloi të dalë në shesh, “Milorad Ulemek-Legija u deklarua se është i gatshëm të dëshmojë se urdhri për vrasjen në Pejë ka ardhur nga kreu i Shërbimit të Sigurisë Shtetërore, në krye të së cilit ka qenë Rade Marković-i. Ata kanë filluar ta zbulojnë njëri tjetrin. Nuk e dimë se çfarë provash posedojnë, por është fakt se për këtë krim përgjegjës është shteti, konkretisht Sigurimi Shtetëror.”⁴

Sqarimi se prapa këtij krimi qëndronte shteti serb nuk i dha përgjigje pyetjes që dominonte në opinionin publik të Serbisë: pse regjimi i Beogradit vrau edhe fëmijë serbë në Kosovë?

Këtë aspekt e ndriçoi Vuk Drašković-i, kryetari i Lëvizjes së Ripërtëritjes Serbe, i cili gjatë periudhës më të vështirë të luftës në

¹ Po aty

² Kurir, «Rade Marković dao nalog da se ubiju srpska deca u Peći 1998?!», 17.01.2014
<http://www.kurir-info.rs/rade-markovic-dao-nalog-da-se-ubiju-srpska-deca-u-peci-1998-clanak-1182597>

³ Kurir, artikulli i cituar «Rade Marko»

⁴ Kurir, « Rade Marković dao nalog da se ubiju srpska deca u Peći 1998?! », 17.01.2014
<http://www.kurir-info.rs/rade-markovic-dao-nalog-da-se-ubiju-srpska-deca-u-peci-1998-clanak-1182597>

Kosovë (18 janar 1999 - 29 prill 1999) ishte Zëvendës-kryeministër i Jugosllavisë dhe i ngarkuar të udhëhiqte marrëdhëniet me jashtë.

Në intervistën për gazetën «Kurir» ish-zëvendës-kryeministri jugosllav Vuk Drašković-i, deklaroi: “Vendimin për serinë e krimeve kundër serbëve në Kosovë dhe shqiptarëve që e mbështetnin Serbinë dhe e dënonin UÇK-në, e solli Milošević-i dhe Shtabi i tij strategjik. Në krye të eskadronit të vdekjes, Njesisë për Operacione Speciale¹, u caktua Milorad Ulemek-Legija (...) Ky i merrte urdhrat nga Radomir Marković-i, ish-Shefi i Shërbimit të



Legija i gatshëm të dëshmojë se urdhrin për aksionin e ka marrë nga kreu i Sigurimit Shtetëror, në ballë të së cilës në atë kohë ishte Marković-i RADE MARKOVIĆ-I DHA URDHËR TË VRITEN FËMIJËT SERBË NË PEJË NË VITIN 1998?!

Marković-i pohon se Milorad Ulemek-u ka organizuar grupin që likuidoi gjashtë djelmosha serbë në kafeterinë “Panda” më 14 dhjetor të vitit 1998

¹ Në serbisht JSO (Jedinica za specielne operacije)

Sigurimit Shtetëror të Serbisë, i dënuar sikurse Milorad Ulemek-Legija, me 40 vjet burg për dhënien e urdhrat dhe porosinë e vrasjeve të lartpërmendura. Radomir Marković-i urdhrat i jepte drejtpërdrejt ose përmes njerëzve të tij. Për këtë çështje mund të merret në pyetje edhe Guri¹ (...)

U vendos që Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të kryente një varg sulmesh terroriste të cilat duhej t'i visheshin UÇK-së. Qëllimi i këtyre sulmeve ishte që UÇK-ja të paraqitej në sytë e bashkësisë ndërkombëtare si organizatë terroriste. Në të njëjtën kohë, përmes këtyre aksioneve do t'u jepej zjarr ndjenjave antishqiptare në Kosovë dhe në tërë Serbinë (...) Në funksion të kësaj strategjie, Sigurimi Shtetëror i Serbisë, me në krye Radomir Marković-in, me ndihmën e Milorad Ulemek-Legija-s, më 14 dhjetor 1998 kreu masakrën kundër gjashtë djelmohave serbë në kafenenë «Panda» në Pejë.²

Ndriçimi nga ana e politikanëve dhe bartësve të institucioneve shtetërore të Serbisë se prapa këtyre akteve terroriste të vrasjes së civilëve të pafajshëm qëndronin strukturat e shtetit të Serbisë është një hap i madh drejt ndriçimit të plotë të asaj që ka ndodhur në Kosovë. Pa marrë parasysh se përmes hedhjes së përgjegjësive te njëri-tjetri Milorad Ulemek-Legija dhe Radomir Marković-i dëshirojnë të nxjerrin përfitime individuale, duhet të gjendet mënyra se si të sillen para drejtësisë edhe ekzekutuesit e këtij krimi dhe krimeve tjera të kësaj natyre.

Megjithatë, sado shpresëdhënëse të jetë dëshira për të ndriçuar krimet e regjimit të Slobodan Milošević-it, logjika e vjetër është tepër e pranishme në të gjitha institucionet shtetërore të Serbisë. Shumë shpesh, të maskuar me gjoja “vendosmërinë për të mos bërë asnjë kompromis me kriminelët”, dërgohen mesazhe negative për ata që dëshirojnë të dëshmojnë për krimet e kryera. Në këtë

¹ Fjala është përgjeneraline Policisë serbe, Goran Radosavljević Guri-i për të cilin do të flas hollësisht në kapitullin e ardhshëm.

² Kurir, «Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu!» (Milošević-i urdhëroi Radeta-n dhe Legija-n që t'i vrisnin fëmijët serbë) <http://www.kurir.rs/vuk-draskovic-milosevic-naredio-radetu-i-legiji-da-ubiju-srpsku-decu-clanak-1185359>

kontekst e shoh edhe deklaratën e Prokurorit për krim të organizuar të Serbisë, Miljko Radisavljević-it, i cili në Konferencën për shtyp deklaroi: “Milorad Ulemek-Legija nuk mund të ketë as statusin e të dënuarit që bashkëpunon me prokurorinë e as ndonjë privilegj tjetër.”¹

Sipas mendimit tim, kjo është forma më e mirë për t'i shkurajuar ata që dëshirojnë të flasin për krimet e përbindshme të kryera nga strukturat shtetërore serbe! Kjo mund të shihet edhe në qëndrimin e ish-shefit të Shërbimit Sekret Serb. *“Radomir Marković-i në kërkesën për falje të dënimit që i drejtoi Kryetarit të Serbisë, Tomislav Nikolić-it, kërcënoi se do ta rrëzojë Serbinë në gjunjë nëse e publikon listën e krimeve të bëra kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë.”*²

Deklarata e njeriut që ka qenë në krye të Shërbimit Sekret të Serbisë për listën e krimeve që ky shërbim i kishte kryer kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, “LISTË QË DO TA GJUNJË-ZONTE SERBINË”, është domethënëse për përmasat e krimeve shtetërore kundër civilëve të të gjitha përkatësive etnike me qëllim të nxitjes së urrejtjes ndëretnike dhe stigmatizimit të UÇK-së si organizatë “terroriste”.

Për pesëmbëdhjetë vjet rresht është manipuluar me listat e civilëve të vrarë, vrasja e të cilëve i vishej UÇK-së. Këtë formë të manipulimit do ta trajtoj gjerësisht në kapitullin e fundit të librit tim. Shpresoj se në shtjellimin që iu bë rastit të vrasjes së gjashtë të rinjve të përkatësisë serbe dhe malazeze në kafenenë «Panda» lexuesi pati mundësi të shihte realitetin e propagandës që ia atribuonte këtë vrasje “terroristëve të UÇK-së”.

Familjarët e të vrarëve presin që ekzekutorët e këtij akti kriminal të dalin para drejtësisë! Pritjet dhe kërkesat e tyre janë plotësisht të ligjshme. Por, nuk duhet të harrohen as Gazmend Bajrami,

¹ Press, « Radisavljević: Ulemek neće imati nikakve privilegije zbog svedočenja » <http://www.pressonline.rs/info/hronika/297131/radisavljevic-ulemek-neece-imati-nikakve-privilegije-zbog-svedocenja.html>

² Kurir, artikulli cituar « Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu! »

Vllaznim Përgjegjaj, Xhevdet Bajrami, Beqir Loxhaj, Agron Kollçaku dhe Behar Bajri të cilët u torturuan në formën më mizore të mundshme për të pranuar veprat që nuk i kishin kryer. Atyre duhet t'u jepet dëmshpërblim për të gjitha vuajtjet që përjetuan.

KAPITULLI I TRETË

PROLOGU I KAPITULLIT TË TRETË

“Në qendër të fshatit, në shtëpinë ku ishte Shtabi i UÇK-së, policia gjeti një kompjuter me të dhënat e brigadës terroriste dhe listën prej 126 terroristëve që ishin në Reçak. Në mesin e tyre ishin edhe katër të huaj, me mbiemra amerikanë ose anglezë. Ata ishin instruktorë ose specialistë të huaj (...)

Nga zjarri i ashpër i terroristëve, forcat policore u detyruan të tërhiqeshin drejt Ferizajt. Terroristët hynë në Reçak. Atëherë filloi mashtrimi i madh, që në botë u përhap si masakra e civilëve nga ana e policisë serbe.

I tërhoqën trupat e terroristëve të vdekur nga përroi dhe istikamet dhe i vendosën në përroskë, ku më parë nuk kishte pasur asnjë kufomë. Terroristët i veshën dyzet kufoma me tesha civile, sepse për të tjerët nuk kishin veshmbathje. Të tjerët në uniforma i nisën për në fshatin Budakovë, ku sipas gjasave i kanë varrosur. Kuptohet, nuk donin kurrresi të shiheshin terroristët e vdekur në uniforma. Ata terroristë të likuiduar, që luftuan djallëzisht tërë ditën, duhej të paraqiteshin si ‘civilë paqësorë’.

Së bashku me kufomat, terroristët i morën dhe armët, që policët, për shkak të territ dhe të hapësirës së madhe, nuk mundën t’i mblihdnin.

Të nesërmen herët në mëngjes erdhi William Walker-i, xhelati, i cili Serbisë dhe RFJ-së dëshironte t’ia vinte lakun në fyt dhe t’ua hapte rrugën bombardimeve. Krimineli filloi banketin e tij të përgjakshëm. Walker-i u dha udhëzime terroristëve që ishin rreth tij se si duhej t’i renditnin kufomat që t’i përngjante masakrës, respektivisht ekzekutimit të civilëve. Pastaj i solli ekipet e TV-ve dhe gazetarët. Me fytyrë të mërzitur, gjoja tepër i prekur, William

*Walker-i dha deklaratën, me të cilën dënonte policinë serbe për «masakër».*¹

Shpresoj se në fund të këtij kapitulli lexuesi do të jetë në gjendje të gjykojë se a ishte «Masakra e Reçakut» gënjeshtër e inskenuar nga qarqet e caktuara për të arsyetuar ndërhyrjen ushtarake kundër regjimit të Milošević-it, siç pretendon gazetari i Radio Televizionit të Beogradit, apo kjo masakër ishte vetëm një “akt i tragjedisë” që përjetuan shqiptarët në Kosovë.

¹ Milovan Drecun, *Drugi kosovski boj* (Beteja e Dytë e Kosovës) f. 23

Lufta dhe «gënjeshtër mediatiqe»

Më 26 maj 2000, para të pranishmëve të ftuar nga Shoqata e Miqësisë Franko-Serbe në Lyon, gazetari belg, Michel Collon-i, nisi fjalimin e tij me këtë sintagmë: “Çdo luftë fillon me një gënjeshtër mediatiqe!”¹ Për të ilustruar qëndrimin e mësipërm, ai u tha të pranishmëve se “Masakra serbe e Reçakut nuk ka ekzistuar asnjëherë, por ishte një gënjeshtër që u sajua për të provokuar ndërhyrjen e NATO-s kundër Serbisë”.²

Ky gazetar, që trajton këtë problematikë edhe në veprën e titulluar «Monopoly...»³ ngul këmbë se legjitimimi i ndërhyrjes ushtarake u arrit falë mediatisimit të «Masakrës së Reçakut». Si ilustrim të mediatisimit ndërkombëtar të këtij rasti, autori përmend “gazetat më të mëdha frankofone, «Le Monde»-i i Parisit dhe «Le Soir» i Brukselit (...), që sollën prova për koka të thyera, krahë të prerë (...) të 15 kufomave të civilëve të gjetur në përrua, afër këtij fshati të qetë.”⁴

Në të njëjtën logjikë, në shkrimin «Industria e gënjeshtër dhe lufta imperialiste», filozofi italian, Domenico Lasurdo-ja, vlerësoi se “Masakra e Reçakut është e tmerrshme, me gjymtime dhe me koka të prera. Është skenë ideale për të nxitur indinjatën e opinionit publik ndërkombëtar (...). Siç na mëson lufta e Bosnjës, dhuna në trup, shenjat e torturës, kokat e prera janë armë mjaft të përhapura të propagandës (...)”⁵ Përveç përshkrimit të këtyre tmerreve, Lasurdo-ja shtron si hipotezë se “ndoshta nuk janë serbët që i gjymtuan trupat e viktimave, por, mund të jenë guerilast shqiptarë.”⁶

¹ Esprit Européen, «Michel Collon, l'anti-désinformateur»
http://www.esprit-europeen.fr/perspectives_desintox_collon.html

² Po aty.

³ Michel Collon, Monopoly - l'OTAN à la conquête du monde, Editions Epo, Bruxelles, 2000.

⁴ Esprit Européen, artikulli i cituar, «Michel Collon...»

⁵ Domenico Lasurdo, «Industrie du mensonge et guerre impérialiste»
<http://www.mondialisation.ca/industrie-du-mensonge-et-guerre-imperialiste/5349478?print=1>

⁶ Po aty

Hipoteza e Domenico Lasurdo-s se “guerilët shqiptarë mund të kishin gjymtuar trupat me qëllim që të nxisnin indinjatën e opinionit publik” për Michel Collon-in është fakt! Madje, ky gazetar belg ngul këmbë “se shumë janë nga ata që mendojnë se kufomat janë transportuar nga vendi i betejës, janë veshur si civilë, janë gjymtuar vetëm e vetëm për t’i dhënë këtij rasti karakter mizorie, për ta mediatizuar në atë mënyrë që sulmet e parapara nga NATO-ja kundër Jugosllavisë të bëheshin ‘politikisht të pranueshme’. Mund të thuhet se po të mos ekzistonte ky krim, NATO-ja do ta kishte shpikur, sikurse ujku i fabulës, që sajoi krimin e qengjit!”¹ - këmbëngulte Michel Collon-i në vërtetësinë e pohimeve të veta.

Para se t’i shqyrtoj argumentet e autorëve që «Masakrën e Reçakut» e paraqesin si “gënjeshtër” ose që denoncojnë “dezinformatat mediatike” që shërbyen, sipas tyre, si pretekst për të arsyetuar bombardimet e NATO-s kundër Serbisë, po ndalem në këtë ngjarje të 15 janarit 1999.

Çka ndodhi në të vërtetë atë të premtë janari në fshatin Reçak të Komunës së Shtimes?

Në shtjellimin e kësaj teme do t’u shmangem në maksimum referencave të burimeve shqiptare. Jo se këto burime janë më pak të besueshme, por, për të shmangur mundësinë që kjo analizë të shihet si konfrontim i dy vizioneve: vizionit shqiptar për atë që ndodhi në Reçak, përballë vizionit serb. Kam bindjen e plotë se lexuesi do të shohë zbulimin e së vërtetës duke zhveshur “të vërtetën serbe” për këtë rast. Për këtë arsye, një vend shumë i madh do t’u lihet interpretimeve serbe për «Masakrën e Reçakut» dhe konfrontimit të këtyre interpretimeve me rezultatet e punës së ekipeve të ekspertëve të Mjekësisë Ligjore serbo-bjelloruse dhe finlandeze.

Të shohim shkurtimisht kronologjinë e ngjarjes së 15 janarit 1999.

¹ Esprit Européen, artikulli i cituar, «Michel Collon...»

Komandanti i aksionit policor në Reçak, gjenerali serb, Goran Radosavljević Guri, në emisionin «Reçaku - gënjeshtër dhe e vërteta»¹, sqaroi qëndrimin zyrtar se për autoritetet serbe “fshati Reçak ishte cak legjitim, sepse në të nuk kishte civilë! Aksioni kishte filluar në orë 3:00 të mëngjesit.”²

Në mëngjesin e asaj dite, gazetarët e Radio Televizionit Shtetëror të Serbisë, Milovan Drecun-i dhe kameramani Tomislav Magoči, ishin përkrah policisë. Fillimisht, Tomislav Magoči filmonte nga maja e një kodre në afërsi të katundit, e më vonë filmimet i vazhdoi rrugëve të fshatit, duke ndjekur një veturë të blinduar. RTV Beogradi transmetonte vazhdimisht lajme nëpërmjet gazetarëve të vet “nga terreni”.

Në orën 15:00, Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë komunikoi “se gjatë përleshjes me bandat terroriste shqiptare u vranë 15 terroristë.”³

Atë ditë, shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së për Kosovën (MVK në vijim), William Walker-i, ndodhej për vizitë zyrtare në Mal të Zi. Zëvendësi i tij, gjenerali anglez Drewienkiewicz-i⁴ sqaroi se me datën 15 janar kishin ndodhur dy ngjarje: “një në Deçan dhe një në Reçak. Ai ishte nisur për në Deçan, ndërsa nga gjenerali Maisonneuve-i⁵, kërkoi të shkonte në Shtime.”⁶

Vëzhguesit ishin rreth 8 km larg nga vendi ku zhvillohej lufta!⁷ Megjithëse nuk shihej se ku binin granatat, pjesëtarët e

¹ Radio Televizija Serbije, «Račak - Laži i istine» (Raçaku- gënjeshtër dhe e vërteta) <http://www.youtube.com/watch?v=RH2LB-n3RpI>

² Po aty

³ Po aty dhe në artikullin e gazetës Le monde, «Les morts de Racak ont-ils vraiment été massacrés froidement ?» (A u masakruan me gjakftohtësi të vdekurit e Reçakut ?), 21 janar 1999

<http://www.srpska-mreza.com/ddj/Racak/Articles/LeMonde990121.html>

⁴ Karol John Drewienkiewicz

⁵ Gjenerali Joseph Omer Michel Maisonneuve, ishte shefi i MVK-së për Qendrën Rajonale të Prizrenit.

⁶ Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, seanca e 11 prillit 2002, f. 276.

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

⁷ Në tekst përdoret pesë milje (1milje=1609 m); Dëshmia e Karol John Drewienkiewicz, 13 maj 2002, f. 567.

MVK-së janë dëshmitarë të aksionit policor dhe ushtarak, ku u përdorën armët e rënda (tanket e tipit T55¹ dhe artileria kundër-ajrore). Implikimin e Ushtrisë Jugosllave në sulmin ndaj Reçakut dhe fshatrave përreth e konfirmoi edhe nënkoloneli serb, Petrović-i, gjatë takimit² me gjeneralin Maisonneuve, më 16 janar 1999, në Shtabin e Forcave të Armatosura serbe në Ferizaj.

Pas kthimit të William Walker-it nga Mali i Zi, “dikur vonë pasdite, gjenerali Drewienkiewicz-i e njoftoi se, sipas informatave të Lončar-it dhe njerëzve përreth tij, në përleshjet e armatosura ndërmjet forcave të sigurisë serbe dhe UÇK-së, në fshatin Reçak ishin vrarë 15 pjesëtarë të UÇK-së dhe nuk ishte lënduar askush nga ana e forcave qeveritare.”³

Pas informatave shqetësuese që erdhën te zyrtarët e lartë të MVK-së, në mëngjesin e 16 janarit, gjenerali Drewienkiewicz kërkoi drejtpërsëdrejti nga gjenerali Lončar që t'i shoqëronte, atë dhe William Walker-in, në fshatin Reçak, por, Lončar-i nuk pranoi.”⁴

“Lončar-i kishte mundësi të vinte me ne në vendin e ngjarjes dhe të shihte me sytë e vet atë që pamë. Por, ai refuzoi.”⁵- deklaroi William Walker-i.

Pse refuzoi gjenerali serb t'i shoqëronte Walker-in dhe Drewienkiewicz-in në Reçak? A ishte në dijeni të asaj që kishte ndodhur në të vërtetë në këtë fshat? Apo revolta e tij ndaj udhëheqësve të MVK-së fshihte diçka më tepër se një revoltë ndaj mosbesimit të interpretimit zyrtar serb që ngërthente në vete kërkesa që të shihnin me sytë e vet atë që kishte ndodhur në Reçak?

¹ Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, dëshmitari Joseph Omer Michel Maisonneuve, seanca e 29 maj 2002, f. 475-482.
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Po aty, f. 480-482.

³ Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, Dëshmitari William Walker, seanca e 12 qershor 2002, f. 602.
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

⁴ Po aty, f. 572

⁵ Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, Dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, 13 maj 2002, f. 578.
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

Gjenerali i policisë serbe që udhëhoqi aksionin, Goran Radosavljević Guri, pohoi se gjoja “përleshjet e policisë serbe dhe të terroristëve i xhiruan edhe dy agjenci të huaja, «Reuters»-i dhe «Associated Press»-i. U xhiruan terroristët e vrarë dhe tërë arsenalin i armatimit të tyre: dy mitraloza, 36 pushkë automatike, dy snajperë, bomba dhe municion. Të njëjtën ditë xhirimet i publikoi edhe «Libération»-i francez.”¹

Në funksion të manipulimit të opinionit publik, sidomos të atyre që nuk patën mundësi t'i lexojnë shkrimet e asaj kohe për këtë ngjarje, ky komandant policor, pa cekur as autorin, as titullin e artikullit e as datën e publikimit theksoi “se terroristët e vrarë u publikuan edhe në gazetën franceze «Libération»!”²

Në vijim po sjell për lexuesin pjesë të gjata të dy artikujve të gazetarit Pierre Hazan, që në këtë kohë ishte i dërguari special i gazetës «Libération» në Kosovë.

Shpresoj se pjesët e artikullit «Ishim të sigurt se të gjithë do të vdisnim»³, me anë të të cilit gazetari sjell dëshmi të fshatarëve të Reçakut për atë se çka përjetuan në dhjetë orët e sulmeve të ushtrisë dhe policisë serbe dhe pjesët nga artikulli që lidhet me dëshminë⁴ e një vëzhguesi të OSBE-së, do t'i mundësojnë lexuesit të kuptojë arsyet e vërteta pse komandanti i aksionit policor në Reçak nuk jep referencat e sakta lidhur me shkrimin e gazetarit të gazetës «Libération».

Në artikullin e titulluar «Masakra e Reçakut: rrëfimi i një dëshmitari çelës...»⁵, Pierre Hazan-i sjell rrëfimin e dëshmitarit:

¹ Večerne Novosti, «Laž za NATO bombe» (Gënjeshtër për bombat e NATO-s) <http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.292.html:230221-Laz-za---NATO-bombe>

² Po aty

³ Libération, Pierre Hazan, «Nous étions sûrs de tous mourir. Des habitants de Racak racontent les dix heures de massacre», 18 janar 1999.

http://www.liberation.fr/evenement/1999/01/18/nous-etions-surs-de-tous-mourir-des-habitants-de-racak-racontent-les-dix-heures-de-massacre_261409

⁴ Libération, Pierre Hazan, «Massacre de Racak: récit d'un témoin clé. Arrivé après la tuerie, il dément la thèse d'une mise en scène», 27 Janvier, 1999, (Masakra e Reçakut: tregimi i një dëshmitari çelës. Kishte ardhur pas vrasjes dhe përgënjeshtroi tezën serbe për inskenim”).

http://www.liberation.fr/monde/1999/01/27/-_262191

⁵ Po aty

“Rreth orës 15:45, një çerek ore pas përfundimit të të shtënave, forcat serbe u larguan nga fshati (...) Ne vendosëm të hynim në Reçak. Një duzinë civilësh ishin aty në një gjendje tronditëse. Njëri nga ta na zgjati diçka. Njëri nga njerëzit e mi e mori. Papritmas konstatuam se ishte pjesë kafke. Përkthyesi ynë na shpjegoi se ky njeri sapo kishte gjetur kufomën e vëllait të vet, me kokë të copëtuar. Ne pamë një trup. Plumbi i kishte krisur mbi kokë dhe tërë kafka ishte copëtuar. Fshatarët na thanë se nja njëzet burra ishin arrestuar (...) Ora ishte rreth 17:30. Bënte terr i zi. I mora 5 të plagosur. Të gjithë civilë. Këtë të premte, për herë të parë dhe të vetme, një grua na tha se burrat ishin dërguar për ekzekutim. Ajo ishte në gjendje tejet të shqetësuar. Vajza e saj ishte e plagosur. Jemi afruar rreth 400 ose 500 metra afër përroit, por nuk pamë gjë. Në orën 18:00 u larguam nga Reçaku...”¹

“Të shtunën në orën 8:45”- vazhdon tregimin vëzhguesi i OSBE-së, që gazetari e paraqet vetëm me emrin «Mike»- “ne u kthyem përsëri në Reçak. Ushtarët e UÇK-së ishin aty. Ata i zbuluan të vdekurit në të njëjtën kohë me ne (...). Disa media pretendojnë se ata kanë organizuar një inskenim për ta bërë të besueshme masakrën. Duhet të kishin qenë gjeni të inskenimit, të pajisur me një talent të jashtëzakonshëm për aktrim (...). I morëm gëzhojat si prova. Ndoshta nja dy duzina gëzhoja dhe karikatorë. Ushtarët e UÇK-së i morën 9 shokët e tyre. Kufoma pa koka. I pashë nja njëzet kufoma në përrua, të ekzekutuara me nga një plumb në kokë. Mandej kufoma të tjera përreth. Këta, sipas asaj që shihej, kanë tentuar të iknin. Pastaj zbrita në fshat, aty ku viktimat ishin vrarë me nga një plumb në kokë ose duke u përpjekur të iknin. Pashë trupin e një djaloshi 12-vjeçar, i vrarë me një plumb pas qafe, pranë kufomës së babait të vet. Pashë kufomën e një burri pa kokë, të cilën e gjeti vëllai i tij. I kishin mbetur flokët e hequra me lëkurën e kafkës. A janë gjymtuar këta trupa apo kafshët ua kanë ngrënë mishin? Nuk e di! Vëllai i vuri ndërmjet shpatullave atë që kishte mbetur nga koka...”²

¹ Po aty

² Libération, Pierre Hazan, artikulli i cituar «Massacre de Racak...»

Në artikullin «Ishim të sigurt se të gjithë do të vdesim»¹, Pierre Hazan-i filloi dëshminë e fshatarëve të Reçakut me thëniet e një fëmije të vrarë në këtë aksion. “Kujdes mami, ata do të vrasin!”, ishin fjalët e fundit të Halim Beqirit, 12-vjeçar. Një plumb e goditi pas qafe. Kishte gjak në gojë. Isha dy metra larg. Serbët shtinin nga të gjitha anët. Nuk mund të afrohesha. ‘Ata e vranë edhe burrin tim. Ai ishte pranë djalit tonë’” rrëfente nëna e tij, Eminja.

“Burrat u ndanë në disa grupe. Nja 20 veta u dërguan mbi fshat. Na thanë se do të na çonin në stacionin policor. Por dëgjoheshin krisma nga të katër anët”, tha Rama, një burrë rreth dyzet vjeç. “Pjesa tjetër e grupit u dërguan në përrua. Policët serbë i prisnin që t’i vrisnin.”

“Të shtunën, trupat e këtyre njëzet burrave ishin ende njëri mbi tjetrin, në pozicionin që ishin vrarë. Ishin ekzekutuar nga afër. Një vdekje e përgatitur dhe e ekzekutuar me gjakftohtësi. Në orën 17:00 serbët u tërhoqën. Të mbijetuarit filluan të lëvizin. Një nga shtëpitë e para të fshatit, afër xhamisë, ishte ajo e Azem Banosit², 62-vjeçar. Kufoma e tij, pa kokë, ishte pranë shtëpisë së tij. Vëllai i tij, Bedriu, 55-vjeçar, kërkonte kokën. Fshatarët e gjetën më vonë. Në fshat ishte edhe një kufomë e një burri të gjymtuar. Një adoleshent sapo kishte gjetur kufomat e tre vëllezërve të tij...”³

Mendoj se lexuesi i kupton arsyet e vërteta pse ky gjeneral i policisë serbe nuk jep të dhëna të sakta për artikujt e gazetës «Libération», në të cilat, sipas propagandës serbe, “ishin botuar pamjet e terroristëve të vrarë”. Arsyeja e vërtetë qëndron në faktin se këto dy shkrime, në të njëjtën masë, si dhe qindra shkrime të tjera kushtuar kësaj ngjarjeje tragjike, nxjerrin në shesh se kush ishin terroristët e vërtetë në këtë luftë.

“E shtunë pasdite”, vazhdon Pierre Hazan-i. “Ora ishte gati 15:00 kur erdhi gjenerali Walker, shefi i Misionit të OSBE-së. Të mbijetuarit nga kjo ngjarje e dërguan Walker-in te përroi ku ishin të shtrira mbi njëzet viktima”.

¹ Libération, Pierre Hazan, artikulli i cituar «Nous étions sûrs ...»

² Fjala është për Banush Azem Kamberin (shih listën e vrarëve të Reçakut në tekstin më poshtë).

³ Libération, Pierre Hazan, artikulli i cituar «Nous étions sûrs ...»



*Reçak, 16 janar 1999,
William Walker-i pranë kufomave të fshatarëve*

“Janë vrrarë me nga një plumb në kokë ose pas qafe”, deklaroi pa asnjë dyshim William Walker-i.

Në orën 18:00, pasi u kthye në Prishtinë, Walker-i organizoi një konferencë për shtyp: “Unë i akuzoj forcat policore dhe

ushtarake serbe se janë përgjegjëse për këtë masakër. Para disa ditësh, Ushtria Çlirimtare e Kosovës liroi 8 ushtarë serbë. Prisnim një masë reciprociteti. E çka kemi në vend të saj? Vrasje të 40 civilëve të pafajshëm. Dëshiroj të di se kush ka dhënë urdhër. Duhet të dalin para drejtësisë. Nuk jam jurist, por, sipas meje, këtu ka ndodhur një krim kundër njerëzimit. Kam kërkuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë t'i dërgojë ekspertët e vet brenda 24 orëve, me ose pa viza, dhe e këshilloj qeverinë serbe t'i lejojë të hyjnë në territorin jugosllav.”¹

Jo vetëm që këshillat e shefit të OSBE-së nuk u përfillën nga autoritetet e Beogradit, por përkundrazi. Të nesërmen e konferencës për shtyp të Walker-it, më 17 janar 1999, edhe pse ishte ditë e diel, Qeveria e Beogradit, në mbledhjen e saj të jashtëzakonshme, shpalli William Walker-in “persona non grata” dhe i dha një afat prej 48 orësh për t’u larguar nga Jugosllavia.

Në të njëjtën ditë, me arsytim se mandati i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë kishte të bënte me konfliktet e armatosura e jo me operacionet policore kundër terroristëve, autoritetet e Beogradit nuk i lejuan prokurores së kësaj gjykate, Louise Arbour-it, hyrjen në Jugosllavi.²

Realisht, ky vendim i Qeverisë së Jugosllavisë ishte shprehje e shqetësimit që i kishte kapluar autoritetet serbe. Shqetësimi i autoriteteve qeveritare nga mediatizimi i asaj që kishte ndodhur në Reçak u publikua edhe në «Washington Post», më 28 janar 1999. Përgjimet telefonike të zyrtarëve të lartë shtetërorë të Jugosllavisë dëshmonin se kryeministri serb, Nikola Šainović-i dhe ministri i Brendshëm serb, Sreten Lukić-i, kishin frikë nga reagimet ndaj sulmit në Reçak dhe kishin biseduar rreth mënyrës për ta paraqitur si sulm të trupave qeveritare ndaj UÇK-së.³

Të njëjtën gjë e konfirmoi edhe komandanti i aksionit policor në Reçak, Goran Radosavljević Guri. “Pas deklaratës së Walker-it,

¹ Po aty

² INA.FR, Le nouvel affront de Milosevic,
<http://www.youtube.com/watch?v=gv1yB7O7Jpk>

³ R. Jeffrey Smith, «Serbs Tried To Cover Up Massacre»; Kosovo Reprisal Plot Bared by Phone Taps. “Washington Post”, 28 January 1999.

shtabi u mblodh menjëherë. Menduam se si ta përgënjeshtrojmë atë që tërë ditën qarkullonte në stacionet televizive botërore dhe në agjencitë informative”¹- rrëfen ai. “Atëherë vendosëm që të futemi përsëri në Reçak. Dy ditë më vonë, më 17 janar hymë në fshat. Aty ende ishin terroristët e mbetur. Arritëm deri në qendër, te xhamia, ku ishin vendosur të vrarët.”²

Me qëllim që të neutralizohej indinjata ndërkombëtare që provokuan pamjet televizive dhe fotografitë nga «Masakra e Reçakut», gazetarët e televizionit shtetëror të Serbisë, Milovan Drecun-i dhe Tomislav Magoçi, u ofruan gazetarëve të agjencive të ndryshme botërore, që ishin vendosur në Hotelin Grand të Prishtinës, të “vërtetën” për atë që kishte ndodhur në këtë fshat.

Teksti i shpërndarë në mënyrë “konfidenciale”³ artikulohej rreth prezantimit të fshatit Reçak, ku, sipas propagandës zyrtare të Beogradit, “ishte vendosur Shtabi i terroristëve të UÇK-së”, si “fshat ku nuk kishte civilë”; “se gjatë betejës ndërmjet forcave të policisë dhe të UÇK-së ishin vrarë 45 terroristë dhe asnjë civil shqiptar”; se “pas tërheqjes së forcave policore serbe, terroristët kishin hyrë në Reçak, i kishin tërhequr trupat e terroristëve të vrarë nga të gjitha anët dhe i kishin renditur në një përrua, për të krijuar përshtypjen se fjala është për një ekzekutim e jo për të vrarë gjatë luftimeve”; dhe në funksion të kësaj “ua kishin hequr uniformat e UÇK-së dyzet kufomave dhe i veshën me tesha civile, ndërsa për ata që nuk patën veshmbathje civile i nisën për në fshatin Budakovë, ku sipas gjasave i kanë varrosur”; ndërsa “kufomat i gjymtuan për të krijuar përshtypjen se kishte ndodhur një masakër”.

Si argumente për pohimet se gjoja kjo ngjarje ishte e inskenuar, autorët sollën “faktet” se:

¹ Večerne Novosti, artikulli i cituar «Laž za...»

² Po aty

³ Një pjesë e madhe e asaj që u shpërnda si e “vërteta serbe” për Reçakun botohet në veprën e Milovan Drecun-it, Drugi kosovski boj, f. 20-26. Citatet e mëposhtme janë nxjerrë nga ky libër.

- “në teshat civile të kufomave nuk kishte as gjak e as vrima të plumbave prej të cilëve kishin vdekur” e që do të thotë se “ishin vrrarë në tesha të tjera”;
- “në qafat e kokave të prera të kufomave nuk kishte gjak”, që do të thotë se “kokat ishin prerë pas vdekjes së terroristëve”;
- “nuk kishte gjak as në vendin ku ishin hedhur kufomat”, që do të thotë se “janë vrrarë në tjetër vend”;
- “nuk kishte as gëzhoja përreth kufomave”, që do të thotë se “nuk ka pasur luftime në atë vend”;
- “policia gjeti armatim dhe municion, uniforma dhe rezerva ushqimore, një makinë shkrimi dhe listën e 126 terroristëve që ishin në Shtabin e Reçakut. Në mesin e 126 emrave, në këtë listë ishin edhe katër mbiemra të huaj, amerikanë ose anglezë. Ata ishin instruktorë ose specialistë të huaj”¹.

Pas shpërndarjes së kësaj të “vërtete” dhe kontakteve të shumta të Milovan Drecun-it dhe Tomislav Magoči-t me gazetarët e huaj, pasojnë dy shkrime.

Gazetari i «Le Figaro»-së, Renaud Girard-i, në artikullin «Re të zeza mbi një masakër»², hedh dyshimet e para për vërtetësinë e kualifikimit si “masakër” të asaj që kishte ndodhur në Reçak. Më duket mjaft e rëndësishme të përshkruhet konteksti në të cilin shkruhet ky shkrim, sepse një gjë e tillë do të na ndihmonte ta kuptojmë më mirë se në çka bazohet ky autor për të mbështetur hipotezat e artikullit në fjalë.

Si i ftuar i veçantë në dokumentarin «Reçaku - gënjeshtër dhe e vërteta»³ të Radio Televizionit të Serbisë, Renaud Girard-i është ndër protagonistët kryesorë të këtij filmi. Në këtë dokumentar ai sqaroi shumë gjëra. Për këtë arsye po e sjell në tërësi rrëfimin e tij:

¹ Po aty, f. 20-26

² Le Figaro, Renaud Girard, «Nuages noirs sur un massacre», 20/01.1999.

³ RTS: «Račak - laži i istine», <http://www.youtube.com/watch?v=RH2LB-n3RpI>

“Të hënën, kur u botua artikulli në «Le Figaro», takova dy njerëz. Njëri ishte korrespondent i gazetës «Le Monde», i cili kishte ardhur në Prishtinë të premten. Ai nuk kishte parë asnjë njeri në hotel, sepse të gjithë gazetarët kishin shkuar në perëndim të Kosovës. Serbët i thanë: ‘Shko në Reçak! Është duke ndodhur diçka interesante!’

Ai kishte mbërritur në Reçak, sipas të gjitha gjasave, rreth orës 15:30. Quhej Christophe Châtelot.

E pyeta: ‘Domethënë, ti i ke parë ata njerëz të vdekur?’

Më tha: ‘Jo! Nuk kam parë asgjë! Ishin tre automobila me vëzhgues amerikanë. Ata më thanë se nuk ka asgjë të veçantë. Ka pasur luftime dhe asgjë e veçantë! Dhe atëherë kam takuar ekipin e «Associated Press»-it, që ishin ftuar nga policia serbe që ta përcillnin operacionin ditën e premte. Ata kaluan tërë ditën me policinë. I pyeta: ‘A keni qenë në qendër të Reçakut? A keni parë masakër?’ Më thanë: ‘Jo! Nuk kemi parë asgjë të tillë! Kemi qenë në qendër të fshatit, te xhamia dhe nuk jemi ngjitur kodrinës.’ Më thanë se kishin parë policinë serbe se si zbriste me shumë armatim, që me gjasë ua kishin marrë luftëtarëve shqiptarë. Në atë kohë Radioja shqiptare¹ njoftonte se në betejën e madhe kundër forcave serbe, shqiptarët kishin humbur 9 trima në istikame!

Pyeta: ‘A keni parë ndarjen e burrave nga gratë dhe fëmijët?’

Më thanë: ‘Jo! Nuk e kupton?! Nuk ka pasur as gra e as fëmijë në fshat!’

Thashë: ‘Uaauu! Diçka po ndodh këtu. A mund të më tregosh çka ke xhiruar?’ Më tregoi materialin nga qendra e fshatit dhe shihej se nuk kishte gra dhe fëmijë. ‘Por, ajo gruaja shqiptare më tha se në orën 14:00, në sheshin kryesor, janë ndarë burrat nga gratë në qendër të fshatit. A është e mundur që të mos e kishit parë?’

¹ Interesante apo jo! Gazetarët e «Associated press»-it, duke përcjellë luftimet live, dëgjojnë Radion shqiptare!

‘Nuk mund të flasim për përroin! Nuk e dimë! Nuk kemi qenë atje! Por, ...’ (ndërpritet nga vetë Renaud Girard-i).

Thashë: ‘O zot! Domethënë, ajo shqiptarja më paska gënjyer!’¹

Të njëjtin përshkrim Renaud Girard-i e bën edhe në intervistën e 28 shtatorit 2005 dhe të vetmin dallim që bën nga intervista televizive për Radio Televizionin Shtetëror të Serbisë qëndron në një fjali. Në vend të fjalisë së mësipërme ai shton frazën: “Atëherë thashë me vete: ata ma paskan futur!”²

Pas takimit dhe bisedave që kishte pasur me gazetarin e «Le Monde-it», Christophe Châtelot-in dhe duke u mbështetur në bisedimet që ky gazetar kishte pasur me gazetarët që gjoja kishin filmuar për «Associated Press»-in³, gazetari i «Le Figaro-s», Renaud Girard-i, shkroi artikullin «Re të zeza mbi një masakër»⁴.

Nëse gazetari i «Le Figaro-s», Renaud Girard-i, ende nuk e ka kuptuar se kush në të vërtetë “ia ka futur”, shpresoj se lexuesi do ta kuptojë se këtu nuk është puna kush kujt ia “futi”. Këtu nuk bëhet fjalë për mashtrim! Këtu kemi të bëjmë me qëndrime që kushtëzohen nga përcaktimet politike dhe ideologjike.

Artikulli i dytë u botua pikërisht nga Christophe Châtelot-i, i dërguari special i gazetës «Le Monde», që kishte arritur të premten më 15 janar në Prishtinë dhe të cilit serbët i kishin thënë të shkonte në Reçak, se atje po ndodhte diçka interesante!

Në shkrimin e botuar në gazetën «Le Monde», në datën 21 janar⁵ 1999, të titulluar «A ishin vërtet të masakruar me gjakftohtësi të vdekurit e Reçakut?»⁶ Christophe Châtelot-i vazhdon të shtrojë në formë pyetjesh atë që gazetarët serbë ia kishin ofruar si të vërtetë: “Pse në vendin ku ishin ekzekutuar 23 persona me nga disa plumba në kokë ka aq pak gëzhoja dhe aq pak gjak përreth kufomave? A nuk mundet të jenë grumbulluar trupat e shqiptarëve

¹ RTS. «Račak - laži i istine», <http://www.youtube.com/watch?v=RH2LB-n3RpI>

² Frédéric Saillot, *De l'utilité des massacres*, Volume 2, f. 79.

³ Gazetarëve që nuk do t'ua përmendim asnjëherë emrat!

⁴ Le Figaro, artikulli i cituar «Nuages noirs ...»,

⁵ D.m.th. gjashtë ditë pas ngjarjes në fshatin Reçak!

⁶ Le monde, artikulli i cituar «Les morts de Racak ...»

<http://www.srpska-mreza.com/ddj/Racak/Articles/LeMonde990121.html>

të vrarë nga policia serbe gjatë luftimeve dhe të jenë vendosur në këtë hendek, vetëm e vetëm për të krijuar një skenë tmerrri që do ta lemeriste opinionin publik?”¹

Christophe Châtelot-ja nuk është i vetmi që pretendon se ka pasur pak gjak përreth kufomave! Sado që kufoma e Banush Azemit pa kokë është një skenë e tmerrshme po e sjell për lexuesin që të gjykojë vetë për shkallën e manipulimit të atyre që pretendojnë se kanë qenë në Reçak dhe se gjoja i kishin parë kufoma përreth të cilave kishte pak gëzhoja dhe pak gjak!



Banush Azemi me kokë të prerë!

Në fillim të publikimit të tyre, shkrimet e Renaud Girard-it dhe Christophe Châtelot-it ishin tepër marginale në krahasim me shkrimet e shumta, që pa asnjë hamendje theksonin se kishim të bënim me një krim të shëmtuar kundër civilëve shqiptarë. Dhe për këtë krim fajësohej Slobodan Milošević-i, që nuk kishte përfillur deri atëherë as rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për çështjen e Kosovës e as

¹ Po aty

kërcënimet për përdorimin eventual të forcës, në rast se nuk ndërpritej dhuna që ushtronte sistematikisht regjimi i tij ndaj shqiptarëve.

Kjo arrogancë e Milošević-it ishte e njohur për të gjithë ata që kishin pasur mundësi të përcillnin procesin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave dhe luftërat e mëparshme në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë.

Demaskimi dhe trysnia ndërkombëtare

Ndryshe nga qëndrimi gjatë luftës në Bosnje dhe Kroaci, kësaj radhe reagimet e personaliteteve më me peshë në skenën politike ndërkombëtare ishin të menjëhershme dhe tejet energjike, siç ishin edhe qëndrimet e institucioneve ndërkombëtare.

Anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së e dënuan ashpër vrasjet që ndodhën në Reçak dhe shprehën keqardhje për dëbimin e shefit të OSBE-së, të cilit i dhanë mbështetje të plotë¹.

Më 18 janar 1999, NATO-ja dërgoi në Beograd komandantin suprem të Forcave të Aleancës për Evropë, gjeneralin Wesley Clark-un dhe presidentin e Komitetit Ushtarak, gjeneralin Klaus Naumann-in. Kjo vizitë kishte për qëllim që t'ia bënin me dije Slobodan Milošević-it se situata në Kosovë ishte e papranueshme². Në të njëjtën kohë, dy gjeneralët i kërkuan Milošević-it të bashkëpunonte me inspektorët ndërkombëtarë rreth hetimeve lidhur me «Masakrën e Reçakut», t'i identifikonte dhe t'i sillte para drejtësisë autorët e masakrës, si dhe të tërhiqte vendimin për të dëbuar shefin e MVK-së, William Walker-in. Nëse nuk arrihej marrëveshja rreth këtyre çështjeve, NATO-ja nuk përjashtonte mundësinë e përdorimit të forcës. “Urdhri i aktivizimit ushtarak

¹ INA.FR, video e cituar: Le nouvel affront de Milosevic

² NATO, «Meeting in Belgrade between NATO Generals Wesley Clark and Klaus Naumann and the Yugoslav President Slobodan Milosevic»
http://www.nato.int/cps/fr/SID-F8C52692-50A670C9/natolive/news_27391.htm

ishite mbi tavolinë”- deklaroi Sekretarja e Shtetit amerikan, Madeleine Albright-i¹.

Në këtë kontekst, Milošević-i pranoi të hetohej rasti. Por, në vend të ekspertëve ndërkombëtarë, Milošević-i caktoi gjykatësen hetuese të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Danica Marinković-in, të zhvillonte hetimet dhe të ndriçonte rastin! Caktoi gjykatësen që u bë botërisht e njohur për montimin e procesit gjyqësor kundër vëllezërve Mazreku dhe për inskenimin e «Krematorit të Kleçkës»²! Ishte po ajo gjykatëse hetuese që në praninë e tridhjetë pjesëtarëve të Njësisë Speciale Antiterroriste të Serbisë kishte urdhëruar vrasjen e civilëve të plagosur të familjes Ahmetaj në fshatin Likoshan, më 28 shkurt 1998, dhe kur ishin vendosur pushkë dhe bomba pranë kufomave të civilëve të vrarë me qëllim që të manipulonin me opinionin publik³.

Për të krijuar përshtypjen se ishin të interesuar të ndriçoheshin vrasjet në Reçak, Qeveria e Serbisë urdhëroi krijimin e një komisioni të përbërë nga patologë dhe ekspertë të forenzikës që të sqaronin aspektin mjekoligjor të këtyre vrasjeve. Në përbërje të këtij ekipi ishin: dr. Slaviša Dobričanin-i, shefi i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, që u emërua në këtë funksion pas dëbimit të profesorëve dhe të studentëve shqiptarë nga ky institut; dr Vujadin Otašević-i, profesor i Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Nishit, (Serbi); dr. Dušan Dunjić-i, profesor i Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Beogradit, (Serbi); dr. Miloš Tasić-i, profesor i Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Novi Sadit (Vojvodinë).

Për t'i dhënë karakter sa më “ndërkombëtar” ekipit të tyre, serbët përfshinë edhe dy patologë bjellorusë, dr. Vladimir Kuzmichev-in dhe dr. Oleg Levkovich-in.

¹ INA.fr, «La menace de l'OTAN»,
<http://www.youtube.com/watch?v=55AaRkvace8>

² Temë e trajtuar në kapitullin e parë të këtij libri

³ Nataša Kandić, artikulli i cituar «Uznemiravajuca istina»

Kriminelët kthehen në vendin e krimit!

T'i kthehemi ekspeditës policore të 17 janarit. Gjatë ekspeditës për marrjen e kufomave në fshatin Reçak, policinë serbe e shoqëruan gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i dhe profesori i Mjekësisë Ligjore, Slaviša Dobričanin-i. Sikurse në «Rastin Kleçka», Danica Marinković-i, kishte ftuar gazetarët, si dëshmitarë në “shikimin” e vendit! Ajo, siç shihet edhe në emisionin special të TV Beogradit, sapo hyri në xhaminë ku gjendeshin kufomat, deklaroi: “Të gjithë qenkan burra, nuk ka gra, nuk ka fëmijë, nuk ka të masakruar, siç janë munduar ta paraqesin...”¹

Më pas, gazetarët u ftuan të shihnin “Shtabin e UÇK-së”, ku gjoja ishin “gjetur” lista e 126 ushtarëve të UÇK-së, fotografi, uniforma, armë dhe municion! Gazetarëve iu mundësua të shihnin 40 kufomat në xhami dhe 40 armët e ekspozuara me këtë rast: dy mitraloza, 36 pushkë automatike, dy snajperë, granata dore dhe municion... Skenar i parë me aktorë të njëjtë edhe në fshatin Kleçkë!

“Forcat e sigurisë serbe i nxorën nga Reçaku trupat e terroristëve të vrarë. Kufomat u transportuan në Prishtinë, në Institutin e Mjekësisë Ligjore.”² Ekipi i Mjekësisë Ligjore serbe filloi punën menjëherë. Ndërkohë, Qeveria e Serbisë pranoi që këtij ekipi të Mjekësisë Ligjore t'i bashkëngjitej edhe ekipi i Mjekësisë Ligjore finlandez, që ishte ngarkuar nga Bashkimi Evropian për ekspertizën e këtij rasti. Në kuadër të ekipit finlandez, të udhëhequr nga Helena Ranta, ishin: Antti Pentilla, Kaisa Lalu, Juha Rainio, personeli teknik, tekniku i kriminalistikës, fotografë etj.

Krahas përcaktimit të ekipit të Mjekësisë Ligjore që do t'i përkushtohej ndriçimit të “Rastit të Reçakut”, diplomacia e shteteve perëndimore u mobilizua si asnjëherë më parë. Grupi i Kontaktit³ për ish-Jugosllavinë, në takimin e 29 janarit 1999 të mbajtur në Londër, doli me konkluzionet për mbajtjen e një konfe-

¹ RTS, emisioni i cituar, «Kosovo: Racak ...»

² Večerne Novosti, artikulli i cituar «Laž za... »

³ Grupi i Kontaktit për Kosovën përbëhej nga ministrat e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Irlandës Veriore, Italisë, Federatës Ruse dhe SHBA-ve.

rence me ndërmjetësim ndërkombëtar. Në këtë takim u përcaktua edhe korniza e zhvillimit të bisedimeve dhe sidomos përcaktimi i dhjetë parimeve¹, që duhej të pranoheshin paraprakisht nga të gjitha palët dhe të cilat nuk mund të negocioheshin në këtë konferencë:

- Domosdoshmëria e ndërprerjes së menjëhershme të dhunës dhe respektimi i armëpushimit;
- Zgjidhja paqësore e krizës me anë të dialogut të palëve kundërshtare;
- Një periudhë kalimtare, parimisht në kohëzgjatje prej tre vjetësh, duke pritur zgjidhjen përfundimtare;
- Ndalohej çfarëdo ndryshimi i njëanshëm i statusit kalimtar të krahinës;
- Integriteti territorial i RFJ-së dhe i shteteve fqinje;
- Mbrojtja e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive nacionale (identiteti, institucionet e tyre fetare, arsimit);
- Zgjedhje të lira nën mbikëqyrjen e OSBE-së;-
- Mosndjekja gjyqësore për aktet e kryera gjatë konfliktit në Kosovë, pos në rastet e krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit;
- Amnisti dhe lirimi i të burgosurve politikë;
- Pjesëmarrja e ndërkombëtarëve dhe bashkëpunim i plotë i të dy palëve në zgjidhjen e krizës.

Nëpërmjet Deklaratës së Grupit të Kontaktit u bë me dije se pala që do të refuzonte t'u përmbahej rekomandimeve dhe që do të sabotonte suksesin e kësaj konference, do të mbante përgjegjësinë e dështimit.

Një ditë pas qëndrimit të Grupit të Kontaktit, më 30 janar 1999, Këshilli i NATO-s lëshoi një deklaratë² në mbështetje të kërkesave të lartpërmendura.

¹ Përkthimin e dhjetë parimeve e kam bërë duke u mbështetur në publikimin e këtyre parimeve në gazetën *Le monde diplomatique*, <http://www.monde-diplomatique.fr/cahier/kosovo/rambouillet>

² Déclaration du Conseil de l'Atlantique Nord sur le Kosovo, Communiqué de presse (99) 012, 30 janar 1999

Në pikën 4 të kësaj deklarate, Këshilli i NATO-s theksonte se “kriza në Kosovë mbetet rrezik për paqen dhe për sigurinë në rajon. Strategjia e NATO-s është e orientuar t’i japë fund dhunës dhe arritjes së një marrëveshjeje politike të përkohshme për Kosovën, që do të mundësonte parandalimin e një katastrofe humanitare.”¹

Pala që nuk do të respektonte angazhimet ndërkombëtare do t’i bartte pasojat në përputhje me pikën 5 të Deklaratës së Këshillit të NATO-s. Në rast të sabotimit të punëve nga ana e autoriteteve të Beogradit, “Këshilli i NATO-s vendosi atë ditë për mundësinë që Sekretari i Përgjithshëm të autorizojë goditjet ajrore kundër caqeve në territorin e Jugosllavisë. Ndërsa, në rast të mosrespektimit të kushteve nga pala shqiptare e Kosovës, NATO-ja do të ndërmarrë masat adekuate kundër tyre.”²

Nëpërmjet kësaj deklarate, ndër çështjet e tjera që u shtruan si qëndrime orientuese, “NATO-ja rikujtoi se përgjegjësit e masakrës së Reçakut duhet të dalin para drejtësisë dhe se autoritetet e RFJ-së duhet të bashkëpunojnë plotësisht me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.”³

Deklarata e Grupit të Kontaktit dhe ajo e Këshillit të NATO-s paraqesin kthesën vendimtare në trajtimin e çështjes së Kosovës. Çështjen e Kosovës Serbia e konsideronte si problem të brendshëm të saj dhe refuzonte çdo ndërmjetësim ndërkombëtar. Për këtë arsye, imponimi i ndërmjetësimit ndërkombëtar në përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje politike u konsiderua nga një numër analistësh si ultimatium drejtuar Jugosllavisë së Milošević-it.

Duke e konsideruar «Masakrën e Reçakut» si katalizator të mobilizimit ndërkombëtar dhe vendimeve të Grupit të Kontaktit dhe Këshillit të NATO-s ekipi i Mjekësisë Ligjore serbe u përpoq të sqarojë se “në fshatin Reçak nuk kishte ndodhur masakër!”

Më 30 janar 1999, disa orë pas publikimit të Komunikatës për shtyp të Këshillit të NATO-s, ekipi i ekspertëve të lartpër-

<http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-012f.htm>

¹ Po aty

² Po aty

³ Po aty

mendur lëshoi një komunikatë¹ për rezultatet preliminare të hulumtimeve të tyre. Me anë të kësaj komunikate, ekipi i Mjekësisë Ligjore serbe dhe bjelloruse njoftonte opinionin se:

- “Para fillimit të autopsive, shërbimi i hetimeve penale në Prishtinë mori shenjat e pëllëmbëve dhe gishtërinjve në letër metalike;
- mbi bazën e autopsive, u konstatua se në të gjitha rastet vdekja ishte shkaktuar nga efektet e shkrepjes së pre-dhave nga armët e zjarrit;
- nuk ka pasur shenja të përdorimit të armëve të mprehta në ndonjë prej organeve, qoftë para ose pas vdekjes, që do të thotë se nuk ka pasur prerje kokash;
- asnjë gjurmë baruti nuk është parë në ndonjë prej trupave, që do të thotë se nuk ka pasur ekzekutim dhe vrasje nga afër;
- ka pasur dy plagë, në të cilat ka qenë e pamundur të vërtetohej distanca nga e cila ishin shkaktuar plagët;
- dhe në fund, në mënyrë të veçantë u theksua se puna e të gjithë ekspertëve mjekoligjorë që morën pjesë në ekzaminimet e mësipërme, ka qenë i një niveli të lartë profesional dhe u realizua me besim të plotë dhe me respekt reciprok.”²

Konferenca e Rambouillet-së³

Me gjithë vërejtjet dhe rezistencën që u tregua për pjesëmarrje në këtë konferencë ndërkombëtare për Kosovën, delegacioni serbo-jugosllav dhe ai i Kosovës erdhën në Francë në datën e caktuar nga Grupi i Kontaktit!

¹ ARCHIVE: Racak forensics

<http://www.srpska-mreza.com/guest/sirius/KLA-Racak-Forensics.html>

² Nënshkruar në Prishtinë, 30 janar 1999, nga dr. Slaviša Dobričanin, dr Vujadin Otašević, dr. Dušan Dunjić dr. Miloš Tasić, dr. Vladimir Kuzmichev dhe dr. Oleg Levkovich.

<http://www.srpska-mreza.com/guest/sirius/KLA-Racak-Forensics.html>

³ Qytet në Francë i cili në gjuhën shqipe shqiptohet: Rambuje. Në vijim të tekstit do ta përdor transkriptimin e shqiptimit shqip të këtij qyteti.

Më 6 shkurt 1999, në Rambuje të Francës, të dyja delegacioneve iu dorëzua «Projekt marrëveshja kalimtare për paqen dhe për vetëqeverisjen në Kosovë», që ishte në përputhje me 10 parimet e lartpërmendura.

Një pjesë e madhe e asaj që ndodhi gjatë kësaj konference dhe sidomos zhvillimet në kuadër të delegacionit të Kosovës dhe raporti i këtij delegacioni me ndërmjetësuesit ndërkombëtarë përshkruhen hollësisht në veprat e Rexhep Qosjes¹, Blerim Shalës², Edita Tahirit³, Jakup Krasniqit⁴ dhe Ramë Bujës⁵.

Këto vepra janë të domosdoshme për secilin që ka për objekt studimi këtë periudhë të historisë së Kosovës. Përkthimi i tyre në gjuhë të ndryshme botërore do të ishte me rëndësi të madhe për të gjithë studiuesit e huaj që nuk lexojnë shqip.

Meqenëse zhvillimet në këtë konferencë lidhen tërthorazi me objektin e hulumtimit tim, unë nuk do të ndalem në këto burime shumë të rëndësishme. Në studimin tim do të kufizohem në interpretimin e kësaj konference si “komplot amerikan për shkatërrimin e një shteti sovran dhe për pushtimin kolonial të tij nga ana e NATO-s.”⁶ Në këtë kontekst, burimet serbe, kryesisht ato të hartuara nga instrumentet e propagandës së regjimit të Milošević-it, janë burimet kryesore që shërbyen si bazë për “argumentet” e “analistëve kritikë”.

Ekipi serbo-jugosllav përbëhej nga Ratko Marković-i, zëvendës-kryeministër i Serbisë, që ishte njëherësh edhe shef i delegacionit; nga dy zëvendës-kryeministra: ai i Qeverisë Federale, Nikola Šainović-i dhe i asaj të Serbisë, Vladan Kutlešić-i; nga nënkryetari i Kuvendit të Serbisë, Vladimir Štambuk-u dhe nga

¹ Rexhep Qosja, *Paqja e përgjakshme*, “Toena”, Tiranë, 1999, f. 437.

² Blerim Shala, *Vitet e Kosovës: 1998-1999*, “Gama”, Prishtinë, 2001, f. 432.

³ Edita Tahiri, *Konferenca e Rambujesë* (dy gjuhësh shqip-anglisht), “Dukagjini”, Pejë, 2001, f. 524.

⁴ Jakup Krasniqi, *Kthesa e Madhe, Shtëpia Botuese «Buzuku»*, Prishtinë, 2006, f. 302.

⁵ Ramë Buja, *Kosova në krizën Jugosllave*, botoi AAB-Rinvest, Prishtinë, 2011, f. 478.

⁶ Michel Collon, vepra e cituar, *Monopoly...*, f. 40

“përfaqësuesit e bashkësive nacionale të Kosovës që dëshirojnë të jetojnë në Serbi dhe në Jugosllavi.”¹

Në kuadër të “përfaqësuesve” të bashkësive nacionale të Kosovës, që kishte për qëllim t’i jepte karakter “shumetnik” përbërjes së delegacionit serbo-jugosllav, “Slobodan Milošević-i dhe gruaja e tij, Mirjana Marković-i, përzgjedhën si përfaqësues për serbët e Kosovës kryetarin e Partisë Socialiste të Serbisë për Kosovë dhe Metohi, Vladimir Štambuk-un; dy përfaqësues të bashkësisë turke, Zejnelabedin Kurejsh-in dhe Guljbehar Rauf Šabović-in; për bashkësinë e goranëve u caktua Ibro Vajt-i; për myslimanët, Refik Senadović-i; për bashkësinë rome, Luan Rama; për bashkësinë egjiptiane dhe asaj të ashkalinjve, u caktua Qerim Abazi dhe për të përfaqësuar shqiptarët e Kosovës u caktuan Faik Jashari dhe Sokol Qysja!”²

Gazeta beogradase «Večernje novosti» ishte tejet kritike për përzgjedhjen e delegacionit serb që do t’i përfaqësonte në Konferencën e Rambujesë. Sipas kësaj gazete “në vend të njerëzve prestigjiozë dhe me ndikim, dy partitë³ politike në pushtet dërguan njerëz që kanë zhgënjyer shumicën e subjekteve politike dhe vetë popullin serb.”⁴

Për të krijuar përshtypjen se Faik Jashari dhe Sokol Qysja përfaqësonin shqiptarët e Kosovës, propaganda e regjimit të Beogradit i paraqiti si kryetarë të gjoja dy partive politike shqiptare! Për pushtetin e Milošević-it, Faik Jashari ishte kryetar i Iniciativës Demokratike të Kosovës ndërsa Sokol Qysja, kryetar i Partisë Reformatore Demokratike. Në realitet, ata jo vetëm që nuk

¹ Večernje Novosti, «Kako JUL kaže» (Si thotë JUL-i) http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:276454-Kako-JUL-kaze dhe Jedinstvo, «Dijalog-uslov postizanja mira» (Dialogu kusht për arritjen e paqes) «Zaštiti kulture i istorijske spomenike» (Të mbrohen monumentet kulturore dhe historike), 04.02.1999

² Večernje Novosti, artikulli i cituar «Kako JUL kaže», dhe Vreme, br. 434, «Ko su pregovarči» (Kush janë negociatorët), 13.02.1999 http://www.vreme.com/arhiva_html/434/3.html

³ Partia Socialiste e Serbisë e Slobodan Milošević-it dhe E Majta e Bashkuar Jugosllave e gruas së tij, Mirjana Marković-it

⁴ Večernje Novosti, artikulli i cituar «Kako JUL kaže»

kishin parti politike, por nuk përfaqësonin as familjet e tyre. Në këtë kontekst, gazeta tjetër beogradase, «Vreme», e datës 13 shkurt 1999, solli lajmin se familjarët e Faik Jasharit distancoheshin nga ky anëtar i delegacionit serb dhe e bënë publik që Faik Jashari nuk mund t'i përfaqësojë politikisht. Rrjedhimisht në këtë konferencë ai mund të përfaqësojë vetëm veten e tij!¹

Nga ana tjetër, delegacionin e Kosovës e përbënin udhëheqësit e partive politike kryesore (LDK-ja² dhe LBD-ja³), përfaqësuesit e UÇK-së⁴ dhe dy përfaqësues të shoqërisë civile: Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Bujar Bukoshi, Edita Tahiri, Idriz Ajeti, Mark Krasniqi, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Azem Sylja, Ramë Buja, Xhavit Haliti, Rexhep Qosja, Hidajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Veton Surroi dhe Blerim Shala.

Në dallim nga delegacioni serbo-jugosllav që nuk mund të vendoste për asgjë pa konsultuar Beogradin, delegacioni i Kosovës kishte legjitimitetin e plotë dhe fuqinë të merrte vendimet e nevojshme.

Në fjalën e hapjes së konferencës, presidenti i Republikës së Francës, Jacques Chirac-u deklaroi: «Korniza e bisedimeve është e përcaktuar qartë nga Grupi i Kontaktit. Do t'ju prezantohen parimet e autonomisë substanciale. Ju duhet t'i precizoni, t'i jepni formën që në kuadër të kufijve ekzistues, të gjithë banorët e krahinës, cilado qoftë origjina e tyre, të mund të jetojnë në paqe dhe respekt të personalitetit të tyre dhe të drejtave që u takojnë (...) Ju keni mundësinë të zgjidhni ndërmjet vazhdimit të tragjedisë së kaluar ose shpresës për jetën që merr formë (...) Komuniteti ndërkombëtar është unanim dhe i mobilizuar. Aksioni i tij nuk drejtohet kundër askujt. Ai është në interes të të gjithëve. Por, duhet ta dini se Franca, po ashtu si partnerët e tjerë evropianë, amerikanë dhe rusë, nuk do të tolerojë vazhdimin e konfliktit që shkel parimet themelore të dinjitetit njerëzor. Ne nuk

¹ Vreme, artikulli i cituar «Ko su pregovarči»

² Lidhja Demokratike e Kosovës

³ Lëvizja e Bashkuar Demokratike

⁴ Ushtria Çlirimtare e Kosovës

do të pranojmë që cikli i dhunës ta kërcënojë stabilitetin e juglindjes së Evropës (...) Përfaqësuesve të të dyja palëve, serbëve dhe shqiptarëve u them se paqja është në duart tuaja (...) Ju inkurajoj të bëni atë që ju takon ta bëni që të ngadhënjë forcat e jetës e jo ato të vdekjes (...)”¹

Gjatë fjalës së tij, Presidenti francez njoftoi se Grupi i Kontaktit u kishte besuar detyrën e drejtimit të mbledhjeve ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Robin Cook-ut dhe ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Hubert Védrine-it.

* * *

Në vend të ndërprerjes së menjëhershme të dhunës dhe respektimit të armëpushimit, që ishte përcaktuar si parim i parë nga ana e Grupit të Kontaktit, Shtabi Strategjik² i Milošević-it hyri në veprim.

Lexuesit i kujtohet nga Kapitulli i Dytë, kur fola për rastin e vrasjes në Kafenenë «Panda», se ky Shtab kishte sjellë vendimin që Shërbimi i Sigurimit Shtetëror të kryente sulme terroriste kundër civilëve shqiptarë dhe serbë të cilat duhej t'i visheshin UÇK-së. Përmes kësaj strategjie UÇK-së duhej të paraqitej në sytë e bashkësisë ndërkombëtare si organizatë terroriste dhe në të njëjtën kohë të nxiteshin ndjenjat antishqiptare në Kosovë dhe në tërë Serbinë.

Përqendrimi i mediave në ditën e hapjes së Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën ishte një rast i volitshëm për aplikimin e kësaj strategjie. Dhe ashtu ndodhi. Më 6 shkurt 1999, nga shpërthimi i një bombe në lagjen Ulpiana të Prishtinës u vranë tre shqiptarë: Enver Shala (52 vjeç), pronari i shitores, Agon Ajeti

¹ Vie Publique, « Discours de M. Jacques Chirac, Président de la République française, sur les enjeux de la négociation pour l'avenir de la paix en Europe et l'objectif d'un accord entre les belligérants serbes et kosovars sur l'autonomie substantielle du Kosovo, Rambouillet le 6 février 1998»

<http://discours.vie-publique.fr/notices/997000031.html>

² Për strategjinë e këtij Shtabi fola në Kapitullin e Dytë por do t'i rikthehem edhe në kapitujt në vijim.

(20 vjeç) dhe Vlora Humolli (18-vjeçare). Ky akt terrorist ishte një mesazh i keq dhe një goditje e rëndë kundër parimeve mbi bazën e të cilave duhej të zhvilloheshin bisedimet. Disa minuta pasi që ndodhi ky akt terrorist, autoritetet politike të Beogradit dolën me komunikatë dhe e cilësuan si “sulm me bomba kundër marrëveshjes për Kosovën!”¹ Në të njëjtën kohë bënë publike se për ndriçimin e këtij rasti ishte ngarkuar sërish gjykatësja hetuese Danica Marinković-i!

Sapo mori detyrën, kjo gjykatëse tashmë e njohur edhe për lexuesin, u prononcua për media dhe sulmin mbi dyqanin shqiptar ia atribuoi “terroristëve shqiptarë”, të cilët, sipas saj, “vrasin shqiptarët besnikë ndaj Republikës së Serbisë!”²

Sulmi me bomba në Prishtinë dhe vrasja e tre civilëve shqiptarë u shtruan edhe në kuadër të konferencës. Të dyja delegacionet e dënuan këtë akt terrorist.”³

Edhe pse të gjithë pjesëmarrësit e konferencës e dënuan aktin terrorist ku humbën jetën tre civilë shqiptarë, edhe pse delegacioni i Kosovës kërkonte të nënshkruhej armëpushimi dhe të ndërpriteshin luftimet në Kosovë, ditët në vijim do të jenë plot e

¹ Večernje novosti, «Bombama protiv dogovora o Kosmetu» 08.02.1999

² Politika, «Osuda terorističkog napada na trgovinsku radnju», (Dënohet sulmi terrorist në shitoren tregtare) «Atak na slobodu dostojanstvo građana Prištine» (Sulm ndaj lirisë dhe dinjitetit të qytetarëve të Prishtinës), 8 shkurt 1999, Večernje novosti, «Stradali neđužni» (Humbën jetën të pafajshmit), «Miniranj razgovora» (minim i bisedimeve) «Bombama protiv dogovora o Kosmetu» (me bomba kundër marrëveshjes për Kosovën), 8 shkurt 1999

³ Për ata që janë të interesuar të shohin pasqyrimin e kësaj ngjarje në shtypin serb po sjell vetëm disa nga titujt e atyre që m'u dukën më interesante: «Na predlog državne delegacije svih učesnici skupa osudili teroristički napad u Prištini» (Me propozimin e delegacionit shtetëror të gjithë pjesëmarrësit e dënuan sulmin terrorist në Prishtinë), «Politika» 08/02/1999/; «Stradalo 14 osoba» (Humbën jetën 14 persona), «Politika» 08/02/1999, Priština, 07/02/ (Tanjug); «Bombama protiv dogovora o Kosmetu...» (Me bomba kundër marrëveshjes në Kosovë), (Rambuže, Francuska 07/02/1999, (Tanjug); «Atak na mir» (Sulm kundër paqes), «Ekspres i Politika» 08/02/1999, (Rambuže, Francuska 07/02 (Tanjug); Poginulo troje civila (Humbën jetën tre civilë), Priština, 08/02/ Tanjug ; Jedinstvena osuda iz Rambujea (Dënim i unanimit nga Rambouillet-ja), RAMBUJE (Beta/Rojters/AFP); Pregovori u Francuskoj, terorizam na Kosmetu (Bisedime në Paris, terrorizëm në Kosovë) «Politika» 10/02/1999/

përplot me akte dhune kundër civilëve shqiptarë. Kështu, në rrethinën e qytetit të Gjakovës¹ u gjet trupi i pajetë i një personi të vrarë, i gjinisë mashkullore dhe i moshës 25-30 vjeç. Ende pa u identifikuar viktima shtypi serb akuzoi “terroristët shqiptarë” se kishin vrarë një shqiptar që ishte besnik ndaj shtetit serb!² Danica Marinković-i njoftoi se në rrethin e Lipjanit u gjet kufoma e një mashkulli rreth 25-27-vjeçar, i vrarë nga një armë zjarri; në rrethinën e Kaçanikut gjithashtu u gjet një kufomë e një mashkulli të vrarë; në Novosellë të Gjakovës u vra Luigj Metaj (26 vjeç) dhe u plagos rëndë Skender Lekaj (25 vjeç); u gjetën të vrarë edhe një vajzë 17-vjeçare (Sebahate Zuka) dhe Xhemajl Smaçi (20 vjeç)...³ Megjithëse tepër të rinj për të qenë qytetarë “besnikë ndaj shtetit të Serbisë”, shtypi serb nuk hezitoi në asnjë rast t’i cilësonte si të tillë.⁴ Sipas qëndrimeve politike dhe mediatike të Beogradit këto “aksione terroriste bëheshin për t’i hedhur një hije të keqe bisedimeve dhe mundësisht për t’i vënë në dyshim rezultatet e tyre. Terroristët nuk duan paqe!”⁵ - pohonin në kor politikanët dhe gazetarët serbë!

Krahas vrasjeve të shqiptarëve, të gjitha gazetat serbe njoftuan se “në qendër të Vushtrrisë⁶, katër terroristë shqiptarë, njëri me uniformë të UÇK-së, plaçkitën shtëpinë e një gruaje serbe (Stanka Šćepanović-it, 43-vjeçare), që ishte pa burrë dhe kujdesej e vetme për fëmijën e saj. Në momentin e plaçkitjes, te shtëpia e kësaj gruaje kishin qenë edhe katër fëmijët e motrës së saj. Familja nuk ishte keqtrajtuar, por i ishte marrë pushka e gjuetisë!”⁷

¹ Qytet në Kosovë

² Danas, «Pronađena tela pet ubijenih osoba», 9 shkurt 1999,

³ Po aty

⁴ Në bibliografi cekenshkrimet e gazetave kryesore serbe ku lexuesi mund të shohë konsensusin e gazetarëve serbë për të cilësuar civilët e vrarë shqiptarë, pa asnjë përjashtim, si besnikë ndaj shtetit të Serbisë.

⁵ Artikujt e lartpërmendur

⁶ Qytet në Kosovë

⁷ Politika , «Teroristi pokrali samohranu majku» 10.02.1999

Plaçkitës me uniforma të UÇK-së!

Edhe në këtë kontekst, thëniet e publicistit serb, Miroslav Filipović-it, se Serbia kishte formuar “eskadronët e përbërë nga serbë që sulmonin serbët dhe pronat e tyre në Kosovë me qëllim që të krijonin tensione ndëretnike”¹ hapën shtegun e hipotezave të shumta për të hulumtuar në ndriçimin e këtyre rasteve.

Një gjë është e sigurt! Koloneli i policisë serb, Slavko Nikić-i, nuk ishte personi i vetëm që kreu akte dhune i veshur me uniformë të UÇK-së në Kosovë. Në kapitullin e parë përmenda vrasjen e mjekut serb Branimir Đokić-it nga polici serb, Goran Stamenković – Stamenko dhe akuzat drejtuar “terroristëve të UÇK-së” për këtë vrasje.

Shtypi solli edhe një akt tjetër dhune kundër serbëve të Kosovës. “Në rrugën kryesore të Gjakovës ndodhi një akt terrorist kundër një shtëpie të një familjeje serbe. Asnjë i lënduar!”² Ndërsa, “më 18 shkurt, në Vushtrri u plaçkitën pesë shtëpi serbe nga terroristët shqiptarë dhe u vodhën pajisje elektrike.”³

Po të njëjtën ditë u njoftua se “Në rrugën Rahovec-Malishevë u gjet kufoma e një shqiptari të vvarë (Milaim Morina) dhe vrasja i atribuohet terroristëve shqiptarë.”⁴

Në tërë territorin e Kosovës ndodhën vrasje të civilëve shqiptarë dhe vjedhje në shtëpi të serbëve! Nga të gjitha vrasjet që ndodhën gjatë kësaj periudhe vetëm në një rast viktimja ishte civil i përkatësisë etnike serbe! Mediat serbe i dhanë një publicitet të madh kësaj ngjarjeje. Pa u bërë asnjë hetim lidhur me vrasjen, gazeta në gjuhën serbe, «Jedinstvo», që shtypej në Prishtinë, në shkrimin «Krimi i ri i terroristëve shqiptarë»⁵, solli më shumë hollësi rreth kësaj ngjarjeje. “Më 18 shkurt, në fshatin Pestovë të Vushtrrisë, u gjet i vvarë Marjan Jović-i. Ai kishte qenë te fqinji i tij

¹ Ogledi Republika, Nr. 263, Miroslav Filipović, «Dugi marš ka istinio zlocinima»

http://www.yurope.com/zines/republika/arhiva/2001/263/263_16.html

² Jedinstvo, «Oštra osuda najnovijih terorističkih napada», 19.02.1999

³ Politika, «Opljačkano pet srpskih kuća», 19.02.1999

⁴ Novosti, «Ubijen Morina», 19 shkurt 1999

⁵ Jedinstvo, «Novi zločin albanski terorista» dhe «Ubijen Marjan Jović», 20-21 shkurt 1999

Božidar Jarić-i dhe ishte vrarë rreth orës 21:30 minuta kur kthehej prej tij. Kufoma u gjet në mëngjes pranë shtëpisë së një gruaje, Jadranka Simetić-it. Nëna e Božidar-it u tregoi gazetarëve se djali i saj kishte kërkuar ndihmë, por nuk kishte guxuar të dilte dhe t'i ofronte ndihmën e nevojshme. Plaka kishte pasur frikë, sepse ajo kishte vërejtur tre terroristë që ecnin rrugës.”¹

Nga mbrëmja e deri në mëngjes askush nuk e kishte parë këtë kufomë dhe as që kishte dëgjuar krisma armësh. Vetëm një nënë plakë kishte vërejtur tre terroristë! Dhe ajo nuk kishte guxuar të dilte dhe t'i ndihmonte fëmijës së vet! Le të vlerësojë lexuesi për besueshmërinë e interpretimit serb të kësaj vrasjeje!

Nëse për autorët e vrasjeve të pasqaruara të kësaj kohe, që ishin në kundërshtim me kërkesat për të ndërprerë të gjitha format e dhunës, mund të spekulohet, ajo që ishte e qartë lidhej me proceset gjyqësore.

Në vend të përgatitjes së përmbushjes së kërkesave ndërkombëtare për lirimin e të burgosurve politikë, gjykatat serbe u mobilizuan edhe më tepër. Kështu, me 18 shkurt 1999, ditën kur afatit të bisedimeve në Rambuje i afrohej fundi, Gjykata e Qarkut në Pejë shpalli fajtor dhe dënoi për terrorizëm Rexhë Jakupin dhe Izet Morinën me nga katër vjet burg, Ismet Gashin, Ramadan Gashin dhe Jahir Agushin me nga tre vjet e gjashtë muaj burg, Bajram Berishën me dy vjet burg ndërsa Zaim Gashin dhe Ramadan Bacajn me nga shtatë muaj burg.²

Kjo sjellje e autoriteteve gjyqësore serbe ishte mesazh i qartë se Serbia nuk do të respektonte as parimet 8 dhe 9 të përcaktuara nga Grupi i Kontaktit për lirimin e të burgosurve politikë dhe për mosndjekjen gjyqësore për aktet e kryera gjatë konfliktit në Kosovë. Në bazë të parimeve të lartpërmendura vetëm personat e implikuar në krime lufte dhe në krime kundër njerëzimit do të ndiqeshin.

Konteksti i shpalljes së dënimeve, që përkon me datën kur duhej të përmylleshin bisedimet, ndër të tjera edhe për lirimin e

¹ Po aty

² Jedinstvo, «Osudeni teroristi» (U dënuan terroristët), 19.02.1999

të burgosurve politike dhe lartësia e dënimeve nga shtatë muaj deri në katër vjet burg për “vepra terroriste” dëshmonte farsën e këtyre proceseve të montuara gjyqësore të komanduara nga strukturat politike.

* * *

Gjatë dy javëve, delegacionet punuan tërësisht të ndarë njëri nga tjetri dhe komunikimi zhvillohej nëpërmjet ndërmjetësuesve të bashkësisë ndërkombëtare: Christopher Hill-it, Wolfgang Petritsch-it dhe Boris Majorski-t.

Më 19 shkurt, një ditë para përfundimit të afatit për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për të dy palët, delegacionit të Kosovës dhe atij serb iu dha projekt marrëveshja që duhej ta nënshkruanin të nesërmen, më 20 shkurt.

Drafti final i dorëzuar më 19 shkurt kishte ndryshime thelbësore në krahasim me «Projekt marrëveshjen kalimtare për paqe dhe për vetëqeverisje në Kosovë» të datës 6 shkurt.

Në vend të autonomisë substanciale, si status kalimtar deri në zgjidhjen përfundimtare që parashihej të përcaktohej pas tre vjetësh, drafti i ri e parashihte këtë formë si zgjidhje përfundimtare. Për delegacionin shqiptar të Kosovës një ndryshim i tillë ishte i papranueshëm. Lexuesit, që i intereson ky aspekt i problematikës, i sugjeroj veprat e cituara më lart, të autorëve Rexhep Qosja, Blerim Shala, Edita Tahira, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja, që do t’ia mundësojnë të njihet me dinamikën që ngjalli ky draft në kuadër të delegacionit shqiptar.

Nga ana tjetër, për palën serbo- jugosllave modaliteti i autonomisë së Kosovës¹ dhe prania ushtarake për të mbikqyrur implementimin e kësaj marrëveshjeje ishin të papranueshme.

Qeveria e Serbisë doli me qëndrim unik se autonomia e Kosovës mund të realizohej vetëm në kuadër të Republikës së Serbisë dhe përjashtoi mundësinë e pranisë së trupave të huaj në Kosovë. Sipas saj, Korpusi i Prishtinës i Ushtrisë Jugosllave

¹ Edhe pse nuk cenohet integriteti territorial i Jugosllavisë

garantonte paqen në Kosovë¹. Deklaratat që përjashtonin çfarëdo forme të autonomisë së Kosovës, që dilte jashtë kuadrit juridik të Serbisë, u bënë gjithnjë e më të shpeshta. “Nuk e japim Kosovën as me çmimin e bombardimeve”², theksoi Milošević-i në takimin me parlamentarët qipriotë.

Në të njëjtën kohë, një mobilizim i gjithanshëm politik dhe mediatik kundër NATO-s u organizua në të gjitha qytetet e Serbisë. «Do ta mbrojmë atdheun!», «Kosovën do ta mbrojmë me çdo çmim!», «Do të mbrohemi kundër çdo agresori!», janë vetëm disa nga motot rreth të cilave u mobilizuan njerëzit në Serbi³.

Në këtë situatë, ku rreziku i dështimit të konferencës ishte i qartë, ministrat e Punëve të Jashtme të Francës dhe të Britanisë së Madhe, Hubert Védrine-i dhe Robin Cook-u, bënë apel publik për kompromis!

“Ju mund të zgjidhni t’i jepni fund konfliktit dhe ta integroni Jugosllavinë në familjen e vendeve evropiane moderne. Por, ju gjithashtu mund ta fundosni në luftëra të brendshme dhe izolim që aq shumë e ka karakterizuar historinë tuaj të re. Populli i RFJ-së duhet t’i njohë Kosovës të drejtën për një shkallë të lartë të vetëqeverisjes. Ndërsa shqiptarët e Kosovës duhet të heqin dorë nga kërkesa për pavarësi dhe të njohin të drejtat e grupeve të tjera etnike në Kosovë. Dhe sidomos, të dy palët duhet të pranojnë praninë ushtarake ndërkombëtare, që do të garantonte zbatimin e marrëveshjes”⁴, ishin mesazhet e Hubert Védrine-it dhe Robin Cook-ut.

¹ Politika, « Protiv strani trupe » « Vladasložna-NATO neće doći », « Alijansa ne dolazi u obzir », « Ključna tema NATO trupe » 19.02.1999

² « Ne damo Kosmet ni po cenu bombardovajna » (Nuk e japim Kosovën qoftë edhe me çmimin e bombardimeve), “jedinstvo” 20-21 shkurt 1999; Të njëjtin titull kanë edhe shkrimet në gazetën “Politika” të datës 20-21 shkurt 1999 dhe në gazetën “Ekspres” të 20 shkurtit.

³ Politika, « Jugoslavia će čvrsto braniti suverenitet » « Miting mira za Kosovo », 20-21 shkurt 1999

⁴ Despicić-popović Helene: « Kosovo: un accord sans signataires. Ni Albanais ni Serbes ne semblent disposés à s'entendre à la veille de l'échéance. », 19.02.1999 http://www.liberation.fr/monde/1999/02/19/kosovo-un-accord-sans-signataires-ni-albanais-ni-serbes-ne-semblent-disposes-a-s-entendre-a-la-veill_265414

Blokimi i bisedimeve solli para një situate të vështirë diplomacinë e shteteve të Grupit të Kontaktit për Kosovën. Në këtë kontekst, Sekretarja e Shtetit Amerikan, Madeleine Albright-i, më 20 shkurt 1999, nga kështjella e Rambujesë, ju drejtua palëve në bisedime me një gjuhë të qartë kërcënuese: “Merrini gjërat seriozisht!”, tërhoqi vërejtjen Madeleine Albright-i. “Kësaj radhe nuk mund të lejojmë që dikush të shtiret! Nëse serbët thonë ‘JO!’ dhe bisedimet dështojnë për shkak të tyre, atëherë do të kemi bombardime! Nëse shqiptarët nuk thonë ‘PO!’ dhe bisedimet dështojnë për shkak të tyre, ne nuk do t’i mbrojmë dhe rrjedhimisht nuk do të ketë bombardime kundër Serbisë!”¹

Nga data 19 shkurt filloi një angazhim shumë më intensiv dhe shumë më i gjithanshëm për të shmangur dështimin e konferencës.

Ekipi që përfaqësonte shqiptarët e Kosovës në këto negociata kishte fuqinë që të merrte vendime! Ndërsa, ekipi serb nuk e kishte një gjë të tillë. Për këtë arsye, me delegacionin e Kosovës bisedohej në Rambuje, kurse, për të zhbllokuar situatën, ambasadori amerikan, Christopher Hill-i, udhëtoi për Beograd!

Edhe kësaj radhe Milošević-i tregoi arrogancën e tij të njohur nga diplomacia e shteteve perëndimore duke refuzuar ta pranonte. Në vend që ta pranonte ambasadorin amerikan dhe të shprehte qëndrimet e tij, Milošević-i parapëlqeu që me anë të mediave të njoftonte se “asnjëherë nuk do ta braktisim Kosovën, qoftë edhe nëse na bombardojnë”².

Është me rëndësi të theksohet se krahas deklaratave refuzuese të regjimit të Milošević-it karshi kërkesave të diplomatëve të

¹ INA.FR, «Rappel négociations/Rambouillet», le 20.02.1999, shih: <http://www.ina.fr/video/CAB99008831>

² Libération, Didier François, «Les pourparlers de Rambouillet arrivent à leur date-butoir. L'heure de vérité pour le Kosovo. Faute d'un accord de paix entre Serbes et Kosovars avant samedi midi, l'Otan pourrait lancer ses frappes aériennes» http://www.liberation.fr/evenement/1999/02/20/les-pourparlers-de-rambouillet-arrivent-a-leur-date-butoir-l-heure-de-verite-pour-le-kosovo-faute-d-_265478 dhe Politika, «Ne damo Kosovo po cenu bombardovanja», 20-21 shkurt 1999

shteteve perëndimore, shtypi serb i dha një publicitet të madh qëndrimeve që vinin nga institucionet shtetërore të Rusisë.

Në titujt kryesorë të mediave serbe theksohej se gjoja gjatë një bisede telefonike presidenti i Federatës Ruse, Boris Jelcin-i i kishte thënë presidentit amerikan, Bill Clinton-it, t'i mbante "duart larg nga Kosova!", se "kërcënimet kundër Serbisë nuk do të kalojnë", se "Jelcin-i nuk do të lejojë të preket Kosova"¹ e kështu me radhë.

Me gjithë faktin se Shtëpia e Bardhë përgënjeshtroi² këtë lajm dhe njoftoi opinionin publik se presidenti Clinton kishte kohë që nuk kishte biseduar me Boris Jelcin-in për këtë temë, shtypi serb nuk e hiqte nga faqet e para!

Në gazetat serbe dominonin lajmet se në takimin me Milošević-in, nënkryetari i Dumës Ruse, Sergei Baburin-i kishte deklaruar se "Duma ruse përkrah Serbinë dhe Jugosllavinë"³, se "kryeministri i Qeverisë ruse, Jevgeni Primakov-i, e kishte cilësuar si absolutisht të papranueshëm përdorimin e forcës"⁴, se "gjenerali

¹ «Nećemo dozvoliti da dirnu Kosovo», (Nuk do ta lejojmë ta ngucin Kosovën), Moskva, 18/02/ (Tanjug), "Jedinstvo" 19/02/1999; «Podrška Dume Srbije i SRJ», (Mbështetja e Duma-s Serbisë dhe RFJ-së) EKSPRES 19/02/1999; Nećemo dozvoliti da pipnu Kosovo (Nuk do ta lejojmë ta prekin Kosovën), Moskvë, "Ekspres-Politika" 19/02/1999; «Podrška Ruske Dume Srbije i SR Jugoslaviji» (Mbështetja e Duma-s Ruse Serbisë dhe RFJ-së), "Politika" 19/02/1999; «Jelcin protiv vojne pretnje NATO-a Jugoslaviji» (Jelcin-i kundër kërcënimeve të NATO-s ndaj Jugosllavisë), Moskvë, 18/02, "Politika", 19/02/1999; «Dalje prste od Kosmeta» (Larg gishtat nga Kosova) NOVOSTI, 19.02.1999; «Ne damo da dirate Kosovo», (Nuk do lejojmë të preket Kosova), Moskva, Politika, 19.02.1999; «Klinton, ne diraj u Kosovo!», (Klinton, mos e prek Kosovën!) "POLITIKA" 19.02.1999, Moskva (Beta-Roitors); «Rusija ima pravo da pomogne SRJ» (Rusia ka të drejtë të ndihmojë Jugosllavinë), "Politika", 21.02.1999; «Primena sile apsolutno neprihvatljiva» (Përdorimi i dhunës absolutisht i papranueshëm) "Jedinstvo" 24.02.1999; «Američke trupe nemaju šta da traže na Kosovu» (Trupat amerikane nuk kanë çka kërkojnë në Kosovë), "Politika" 24.02.1999; «Rusija preti prekidom odnosas NATO» (Rusia kërcënon me ndërprerje të marrëdhënieve me NATO-n), "Ekspres-Politika" 24.02.1999; «Bio bi to Vijetnam usred Evrope» (Do të ishte Vietnam në mes Evropës), "Politika", 24.02.1999;

² Politika, «Nisu razgovarali u poslednje vreme», 19 shkurt 1999.

³ Politika, «Podrška Ruske Dume Srbije i SR Jugoslaviji», 19.02.1999

⁴ Jedinstvo, «Primena sile "apsolutno neprihvatljiva"», (Përdorimi i dhunës absolutisht i papranueshëm), 24.02.1999

rus Leonid Ivashov-i ua tërhoqi vërejtjen amerikanëve dhe NATO-s që të largohen nga ideja e bombardimeve dhe se sulmi kundër Jugosllavisë do t'i japë të drejtë morale Ruisë që t'i ofrojë RFJ-së ndihmë ushtarake dhe teknike”¹, se “ministri rus i Mbrojtjes, mareshali Igor Sergejev-i, kishte theksuar se sulmet ajrore kundër Jugosllavisë mund të sillnin deri te «Vietnami i Ri» në Evropë dhe se Moska do të ndërpriste bashkëpunimin me NATO-n dhe do të ndihmonte ushtarakisht viktimitë”², se “pa pëlqimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nuk mund të kishte ndërhyrje ushtarake”³ dhe shkrime të shumta të kësaj natyre.

Krahas intensitetit të aktiviteteve diplomatike serbe me qëllim që t'u lihet faji “terroristëve shqiptarë” për dështimin eventual të Konferencës, në Kosovë vazhdonin vrasjet e civilëve shqiptarë që i atribuoheshin UÇK-së.

Më 21 shkurt, në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit, u ekzekutua para shtëpisë së vet veprimtari i njohur shqiptar, Gafurr Loku dhe djali i tij, Dritoni (20 vjeç). Që nga viti 1971 kur ishte student në Universitetin e Prishtinës e deri në vrasjen e tij, në vitin 1999, Gafurr Loku ka qenë vazhdimisht i përndjekur nga regjimet e njëpasnjëshme jugosllave. Më 21 janar 1973 Gjykata e Qarkut në Shkup e dënoi me 5 vjet burg⁴ për shkak të angazhimit për avancimin e të drejtave të shqiptarëve, ndërsa më 16 gusht 1982, e njëjta gjykatë e dënoi me 3 vite e 6 muaj burg.

Krahas këtij akti kriminal, regjimi i Milošević-it provokoi në mënyrën më të keqe të mundshme duke i futur në listën e civilëve të vrarë nga UÇK-ja⁵! Strategjinë e ekzekutimit të civilëve që aplikonte Shërbimi Sekret Serb dhe përpjekjet për t'ua veshur këto

¹ Politika, «Rusia ima pravo da pomogne SRJ» (Rusia ka të drejtë ta ndihmojë RFJ-në), 24 shkurt 1999

² Politika, «Bio bi to Vijetnam usred Evrope», (Do të ishte një Vietnam në mes të Evropës, 24 shkurt 1999

³ Politika, «Šešelj: SRS protiv bilo čijih trupa na Kosovu», 19 shkurt 1999

⁴ Në të njëjtin proces gjyqësor u dënuan edhe Rafi Halili, Rushit Nesimi, Elmaz Ajeti, Ajet Ademi dhe Nasuf Dauti

⁵ Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija : documents and evidence 1 January 1998 - 10 June 1999, III, Part One & Part Two p. 1023, Beograd, march 2000, f. 918

krime UÇK-së do të trajtohen në kapitullin e fundit të librit tim. Tani po i kthehem zhvillimeve rreth Konferencës së Rambujesë.

Zhvillimet në kuadër të kësaj konference imponuan vazhdimin e saj edhe për disa ditë. Më datën 23 shkurt 1999 delegacioni i Kosovës, nëpërmjet një letre, njoftoi ndërmjetësuesit ndërkombëtarë se pranon marrëveshjen e përkohshme për paqe¹. Nga ana tjetër, delegacioni serb ishte kategorikisht kundër nënshkrimit të marrëveshjes dhe kërkoi kohë që të konsultohet me Beogradin për një gjë të tillë.

Në këtë situatë u vendos që konferenca t'i ndërpresë punimet për një afat 2-3 javësh dhe të rifillojë në Paris më 15 mars 1999.

Dy javët në vijim të ndërprerjes së Konferencës së Rambujesë diplomacia e shteteve perëndimore ishte tejet aktive për të përgatitur të gjitha parakushtet për suksesin e Konferencës Paqësore për Kosovën. Por në Beograd qëndrimi bëhej gjithnjë e më negativ.

Krahas ngurtësisë së qëndrimeve politike që vinin, dhuna ndaj shqiptarëve nuk kishte të ndalur. Kështu, më 3 mars u gjetën të vrarë Qerim Rexha dhe Ilir Dini, shqiptarë nga Rahoveci, ndërsa në Rudar të Vogël të Komunës së Zveçanit², u gjetën të vrarë edhe dy shqiptarë të tjerë: Nexhat Azemi dhe Reshat Sejdiu³.

Më 3 mars, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë për "aktivitete terroriste" dënoi Agron Prokshin me 6 muaj burg, Raif Mustafën dhe Ismat Saraçin me nga 10 muaj, Sabedin Imerin me 15 muaj, Sedat Hasanin me 1 vit e gjysëm, Agron Ademin me 1 vit e 8 muaj, Basri Reçin, Bedri Bajramin, Nexhmi Sallahun, Faruk Reçin dhe Rifat Shaqirin me nga 1 vit e 8 muaj, Esat Shaqirin me 2 vite, ndërsa Safet Ferizi, i moshës 20-vjeçare, u dënua me 12 vjet burg⁴.

Vrasjet dhe dënimet e shqiptarëve ishin tregues se regjimi i Milošević-it nuk ishte i gatshëm të hiqte dorë nga qëllimet e tij politike për Kosovën.

¹ Rexhep Qosja, Paqja e Përgjakshme, Toena, Tiranë, 1999, f.333-339

² Komunë me shumicë serbe

³ Ekspres, «Još dve žrtve terorista», 4 mars 1999

⁴ Jedinsvo, «Zatvorske kazne teroristima», 4 mars 1999

Sa i përket qëndrimit lidhur me përpjekjet për të gjetur një zgjidhje politike për Kosovën, në takimin¹ që pati me të dërguarin special për Ballkanin, ambasadorin amerikan Richard Holbrooke-un, Milošević-i refuzoi në mënyrë kategorike dhe përfundimtare projekt marrëveshjen e lartpërmendur².

Të nesërmen e shpalljes së qëndrimit negativ të pushtetit të Beogradit ndaj projektit të propozuar nga Grupi i Kontaktit, më 10 mars 1999, ekipi i Mjekësisë Ligjore serbe dhe bjelloruse lëshoi një deklaratë për media, përmes së cilës komunikuan rezultatet paraprake të punës së tyre.

Sipas kësaj deklarate të transmetuar edhe nga Radioja serbe B92, të emisionit të orës 13:00, të datës 10 mars³, rezultatet e autopsisë dhe të testeve me «dorashka parafine», zbuluan se:

“Në rastin e Reçakut, 37 nga 40 kufomat e ekzaminuara rezultuan se kishin pasur mbetje baruti të padjegur në duar. Kjo dëshmon se ata kishin përdorur armë zjarri dhe rrjedhimisht ata kishin qenë ushtarë të UÇK-së e jo civilë”;

“U konstatua se 39 nga 40 kufoma nuk ishin vrarë nga afër dhe se vetëm në një rast kufoma kishte dy plumba nga një distancë relativisht e largët, por jo nga shumë afër”;

“Nga 40 të vrarët kishte vetëm një grua dhe një fëmijë 10-15-vjeçar, që ishte vrarë nga një distancë minimale prej 500 metrash e që dëshmonte se nuk ka pasur ekzekutim por të vrarë gjatë luftimeve”;

“Viktimat nuk ishin gjymtuar e as që u ishin prerë kokat e që dëshmonte se nuk ka pasur masakër.”⁴

Nëpërmjet këtyre rezultateve, ekspertët e Mjekësisë Ligjore serbe dhe bjelloruse hidhnin poshtë argumentet që theksonin se në Reçak kishte ndodhur masakër. Pra, këta “ekspertë”, nëpërmjet

¹ Beograd, 9 mars 1999

² Ivo H. Daalder et Michael E. O'Hanlon, *op. cit.*, f. 83-84

³ Jürgen Elsässer, *La RFA dans la guerre au Kosovo, Chronique d'une manipulation*, Harmattan, 2002, f.63-64

⁴ SERB INVESTIGATORS: RACAK NOT A MASSACRE, B92 vesti, 031099/1 [English] 13:00 CET: source: http://moumee.calstatela.edu/~sii/odrazb/n_990301/0309991e.htm

punës së tyre “shkencore” nxorën në shesh se “... masakra e civilëve shqiptarë ishte gënjeshtër!” Pra, edhe Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën ishte ftuar mbi bazën e “gënjeshtrove”! Por, shefja e ekipit të Mjekësisë Ligjore finlandeze, Helena Ranta, u dorëzoi raportin e ekipit të ngarkuar nga Bashkimi Evropian gjykatëses hetuese Danica Marinković-it dhe shefit të ekipit të Mjekësisë Ligjore serbe, Slaviša Dobričanin-it. Në të njëjtën kohë ajo paralajmëroi organizimin e një konference me gazetarë në Selinë e OSBE-së në Prishtinë, për datën 17 mars 1999.

Gjatë dy ditëve që i paraprinë mbajtjes së kësaj konference, mediat serbe shpërndanë informata se gjoja ekspertët finlandezë të Mjekësisë Ligjore kishin ardhur deri te konstatimi se “në Reçak nuk kishte ndodhur masakër!”¹ Gazetat përsëritën qëndrimet tanimë të shpallura nga ekspertët serbë dhe bjellorusë se “të vrrarët në Reçak ishin të armatosur dhe kishin krisur me armë zjarri para se të vriteshin. Te 37 nga 40 kufomat ishin zbuluar mbetje baruti...”²

Duke qenë e ngarkuar nga Bashkimi Evropian që të bënte ekspertizë profesionale për këtë rast, Helena Ranta u kufizua vetëm në disa përfundime të hulumtimeve të ekipit finlandez. Në bazë të asaj që kjo patologe theksoi gjatë konferencës, rezultatet e deritanishme të punës së tyre dëshmonin se në rastin e 40 kufomave, të cilave u ishte bërë autopsia dhe për të cilat ishin grumbulluar fakte të shumta “nuk bëhej fjalë për asgjë tjetër pos për fshatarë të paarmatosur, të cilët ishin vrrarë në ato tesha që i kishin pasur të veshura.”³

Këto qëndrime të Helena Ranta-s hidhnin poshtë pretendimet serbe se gjoja të vrrarët ishin ushtarë të UÇK-së, të cilëve kinse u ishin zhveshur uniformat ushtarake dhe u ishin veshur

¹ Politika, «Patologët finlandez në emër të BE-së: në Reçak nuk ka pasur masakër!», 16.03.1999

² Po aty

³ Të njëjtën gjë e përsërit edhe gjatë procesit gjyqësor kundër Milošević-it, me 12 mars 2003, f. 760

Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Helena Ranta, seanca e 12 mars 2003, f. 760

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

tesha civile. Përgënjeshttrimin që u bëri ekspertja e ngarkuar nga BE-ja revoltoi autoritetet politike të Beogradit dhe ekipin e Mjekësisë Ligjore serbe.

Një ditë pas konferencës së Helena Ranta-s, më 18 mars, ministri i Drejtësisë serbe, Dragoljub Janković-i, dhe anëtarët e ekipit të Mjekësisë Ligjore serbe, Slaviša Dobričanin-i, Vujadin Otašević-i dhe Dušan Dunjić-i organizuan një konferencë për shtyp. Në këtë konferencë në mënyrë të veçantë u theksua se “Helena Ranta është patologe dentare dhe se nuk është eksperte që të flasë me kompetencë për atë që ka ndodhur në Reçak.”¹

Krahas akuzave publike për “mungesë kompetence profesionale” të Helena Ranta-s, ministri i Drejtësisë i regjimit të Milošević-it dhe ekspertët serbë të Mjekësisë Ligjore, i kualifikuan deklaratat e shefes së ekipit finlandez si “qëndrime të ndikuara nga politika!”²

Edhe pse lajmet kryesore kishin të bënin me aktivitetet intensive për fillimin e raundit të dytë të bisedimeve të Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën, divergjencat lidhur me rezultatet paraprake të ekipeve të mjekëve ligjorë serbë e finlandezë për 40 viktimat do të zënë një vend të rëndësishëm në mediat serbe³.

Para se të fillonte vazhdimi i bisedimeve, më 13 mars, në tregun e Mitrovicës që frekuentohej kryesisht nga shqiptarët, shpërtheu një bombë. Tre shqiptare u vranë: Sevdije Selimi, Valdete Stana dhe Elizabeta Hashani (5-vjeç), ndërsa 48 persona

¹ Ekspres-Politika, «Nečista posla Helene Rante»; Novosti, «Iza Rante politika»; Politika, «Izveštaj Rante ravan nuli» 19.03.1999

² Po aty

³ Po sjell disa artikuj të shtypit serb denigrues ndaj raportit të Helena Ranta-s: «Izveštaj Rante ravan nuli» (Raporti i Ranta-s I barabartë me zero), “Blic” Hronika, 19 mars 1999; «Zašto Finci nisu koristili pouzdaniju metodu folije» (Për çarsye finlandezët nuk e përdorën metodën për të përsosur të foliejeve), “Politika”, 19 mars 1999; «Patolozi u senci politike» (Patologët nën hije të politikës), “Politika”, 19 mars 1999; «”Parafinska rukavica” jeste dokaz» (Dorashkat e parafinës janë dëshmi), “Ekspres”, 19 mars 1999; «Nečista posla Helene Rante» (Puna e papastër e Helena Ranta-s, “Ekspres”, 19 mars 1999; «Iza Rante politika» (Prapa Rana-s qëndron politika), “Novosti”, 19 mars 1999; «Sumnjiv izveštaj» (Raport i dyshimtë) “Novosti” 19 mars 1999

të tjerë u plagosën¹. Ndërsa, më 15 mars, kur mediat njoftuan se delegacioni shqiptar kishte udhëtuar në Paris për të nënshkruar marrëveshjen e propozuar nga Grupi i Kontaktit, në Komunën e Istogut u gjetën dy shqiptarë të vrarë, Rrahman Morina dhe Shaban Ramxhaj². Gjithashtu katër anëtarë të familjes Tafa (Xhemali, Ismaili, Rizahu dhe Ibrahim) nga fshati Grejkovc i Suharekës, u vranë në pyllin e fshatit ku kishin shkuar për të prerë dru.

Sikurse në raundin e parë të bisedimeve në Rambuje edhe në vigjilje të raundit të dytë, gjykatat që ishin nën kontrollin e plotë të regjimit politik të Milošević-it u përpoqën të tregonin efikasitetin e tyre. Gjykata e Qarkut në Prizren dënoi 5 shqiptarë të akuzuar për terrorizëm. Vehbi Muhadri u dënua me 8 vjet, Isak Hoti dhe Sokol Morina me nga 5 vjet, ndërsa Nysret Hoti me 4 vjet burg³.

Më 14 mars 1999, delegacioni shqiptar mbërriti në Paris. Me gjithë refuzimin e marrëveshjes nga ana e Milošević-it, delegacioni serbo-jugosllav shkoi në Francë. Kësaj radhe, delegacionin serb e shoqëroi edhe kryetari i Qeverisë së Serbisë, Milan Milutinović-i.

Të nesërmen, në takimin me Hubert Védrine-in dhe Robin Cook-un, shefi i delegacionit të Kosovës, Hashim Thaçi⁴, i njoftoi ndërmjetësuesit ndërkombëtarë se “pas konsultimeve dhe pas marrjes së mendimeve nga pjesa dërrmuese e popullit ... edhe pse ‘Po-ja’ jonë nuk kënaq plotësisht popullin e Kosovës, e pranon marrëveshjen. Ne mendojmë se kështu i kontribuojmë paqes në rajon.”⁵ Në të njëjtën ditë delegacioni i Kosovës nënshkroi marrëveshjen dhe mbajti një konferencë për shtyp⁶, me të cilën u njoftua opinioni publik ndërkombëtar për vendimet që ishin marrë.

Sado pozitiv që ishte nënshkrimi i marrëveshjes nga përfaqësuesit e Kosovës më 15 mars 1999, delegacioni serb refuzoi edhe aspektin politik, edhe atë të pranisë ushtarake për të mbikqyrur

¹ Politika 19 mars

² Jedinstvo, 16 mars 1999

³ Politika, « Osuđeno petoro terorista », 19 mars 1999

⁴ I cili ishte edhe shefi i Drejtorisë Politike të UÇK-së

⁵ Rexhep Qosja, Paqja e Përgjakshme, Toena, Tiranë, 1999, f.376-377

⁶ Po aty, 378-379

implementimin e marrëveshjes eventuale¹. Refuzimi serb e solli konferencën në një situatë tejet të vështirë.

Për të fituar kohë, delegacioni serb shtirej se nuk e kishte parë projekt marrëveshjen që duhej ta nënshkruante. Madje, qëndrimi i tillë tallës detyroi edhe ndërmjetësuesin rus, Boris Majorskin, të deklaronte publikisht se “serbët e kanë pasur këtë dokument që nga muaji shkurt”² ndërsa Ivanovi, shefi i diplomacisë ruse, kërkoi nga autoritetet e Beogradit “që ta nënshkruanin dokumentin!”³

Në vend që të nënshkruanin marrëveshjen, ata dorëzuan një dokument të ri për autonominë e Kosovës në kuadër të Serbisë dhe u treguan të gatshëm të nënshkruanin këtë dokument që kishin përgatitur vetë! Madje, për implementimin e këtij dokumenti delegacioni serb ngulte këmbë që të bëhej përmes “Ushtirisë Jugosllave dhe Korpusit të saj në Prishtinë, që paraqiten si garant të paqes në Kosovë.”⁴ Propozime të tilla ishin tallje e hapur me të gjitha angazhimet ndërkombëtare për të gjetur një zgjidhje gjatë kësaj konference.

Paralelisht me këto qëndrime të autoriteteve politike, institucionet gjyqësore serbe vazhduan me logjikën e vjetër. Më 19 mars, Gjykata e Qarkut në Prokuplje⁵ dënoi 15 punëtorë shqiptarë, që u arrestuan më 19 qershor 1998 ndësa ishin duke u kthyer me autobus nga Republika e Sllovenisë. Gjatë bastisjes së këtyre shqiptarëve, që punonin në këtë shtet, tashmë të pavarur nga Jugosllavia, atyre iu “gjetën” 96.155 marka gjermane. Krahas plaçkitjes së kursimeve u akuzuan se gjoja kishin dashur t’ua dërgonin paratë “terroristëve” në rajonin e Malishevës! Mbështetur mbi këtë akuzë, kjo gjykatë dënoi Ramadan Avdiun, Ali Gashin, Qazim Krasniqin, Imer Krasniqin, Azem Krasniqin, Burim Bllacën, Naim Balajn, Nuhi Bokajn, Enver Zogajn, Halid Nareçajn dhe Hajrulla

¹ Yves Tomic, *L'état du monde 2000*, La Découverte, Paris, 1999 shih: http://www.afebalk.org/edm/articles.php?id_article=167

² Politika, «Majorski: Srbi su dobili dokument u feburara», 19 mars 1999

³ Po aty

⁴ “Delegacioni jonë jep vërejtje dhe propozime me shkrim”, Politika 16 mars 1999

⁵ Qytet në Serbi

Samaraxhën me dënim në kohëzgjatje nga tre vjet e gjysmë burg, ndërsa Feriz Zabelajn, Rrahim Aliun, Xhavit Kaçanikun dhe Sinan Bytyqin me nga katër vjet burgim.

Me gjithë mesazhet tejet negative dhe akteve që i shoqëronin qëndrimet këmbëngulëse serbe të mentalitetit të vjetër, diplomacia e shteteve të Grupit të Kontaktit vazhdoi me intensitet edhe më të madh. Që nga 15 marsi e deri më 22 mars nuk u ndërpre në përpjekjet për të përmbyllur këtë konferencë me sukses të përgjithshëm.

Më 22 mars dështoi përpjekja e fundit e Ambasadorit R. Holbrooke për të bindur Slobodan Milošević-in që të pranonte marrëveshjen e nënshkruar nga delegacioni shqiptar. Të nesërmen, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Javier Solana deklaroi se i kishte dhënë urdhër gjeneralit Wesley Clark-ut, të fillonte operacionet ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë.”¹

Me gjithë mesazhet e qarta se ishte dhënë urdhri për bombardime, mediat serbe përsëritnin pa ndërprerë qëndrimin e Milošević-it “Nuk e japim Kosovën as me çmimin e bombardimeve!” Kjo deklaratë e tij, e thënë në takimin me parlamentarët qipriotë që e përmendëm më lart, ishte shndërruar në moto mobilizuese në tërë Serbinë.

Më poshtë do të përpiqem të sqaroj nese këto mobilizime ishin në funksion të bindjes së shteteve anëtare të NATO-s për gatishmërinë serbe që të luftonin për të mbajtur Kosovën nën thundrën e vet ose refuzimi i marrëveshjes politike dhe vazhdimi i dhunës në Kosovë nga ana e regjimit të Beogradit bëhej në funksion të provokimit të bombardimeve. Por, para se ta trajtoj këtë aspekt, e shoh të udhës të ndalem në detajet rreth asaj që ndodhi më 15 janar 1999 në fshatin Reçak.

¹ Conseil de l'Europe, Denis Huber, *Le Conseil de l'Europe (1989-1999): une décennie pour l'histoire* <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=123029>

Rezultatet e ekspertëve mjekoligjorë dhe Betimi i Hipokratit!

Me qëllim që të ndriçohet se çka ndodhi realisht në këtë fshat të Kosovës, është e domosdoshme të tregohen rezultatet e punës së ekspertëve serbë dhe atyre ndërkombëtarë të Mjekësisë Ligjore. Edhe në rastet kur divergjencat janë tejet të mëdha midis dy ekipeve që hulumtuan rastin, ato do t'i mundësojnë lexuesit që të kuptojë jo vetëm «Masakrën e Reçakut», por edhe mekanizmat e regjimit që u futën në lojë për të fshehur gjurmët e krimit. Pra, t'ua lëmë fjalën ekspertëve dhe të shohim se çka u ndriçua me punën e tyre.

Në intervistën për dokumentarin e Televizionit Shtetëror të Serbisë, kushtuar ngjarjes së Reçakut, shefi i ekipit serb të Mjekësisë Ligjore, Slaviša Dobričanin-i, deklaroi se “ekipi finlandez u inkuadrua në punët për përcaktimin e shkaqeve të vrasjes së 40 personave në Reçak, më 22 janar 1999. Domethënë tri ditë pasi ekipi serb kishte filluar punën. Erdhën shumë vonë”¹, konstatoi ai. Për të mos humbur kohën e çmuar, deri më 22 janar, ekipi mjekoligjor serb kishte bërë autopsinë e 16 personave, i kishte përfunduar testet me «dorashka parafine» dhe i kishin marrë shenjat e gishtërinjve të kufomave². Ngutja për të kryer këto punë ishte bërë, sipas Dobričanin-it, vetëm e vetëm që të mos vonoheshin! “Çdo vonesë mund të kishte pasoja shumë të mëdha, sidomos në vështirësitë e përcaktimit të shkaqeve të vdekjes dhe të lëndimeve të tjera eventuale që u gjetën te kufomat.”³

Pas ardhjes së ekipit finlandez, autopsia e 24 trupave të tjerë është bërë nga ekipet e përziera. “Pastaj u jemi kthyer atyre 16 kufomave, që ua kishim bërë autopsinë dhe para ekspertëve finlandezë bëmë demonstrimin në trupat e kufomave. Bëmë një shikim të jashtëm, krahasimi i hyrjeve dhe i daljeve të plagëve dhe çdo gjë që ka qenë e nevojshme për të pasur një pasqyrë të vërtetë të zbulimeve të Mjekësisë Ligjore.”⁴

¹ Dokumentari i cituar i RTS, « Kosovo : Raçak Laži i istine »

² Po aty

³ Po aty

⁴ Po aty

Sipas pohimeve të Slaviša Dobričanin-it “mjekët finlandezë ishin shumë të kënaqur. Nuk patën asnjë vërejtje për punën që kishim bërë me 16 trupat. Në fund u shkruan konkluzionet, veç e veç për secilin rast dhe të përmbledhura në një raport. Ne u ofruam mjekëve finlandezë që edhe ata ta nënshkruajnë tërësinë e konkluzioneve të autopsisë së Mjekësisë Ligjore. Fillimisht ata pranuan. Por, më vonë, pas konsultimeve me Helena Ranta-n, ajo na komunikoi se ata nuk duhet dhe nuk kanë të drejtë të nënshkruajnë, sepse kanë nevojë të vazhdojnë të punojnë.”¹ Edhe Helena Ranta pohoi se “gjatë gjithë punës profesionale në sallat e autopsisë puna ka ecur pa asnjë problem, pa marrë parasysh prejardhjen e ekspertëve.”² Divergjencat fillojnë kur dilet nga fusha profesionale dhe interpretohen me kritere që nuk kanë lidhje me Mjekësinë Ligjore.

Lexuesit i kujtohet se në konferencën e organizuar nga ministri i Drejtësisë serbe, Dragoljub Janković-i, dhe nga anëtarët e ekipit serbë të Mjekësisë Ligjore, u ngritën dyshime për kompetencat profesionale të Helena Ranta-s.

Qëndrime të njëjta denigruese ndaj kompetencave profesionale të Helena Ranta-s u përsëritën nga anëtarët e ekipit të Mjekësisë Ligjore serbe si në artikuj gazetash ashtu edhe në emisione televizive kushtuar kësaj ngjarjeje³. Madje, edhe në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në procesin gjyqësor kundër Milošević-it⁴, dr. Slaviša Dobričanin-i përsëriti të njëjtin qëndrim. I ftuar nga ana e Milošević-it si ekspert për të dëshmuar se gjoja “në Reçak nuk kishte pasur civilë të vrarë”, Dobričanin-i u mundua të bindte trupin gjykues se “Helena Ranta ishte stomatologe me profesion, që kishte bërë një specializim për stomatologjinë gjyqësore, ndërsa të gjithë anëtarët e tjerë të ekipit finlandez ishin specialistë të Mjekësisë Ligjore dhe konsidero-

¹ Dokumentari i TVB « Kosovo : Račak Laži i istine »

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Helena Ranta, seanca e 12 mars 2003, f.763-764, http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

³ Më lart përmendëm disa nga shkrimet e publikuara në gazetat serbe, ku Helena Rante denigrohet skajshmërisht.

⁴ i ftuar si dëshmitarë nga ana e mbrojtjes së Slobodan Milošević-it

heshin si ekspertë në krye të listës së patologëve në botë. Nuk kishte asnjë arsye që e justifikonte Helena Ranta-n të ishte në krye të një ekipi të tillë, që përbëhej nga specialistë botërorë të Mjekësisë Ligjore. Por, me gjasë kjo është punë e politikës dhe e marrëveshjeve.”¹

Me qëllim që të mos ndikonte në opinionin publik, e ngarkuara e Bashkimit Evropian, Helena Ranta, heshti për një periudhë gati dyvjeçare dhe nuk publikoi asgjë lidhur me rezultatet përfundimtare të ekspertizës që kishte bërë ekipi finlandez. Kjo heshtje u hapi rrugë spekulimeve të ndryshme me emrin e saj dhe me rezultatet e hulumtimeve të këtij ekipi mjekoligjor. Ajo heshti edhe kur u spekulua me deklaratën e saj se në Kosovë kishte ardhur pa paragjykime rreth rasti duke mos përjashtuar asnjë hipotezë. Bile nuk përjashtoi as hipotezën se rasti kishte mundur të ishte i inskenuar². Deklarata se nuk kishte pranuar të cilësonte ngjarjen me termat që nuk ishte adekuate me terminologjinë e Mjekësisë Ligjore³ u keqpërdor deri në atë shkallë sa u cilësua si presion politik ndaj kësaj eksperteje!

Mirëpo, më 10 mars 2001, Helena Ranta theu heshtjen. Në artikullin «Masakra e Reçakut ishte me të vërtetë një masakër», redaktorja e NRC Handelsblad, Petra de Koning-u, solli, ndër të tjera, pjesë nga intervista që kishte bërë me Helena Ranta-n⁴.

Në këtë intervistë Helena Ranta sqaroi për punën e madhe që ishte bërë për të ndriçuar këtë krim. “Me autopsinë e trupave, me gëzhojat që u gjetën në vendin e krimit, me hulumtimet në përrua, ku çdo centimetër e tokës së tij është përshkuar me lopatë, me lugë dhe me detektor metalesh (...) «Çështja e Reçakut» është tema e shoshitur më së miri në historinë e Gjykatës së Hagës.”⁵

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca 8 prill 2005, f. 506-507 dhe f.514.

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Helena Ranta, seanca e 12 marsi 2003, f.763-764. Po aty, f. 733-735

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

³ Dokumentari i i cituar i RTS, « Kosovo : Račak Laži i istine »

⁴ Petra De Koning, « Le “Massacre” de Reçaken était bien un »

https://docs.google.com/document/d/1kV_5OI_gI3IzEAgwxfwKRbNCTuNye7YZOTSPsi6rY/edit?pli=1

⁵ Po aty

Sipas këtyre hulumtimeve “të vdekurit bartnin veshje civile shtatë-tetë shtresash njëra mbi tjetrën, sepse ishte dimër. Autopsia vërtetoi se ata ishin vrarë në këto tesha. Gjatë hulumtimeve u gjetën plumba në gropën e përroit nën sipërfaqen e dheut, aty ku u gjetën viktimat. Pranë njërit nga plumbat u gjet edhe pjesë e një trupi. Rezultatet e autopsisë që u bënë në Spitalin e Prishtinës korrespondojnë me ato që kemi gjetur në përrua: burri, pjesa e të cilit u gjet, ishte i shtrirë në tokë në momentin kur u shti mbi të. Viktimat e tjera paraqesin modalitete të ngjashme. Kategorikisht përjashtohet mundësia që 23 njerëzit e gjetur në përrua të jenë vrarë në ndonjë vend tjetër. Nuk janë vendosur më vonë në këtë përrua dhe nuk ka pasur asnjë inskenim. Civilët shqiptarë janë vrarë nga afër dhe nuk ka asnjë rëndësi nëse ishin vrarë nga distanca një apo dy metra. Sido që të jetë, ata nuk janë vrarë në betejë”¹, deklaroi shefja e ekipit finlandez të Mjekësisë Ligjore, Helena Ranta.

Të njëjtat qëndrime ajo do t'i përsërisë edhe gjatë dëshmisë² së saj në procesin gjyqësor kundër Slobodan Milošević-it në Hagë.

Për një kohë relativisht të gjatë, ekipi serb i Mjekësisë Ligjore mbrojti me këmbëngulje qëndrimet që u përpiluan në qarqet politike të Beogradit dhe që u shpërndanë në publik nga gazetarët e Radio Televizionit Shtetëror të Serbisë, Milovan Drecun-i dhe Tomislav Magoči-t. Megjithatë, në pesëvjetorin e «Masakrës së Reçakut» , ata që nuk kanë pasur mundësi të përcjellin procesin gjyqësor kundër Slobodan Milošević-it në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, patën mundësi të zbulojnë një pjesë të së vërtetës që lidhet me vrasjen e fshatarëve në Reçak.

Në konferencën me gazetarë, të mbajtur më 26 janar 2004, për herë të parë një patolog i ekipit serb (dr. Vujadin Otašević-i) nuk mohoi se trupat e shqiptarëve në Reçak ishin të masakruar. Por, ai sqaroi se “në trupat e tyre ishin gjetur shenjat dhëmbësh kafshësh dhe se trupat ishin masakruar nga qentë!”³

¹ Po aty

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Helena Ranta, seanca e cituar e 12 marsit 2003, f.744 dhe f.752

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

³ Glas Javnosti, «Tela masakrirali psi!» (Trupat i masakruan qentë) në : <http://www.mail-archive.com/sim@antic.org/msg15483.html>

Në pjesën e mësipërme lexuesi pati mundësi të lexonte dëshminë e vëzhguesit të OSBE-së të botuar në shkrimin e Pierre Hazan-it, që nuk e dinte “ishin trupa të gjymtuar apo nëse kafshët ua kishin ngrënë mishin.”¹ Kjo hipotezë, që më tepër mund të shihet si ironi ndaj veprimit shtazarak që ishte treguar më 15 janar 1999 në fshatin Reçak, fillimisht dr. Vujadin Otašević-i në vitin 2004 e më vonë edhe Slaviša Dobričanin-i, në vitin 2005 e paraqitën si të vërtetë të zbuluar nga patologët serbë! Ajo që e bëri këtë konferencë të jetë në qendër të vëmendjes lidhet me pohimin e dr. Vujadin Otašević-it se “tregimet e sajara në Beograd për veshjen e terroristëve me tesha civile pas vrasjes ishin plotësisht konfuze.”² “Nuk e di se kujt i ra ndër mend një marrëzi³ e tillë, por e di se të gjithë kemi qenë tmerrësisht të hidhëruar me deklarata të tilla”⁴, theksoi dr. Vujadin Otašević-i. “Plagët e plumbave në tesha u përgjigjeshin saktësisht atyre që kishin në trup dhe ky fakt u shfrytëzua nga Walker-i për t’u ofruar gazetarëve të huaj versionin e masakrës.”⁵

Megjithëse dr. Vujadin Otašević-i e cilësoi si marrëzi “gënjeshtrën e sajuar në Beograd për zhveshjen e terroristëve të vrarë nga uniformat e UÇK-së dhe veshjen e tyre me tesha civile”, edhe ky patolog “mbështet qëndrimin se të gjithë personat ishin vrarë gjatë luftimeve dhe nga një distancë e largët”⁶!

Vlen të theksohet se dy vjet para se dr. Vujadin Otašević-i ta cilësonte si marrëzi sajimin e gënjeshtrës në Beograd për të fshehur gjurmët e «Masakrës së Reçakut», në seancën gjyqësore të datës 12 qershor 2002, të procesit gjyqësor kundër Milošević-it,

¹ Libération, Pierre Hazan, artikulli i cituar, «Massacre de Racak...»

² Večerne Novosti, «Laž u službi “tomahavka”»
<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.69.html:154641-SLU268AJ-RA268AK-PET-GODINA-POSLE-INSCENIRANOG-MASAKRA--Laz-u-službi-tomahavka---4>

³ Në vijim të shkrimit tim fjalën marrëzi do ta shkruaj me shkronja italiane kur i referohem cilësimit që dr. Vujadin Otašević-i i bëri përpjekjes së qarqeve politike të Beogradit të fshihnin në këtë formë gjurmët e krimit.

⁴ Večerne Novosti, artikulli i cituar, «Laž u službi “tomahavka”»

⁵ Po aty

⁶ Po aty

William Walker-i deklaroi: “Në bazë të pozitive se si ishin trupat e shtrirë, se si ishin të veshur, në bazë të vrimave të plumbave dhe gjakut përreth, duke u mbështetur në faktin se e gjithë kjo ndodhi në mes të dimrit, të pohohet se kufomave u janë ndërruar teshat, apo diçka të ngjashme si kjo, nuk është asgjë tjetër pos pohim tërësisht i marrë.”¹ “Nga ajo që kemi parë unë dhe shoqëruesit e mi atë ditë kemi dalë në përfundimin se nuk bëhej fjalë për asnjë lloj montimi, por aty ishte vendi ku ishin vrarë 40 persona civilë”² - përmbylli qëndrimin e vet për këtë çështje William Walker-i.

Milošević-i, sipas të gjitha gjasave, kishte mbetur ende me “marrëzinë” dhe me “gënjeshtren” e sajuar në Beograd. Ai solli këtë temë edhe në procesin e gjykimit kundër tij në Hagë. Duke shpresuar se në këtë proces do të konfirmohej ajo që ishte shpërndarë për “zhveshjet-veshjet” e të vrarëve në Reçak, Milošević-i kërkoi sqarime nga Dobričanin-i “nëse përputheshin plagët e trupave me vrimat e teshave”. Dobričanin-i i përgjigjet shkurt: “Po”³!

I pakënaqur nga përgjigja, Milošević-i kërkoi të dihet se a kishte përputhje në të gjitha rastet apo kishte raste ku vrimat e teshave nuk përputheshin me plagët. “Në të gjitha rastet”⁴, iu përgjigj Dobričanin-i përsëri me një përgjigje të shkurtër.

Deklarata e Dobričanin-it se personat ishin vrarë në ato tessa konfirmoi qëndrimin e patologëve finlandezë, që pati publikuar Helena Ranta në konferencën e 17 marsit 1999 dhe e rikonfirmoi gjatë dëshmisë së saj të 12 marsit 2003, në gjykimin kundër Slobodan Milošević-it.

Hedhja poshtë e gënjeshtres për “zhveshjet-veshjet” e të vrarëve në Reçak, që u bë nga ekspertiza e patologëve dhe që u konfirmua edhe nga ana e shefit të ekipit të patologëve serbë në

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari William Walker-i, Seanca e 12 qershorit, f. 563

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Po aty f.644-645

³ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, *seanca e cituar e 8 prill 2005*, f. 533

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

⁴ Po aty, f.533

këtë proces gjyqësor, shënoi fillimin e zhveshjes së gënjeshtres së sajuar nga qarqet politike të Beogradit.

Megjithatë, me qëllim që të shpëtohej diçka nga ajo që ishte përhapur si e “vërtetë” nga qarqet e Beogradit, Slaviša Dobričanin-i theksoi se “kufomat kishin teshë me ngjyra të errëta, karakteristikë e veshjes së ushtarëve të UÇK-së, të policisë ushtarake të UÇK-së ose ndoshta edhe të rojeve të fshatit.”¹

Nga eksperti i Mjekësisë Ligjore, Slaviša Dobričanin-i u prezantua si “ekspert” për veshmbathjet ushtarake²! Foli për ngjyrën e teshave të ushtarëve të UÇK-së ky profesor i Mjekësisë Ligjore, që në shumë shkrime të veta, që u cituan edhe gjatë audiencës në procesin kundër Milošević-it, këmbënguli se nuk i takonte Helena Ranta-s të cilësonte se në Reçak “nuk bëhet fjalë për asgjë tjetër pos për fshatarë të paarmatosur.” Kur është për të tjerët, sidomos kur qëndrimet e tyre nuk përputhen me propagandën e regjimit të Beogradit, Slaviša Dobričanin-i këmbëngulte: “nuk është punë e ekspertëve të Mjekësisë Ligjore të flasin për prejardhjen e njerëzve dhe për ngjarjet që kanë ndodhur atje ku u gjetën kufomat.”³ Por, “detyra e ekspertëve të Mjekësisë Ligjore është përcaktimi i shkaqeve, i mënyrës së vrasjes, i lëndimeve të tjera eventuale, i ndryshimeve patologjike dhe i fakteve që lidhen me identifikim. Ndërsa, vlerësimet për motivet dhe për arsyet e vrasjeve, implikimet e tyre politike ose aspektet morale, lidhjet e viktimave me organizatat politike ose me organizatat e tjera (...) janë çështje që nuk kanë të bëjnë me hapësirën në të cilën shtrihet shkenca e Mjekësisë Ligjore.”⁴

Kriteret profesionale të shkencës së Mjekësisë Ligjore vlejné vetëm për të tjerët! Kur është fjala për shqiptarët e vrarë në Reçak, Slaviša Dobričanin-i nuk ngurroi të fliste për “lidhjet e viktimave me organizatën terroriste të UÇK-së”, për “veshmbathjet e tyre”,

¹ Po aty, 532-533

² Intendent ushtrie!

³ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 12 prillit 2005, f.613

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

⁴ Po aty, f.613

për “ngjyrat e teshave” për rolet dhe për funksionet që kishin (“Rojet e fshatit”) dhe kualifikime të tjera që i takojnë pikërisht kategorisë që denonconte.

Vërejtjet që iu bënë për faktin se ai vetë përdorte cilësime për të cilat e kritikonte Helena Ranta-n¹, Dobričanin-i përpiqet të arsyetohet se në “Rastin e Reçakut” ai ka pasur dy role: të anëtarit të ekipit hetimor të gjykatësës hetuese Danica Marinković-it dhe të specialistit të Mjekësisë Ligjore. Ai këmbëngul në këtë rol të dyfishtë dhe kërkon që të kuptohet se thëniet e tij lidhur me “rojet e fshatit” dhe me “ngjyrën e teshave” janë gjëra që i ka parë si “anëtar i ekipit hetimor”, ndërsa çdo gjë që thotë për kufomat, e bën “si profesor dhe si specialist i Mjekësisë Ligjore!”²

Të shohim se si ky “profesor dhe specialist i Mjekësisë Ligjore” flet për kufomat e shqiptarëve të vvarë!

Pasi ia sollën të gjitha argumentet e ekspertizës që dëshmonin se Halim Beqiri³ (14 vjeç) ishte vvarë pas shpine, gjykatësi kërkoj nga Dobričanin-i që të jepte mendimin e vet profesional në cilësinë e ekspertit të Mjekësisë Ligjore nëse ishte e mundur që ky 14 vjeçar të kishte qenë civil. Në këtë rast Slaviša Dobričanin-i nuk mundi të përgjigjej as si “anëtar i grupit hetues”, as si “profesor dhe specialist i Mjekësisë Ligjore”. Në këtë rast ai iu referua eksperiencës së tij jetësore dhe solli “faktet” e tij se Halim Beqiri “ishte një djalosh dhe se shqiptarët 14 vjeçarë tanimë janë të rinj të pjekur! Shumë prej tyre mbajnë armë, ndërsa mosha nuk do të thotë asgjë për shqiptarët.”⁴

Ekspertencë e çuditshme! Përpjekja për të fshehur krimin e vrasjes së një djali 14-vjeçar, me argumente se “mosha për shqiptarët nuk do të thotë asgjë”, është përpjekje neveritëse. Aq më tepër kur një gjë e tillë bëhet nga një mjek! Për “profesionalizmin” e këtij konkluzioni le të gjykojë vetë lexuesi!

¹ Po aty, f.614

² Po aty, f.616

³ Të njëjtën ditë babai Halimit është vvarë, ndërsa nëna dhe motra u plagosën

⁴ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 12 prillit 2005, f.641-642

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

Megjithatë, pohimi se shqiptarët ishin vrarë në tesha civile ishte një goditje për Milošević-in dhe për ata që kishin ftuar dr.Slaviša Dobričanin-in si dëshmitar të mbrojtjes. Me shpresë se do të sillte diçka që do të konfirmonte versionin e sajuar në qarqet politike serbe të Beogradit për këtë rast, Slobodan Milošević-i ndërroi temën dhe nga teshat e viktimave kaloi te distanca e vrasjeve.

Para se t'i përgjigjej pyetjes së Milošević-it nëse ishin vrarë 40 personat e fshatit Reçak nga larg apo nga afër, dr. Dobričanin-i shpjegoi se çfarë kuptohet me termat «afër» dhe «larg» në Mjekësinë Ligjore.

“Çdo vrasje me armë zjarri që shkon nga distanca 2-3 milimetra nga trupi e deri në distancën 200-250 centimetra nga trupi, konsiderohen si vrasje nga afër. Sa i përket të vrarëve në Reçak, në dy raste janë gjetur mbetje të barutit të padjegur, që dëshmon se, sipas të gjitha gjasave, janë vrarë nga distanca për afërsisht një metër e gjysmë deri dy metra. Të gjithë personat e tjerë janë vrarë nga larg. Nga dy metra e më shumë!”¹

As terminologjia profesionale e kualifikimit të vrasjes nga distanca më e madhe se dy metra “si vrasje nga larg”, nuk ishte “distancë minimale prej 500 metrash”, që priste të dëgjonte Milošević-i! Edhe në këtë rast Milošević-i ndërroi temën dhe solli në audiencë idenë e sajuar nga Beogradi se “gjymtimi i trupave ishte bërë nga ana e terroristëve shqiptarë për të krijuar përshlytjen e masakrës.” Ai kërkoi sqarime nga eksperti i Mjekësisë Ligjore për kohën e shkakimit të plagëve: para apo pas vdekjes?

Nga hulumtimet që kishte bërë ekipi i patologëve serbë, Dobričanin-i solli rezultatet se “të gjitha plagët që ishin në trupat e tyre, e që ishin shkaktuar nga armët e zjarrit, kishin ndodhur sa ishin gjallë. Pos plagëve me armë zjarri, në gjashtë trupa ishin gjetur lëndime nga kafshët, që kanë ndodhur pas vdekjes!”²

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.540-541
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.536
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

Për të bërë bindëse hipotezën e dëmtimit të kufomave nga kafshët, Slaviša Dobričanin-i theksoi se kjo gjë kishte ardhur për arsye se “trupat e të vdekurve në Reçak kishin qëndruar katër ditë të shtrirë në hapësirë të hapur, e ndoshta edhe në xhami¹ dhe konstatimi se kufomat ishin dëmtuar nga kafshët ishte vërtetuar në bazë të teheve të eshtrave...”²

Pasi nuk mori përgjigjen e pritur, Milošević-it i interesoi të dinte nëse kishte pasur së paku ndonjë veprim post mortem ndaj viktimave. Edhe në këtë rast Dobričanin-i iu përgjigj se “nuk ka pasur absolutisht asnjë veprim post mortem!”³ Në sqarimin e tij për kokat e prera, eksperti Dobričanin thotë se ato nuk janë prerë pas vdekjes, por kjo ka ndodhur për së gjalli. Sepse dihet se plumbat mund ta coptojnë kokën për shkak të konstruktit të kafkës, madje edhe vetëm një plumb nga arma e zjarrit mund ta shkatërrojë gati tërësisht kokën.”⁴

Si përfundim, personat nuk janë gjymtuar dhe nuk janë masakruar nga njerëzit as për së gjalli e as post mortem! Ata janë vrarë gjatë luftimeve dhe janë gjymtuar nga kafshët! Kjo është e vërteta e “profesorit dhe e specialistit të Mjekësisë Ligjore”, Slaviša Dobričanin-it, që në këtë rast flet si “anëtar i ekipit të gjykatëses hetuese, Danica Marinković-it!

Duke pohuar se ata ishin vrarë gjatë luftimeve, ai hodhi poshtë se këta persona ishin ekzekutuar nga forcat e armatosura policore dhe ushtarake serbe. Madje, Dobričanin-i theksoi se gjoja edhe patologët serbo-bjellorusë edhe kolegët e tyre nga ekipi finlandez “kishin shënuar në shënimet e tyre se nuk ka pasur shenja ekzekutimi.”⁵

Pohimi i ekzistimit të shënimeve “për mungesë shenjash të ekzekutimit”, ku implikoheshin edhe patologët e ngarkuar nga Bashkimi Evropian, e detyruan trupin gjykues të kërkonte të dhëna

¹ Ai thotë se nuk e di se kur janë transferuar ata atje

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari *Slaviša Dobričanin*, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f. 547-548

³ Po aty, f.548

⁴ Po aty, f.548-549

⁵ Po aty, f.525

të sakta lidhur me këtë çështje. Konkretisht burimin e dokumentit, në të cilin finlandezët paskan shkruar se nuk ka pasur asnjë shenjë ekzekutimi!

“Më tregoni ku mund ta gjej atë dokument?” nguli këmbë gjykatësi Bonomi gjatë kësaj seance.

I zënë ngushtë nga kjo pyetje, dr. Dobričanin-i u përgjigj: “E kam parë një gjë të tillë në dokumentet e tyre. Nuk më kujtohet saktësisht, por kam hasur gjatë leximit se është shkruar diku që nuk ka shenja ekzekutimi. Ne kemi rënë dakord për këtë çështje. Ju lutem, kanë kaluar gjashtë vjet. Në të vërtetë nuk e di. Kam lexuar dhe rilexuar shumë, por nuk jam përgatitur për këtë...”¹

Nëse nuk i kujtohej se ku e kishte parë të shkruar në dokumentet e ekipit të patologëve finlandezë se gjoja nuk kishte pasur shenja ekzekutimi, gjykatësi nguli këmbë të dinte “nëse mund të përmendte konkretisht cilindo qoftë nga pjesëtarët e ekipit finlandez të mjekëve ligjorë, që janë pajtuar me konkluzionet e patologëve serbë, se ajo që ka ndodhur në Reçak nuk u është dukur si ekzekutim?” Përgjigja e Dobričanin-it ishte e qartë dhe zhgënjyese për Milošević-in: “Jo, nuk mund të përmend asnjë anëtar. As të ekipit finlandez e as të ekipit tonë. Shumë vjet kanë kaluar që nga ajo kohë.”² Por atë që e tha me bindje të plotë dhe u përpoq të bindte trupin gjykues ka të bëjë me pohimin se në Reçak, më 15 janar 1999, të gjithë personat ishin vrarë gjatë luftimeve. Këtë e tha si njeri me përvojë dhe si anëtar i ekipit hetues e jo si “profesor dhe specialist i Mjekësisë Ligjore”!

Në çka mbështeten në të vërtetë të gjitha ata që të vrarët në fshatin Reçak i konsiderojnë “ushtarë të UÇK-së”, “terroristë shqiptarë”, “të vrarë gjatë luftimeve”? Të gjithë ata që interpretojnë këtë temë nga ky këndvështrim ose që e integrojnë në një kontekst për të argumentuar “komplotin e imperializmit amerikan kundër Serbisë”, sjellin dëshmitë serbe gjatë ekspeditës për nxjerrjen e kufomave nga ky fshat më 17 janar 1999.

¹ Po aty, f.525

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 12 prillit 2005, f.616

Siç u përmend edhe më lart, në ditën e kësaj ekspedite, gjykatësja hetuese Danica Marinković-i, profesori i Mjekësisë Ligjore, Slaviša Dobričanin-i¹ dhe policia serbe ekspozuan para gazetarëve “40 kufomat që ndodheshin në xhaminë e fshatit, 40 armë (dy mitraloza, 36 pushkë automatike dhe dy snajperë), municion, uniforma, rezerva ushqimore, makinë shkrimi dhe listën e 126 terroristëve që ishin në Shtabin e Reçakut...”² Krahas kësaj, pala serbe pretendon se testet me «dorashka parafine» dhe marrja e shenjave të gishtërinjve dëshmuar për identitetin e tyre dhe për përfshirjen në luftë!

Më lart u përmend fakti se deri më 22 janar, ende pa ardhur ekipi i patologëve finlandezë, ekipi i Mjekësisë Ligjore serbe kishte përfunduar autopsinë e 16 personave, kishin kryer testet me «dorashka parafine», ishin marrë shenjat e gishtërinjve etj.³ Atëherë, cilat janë rezultatet e këtyre hulumtimeve që u bënë me aq ngut nga ana e ekipit serb?

Në të gjitha shkrimet dhe në emisionet dokumentare serbe lidhur me këtë ngjarje ekziston një konsensus se “te 37 nga 40 trupat, që u ishte bërë autopsia, janë gjetur gjurmët e nitratit. Këto gjurmë të barutit të padjegur ishin gjetur në gishtin tregues, në gishtin e madh, në shuplakë ... Pra, në ato pjesë ku pritet të gjendet te njerëzit që kanë përdorur armë zjarri!”⁴

Përkundër asaj se nitratet mund të jenë mbetje të barutit të padjegur, kjo nuk do të thotë se të gjitha gjurmët e nitrateve janë nga shpërthimi i barutit. Madje edhe vetë dr. Dobričanin-i sjell shembuj të shumtë, si mbetjet e plehut artificial, të duhanit, të urinës (...), që mund të ndikojnë që testet të rezultojnë pozitivisht në nitrate. Megjithatë, në dëshminë e tij, shefi i ekipit serb privilegjoi hipotezën se mbetjet e nitratit në duart e të vranëve shqiptarë ishin nga baruti i armëve të zjarrit!

¹ Por, sipas pohimeve të tij të cituara më lart, ai ishte në cilësi të anëtarit të ekipit hetues!

² Një pjesë e madhe e asaj që u shpërnda si e ‘vërteta serbe’ për Reçakun u botua në veprën e Milovan Drecun, *Drugi kosovski boj*, f. 20-26

³ Po aty

⁴ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.560

Nga ana tjetër, testi me mikroskop elektronik EDX, i bërë nga ekipi finlandez i Mjekësisë Ligjore, rezultoi negativ në të gjitha rastet. Në këtë mënyrë u hodhën poshtë pretendimet e ekipit serb të Mjekësisë Ligjore për mbetjet nga baruti i padjegur¹. Përfundimi i tyre ishte se 40 personat e vrarë në Reçak nuk kishin përdorur armë zjarri!

Atëherë, ku qëndron e vërteta?

Për të sqaruar “rezultatet” diametralisht të kundërta të dy ekipeve të Mjekësisë Ligjore (asaj serbe dhe asaj finlandeze), gjatë dëshmisë së tij në procesin gjyqësor kundër Milošević-it u kërkua shpjegim nga Slaviša Dobričanin-i. Konkretisht, trupi gjykues kërkonte të dijë se a u ishin dhënë patologëve finlandezë rezultatet e testit të «dorashkave të parafinës» te i cili kishte arritur ekipi serb? A i kishin pasur finlandezët këto rezultate para se të dilnin me rezultatet e tyre?

Pas disa hezitimeve të shprehura në formën “nuk jam i sigurt”, “nuk e di” e kështu me radhë, dr. Dobričanin-i u përgjigj: “Ekipi finlandez nuk i ka marrë rezultatet e këtij testi!”²

Mosdhënia e rezultateve të punës së ekspertëve serbë, ekipit të Mjekësisë Ligjore të ngarkuar nga Bashkimi Evropian, mund të ngjallë dyshime të shumëkush. Por, ajo që e bën edhe më të dyshimtë pohimin serb, lidhur me këtë lloj testi, lidhet me faktin se ato nuk i ishin bashkangjitur as raportit të autopsisë së ekipit serbo-bjellorus! Pse nuk i ishin bashkangjitur raportit që e kishin përgatitur vetë ekspertët serbë?

Ku ishin në të vërtetë rezultatet e këtyre testeve? A ishin publikuar diku?

Për të sqaruar këtë aspekt të kundërthënieve që ngërthente pohimi serb për “gjetjen e gjurmëve të nitratis të barutit të padjegur te 37 nga 40 kufomat” dhe dyshimet që ngjallte fakti se askush nuk i kishte parë këto “rezultate”, gjatë audiencës së datës

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Helena Ranta, seanca e cituar e 12 marsit 2003, f.741-742

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 12 prillit 2005, f.620

13 prill 2005, Slaviša Dobričanin-i u mundua të mbështetej në “mbingarkimin e njerëzve që punonin në këtë punë, sepse, sipas tij, kishin pasur një situatë jashtëzakonisht të rëndë ata muaj.”¹ Krahas “mbingarkesës” së personelit, Dobričanin-i solli edhe një fakt tjetër! Sipas tij këto rezultate “kishin qenë të përgatitura me shënime të detajuara, me video dhe me fotografi që t’u jepeshin të gjithëve, por u asgjësuan tërësisht me shkatërrimin e ndërtesës së SPB-së². Nuk ka asnjë arsye tjetër!”³ - përpiquej të tregohej bindës shefi i ekipit serb të ekspertëve mjekoligjorë!

Për të qenë edhe “më bindës”, ky patolog solli të dhëna më “precize” për “asgjësimin e fakteve”! Sipas tij “ekipi finlandez kishte bërë më shumë se 3000 fotografi dhe 10 orë video-filma, ndërsa teknikët e ekipit serb të kriminalistikës kishin bërë 18000 fotografi dhe disa qindra video-filma. Por, fatkeqësisht, një pjesë e fotografive, e video-filmave dhe raporti i patologëve finlandezë, që i takonin zonjës Marinković⁴, u zhdukën përgjithmonë nga bombardimi që iu bë ndërtesës së SPB-së krahinore në vitin 1999 nga NATO-ja⁵. Sikur dikush ngutej që t’i zhdukte sa më parë!”⁶

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.572 dhe

Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 13 prillit 2005, f.677

² Fjala është për Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme të Kosovës

³ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.572 dhe

Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 13 prillit 2005, f.677

⁴ Gjykatësja hetuese e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

⁵ Ndërtesa e Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme të Prishtinës, e cila u dëmtua pjesërisht gjatë bombardimeve të NATO-s është në distancë prej 1070 metrash nga ndërtesa e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës. Të bombardohet ndërtesa e SPB-së në Prishtinë dhe të digjen dokumentet e ekspertizës së «masakrës së Reçakut» në ndërtesën e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dëshmon për “efikasitet të paparë” në mënyrën e bombardimeve! Jo Emir Kusturica, por do ta kishin të vështirë edhe realizatorët më të niohur në botë të filmave të zhanrit fantastiko-shkencor që të realizonin asgjësimin e dokumenteve në këtë formë!

⁶ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.572 dhe

Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 13 prillit 2005, f.677

Për të fshehur “fajësinë e shqiptarëve” dikush i asgjësoi faktet që autoritetet serbe “i kishin në duart e tyre”, por që nga “mbingarkimi” nuk patën mundësi t’ia jepnin as ekipit finlandez e as t’i publikonin vetë! Humbën provat si në rastin e Kleçkës! E megjithatë, profesori i Mjekësisë Ligjore, dr. Slaviša Dobričanin-i, ngul këmbë t’i besohet fjalës së tij se “te 37 nga gjithsej 40 trupa janë gjetur gjurmët e nitratit në ato pjesë ku pritët të gjenden te njerëzit që kanë përdorur armë zjarri”! Për trupin gjykues në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë fjalët nuk janë të mjaftueshme, qofshin ato edhe fjalë të “ekspertit”! Duhet të sillen prova!

Për këtë arsye nga testet me «dorashka parafine» u kalua në temë tjetër! Te armët e “konfiskuara nga policia” më 15 janar, pas luftimeve në fshatin Reçak!

U sollën detaje për t’i bindur të tjerët se kishim të bënim me njerëz të vrarë gjatë luftimeve! 40 kufoma dhe saktësisht 40 armë! Saktësi e jashtëzakonshme!

Duke e sjellë këtë të dhënë që figuronte në raportin për të vrarët e Reçakut, Milošević-i iu drejtua gjeneralit Drewienkiewicz-i dhe kërkoi prej tij të sqaronte nëse mendonte që gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i, e kishte trilluar një fakt të tillë.

“Jam i sigurt se ajo ka shkruar atë që i është thënë të shkruante”, iu përgjigj Drewienkiewicz-i, “por nuk e di se deri në cilën masë mund të ndërliidhen këto armë me personat e vrarë, për të cilët pretendoni t’i kenë poseduar ata. Dua ta shoh atë ndërliidhje! Ai armatim ka mundur të jetë në bodrumet e cilitdo stacion policor, në cilindo vend të Kosovës. Kanë pasur plot nëpër bodrumet e tyre. Dikush mund të shkojë në një bodrum policor, t’i marrë armët, t’i vendosë pranë kufomave dhe të dalë e të deklarojë: ‘Ja! I vramë se ishin terroristë dhe si dëshmi ja ku i kemi armët!’”¹

Ndërliidhja e 40 të vrarëve dhe e 40 armëve të ekspozuara nxori në shesh një problem tjetër, të cilin “ekspertët serbë” nuk e kishin paraparë!

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, seanca e 15 prillit 2002, f. 467-469
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

Meqenëse edhe dr. Slaviša Dobričanin-i, kësaj radhe si profesor i Mjekësisë Ligjore, nuk e mohon dobësinë e testit me «dorashka parafine» dhe testi me mikroskop elektronik kishte dëshmuar të kundërtën e asaj që pretendonin anëtarët e ekipit të Mjekësisë Ligjore serbe, atëherë pyetja që shtrohet në gjyq ka të bëjë me atë se “a nuk do të kishte qenë e mundur që me një shkallë të lartë preciziteti të dëshmohej nëse ndonjëri nga viktimat e Reçakut ka përdorur ndonjëren nga ato armë të ekspozuara para gazetarëve? Shkurt, kjo gjë do të ishte shumë e lehtë, pasi armët ishin aty dhe shenjat e gishtave të viktimave ishin marrë!”¹

Duke u mbështetur në atë se pas testit me «dorashka parafine» kufomave u janë marrë shenjat e gishtave për identifikim, u kërkua sqarim nga Slaviša Dobričanin-i “nëse kishte bërë dikush hulumtime në pushkët automatike që ishin vendosur me një rend të caktuar për të parë nëse ka pasur në to shenja të gishtave të cilësdo viktimë të Reçakut?”²

“Zotëri, kjo është jashtë fushës sime profesionale!”, u përgjigj, i zënë ngushtë, eksperti serb dhe profesori i Mjekësisë Ligjore, Slaviša Dobričanin-i. “Mendoj se do të ishte dashur të bëhej një analizë e tillë. Me të vërtetë nuk e di nëse është bërë dhe më besoni nuk mund të them asgjë më shumë për këtë gjë. Atë armatim vetëm e kam parë, e pastaj çka është bërë dhe si është vepruar me të, a janë marrë shenjat, besomëni nuk e di.”³

Në këtë rast, Slaviša Dobričanin-i “harron” se gjatë procesit gjyqësor të Milošević-it ai fliste herë si ekspert i Mjekësisë Ligjore e herë si anëtar i ekipit hetimor të udhëhequr nga gjykatësja Danica Marinković-i. Edhe pse ai vetëm e ka parë atë armatim dhe nuk di se çka është vepruar me të, Dobričanin-i kërkon t’i besojmë fjalës së tij se gjoja ky armatim ishte “armatim i terroristëve shqiptarë!”

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 12 prillit 2005, f. 629
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Po aty, f. 628

³ Po aty, f.628

Nuk mjaftojnë fjalët! Në gjykatë u ngul këmbë të sqarohej çështja e armëve të ekspozuara më 17 janar. Duhej të nxirrej në shesh se ku u gjetën armët. A u gjetën në të njëjtin vend ku ishin edhe 40 viktimat? Gjyqtarët e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë donin të sqaronin nëse ekzistonte “ndonjë raport, shënim apo dokumentacion në të cilin pohohej se armët u gjetën në të njëjtin vendin ku u gjetën trupat e vrarë në Reçak?”¹

Kjo çështje ia humbi durimin ekspertit serb. Ai u përgjigj me një dozë arrogance: “Nuk kam raport të tillë dhe as që më ka interesuar një gjë e tillë.”²

Për të gjetur një arsyetim, “jashtë fushës së tij profesionale”, Slaviša Dobričanin-i deklaroi se është “njeri që pranon vetëm faktet” dhe se faktet e tij “janë absolutisht në anën e atyre që mendojnë se është bërë gabim i madh që nuk janë bërë hetimin në vendin e ngjarjes.“ Por, faji për këtë gjë nuk është i autoriteteve serbe! Ai jep arsyetimin në formën e pyetjes: “Pse nuk na u lejua t’u afrohem trupave gjatë katër ditëve, përderisa trupat e të vdekurve në Reçak kishin qëndruar katër ditë të shtrirë në hapësirë të hapur!”³

Ai mendon se të gjithë kanë harruar që kufomat e «Masakrës së Reçakut» u gjetën në mëngjesin e 16 janarit, u vendosën në xhaminë e fshatit të njëjtën ditë dhe më 17 janar policia serbe, me të cilët ishte edhe Slaviša Dobričanin-i, i transferoi në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë. Apo ndoshta “nuk i kujtohet” siç deklaroi shpesh, se “ka kaluar shumë kohë që atëherë”!

Sido që të jetë, Slaviša Dobričanin-i është “njeri që pranon vetëm faktet” dhe kërkon nga ne që t’i marrim fjalët e tij për fakte!

Edhe pse rezultatet e testeve serbe me «dorashka parafine» nuk iu dhanë ekipit finlandez e as nuk u integruan në raportin e autopsisë, ne duhet t’i besojmë fjalës së Slaviša Dobričanin-it se 37 nga 40 kufomat kishin pasur mbetje baruti të padjegur në duar!

¹ Po aty, f.640

² Po aty, f.640

³ Po aty, f. 654 dhe Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 12 prillit 2005, f. 547-548

Edhe pse nuk u dha asnjë raport lidhur me hulumtimet për të verifikuar nëse u gjetën armët në vendin ku ishin gjetur kufomat dhe nëse kishte pasur shenja të gishtave të 40 personave ndaj të cilëve u bë autopsia nga ekspertët e ekipit serb në 40 armët e ekspozuara para gazetarëve, kërkon t'i besohet fjalës së tij “se 37 nga 40 kufomat u identifikuan si terroristë të UÇK-së, ndërsa kufomat e tre personave mbetën të paidentifikuara!”

Nga armët e ekspozuara ai doli te identiteti i personave të vrarë. Në këtë rast, jo si profesor i Mjekësisë Ligjore, por, në përputhje me “eksperiencën e tij jetësore”, dr. Slaviša Dobričanin-i “sqaroi” se “tri kufomat e paidentifikuara kishin shenja në trupat e tyre që dëshmonin se nuk kanë qenë myslimanë ose pjesëtarë të popujve që bëhen synet pas lindjes.”¹

Çështjen e kufomave të pabëra synet e nxjerrin si argument edhe anëtarët e tjerë të ekipit serb të Mjekësisë Ligjore. Por, ndryshe nga Slaviša Dobričanin-i, për anëtarin tjetër të ekipit serb të Mjekësisë Ligjore, profesorin e Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Beogradit, Dušan Dunjić-in², dhe për profesorin e Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Nishit, Vujadin Otašević-in³ nga 40 kufomat, ndaj të cilave u bë autopsia, të pabërë synet ishin “katër persona, me mbiemra amerikanë ose anglezë dhe nuk përjashtohet mundësia që ata të kenë qenë instruktorë të Walker-it ose mercenarë të shërbimeve dhe të organizatave të tjera.”⁴

Profesorë të Mjekësisë Ligjore, të cilët duhet të përcaktojnë shkaqet dhe mënyrën e vrasjeve, të analizojnë plagët dhe lëndimet... dhe në vend të kësaj ata përqendrojnë vëmendjen aty ku nuk ka plagë! Pse nuk paskan qenë të bërë synet! Ekspertë se jo shaka! E çuditshme!

Në këtë rast ata nuk treguan nëse e bënë këtë “zbulim” në përputhje me “perimetrin e fushës së tyre profesionale”, si “anëtarë të ekipit hetues” apo si “njerëz me përvojë”! Pa marrë parasysh se çka thanë, “ata janë njerëz që mbështeten në fakte” dhe fjalët e tyre duhet

¹ Dokumentari i TVB « Kosovo : Račak Laži i istine »

² Jürgen Elsasser, vepra e cituar, f. 64

³ Večerne Novosti, artikulli i cituar «Laž za... »

⁴ Po aty

të merren si fakte! Ata pohuan se “në shtëpinë ku ishte Shtabi i UÇK-së, policia gjeti një kompjuter me të dhënat e brigadës terroriste dhe listën prej 126 terroristëve që ishin në Reçak. Në mesin e tyre ishin edhe katër të huaj, me mbiemra amerikanë ose anglezë. Ata ishin instruktorë ose specialistë të huaj!” Dhe pikë!

Por, jo të gjithë i marrin pohimet e tyre për fakte! Dhe jo të gjithë e venë pikën aty ku dëshirojnë ata!

Për të sqaruar këtë çështje, nga gjykatësja hetuese Danica Marinković-i, e ftuar nga Milošević-i për të dëshmuar se “në Reçak nuk kishte parë civilë të masakruar por terroristë të vrarë”, në dëshminë e saj¹ të 24 marsit 2005 u kërkuan informata plotësuese për “listën e 126 terroristëve të gjetur në Shtabin e UÇK-së në Reçak”. Listë të cilën Danica Marinković-i e shpalosi para gazetareve më 17 janar 1999, në fshatin Reçak! U kërkua të jepej përgjigje nëse ishin në atë listë edhe emrat e 40 personave ndaj të cilëve ishte bërë autopsia.”²

Danica Marinković-i, e shqetësuar nga një pyetje që nuk e priste, kërkoi që t’i besonin, sepse tani nuk i kujtoheshin gjërat. “Në incizimin që e pamë dëgjohet se unë lexoj emra”, theksoi ajo. “Megjithatë, tani nuk më kujtohet, ka ndodhur kohë më parë, por fletorja e shënimeve me listën e emrave u mor dhe ky material, si provë, ndodhet në lëndën komplete për Reçakun. Dhe kjo mund të krahasohet.”³

Por, që të krahasohen emrat e të vrarëve me listën e publikuar në konferencën e improvizuar me gazetarë në “Shtabin e UÇK-së në Reçak”, duhet pasur atë “listë”. Për këtë arsye gjykatësi kërkoi të dinte se ku mund të gjendej lista me 126 emra!

“E dini çka?”- pyeti në formë përgjigjeje Danica Marinković-i. “Pas përfundimit të hetimeve unë ia kam dhënë dosjen komplete prokurorit publik të autorizuar për këtë rast. Dhe lënda duhet të jetë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, me të cilën nuk kemi kontakt, e ndoshta ju mund të vini deri te ajo lëndë. Pasi kam për-

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitarja Danica Marinković, mars 2005 http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitarja Danica Marinković, 24 mars 2005, f. 275 http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

³ Po aty, f.275

funduar hetimet dhe kam marrë rezultatet dhe mendimet lidhur me autopsinë, më 1 mars 1999 ia kam dorëzuar dokumentacionin e plotë prokurorit publik të Qarkut në Prishtinë. Kjo është lënda Kri 14/99.”¹

Pra, dokumentacioni i plotë i lëndës së Reçakut (Kri 14/99) ndodhet në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë! Nuk paska qenë djegur, siç pretendonte Slaviša Dobričanin-i në seancën e 13 prillit 2005. Pra, dokumentet na qenkëshin në Prishtinë dhe nëse nuk gjenden, duhet t'i besojmë gjykatëses hetuese Danica Marinković-it, atëherë ndoshta “i kanë asgjësuar shqiptarët, UNMIK-u ose dikush tjetër ... për të fshehur fajësinë e shqiptarëve.”

Është interesant se sa herë që duhet të sjellin faktet konkrete në mbështetje të “marrëzisë së sajuar në Beograd” për gjoja vrasjen e “terroristëve të UÇK-së”, si gjykatësja hetuese ashtu edhe profesorët serbë të Mjekësisë Ligjore fshihen herë prapa kujtesës së tyre, se gjoja “nuk u kujtohet” e herë prapa kohës, se “ka ndodhur moti”. Vetëm për një gjë nuk kanë harruar! Herë tre e herë katër persona nga të vrarët nuk paskan qenë të bërë synet! Ekspertë me kujtesë profesionale të çuditshme!

Megjithatë, në seancën e 12 prillit 2005 Dobričanin-it iu desh të ballafaqohej me kundërthëniet e dy listave: listës që kishte përgatitur gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i, dhe atë që kishte përgatitur Zyra e Prokurorisë. Dobričanin-i u shtrëngua të pranonte se kishte kundërthënie lidhur me emrat dhe me mbiemrat e tre vëllezërve (Jashar Salihu, Rifat Salihu, dhe Shukri Salihu) të vrarë më 15 janar në Reçak. Por, u arsyetua: “Në identifikimin përfundimtar nuk kanë marrë pjesë anëtarët e ekipit të Mjekësisë Ligjore. Atë e ka bërë teknika kriminalistike... Me gjasë ashtu është. Po ua tërheq vëmendjen se unë me këta emra nuk kam asnjë lidhje! Gjatë kohës që kemi bërë autopsitë në institut, ne nuk i kemi marrë emrat e të vrarëve, as që na ka interesuar, sepse ata njerëz janë dërguar në morg ku është bërë procesi i identifikimit dhe dokumentet e atij procesi janë dërguar në teknikën

¹ Po aty, f.275

kriminalistike të SPB-së krahinore. Dhe atë që mund t'ju them është se këta emra i gjeta këtu dhe askund tjetër. Nuk e di pse më pyesni për këtë, derisa unë nuk di asgjë për të! Të gjitha këto dokumente i shoh për herë të parë këtu, sepse ne i kemi bërë autopsitë, ndërsa procesi i identifikimit ka qenë tjetërkund dhe në ndërtesë tjetër. Është dashur që të m'i sjellin më vonë emrat e verifikuar që t'i regjistrojmë në protokollet tona. Këto nuk i kam marrë asnjëherë. E vërteta ime që e kam deklaruar është se ne kemi konstatuar tre veta që nuk ishin bërë synet! Mendoj se konfuzioni lidhur me këta tre individë është krijuar për shkak të emrave dhe të mbiemrave të tyre...”¹

Në dëshminë e tij, Slaviša Dobričanin-i nuk tregoi se për cilën arsye emrat ose mbiemrat e këtyre tre vëllezërve mund të kishin krijuar konfuzion. Sidomos nuk shihet se çfarë asociacioni mund të krijojnë emrat e Jashar Salihut, Rifat Salihut dhe Shukri Salihut me emra instruktorësh amerikanë, anglezë ose mercenarë jomyslimanë!!!!

Po sjell në tërësi listën e civilëve dhe të ushtarëve të UÇK-së, të vrarëve në Reçak, më 15 janar 1999, që lexuesi të shohë se asnjëri nga emrat e as nga mbiemrat e tyre nuk mund të krijojë konfuzion me “emra ose me mbiemra amerikanë, anglezë ose mercenarë jomyslimanë!”

¹ Transkriptimi gjatë procesit gjyqësor të Milošević-it, S. Dobričanin, 12 prill 2005, f.605-609

Lista e civilëve të vrarë më 15 janar 1999, në fshatin Reçak

Nr	Emri	Emri i babës	Mbiemri	Vend-lindja	Datë-lindja	Mo sha
1	Halim	Rizah	Beqiri,	Reçak	24.07.1985	14
2	Hasan	Rizah	Beqiri	Reçak	13.11.1983	16
3	Shukri	Halim	Salihu	Reçak	06.02.1982	17
4	Xheladin	Ahmet	Jakupi	Reçak	05.04.1982	17
5	Bujar	Hanifi	Hajrizi	Reçak	17.02.1979	20
6	Murtez	Ramiz	Imeri	Reçak	20.05.1979	20
7	Muhamet	Hafir	Mustafa	Reçak	15.01.1978	21
8	Nexhat	Faik	Ramadani	Reçak	10.02.1978	21
9	Raif	Milaim	Salihu	Reçak	12.03.1978	21
10	Zenel	Shefshet	Beqiri	Reçak	22.09.1978	21
11	Hanumshahe	Bairam	Mehmeti	Reçak	10.10.1977	22
12	Bajrush	Nesret	Shabani	Reçak	01.11.1976	23
13	Sali	Faik	Ramadani	Reçak	26.04.1974	25
14	Jashar	Milaim	Salihu	Reçak	08.09.1974	25
15	Mufail	Mehdi	Hajrizi	Reçak	01.02.1969	30
16	Mustafë	Beqë	Asllani	Rancë	01.01.1968	31
17	Skender	Sylejman	Halili	Reçak	17.12.1968	31
18	Hakip	Imer	Imeri	Reçak	01.01.1966	33
19	Bajram	Haki	Xheladini	Reçak	24.02.1964	35
20	Ragip	Jahir	Bajrami	Reçak	18.11.1964	35
21	Sheremet	Shyqeri	Syla	Reçak	05.11.1962	37
22	Fatmir	Faik	Ramadani	Reçak	27.05.1961	38
23	Ajet	Minush	Brahimi	Reçak	03.02.1959	40
24	Lutfi	Hasan	Bilalli	Reçak	15.07.1957	42
25	Muhamet	Faik	Ismajli	Reçak	14.04.1955	44
26	Mehmet	Qerim	Jakupi	Reçak	17.08.1955	44
27	Njazi	Sherif	Zymeri	Reçak	01.01.1954	45
28	Sadik	Xheme	Osmani	Reçak	21.05.1954	45
29	Haqif	Shefki	Hysenaj	Petrovë	10.07.1949	50
30	Rizah	Maliq	Beqiri	Reçak	10.05.1946	53
31	Arif	Murat	Metushi	Reçak	25.09.1946	53
32	Eshref	Halim	Jakupi	Reçak	11.03.1945	54
33	Bajram	Sokol	Mehmeti	Reçak	26.08.1945	54
34	Ahmet	Izet	Jakupi	Reçak	28.02.1942	57
35	Sabri	Murat	Syla	Reçak	16.06.1939	60
36	Shyqeri	Isamajl	Syla	Reçak	01.01.1938	61
37	Hajriz	Brahim	Brahimi	Reçak	15.04.1937	62
38	Haki	Murat	Metushi	Reçak	10.10.1937	62
39	Banush	Azem	Kamberi	Reçak	09.04.1936	63
40	Ahmet	Zenun	Mustafa	Reçak	01.01.1933	66
41	Nazmi	Nuhë	Imeri	Reçak	13.06.1917	82
42	Sahide	Hysen	Metushi (Zeqiri)	Shti-mje	06.07.1938	61

Lista e ushtarëve të UÇK-së të vrarë më 15.01.1999

1	Ismail	Adem	Luma	Kraishtë - Lipjan	05.03.1975
2	Skender	Nezir	Qarri	Greicec - Shtime	24.05.1975
3	Nazim	Tahir	Kokollari	Prizren	22.03.1974
4	Enver	Hyzer	Rashiti	Reçak - Shtime	10.07.1974
5	Ali	Ragip	Beqa	Pustenik-Hani i Elezit	30.01.1973
6	Kadri	Shyqeri	Syla	Reçak - Shtime	17.06.1967
7	Shaqir	Zejnush	Berisha	Reçak - Shtime	08.11.1969
8	Sadik	Murat	Mujota	Mollapolc - Shtime	20.02.1943
9	Mehmet	Zenun	Mustafa	Reçak - Shtime	17.03.1938

Dëshmitarët e ftuar nga mbrojtja e Slobodan Milošević-it nuk mundën ta “shpëtonin” as “marrëzinë e zhveshje-veshjeve të kufomave” e as “gënjeshtrën për zhvendosjen e të vrarëve për të krijuar përshtypjen e masakrës ndaj civilëve.” Megjithatë, për të mbajtur “gjallë” këtë marrëzi, Slobodan Milošević-i u përpoq të manipulonte me disa fotografi të një personi të vrarë.

Gjatë shumë seancave të procesit gjyqësor kundër tij, ai do të mbështetet në fotografitë e Eshref Jakupit, të vrarë më 15 janar. Unë do të kufizohem vetëm në disa seanca gjyqësore, sepse edhe sikur t’i citoja të gjitha seancat ku manipulohet me këto fotografi, kjo nuk do të ndryshonte asgjë në thelbin e problemit: Përmes këtyre fotografive Milošević-i përpiqej “të argumentojë” se kufomat ishin zhvendosur!

Kështu, në seancën e 15 prillit kur ishte duke dëshmuar gjenerali anglez, Drewienkiewicz-i¹, Milošević-i iu drejtua me pyetjen nëse i kishte “parë fotografitë e Walker-it pranë kufomave të shqiptarëve me ata plisa tipikë shqiptarë në kokë?”²

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, 15 prill 2002, f.463

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Po aty, f.463



William Walker-i inspekton vendin ku u ekzekutuan shqiptarët

Ai kërkoi të sqarohet se “si është e mundur që dikush të goditet me plumb në kokë dhe t’i mbetet plisi pa iu rrëzuar! Aq më tepër kur kjo kapelë i ngjan majës së vezës. Kur njerëzit goditen në atë mënyrë, ata dalin edhe nga këpucët e veta, ndërsa ky e ka ende plisin në kokë! Patologët e Mjekësisë Ligjore thonë se nga një goditje e tillë edhe sytë dalin nga vendi e jo më kapela nga koka! A e keni parasysh se ai grumbull kufomash atje ishte një montim i përgatitur për televizione?”¹

“Gjithsesi”- u përgjigj Drewienkiewicz-i. “Është njëra nga idetë që më ka shkuar ndër mend kur ngjitesha kodrinës. Kur i kam parë kufomat ashtu në grumbull kam ardhur te përfundimi se ata nuk janë zhvendosur, por që janë vrarë në vendin ku ishin të shtrirë. Këtë mendim e kam edhe sot!”²

¹ Po aty, f.463

² Po aty, f.463

Pa marrë parasysh përgjigjen e gjeneralit Drewienkiewicz-i, gjatë seancës së 30 majit, Slobodan Milošević-i iu drejtua me të njëjtën pyetje edhe gjeneralit kanadez, Joseph Omer Michel Maisonneuve-it.

“Ju e shihni se plisi shqiptar ka formën e majës së vezës. A mund ta paramendoni që dikush që është goditur në kokë, që rrëzohet dhe kapela e tillë t’i mbetet në kokë?”¹

“Supozoj se nëse goditet në kokë është e pabesueshme t’i mbetet kapuçi pa u rrëzuar.”²- përgjigjet Maisonneuve-i.

I kënaqur me përgjigjet e tipit të silogjizmave aristoteliane, Milošević-i ua shtroi të njëjtën pyetje edhe shumë dëshmitarëve të tjerë. Me një veprim të tillë ai synonte të manipulonte opinionin publik, sidomos opinionin publik në Serbi dhe në Kosovë, ku gjykimi transmetohej drejtpërsëdrejti nëpërmjet disa kanaleve televizive.

Për këtë problematikë po sjell vetëm një dëshmi. Atë të Slaviša Dobričanin-it. Në dëshminë e shefit të ekipit mjekoligjor serb të datës 8 prillit 2005 Milošević-i i kërkoi “që në cilësinë e ekspertit me eksperiencë të madhe në hulumtimet e forenzikës, të tregonte se a ishte e mundur që njeriut të rrëzuar nga goditja e plumbit në kokë t’i mbetej plisi?”

“Asnjëherë!”-u përgjigj Slaviša Dobričanin-it. “As edhe në një rast të vetëm gjatë karrierës sime nuk më ka ndodhur të shoh që njeriu të rrëzohet i goditur nga plumbi, ose nga vetura, nga guri, nga çekiçi e kështu me radhë, e raste të tilla ka pasur shumë në Kosovë, dhe t’i ketë mbetur kapela e këtij lloji në kokë. Kapela patjetër që i është rrëzuar nga koka, afër ose larg trupit, kjo varet nga energjia kinetike që ka vepruar në të. Këtij njeriu të goditur me plumb në kokë, e që shihet qartë nga fotografia, nuk do t’i kishte mundur t’i mbetej plisi në kokë! Dhe pa marrë parasysh llojin e lëndimit, kapela nuk mund të qëndrojë në kokë. Kjo është një kapelë specifike në formë të rrumbullakët, që nuk futet thellë deri

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Joseph Omer Michel Maisonneuve, 30 maj 2002, f. 551

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Po aty, f.551

te veshët por qëndron në majë të kokës dhe kjo është edhe një arsye më tepër...”¹

Debate të panumërta u bënë rreth asaj nëse mund të qëndrojë në kokën e goditur nga plumbi, plisi në “formë të vezës”! Për ata që përpiqen të gjejnë gabime, të meta ose kundërthënie atje ku nuk ka, shqiptarët e kanë një shprehje popullore: «Lyp qime në vezë!»



Eshref Jakupi pa plis!



Eshref Jakupi me plis!

¹ Ndërpritet mendimi i tij. Shih: Transkriptimi gjatë procesit gjyqësor të Milošević-it, S. Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.534

Për të forcuar përshtypjen se dikush i ka zhvendosur kufomat, Slobodan Milošević-i solli dy fotografi të të njëjtit person. Në njërën fotografi, viktimat shihet pa plis ndërsa në fotografinë tjetër, po i njëjti person, në të njëjtin vend, shihet me plisin e bardhë në kokë.

Për secilin që i sheh këto dy fotografi dhe nuk e di se cila është bërë më parë, del qartë se këtij personi dikush ose ia ka hequr plisin nga koka ose ia ka vënë në kokë. Sipas logjikës së Milošević-i dhe ithtarëve të tij, nëse dikush ia ka hequr ose ia ka vendosur plisin mbi kokë, atëherë kjo “dëshmon” se gjoja personi nuk është vrarë në atë vend por është vrarë në një vend tjetër. Sipas qëndrimit zyrtar të Beogradit, që e përsëriti Milošević-i disa herë, ky person është vrarë “duke luftuar” dhe për të krijuar “spektaklin televiziv”, ai është “hedhur në grumbullin e kufomave të tjera në përrua”.

Atëherë, kush e bëri një gjë të tillë? “Ushtarët e UÇK-së, me udhëzime të William Walker-it për të krijuar përshtypjen e masakrës?” Apo dikush tjetër? Këtë aspekt do ta sqarojmë më poshtë, sepse është e ndërlidhur me shtyllën kryesore ku është mbështetur manipulimi serb për gjoja inskenimin e «Masakrën e Reçakut». Për arsye që të mos e shkëpus nga ai kontekst «çështjen e plisit», kërkoj nga lexuesi të ketë durim dhe mirëkuptim.

Nga ajo që u trajtua më lart lexuesi mundi të shohë se dëshmitarët¹ e ftuar nga Slobodan Milošević-i në Gjykatën e Hagës nuk sollën provat që ai i priste. Përkundrazi. Ballafaqimi në gjyq i këtyre dëshmitarëve nxori në shesh se:

- 40 shqiptarët, ndaj të cilëve u bë autopsia, ishin vrarë në teshat që i kishin të veshura ditën e vrasjes dhe se ideja për “zhveshjen e viktimave nga uniformat ushtarake të UÇK-së dhe veshja me tesha civile” ishte një marrëzi e shpikur nga qarqet politike të regjimit të Milošević-it në Beograd;

¹ Shefi i ekipit serb të Mjeksësisë ligjore (dr. Slaviša Dobričanin) dhe gjykatësja hetuese (Danica Marinković)

- Hulumentimet në përrua, ku çdo centimetër e tokës së tij është përshkuar me lopatë, me lugë dhe me detektor metalesh, dëshmuar se viktimat ishin vrrarë në atë vend dhe se nuk kishte pasur zhvendosje të kufomave;
- Kufomat nuk ishin gjymtuar “post mortem” për të krijuar përshtypjen e masakrës, plagët ishin shkaktuar për së gjalli. Pos pretendimit neveritës se në gjashtë raste qentë ua kishin masakruar trupat!;
- Rezultatet e testit me «dorashka parafine» të bëra nga “ekspertët serbë”, që duhej të dëshmonin për pohimet publike se 37 nga 40 viktimat kishin përdorur armë zjarri, dhe rrjedhimisht ishin vrrarë duke luftuar, as nuk u publikuan nga autoritetet serbe, as nuk iu dhanë ekipit finlandez të Mjekësisë Ligjore e as nuk u përfshinë në raportin përfundimtar të ekipit serb të Mjekësisë Ligjore, sepse “kishin qenë të mbingarkuar me punë dhe nuk kishin pasur kohë!”;
- Përkundër asaj se “ekspertët serbë” i kishin marrë shenjat e gishtërinjve të 40 kufomave që pretendohesh se ishin vrrarë gjatë luftimeve dhe i posedonin 40 armët, që gjoja kishin përdorur viktimat, nuk ishte bërë asnjë analizë për të përcaktuar se cilën armë kishte përdorur secila viktimë. Dikujt, si dr. Slaviša Dobričanin-it mund t’i duket “gabim pse nuk janë bërë analiza të tilla!”¹
- Por, dikujt si gjeneralit anglez Drewienkiewicz-i, mund t’i shkojë mendja se armët janë nxjerrë nga bodrumet e policisë serbe për të thënë: “Ja! I vramë se ishin terroristë dhe si dëshmi ja ku i kemi armët.”²

Vetëm ata që ishin të implikuar në inskenimin e këtyre 40 armëve, në funksion të manipulimit mediatik, e dinin saktësisht se ku ishin marrë ato armë dhe prandaj nuk e panë të arsyeshme t’i

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 12 prillit 2005, f.628

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, seanca e cituar e 15 prillit 2002, f. 467-469

bënin analizat. Sikur t'u shkonte mendja se një ditë do të shtrëngoheshin të jepnin sqarime për një gjë të tillë, ata "si ekspertë" të dëshmuar në të kaluarën, do ta "zbulonin" se cila armë ishte përdorur nga secila viktimë. Në rastin e tillë, nuk përjashtohet hipoteza që mitralozi Browning M2 t'i atribuohet 14 vjeçarit, Halim Beqirit. Fakti se mitralozi i tipit Browning M2, me aksesoret e nevojshëm për përdorim, peshon 72.6 kg nuk do të thotë asgjë! Sepse, siç deklaroi dr. Slaviša Dobričanin-i, "për shqiptarët mosha nuk do të thotë asgjë."¹ Pësia edhe më pak!

Pohimi se "në shtëpinë ku ishte Shtabi i UÇK-së u gjet lista prej 126 terroristëve që ishin në Reçak" dhe fakti se "nuk ishte bërë asnjë punë për të krahasuar emrat e 40 kufomave, të cilave iu bë autopsia dhe të gjitha procedurat e identifikimit për të parë nëse përputheshin me emrat që figuronin në atë listë", nxorri në shesh montimin e listës, që Danica Marinković-i e lexoi para gazetarëve më 17 janar 1999.

Pohimi se "në mesin e 126 emrave të terroristëve nga lista e zënë ishin edhe katër persona me mbiemra amerikanë ose anglezë, instruktorë ose specialistë të huaj!" dhe mbështetja e një pohimi të tillë në "provat" të ekspertëve të Mjekësisë Ligjore serbe se 3-4 veta ishin të pabërë synet, ishte neveritëse.

Me gjithë demaskimin e plotë të propagandës për praninë e "instrukturëve anglezë ose amerikanë" në mesin e ushtarëve të UÇK-së në Reçak, "ekspertët" serbë dëshirojnë të mbajnë gjallë marrëzinë e shpikur në qarqet politike të regjimit të Milošević-it. Dobričanin-i, katër vjet pas ballafaqimit në Hagë, kur u detyrua të thoshte se nuk ishte në kompetencat e tij të bënte identifikimin dhe se kundërthëniet evidente në lista nuk kishin të bënin me të, po i njëjti "ekspert", në dhjetëvjetorin e «Masakrës së Reçakut» deklaroi: "Ne asnjëherë nuk mundëm ta merrnim vesh se kush ishin personat e pabërë synet dhe është interesante që edhe në Gjykatën e Hagës askush nuk nguli këmbë e as që i interesoi dikujt

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 12 prillit 2005, f.641-642

kjo çështje!”¹ Por, për çudi edhe pas dhjetë vjetësh nga kjo tragjedi, Dobričanin-it i rri mendja te “të pabërët synet”! Këmbëngulja e vazhdueshme te çështja e personave të pabërë synet ka qëllim që “komplotin kundër Jugosllavisë” t’ua veshë “imperialistëve anglo-amerikanë”. Këtë aspekt do ta trajtoj në pjesën e dytë të librit.

Deklaratat e ekspertëve serbë se “në dy raste janë gjetur mbetje të barutit të padjegur, që dëshmon se sipas të gjitha gjasave janë vrarë nga distanca përafërsisht një metër e gjysmë deri në dy metra, ndërsa të gjithë personat e tjerë janë vrarë nga largësia, dy metra e më shumë”², nuk ishte distanca prej më shumë se 500 m largësi që priste Milošević-i.

Dhe në fund, pohimi i dr. Slaviša Dobričanin-it se dosjet, që i takonin gjykatësës hetuese, Danica Marinković-it, u zhdukën përgjithmonë nga bombardimi i NATO-s, që iu bë ndërtesës së SPB-së krahinore në vitin 1999, sepse dikujt i “ngutej që t’i zhdukte sa më parë”³ provat e “fajësisë” së shqiptarëve dhe deklarata e Danica Marinković-it, se “dokumentacionin komplet të lëndës Kri 14/99 ia ka dorëzuar prokurorit publik të Qarkut të Prishtinës, më 1 mars 1999”⁴, nxorën në shesh faktin se gënjeshtret e “ekspertëve serbë” nuk mund ta maskonin marrëzinë e shpikur në Beograd.

Për këtë arsye, i vetmi burim manipulimi mbetën shkrimet e gazetarëve.

Manipulim mediatic apo mediatizim i manipulimit?

I bindur se marrëzia e sajuar në Beograd për të fshehur gjurmët e «Masakrës së Reçakut» ishte ende në fuqi, Milošević-i disa herë gjatë procesit të tij gjyqësor përsëriti se gjoja “sipas gazetarëve të huaj, në Reçak nuk ka pasur civilë të vrarë, por, terroristë të UÇK-së; se gazetari i «Associated Press»-it kishte

¹ Dokumentari i TVB « Kosovo : Raçak Laži i istine »

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 8 prillit 2005, f.540-541

³ Po aty, f.572

⁴ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitarja Danica Marinkovic, seanca e cituar e 24 marsit 2005, f 275

deklaruar për shtyp se aksioni i forcave serbe ishte i pastër si kristali!”¹; se “gazetari i «Le Figaro»-s, nga vendi i ngjarjes, kishte shprehur habi se si William Walker-i deklaroi diçka të ngjashme”² e kështu me radhë.

Në seancën e 12 qershorit 2002 Milošević-i kërkoi drejt-përsëdrejti nga Walker-i të komentonte deklaratën e gazetarëve të «Associated Press»-it³!

Kur u kërkuan sqarime se “kush ishin gazetarët e «Associated Press»-it të cilëve u referohet, Milošević-i u përgjigj se “këtë informatë e kishte nxjerrë nga referimet që u bëjnë gazetarët francezë gazetarëve të «Associated Press»-it”⁴.

Në të gjitha veprat, artikujt dhe në emisionet televizive ku trajtohet «Rasti i Reçakut» përmenden emrat e gazetarëve francezë të «Figaro»-s dhe të «Le Monde»-it⁵, që u referohen gazetarëve të «Associated Press»-it; përmendet Jürgen Elsässer-i dhe Portali «Konkret», që bazohen në atë që kanë shkruar gazetarët francezë të mbështetur në atë që u paskan thënë gazetarët e «Associated Press»-it; përmendet «Berliner Zeitung»-u dhe Bo Adam-i, që burim ka gazetarët e lartpërmendur francezë; përmendet gazeta «Times» për të njëjtat arsye... Vetëm gazetarët e «Associated Press»-it, që më së shumti citohen si gazetarë, mbetën anonimë! Pse?

A thua fakti se gazetarët që informuan Renaud Girard-in ishin dy serbë, që i takoi në Media Center⁶, ndikuan që në asnjë rast të mos përmenden burimet e vërteta të dezinformatave?

Ndoshta përkatësia kombëtare e gazetarëve ka ngjallur frikën se mund t’ua humbte shkallën e besueshmërisë informatave, që

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, seanca e cituar e 13 majit 2002, f. 457

² Po aty, f. 459

³ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari William Walker, seanca e cituar e 12 qershorit 2002, f.619-622

⁴ Po aty, f. 619

⁵ Renaud Girard e Christophe Chetelot

⁶ Qendra mediatike e krijuar nga Milošević-i dhe e kontrolluar nga njerëzit e pushtetit të tij.

eventualisht mund të shpërndareshin duke përmendur emrat e tyre serbë?

Për “fitoren e madhe serbe në Reçak, ku nuk ishin vrarë 15 por 40 ose 50 persona, Renaud Girard-in e informuan gazetarët serbë të Media Press Center-it.

“Ata ishin njerëz të besueshëm”, thotë Renaud Girard-i në intervistën me gazetarin belg Michel Collon-in. “Ndoshta jo plotësisht të besueshëm, në kuptimin se nuk informonin për çdo gjë, sidomos nuk informonin për masakrimin e shqiptarëve nga ana e serbëve, por, ajo që thonë ata është e besueshme.”¹

Sado e pabesueshme të duket, vetë autori që shpërndau dyshimet mbi vërtetësinë e vrasjes së civilëve në fshatin Reçak, Renaud Girard-i, pohon se është mbështetur në burimet e gazetarëve të “besueshëm” serbë, që “nuk janë plotësisht të besueshëm” kur bëhet fjalë për informatat që lidhen me masakrimin e shqiptarëve nga ana serbëve! E megjithatë, informatat që i mori prej tyre i shpërndau pa asnjë dozë rezerve!

Është interesante të theksohet se jo vetëm që u heshtën emrat e gazetarëve të «Associated Press»-it, që gjoja i kishte ftuar policia serbe të përcillnin operacionin ditën e premte të 15 janarit 1999, por as u ftuan të dëshmonin në mbrojtje të Milošević-it! Nga dëshmitarët e shumtë që kishte ftuar mbrojtja e Milošević-it nuk figuronin ata që gjoja “kishin parë se në Reçak nuk ka pasur civilë të ekzekutuar dhe se aksioni policor kishte qenë i pastër si kristali!”

Në fillim të kapitullit, lexuesi pati mundësi të shihte manipulimin lidhur me gazetarët e «Libération»-it francez. Nuk përmendej as emri i gazetarit, as titulli i shkrimit dhe as data e publikimit. Me këtë mënyrë të fshehjes së burimeve të referencave, instrumentet e regjimit të Milošević-it përpiqeshin të manipulonin opinionin publik, sidomos opinionin e brendshëm serb, që nuk kishte pasur mundësi t’i lexonte shkrimet e publikuara në këtë gazetë. Pjesët që solla nga shkrimet e gazetës «Libération» i japin

¹ Michel Collon, Monopoly - l’OTAN à la conquête du monde, Editions Epo, Bruxelles, 2000, f. 20

mundësi lexuesit të bindet me të kundërtën e asaj që propagandonte regjimi serb dhe ata që ishin vënë në shërbim të këtij regjimi. E njëjta gjë ndodhi edhe me arsyet e mbajtjes në anonimet të emrave të gazetarëve që shërbyen si burim keqinformimi lidhur me «Masakrën e Reçakut» dhe të cilat ia atribuuan gazetarëve të «Associated Press»-it.

Në tri ditët që pasuan «Masakrën e Reçakut» gazetarja e «Associated Press»-it, Melissa Eddy, bëri tri shkrime lidhur me këtë ngjarje. Po sjellim për lexuesin pjesë nga tri shkrimet e kësaj gazetareshe dhe referencat që lexuesi të bindet se tërësia e shkrimeve të korrespondentes së këtij gjiganti informativ nxjerr në shesh dhunën dhe terrorin që kanë përjetuar fshatarët e këtij fshati të Kosovës.

Në shkrimin e 16 janarit 1999, të titulluar «Gjurmët e kufomave tregojnë historinë e Kosovës»¹, gazetarja e «Associated Press»-it njoftonte se “një person i moshuar², me kokë të prerë, ishte i shtrirë në oborrin e vet, pranë plemes (plevicës). Në rrugicën me kthesa drejt kodrinës - trupa të gjymtuar. Një 18-vjeçare e qëlluar në shpinë. Të shtunën në mëngjes, në këtë fshat të Kosovës me 1400 banorë, në çdo hap zbuloheshin tmerrri i ndërhyrjes së policisë serbe i një dite më parë: shtëpi të djegura, dritare të thyera, jetë të shkatërruara... Rrahimi na tregoi me shenjë 15 trupat e hedhur në një përroskë. Në mesin e tyre ishin edhe babai dhe vëllai i tij. Edhe 8 trupa të tjerë, të shtangur nga vdekja, me krahë të shtrirë dhe me fytyrat e trishtuara nga frika ishin gjymtuar dhe hedhur përgjatë asaj përroske (...)

Disa me plagë plumbash të përskuqura në formë unazash dhe të zverdhura përreth qafës. Të tjerët kishin plagë edhe më të tmerrshme në kokë: sy të përgjakur, balle të thyer. Pranë kufomave shiheshin çelësa, kuleta të zbrazëta, një pako e shtypur cigaresh, sikur të ishin shqyer nga xhepat e tyre. Një fshatar, që po

¹ Trail of Bodies Tells Kosovo Tale, By MELISSA EDDY .c The Associated Press AP-NY-01-16-99 1718EST
<http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 3)

² Gazetarja përdor fjalën “gjysh” në artikullin e saj

kontrollonte trupat e viktimave, ia vendosi plisin e bardhë tradicional që i kishte rënë nga koka një plakut të vrarë. Nga poshtë fshatit, lemerisja e grave jehonte lugut; nënat, motrat dhe gratë sapo kishin marrë lajmin për humbjen e më të dashurve të tyre.

Imer Emini, 20-vjeçar, u tregoi gazetarëve se si policia serbe i mbledhi përafërsisht 30 persona, shumica meshkuj, dhe i urdhëroi të mbështeteshin për muri. Të tmerruar nga kaosi që kishin shkaktuar zjarri i armëve dhe i granatimeve, disa nga fshatarët filluan të vraponin dhe policia hapi zjarr, tregonte Imeri.

Sipas vëzhguesve ndërkombëtarë, në fshatin Reçak policia serbe vrau 45 persona, në mesin e të cilëve 3 femra dhe një fëmijë.”¹

Të nesërmen, më 17 janar, në shkrimin e titulluar «Forcat serbe hapën zjarr në një fshat të Kosovës»², Melissa Eddy informoi se “të dielën, herët në mëngjes, trupat e 40 viktimave të mbuluara me çarçafë plastike u sollën në xhaminë e fshatit. Edhe pse ndër të vdekurit kishte 3 femra, një djalë 12 vjeç dhe burra të moshuar, të gjithë të veshur me tesha civile, presidenti serb, Milan Milutinović-i, përsëriti deklaratën e policisë lidhur me këtë rast e sipas së cilës të vvarët gjatë luftime kishin qenë rebelë!”

Autorja e shkrimit thekson se “shumica ishin qëlluar nga afër, ndërsa disa nga trupat ishin të masakruar dhe me sy të nxjerrë. Një burrë me kokë të prerë³ kishte mbetur i shtrirë në oborrin e tij. Milutinović-i e akuzoi kryesuesin e Misionit Ndërkombëtar të Monitorimit, amerikanin William Walker-in për ‘vlerësime personale, të pavërteta dhe të pabaza’. Ndërsa, Walker-i i akuzoi forcat e qeverisë për masakër, që e quajti ‘krim kundër njerëzimit’. Të shtunën në mëngjes, një ditë pasi policia ua ndaloi qëndrimin në atë vend, monitoruesit ndërkombëtarë dhe gazetarët

¹ Trail of Bodies Tells Kosovo Tale, By MELISSA EDDY .c The Associated Press <http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 3)

² Serb Forces Fire on Kosovo Village, By MELISSA EDDY .c The Associated Press, AP-NY-01-17-99 0844EST <http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 8)

³ Informatë me të cilën e kishte filluar shkrimin e 16 janarit

e gjetën këtë kasaphane në Raçak, 15 milje në jug të kryeqytetit, Prishtinës.”¹

Ndërsa në shkrimin e 18 janarit «Forcat serbe sulmojnë fshatin shqiptar»², kjo korrespondente e «Associated Press»-it sjell reagimet ndërkombëtare për këtë masakër.

“Në një mbledhje urgjente të OSBE-së, që u mbajt në Vjenë të Austrisë, ambasadori amerikan, David Johnson-i, shprehu zemërimin e vet jo vetëm për shkak të masakrimit të shqiptarëve etnikë, por deklaroi se ishte i irrituar nga ‘përpjekjet skandaloze të autoriteteve jugosllave që ta paraqitnin masakrën e kryer me gjakftohtësi dhe me gjymtimin e civilëve si operacion ushtarak kundër terrorizmit!”

Në këtë shkrim Melissa Eddy solli informatat se “në Washington, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, James Rubin-i, e dënoi masakrën e Raçakut dhe e quajti hapin e Serbisë ‘provokim’. Edhe ish-kandidati për president të SHBA-ve, Bob Dole-i, shprehu zhgënjimin e tij. Në emisionin e ‘ABC - Good Morning America’ Dole-i deklaroi se ishte koha kur SHBA-të, OKB-ja dhe NATO-ja të mos vazhdojnë vetëm duke shprehur shqetësime të mëdha, por të bëjnë diçka para se Miloshević-i të vrasë edhe më shume njerëz të pafajshëm (...) Shpresoj që do të ketë sulme ajrore nga NATO-ja, deklaroi në fund të emisionit Bob Dole-i.”³

* * *

T’i kthehem shkurtimisht përpjekjes së Milošević-it për të manipuluar me fotografitë e Eshref Jakupit, të vrarë nga forcat serbe.

¹ The Associated Press, By MELISSA EDDY .c «Serb Forces Fire on Kosovo Village»
<http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 8)

² The Associated Press. By MELISSA EDDY .c «Serb Forces Attack Albanian Village», AP-NY-01-18-99 0846EST
<http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 10)

³ Po aty

Në pjesën e sipërme, kur trajtova këtë çështje, nuk desha të sillja për lexuesin dëshmitarë shqiptarë që vërtetonin se në shenjë respekti për të vrarët dikush ia kishte vënë plisin mbi kokë. Një gjë e tillë do të mund të perceptohej si “argument kulturalist”, për një çështje ku kërkoheshin “dëshmitarë okularë neutralë”(!), sepse këtu kishim të bënim me vrasje, sado që vrasjet e kësaj natyre ishin si rezultat edhe i kulturës së mos tolerancës ndaj të tjerëve, që u ishte ngulitur në kokë nga regjimi diktatorial i Beogradit!

Gazetarja e «Associated Press»-it, që aq shumë u përmend nga regjimi i Beogradit dhe marionetat e tij, por që mbeti anonim në citimet e tyre, të nesërmen e «Masakrës së Reçakut» dëshmoi në shkrimin e vet se “një fshatar që po i kontrollonte trupat e viktimave, ia vendosi plisin e bardhë tradicional që i kishte rënë nga koka një plakut të vrarë.”¹

A thua vetëm për këtë arsye gazetares së «Associated Press»-it, Melissa Eddy-t nuk iu përmend emri asnjëherë? Lexuesi e kupton se nuk është vetëm kjo arsye. Të tri shkrimet e kësaj gazetares dëshmojnë të kundërtën e asaj që propagandonte regjimi i Beogradit dhe instrumentet e tij. Dëshmojnë “sa i kristaltë”² ishte aksioni kundër civilëve shqiptarë në fshatin Reçak.

Shpresoj se për lexuesin është e qartë pse fshihej emri i gazetares së «Associated Press»-it dhe arsyet pse në mesin e dëshmitarëve që kishte ftuar mbrojtja e Milošević-it, nuk figuronte Melissa Eddy.

Mbrojtjes së Milošević-it i duheshin gazetarë që do të “dëshmonin” se në Reçak “nuk kishte pasur masakër”, se “ekzekutimi i civilëve kishte qenë gënjeshtër” e kështu me radhë. Pikërisht për këto arsye, gazetares së «Associated Press»-it, Melissa Eddy-t, nuk iu përmend as emri, ndërsa, për të dëshmuar u ftua gazetari i «Berliner Zeitung», Bo Adam-i, që kishte vizituar Reçakun 14 muaj pas ngjarjes!

¹ Trail of Bodies Tells Kosovo Tale, By MELISSA EDDY .c The Associated Press AP-NY-01-16-99 1718EST
<http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 3)

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, seanca e cituar e 13 majit 2002, f. 457

Në fillim të dëshmisë së tij të 26 janarit 2005, gazetari i «Berliner Zeitung»-ut, Bo Adam-i, shpjegoi arsyet e udhëtimit të tij më 23 mars 2000 në fshatin Reçak të Kosovës. Motivi kryesor i tij ishte të verifikonte vërtetësinë e thënieve të presidentit Bill Clinton drejtuar popullit amerikan me rastin e sulmeve kundër regjimit të Milošević-it. Konkretisht dëshironte të hulumtonte në terren nëse ishin të vërteta pohimet e presidentit Clinton se “në Reçak burra, gra dhe fëmijë të pafajshëm u nxorën nga shtëpitë e tyre, u detyruan të gjunjëzoheshin në tokë dhe ndaj tyre u krisën breshëri plumbash, jo për atë që kishin bërë, por për shkak të përkatësisë së tyre etnike.”¹

Pasi hulumtoi listën e personave të vrarë gjatë operacionit policor dhe ushtarak të 15 janarit 1999, ai doli te përfundimi se në këtë rast nuk bëhej fjalë për fëmijë në shumës, por vetëm për një djalë të vrarë, ndërsa numri i grave të vrara ishte dy!² Ky “fakt e solli Bo Adam-in te konstatimi se Clinton-i kishte gënjyer!”³

Sa i përket vrasjes së djalit që figuronte në listën e të vrarëve të Reçakut, Bo Adam-i tregoi se ka qenë “edhe te shtëpia e tij, i ka shprehur ngushëllime⁴ nënës së djaloshit, kanë dalë 10, 20 a 30 metra nga oborri i shtëpisë (nuk i kujtohet saktësisht!), ka shkuar te vendi ku është vrarë dhe aty i ka thënë dikush nga grupi i vogël i njerëzve që e shoqëronin⁵ se djali është vrarë nga një kodër disa qindra metra larg (...). Nuk i kujtohet se kush i kishte thënë një gjë të tillë, sepse kjo për të nuk ka pasur rëndësi. E rëndësishme ishte se e vërtetoi se ky djalosh nuk ishte detyruar të gjunjëzohej në baltë dhe nuk është shtënë me rafalë kundër tij.”⁶ Pra, Clinton-i kishte gënjyer, përfundoi Bo Adam-i për rastin e parë!

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitar Bo Adam, seanca e 26 janar 2005, f.254

² Po aty, f.258

³ Po aty, f.271-272

⁴ Humanist i madh!

⁵ Sipas pohimeve të tij, Bo Adam-ine shoqëronte një taksist shqiptar, i cili fliste pak anglisht dhe me të cilin kishin arritur të merreshin vesh disi, f.282

⁶ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Bo Adam, seanca e 26 janar 2005, f.272-274

Nuk e shoh të udhës të sjell dëshmitë rrëqethëse të publikuara nga gazetarët Pierre Hazan dhe Melissa Eddy për të dëshmuar të kundërtën e pohimeve të këtij gazetari që “hulumtoi” rastin 14 muaj më vonë!

Edhe për rastin e dytë “dikush nga grupi, që e kishte shoqëruar, i kishte pohuar Bo Adam-it se gruaja është vrarë nga një kodër disa qindra metra larg dhe, sado tragjike të ketë qenë rasti, kjo flet se ajo nuk është ekzekutuar, nuk ka qenë e detyruar të gjunjëzohej në baltë dhe ndaj saj nuk është shtënë me rafalë plumbash. Pra, Clinton-i kishte gënjyer edhe kësaj radhe!”¹

Krahas informatave nga persona të pidentifikuar, të cilëve u referohet, Bo Adam-i kishte shkruar në shkrimet e veta se “një dëshmitar okular, edhe identiteti i tij nuk i kujtohet (!), i kishte thënë se babai i djaloshit ishte vrarë në pozicion të shtrirë, duke luftuar me pushkë në dorë dhe rrjedhimisht ai nuk ishte detyruar të gjunjëzohej në baltë e as që është shtënë me rafalë plumbash ndaj tij.”² Pra, Clinton-i kishte gënjyer!

Mirëpo, pesë vjet pas shkrimeve të tij, në seancën gjyqësore ku ishte ftuar të dëshmonte në favor të Milošević-it, Bo Adam-i e hodhi poshtë këtë pjesë të shkrimit të vet. Ai deklaroi se “ishte vërtetuar që babai i djaloshit i kishte marrë plumbat në kraharor dhe rrjedhimisht nuk ka mundur të jetë i shtrirë në pozicion luftarak në momentin e vrasjes”³.

Pohimi i Bo Adam-it nxori në shesh se shkrimi i tij kishte shpërndarë një gënjeshtër! Pra, u vërtetua se dikush gënjente për vrasjen e babait të djaloshit! Kush është gënjeshtari? Persona të pidentifikuar, identiteti i të cilëve nuk i kujtohet (!) autorit të shkrimit, dikush tjetër apo vetë ai? Kush mund të qëndrojë prapa një gënjeshtre të tillë mbetet vetëm në nivelin e hipotezave. Ajo që është e qartë në këtë rast lidhet me faktin se gazetari Bo Adam-i, që kishte ardhur të dëshmonte se “masakra e Reçakut ishte gënjeshtër”, kishte shpërndarë një gënjeshtër në funksion të fshehjes së gjurmëve se në këtë fshat ishin vrarë civilë të pafajshëm.

¹ Po aty, f.271-272

² Po aty, f.272-274

³ Po aty, f.274

Në këtë seancë gjyqësore, Bo Adam-it, ia rikujtuan se në artikullin e tij të 24 marsit 2000 ai kishte shkruar se shoqëruesi i “tha që 25 meshkuj ishin fshehur në një stallë, rrëzë kodrës. Shumica e tyre kishin filluar të iknin tatëpjetës, por ishin përballur me policinë dhe ishin vrarë.”¹

Bo Adam-i pranoi se kishte cituar atë që i kishin thënë njerëzit. Por, theksoi se kjo nuk ishte shumë domethënëse dhe se kishte dallim shumë të madh midis asaj që kishte shkruar ai, se 25 meshkujt ishin vrarë duke ikur, dhe asaj që qëndronte në akuzë² kundër Milošević-it, se janë dërguar për t’u vrarë!³ Domethënëse për të janë ato që i kishin thënë “dëshmitarët okularë” të ngjarjes, që nuk i kujtohen se kush ishin! Po ia rikujtoj lexuesit se sipas dëshmisë së tij, përkthyes i Bo Adam-it kishte qenë një taksist shqiptar, i cili fliste pak anglisht dhe me të cilin kishin arritur të merreshin vesh disi. As identiteti i tij nuk i kujtohet!⁴

E vetmja gjë që mundi të vërtetohej me dëshminë e Bo Adam-it lidhej me praninë e civilëve, dëshmitarë okularë të asaj çka ndodhi në fshatin Reçak! Kjo nuk i shkonte për shtati Milošević-it dhe mbrojtjes së tij, sepse ata prisnin të dëgjonin gënjeshttrat e sajura në qarqet politike të regjimit të Beogradit dhe të shpërndara nga Milovan Drecun-i dhe Tomislav Magoçi, nëpërmjet «Media Press Center»-it⁵.

Për këtë arsye, as Milošević-i e as mbrojtja e tij nuk shtruan më shumë pyetje dhe kjo seancë ishte shumë e shkurtër në krahasim me seancat e tjera të këtij procesi gjyqësor. Bo Adam-i me kundërthëniet e veta dëshmoi vetëm një gjë: ai kishte shpërndarë gënjeshttra!

¹ Po aty, f.304

² Paragrafi 66 (A) f. 26 e aktakuzës kundër Milošević-it përrastine Kosovës “Në tërë fshatin shtihet kundër vendasve që përpiqeshin të iknin nga forcat speciale të Serbisë” e më pas” Grupi prej 25 meshkujve ishte përpjekur të strehohej në një ndërtesë, por i zbuluan forcat speciale serbe, i kanë rrahur, pastaj i kanë dërguar në afërsi të kodrës dhe i kanë vrarë me armë zjarri.”

³ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitar Bo Adam, seanca e 26 janar 2005, f.305-306

⁴ Po aty, f.282

⁵ Qendra Mediale shtetërore serbe për Kosovë, me qendër në Hotel Grand Prishtina dhe e udhëhequr në atë kohë nga Radovan Uroševac

Manipulimi kronik i «Masakrës së Reçakut»

Nëse u kthehemi edhe një herë dy shkrimeve të publikuara në shtypin francez në janar të vitit 1999, do të shohim se shkrimet: «A ishin vërtet të masakruar me gjakftohtësi të vdekurit e Reçakut?»¹ dhe «Re të zeza mbi një masakër»², nuk ishin asgjë tjetër pos parafrazim i tekstit të shpërndarë nga gazetarët e Radio Televizionit Shtetëror të Serbisë, Milovan Drecun-it dhe Tomislav Magoçi-t.

Megjithatë, ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër regjimit të Milošević-it, që mobilizoi të gjitha qarqet anti-NATO dhe antiamerikane, bëri që këto shkrime tepër marginale në kohën e publikimit të shndërroheshin në referenca kryesore!

Kështu, në shkrimin e titulluar «“Masakra” serbe e Reçakut nuk ka ekzistuar»³, autori Louis Magnin-i theksoi se gjoja “preteksti që arsyetoi bombardimin e Jugosllavisë ishte një gënjeshtër e madhe.”⁴ Për të ardhur deri te ky përfundim, autori pranon se mbështetet në artikujt e lartpërmendur dhe në veprën e Milovan Drecun-it: «Beteja e Dytë e Kosovës»⁵.

Dhjetë vjet pas «Masakrës së Reçakut» dhe ndriçimit të rastit se në këtë fshat u vranë 42 civilë shqiptarë, ndërsa një grua ende konsiderohet e zhdukur, ky autor përsërit tërësisht tezat e trilluara në Beograd se “në fshatin Reçak nuk kishte civilë; se aty ishte vendosur një brigadë e UÇK-së prej 126 ushtarësh, në mesin e të cilëve ishin katër instruktorë të huaj me emra anglo-saksonë; se ushtarët e vrarë u zhveshën nga teshat ushtarake dhe u veshën me tesha civile; se kufomat, me sugjerime të William Walkeri-it, u grumbulluan në një përrua dhe u vendosën në atë mënyrë që të

¹ Le monde, Christophe Châtelot, «Les morts de Racak ont-ils vraiment été massacrés froidement?» 21.01.1999

<http://www.srpska-reza.com/ddj/Racak/Articles/LeMonde990121.html>

² Le Figaro, Renaud Girard, «Nuages noirs sur un massacre», 20/01.1999

³ Louis Magnin, «Le “massacre” serbe de Racak n’a jamais eu lieu» në:
<http://www.mondialisation.ca/le-massacre-serbe-de-racak-n-a-jamais-eu-lieu/12232>

⁴ Po aty

⁵ Milovan Drecun, vepër e cituar, *Drugi kosovski boj*, f. 23

krijohej përshtypja se ata nuk ishin vranë gjatë luftimeve, por ishin ekzekutuar nga forcat serbe (...).”¹

Nëntë vjet pas demaskimit të përpjekjeve të regjimit të Milošević-it për të fshehur gjurmët e krimit në Reçak, historiani dhe gazetari francez, themeluesi dhe kryeredaktori i Portalit frankofon «Le Courrier des Balkans», që afishon qëllimin e vet për të zhvilluar solidaritetin me gazetarët e Ballkanit, Jean-Arnauld Derens-i përsërit të njëjtat teza!

Në veprën e tij «Kurthi i Kosovës»², Jean-Arnauld Derens-i “informon” lexuesin se “UÇK-ja provokoi forcat serbe, që iu kundërpërgjigjën me ashpërsi. Më 8 janar UÇK-ja vrau tre policë në një pritë të përgatitur shumë mirë. Dy policë të tjerë u vranë disa ditë më vonë. Policia serbe filloi një aksion ndëshkimi. Ajo evakuo i fshatarët nga Reçaku, ndërsa UÇK-ja mbeti e pranishme (...) Të premten, më 15 janar, ndodhën konfrontimet më të ashpra ndërmjet policisë dhe UÇK-së, që sipas gjasave mbështetej nga civilët shqiptarë. Forcat serbe vranë gati të gjithë mbrojtësit e Reçakut, gjithsejt 51 persona, trupat e të cilëve u zhvendosën gjatë natës, sipas të gjitha gjasave nën udhëzimin e UÇK-së, me qëllim që të përforconin karakterin makabër të vrasjes. Praktikisht të gjitha viktimat ishin burra të moshës madhore (...).”³

Autori, që i përcakton vetes si qëllim që të informojë lexuesin se si të shmangen kurthet lidhur me Çështjen e Kosovës, e bën të vetin interpretimin e sajuar nga regjimi politik i Milošević-it, që edhe ekspertët serbë e cilësojnë si marrëzi! Për më tepër, interpretimit zyrtar serb Jean-Arnauld Derens-i i shtoi gënjeshtër të reja, që, nëse nuk janë sajim i tij, duhet të tregojë se nga cili burim e ka marrë këtë informatë!

Ku e gjeti ky historian pohimin se “policia serbe evakuo i fshatarët nga Reçaku, ndërsa UÇK-ja mbeti e pranishme” dhe nëse kishte civilë në këtë fshat, atëherë “ata ishin mbështetës të UÇK-së”

¹ Louis Magnin, artikulli i cituar

² Jean-Arnauld Derens, *Le piège du Kosovo*, Editions Non Lieu, 2008, f. 130-131

³ Po aty

dhe se “gjatë konfrontimeve u vranë gati të gjithë mbrojtësit e Reçakut...”(?!)

As kreu i regjimit të Slobodan Milošević-it, që përgatiti këtë krim, as forcat speciale të policisë serbe të komanduara nga Goran Radosavljević Guri, që ekzekutuan krimin, as gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i dhe makineria propagandistike serbe, që u vu në funksion të fshehjes së gjurmëve të krimit, nuk thanë asnjëherë se “policia serbe evakuoi fshatarët nga Reçaku”! Po e përsëris! Nëse Jean-Arnauld Derens-i nuk e sqaron se nga e ka marrë këtë gënjeshtër të re që synon të sjellë “prova të reja” për të vërtetuar atë që Milošević-i e përsëriti disa herë se gjoja “aksioni në Reçak ishte i pastër si kristali”¹ atëherë ai është autori i kësaj gënjeshtre!

Flas për gënjeshtër të re sepse po i njëjti Jean-Arnauld Derens në veprën «100 dyert e konflikteve jugosllave»², që është bashkautor me Cathrine Samy-në, për të njëjtën çështje ka shkruar se “kur policia dha urdhër që të sulmohet Reçaku, i cili në rrethana normale numëronte 2000 banorë, fshati ishte i zbrazur. Pothuajse nuk kishte as gra e as fëmijë. Kjo lë të nënkuptohet se UÇK-ja kishte dhënë urdhër të evakuheshin nga Reçaku, sepse e priste një sulm të tillë si përgjigje ndaj provokimeve të ndryshme që kishte bërë ditë më parë.”³

Nuk mund të thuhet se Jean-Arnauld Derens-i kishte harruar gënjeshtërën që kishte shpërndarë disa vite më parë. Përtej jokoherecencën intelektuale që nxjerrin në shesh pohimet kontraktore ku herë UÇK-ja e herë policia serbe gjoja kishin larguar popullsinë civile nga fshati Reçak, Jean-Arnauld Derens-i rreshtohet përkrah atyre që synojnë të fshehin faktin se forcat serbe kishin masakruar civilë shqiptarë.

Nëntë vjet pas autopsisë së 40 kufomave dhe identifikimit se në mesin e tyre ishin dy gra dhe katër persona nën moshën 18-vjeçare⁴, ndërsa gruaja e tretë, Sahide Metushi, ende konsiderohet

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Karol John Drewienkiewicz, seanca e cituar e 15 prillit 2002, f. 457

² Jean-Arnauld Derens & Cathrine Samary, *Les 100 portes des Conflits Yougoslaves*, Les Éditions de l'Atelier, Paris, 2000, f.427

³ Po aty, f.295

⁴ Shih listën complete të personave të vranë

e zhdukur, del një historian francez dhe deklaroi se “praktikisht të gjitha viktimat ishin burra të moshës madhore”!

Nuk mund të thuhet se Jean-Arnauld Derens-i, në cilësinë e gazetarit që i ka vënë vetes për qëllim të zhvillojë solidaritetin me gazetarët e Ballkanit, nuk e ka lexuar shkrimin e gazetarit Pierre Hazan¹, në të cilën sillet dëshmia e vrasjes së fëmijës përpara syve të nënës!

Apo ndoshta në këtë rast ai solidarizohet me ekspertin serb të Mjekësisë Ligjore, dr. Slaviša Dobričanin-in, që thotë se “shqiptarët 14 vjeçarë tanimë janë të rinj të pjekur dhe se shumë prej tyre kanë mbajtur armë, ndërsa mosha nuk do të thotë asgjë.”² “Të gjithë janë burra të moshës madhore”, tenton të bindë lexuesin Jean-Arnauld Derens-i!

Lexuesit i kujtohet se në ditën e ekspeditës për marrjen e kufomave në Reçak, gjykatësja hetuese serbe Danica Marinković-i, sapo hyri në xhaminë ku ishin të shtrira kufomat, deklaroi para gazetarëve se “të gjithë qenkan burra, nuk paska gra, nuk paska fëmijë, nuk ka të masakruar, siç janë munduar ta paraqesin...”³

Ndoshta Jean-Arnauld Derens-i nuk e ka ditur se Danica Marinković-i nuk është gazetare, por gjykatëse hetuese! Duke e parë para gazetarëve se pohon që të gjithë të vrarët janë burra dhe nga dëshira që të “solidarizohet me gazetarët e Ballkanit” ai shpërndan marrëzinë e atyre që përpiqeshin ta fshihnin krimin në Reçak!

“Të gjithë janë burra të moshës madhore”! “Nëse dikush kishte mbetur në Reçak, ai ishte mbrojtës i fshatit.” Madje, sipas kësaj logjike, edhe plaku 82 vjeç e gjysmë, Nazmi Nuhë Imeri, i lindur më 13 qershor 1917, ishte civil i vrarë në mbrojtje të Reçakut! “Për shqiptarët mosha nuk do të thotë asgjë!” Askush nuk mund ta mohojë se Nazmiu është i moshës madhore!

Sidoqoftë, kushdo që krahason qëndrimet e publikuara nga drejtuesi i Portalit frankofon «Le Courrier des Balkans» me ato të

¹ Libération, Hazan Pierre, artikulli i cituar «Nous étions sûrs de tous mourir»

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e cituar e 12 prillit 2005, f.641-642

³ Emissioni dokumentar i RTS i cituar më lart «Kosovo Racak Laži i istine» <http://www.youtube.com/watch?v=RH2LB-n3RpI>

publikuara nga Milovan Dracun-i¹, gazetari i çështjeve ushtarake e politike të Radio Televizionit të Serbisë së Milošević-i, kundër të cilit Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Serbisë dorëzoi padinë në Gjykatën për Krime Lufte në Serbi, do të bindet se Jean-Arnauld Derens-i solidarizohet me të dhe gazetarët tjerë që u vunë në shërbim të propagandës luftënxitëse, të cilët nxitën kryerjen e krimeve të luftës dhe gjenocidit në Kosovë.

Nuk mund të thuhet se Jean-Arnauld Derens-i, në cilësinë e historianit, pas publikimeve të shumta të shefes së ekipit finlandez të Mjekësisë Ligjore, Helena Ranta-s se “hulumtimet në përrua, ku çdo centimetër e tokës së tij është përshkuar me lopatë, me lugë dhe me detektor metalesh, kanë dëshmuar se viktimat ishin vrarë në atë vend dhe se kishin qenë civilë të paarmatosur” do të këmbëngulë në shpërndarjen e gënjeshtres serbe për zhvendosjen e trupave të vrarë dhe se gjoja Helena Ranta “nuk sjell përgjigje të qarta dhe definitive për pyetjet e shumta që vazhdojnë të shtrohen.”²

Nëse ka diçka të paqartë në përfundimin e Jean-Arnauld Derens-it, ajo lidhet me motivet e vërteta të tij që, duke kërkuar nga lexuesi të shmangë kurthet lidhur me Kosovën, ai u ofron idetë e marrëzishme të sajuara në qarqet politike të regjimit të Milošević-it dhe rrjedhimisht i fton të bien në kurthin e propagandës serbe!

Katërmëdhjetë vjet më vonë, gazetari hulumtues francez, Pierre Péan-i, në librin «Kosova: një luftë e ‘drejtë’ për një shtet mafioz», i kushton një kapitull «Masakrës së Reçakut»³.

Duke u mbështetur në dëshmitë e “reporterëve amerikanë, që ishin të pranishëm në fshat ditën e sulmit serb, në hulumtimet e ndryshme gazetareske, në mesin e të cilave hulumtimin e të dërguarit special të ‘Le Monde-it’” - dhe përfundimin e mjekëve ligjorë të dërguar në vendin e ngjarjes nga Bashkimi Evropian, ai

¹ Shih prologun e këtij kapitulli

² Jean-Arnauld Derens, vepra e cituar *Le piège du Kosovo*, f. 132

³ Pierre Péan, *Kosovo: une guerre «juste» pour un Etat mafieux*, Fayard, 2013, f.77-85

citon Jean-Arnauld Derens-in se “UÇK-ja me gjasë kishte kurdisur një inskenim duke i zhvendosur trupat për t’i grumbulluar... dhe kështu ta bënte të besueshme se viktimat ishin ekzekutuar e jo të vrarë gjatë luftimeve.”¹ Sipas këtij autori, efektet e kësaj “masakre” ishin të menjëhershme: organizimi i Konferencës së Rambujesë, që duhej të përgatiste opinionin për ndërhyrjen e NATO-s.”²

Në të njëjtën frymë, 12 vjet pas kësaj ngjarjeje, gjeografi francez Christian de Bongain-i, që në shkrimet e veta fshihet prapa emrit Xavier Raufer dhe profesionit të kriminologut, shkruan se kemi të bëjmë me “fushatë botërore të dezinformimit më të pabesueshëm në historinë e re!” Në shkrimin «Ballkani, kasaphana dhe mashtrimi»³ ai deklaron: “Në janar të vitit 1999, dyzet kufoma njerëzish, të vrarë me plumb, të vendosura njëra mbi tjetrën, u zbuluan në fshatin Reçak të Kosovës. Stuhi e menjëhershme! ‘Masakra e Reçakut’ u dha zjarr mediave botërore. Pos që askush nuk e di nëse ishin viktima civile ose guerilë të UÇK-së të vrarë gjatë luftimeve anekënd Kosovës dhe të grumbulluara për nevojat e show-ut. Askush nuk e di (ligji i heshtjes imponon një gjë të tillë...) nëse viktimat janë nga Reçaku apo nga rajoni...”⁴

T’i kthehemi edhe një herë Michel Collon-it, autorit që u përmend edhe në fillim të këtij kapitulli. Ai ka publikuar tri vepra kushtuar “dezinformimit”⁵ dhe lidhur me «Rastin e Reçakut» ai këmbëngul “se shumë janë nga ata që mendojnë se kufomat janë transportuar nga vendi i betejës, janë veshur si civilë, janë gjymtuar për t’i dhënë këtij rasti karakter mizorie, për ta mediatizuar në mënyrë që sulmet e parapara nga NATO-ja kundër Jugosllavisë të bëheshin ‘politikisht të pranueshme’. Mund të thuhet se po të mos ekzistonte ky krim, NATO-ja do ta kishte shpikur, sikurse ujku i fabulës, që sajoi krimin e qengjit!”⁶

¹ Po aty, f.84

² Po aty, f.85

³ Balkans, Boucherie et bidonnages, Le nouvel Economiste, 15 shkurt 2011, <http://www.lenouveleconomiste.fr/balkans-boucherie-et-bidonnages-9201/>

⁴ Po aty

⁵ L’Esprit européen, «Michel Collon, l’anti-désinformateur» http://www.esprit-europeen.fr/perspectives_desintox_collon.html

⁶ Po aty

Të njëjtin qëndrim e përsërit edhe në veprën e vet «Monopoli¹: NATO-ja dhe pushtimi i botës».² Në të njëjtën mënyrë Régis Debray-ja, nëpërmjet shkrimit publik «Letër e një udhëtari presidentit të Republikës»³ i rikujton publikut qëndrimet e gjeneralit francez, Charles de Gaulle-it, që denonconte “nënshtimin ushtarak dhe politik të Evropës Perëndimore karshi SHBA-ve”.

Fakti që gazetari belg shpreh mendime të tilla në një takim të organizuar nga Shoqata e Miqësisë Franko-Serbe në Lyon ose që Régis Debray-ja i shkruan letër presidentit të Francës pas kthimit nga vizita që bëri në Serbi, nuk do të thotë se “për hir” të kësaj “miqësie” ata i besojnë të “vërtetës serbe” për atë që ka ndodhur në Reçak. Shumë më shumë se “pro-serbizmi” i Michel Collon-it apo Régis Debray-së është “anti-amerikanizmi” dhe/ose “anti-imperializmi” i tyre që i bën të rreshtohen përkrah propagandës zyrtare të regjimit të Milošević-it njëlloj si edhe Christophe Châtelot-ja e Renaud Girard-i, Jürgen Elsässer-i e Christophe Chiclet-i, Domenico Lasurdo-ja e Serge Halimi, Frédéric Saillot-ja e Xavier Raufert-i, Patrick Barriot-i e John Laughland-i, Jean-Arnault Dérens-i e Pierre Péan-i⁴ dhe autorë të tjerë që do të përmenden në vijim të librit tim.

Të konsiderohet Milošević-i, i njohur botërisht si «kasap i Ballkanit»⁵ si “i pafajshëm”, si “qengji” i fabulave të La Fontain-it,

¹ Monopoli është lojëku lojtarët synojnë të pushtojnë sa më shumë hapësira.

² Michel Collon, vepra e cituar, *Monopoly-l'OTAN à la conquête du monde*, f.5-55

³ Le monde, Régis Debray, «Lettre d'un voyageur au président de la République», 13 maj 1999

Në: <http://www.sarantakos.com/kosovo/ks20debray.html>

⁴ Sa për ilustrim po përmend disa autërë dhe disa vepra që ndajnë të njëjtat mendime dhe që citohen reciprokisht: Christophe Chiclet, Bernard Ravenel, *Kosovo: le piège*, Jürgen Elsässer, *La RFA dans la guerre au Kosovo*, *Chronique d'une Manipulation*, Harmattan, 2002 (libri është botuar në gjuhën gjermane në vitin 2000)», Noam Chomsky, *Le Nouvel Humanisme militaire, leçons du Kosovo*, Serge Halimi, Dominique Vidal et Henri Maler, *L'opinion, ça se travaille. Les médias et les «guerres justes»: Kosovo, Afghanistan, Irak*, Jean-Arnault Dérens, *Le piège du Kosovo*, Frédéric Saillot, *Racak: De l'utilité des massacres* (Tome 2), Pierre Péan *Kosovo: une guerre «juste» pour un Etat mafieux ...*, Régis Debray ...etj

⁵ Méditerranée, «Serbie: Un monument pour le bourreau des Balkans Slobodan Milosevic»

si “viktimë e ujkut amerikan”, nuk janë asgjë tjetër veçse tregues i verbërimit ideologjik me «anti-amerikanizëm». Përveç «anti-amerikanizmit», si këndvështrim ideologjik që dominon në disa qarqe në Evropën Perëndimore, nuk di se si mund të shpjegohet fakti që bashkëlufëtari i Che Guevara-s, Regis Debray-ja, gazetarët e «Le monde diplomatique»-ut, Serge Halimi, Dominique Vidal-i e Jean-Arnault Dérens-i kanë të njëjtin qëndrim politik si Jean-Marie Le Pen-i, përfaqësuesi i ekstremist të djathtë të Frontit Nacional¹ dhe Xavier Raufer-i, këshilltari i disa partive politike të djathta!

Veç luftës “kundër armikut të popujve: imperializmit amerikan dhe NATO-s”² nuk mund të kuptohet se si është e mundur që gazetarët e së majtës gjermane, si Bo Adam-i³ dhe Jürgen

<http://www.mediterranee.com/0732011-serbie-un-monument-pour-le-bureau-des-balkans-slobodan-milosevic.html#.U1MQH9LwY8o>

¹ Portali i Jean-Arnault Dérens, «Le courrier des Balkans», sjell pjesë nga intervista e Le Pen-it dhënë gazetës kroate «Jutarni List». Në këtë intervistë Le Pen-i pohoi miqësinë e tij me Vojslav Šešel-in, Radovan Karadžić-in dhe Biljana Plavšić-in, tre krijuesit e politikës së spastrimit etnik dhe gjenoçidit në Bosnje, të arrestuar për krimet e luftës në Bosnje. Arroganca e Le Pen-it shkoi deri në atë shkallë sa u bëri thirrje kroatëve që të mos mbështesin Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Ky qëndrim i Le Pen-it është i kuptueshëm, sepse i ndiqen miqtë për gjenocidin e kryer në Bosnje. Në të njëjtën kohë, kjo figurë politike e ekstremist të djathtë të politikës franceze dhe evropiane deklaronte se ka mbështetur Serbët në luftën e tyre kundër NATO-s dhe amerikanëve” (<http://balkans.courriers.info/article22231.html>)

Intervistën në tërësi mund ta lexoni në faqen web të «Jutarni list»:

<http://www.jutarnji.hr/jean-marie-le-pen--svi-vi-koji-zelite-u-francusku--nedolazite-tu-ako-nemate-novca--vec-imamo-pet-milijuna-nezaposlenih/1095656/>

Për qëndrimet e Le Pen-it lidhur me ndërhyrjen e NATO-s shih edhe:

Déclaration de M. Jean-Marie Le Pen, président du Front national, sur l'histoire de Jeanne d'Arc, l'histoire de la construction européenne, son opposition à la constitution d'une Europe fédérale et à l'intervention de l'Otan au Kosovo, Paris le 1er mai 1999.

<http://discours.vie-publique.fr/notices/003000049.html>

² Contre la violence hégémonique de l'Empire US-OTAN, L'ennemi commun des peuples: l'imperialisme des USA (Kundër dhunës hégjemonike të Mbretërisë SHBA-NATO, Armiku i përbashkët i popujve: imperializmi i SHBA-ve, Në: <http://www.oniros.fr/contrelempire.html>

³ Të cilin e ftoi Milošević-i si dëshmitar në mbrojtjen e tij.

Elsässer-i, të rreshtohen në një linjë me udhëheqësin e neonazistëve gjermanë, Udo Voigt-in!¹

Varshmëria nga «antiamerikanizmi» si ideologji i bën këta autorë të orientimeve politike diametralisht të kundërta të “bashkohen” në qëndrimin kundër veprimeve të amerikanëve, qoftë edhe në rastet kur veprohet për të shpëtuar një popull nga katastrofa humanitare dhe nga politika e gjenocidit!

Lexuesi ka pasur në dispozicion argumente të mjaftueshme për të krijuar idenë lidhur me vërtetësinë e «Masakrës së Reçakut». Shpresoj se pas këtij kapitulli ai do të jetë në gjendje të gjykojë nëse ishte «Rasti i Reçakut» inskenim i qarqeve të caktuara për të arsyetuar ndërhyrjen ushtarake kundër regjimit të Milošević-it ose «Masakra e Reçakut» ishte vetëm një nga aktet e shumta të tragjedisë që përjetuan shqiptarët në Kosovë.

Protagonistët e krimit

Në pjesën e mësipërme solla pjesë të gjata të shkrimeve të gazetës franceze «Liberation» dhe të gazetares së «Agjencisë Associated Press» me anë të të cilave lexuesi ka mundur të kuptojë arsyet e vërteta pse nuk jepeshin detaje se cilët ishin këta gazetarë, se në cilën datë u shkruan artikujt etj. Artikujt e «Liberation»-it dhe të «Associated Press»-it, që përmend komandanti i policisë serbe, Goran Radosavljević Guri, dëshmojnë sadopak për tmerret dhe për masakrat që u bënë nën komandën e tij. Por, në teknikat e manipulimit me opinionin publik është e njohur thënia e ministrit të Edukimit të Popullit dhe të Propagandës së regjimit nazist, Joseph Goebbels-i, se “sa më e madhe është gënjeshtria, aq më lehtë kalon! Sa më shpesh të përsëritet, aq më shumë i beson populli!”

Jo vetëm Goran Radosavljević Guri, që ishte drejtpërsëdrejti i implikuar në këtë krim, por të gjithë ata që shpërndajnë interpretimin zyrtar të regjimit të Slobodan Milošević-it për

¹ Shih më gjerësisht në : National, Social & Radical: <http://club-acacia.overblog.com/15-categorie-10951540.html>

«Rastin e Reçakut», përsëritin vazhdimisht se në këtë fshat nuk ka pasur vrasje të civilëve! Thënia e Goebbels-it merr kuptimin e plotë në këtë praktikë.

Pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, për meritat që kishte në luftën kundër shqiptarëve në Kosovë, Goran Radosavljević Guri u emërua komandant i Qendrës Mësimore në Petrovo Selo. Kjo qendër ishte njëra nga qendrat më të njohura për trajnime të forcave speciale të Policisë së Serbisë. Me gjithë avancimet në funksion, gjurmët e krimit e ndiqnin gjithkund.

I pyetur nga gazetari i gazetës serbe «Blic», se si ishte e mundur që një bashkëpunëtor i ngushtë i Nebojša Pavković-it, Sreten Lukić-it dhe Vladimir Lazarević-it, që kishin përfunduar në Hagë për krimet e bëra në Kosovë, ende nuk ishte arrestuar, komandanti i aksionit policor në Reçak, Goran Radosavljević Guri, përgjigjet: *“Lukić-i dhe Pavković-i janë në Hagë për shkak të përgjegjësisë komanduese. Ata nuk kanë mundur ta dinë se cilët janë autorët e vrasjeve! Unë në Kosovë kam qenë zëvendës i Sreten Lukić-it dhe funksioni më ka shpëtuar nga Haga.”*¹

Goran Radosavljević Guri mendon se nuk dihet se “cilët janë autorët vrasjeve” në Kosovë dhe përpiqet të fshihet prapa funksionit që ka pasur në zinxhirin komandues. Kur është fjala për përgjegjësitë komanduese në kryerjen e krimeve kundër shqiptarëve dhe “shpëtimi nga dënimi vetëm për shkak të funksionit”, po sjell për lexuesin vetëm një shembull: «Rastin e vëllezërve Bytyqi».

Krahas vazhdimit të krimeve të këtij gjenerali të policisë serbe, ky rast do t’i mundësojë lexuesit të shohë mungesën e vullnetit të autoriteteve të Beogradit për të nxjerrë kriminelët përpara drejtësisë.

Në përshkrimin e «Rastit të vëllezërve Bytyqi» do t’u referohem kryesisht burimeve zyrtare serbe. Aktakuza e Prokurorisë

¹ Blic, «Goran Radosavljević Guri: Taçi preti praznom puškom» (Thaçi kërcënohet me pushkën e zbratur), 14.04.2013
<http://www.blic.rs/Vesti/Politika/377538/Goran-Radosavljevic-Guri-Taci-preti-praznom-puskom>

për Krime Luftë në Beograd, Vendimi i Gjykatës së Lartë, Seksioni për Krime Luftë dhe Vendimi i Gjykatës së Apelit përmbajnë informata të mjaftueshme për të kuptuar se çka ndodhi në Qendrën Mësimore të Petrovo Selo-s, të komanduar nga Goran Radosavljević Guri.

Në vijim po sjell për lexuesin pjesë nga këto vendime.

Sipas të dhënave që përmenden në Vendimin¹ e Gjykatës së Lartë të Serbisë, të Seksionit për Krime Luftë, të datës 9 maj 2012 “çdo gjë filloi më 26.06.1999”².

Në këtë ditë qershori, tre vëllezër: Yll Bytyqi (1974), Agron Bytyqi (1976) dhe Mehmet Bytyqi (1978), shtetas amerikanë me origjinë nga Kosova, duke dashur t’u ndihmonin dy familjeve rome që udhëtonin për në Serbi, i marrin në veturat e tyre dhe në vend që të ndaleshin në afërsi të kufirit, duke mos njohur vendin, kishin kaluar kufirin administrativ të Kosovës dhe kishin hyrë në territorin e Serbisë. Ndalohen nga pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë³, në një checkpoint në vendin Rudar. Dënohen nga Gjykata për Kundërvajtje e Kurshumlisë me nga 15 ditë burg për kalim ilegal të kufirit shtetëror. Më 27 qershor dërgohen në Burgun e Qarkut të Prokuples për të vuajtur dënimin. Për shkak të sjelljes së mirë gjatë vuajtjes së dënimit, u pranua kërkesa për lirim me kusht dhe u parashikua të liroheshin para kohe, më 8 korrik. Megjithatë, për rastin e tyre u njoftuan instancat më të larta në Beograd, madje edhe ministri i policisë, Vljako Stojiljković-i⁴.

“Një ditë para se vëllezërit Bytyqi të liroheshin nga burgun, gjenerali Vlastimir Đorđević Rođa, shef i Resorit për Siguri Publike në MPB të RS-së, nëpërmjet telefonit kontaktoi me Qendrën Mësimore në Petrovo Selo. Në mungesë të komandantit Goran Radosavljević Guri në linjën telefonike u përgjigj Sreten Popović-i,

¹ Republika e Serbisë, Gjykata e Lartë, Seksioni për Krime Luftë, K-Po2-51/2010, Transkripti i vendimit për lirim nga akuza, 9 maj 2012

² Po aty, f.6

³ Në vazhdim të tekstit MPB e RS

⁴ Republika e Serbisë, Gjykata e Lartë, Seksioni për Krime Luftë, K-Po2-51/2010, Transkripti i vendimit për lirim nga akuza, 9 maj 2012, f.6

zëvendëskomandant i kësaj qendre. Gjenerali Đorđević e urdhëroi të akuzuarin, Popović-in që të angazhonte disa pjesëtarë të njësisë së vet, të shkonin në Prokuple dhe sapo të dilnin nga burgu vëllezërit Bytyqi të arrestoheshin dhe të dërgoheshin në Qendrën e Petrovo Selo-s. Sipas të njëjtave udhëzime, vëllezërit Bytyqi duhej të mbaheshin në këtë qendër deri sa të vinin pjesëtarë të MPB-së të RS-së që t'i merrnin. Për këtë operacion ishin të informuar shefi i Seksionit Policor të Prokuples dhe Drejtoria e Burgut të Qarkut të Prokuples. Të gjithë së bashku koordinuan aksionin dhe kjo dëshmon se kishim të bënim me një aksion të organizuar mirë”¹, theksohet në vendimin e lartpërmendur.

Duke vepruar sipas urdhrave të eprorëve të tyre, Sreten Popović-i, Miloš Stojanović-i, Aleksandar Nikolić-i, Dejan Stamenković-i dhe pjesëtarë të tjerë të MPB-së të RS-së arrestuan tre vëllezërit Bytyqi, i dërguan në Qendrën Mësimore në Petrovo Selo, i mbajtën të lidhur në një lokal me derë të hekurt dhe me 9 korrik ua dorëzuan personave të panjohur (!!!) të MPB të Serbisë. Këta pjesëtarë të policisë serbe, që në dosjen e vëllezërve Bytyqi përmenden si persona NN (të paidentifikuar!), “i lidhën me tel këta shtetas amerikanë me origjinë shqiptare, i dërguan rreth 500 metra nga Qendra Mësimore, hapën zjarr nga armët e tyre dhe i goditën në pjesën e pasme të kokës.”²

Me kërkesë të vazhdueshme të SHBA-ve, autoritetet e Beogradit urdhëruan hapjen e hetimeve. Kjo detyrë iu ngarkua Gjykatës së Qarkut në Negotin. Për të hedhur dritë mbi këtë krim u ngarkua ekipi i ekspertëve nga Instituti i Mjekësisë Ligjore të Nishit³, nën udhëheqjen e dr. Vujadin Otašević-it⁴. Kohë pas kohe, hetimet u monitoruan nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-

¹ Po aty, f.7

² Republika e Serbisë, Prokuroria për Krime Lufte, Aktakuza, f.2
[http://www.hlc-
rdc.org/images/stories/pdf/sudjenje_za_ratne_zlocine/srbija/Za%20sajt-
Bitici/Bitici-optuznica-23.08.2006..PDF](http://www.hlc-rdc.org/images/stories/pdf/sudjenje_za_ratne_zlocine/srbija/Za%20sajt-Bitici/Bitici-optuznica-23.08.2006..PDF)

³ Qytet në Serbi

⁴ I njëjti ishte anëtar i ekipit të ekspertëve të mjekësisë ligjore për ndriçimin e “Rastit të Reçakut”

Jugosllavinë, nga Qendra Juridike Humanitare dhe nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian.

Në afërsi të Qendrës për trajnimin e njësive speciale të forcave policore serbe, që ishte nën komandën e Goran Radosavljević Guri-t, u zbuluan dy varreza masive¹.

Zhvarrosja nga varreza e parë, që hetuesit e emëruan «Petrovo Selo I», përfundoi më 26 qershor 2001, kurse në varrezën e dytë, të emëruar «Petrovo Selo II», hulumtimet përfunduan më 28 qershor 2001².

Të njëjtën ditë, më 28 qershor 2001, Qeveria e Serbisë emëroi Goran Radosavljević Guri-n në detyrën e shefit të Xhandarmërisë së Republikës së Serbisë. Ngritja në funksionin e ri, që ishte si shpërblim për krimet e kryera kundër shqiptarëve, bëri që të heshtej përgjegjësia e komandantit të Qendrës Mësimore në Petrovo Selo për dy varrezat masive.

Sipas ekspertizës së Mjekësisë Ligjore serbe për të dy varrezat masive në Petrovo Selo u konstatua se “në 60 raste vdekja ishte shkaktuar nga plagët me të shtëna armësh, 9 persona kishin vdekur nga plagë prej mjeteve jo të mprehta, kurse në 8 raste shkaktari i vdekjes ishte i panjohur.”³ Në mesin e kufomave të varrosura në këto varreza ishin edhe tre vëllezërit: Mehmet Bytyqi (21-vjeçar), Agron Bytyqi (23-vjeçar) dhe Yll Bytyqi (25-vjeçar).

Kjo ekspertizë dëshmoi se Goran Radosavljević Guri e kishte shndërruar Qendrën Mësimore të forcave speciale të policisë serbe në Petrovo Selo, në një qendër të “mësimin praktik” se si të ekzekutoheshin shqiptarët.

Zhvarrosja “hoqi dheun” me të cilin autoritetet politike, ushtarake dhe policore të Beogradit ishin përpjekur t’i mbulonin krimet. Një vendim të rëndësishëm në drejtim të ndriçimit të rasteve miratoi edhe Kuvendi i RFJ-së⁴. Më 11 prill 2002, ky

¹ Të cilat u emërtuan nga hetuesit e këtij rasti si Petrovo Sello I dhe Petrovo Selo II dhe kishin dimensionet 3x3 metra me 1.5 metra thellësi dhe 3x3 metra me 3.5 metra thellësi.

² International Commission on Missing Persons, f.5
<http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2008/02/batajnica-2001-alb.pdf>,

³ Po aty, f.5-6

⁴ Republika Federative e Jugosllavisë, emërtim zyrtar në atë kohë.

kuvend miratoi Ligjin për bashkëpunim me Gjykatën Penale Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

Në ditën e miratimit të këtij ligji, ish-ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Vljako Stojiljković-i, ndaj të cilit Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë kishte ngritur padi penale¹ për krime ndaj shqiptarëve të Kosovës, vrau veten me plumb në kokë! Vetëvrasjen e bëri publikisht para ndërtesës së Kuvendit të RFJ-së, në orën 19:10.²

Sado shpresëdhënës që ishte vendimi për bashkëpunim me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, praktika dëshmoi se realizimi konkret i tij hasi në pengesa të mëdha, që janë të lidhura me logjikën e moçme të “fshehjes së krimit në rrugë institucionale.”

Pesë vjet pas zbulimit të kufomave të vëllezërve Bytyqi, më 23 gusht 2006, Prokuroria për Krime Luftë në Beograd ngriti akt-padi penale kundër zëvendëskomandantit të Qendrës Mësimore të Petrovo Selo-s, Sreten Popović-it dhe pjesëtarit tjetër të policisë serbe, Miloš Stojanović-it. Akuza i ngarkoi “për krim luftë ndaj robërve të luftës.”³ Ndërsa, dy pjesëtarët e tjerë të MPB-së të RS-së, Aleksandar Nikolić-i dhe Dejan Stamenković-i, përkundër asaj se përmenden në faqen 2 të aktakuzës si bashkëpjesëmarrës në rrëmbimin e vëllezërve Bytyqi, ndaj tyre nuk u ngrit akuza. Në vend të përgjegjësive penale, me të cilat duhej të ballafaqoheshin, ata u ftuan në cilësi të “dëshmitarëve”, në të njëjtën mënyrë siç u veprua edhe ndaj “Milenko Arsenijević-it, Aleksandar Đorđević-it, Marjan Mijatović-it, Milovan Vučićević-it, Milisav Vučković-it dhe policëve të tjerë të implikuar në këtë krim.”⁴

¹ Padia e datës 27 maj 1999

² B92, «Vljako Stojiljković pucao sebi u glavu» (Vljako Stojiljković goditi veten në kokë)
http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2002&mm=04&dd=11&nav_id=58055

³ Republika e Serbisë, Prokuroria për Krime Luftë, Aktakuza,
[http://www.hlc-
rdc.org/images/stories/pdf/sudjenje_za_ratne_zlocine/srbija/Za%20sajt-Bitici/Bitici-optuznica-23.08.2006..PDF](http://www.hlc-rdc.org/images/stories/pdf/sudjenje_za_ratne_zlocine/srbija/Za%20sajt-Bitici/Bitici-optuznica-23.08.2006..PDF)

⁴ Suđenja za ratne zločine u Srbiji (Gjykimet për krime luftë në Serbi) Dokumenti |
19/12/2007
<http://pescanik.net/2007/12/sudenja-za-ratne-zlocine-u-srbiji/>

Për të humbur gjurmët e implikimit në këtë krim, “më 17 gusht 2004, Goran Radosavljević Guri largohet nga posti i shefit të Xhandarmërisë Serbe dhe transferohet si këshilltar në MPB-së të RS-së. Por, në dhjetor të vitit 2006, me urdhëresë të Gjykatës për Krime Lufte, ndaj tij u lëshua një urdhër arresti për shkak të implikimit në vrasjen e vëllezërve Bytyqi.”¹

Më 14 shkurt 2007, gazeta qeveritare e Beogradit, «Politika» solli në ballinën e saj artikullin e titulluar «Guri në arrati»², në të cilin jepeshin detaje për motivet e kësaj arratie. Në të njëjtën kohë, gazeta informoi se Goran Radosavljević Guri ndodhej në Libi, ku trajnonte forcat speciale të Mouammar Khadhafi-it. Ikja e tij nuk ishte e papritur, theksohej në këtë artikull.

Krahas komandimit të forcave speciale të policisë serbe në krimet e bëra në fshatin Reçak dhe në Petrovo Selo, Goran Radosavljević Guri komandonte edhe forcat famëkëqe “paramilitare” «Tigrovi», të krijuara nga kriminelin i njohur Željko Ražnatović-i. Këtë informatë e panoi Aleksandar Vasiljević-i, zëvendëshefi i Drejtorisë së Sigurisë së Ushtrisë Jugosllave³. Megjithatë, as funksioni i komandantit në strukturat që u dëshmuar se kishin kryer krime në Petrovo Selo, nuk ndikoi që ky kriminel të përgjigjej për veprat e kryera.

Në shkrimin lidhur me proceset gjyqësore në Serbi për krime lufte, Fondi për të Drejtën Humanitare në Beograd përmend mungesën e vullnetit për të ndriçuar krimet e bëra dhe për të dënuar ata që ishin implikuar në krime. Në këtë kontekst, ky

¹ Hronologija Reforme Sektora Bezbednosti u Republici Srbije (2000-2008) f. 34-35

(Kronologija e reformës së sektorit të Sigurisë në Republikën e Serbisë 2000-2008)

<http://www.bezbednost.org/upload/document/hronologija.pdf>

² Politikaonline, 14.02.2007, « Guri u bekstvo »,

<http://www.politika.rs/rubrike/Hronika/t19752.lt.html>

³ Shih dëshminë e Aleksandar Vasiljević-it në procesin kundër Slobodan

Milošević-it, me 13 shkurt 2003, f. 365

<http://www.hlc->

[rdc.org/Transkripti/Milosevic/Transkripti/Transkripti%20osa%20osudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20\(31\)/Transkript%20osa%20osudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20-%202013.%20februar%202003..pdf](http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/Transkripti/Transkripti%20osa%20osudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20(31)/Transkript%20osa%20osudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20-%202013.%20februar%202003..pdf)

fondacion serb theksonte: “Karakteristika kryesore e këtyre gjykimeve është fakti se nuk ndërmerret asgjë kundër urdhërdhënësve e as kundër ekzekutuesve të drejtpërdrejtë të krimeve. Ka indikacione se udhëheqësi i Kampit në fshatin Petrovo Selo, Goran Radosavljević Guri, ka ikur jashtë vendit dhe me dijeninë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Qeverisë së Serbisë dhe të Prokurorisë për Krime Luftë, para fillimit të procesit edhe pse është ditur se dyshohej për përgjegjësinë e tij për këtë krim.”¹

Pas procesit gjyqësor që zgjati pesë vjet, me vendim të Gjykatës së Lartë të Serbisë, të Seksionit për Krime Luftë, të datës 9 maj 2012, Sreten Popović-i dhe Miloš Stojanović-i u liruan nga aktakuza si të pafajshëm.

Edhe Gjykata e Apelit në Beograd, Seksioni për Krime Luftë, në seancën e 18 janarit 2013 hodhi poshtë ankesën e prokurorit dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës së Lartë të Beogradit të datës 12 prill 2012².

Sipas këtyre vendimeve “nga ana e Gjykatës së Lartë të Beogradit janë dhënë mjaft arsye të argumentuara, ku nuk ka asgjë të paqartë, asgjë jologjike dhe asnjë kundërthënie se vëllezërit Bytyqi nuk kanë qenë robër luftë:

- sepse lufta kishte përfunduar më 9 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes Ushtarake-Teknike të Kumanovës;
- edhe pse kanë qenë pjesëtarë të «Batalionit Atlantiku»³, në momentin e arrestimit nuk kanë qenë pjesëtarë të asnjë njësi ushtarak ose policor dhe nuk kanë qenë duke kryer ndonjë detyrë ushtarake ose policore;

¹ Sudenja za ratne zločine u Srbiji, Dokumenti | 19/12/2007

<http://pescanik.net/2007/12/sudenja-za-ratne-zlocine-u-srbiji/>

² Republika Serbije, Apelacioni sud u Beogradu, (Republika e Serbisë, Gjykata e Apelit në Beograd), Kž1 Po2 5/12

<http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/07/Drugostepena-presuda1.pdf>

³ «Batalioni Atlantiku» u formua nga nënshkretas amerikanë me origjinë shqiptare të cilët erdhën për të luftuar në Kosovë dhe në këtë mënyrë dhanë kontributin e tyre për çlirimin e Kosovës.

- në ditën e arrestimit nuk kanë qenë në ndonjë mision të armatosur luftarak, por misioni i tyre ishte skajshmërisht humanitar dhe bamirës;
- në momentin e arrestimit nuk kanë qenë të armatosur, nuk kanë pasur uniformë ushtarake ose policore;
- kanë qenë të veshur me tesha civile (bluza, këmisha, pantallona, xhinse...) dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohen robër lufte që kanë rënë në duart e armikut.”¹

Nga ana tjetër, u vërtetua se:

- “të akuzuarit, Sreten Popović-i dhe Miloš Stojanović-i, nuk kanë mundur ta dinë se personat NN, pjesëtarë të policisë, do t’i vrasin vëllezërit Bytyqi. Askush nuk u ka thënë një gjë të tillë dhe se ata kanë zbatuar urdhrat e eprorëve të tyre;
- në bazë të ekspertizës së profesorit të Mjekësisë Ligjore të Nishit, dr. Vujadin Otašević-it², vëllezërit Bytyqi kanë mundur të dërgohen në Beograd dhe pas një kohe të konsiderueshme të vriten e pastaj të sillen në varrezën masive të Petrovo Selo-s; “Ata kanë mundur të jenë vrarë një ditë, dy ditë, tre ditë, pesë ditë, një muaj, dy muaj, tre muaj para se të varroseshin këtu. Këtë gjë, në aspektin mjekoligjor, nuk mund ta konstatoj. Por, është i e sigurt se nuk janë vrarë pranë varrezës masive!”³
- Në bazë të ekspertizës së këtij profesori të Mjekësisë Ligjore u “vërtetua se eshtrat e thyera që u konstatuan gjatë autopsisë së viktimave, nuk kishin qenë pasojë e torturës dhe se në aspektin mjekësor nuk mund të thuhet se si ka ndodhur. A janë shkaktuar nga ekskavatori apo në ndonjë formë tjetër, nuk mund ta dimë.”⁴ “Janë gjëra që ndodhin. Nuk duhet të kesh shumë njohuri nga mjekësia për ta ditur se edhe njeriut që ecën rrugës, kur i rrëshqet

¹ Gjykata e Apelit Beograd, KŽ1 Po2 5/12

² Republika e Serbisë, Gjykata e Lartë, Seksioni për Krime Lufte, K-Po2-51/2010, Transkripti i vendimit për lirim nga akuza, 9 .05.2012, f.11

³ Po aty, f.11

⁴ Dëshmia e dr. Vujadin Otašević në procesin gjyqësor kundër Sreten Popović-it dhe Miloš Stojanović-it, më 13 prill 2007, f. 5

këmba, rrëzohet në diçka të fortë e thyen këmbën. E lëre më të hidhet nga lartësia e kamionit ose nga ndonjë lartësi tjetër dhe të bjerë në ndonjë dru, në ndonjë gur ose në ndonjë send të fortë”¹, deklaroi dr. Vujadin Otašević-i gjatë procesit gjyqësor kundër Sreten Popović-it dhe Miloš Stojanović-it. Në vend të ekspertit mjekoligjor, ai u shndërruar në avokat të këtyre dy të akuzuarve.

Në fund të këtij procesi, meqenëse nuk u konstatua se kur ishin vrarë vëllezërit Bytyqi dhe këmbënguljes së dr. Vujadin Otašević-it se vëllezërit Bytyqi nuk janë ekzekutuar pranë varrezave masive, gjykata liroi Sreten Popović-in dhe Miloš Stojanović-in si të pafajshëm! Ata i liruan nga akuza dhe ua kthyen pasaportat që u ishin marrë më parë².

Në vendimin e 9 majit 2012, Gjykata e Lartë e Beogradit, Seksioni për Krime Luftë, theksoi se “Prokurorisë i mbetet një detyrë e rëndë ta zbulojë se kush, pse dhe me urdhër të kujt u vranë këta tre të rinj. Jemi thellësisht të bindur se askush, madje as tre vëllezërit Bytyqi nuk e kanë merituar që jetën e tyre të re ta përfundojnë me plumb në kokë, me sy të mbyllur, me duar të lidhura me tel dhe të varrosen në varrezë masive në periferi të Serbisë.”³

Sado revoltuese të jetë një vendim i tillë dhe tallës “keqardhja” e lartpërmendur për fundin e jetës së tre të rinjve “me plumb në kokë, me sy të mbyllur dhe me duar të lidhura me tel” kjo dëshmon se sa thellë janë të rrënjosura në strukturat politike, ushtarake, policore, gjyqësore dhe mediatike format e mentalitetit të vjetër ku “tjetri” shihet si “objekt që duhet asgjësuar!”

Nga të gjithë të implikuarit në këtë krim, vetëm shefi i Resorit për Siguri Publike në MPB të RS-së, gjenerali Vlastimir Đorđević-i, që u arrestua⁴ në bazë të akuzës së ngritur nga Gjykata

¹ Po aty, f.19

² Republika e Serbisë, Gjykata e Lartë, Seksioni për Krime Luftë, K-Po2-51/2010, Transkripti i vendimit për lirim nga akuza, 9 .05.2012, f.11-12

³ Po aty, f.12

⁴ Arrestimi i tij u bë më 17 qershor 2007

Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, për krimet e kryera ndaj shqiptarëve të Kosovës, u dënua me 27 vjet burg.

Gjatë procesit të gjykimit të tij, ai, për rastin e vëllezërve Bytyqi fajësoi ministrin e Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, Vljako Stojiljković-in. Eprorin e vet, që bëri vetëvrasje publike para ndërtesës së Kuvendit të RFJ-së!¹

Është me rëndësi të përmendet fakti se gjenerali Vlastimir Đorđević-i e pranoi akuzën, pranoi se ndihet fajtor për pjesëmarrjen në krimet kundër shqiptarëve të Kosovës dhe u kërkoi falje familjarëve të shqiptarëve të vrarë të Kosovës.

“Në Kosovë, në vitin 1999 u bënë krime. Ato krime nuk i kam dashur dhe sikur të kisha pasur mundësi ta kthej kohën prapa do të kisha vepruar krejt ndryshe. Nuk kam pasur fuqi dhe mundësi t'i kundërvihem ministrit të atëhershëm të Punëve të Brendshme, Vljako Stojiljković-it. Nuk i jam kundërvënë fshehjes së krimit. Për këtë ndihem fajtor. Ndjej keqardhje të thellë për të gjitha viktimat në Kosovë dhe vuajtjeve që kanë përjetuar familjarët e tyre. Në veçanti u kërkoi falje të gjitha familjeve të shqiptarëve të Kosovës, që kanë humbur jetë. U kërkoi falje edhe personave të shpërngulur dhe ndaj dhembjen e tyre...”² - deklaroi Vlastimir Đorđević-i në Hagë.

Ish-zëvendësministri i Punëve të Brendshme të Serbisë dhe shefi i Resorit për Siguri Publike, Vlastimir Đorđević-i, pranon publikisht se në Kosovë, me urdhër politik, janë bërë krime kundër shqiptarëve të Kosovës dhe deklaroi se ndihet përgjegjës pse nuk i është kundërvënë strategjisë së fshehjes së krimeve të bëra në Kosovë.

¹ RTS, « Đorđević: Izvršavao sam nalog Vljaka Stojiljkovića » (Đorđević: Zbatova urdhërat e Vljako Stojiljkovića)

<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/135/Hronika/70187/%C4%90or%C4%91evi%C4%87%3A+Izvr%C5%A1avao+sam+nalog+Vljaka+Stojiljkovi%C4%87a.html>

² Kurir, « Priznao krivicu: Vlastimir Đorđević se izvinio žrtvama na Kosovu », (Pranoi fajin: Vlastimir Đorđević u kërkoi falje viktimave nga Kosova) 13 maj 2013

<http://www.kurir-info.rs/priznao-krivicu-vlastimir-dordevic-se-izvinio-zrtvama-na-kosovu-clanak-787765>

Nuk mund të gjykoj për sinqeritetin e pendimit të këtij kryepolici! Le të mbetet e drejta e secilit lexues!

Ajo që nxit të theksohet në këtë rast ka të bëjë me etikën profesionale të mjekëve ligjorë, që ishin ngarkuar të ndriçonin vrasjet e kryera me urdhër të strukturave politike, ushtarake dhe policore të Serbisë.

Profesori i Mjekësisë Ligjore të Universitetit të Nishit, dr. Vujadin Otašević-i, tenton të na bindë se “eshtrat e thyera që u konstatuan gjatë autopsisë së viktimave të varrezave masive në «Petrovo Selo I» dhe «Petrovo Selo II» nuk kishin qenë pasojë e torturës (...), por ishin shkakuar nga ekskavatori ose në ndonjë formë tjetër. Edhe më neveritëse janë banalizimet e tipit se nuk duhet të kemi shumë njohuri nga mjekësia për ta ditur se edhe njeriut që ecën rrugës, kur i rrëshqet këmba, rrëzohet në diçka të fortë dhe e thyen këmbën (...).”¹

Këmbënguljet e tij se vëllezërit Bytyqi nuk ishin vrarë pranë varrezës masive kishin për qëllim të vetëm të shfajësonin Sreten Popović-in dhe Miloš Stojanović-in, që ishin vetëm dy të akuzuar nga tërë zinxhiri komandues në kuadër të policisë serbe që rrëmbyen, keqtrajtojnë dhe ekzekutojnë vëllezërit Bytyqi. U ekzekutojnë për të vetmen arsye se ishin amerikanë me prejardhje shqiptare.

Po përmend rastin kur avokati kërkoi sqarime nga ky “ekspert i Mjekësisë Ligjore”, se pse kufomat i kishin pasur të lidhura duart me tel dhe sytë e mbyllur me shirit, nëse nuk janë ekzekutuar në atë vend, dr. Vujadin Otašević-i u përgjigj me arrogancë: “Jo, nuk e di! Kjo nuk ka të bëjë me profesionin tim!”² Atë që ai mundi të pohonte në përputhje me “fushën e tij profesionale”, në mënyrë të ngjashme si të Slaviša Dobričanin-it, ka të bëjë me “faktet” se “gjatë zhvarrosjes u zbulua se njëra kufomë kishte uniformë me shenjën e UÇK-së, te tjetra u gjet e vizatuar harta e Kosovës, te i treti ishte harta e Gjermanisë në një bluzë e kështu me radhë...”³

¹ Po aty, f.19

² Dëshmia e dr. Vujadin Otašević në procesingjyqësor kundër Creten Popovic dhe Milos Stojanovic, më 13 prillit 2007, f.10-13

³ Po aty, f.15

Sikur të mos ishte bërë publike se vëllezërit Bytyqi në ditën e arrestimit “nuk kishin qenë as me uniforma, as të armatosur e as në ndonjë mision luftarak”¹, profesori i Mjekësisë Ligjore të Universitetit të Nishit, dr. Vujadin Otašević-i, do ta kishte përgjigjen e gatshme, në të njëjtën mënyrë, siç veproi anëtari tjetër i ekipit serb të Mjekësisë Ligjore për “Rastin e Reçakut”, profesori i Mjekësisë Ligjore i Universitetit të Beogradit, dr. Dušan Dunjić-i, në «Rastin e Srebrenicës».

Në pyetjen e njëjtë, por në kontekst tjetër, si dëshmitar në mbrojtje të liderit të serbëve të Bosnjës, Radovan Karadžić-it, në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, dr. Dušan Dunjić-i deklaroi se “në Srebrenicë² janë ekzekutuar vetëm 400 njerëz, përderisa shumica e njerëzve që janë gjetur në varrezat masive të Srebrenicës nuk janë aspak viktimat të ekzekutimeve të kryera në korrik të vitit 1995. Shumë prej tyre kanë mundur të kenë qenë vrarë pas korrikut të vitit 1995 ose para korrikut 1995. Shumë plagë kanë mundur t’u bëhen viktimave pos mortem dhe nuk kemi arsye t’i konsiderojmë si viktimat të rastit të njëjtë. Madje, vetëm një numër shumë i vogël nga 400 të vrarët mund të konsiderohen si viktimat të ekzekutimit. Ata që, kur u zhvarrosën, u konstatua se kishin duar të lidhura me tel ose me konop mund të konsiderohen të ekzekutuar. Ndërsa, për ata që kishin sy të mbyllur me shirit nuk mund të pohohet nëse u janë vendosur këto shirita, por se shiritat e këtyllë janë shenja³ që i kanë mbajtur viktimat për t’u dalluar dhe pasi janë vrarë u kanë rënë mbi sy!”⁴

Po e përsëris! Sikur të mos ishte bërë publike se vëllezërit Bytyqi në ditën e arrestimit më 26 qershor 1999 nuk kishin qenë as

¹ Fakte që u shfrytëzuan nga Gjykata e Larë e Beogradit për të hedhur poshtë tezën se bëhej fjalë për « robër luftime » !

² Më 13 korrik 1995, forcat serbe në Bosnjë masakruan përafërsisht 8000 burra dhe adoleshent mysliman në Srebrenicë. Pas Luftës së Dytë Botërore është vrasja më e keqe në Evropë. Drejtësia Ndërkombëtare e kualifikoi si gjenocid. (<http://fr.euronews.com/2013/07/13/srebrenica-hommage-aux-victimes-du-13-juillet-1995>)

³ Aluzion për luftëtarët islamikë që bartin shirita në ballë.

⁴ <http://iwpr.net/sr/report-news/svedok-tvrđi-da-je-u-srebrenici-pogubljen-samo-400-ljudi>

me uniforma, as të armatosur e as në ndonjë mision luftarak dhe se kishin qenë në një mision humanitar, dr. Vujadin Otašević-i do të kishte përsëritur atë që kishte thënë kolegu i tij, Dušan Dunjić-i për “shiritat që u kishin rënë nga balli dhe ua kishin zënë sytë!” Së paku ky është mendimi im. I mbetet lexuesit të gjykojë për etikën profesionale të këtyre profesorëve të Mjekësisë Ligjore që minimizojnë krimin dhe tentojnë ta paraqesin nga një këndvështrim ideologjik dhe propagandistik!¹

Shfajësimi i kriminelëve që urdhëruan rrëmbimin, keq-trajtimin dhe ekzekutimin e vëllezërve Bytyqi, është revoltues. Po aq revoltues është fakti se për viktimat e tjera të zhvarrosura nga varrezat masive «Petrovo Selo I» dhe «Petrovo Selo II» nuk u bë fjalë aspak! Është revoltues kur dihet se nuk u dënua askush nga zinxhiri komandues i kësaj qendre “mësimore”, ku njësitë speciale të policisë serbe kishin civilët shqiptarë si “lëndë të parë” për trajnimin praktik të ekzekutimit me duar të lidhura me tel dhe me sy të mbyllur me shirit!

Shpërthimi i revoltës që njihet si «Pranvera arabe» e detyroi Goran Radosavljević Guri-n që të kthehej nga Libia në Serbi. Në vend të arrestimit për krime lufte ai u prit si hero! Nga ofertat e shumta, ai zgjodhi të bëhej anëtar i Komitetit që kryeson Partinë Përparimtare Serbe², të kryesuar nga Kryeministri aktual i Serbisë, Aleksandar Vučić-i e që parim themelor ka “ruajtjen e integritetit territorial të Republikës së Serbisë me Krahinat Autonome të Kosovës dhe të Vojvodinës, si pjesë të pandashme të saj.”³

Po i sjell për lexuesin, që nuk është i informuar se bëhet fjalë për partinë politike të themeluar nga presidenti aktual i Serbisë, Tomislav Nikolić-i, që ka qenë nënkryetarë i Partisë Radikale Serbe të Vojislav Šešel-it⁴.

¹ Për ata që nuk kanë parë incizimet e ekzekutimeve të bëra nga vetë serbët dhe që nuk kanë probleme të shohin skenatë tmerrshme po u sugjeroj të shohin këtë video (<http://www.youtube.com/watch?v=oS-UZJ67AKc>) për të parë talljen që ky mjek i bën realitetit tragjik të gjenocidit serb në Srebrenicë.

² Sprska Napredna Stranka, Glavni Odbor

³ Statut Srpske Napredne Stranke, Parimet Themelore, Neni 2, pika 1.
<http://www.sns.org.rs/lat/o-nama/statut-sns>

⁴ Vojislav Šešel-i është arrestuar dhe që nga viti 2003 pret të dënohet për Krime lufte. Më 7 mars 2012 Gjykata e Hagëska kërkuar për të dënim me 28 vjet burg.

Edhe në cilësinë e anëtarit të Komitetit që kryeson këtë parti qeveritare të Serbisë, Goran Radosavljević Guri nuk mundi t'u ikte pyetjeve të gazetarëve lidhur me «Rastin e Reçakut».

Në intervistën për gazetën «Blic», të datës 14 prill 2013, ai deklaroi se “aksioni në Reçak është ndër aksionet më të mira të ndërmarra në Kosovë, që ka hyrë si shembull për mësim edhe në doracakët amerikanë të forcave speciale! Reçaku është hequr nga akuza ndaj gjeneralëve policorë dhe ushtarakë dhe kjo do të thotë se NATO-ja ka pohuar se atje nuk ka pasur masakër. Për bombardim është dashur të gjendet pretext. Reçaku u kurdis si aksioni i fundit pak para bombardimeve. Sikur të mos ishte Reçaku, do të gjendej diçka tjetër! Edhe ekspertët gjyqësorë të Mjekësisë Ligjore, edhe kolegët tuaj nga «Associated Press»-i, edhe «Liberation»-i francez sollën të dhëna në bazë të të cilave Gjykata e Hagës vendosi të heqë Reçakun nga akuza!”¹

Pohimi i ministrit të Edukimit të Popullit dhe të Propagandës të regjimit nazist, Joseph Goebbels-i, se “sa më e madhe të jetë gënjeshtria aq më lehtë kalon! Sa më shpesh të përsëritet, aq më shumë i beson populli!”, është ende në fuqi!

* * *

Në kapitullin e parë të këtij libri, kur trajtova «Rastin Kleçka», solla për lexuesin faktin se në mesin e gazetarëve që u akuzuan për manipulime mediatike në funksion të nxitjes së krimeve, për përhapjen e urrejtjes ndërnacionale dhe ndërfetare si dhe për nxitjen e diskriminimit dhe armiqësisë, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë akuzoi edhe gazetarin e çështjeve ushtarake e politike të Radio Televizionit të Serbisë, Milovan Drecun-in².

Ndërsa për rolin e madh në shpërndarjen e gënjeshtres së sajuar në Beograd, si të “vërtetë” për “Rastin e Reçakut”, Milovan Drecun-i dhe kameramani i Radio Televizionit të Serbisë, Tomislav

¹ Blic, artikulli i cituar, « Taçi preti...»

² Vreme, aktakuza e cituar e Shoqatës së gazetarëve të pavarur të Serbisë
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=875112&print=yes>

Magoči, më 27 prill 1999, u dekoruan nga gjeneralkoloneli Nebojša Pavković-i¹.

Milovan Drecun-i dhe Tomislav Magoči ishin të vetmit gazetarë që u dekoruan nga komandanti i Armatës së Tretë Jugosllave, që udhëhoqi luftën serbe në Kosovë.

Për lexuesin që nuk e di se kush është Nebojša Pavković-i po sjell shkurtimisht vetëm këtë fakt.

Nebojša Pavković-i kërkohet nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për katër vepra penale të kryera gjatë luftës në Kosovë: deportime, shpërngulje të dhunshme, vrasje dhe përndjekje. Më 25 prill 2005 ai u dorëzua te autoritetet ndërkombëtare për t'u ballafaquar me drejtësinë. Në shkurt të vitit 2009, gjeneralkoloneli serb, Nebojša Pavković-i, u dënua me 22 vjet burg.

Akuza e Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë për manipulime mediatike në funksion të nxitjes së krimeve, për përhapjen e urrejtjes ndërnacionale dhe ndërfetare, si dhe për nxitjen e diskriminimit dhe të armiqësive nuk pati asnjë pasojë për Milovan Drecun-in.

Pas veprimtarisë së gjatë aktive në kuadër të partisë së Milošević-it, në qershor të vitit 2011 u anëtarësua², sikurse edhe Goran Radosavljević Guri, në Partinë Përparimtare Serbe! Si anëtarë i kësaj partie politike, në zgjedhjet e 2012-s u bë deputet i Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë dhe u emërua kryetar i Komisionit Parlamentar të Serbisë për Kosovë!³

Në vend të ndëshkimeve për implikim në krime kemi përparim në karrierë politike nëpërmjet Partisë Përparimtare Serbe!

¹ Glas Javnosti, «General-pukovnik Nebojša Pavković uručio, Odlikovanja u Trećoj armiji» (Gjeneral Koloneli Nebojša Pavković-i ndau dekorata Armatës së Tretë)
<http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/1999/04/28/glavne-vesti.html>

² RTS, «Milovan Drecun u SNS-u» (Milovan Drecun në SNS)
<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/922260/Milovan+Drecun+u+SNS-u+.html>

³ Narodna Skupština Republike Srbije
http://www.parlament.gov.rs/MILOVAN_DRECUN+.619.891.html

EPILOGU I KAPITULLIT TË TRETË

“Me ujdinë e tri partive të koalicionit qeveritar të Serbisë¹ u vendos të punohej për përgatitjen e një zgjidhjeje politike për Kosovën. Secila parti kishte 1-2 përfaqësues në ekipin për negociata. Unë përfaqësoja «Demokracinë e Re»” - deklaroi Ratomir Tanić-i, këshilltar i kryetarit të Partisë Demokracia e Re, Dušan Mihajlović-it.

Përkundër asaj se ai deklarohet haptazi “për qëndrimin e tij tejet negativ ndaj shqiptarëve, sepse ata paraqesin problem të caktuar për interesat kombëtare të Serbisë”² dëshmitë që solli Ratomir Tanić-i mundësojnë të sqarohen disa aspekte që për disa nga lexuesit mund të jenë të panjohura.

Teksti i mëposhtëm është vetëm një përmbledhje e shkurtër e dëshmisë së tij në procesin gjyqësor kundër Miloshević-it,³ e intervistës dhënë Radio Evropës së lirë⁴ dhe e intervistës ekskluzive për gazetën serbe «Vreme»⁵.

“Që të shmangej konflikti i armatosur, nga viti 1994 e deri në vitin 1997 u përpoqëm të gjenim një zgjidhje politike globale për Kosovën. Krahas delegacioneve të Serbisë dhe të Kosovës, në këto bisedime merrnin pjesë edhe përfaqësues të shteteve të Grupit të Kontaktit për Jugosllavinë dhe të Organizatave Joqeveritare me influencë në diplomacitë e vendeve të tyre.

Gjatë këtyre bisedimeve, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare ishin shprehur kundër çfarëdo ideje të ndarjes së Kosovës

¹ Partia Socialiste e Serbisë, E Majta e Bashkuar e Jugosllavisë dhe Demokracia e Re

² Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Ratomir Tanić, seanca e 16 majit 2002, f. 755

³ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Ratomir Tanić, seancat e 15-16 majit 2002

⁴ Radio Evropa e Lirë, Ratomir Tanić: "Oui, il existait un plan de nettoyage ethnique du Kosovo", 7 mars 2001
<https://docs.google.com/document/d/1lBGqdCw5E9tFjZlQpn96ohv7UlnKXl3DNkCOECzEV2M/edit?pli=1>

⁵ Miloš Vasić, «Privatni nihilizam i ideološke fikcije»,
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=323038>

dhe të pavarësimit të saj. Kur përfaqësuesit shqiptarë e panë se bashkësia ndërkombëtare nuk mbështeste ndarjen e Kosovës, ata, në mënyrë të heshtur, hoqën dorë prej këtij objektiv, duke gjetur një formulë ngushëllimi se pavarësia e Kosovës mbetet një objektiv afatgjatë, që mund të realizohej nëse të gjitha palët binin në ujdi. Kjo donte të thoshte se një gjë e tillë mund të realizohej kur të binin dakord edhe Beogradi, edhe bashkësia ndërkombëtare! Pra, praktikisht asnjëherë!

Mirëpo, përfundimi i luftës në Bosnjë dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Dayton-it¹ krijoi një paqe relative në vend. Kjo periudhë e shkurtër mjaftoi për të parë se pushtetit të Milošević-it i kishte ardhur fundi. Manipulimi me rezultatet e zgjedhjeve të vitit 1996 provokoi një revoltë të madhe të opozitës, në dhjetor të këtij viti. Për shtypjen e kësaj revolte Milošević-i nuk gjeti përkrahje te gjenerali i Ushtrisë Jugosllave, Momčilo Perišić-i, e as te kryetari i Bashkisë së qytetit Beograd, Nebojša Čović-i. Për këtë arsye ai shkatërroi rezultatet e punës që kishim bërë gjatë bisedimeve, sepse i duhej lufta për të luajtur rolin e shpëtimtarit të Serbisë!

Ta izolosh terrorizmin është një çështje krejt tjetër nga vrasja e grave dhe e fëmijëve, siç është krejtësisht tjetër të shpërngulësh një popull të tërë. Forcat tona të sigurisë nuk bënë aspak luftë kundër terroristëve. Ata luftën e bënë kundër popullatës civile. Kështu filloi konflikti etnik në mars të vitit 1998. Në vend të arrestimit të vëllezërve Jashari dhe të tjerëve, forcat tona sulmuan shtëpitë ku jetonin ata dhe masakruan gratë, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes. Në vend që të kufizoheshin aksionet në caqet e caktuara, u sulmuan edhe fqinjët e tyre... Sigurisht që kjo provokoi revoltën e popullit shqiptar, siç do të provokonte revoltën e cilitdo popull në botë. Milošević-i e dinte se kjo do të provokonte kryengritjen e popullit shqiptar dhe e bëri vetëm e vetëm që të kishte mundësi të arsyetohej se kishim të bënim me

¹ Të nënshkruara më 14 dhjetor 1995

një revoltë! Milošević- i dhe Šainović-i¹ vepronin në atë mënyrë që “lufta kundër terrorizmit” të kthehej në luftë kundër fshatrave dhe civilëve shqiptarë. Dhe kështu të dëboheshin këta njerëz nga Kosova, t’u merreshin dokumentet dhe t’i fshinin nga evidenca. Më vonë, në rast se imponohej t’i kthenim të dëbuarit do të pohonim se janë shqiptarë nga Shqipëria.

Marrëveshja ndërmjet Milošević-it dhe Holbrooke-ut e datës 13 tetor 1998 përfshiu shumëçka nga rezultatet e bisedimeve që kemi pasur me palën shqiptare gjatë gjithë asaj periudhe. Por Milošević-i nuk respektoi asgjë. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ishte vetëm një manovrim taktik për të përfituar në kohë.

Konferenca e Rambujesë ishte një përpjekje e pashpresë e diplomacisë së shteteve perëndimore për të shpëtuar atë që mund të shpëtohej.

Milutinović-i² dhe Milošević-i e mashtruan opinionin publik duke e bindur se trupat e huaja do të hynin në Kosovë me flamurin e NATO-s e jo të OKB-së. Kjo është krejtësisht e pavërtetë. Para se të fillonin bombardimet, komuniteti ndërkombëtar ishte dakord që forcat paqeruajtëse të ishin nën mandatin e OKB-së dhe Korpusi i Armatës Jugosllave të Prishtinës të mbetej në Kosovë, që në bashkëpunim me trupat e Kombeve të Bashkuara të ruanin rendin. Por, Milošević-it i duhej lufta! Lufta për të ishte ideale si ‘prova’ për të mbështetur tezat e veta të trilluara. Regjimi i Beogradit dëshironte luftë me NATO-n, por që kjo të ishte në kufij të kontrollueshëm, të mos kishte shumë bombardime (...). Madje, sado paradoksale të duket, në Beograd ishin të dëshirueshme ‘pak bombardime’! U konvenonte të kishte bombardime të përmasave të vogla, sepse do të shërbente si pretekst i mirë që të vazhdohej me dëbimin e shqiptarëve dhe në të njëjtën kohë edhe të opozitës serbe.

¹ Nikola Šainović-i, ish kryetar i Republikës së Serbisë dhe nënkryetar i Qeverisë Federative të Jugosllavisë. Më 26 shkurt 2009 u dënua nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, me 22 vjet burg për përgjegjësitë në krimet e luftës kundër shqiptarëve në Kosovë.

² Milan Milutinović-i kryetar i Republikës së Serbisë

Në rrethana luftime askush nuk pyet për asgjë. U kërkua nga unë që t'i përcjellja kryetarit të partisë sime që të ktheheshim në koalicion dhe të mos kundërshtonim krijimin artificial të rrethave të luftës. Thënë shkurt, arsyeja pse Milošević-i nuk nënshkroi Marrëveshjen e Rambujesë është se ai dëshironte luftë me NATO-n¹.

Por dhuna dhe spastrimi etnik i shqiptarëve nga Milošević-i bëri që të forcohej UÇK-ja, të kemi një kryengritje masive të shqiptarëve dhe në fund një konflikt me bashkësinë ndërkombëtare.”²

Përtej dallimeve politike dhe ideologjike që mund të kenë lexuesit e këtij libri, shpresoj se ky kapitull mundëson, sado pak, që të kuptohet nëse ishte ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër Serbisë rezultat i një “komploti amerikan i mbështetur në dezinformata” ose ndërhyrja u bë me qëllim që “të ndërpritej dhuna ndaj shqiptarëve dhe spastrimi etnik i Kosovës”. Në kapitullin e ardhshëm do të trajtohen disa aspekte që do të na mundësojnë ta shohim këtë problematikë në kuadër të një dinamike rajonale dhe ndërkombëtare dhe shpresoj se gjërat do të bëhen edhe më të qarta.

¹ Procesi kundër Milošević-it, Dëshmitari Ratomir Tanić-i, seanca e 14 majit 2002, f. 718-719

² Po aty

KAPITULLI I KATËRT

PROLOGU I KAPITULLIT TË KATËRT

“Në Kosovë jetonin të barabartë serbët, shqiptarët, turqit, myslimanët, goranët, romët, egjiptianët (...)

Përballë terroristëve të tërbuar në Kosovë që rrëmbenin civilë, që vrisnin njerëz të pafajshëm, që dhunonin, që i digjinin në kremator gëlqeror, që vrisnin fëmijë dhe që aplikonin format më barbare të dhunës, organet tona shtetërore reagueshan në përputhje me Kushtetutën e Jugosllavisë dhe me përvojat e ngjashme apo identike të vendeve evropiane. Fatkeqësisht, qeveritë perëndimore i trajtuan reagimet tona si dhunë ndaj pakicës shqiptare në Kosovë dhe rrjedhimisht kjo shërbeu si shkas që bashkësia ndërkombëtare të ndërhyjë në mbrojtje të popullsisë së pafajshme. Dhe ashtu ndodhi. NATO-ja sulmoi vendin tim (...)

Në Kosovë nuk ka pasur as katastrofë humanitare e as dëbime të shqiptarëve. Të dyja u provokuan nga bombardimet e NATO-s (...) Bombardimet e NATO-s uranë serbë, malazez, egjiptianë, romë, turq, myslimanë etj. Por, më shumë se gjysma e të vrarëve ishin shqiptarë, të cilët NATO-ja dëshironte t'i shpëtonte nga katastrofa humanitare(...)

Krahas agresionit që synonte të nënshtronte vendin tim, kjo luftë u bë edhe për shkak të urrejtjes personale që kishin ndaj meje. Sepse isha pengesë për shtrirjen e influencës së tyre në këtë pjesë të Ballkanit. Kjo urrejtje shprehet edhe përmes sulmeve mediatike që bëhen kundër familjes sime. Gruaja ime, që është profesororeshë universiteti, vajza ime që nuk është marrë me politikë dhe djali im, që është shumë i sjellshëm, janë bërë objekt i fushatës më të tmerrshme mediatike. Një pandershmëri e tillë dhe një kanibalizëm i tillë nuk është parë në Evropë. Pa marrë parasysh se sa e urreni një armik, sulmi ndaj grave dhe fëmijëve është konsideruar nga gjithë bota si pandershmëri dhe qyqari (...)

Agresioni kundër Jugosllavisë është në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe me parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara, është shkelje e statutit të NATO-s dhe mosrespektim i Kushtetutave të shumicës së shteteve anëtare të saj!”

Slobodan Milošević¹

Shërbimet sekrete serbe kishin hartuar përmbledhje të materialeve² propagandistike të regjimit të Beogradit, të titulluara «Libri i Bardhë për terrorizmin shqiptar» të cilat u publikuan herë në emër të Ministristrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë e herë në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë. Misionet diplomatike të Jugosllavisë dhe më vonë të Serbisë ua shpërndanë falas këto materiale qarqeve politike, mediatike dhe intelektuale nëpër shumë vende të botës.

Sinteza e mësipërme nga fjala e Slobodan Milošević-it nxjerr në pah vetëm disa nga shtyllat e kësaj propagande. Në vijim, lexuesi do të ketë mundësi të shohë se deri në cilat përmasa kishte gjetur shtrirje kjo propagandë dhe deri në cilën shkallë kishin arritur ta prezantojnë si realitet interpretimin serb për atë që ndodhte në Kosovë.

¹ Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi
Traskriptet e seancave të vitit 2002: të 14, 15 dhe 18 shkurt; të 13, 14 dhe 15 marsit; të 18 e 19 prillit dhe seanca e 14 qershorit 2002
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

² Këto libra dhe sidomos ndikimi i tyre janë objekt i analizës në pjesën e Dytë të librit tim.

Dëshira për “pak bombardime”!

Në kapitullin paraprak trajtova dinamikën që përshkoi Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën.

Siç mundëm ta shohim, që nga 15 marsi 1999, data e nënshkrimit të marrëveshjes nga përfaqësuesit e Kosovës, diplomacia e shteteve perëndimore angazhoi përpjekjet maksimale që kjo Konferencë të përmbylej me sukses të përgjithshëm. Por, angazhimet diplomatike nuk lanë anash edhe parashikimet e dështimit të tyre. Në rast të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, një preokupim i veçantë lidhej me fatin e personelit diplomatik që kishte mbetur në ambasadat e shteteve anëtare të NATO-s në Beograd dhe të verifikuesve të OSBE-së në Kosovë. Me qëllim që të mos përsëritej përvoja e hidhur që kishin nga lufta në Bosnje, më 19 mars personeli i ambasadave u largua, ndërsa, më 20 mars, u larguan nga Kosova 1400 pjesëtarët e mbetur të Misionit të Verifikimit të OSBE-së¹.

Po sjellim për lexuesin disa të dhëna që shpjegojnë brengën e shteteve perëndimore për rrezikun real që i kanosej personelit të tyre.

Në nëntor të vitit 1994, kur NATO-ja filloi bombardimet kundër pozicioneve të “paramilitarëve” serbë në Bosnje për t’u imponuar respektimin e zonave të shpallura si «Zona të sigurisë» nga Kombet e Bashkuara, serbët zunë peng 500 ushtarë që ishin me mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në disa vendbanime të Bosnjës.

I njëjti skenar u përsërit edhe në maj të vitit 1995, kur 21 kaska blu franceze dhe 13 vëzhgues të OKB-së u zunë peng ndërsa 150 të tjerë i ngujuan në 9 vendgrumbullime të armëve². Ata u lidhën me pranga dhe u vendosën në vende strategjike që mund të

¹ Libération, Hélène Despic-Popovic, «Escalade des menaces sur Belgrade. Les vérificateurs de l'OSCE sont évacués du Kosovo.», 20 mars 1999
http://www.liberation.fr/monde/1999/03/20/escalade-des-menaces-sur-belgrade-les-verificateurs-de-l-osce-sont-evacues-du-kosovo_268049

² Të dhënat janë nxjerrë nga shkrimi i mëposhtëm:
Libération, «Les Serbes prennent l'ONU en otage pour faire cesser les raids »(Serbët marrin OKB-në si peng për të detyruar ndërprerjen e sulmeve ajrore), 27 maj 1995
http://www.liberation.fr/evenement/1995/05/27/les-serbes-prennent-l-onu-en-otage-pour-faire-cesser-les-raids_132202

ishin caqe të sulmeve të NATO-s. Përmes kësaj forme (mburojës njerëzore) serbët dëshmuar se nuk zgjidhnin mjetet për të justifikuar qëllimet e tyre.



Ushtari perëndimor i zënë peng



Ushtari perëndimor i lidhur për shtyllë, afër urës

Edhe pse tërheqja e personelit diplomatik dhe pjesëtarëve të Misionit Verifikues të OSBE-së u bë në funksion të shmangies së mundësisë që të ziheshin si pengje në rast sulmi kundër Jugosllavisë, ky veprim ngërthente në vetvete edhe mesazhin e rrezikut potencial që bombardimet të fillonin së shpejti.

Më 22 mars 1999 dështoi përpjekja e fundit e Ambasadorit amerikan, R. Holbrooke, për të bindur Slobodan Milošević-in që të pranojë Marrëveshjen e propozuar nga Grupi i Kontaktit.

Të nesërmen, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, deklaroi: “Pas dështimit të «misionit të shansit të fundit» të Richard Holbrooke-ut në Beograd i dhashë urdhër Gjeneralit Wesley Clark-ut të fillojë operacionet ajrore kundër Republikës Federative të Jugosllavisë. Të gjitha përpjekjet që përmes negociatave të arrihet te një zgjidhje politike për krizën e Kosovës dështuan. Nuk ka zgjidhje tjetër pos përdorimit të aksioneve ushtarake (...) Ne duhet ta ndalojmë një regjim autoritar që të vazhdojë të shtypë popullin e vet në Evropë dhe kjo në fund të shekullit XX. Për ne është një detyrë morale.”¹

Përkundër mesazheve të qarta se ishte dhënë urdhri për bombardime, mediat serbe përsërisnin pa ndërprerë qëndrimin e Milošević-it se “nuk e japim Kosovën as me çmimin e bombardimeve!” Ky qëndrim i Milošević-it ishte shndërruar në moto mobilizuese në tërë Serbinë.

Në epilogun e Kapitullit të Tretë solla një pjesë të dëshmisë së Ratomir Tanić-it. Dëshmia e tij na mundëson të shohim se a ishin këto mobilizime në funksion të bindjes së shteteve anëtare të NATO-s për gatishmërinë serbe që të luftojë për të mbajtur Kosovën nën thundrën e vet dhe t'i detyrojë të heqin dorë nga sulmi, apo refuzimi i marrëveshjes politike dhe vazhdimi i dhunës në Kosovë nga ana e regjimit të Beogradit bëhej në funksion të provokimit të bombardimeve.

Me një fjalë, dëshmia e Tanić-it hedh dritë në atë pse regjimi i Beogradit dëshironte luftë me NATO-n, duke shpresuar se kjo

¹ Studimi i cituar i Denis Huber-it *Le Conseil de l'Europe...*
<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=123029>

luftë do të ishte me bombardime të përmasave të vogla. Aq sa do t'u mjaftonin për të justifikuar dëbimin e tërësishëm të shqiptarëve nga Kosova.

Sulmet ajrore të NATO-s në Bosnje, të kufizuara dhe me intensitet të vogël, ishin model referimi se si mund të zhvillohej kjo luftë. Apo së paku si i imagjinonte kreu i regjimit të Beogradit sulmet eventuale të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Ndryshe nga Bosnja, ku Këshilli i Sigurimit autorizonte sulmet nëse nuk respektoheshin rekomandimet e shprehura në rezolutat e saj, në rastin e Kosovës nuk kishte vendim të tillë në formë qartë.

Milošević-i dhe autoritetet e Beogradit shpresonin se sulmet eventuale që mund të bëheshin pa miratimin paraprak nga ana e Këshillit të Sigurimit, do t'i ballafaqonin strukturat e NATO-s me një presion të fuqishëm ndërkombëtar dhe do të detyroheshin t'i ndërprisnin!

Në planin e brendshëm, qëndrimet publike të bartësve të institucioneve të Federatës Ruse kishin një efekt të madh propagandistik. Kështu, mediat nuk hiqnin nga kryeartikujt titujt se «Duma Ruse mbështet Serbinë dhe Jugosllavinë», se «Kryeministri rus, Primakov-i, e cilësoi si absolutisht të papranueshëm përdorimin e forcës», se «Gjenerali i armatës ruse, Ivashov-i ishte shprehur pa asnjë hamendje se agresioni ndaj Jugosllavisë do t'i jepte të drejtë morale Ruisë që ta ndihmonte në të gjitha aspektet Jugosllavinë», se «Ministri i Mbrojtjes ruse, Sergejev-i, tërhoqi vërejtjen se anashkalimi i Këshillit të Sigurimit do të krijonte një «Vietnam të Ri» në Evropë» e kështu me radhë. Qëndrime e tilla dhe të ngjashme me to përforcuan bindjen e njerëzve kyç të regjimit të Milošević-it se në rast të vendimit të strukturave të NATO-s që ta sulmonin Jugosllavinë, pa pëlqimin e Këshillit të Sigurimit, kjo luftë nuk mund të zgjaste shumë.

Krahas Federatës Ruse, qëndrime të ngjashme kishin edhe Kina, si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit, dhe një numër shtetesh tjera anëtare të OKB-së. Të gjitha këto elemente ndikuan në vendimin e Milošević-it që ta refuzonte kategorikisht Marrëveshjen e propozuar nga Grupi i Kontaktit.

Duke pasur parasysh faktin se Marrëveshjen e kishte nënshkruar paraprakisht delegacioni shqiptar i Kosovës, refuzimi i Marrëveshjes nga ana e Beogradit e ngarkoi regjimin e Milošević-it me përgjegjësinë e dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për të gjetur një zgjidhje politike. Si pasojë e kësaj, më 24 mars 1999, Aleanca e Atlantikut Verior filloi bombardimet kundër caqeve ushtarake dhe policore të Jugosllavisë.

Të «drejtat e njeriut» dhe «parimi i sovranitetit të shteteve»

Ndërhyrja e NATO-s kundër Jugosllavisë nxori në shesh divergjencat permanente në interpretimin e të drejtës ndërkombëtare lidhur me çështjen nëse duhet të respektohet parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti edhe në rastet kur shteti nuk respekton të drejtat e qytetarëve të vet. Si duhet të veprohet në raste të tilla? Nëse kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut a është e ligjshme ndërhyrja ushtarake në një shtet sovran?

Flas për divergjenca interpretimeve sepse të dy aspektet qëndrojnë në themelet e të drejtës ndërkombëtare.

Që në fillim e shoh të arsyeshme të theksoj se edhe pse nuk është saktësuar qartë se të drejtat e njeriut qëndrojnë më lart se parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti, të drejtat e njeriut janë baza e të drejtës ndërkombëtare. Sovraniteti i shtetit dhe mosndërhyrja në punët e brendshme të tij janë «parime» për të siguruar mirëqenien dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Në rastet kur një shtet bën shkelje të rëndë lidhur me respektimin e kësaj të «drejte», «parimet e sovranitetit dhe mosndërhyrjes» dalin në rend të dytë.

Përkundër faktit se ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër forcave të Milošević-it shpesh kualifikohet si «ndërhyrje morale për të shmangur rrezikun imediat të katastrofës humanitare në Kosovë» dhe për të «parandaluar realizimin e projektit për

spastrimin etnik» të saj, nuk duhet të harrohet se legjitimiteti i kësaj ndërhyrjeje mbështetet mbi bazën e të drejtës ndërkombëtare.

Politika e dhunës që ushtronte regjimi i Beogradit në Kosovë kishte marrë përmasa dramatike. Në shtator të vitit 1998 Këshilli i Sigurimit të OKB-së alarmonte të gjitha shtetet për rrezikun potencial të një katastrofe humanitare. Edhe pse shifrat ishin shumë më të vogla se ato që publikonin organizatat e ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rezoluta 1199¹ përmend se për shkak të dhunës së forcave të armatosura serbe 230 mijë njerëz ishin zhvendosur dhe se rreth 50 mijë shqiptarë të Kosovës kishin mbetur të pa strehë.

Të drejtat e shqiptarëve ishin dhunuar në mënyrën më flagrante nga ana e regjimit të Milošević-it. Këtu nuk bëhet fjalë për një perceptim subjektiv të këtij realiteti, por, për një konkluzion që figuron në rezolutat 1160, 1199, 1203 dhe 1207 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Sipas të drejtës ndërkombëtare, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara është instanca e vetme kompetente për të përcaktuar situatat të cilat mund të vlerësohen si «rrezik për paqen dhe sigurinë dhe të rekomandojë masat për tejkalimin e tyre.»²

Në rastin e Kosovës, krahas rrezikut të një katastrofe humanitare, ushtrimi i dhunës së forcave të armatosura jugosllave u cilësua nga Këshilli i Sigurimit si rrezik për paqen dhe sigurinë rajonale. Pikërisht për këtë arsye, rezolutat 1166, 1199, 1203 dhe 1207 të vitit 1998 u miratuan në përputhje me Kapitullin e VII³-të të Kartës së OKB-së⁴.

Duke u mbështetur në kapitullin që i kushtohet paqes dhe sigurinë ndërkombëtare, Këshilli i Sigurimit rekomandoi që të ndërpritej çdo formë dhune në Kosovë, të respektohej armëpushimi, të lehtësohej kthimi i refugjatëve në shtëpitë e veta dhe të

¹ Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, S/RES/1199(1998), 23 shtator 1998

² Karta e Kombeve të Bashkuara, Kapitulli VII, neni 39-42

³ Që lidhet me paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

⁴ Më hollësisht për të gjitha rezolutat :

<http://www.un.org/fr/sc/documents/resolutions/>

fillonte dialogu i mirëfilltë për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për problemin e Kosovës¹. Në këto rezoluta theksohet gatishmëria e Grupit të Kontaktit² për të lehtësuar dialogun. Përpos kësaj gatishmërie për të ndihmuar në gjetjen e një zgjidhjeje përmes dialogut, nuk duhet të harrohet se Karta e Kombeve të Bashkuara autorizon Këshillin e Sigurimit të ndërmarrë masa tjera nëse anëtarët e tij konstatojnë se masat e parashikuara nuk japin rezultatet e pritura. Në nenin 42 të kësaj Karte saktësohet: “Për ruajtjen apo rivendosjen e paqes botërore dhe të sigurisë ndërkombëtare mund të përdoren forcat e armatosura tokësore, ajrore dhe ujore.”

Në përputhje me këtë nen të Kapitullit të VII, përmes pikës 19 të rezolutës 1160 dhe të pikës 16 të rezolutës 1199, Këshilli i Sigurimit i OKB-së tërhoqi vërejtjen se “në mungesë të përparimit thelbësor drejt rregullimit të situatës në Kosovë do të shqyrtohet mundësia e marrjes së masave shtesë për të ruajtur apo rivendosur paqen dhe stabilitetin në regjion.”³

Edhe pse nuk jepeshin modalitetet e “masave shtesë”, Kapitulli i VII i Kartës qartësohte se kjo nënkuptonte përdorimin e “forcave të armatosura tokësore, ajrore dhe ujore.”

Siç e përmendëm edhe në kapitullin paraprak, më 30 janar 1999, Këshilli i NATO-s kishte dalë te përfundimi i njëjtë: “Krizë në Kosovë mbetet një rrezik për paqen dhe sigurinë në rajon.” Të njëjtën ditë ishte sjellë vendimi që në rast të sabotimit të gjetjes së një zgjidhjeje paqësore për konfliktin, pala që nuk do të respektojë angazhimet ndërkombëtare do t’i bartë pasojat. Në përputhje me zhvillimin eventual të situatës, Këshilli i NATO-s i dha kompetencat e plota “Sekretarit të Përgjithshëm që të autorizojë goditjet ajrore kundër caqeve në territorin e Jugosllavisë, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga pala e Beogradit, ndërsa, në

¹ Në rezolutë theksohet autonomia e zgjeruar dhe autonomia e vërtetë administrative për Kosovën.

² Federata Ruse, Franca, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar (Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut) Italia dhe SHBA-të,

³ S/RES/1160 (1998), 31 mars 1998 dhe S/RES/1199 (1998), 23 shtator 1998

rast të mosrespektimit të kushteve nga pala shqiptare e Kosovës, NATO-ja do të ndërmarrë masa adekuate kundër tyre.”¹

Përkundër asaj se analizat e hollësishme dëshmojnë në mënyrë të qartë se ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, nuk janë të paktë ata analistë që mbështeten në kriteret e analizave tradicionale juridike dhe në mungesë të një vendimi të qartë nga ana e Këshillit të Sigurimit për t’i autorizuar sulmet kundër Jugosllavisë, ata pretendojnë se kjo ndërhyrje nuk ishte e ligjshme.

Reagimet ndaj fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s ishin të menjëhershme. Shtetet anëtare të NATO-s, pjesëmarrëse në këto operacione, dolën me arsyetimet për domosdoshmërinë e ndërhyrjes ushtarake për të parandaluar katastrofën humanitare dhe realizimin e politikës së spastrimit etnik të Kosovës. Vendimin për sulmet ajrore e mbështetën një numër shtetesh si Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Shqipëria etj. Të gjitha shtetet që mbështesnin ndërhyrjen ushtarake këmbëngulin se ky vendim ishte në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Kapitullin VII të Kartës së OKB-së.

Nga ana tjetër, regjimi i Milošević-it i cilësoi sulmet e NATO-s si “agresion në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe me parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara.” Edhe Federata e Rosisë, Kina, India, Grupi i Rios², Grupi 77³ dhe një numër shtetesh të dala nga shpartallimi i Federatës Sovjetike shprehën haptazi kundërshtimet e tyre dhe kërkuan ndërprerjen e sulmeve kundër Jugosllavisë⁴.

¹ Déclaration du Conseil de l’Atlantique Nord sur le Kosovo, Communiqué de presse (99) 012, 30 janar 1999
<http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-012f.htm>

² Organizatë e disa shteteve të Amerikës Latine, krijuar në vitin 1986 për të lehtësuar bashkëpunimin mes tyre.

³ Grup i themeluar në vitin 1964 nga 77 shtete në kuadër të OKB-së. Sot ky grup numëron 132 shtete dhe shumica e tyre njohin pavarësinë e Kosovës.

⁴ Një përmbledhje e qëndrimeve të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare lidhur me këtë çështje mund ta gjeni në:
<http://iusadbellum.files.wordpress.com/2011/07/kosovo-1999.pdf>

Mobilizimi “kundër armikut të popujve: imperializmit amerikan dhe NATO-s”¹ nuk mungoi edhe në qarqet politike dhe mediatike të shteteve të Evropës perëndimore. Po përmend rastin e peticionit me moto: «Evropianët duan paqe»²

Sipas nënshkruesve të këtij peticioni “e mërkura e 24 marsit do të shënohet si një fatkeqësi në historinë tonë: që nga viti 1945, për herë të parë u bombardua një shtet sovran nga një aleancë ushtarake, nën komandën amerikane. Kjo paraqet një përbuzje të plotë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe shkelje flagrante e Kartës së OKB-së. Agresioni i NATO-s është i papranueshëm”³ për këta evropianë!

Ata që nga njëra anë deklarohen se janë kundër luftës, kundër agresionit dhe kundër dhunës nuk thanë asnjë fjalë për luftën dhe agresionin e Serbisë kundër popullit shqiptar të Kosovës, heshtën tërësisht mbi dhunën dhe spastrimin etnik që aplikonte regjimi i Milošević-it kundër shqiptarëve të Kosovës⁴. Heshtje e plotë për vrasjet e shqiptarëve, për dhunimet, për spastrimin etnik!

“Evropianët e majtë” të tipit si Max Gallo-ja e Gisèle Halimi, Bruno Etienne-i e Yves Vargas-i, së bashku me personalitetet e të Djathtës së Re të Alain de Bonoist-it, Guillaume Faye-së dhe intelektual të tjerë, të majtë e të djathtë, që kishin në qendër të preokupimit të tyre “një Evropë tërësisht të pavarur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të çliruar nga NATO-ja, që nuk është gjë tjetër pos instrument i imperializmit dhe hegjemonisë amerikane”⁵ nuk heshtën vetëm për një gjë: “t’u bëjnë thirrje evropianëve që ta shprehin refuzimin e luftës amerikane në Evropë dhe të solidarizohen me popullsinë civile që bombardojë.”⁶

¹ <http://www.oniros.fr/contrelempire.html> dhe <http://club-acacia.over-blog.com/15-categorie-10951540.html>

² Peticion i organizuar nga Collectif français Non à la gurre (Kolektivi francez JO luftës!)

<http://www.doorbraak.eu/gebladerte/30159v01.htm>

³ Jean Jacob, *Le retour de l'ordre nouveau*, Librairie Droz, Genève, 2000, f.270

⁴ Po aty

⁵ VOXNR, «Guillaume Faye sur le grill»

http://www.voxnr.com/cc/d_entretiens/EpFkFlAyllFfNPrnDB.shtml

⁶ Po aty

Siç do të shohim në vijim të këtij kapitulli, «anti-amerikanizmi», si verbërim ideologjik, i vuri në një front të përbashkët, Serge Halimi-n, Bernard Lugan-in, Dominique Vidal-in, Dominique Venner-in, Gisèle Halimi-n, Régis Debray-në, Jean Marie Le Pen-in, Max Gallo-n, Bruno Mégret-in, Jean-Arnault Dérens-in, Xavier Raufer-in, Andrea Grosse-in, Peirre Péan-in, Philippe Conrad-in, Jürgen Elsässer-in, Udo Voigt-in, Michel Collon-in, Hervé Van Laethem-in dhe një numër të konsiderueshëm komunistësh, socialistësh, social demokratësh, të djathtës së vjetër e të re, neonazistë dhe neofashistë, historianë e politologë, filozofë e sociologë, gazetarë e publicist, të orientimit të djathtë e të majtë për ta “mbrojtur Evropën nga imperializmi amerikan.”

Madje, fillimi i bombardimeve nuk do t'i lë “neutral” as politikanët e Zvicrës që njihet si «shtet neutral». Homologu i Jean-Marie Lepen-it në këtë shtet, Christophe Blocher-i, në intervistën për gazetën «SonntagsZeitung», i cilësoi bombardimet kundër Serbisë si “një katastrofë. NATO-ja është duke bërë luftën si të ishte lojë informatike... NATO-ja është sinonim i SHBA-ve. Nuk ma ka marrë mendja se pas Vietnamit, SHBA-të do të lejojnë që në mënyrë naive të futen në një luftë¹. Ndërkaq, politikani i Partisë Radikale Demokratike zvicerane, Dick Marty, së bashku me 19 deputet të parlamentit zviceran, i rekomanduan Këshillit Federal të Zvicrës “masat që synonin t'i jepnin fund luftës në Kosovë.”²

Në këto rekomandime kërkohej nga institucioni më i lartë qeverisës i vendit të tyre që të bëjë çdo gjë që ishte e mundur për të ardhur deri te një “armëpushim mes palëve, të vendosej një trupë neutrale për të ruajtur paqen dhe të përgatitej terreni për zgjidhje politike.”³

¹ Blocher.ch, «Interview dans SonntagsZeitung, më 4 prill 1999»
<http://www.blocher.ch/artikel/l-aide-humanitaire-c-est-non-armee-qu-il-faut-l-apporter.html>

² L'Assemblée fédérale- le Parlement suisse
Mesures visant à mettre fin à la guerre au Kosovo 21.04.1999, Recommandation 99.3171
(masat që synojnë t'i japin fund luftës në Kosovë, Rekomandimi 99.3171, deponuar nga Dick Marty
http://www.parlament.ch/f/suche/pages/geschaefte.aspx?gesch_id=19993171

³ Po aty

Politikani që asnjëherë nuk e kishte ngritur zërin për të kërkuar ndërprerjen e fushatës ushtarake dhe policore serbe në Kosovë, fushatë që pati si pasojë mijëra të vrarë dhe qindra mijëra shqiptarë të dëbuar¹, e çori gurmazin duke kërkuar që të ndërpriten bombardimet kundër caqeve të ushtrisë dhe policisë serbe!

Demokrati radikal zviceran, Dick Marty, i cili në asnjë rast nuk përmend se Misioni Verifikues i OSBE-së në Kosovë ishte mision i pjesëtarëve të paarmatosur që duhej të mbikëqyrnin, ndër të tjera, edhe respektimin e armëpushimit të realizuar më 13 tetor 1998 e që dështoi për shkak të vazhdimit të politikës luftënxitëse të regjimit të Beogradit, rekomandon në mënyrë “radikale” armëpushim dhe vendosje të “trupave neutrale” për t’u kujdesur për respektimin e një armëpushimi të propozuar prej tij!

Nëse e kemi parasysh se shumica e shteteve të demokracive perëndimore ishin të angazhuara në operacionet e NATO-s, atëherë mbetet e paqartë se me forcat e cilit vend do të krijoheshin “trupat neutrale” të Dick Marty-t! Forcat ruse, bjelloruse, kineze, indiane apo të ndonjë vendi tjetër që dënonte sulmet e NATO-s? Nëse një gjë e tillë lihet e paqartë nga Dick Marty, ai është tepër i qartë se në “trupat neutrale” nuk mund të ishin forcat e shteteve që kishin sulmuar Serbinë, sidomos nuk mund të ishin amerikanët! Dick Marty është i mendimit se “ushtritë e komanduara nga NATO-ja bombarduan Serbinë dhe se ky ishte një agresion ilegal, pa miratimin e OKB-së.”²

Rekomandimi “për përgatitjen e terrenit për një zgjidhje politike” nuk dallon për asgjë nga rekomandimet e regjimit të Milošević-it për të “ndërprerë agresionin dhe për të gjetur një zgjidhje politike.”³

Në mënyrë të njëjtë si propaganda zyrtare e Beogradit, edhe rekomandimi i hartuar nga Dick Marty la në heshtje të plotë angazhimet diplomatike të shteteve të Bashkimit Evropian dhe të

¹ Një numër shumë i madh i tyre kishin kërkuar strehim në Zvicër.

² Réseau Voltaire, Dick Marty: «L'indépendance du Kosovo n'apasété décidée à Pristina», entretien avec Silvia Cattori
<http://www.voltairenet.org/article155903.html>

³ Qëndrim që u citua në kapitullin paraprak

SHBA-ve për të përmbyllur konfliktin me një zgjidhje politike. Nuk u përmendën asnjëherë propozimet e Grupit të Kontaktit, as Konferenca në Rambuje dhe Paris dhe as dështimi i tyre për shkak të strategjisë së Milošević-it që të provokohej lufta.

Pozicioni i Dick Marty-t ishte i qartë! Në të njëjtën shkallë sa edhe “neutraliteti” i tij!

Për të denoncuar “agresionin ilegal kundër Serbisë, pa miratimin e OKB-së”, Dick Marty ishte tepër i zëshëm! Por, kur ai i rekomandon Këshillit Federal të Zvicrës që të bëjë çdo gjë që ishte e mundur për të ardhur deri te një “armëpushim në mes palëve, të vendoset një trupë neutrale për të ruajtur paqen dhe të përgatisë terrenin për një zgjidhje politike”, Dick Marty as që përmend OKB-në. Sipas kësaj logjike, anashkalimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të ndërprerë bombardimet kundër regjimit të Milošević-it nuk ishte ilegal!

Me qëndrime të njëjta kundër sulmeve ajrore të NATO-s u shfaq publikisht edhe shkrimtari dhe filozofi francez, Régis Debray-ja.

Përmes shkrimit publik «Letër e një udhëtari Presidentit të Republikës»¹ ai kërkoi haptazi nga Presidenti i Francës, Jacques Chirac-u, që të rishikonte pjesëmarrjen e Francës në luftën e “padrejtë” kundër Jugosllavisë, sepse kjo ishte një formë e “nënshtrimit ushtarak dhe politik të Evropës Perëndimore karshi SHBA-ve.”²

Për të argumentuar qëndrimin se lufta kundër Jugosllavisë ishte një “manipulim i amerikanëve”, Régis Debray-ja, sjell pohimet e “opozitarëve të regjimit” se gjoja “z. Milošević nuk ishte diktator” sepse “ishte zgjedhur tri herë, përderisa diktatorët zgjidhen vetëm një herë (...) se ai e respekton Kushtetutën Jugosllave (...) se Jugosllavia nuk është shtet njëpartiak (...) se në këtë shtet nuk ka të burgosur politikë (...) se ai është tolerant dhe mund ta kritikojmë në një tarracë kafeneje, pa u fshehur (...)”³ e kështu me radhë.

¹ Le monde, Régis Debray, «Lettre d'un voyageur au président de la République», 13 maj 1999. Të gjitha citimet e mëposhtme janë nxjerrë nga kjo letër.

² Të gjitha citimet e mëposhtme të Régis Debray -së janë nxjerrë nga kjo letër

³ Le monde, Régis Debray, artikulli i cituar «Lettre ...»

Regis Debray-ja kërkon që të mos e marrim si të “njëanshëm” në këtë konflikt, sepse ai “bazohet në fakte.” Ai vetë ka qëndruar në Serbi, Kosovë dhe Maqedoni dhe “për të shmangur mundësinë e manipulimit nga përkthyesit që simpatizonin UÇK-në në Maqedoni dhe në Shqipëri”¹, Regis Debray-ja “kërkoj nga pushteti serb që të ketë përkthyesin e vet, veturën e vet dhe mundësinë të shkojë të bisedojë me ata që dëshiron. Pushteti serb e respektoi këtë kontratë”² - pohon ai.

Edhe pse në këtë letër ai nuk përmend se cili i ishte përkthyesi i tij dhe si e siguroi veturën për të vizituar vendet që “dëshironte”, Regis Debray-ja këmbëngul që të mos e konsiderojmë si të “njëanshëm”. Faktet që sjell për publikun përmes letrës së adresuar Presidentit të Republikës franceze ai i bazon në thëniet e dy “dëshmitarëve perëndimorë”. Dëshmitari i parë është “Aleksandar Mitić-i, i cili në të vërtetë ishte me origjinë serbe, por, ai ishte korrespondent i AFP-së dhe properëndimor”³ përpiqet të na bindë Debray-ja. Ndërsa, dëshmitari i dytë është kanadezi anglofon, Paul Waston-it, korrespondenti i «Los Angeles Times»-it për Evropën Qendrore. Sipas Regis Debray-së, “për këtë gazetar mund të thuhej se ishte më shumë antiserb, se e kishte përcjellë luftën civile në Kosovë dhe e njihte çdo fshat dhe çdo rrugë të saj. Kur ditën e parë të bombardimeve gazetarët e huaj u dëbuan nga Prishtina, ai u fsheh dhe qëndroi anonim, pa u ndalur së qarkulluari.”⁴

Pra, burimet e informatave vijnë nga një “serb properëndimor” dhe nga një “perëndimor antiserb”! Regis Debray-ja dëshiron të na bindë se ky “kombinim” i mundësoi të vijë deri te “informatat objektive” dhe të mos jetë i “njëanshëm”! Një gazetar kanadez “antiserb” që paska qëndruar “anonim” gjatë luftës në Kosovë, pa lejen e pushtetit të Milošević-it (!) dhe që së bashku me një gazetar serb “properëndimor” “rastësisht” takohen me Regis

¹ Po aty

² Po aty

³ Po aty

⁴ Po aty

Debray-në për ta informuar “objektivisht” për atë që ndodhte në Kosovë! E çuditshme! Më duket dinjitoze për skenarin e një episodi të ri të serisë televizive «Mission Impossible». Jo, gabova! «Mission Impossible» është seri amerikane dhe Regis Debray-së nuk i pëlqejnë “produktet e imperializmit amerikane”. Konteksti që ai përshkruan dhe dëshira për të na bindur se regjimi i Beogradit e kishte “respektuar” kontratën që këtë intelektual francez ta lërë të lirë të shkojë “të bisedojë me kë të dëshiroj” është shumë më i përshtatshëm me natyrën e filmit të njohur francez: «Le Dîner de cons»¹

Sipas skenarit të këtij filmi, një botues i famshëm i Parisit (Pierre Brochant) çdo të mërkurë organizonte «Darkën e imbecilëve», ku njëri nga miqtë ftonte ndonjë “budalla” që takonte rastësisht dhe ky person bëhej objekt i talljes gjatë darkës. I ftuari nuk e dinte lojën që i ishte kurdisur dhe gjatë tërë kohës besonte se nikoqiri e respektonte “kontratën e ftesës”

Një digresion i qëllimshëm.

Duke pasur si model Shërbimin Sekret Rus (ÇEKA-n), Partia Komuniste e Jugosllavisë themeloi, më 13 maj 1944, Shërbimin Sekret të emërtuar OZNA (Odseka za Zaštitu Naroda - sektori për mbrojtjen e popullit). Që nga themelimi i tij e deri në ditët e sotme ky shërbim ka ndërruar disa herë emër, që në kontekstet e ndryshme historike të “heqë” nga vetja bagazhin e krimeve të përbindshme në të cilat ishte i përfshirë. Përkundër ndryshimit të emrit, një gjë mbeti konstante: më 13 maj të çdo viti, Shërbimi Sekret Jugosllav kremtonte festën e themelimit të vet! Gjithmonë, një natë para festës, ata shtronin darkat për “mysafirët” e tyre për t’i paraprirë festës së 13 majit. Viti 1999 ishte viti i sulmeve ajrore kundër aparateve represive të regjimit të Beogradit. Në këtë vit 13 maji ishte ditë e enjte.

Nuk mund ta di nëse Regis Debray-ja ishte i ftuar nga Shërbimi Sekret Serb në darkën e të mërkurës së 12 majit. Këtë e di më së miri ai vetë! Ajo që shihet nga letra e tij e 13 majit, del qartë

¹ Sipas Larousse, fjala «con» ka kuptimin e budallait, imbecilit, idiotit. Po e përkthej titullin «Darka e imbecilëve» për arsye që do t’i them më poshtë.

se, në rast se ka marrë pjesë në një darkë të tillë, ai nuk ka mundur të luajë rolin e François Pignon-it¹. Aspektet që shtrohen në këtë letër publike do të trajtohen më poshtë dhe shpresoj që lexuesi do të ketë mundësi të shohë “anshmërinë” apo “paanshmërinë” e Regis Debray-së sa i përket luftës së Kosovës.

Tani për tani po theksoj se publikimi i kësaj letre, më 13 maj 1999, ngjalli reagime të shumë intelektualëve në Francë. Këto reagime ishin tregues se fusha politike, mediatike dhe intelektuale ishte e mobilizuar rreth kësaj lufte. Sa për ilustrim të kësaj dinamike konfrontim idesh dhe qëndrimesh, më duket domethënëse të sjell për lexuesin shembullin kur dy gazeta të ndërmarrjes së njëjtë botuese patën qëndrime diametralisht të kundërta rreth ndërhyrjes ushtarake të NATO-s. Fjala është për të përditshmen, «Le monde»-in dhe të përmuajshmen, «Le monde diplomatique»-un.

Politologu dhe gazetari francez Serge Halimi², në një intervistë ekskluzive për revistën «Syndikat»³, shpjegon se këto dy gazeta “i përkasin të njëjtës ndërmarrjes botuese, por redaksitë janë të pavarura e s’kanë lidhje njëra me tjetrën. Kështu, para dhjetë vjetësh, *Le monde*-i ishte pro luftës në Gjirin Persik, ndërsa *Le monde diplomatique*-u ishte kundër. E njëjta gjë ndodhi edhe me luftën e Kosovës, *Le monde*-i ishte për këtë luftë ndërsa *Le monde diplomatique*-u kundër. Ka shumë pak operacione të shteteve perëndimore, që udhëhiqen nga amerikanët, e që *Le monde*-i t’i ketë kundërshtuar dhe ka shumë pak operacione të shteteve perëndimore, që udhëhiqen nga amerikanët, e që *Le monde diplomatique*-u t’i ketë përkrahur. Ky dallim analizash në mes të dy botimeve është bërë i zakonshëm.”⁴

Sado i “zakonshëm” të jetë “ndryshimi i analizave”, ky rast dëshmon se deri në cilën shkallë janë të lidhura qëndrimet që botohen në një gazetë me qëndrimet individuale të anëtarëve të

¹ Rolin e naivit! Shpresoj se aluzioni është i qartë, së paku për lexuesin që e ka parë filmin e lartpërmendur.

² Politolog, anëtar i redaksisë së të përmuajshmes *Le monde diplomatique* që nga viti 1992 dhe kryeredaktor i saj që nga viti 2008.

³ Serge Halimi, «Entretien avec la revue Syndikat», octobre 2000 në:
[http://www.homme-](http://www.homme-moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html)

[moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html](http://www.homme-moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html)

⁴ Po aty

redaksive të caktuara. Me një fjalë, realiteti objektiv duhet të futet në kornizën ideologjike të anëtarëve të redaksisë dhe në përputhje me këtë kornizë “realiteti i tyre” të pasqyrohet si realitet “i vetëm”. Sidomos, t’u prezantohet si i tillë lexuesve që krijojnë opinionet e veta duke u mbështetur ekskluzivisht në “analiza gazetash”.

Nuk është e rastësishme që korniza ideologjike përcakton prezantimin e natyrës së një lufte. “Për ta cilësuar nëse është progresive apo reaksionare një luftë kërkohet që të mos kufizohemi në mizoritë e çastit, që janë të pranishme në të gjitha luftërat, por të bëhet analizë se kush qëndron pas saj, cilat janë qëllimet dhe çfarë roli ndërkombëtar kanë shtetet pjesëmarrëse në luftë.”¹

Sipas kësaj kornize ideologjike, përderisa në krye të këtij aksioni të Aleancës Perëndimore qëndrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të merren me rezerva të gjitha “mizoritë e çastit” që sjellin mediat për civilët e vrarë shqiptarë, vendbanimet e djegura në Kosovë, kolonat e të dëbuarve ...

Serge Halimi është mendimit se “kriza e Kosovës i dha rastin NATO-s për t’u vendosur në Evropë dhe për ta futur OKB-në nën tutelën e saj.”² Sipas tij, për të arritur deri te një qëllim i tillë, manipulimi mediatic ishte i domosdoshëm. Prandaj ai revoltohet kundër mediave të orientuara politikisht, kundër propagandës që synon t’i drejtojë njerëzit drejt “një kampi” të caktuar dhe në veçanti kundër imazheve televizive, të cilat i emërton “uzinë të emocioneve të manipuluar.”³

Me një fjalë, në rastin e Kosovës ai sheh një manipulim të opinionit publik në funksion të mbështetjes së aksionit ushtarak për dominim të SHBA-ve. Për më tepër, Serge Halimi nuk kufizohet vetëm në konstatimin se gjoja opinionit publik kishte qenë i manipuluar. Ai, me “njohuritë” që ka, tregon edhe arsyet pse ndodh një gjë e tillë!

¹ World Socialist Web Site

http://www.wsws.org/francais/News/1999/mai99/24mai_ciqiotan.shtml

² Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3)

http://www.dailymotion.com/video/x4crrr_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

³ Po aty

Sipas tij, faji kryesor për këtë situatë është i gazetarëve, të cilët “nuk kanë bagazhin e nevojshëm për t’u informuar dhe për shkak të mungesës së specialistëve që kanë vizion global dhe transversal të një problemi.”¹

Këto dy aspekte patën si pasojë “mungesën e kulturës në përgjithësi” dhe kjo mungesë kulture lehtëson manipulimin e vazhdueshëm të njerëzve, sepse “opinionit përpunohet gjithmonë”. Që të shmanget ky manipulim, Serge Halimi kërkon që të ndërpritet trajtimi i njerëzve si të ishin “kope e lobotomizuar nga propaganda dhe e përgjumur nga imazhet e televizionit, të kësaj uzine që manipulon me emocionet.”² Pra, duhet që «produksionit mediatik» t’i qasemi me një këndvështrim tjetër. Edhe në këtë rast, Serge Halimi ka “çelësin e zgjidhjes”: mosbesimi total ndaj «produksionit mediatik».

“Mendoj se disa nga ne nisen nga postulati se puna e mediave është të informojë. Unë, gjithnjë e më shumë mendoj se nuk kemi të bëjmë me një gjë të tillë. Kur lexoj çka prodhojnë mediat, nuk e bëj për t’u informuar. Por, për t’u informuar rreth dezinformative.”³ - sqaron Serge Halimi, gazetari i dikurshëm i «Le monde diplomatique »-ut dhe drejtori aktual i saj.

Për të “përpunuar opinionin” sipas shijes së vet, ky gazetar zhvesh teknikën se si “përpunohet opinionin” nga të tjerët dhe tregon se në grackën e sajimeve të tilla mediatike mund të bien edhe njerëz të “kalibrit të tij” e lëre më ata që kanë “mungesë kulture të përgjithshme”, apo që “nuk kanë bagazhin e nevojshëm”!

“Është e qartë se kur ju thonë se ky popull këtu është duke përjetuar një gjenocid, ju nuk mund të mendoni shumë gjatë. Ju jeni të detyruar ta pranoni për të vërtetë. E imagjinoj se një numër nga mesi ynë janë të bindur për këtë çështje”- thekson Halimi. “Unë, kur i shihja imazhet, i thosha vetes se gjendja është shqetësuese dhe se ndoshta do të duhet të veprohet. Por, kjo nuk më

¹ Po aty

² Po aty

³ Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (3/3)
http://www.dailymotion.com/video/x4crvk_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

zgjati shumë sepse kisha edukim politik dhe njohuri për SHBA-të që më mundësonin të mos besoj shumë në angazhimet kryesisht humanitare të SHBA-ve.”¹

Sipas të gjithë autorëve të ndikuar nga «këndvështrimi ideologjik antiamerikan», pa marrë parasysh orientimet politike, ajo që është e rëndësishme dhe përcaktuese për të mbajtur qëndrim “të drejtë” ndaj luftës në Kosovë lidhet me pozicionin e amerikanëve në këtë luftë! Dhe ku implikohen amerikanët, gjërat janë “të dyshimta” dhe duhet të jemi “shumë të kujdesshëm”! “Edukimi politik” dhe “njohuritë” e Serge Halimi-t detyrojnë vigjilencë ideologjike! Për këtë arsye, edhe redaksia e «Le monde diplomatique»-ut nuk e përkrahu luftën e Kosovës. Për të vetmen arsye se në ballë të aksionit të NATO-s qëndronin amerikanët, politologu dhe gazetari francez, Serge Halimi, hedh dyshime për “mizoritë e çastit në Kosovë” dhe për qëndrimet e tilla kërkon që të mos e cilësojmë se mban anën e Milošević-it.

Edhe në rastet kur qëndrimet janë identike me qëndrimet e propagandës së regjimit të Beogradit, krahasimi me Milošević-in, sipas Serge Halimit, është krahasim “imbecil, totalitar dhe një formë staliniste e të menduarit. Sepse në këtë mënyrë përcaktohen të mirët dhe të këqijtë.”²

Por, kur ai i përcakton si “të këqij” ata që rreshtohen përkrah amerikanëve, qoftë personalitete apo forca politike të orientimit politik të djathtë, qoftë ata të orientimit të majtë, kjo nuk duhet të cilësohet as si “imbecile” e as si “formë staliniste e të menduarit.” “Amerikanët përzihen në punët e evropianëve dhe dëshirojnë të jenë përgjegjës të sigurisë në Evropë.”³ Prandaj janë të “këqijtë”! Dhe të gjithë ata që shkojnë “pas të keqit nuk janë të mirë. Meqë nuk janë të

¹ Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (2/3), minuta prej 14:35-15:32
http://www.dailymotion.com/video/x4crvk_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

² Serge Halimi, intervista e cituar «Entretien avec la revue Syndikat»
Shpresoj se lexuesi e kupton arsyen pse filmin «Le Dîner de cons» e përktheva si darka e imbecilëve.

³ Po aty

mirë ata janë të këqij. Jo vetëm që janë të këqij, por janë tmerrësisht të këqij”¹ - përfundon Serge Halimi. Logjikë cirkulare!

Pra, Serge Halimi kërkon që këtë skemë interpretimi të kornizës së lartpërmendur ideologjike ta ruajmë ekskluzivisht për “amerikanët e këqij” dhe ata që mbështesin aksionet e tyre, e “që nuk janë të mirë.”

Pas shpërbërjes së Paktit të Varshavës rendin e kishte shpërbërja e NATO-s. Por, “lufta e Kosovës i dha legjitimitetin e duhur këtij instrumenti amerikan dhe nën mbulesën humanitare u gjet arsytimi i duhur për ta vazhduar ekzistencën e saj.”²- vazhdon argumentimin e vet Serge Halimi.

Sipas kësaj kornize ideologjike, lufta në Kosovë u bë për interesat amerikane dhe si e tillë ajo ishte luftë e keqe. Viktima e kësaj lufte nuk ishin shqiptarët e Kosovës, por regjimi i Milošević-it që i “rezistonte dominimit amerikan”! Pos kësaj, “një viktimë tjetër e kësaj lufte ishte informacioni”³ sepse mediat dezinformonin në interes të atyre që kishin pushtetin në duart e tyre - vëren Serge Halimi. Lidhur me dezinformimin, ai sjell shembullin e motiveve të luftës. “Na është thënë se Jugosllavia kishte refuzuar të nënshkruajë marrëveshjen në Rambuje, se kishte kryer gjenocid apo një plan spastrimi etnik. Na është thënë se perëndimorët dëshironin të ndërhynin për çështje humanitare. Këto arsye ishin të pavërteta. Në Rambuje nuk ka pasur marrëveshje por ultimatum kundër Jugosllavisë. Ultimatum të tillë që ishin të sigurt se ajo do ta refuzonte dhe kështu do t’i ofrohej NATO-s preteksti për ndërhyrjen e saj.”⁴ Ai pohon se “secili e di ose së paku duhet ta di që se humanizmi nuk është motivi parësor i politikës së jashtme amerikane. «Ndërhyrja humanitare» është vetëm një mbulesë për të fshehur qëllimin e vërtetë: dominimin në Evropë! Gjithashtu e dimë se nuk ka pasur gjenocid. Ka pasur masakra që mund t’i numërojmë, po që nuk përngajnë me gjenocidin. E dimë gjith-

¹ Po aty

² Po aty

³ Serge Halimi, emisioni i cituar, «Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3)»

⁴ Po aty

ashtu se Plani «Patkoi» që ishte prezantuar dy herë si lajm kryesor në gazetën «Le monde», ishte i rrejshëm!”¹

Këto ishin përfundimet e këtij “analisti kritik” që aq shumë “shqetësohej” për informacionin objektiv dhe të cilin “edukimi politik dhe njohuritë” e kishin bërë “vigjilent” dhe “të aftë” të dallojë “dezinformatat e atyre që duan të dominojnë në Evropë”!

Të njëjtin qëndrim për dështimin e kësaj Konference Ndërkombëtare dhe për Planin «Patkoi» shprehu edhe anëtarja e Këshillit shkencor të «Attac-France», Catherine Samary-ja, në “analizën” e vet të titulluar: « Kosova: disa gënjeshttra të pseudo luftës humanitare»², Jürgen Elsässer-i, në veprën e tij «Republika Federale e Gjermanisë në luftën e Kosovës: Kronika e një manipulimi»³, Michel Collon-i në veprën «Monopoly- NATO-ja në pushtimin e botës»⁴ dhe shumë autorë të tjerë që “nuk i besojnë ndërhyrjes humanitare” në Kosovë.

Diktatori serb dhe instrumentet propagandistike të Beogradit trumbetonin pa ndërprerë se “kjo luftë u bë për shkak të urrejtjes personale që kishte perëndimi ndaj Milošević-it, sepse ai ishte pengesë për shtrirjen e influencës së tyre në këtë pjesë të Ballkanit.”⁵

Edhe në analizat e shumta në shtetet perëndimore nuk mungoi interpretimi i ngjashëm i sulmeve të NATO-s si të ishin të motivuara nga kjo “urrejtje” ndaj atij që i “rezistonte dominimit amerikan”⁶! “Me sa duket perëndimin e mundon Milošević-i një-

¹ Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3), http://www.dailymotion.com/video/x4crrr_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news dhe

<http://www.homme-moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html>

² Atac France, Cathrine Samary, «Kosovo 1999-2009: Quelques mensonges de la pseudo guerre humanitaire»

<http://france.attac.org/archives/spip.php?article9880>

³ Jürgen Elsässer, vepra e cituar, «La RFA dans...»

⁴ Michel Collon, vepra e cituar, «Monopoly - l'OTAN ...»

⁵ Shih Prologun e këtij kapitulli

⁶ Radio Courtoisie. Emission du «Libre Journal de Serge de Beketch», 07.04.1999, «Le vol du Kosovo. Avec Bernard Lugan, Dominique Venner et Philippe Conrad»

<http://www.ekouter.net/le-vol-du-kosovo-avec-bernard-lugan-dominique-venner-et-philippe-conrad-sur-radio-courtoisie-253>

qind herë më shumë se sa qytetarët e vet!”- përfundoi Regis Debray-ja në letrën e tij drejtuar Presidentit francez.

Debatet rreth legalitetit apo ilegalitetit të këtyre sulmeve nuk e kanë humbur aktualitetin edhe 15 vjet pas këtyre ngjarjeve. Mjafton t’u hidhet një sy revistave që publikojnë shkrime nga e drejta ndërkombëtare apo të shihen publikimet lidhur me këtë çështje për t’u bindur për hapësirën e madhe që zë kjo temë. Mjafton të lexohen disa nga analizat rreth legalitetit të sulmeve të NATO-s dhe lexuesi do të bindet për faktin se pikëpamjet juridike, filozofike dhe sidomos ideologjike të autorëve kushtëzojnë në një masë të madhe edhe formën e konkluzioneve. Nuk do të zgjatëm rreth këtij debati, sepse në fund do të arrijmë te i njëjti përfundim: Qëndrime diametralisht të kundërta në mes atyre që këtë ndërhyrje e shohin në funksion të “dominimit amerikan të Evropës dhe botës” dhe atyre që në këtë ndërhyrje ushtarake shohin shpëtimin e shqiptarëve të Kosovës nga politika e gjenocidit që aplikoi regjimi i Milošević-it.

EPILOGU I KAPITULLIT TË KATËRT

«Edhe unë gjithashtu ndihem shqiptar»

- Vaclav Havel

Në përmbyllje të çështjes së legalitetit apo ilegalitetit të ndërhyrjes së NATO-s kundër Jugosllavisë së Slobodan Milošević-it po citoj një pjesë të pikëpamjeve të Vaclav Havel-it¹, të botuara në gazetën «Republika» dhe «Le monde» të datës 29 prill 1999².

“Kam marrë shumë letra nga aktorë serbë që kanë vënë në skenë pjesët e mia teatrale dhe që më vlerësojnë shumë.”- deklaroi Havel-i. “Më pyesin se ç’të keqe kanë bërë ata që të bombardohen në këtë mënyrë? Natyrisht mua nuk më kanë bërë asgjë të keqe. Por, regjimi i tyre i përdor ushtarët për të masakruar qytetarët e vendit të vet, për të masakruar një grup shumë të madh të bashkëvendësve të tyre (...) Milošević-i i ka duart e përgjakura dhe nuk mund të vazhdojë të jetë bashkëbisedues për gjetjen e një zgjidhjeje politike (...)

Në përputhje me parimin që rrjedh nga solidariteti njerëzor e që i tejkalon kufijtë e shteteve, të regjioneve (...) atë që ky regjim po u bën shqiptarëve është njëlloj sikur të ma bënte mua”- deklaroi ai në këtë intervistë. Vetëm në kontekst të solidaritetit me viktimat e dhunës së regjimit të Milošević-it duhet të shihet deklarimi i Vaclav Havel-it: «Edhe unë gjithashtu ndihem shqiptar»!

“Mendoj se në ndërhyrja e NATO-s ka një gjë që askush nuk mund ta kundërshtojnë: sulmet dhe bombat nuk janë të nxitura nga ndonjë interes material. Karakteri i tyre është ekskluzivisht hu-

¹ Dramaturgu, eseisti dhe politikani çek, i cili qëndroi në krye të shtetit të Çekosllovakisë në periudhën 1989-1992 dhe pas ndarjes së këtij shteti në dy shtetet pavarura ai qëndroi në krye të Republikës së Çekisë në periudhën 1993-2003.

² Le monde.fr, Edition abonné, «Vaclav Havel: "Moi aussi je me sens albanais"» (artikull me pagesë) http://www.lemonde.fr/cgi-bin/ACHATS/acheter.cgi?offre=ARCHIVES&type_item=ART_ARCH_30J&objet_id=20689 dhe «Vaclav Havel: "Moi aussi je me sens albanais"» <http://fr.groups.yahoo.com/neo/groups/Forum-socialiste/conversations/topics/484>

manitar. Këtu kemi të bëjmë me të drejtat e njeriut, që janë prioritet. Dhe këto të drejta qëndrojnë më lart se sovraniteti i shteteve. Ja çka e bën të ligjshme sulmin kundër Federatës Jugosllave, edhe pse nuk e ka mandatin e Kombeve të Bashkuara.”¹ - përfundon qëndrimin e vet Vaclav Havel-i.

¹ Po aty

KAPITULLI I PESTË

PROLOGU I KAPITULLIT TË PESTË

Ujku në lëkurën e qengjit!

“Në Serbi shtypi i lirë dhe i pavarur ishte në nivelin më të lartë. Nuk mbetej ditë që unë dhe familja ime të mos sulmoheshim publikisht. Shpifje nga më të ndryshmet. Askush nuk përgjigjej për fjalën e thënë. Në Serbi nuk kishte të burgosur politikë... Liria e organizimit ishte e plotë.

Nga e njëjta kuzhinë ku u sajua gënjeshtria e Reçakut u sajuan edhe gënjeshttrat e tjera për të arsyetuar ndërhyrjen ushtarake dhe agresionin kundër vendit tonë. U sajua i ashtuquajturi plan i spastrimit etnik me emrin «Patkoi», që nuk ka ekzistuar as si ide e lëre më si projekt (...) Për askënd nuk ishte e fshehtë se në Kosovë kishte më pak se një milion shqiptarë, sepse qindra mijëra shqiptarë kishin shkuar në vendet e huaja (...) Operacioni «Patkoi» ishte fabrikim i Ministrisë së Mbrojtjes Gjermane... ishte propagandë luftime!

Për ta bërë më të besueshme gënjeshttrën për planin e spastrimit etnik të Kosovës, aeroplanët e NATO-s hidhnin letra në gjuhën shqipe, me të cilat udhëzoheshin shqiptarët të braktisnin Kosovën. Ndërsa UÇK-ja, si aleate e tyre, bënte të njëjtën gjë dhe i vriste ata që rezistonin (...).

Në traditën e ushtrisë serbe, robërit e luftës dhe njerëzit e paarmatosur janë të shenjtë! Edhe zogjtë e pyllit e dinë se ka pasur një urdhër që njësi tona ushtarake dhe policore ua ndalonte të hapnin zjarr aty ku mund të rrezikoheshin qytetarët (...) Secili që e ka thyer këtë shenjtëri duhej të përgjigjej, por atë nuk e ka bërë as ushtria, as policia. Me këtë nuk them se diçka të tillë nuk kanë bërë disa individë ose grupe, por, atë gjë nuk e ka bërë as ushtria, as policia.

UÇK-ja e ka ditur se policia dhe ushtria jonë nuk do të shtjerë ndaj civilëve, prandaj i kanë marrë fshatarët e fshatrave të tëra

që t'i kishin si mburojë për të dalë në Shqipëri, në Maqedoni ose në Mal të Zi. Pas kësaj, kolonat e të ikurve, shqiptarë që donin të ktheheshin në fshatrat e tyre, u bombarduan nga NATO-ja. Kjo ishte porosi e qartë se duhej zbatuar urdhri për ta lëshuar Kosovën (...).

Ata që sajuan gënjeshttrat e lartpërmendura sajuan edhe Kampin e Stankovec-it në kufirin jugosllavo-maqedonas. Në këtë vend ishin tubuar 30 mijë shqiptarë nga Maqedonia, që t'ua paraqitnin diplomatëve të huaj sikur ishin të dëbuar nga Kosova. Por, kur këta diplomatë naivë erdhën të nesërmen t'i vizitonin të dëbuarit, kampi nuk ekzistonte më, sepse i kishin lëshuar të shkonin nëpër shtëpitë e tyre.

Po e përsëris se në Kosovë nuk ka pasur as katastrofë humanitare e as dëbime të shqiptarëve. Të dyja u provokuan nga bombardimet e NATO-s.

Slobodan Milošević¹

Mbes me shpresë se në fund të kapitullit lexuesi do të ketë mundësi të vlerësojë se deri në cilat përmasa kishte ndikuar propaganda e regjimit të Beogradit e deri në cilën masë u shkonin për shtat “informatat” e shpërndara falas nga Ministria e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë gazetarëve, filozofëve, sociologëve, politologëve, politikanëve, analistëve e historianëve që kishin “një edukim politik” të veçantë dhe këndvështrime të caktuara ideologjike për SHBA-të.

¹ Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi
Traskriptet e seancave të vitit 2002: të 14, 15 dhe 18 shkurt; të 13, 14 dhe 15 marsit; të 18 e 19 prillit dhe seanca e 14 qershorit 2002
http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

Spastrimi etnik i Kosovës dhe operacioni «Patkoi»

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër regjimit të Milošević-it mobilizoi të gjitha qarqet anti-NATO dhe anti-amerikane. Ky kontekst bëri që shkrimet¹ e gazetarëve francezë, Renaud Girard-it dhe Christophe Châtelot-së, tepër marginalë në kohën e publikimit, të shndërrohen në referenca kryesore!

Lexuesi pati mundësi të njihet me të vërtetën lidhur me vrasjen e civilëve shqiptarë në Reçak. Por, dyshimet që hidhnin rreth ngjarjeve në këtë fshat shërbyen si “argumente” për të ardhur te përfundimi se “masakra serbe e Reçakut nuk ka ekzistuar asnjëherë, por se ishte një gënjeshtër që u sajua për të provokuar ndërhyrjen e NATO-s kundër Serbisë”²

Nga këndvështrimi i njëjtë u interpretua edhe dështimi i Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën. Siç e pamë më lart, sipas kësaj logjike “në Rambuje nuk ka pasur marrëveshje por ultimatum kundër Jugosllavisë! Ultimatum që ishin të sigurt se do ta refuzonte dhe kështu do t'i ofrohej NATO-s preteksti për ndërhyrjen e saj.”³ Pra edhe një “gënjeshtër për të arsyetuar politikën imperialiste të amerikanëve!”

Në vazhdën e kërkimit të “argumenteve” për të vërtetuar teorinë e tyre se sulmi i NATO-s kishte qenë i përgatitur për të arsyetuar vazhdimin e ekzistencës së saj pas shpartallimit të BRSS-së, autorët e lartpërmendur shpallin Planin serb të spastrimit etnik të Kosovës si “gënjeshtër në funksion të legjitimitit të agresionit kundër Jugosllavisë”.

Të shohim se për çka është fjala!

Më 9 prill 1999, Ministri Gjerman i Mbrojtjes, Rudolf Scharping-u shpалosi para opinionit publik Planin serb për dëbimin e shqiptarëve. Sipas këtij plani, operacioni i emëruar «Patkoi» përbënte dëshminë se dëbimi i shqiptarëve nga Kosova nuk ishte

¹ që u shqyrtuan në kapitullin paraprak

² http://www.esprit-europeen.fr/perspectives_desintox_collon.html

³ Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3) (incizim i cituar)

mund të ketë fjalën e fundit. Drejtësia do të ngadhënjejë dhe kriminelët do të japin llogari!”¹

Ngjashëm me qëndrimet e Fischer-it dhe të Chirac-ut ishin edhe qëndrimet e personaliteteve të shumta politike dhe intelektuale që mbështetnin vendosmërinë për t’i dhënë fund shtypjes së popullit shqiptar nga sundimit diktatorial i Milošević-it.

Si pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre reagimeve dhe e kërkesave gjithnjë e më të shpeshta që të ndalej barbaria serbe në Kosovë, Slobodan Milošević-i “i mbylli kufijtë e Jugosllavisë me Maqedoninë dhe me Shqipërinë për dy ditë rresht.”²

Edhe në rrafshin propagandistik, Qeveria e Serbisë përdori të gjitha mjetet e shpërndarjes së përgënjeshtimeve lidhur me vërtetësinë e planit për dëbimin e shqiptarëve.

Siç e përmenda edhe në Prologun e këtij kapitulli, në fjalën hyrëse të mbajtur gjatë gjykimit kundër tij, Slobodan Milošević-i përsëriti qëndrimet zyrtare të pushtetit serb, të asaj kohe. Ai mohonte të gjitha akuzat dhe sipas tij “në të njëjtën kuzhinë ku u sajua gënjeshtria e Reçakut, u sajuan edhe gënjeshttrat tjera për të arsyetuar ndërhyrjen ushtarake dhe agresionin e NATO-s kundër vendit tonë.”-theksoi ai. “ Aty u sajuan edhe i ashtuquajtimi plani i spastrimit etnik të Kosovës, me emrin «Patkoi», i cili nuk ka ekzistuar as si ide e lëre më si projekt (...) Operacioni «Patkoi» ishte fabrikim i Ministrisë së Mbrojtjes Gjermane (...) ishte propagandë luftarake! (...) As emri i këtij plani nuk ishte në gjuhën serbe. Sikur ta kishim përpiluar ne, ai do të emërohej «Potkovic» e jo «Potkova». Për ta bërë më të besueshëm këtë gënjeshtër, aeroplanët e NATO-s hidhnin letra në gjuhën shqipe, përmes të cilave udhëzoheshin shqiptarët të braktisnin Kosovën. Ndërsa UÇK-ja, si aleate e tyre, bënte të njëjtën gjë dhe i vriste ata që rezistonin.”³

¹ Po aty, f.42

² Po aty, f.41

³ Procesi Gjyqësor kundër Slobodan Milošević-it, Fjala hyrëse e Milošević-it, 14.02.2002
[http://www.hlc-
rdc.org/Transkripti/Milosevic/Transkripti/Transkripti%20osa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20\(2\)/Transkript%20osa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20-%202014.%20februar%202002..pdf](http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/Transkripti/Transkripti%20osa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20(2)/Transkript%20osa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20-%202014.%20februar%202002..pdf), f. 154-161

Qëndrime të njëjta me qëndrimet e regjimit të Beogradit, por pa i cituar burimet e “informatave”, kishin ata që ndërhyrjen e NATO-s e shihnin si “agresion kundër një shteti sovran”. Madje, shprehjen e njohur për shpjegimin fetar të krijimit të universit se «në fillim ishte fjala!», e modifikuan në formë tepër domethënëse për këndvështrimin e tyre. Për ta, para se të nisnin sulmet ajrore kundër Serbisë, «në fillim ishte gënjeshtria!»¹

Në përputhje të plotë me këtë mënyrë trajtimi, çdo gjë që ndodhte në Kosovë “ishte në funksion të manipulimit të emociioneve”, se gjoja Serbia “nuk ka pasur plan për spastrimin etnik të Kosovës” dhe rrjedhimisht «Patkoi» ishte “një gënjeshtër e uzinës propagandistike të NATO-s në funksion të manipulimit të opinionit publik!”²

Vetëm ata që kishin “edukim politik të caktuar dhe njohuri” si të Serge Halimi-t nuk ranë në “kurthin e propagandës imperialiste të SHBA-ve!” Vetëm ky lloj i “analistëve kritikë”, që “nuk lexon për t’u informuar, por, për t’u informuar rreth dezinformimit” nuk manipulohet nga kjo propagandë. Përkundrazi, ata janë të “vetmit” që mund të “zbulojnë” se “Plani «Patkoi» ishte i rrejshëm!”³

Edhe pse këto qëndrime janë shumë të ngjashme me qëndrimet e regjimit të Milošević-it, ne nuk duhet t’i krahasojmë me qëndrimet e këtij regjimi, sepse, siç e pamë më lart, për Serge Halimin çdo krahasim i tillë cilësohet si “imbecile, totalitare dhe formë staliniste e të menduarit.”⁴ Madje, lexuesi që nuk dëshiron të jetë “imbecil” e vëren se ka dallime mes dy cilësimeve! Milošević-it flet për “kuzhinë ku sajohen gënjeshtria” ndërsa Serge

¹ Në mbështetje të pohimeve të lartpërmendura, kanali televiziv gjerman ADR në emisionin «Në fillim ishte gënjeshtria!» të transmetua më 8 mars 2001 bëri sintezën e qëndrimeve të tilla. Ngjashëm ishte edhe shkrimi « Au commencement fut le mensonge » (Në fillim qe gënjeshtria) e autorit Marc-Antoine Coppo, anëtar i Këshillit shkencor të revistës franceze «La Pensée libre» (Mendimi i lirë)

<http://math.unice.fr/~coppo/mensonge.pdf>

² Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3) (cituar më lartë) dhe intervista e cituar e Serge Halimi-t, «Entretien avec la revue Syndikat»,

³ Po aty

⁴ Serge Halimi, intervista e cituar, «Entretien avec la revue Syndikat»,

Halimi flet për “uzinë ku manipulohen emocionet dhe opinionioni publik”. Dallim i “madh” në interpretime!

Për të qenë bindës se Plani «Patkoi» ishte një trillim për të arsyetuar luftën imperialiste kundër Serbisë, Serge Halimi sjell kontekstin e mëposhtëm që i parapriu publikimit të tij. Sipas këtij tregimi, “Scharping-u ishte në ethe për të gjetur prova se serbët kishin planifikuar që më parë politikën e tyre kriminale në Kosovë. U ka dhënë urdhër ekspertëve gjermanë që të marrin në pyetje refugjatët, për të mbledhur dhe analizuar hollësisht provat për krime lufte, mizoritë dhe brutalitetet e tmerrshme. Për të nxitur emocionet e opinionit publik në favor të sulmeve ajrore të NATO-s, Scharping-u i merrte për fakte rrëfimet e tmerrshme të viktimave. Dëgjohej se vrasësit luanin futboll me koka të prera, i copëtonin kufomat (...)”¹ dhe rrëfime tjera të tmerrshme të kësaj natyre.

Sipas gazetarit të atëhershëm të «Le monde diplomatique»-ut, Serge Halimi-t, në këtë kontekst zbulohet «Plani Patkoi»! Pra, kjo “gënjeshtër” është në funksion të “rekrutimit të emocioneve”² të atyre që nuk kanë “edukimin politik” dhe njohuri të nevojshme që t’i “lexojnë gazetatat për t’u informuar rreth dezinformatave.”

Me të njëjtin qëndrim del edhe gazetari gjerman, Jürgen Elsässer-i. “Argumentet” dhe të dhënat që përdor ai, janë plotësisht të njëjta me ato që përdorin Serge Halimi e Dominique Vidal-i. Për temën tonë është e parëndësishme të dihet se kush i publikoi i pari dhe cili autor bazohet te tjetri. Është i njëjti “edukim politik dhe të njëjtat njohuri”!

Në Kapitullin e titulluar «Shokët e Fischer-it, ose: si të trillohet një arsye për luftë»³, Elsässer-i thekson se “për të justifikuar bombardimet, Qeveria Gjermane u përpoq ta paraqesë dëbimin sistematik të shqiptarëve si qëllim të përcaktuar që moti nga Beogradi (...) Në mbështetje të kësaj teze, prezantimi i ngjarjeve u

¹ Serge Halimi et Dominique Vidal, «L’opinion ça se travaille...», Marseille, Agone Editeur, 2000, f.63

² Dominique Vidal : « L’émotion enrôlée dans la guerre du Kosovo » (Emocionet e rekrutuara në luftën e Kosovës)

<http://www.acrimed.org/article480.html>

³ Jürgen Elsässer, Vepra e cituar, *La RFA dans la gurre...*

falsifikua. Kështu, në një dokument të shpërndarë nga Fische-i, më 31 mars 1998, mund të lexojmë edhe këtë: «Pas fillimit të luftimeve në mars të vitit 1998, një strategji që kishte për qëllim shpërnguljen, politikë e tokës së djegur u zbatua nga forcat serbe. Jo vetëm UÇK-së, por, edhe popullatës civile duhej t'i bëhej e pamundshme qëndrimi në shtëpitë dhe fshatrat e tyre.»¹

Edhe në kapitullin V të veprës së vet, Jürgen Elsässer-i i kthehet kësaj teme. Madje ai e “huazon” titullin e kapitullit nga filmi amerikan «Wag the Dog» (Trazim qeni). Që të kuptohet aluzioni i Elsässer-it, po përmend shkurtimisht se skenari i këtij filmi vë në qendër të kritikës manipulimet e njerëzve që kanë influencë në pushtetin politik. Konkretisht, për të lënë në heshtje një skandal seksual të presidentit amerikan, “njerëzit me influencë” montuan një luftë kundër Shqipërisë! Në analogji me luftën e NATO-s kundër Serbisë, autori në nëntitullin e këtij kapitulli, të titulluar «Si e shpikën Fischer-i dhe Scharping-u fushatën serbe të dëbimit: operacionin ‘Patkoj’»², konstaton se plani i spastrimit etnik të Kosovës ishte trillim i njerëzve me influencë politike në shtetin gjerman e jo strategji e regjimit të Beogradit.

Argumenti kryesor i autorit për të përgënjeshtuar vërtetësinë e këtij plani është “falsifikimi i emrit të këtij plani: «potkova» është fjalë kroate ose bullgare për patkoin, ndërsa në serbisht thuhet «potkovica».”³

Në të njëjtat pozicione, si të Serge Halimi-t, Dominique Vidal-it, Jürgen Elsässer-it, qëndrojnë edhe historianët e orientimit të djathtë politik: Bernard Lukan-i⁴, Dominique Venner-i dhe Philippe Conrad-i. Sado që këtyre tre gazetarëve nuk u pëlqen të

¹ Po aty, f.42

² F.85-101

³ Po aty, f.88

⁴ Për më hollësisht konsulto: Radio Courtoisie, Emission du "Libre Journal de Serge de Beketch", 07.04.1999, «Le vol du Kosovo. Avec Bernard Lukan, Dominique Venner et Philippe Conrad»,
<http://www.ekouter.net/le-vol-du-kosovo-avec-bernard-lukan-dominique-venner-et-philippe-conrad-sur-radio-courtoisie-253>

citohen përkrah historianëve që njihen si “shkencëtarë” që i thurin lavdi aparteidit të Afrikës Jugore, qëndrimi kundër “dominimit amerikan të Evropës” dhe revolta kundër “dezinformatave, që janë lëshuar në media”¹, i bashkon në një front të përbashkët. I vetmi “dallim” qëndron në terminologjinë e stigmatizimit. Jürgen Elsässer-i përdor “trazimin e qenit”, shprehjen idiomatike angleze, për të treguar strategjinë e politikanëve, që për të tërhequr vëmendjen nga problemet reale shkojnë deri te sajimi i motiveve për të filluar një luftë; Serge Halimi i cilëson si “qen të rinj rojtarë”² gazetarët, botuesit e ndryshëm, ekspertët e mediave, që janë vënë “në shërbim të kësaj propagande”, ndërsa Bernard Lugan-i i quan “qen Pavlovi të shtypit”³. Me një fjalë, punë qensh!

Stigmatizimi i atyre që mendojnë ndryshe nga Jürgen Elsässer-i, Serge Halimi dhe Bernard Lugan-i, si “qen”, nuk është as “formë staliniste” e njollosjes së kundërshtarëve e as “imbecile”. Ajo është në përputhje të plotë me “edukatën politike” që sheh manipulim në çdo veprim të amerikanëve!

Përkundrazi, nëse e cilësoj si punë zagarësh “gjuetinë” e atyre që nuk janë “politikisht korrektë” në përputhje me “edukatën politike” (ideologjinë antiamerikane), atëherë rrezikoj të cilësohem si “stalinist, imbecil...”

Edhe filozofi dhe publicisti francez, Régis Debray-ja, mendon se plani serb për pastrimin etnik të Kosovës nuk ka ekzistuar dhe se shpërngulja e shqiptarëve është provokuar nga bombardimet e NATO-s.

Në funksion të “vërtetimit” të pohimeve se para bombardimeve të NATO-s situata në Kosovë nuk ishte alarmante dhe nuk kishte rrezik për katastrofë humanitare, Régis Debray-ja “njoftoi” presidentin francez dhe lexuesit e letrës së tij publike se para këtyre bombardimeve “luftimet midis UÇK-së dhe të forcave serbe kishin provokuar ikjen e civilëve.”⁴

¹ Po aty

² Titulli i librit të Serge Halimi-t *Les nouveaux chiens de garde*

³ Në emisionin e lartpërmendur

⁴ Le monde, Régis Debray, artikulli i cituar «Lettre ...»

“Më thanë se shumica e tyre ishin familjet e luftëtarëve. Sipas korrespondentit të AFP-së numri i tyre ishte i kufizuar. Njerëzit strehoheshin në shtëpitë e fqinjëve”, konstaton ky i fundit. “Askush nuk vdiste nga uria, nuk vritej në rrugë, nuk iknin drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë. Faktikisht nuk kishte nevojë për kampe refugjatësh në kufi. Sulmi i NATO-s provokoi katastrofën humanitare, si një top bore që rrokulliset.”¹

Ndryshe nga Regis Debray-ja, gazetari gjerman, Jürgen Elsässer-i nuk e mohon se gjendja në Kosovë ishte përkeqësuar në krahasim me vjeshtën e vitit 1998. Mirëpo, fillimisht ky gazetar sjell shifra për të ilustruar pohimet se autoritetet gjermane kishin gënjyer. Konkretisht, në raportin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë flitej për një përkeqësim të situatës në krahasim me vjeshtën e përparshme. Në mbështetje të kësaj silleshin shifrat e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë se numri i përgjithshëm i refugjatëve nga Kosova ishte rreth 400 mijë dhe kjo shifër, në krahasim me vjeshtën e vitit 1998, përbënte një rritje të numrit për 100 mijë refugjat tjerë².

Sipas Jürgen Elsässer-it “ky numër është i shpikur. Më 23 tetor 1998, Komisariami i Lartë i OKB-së për Refugjatë numëroi 285500 refugjatë, ndërsa më 18 mars 1999 numri i tyre ishte 333 300 refugjatë. Në të dy rastet duhet të shtohen 100 mijë kosovarë shqiptarë në Evropën Perëndimore, prej të cilëve vetëm 2.5% kishin fituar të drejtën e refugjatëve politikë në Gjermani. Pra Komisariami i Lartë për Refugjatë sillte rreth 50 mijë refugjatë më shumë se në muajin tetor, ndërsa ministria gjermane 100 mijë.” Pra, ky gazetar e “vërtetoi” se “Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë kishte gënjyer!” Megjithatë, për Elsässer-i, kjo gënjeshtër është “më e vogël” se një “gënjeshtër” tjetër që “zbuloi” ky gazetar. “Gënjeshtera kryesore e Qeverisë Federale nuk qëndronte te zmadhimi i krizës në Kosovë, sepse ishte e padiskutueshme se situata ishte përkeqësuar”, vazhdon ai. “Gënjeshtera kryesore qëndron që me vetëdije të plotë është fshehur se ky

¹ Po aty

² Jürgen Elsässer, vepra e cituar *La RFA dans la gurre...*, f.50-51

përkeqësim nuk ndodhi për shkak të aksioneve të forcave të sigurisë serbe, por, për shkak të akteve terroriste të UÇK-së, prej të cilave vuajtën edhe popullsia serbe, edhe ajo shqiptare.”¹

Me qëllim që lexuesi të shohë manipulimin e këtij autori me shifrat e mësipërme, po sjell në tërësi paragrafin e Rezolutës 1199, të miratuar nga Këshilli i Sigurimit në vjeshtën e vitit 1998.

“Thellësisht të shqetësuar për shkak të luftimeve të ashpra që u zhvilluan në Kosovë dhe në veçanti të brengosur me përdorimin e tepërt dhe pa dallim të forcës nga ana e njërive të sigurisë serbe dhe të Armatës Jugosllave, që shkaktoi viktima të shumta civile dhe sipas vlerësimeve të Sekretarit të Përgjithshëm mbi 230000 persona janë zhvendosur dhe kanë qenë të shtrënguar t’i lëshojnë shtëpitë e tyre.”²

Pa marrë parasysh se shifrat që posedonin organizatat për të drejtat e njeriut evidentonin një numër shumë më të lartë të atyre që ishin detyruar t’i linin shtëpitë e tyre ose të cilëve u ishin rrënuar shtëpitë, numri që figuron në Rezolutën e KS-së (230 mijë persona të zhvendosur) do të jetë statistika që do ta citojnë më së shumti burimet zyrtare.

Mirëpo, në vend që të zbatoheshin kërkesat e përcaktuara në këtë rezolutë, situata përkeqësohej nga dita në ditë. Kështu, para fillimit të bombardimeve të NATO-s Komisarati i Lartë i OKB-së për Refugjatë publikoi shifrën prej 333.300 persona të zhvendosur. Pra, nga vjeshta e vitit 1998³ e deri më 18 mars 1999 numri ishte shtuar me 103.330 persona të zhvendosur. Manipulimi me statistika, ku njerëzit shtohen dhe zbriten në operacione matematike me qëllim që të banalizohet “shtimi i krimeve” dhe “zbritja e jetëve të njerëzve të pafajshëm” është karakteristikë e këtyre gazetarëve dhe e analistëve, me “edukim të veçantë politik”.

Zbritja e “numrave” dhe e “shifrave” të publikuara më 23 tetor 1998 (e jo më 23 shtator!) nga “numrat” dhe nga “shifrat” e 18 marsit 1999, bëhet me të vetmin qëllim që të arrihet të përgë-

¹ Po aty

² Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, S/RES/1199(1998), 23 shtator 1998.

³ Rezoluta e 23 shtatorit

njeshtrohet pohimi se situata në Kosovë para bombardimeve të NATO-s ishte alarmante. Me këtë formë të manipulimit me “operacionin matematik” Jürgen Elsässer-i erdhi te “numri” 50 mijë të shpërngulur dhe e shpalli me mburrje se “zbuloi gënjeshtren” e Ministrisë së Punëve të Jashtme Gjermane!

Edhe pse Milošević-i deklaroi se “në Kosovë kishte më pak se një milion shqiptarë, sepse qindra mijëra shqiptarë kishin shkuar në vendet e huaja”¹, Jürgen Elsässer-i publikoi shifra shumë më të vogla se shifrat zyrtare të regjimit të Beogradit. Ai përpiket t’i fshehtë edhe ato të dhëna që nuk mund t’i fshihnin as strukturat e pushtetit në Serbi!

Të dhënat për zhvendosjen e popullsisë civile ishin publikuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe nga Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatë shumë kohë para se Regis Debray-ja të ftohej të vizitonte Serbinë. Nuk mund të besohet se ky filozof nuk ishte në dijeni të këtyre shifrave, kur pohoi publikisht se atij i kanë “thënë se shumica e të ikurve ishin familjet e luftëtarëve shqiptarë dhe sipas korrespondentit të AFP-së² numri i tyre ishte i kufizuar!”

Minimizimi i përmasave të zhvendosjes së popullsisë shqiptare nxjerr në shesh se deri në cilën masë ai ishte i “paanshëm” në atë që mendohej ta shpërndante si të “vërtetë” për luftën në Kosovë!

Zhvendosja e 333.300 personave dhe e “100.000 kosovarëve shqiptarë në Evropën Perëndimore, që kishin kërkuar azil” që përmend Jürgen Elsässer-i, në sytë e dikujt mund të duket numër i kufizuar! Përmasat e kësaj zhvendosjeje të popullsisë civile, sado të “kufizuara” t’i duken dikujt, sado që ishin më të vogla se shifrat që kishte Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë, dëshmojnë për kontekstin alarmues që ndikoi në vendimin për ndërhyrje ushtarake të NATO-s.

Që të kuptohen përmasat reale të 433.300 personave, që u detyruan të iknin nga shtëpitë e tyre, lexuesit i duhet ta shohë këtë shifër në kontekstin e Kosovës: Kjo shifër paraqiste çerekun e popullsisë së përgjithshme të saj!

¹ Shih prologun e këtij kapitulli.

² Aleksandar Mitić-i

Sikur një gjë e tillë të ndodhte me popullsitë civile të Britanisë së Madhe, të Francës, të Gjermanisë dhe të SHBA-vë, ky proporcion do të manifestohej me 15 milionë britanikë, me 17 milionë francezë, me 20 milionë gjermanë dhe me 80 milionë amerikanë të zhvendosur nga shtëpitë e veta! Vetëm duke i imagjinuar këto përmasa tragjike, lexuesit e letrës së Regis Debray-së, të veprës së Serge Halimi-t, të «Humanizmit të ri ushtarak...»¹ të Noam Chomsky-t, të “Kronikës së manipulimit...” të Jürgen Elsässer-it do t’i kuptojnë manipulimet e filozofëve, të politologëve, të sociologëve, linguistëve dhe të gazetarëve si këta të lartpërmendurit, që përpiqeshin t’i minimizonin përmasat e katastrofës humanitare me të cilën ballafaqohej populli shqiptar i Kosovës.

* * *

Nëse Serbia nuk ka pasur plan për dëbimin e shqiptarëve, atëherë si e shpjegojnë këta autorë shpërnguljen e shqiptarëve?

Sipas asaj që “i kanë thënë” Regis Debray-së, “të gjithë pajtohen se ditët e para të bombardimeve ka pasur një dhunë të shfrenuar nga individë ose grupe, që ishin ‘jashtë kontrollit’ të pushtetit qendror. Gjatë këtyre tri ditëve, mijëra shqiptarë kanë marrë urdhër të shpërngulen”, por ai është dëshmitar “okular” se “fshatarët ktheheshin në Podujevë”, “ushtarët serbë bënë rojë pranë furrave të shqiptarëve”, “viktimat e sulmeve të NATO-s, të plagosurit serbë dhe shqiptarë, të shtrirë njëri pranë tjetrit, në Spitalin e Prishtinës...”²

Pas këtyre tri ditëve, mundohet të na bindë ky filozof, “eksodi ka vazhduar me intensitet të vogël dhe kjo ka ndodhur me urdhër të UÇK-së, që dëshironte t’i tërhiqte të vetët nga frika se mund të shiheshin si ‘kolaboracionistë’, nga frika e bombardimeve të NATO-s, që nuk dallonin nga lartësia prej 6000 metrash se kush ishte serb e kush shqiptar, se kafsha kishte ngordhur, se Amerika

¹ Botimi në gjuhën frenge: Noam Chomsky, *Le Nouvel Humanisme militaire, leçons du Kosovo*,

² *Le monde*, Regis Debray, artikulli i cituar «Lettre ...»

do të fitojë, se ishte një rast i mirë për të emigruar në Zvicër, në Gjermani e gjetiu...”¹

Mediat në Serbi, të kontrolluara tërësisht nga regjimi, shpërndanin të njëjtin diskurs “për intensitetin e vogël të njerëzve që iknin nga bombardimet e NATO-s.”² Madje, këtë propagandë e ilustronin me fotografi nga terreni.



Imazhe të shpërndara nga mediat serbe

Më poshtë po sjell imazhe nga e njëjta hekurudhë, por nga një këndvështrim tjetër!

¹ Po aty

² Radio Televizioni i Serbisë,
<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1023930.html>



Eksodi përmes hekurudhës për të shmangur minat

Krahas këtij aspekti të shpërnguljes, për “të përfituar nga rasti” që të emigronin në një vend më të mirë, Regis Debray-ja sjell edhe aspektin ushtarak të shpërnguljes. Sipas të dhënave që “siguroi”, “vetëm në Prishtinë UÇK-ja kishte 6000 klandestinë, që u futën në aksion sapo filluan bombardimet. Serbët gjykuan se nuk mund të luftonin në dy fronte dhe për këtë arsye vendosën të evakuonin *manu militari*¹ kolonën e pestë të NATO-s, forcën e saj tokësore, domethënë UÇK-në. Ky evakuim u bë sidomos në fshatra, ku UÇK-ja përzihej dhe shkrihej me popullsinë civile,” shpjegon Debray-ja.

¹ Shprehje latine që përdor autori e që do të thotë “ushtarakisht”.



Stacioni hekurudhor në Prishtinë – Dëbimi i shqiptarëve

Në preambulën e këtij kapitulli solla shtyllat kryesore rreth të cilave artikulohej propaganda e regjimit të Beogradit. Lexuesi mund të shohë se nuk ka asnjë dallim përmbajtësor midis propagandës së Milošević-it dhe deklaratave që Regis Debray-ja ia atribuon “korrespondentit të AFP-së” dhe “opozitarëve” të regjimit. Milošević-i nuk përjashtonte mundësinë që pas bombardimeve të NATO-s, individë ose grupe, që ishin “jashtë kontrollit”, të kenë ushtruar dhunë në Kosovë. Të njëjtën gjë e përsërit edhe Regis Debray-ja dhe kërkon ta konsiderojmë të “paanshëm”!

Nebojša Pavković-i, gjeneralkoloneli serb që udhëhoqi luftën në Kosovë dhe operacionin «Patkoi», deklaroi për revistën «Limes»: “Korpusi i Prishtinës i Armatës Jugosllave e ftoi popullsinë të kthehej në shtëpitë e tyre duke ju garantuar sigurinë maksimale.”¹ Regis Debray-ja del dëshmitar se gjoja i ka parë “fshatarët që ktheheshin në Podujevë² dhe se ushtarët serbë bënin

¹Artikujt të përzgjedhur (artikulli i parafundit në listë), Intervista e Nebojša Pavković-it dhënë gazetës *LIMES* «Režija iznenadne katastrofe»
<http://www.srpskapolitika.com/Izdvajamo/latinica/O14.html>

² Qytet në kufi me Serbinë !

rojë pranë furrave të shqiptarëve, për të garantuar sigurinë maksimale” që garantonte Nebojša Pavković-i.

“UÇK-ja i ka marrë fshatarët e fshatrave të tëra që t’i kishin si mburojë për të dalë në Shqipëri, në Maqedoni ose në Mal të Zi”, pohojnë Slobodan Milošević-i dhe Nebojša Pavković-i, ndërsa për Regis Debray-në e “paanshëm”, “ky evakuim u bë sidomos në fshatra, ku UÇK-ja përzihej dhe shkrihej me popullsinë civile”!

Edhe pse nuk ka asnjë dallim midis propagandës së regjimit të Milošević-it dhe deklaratave të Regis Debray-së ne nuk duhet të bëjmë analiza të tilla krahasuese sepse rrezikohemi të kualifikohemi si “imbecil, totalitarë apo njerëz që kanë formë staliniste të të menduarit.”¹

Në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, në shkurt të vitit 2009, Nebojša Pavković-i u dënua me 22 vjet burg për deportime, shpërngulje të dhunshme, vrasje dhe përndjekje të shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë. E Regis Debray-në, a e vret ndërgjegjja për dëshmi të rrejtshme në funksion të fshehjes së krimit? Unë, së paku nuk besoj!

* * *

Në preambulën e këtij kapitulli solla deklaratën e Milošević-it, që nuk përjashtoi mundësinë që ditët e para të bombardimeve të NATO-s, individë ose grupe që ishin “jashtë kontrollit” të tij, të kenë ushtruar dhunë në Kosovë. Por, ai “premtoi” se “ndaj tyre do të merren masat e duhura.”

Për t’u dukur si i “paanshëm” në këtë konflikt dhe për të mos e cituar drejtpërsëdrejti ndonjërin nga pushtetarët e Beogradit, Regis Debray-ja përmend si burim informatash edhe Vuk Drašković-in, i cili, dy javë më parë ishte shkarkuar nga funksioni i Zëvendëskryeministrit të Jugosllavisë dhe përgjegjës për politikë të jashtme.²

¹ Serge Halimi, intervista e cituar «Entretien avec la revue Syndikat»

² Kryetar i Lëvizjes së Ripërtëritjes Serbe.

“Ai dhe të tjerë më kanë thënë se që nga ajo kohë janë arrestuar dhe janë paditur 300 persona për dhunën e ushtruar në Kosovë”- vazhdon mbrojtja e regjimit të Milošević-it nga ana e Regis Debray-ja. Por, se kush ishin këta “të tjerët”, që i “thanë” Regis Debray-së se janë arrestuar dhe janë paditur 300 persona për dhunën e ushtruar në Kosovë, mund vetëm ta supozojmë. Në kapitullin paraprak lexuesi pati mundësi të njihet me qëndrimin e autoriteteve gjyqësore të Beogradit ndaj krimeve të kryera në Kosovë. Edhe pas largimit të Milošević-it nga pushteti, logjika e vjetër dominon, ndërsa kriminelët janë në funksione të larta partiake dhe shtetërore. Ndërsa, sa i përket Vuk Drašković-it do të flas më poshtë!

Për të pohuar vërtetësinë e propagandës që shpërndahej nga Beogradi, për gjoja kthimin e fshatarëve shqiptarë në fshatrat e tyre dhe mbrojtjen e civilëve shqiptarë nga forcat e armatosura serbe, Regis Debray-ja del si dëshmitar!

“Jam dëshmitar i kthimit të fshatarëve shqiptarë në Podujevë”- deklaron ai. Ai dëshmon se i ka parë “ushtarët serbë që bënë rojë pranë furrave të shqiptarëve,” viktimat e sulmeve të NATO-s, “të plagosurit serbë dhe shqiptarë, të shtrirë njëri pranë tjetrit, në Spitalin e Prishtinës (2000 shtretër)”! Pra, Regis Debray-ja, “dëshmitari i paanshëm”, paraqitet si “dëshmitarë okular” i sjelljeve tejet “humane” të pushtetit serb! Ai nuk shkon deri aty sa ta cilësojë haptazi Milošević-in si “demokrat”, por e hedh poshtë në mënyrë kategorike cilësimin e tij si “diktator”, që i bëjnë “disa në Perëndim”!

“Ai nuk është diktator, sepse është zgjedhur tri herë!”¹ dhe është tepër tolerant ndaj mendimit ndryshe! Atë “mund ta kritikojnë në një tarracë kafeneje, pa u fshehur dhe kritikata e tilla nuk mungojnë!” informon “dëshmitari okular”², Regis Debray-ja.

Është e vërtetë se kritikata kundër regjimit të Milošević-it, sado të pakta në numër, nuk munguan asnjëherë në Serbi. Mirëpo, ajo që mungon në letrën e Regis Debray-së ka të bëjë me burimin e mirëfilltë të këtyre informatave. Nga i mori informatat që i mundë-

¹ Le monde, Régis Debray, artikulli i cituar «Lettre ...»

² Po aty

suan të pohonte se Milošević-i ishte “tolerant” ndaj mendimit ndryshe?

Sado që ky filozof francez kërkoi të mos e marrim si të “njëanshëm” në konfliktin e Kosovës dhe u përpoq të bindte presidentin francez dhe lexuesit e letrës së tij publike se ai “ishte takuar vetëm me opozitarë të regjimit”, përmbajtja e letrës nxjerr në shesh të kundërtën.

Të gjithë ata që e kanë përcjellë situatën politike në ish-Jugosllavi, e dinë fare mirë se me ardhjen e Milošević-it në krye të pushtetit serb, u aplikua strategjia e komunikimit të informatave në funksion të krijimit të botëkuptimit unik!

Këtë strategji komunikimi, regjimi i Beogradit e aplikoi si në luftën kundër Kroacisë dhe Bosnjës, ashtu edhe në rastin e Kosovës.

Kur është fjala për Kosovën, pas shpërthimit të luftës së armatosur në mars të vitit 1998, Ministria e Informimit të Serbisë lëshoi direktiva¹ të qarta të cilave duhej t’u përmbaheshin të gjitha mediat. Situata u bë edhe më e vështirë pas miratimit të Ligjit për informim, në tetor të të njëjtit vit.

“Ato media që nuk pranuan të zbatonin qasjen e zhvillimeve në Kosovë në përputhje me direktivat e Ministrisë së Informimit të Republikës së Serbisë dhe të Ligjit për informim, të imponuar nga pushteti i Milošević-it, nuk mundën të mbijetojnë. Kështu, për shkak të refuzimit që ta trajtojë UÇK-në si “bandë terroriste” dhe t’i kualifikojë aktivitetet e saj si “aksione kriminale”, ose, nga ana tjetër, të flasë për aksionet e policisë serbe si për “operacione të ruajtjes së rendit”, gazeta beogradase «Naša Borba» u mbyll. Më vonë, të njëjtin fat e përjetuan edhe mediat e tjera serbe, që nuk i përmbaheshin direktivave të regjimit, si: gazeta «Danas», gazeta «Dnevni telegraf», «Radio B92» dhe shumë radio lokale në gjuhën serbe u mbyllën për të njëjtat arsye.”²

U kufizova vetëm në dhunën dhe në format e ndryshme të presionit që ushtroheshin ndaj mediave në Serbi dhe nuk i

¹ 10 mars 1998

² Renaud de la Brosse, « La couverture médiatique de la guerre au Kosovo ou le journalisme impossible », në : Les Cahiers du Journalisme, qershor 2000, no 7, f.196-210 dhe

Confluences méditerranée, N.30, été 1999, Anne Madelain, « Les média indépendants en RFY », f.47-57

përmenda mediat dhe gazetarët shqiptarë të Kosovë. Sepse, po të sillja tërë atë dhunë dhe presion që është ushtruar ndaj intelektualëve shqiptarë, të dëbuar nga puna kolektivisht nga pushteti i Milošević-it, dhuna ndaj gazetarëve që u hoqën zvarrë nga policia serbe kur pushtoi shtëpitë botuese, ndërtesën e Radio Televizionit të Prishtinës dhe të mjeteve të tjera të informimit në gjuhë shqipe, po të sillja dhunën dhe presionin ndaj institucioneve të arsimit në gjuhën shqipe dhe të kuadrit pedagogjik shqiptar, kjo mund t'i dukej Regis Debray-së si seleksionim i “njëanshëm” i fakteve! Për këtë arsye, si ilustrim të “tolerancës” së Slobodan Milošević-it ndaj kritikave që i adresoheshin në Serbi, po përmend vetëm një rast! Rastin e dy gazetarëve serbë! Mendoj se lexuesit do t'i mjaftojë të kuptojë arsyet e brengosjes së Regis Debray-së se mos po e konsiderojnë si të “njëanshëm” për ato që shpërndante përmes shkrimit të tij.

Më 19 tetor 1998, Slavko Ćuruvija¹ dhe Aleksandar Tijanić-i,² publikuan «Letër Presidentit Slobodan Milošević-it», në të cilën morën guximin ta kritikojnë atë!

Nëpërmjet kësaj letre dy gazetarët në fjalë shprehën revoltën e tyre për faktin se “në Jugosllavi, pa u shpallur as gjendje lufte dhe as gjendje e jashtëzakonshme, aplikohen masa të jashtëzakonshme dhe masa lufte (...) Serbëve u është ndaluar të dëgjojnë, të flasin dhe të shohin. Janë ndaluar të shtypen tri gazeta ditore dhe një radiostacion. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë në historinë e vendit tonë (...). Shoqërisë i është imponuar një psikozë e përhershme e gjendjes së jashtëzakonshme, i është imponuar frika nga policia e gjithëfuqishme ose nga të deleguarit tuaj të gjithëpushtetshëm, që lavdërohen se janë të autorizuar të vendosin për çështjen e jetës dhe të vdekjes së njerëzve që nuk ju pëlqejnë. Kërkohej dëgjueshmëri absolute! (...)

¹ Ish-kryeredaktori i gazetës “Borba” pronar i të përjavshmes “Nedeljni Telegraf”-it, i të përditshmes “Dnevni Telegraf”-it dhe i revistës së ilustruar “Evropljanin”-it.

² Gazetar dhe ish Ministër i Informatave të Qeverisë së Serbisë !

Zoti Kryetar,

Vendi juaj, populli juaj dhe qytetarët tuaj, që dhjetë vjet jetojnë në psikozën e gjendjes së jashtëzakonshme, të rrethuar me të vdekur, me mjerim, pa shpresë dhe me frikë”¹, deklaruan, ndër të tjera, Slavko Ćuruvija dhe Aleksandar Tijanić-i.

Letra publike, drejtuar presidentit të Jugosllavisë, Slobodan Milošević-it, nuk ishte letër publike e Regis Debray-së drejtuar presidentit francez, Jacques Chirac-ut. Në Jugosllavinë e Milošević-it, ndaj atyre që dëshironin “të dëgjonin, të flisnin dhe të shihnin” ndryshe nga ajo që u lejonte ligji dhe dekretet e pushtetit, masat ndëshkuese ishin të menjëhershme.

Për kritikën e shprehura me anë të kësaj letre, Slavko Ćuruvija, pronari i gazetave beogradase, «Nedeljni Telegraf»-it, «Dnevni Telegraf»-it, dhe i revistës së ilustruar «Evropljanin»-it, u dënua me 400.000 marka gjermane² dhe iu konfiskua prona (...). Për kritikën e ardhshme kundër regjimit të Beogradit, Ćuruvija u dënua me pesë muaj burg³.

Me gjithë faktet e panumërta të presioneve ndaj mediave të pavarura, Milošević-i dhe zëdhënësit e regjimit të tij propagandonin pa ndalur se “në Serbi, shtypi i lirë dhe i pavarur ishte në nivelin më të lartë..., se nuk mbetej ditë që Milošević-i dhe familja e tij të mos sulmoheshin publikisht, me shpifje nga më të ndryshmet dhe askush nuk përgjigjej për fjalën e thënë. Në Serbi nuk kishte të burgosur politikë!”⁴

¹ Aleksandar Tijanić i Slavko Ćuruvija, «Pismo Predsedniku: Šta je sledeće, Miloševiću?» (Letër Presidentit: Milošević, cili është veprimi i ardhshëm?), 19 tetor 1998,

<http://www.slavkocuruvijafondacija.rs/sta-je-sledece-milosevicu-tekst-zbog-kojeg-je-zabranjen-evropljanin/>

² Sot vlera e tyre është 200.000 euro

³ Libération, Hélène Despic-Popovic, «Slavko Ćuruvija, l'homme qui en disait trop. Assassiné dimanche à Belgrade, ce journaliste d'opposition avait longtemps fréquenté l'entourage de Milosevic.», 15 avril 1999
http://www.liberation.fr/evenement/1999/04/15/slavko-curuvija-l-homme-qui-en-disait-trop-assassine-dimanche-a-belgrade-ce-journaliste-d-opposition_271296

⁴ Shih prologun e këtij kapitulli

Edhe pse Regis Debray-ja përsërit qëndrimin e regjimit të Beogradit, se gjoja “Milošević-i nuk ishte diktator”, se gjoja atë “mund ta kritikojmë në një tarracë kafeneje, pa u fshehur!” se gjoja “në këtë shtet nuk ka të burgosur politikë!”, ai kërkon që të mos e konsiderojmë si të “njëanshëm” në këtë luftë (!), sepse këto të dhëna i ka nga “opozitarët” e regjimit!

A është e mundur që Regis Debray-ja, që përdor formën e njëjtë si të Ćuruvija-s për të komunikuar me «Presidentin e Republikës», letër publike, të mos ketë dëgjuar se pronari i tri gazetave serbe, Slavko Ćuruvija, u dënua me 400.000 marka gjermane dhe me konfiskim pasurie, vetëm e vetëm pse kritikoi Slobodan Milošević-in? E shtroj këtë pyetje, sepse një muaj para se Regis Debray-ja të ftohej në “darkën e së mërkurës” së 12 majit 1999, të organizuar nga Shërbimi Sekret Serb, shtypi botëror njoftoi se më 11 prill 1999 u ekzekutua Slavko Ćuruvija, pronari i disa gazetave të pavarura nga pushteti i Milošević-it.



Slavko Ćuruvija-s i ekzekutuar para banesës së vet në Beograd

Një numër i madh i gazetave në gjuhën frënge njoftuan për këtë vrasje. Një numër i madh i gazetave njoftuan edhe për reagimet e shumë personaliteteve lidhur me këtë vrasje. Nuk po i citoj personalitetet politike që reagues lidhur me këtë vrasje, sepse

ata mund të konsiderohen si të “njëanshëm” në këtë luftë. Madje ndodh që Regis Debray-ja të mos i ketë dëgjuar reagimet e tilla, sepse ai nuk dëgjon “reagime në funksion të manipulimit të opinionit publik”. Por, është e pamundur të mos ketë dëgjuar për reagimin e Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s në Paris, Federico Mayer-it, që e cilësoi vrasjen e Slavko Ćuruvija-s si “krim të shëmtuar dhe shkelje të rëndë të lirisë së informimit”¹

Po citoj vetëm një shkrim, nga mijëra titujt në gjuhën frënge kushtuar vrasjes së Ćuruvija-s, që lexuesi mund t'i gjejë në internet. Më 15 prill 1999, një muaj para se të botohej «Letra Presidentit të Republikës» franceze e Regis Debray-së, Hélène Despic-Popovic botoi në gazetën «Liberation» shkrimin lidhur me vrasjen e autorit të «Letrës drejtuar Presidentit të Republikës Jugosllave». Në shkrimin e titulluar: «Slavko Ćuruvija, njeriu që fliste shumë u vra të dielën në Beograd»², gazetarja e lartpërmendur solli informata edhe për dënimin me 400 mijë marka gjermane, edhe për konfiskimin e pasurisë së tij, edhe për dënimin me burg dhe në fund për vrasjen e këtij gazetari. Slavko Ćuruvija u vra “nga policia e gjithëfuqishme dhe nga të deleguarit e gjithëpushtetshëm të Slobodan Milošević-it, të atyre që lavdëroheshin se ishin të autorizuar të vendosnin për çështjen e jetës dhe të vdekjes së njerëzve, që nuk i pëlqenin pushtetit, të atyre që nuk i bindeshin ‘kërkesave për dëgjueshmëri absolute’ ndaj regjimit.”

Pas vrasjes së Slavko Ćuruvija-s askush nga opozitarët e regjimit të Beogradit nuk do të ishte aq i pacipë sa ta gënjente Regis Debray-në për gjoja “tolerancën e Milošević-it” ndaj mendimit ndryshe! Kritikën ndaj Milošević-it i kushtuan shumë shtrenjtë pronarit të tri gazetave të pavarura. Publikimi nga ana e Regis Debray-së e informatave diametralisht të kundërta me realitetin e lirive në Jugosllavi, dhe sidomos pohimi i tij, një muaj

¹ Le directeur Général de l'UNESCO condamne l'assassinat à Belgrad du directeur d'un quotidien indépendant (Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s dënon vrasjen në Beograd të drejtorit të një të përditshme të pavarur) <http://www.unesco.org/bpi/fre/unescopresse/99-77f.htm>

² Libération, Hélène Despic-Popovic, artikulli i cituar, «Slavko Ćuruvija, l'homme qui en disait trop...»

pas kësaj vrasjeje, se gjoja Milošević-in “mund ta kritikojnë në një tarracë kafeneje, pa u fshehur” është paturpësi e llojit të vet. Sado që kërkon ta konsiderojmë si të “paanshëm” në këtë luftë, Regis Debray-ja, merr pozicion të qartë në “anën” atyre që synojnë të fshehin krimet e diktaturës së Milošević-it.

Kur them se Regis Debray-ja merr anën e atyre që së bashku me instrumentet e regjimit të Milošević-it synojnë të fshehin gjurmët e krimit, kam për bazë edhe përshkrimin që ai bën dhunës në Kosovë.

Numrin prej rreth 2000 personave të vrarëve¹ gjatë ofensivave serbe të vitit 1998, Regis Debray-ja do t’ia pasqyrojë opinionit publik francez në një “formë të re”. Duke e kamufluar si diçka të “ditur botërisht”, por që vetëm ai ia “rikujton” presidentit francez, Regis Debray-ja publikon të dhënat se “në vitin 1998 ishin vrarë 1700 ushtarë shqiptarë, 180 policë dhe 120 ushtarë serbë!” Pra, saktësisht 2000 persona të vrarë, pjesëtarë të forcave të armatosura të të dyja palëve!

E civilët? Ku mbetën civilët e vrarë, për të cilët u alarmua edhe Këshilli i Sigurimit të OKB-së? Jo, as civilët nuk mbetën pa u përmendur nga ky filozof. Por, në bazë të informatave që Regis Debray-ja kishte siguruar nëpërmjet “opozitarëve” të regjimit të Beogradit, nëpërmjet gazetarit me “origjinë serbe, por pro-perëndimor” dhe nëpërmjet “gazetarit perëndimor, por antiserb”, civilët nuk ishin vrarë nga forcat serbe (!), por, nga UÇK-ja!

Madje, ai i “rikujton presidentit francez” se “UÇK-ja i kishte rrëmbyer 380 persona, prej të cilëve 103 ishin liruar, ndërsa të tjerët kishin vdekur ose konsideroheshin të zhdukur.”

Regis Debray-ja nuk ia drejtoi presidentit Jacques Chirac këto statistika, por opinionit publik francez, sepse ky filozof, si shumica e shkrimtarëve dhe e publicistëve francez, sepse e dinte mirë se çfarë qëndrimi mbante presidenti francez ndaj statistikave që i konsideronte si “forma e tretë e gënjeshtërs!”²

¹ Numër që përmendejnë shumë raporte të organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

² Le Nouvel Observateur, 16 qershor 1980, Citations de Jacques Chirac «Faites attention, la statistique est toujours la troisième forme du mensonge» <http://www.dicocitations.com/citations/citation-85999.php>

Për të manipuluar me lexuesit e letrës së tij dhe për t'u paraqitur si i "paanshëm" në këtë konflikt, gënjeshtrove që plasoi nëpërmjet statistikave të përmendura në letrën e tij, Regis Debray-ja u jep formën e "fakteve" që i kanë dhënë "opozitarët" e regjimit! Madje, ai përmend edhe Vuk Drašković-in, kryetarin e Lëvizjes së Ripërtëritjes Serbe!

Edhe në këtë drejtim i shkoi puna huq! Një numër artikujsh në Francë vunë në dyshim dhe demaskuan "paanshmërinë" e Regis Debray-së. Imazhi më domethënës është karikatura e revistës satirike «Charlie Hebdo», e cila hodhi poshtë me sarkazëm pretendimet e filozofit se "Në Prishtinë, ku ende jetonin me dhjetëra mijëra kosovarë, mund të hash drekë në pizzeritë kosovare, i shoqëruar nga shqiptarë".



Në epilogun e kapitullit të dytë sollëm për lexuesit kontekstin e ri që u krijua pas deklaratave të zëvendëskryeministrit serb të asaj kohe dhe kryeministrit aktual të Serbisë, Aleksandar Vučić-it, se “në Serbi pushteti vriste edhe ata që mendonin ndryshe, edhe kundërshtarët e vet.”

Qëndrimi i tillë publik nga një funksionar i lartë shtetëror dhe sidomos drejtimi i gishtit “për vrasjen e gazetarit serb, Slavko Ćuruvija-s, dhe për vrasjen e gjashtë të rinjve serbë në kafenenë «Panda» të Pejës, në vitin 1998”¹, tronditën opinion publik të Serbisë. Nuk munguan as mbështetjet e atyre që ishin të interesuar të ndriçohen krimet e kryera nga njerëzit e regjimit të Milošević-it. Po ndalem vetëm në mbështetjen e njërit nga opozitarët serbë, të vetmin që e përmend Regis Debray-ja.

Në intervistën e titulluar «Milošević-i urdhëroi Radeta-n dhe Legia-n t’i vrasin fëmijët serbë»², Vuk Drašković-i i dha një mbështetje të fuqishme Aleksandar Vučić-it. Krahas rastit të vrasjes së Slavko Ćuruvija-s, Drašković-i flet gjerësisht edhe për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe të sjelljes së vendimeve kriminale në funksion të nxitjes së urrejtjes kundër shqiptarëve dhe stigmatizimit të UÇK-së. Siç e pamë, ai sqaron se “vendimin për serinë e krimeve kundër serbëve në Kosovë dhe kundër shqiptarëve, që e mbështetnin Serbinë dhe e dënonin publikisht UÇK-në, e solli Milošević-i dhe Shtabi i tij strategjik. Në krye të eskadronit të vdekjes, të Njësisë për Operacione Speciale, u caktua Milorad Ulemek-Legija. Ky i morri urdhrat nga Radomir Marković-i, shefi i atëhershëm i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, i dënua sikurse Milorad Ulemek-Legija, me 40 vjet burg për dhënien e urdhrat dhe porosinë e vrasjeve të shumta (...)”³ deklaroi, ndër të tjera, Vuk Drašković-i për gazetën beogradase «Kurir».

¹ Radijo-televizija Srbije, Vučić: Država je ubila Ćuruviju, 29.12.2013
<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1482926/Vu%C4%8Di%C4%87%3A+Dr%C5%BEava+je+ubila+%C4%86uruviju.html>

² Kurir, intervista e cituar «Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu!»

³ Po aty
<http://www.kurir-info.rs/vuk-draskovic-milosevic-naredio-radetu-i-legiji-da-ubiju-srpsku-decu-clanak-1185359>

Ky kontekst ndikoi që brenda disa ditësh të arrestoheshin ata që kishin mbetur gjallë nga grupi që ekzekutoi Slavko Ćuruvija-n. Në përshpejtimin e këtyre arrestimeve ndikoi edhe dëshmia e kriminelit të njohur serb, Milorad Ulemek-Legija, që, siç e kemi përmendur më parë, është i dënuar me 40 vjet burg, për shkak të implikimit në vrasjen e politikanit serb, Ivan Stambolić-it, të vrasjes së kryeministrit serb, Zoran Đinđić-it, të vrasjes së katër anëtarëve të Partisë së Ripërtëritjes Serbe, për tentim vrasjen e Vuk Drašković-it dhe për shumë krime të tjera.

Në bazë të dëshmisë së Legia-s, u arrestua shefi i atëhershëm i Sigurimit Shtetëror të Beogradit, Milan Radojnić-i dhe ish-drejtori i Drejtorisë së Gjashtë të Sigurimit Shtetëror, Ratko Romić-i. Ndërsa, për të njëjtën vepër, si urdhërdhënës janë të dyshuar edhe ish-shefi i Sigurimit Shtetëror, Radomir Marković-i dhe pjesëtari i Shërbimit të Veçantë, Miroslav Kurak-u¹.

Them se u arrestuan ata që kishin mbetur gjallë, sepse, për të fshehur gjurmët e krimit, kreu i Shërbimit Sekret kishte urdhëruar likuidimin e katër pjesëtarëve të grupit që kryen vrasjen: Luka Pejović-it, Zoran Ristović-it, Zoran Davidović-it dhe Branko Jevtović-it.²

Kosova-Teatër me dyer të mbyllura!

Mirëpo, realizimi i objektivave të Shtabit strategjik të Milošević-it për ta paraqitur UÇK-në si organizatë terroriste “impononte” kontrollin e mediave, me qëllim shpërndarjen e mesazheve të përpiluara në institucionet e propagandës së këtij regjimi, si të ishin “të vërteta absolute”. Krahas kontrollit të mediave vendore dhe dëgjueshmërisë absolute të gazetarëve në Serbi, për Shtabin

¹ Press, «Legija je otkrio ko je ubio Slavka Ćuruviju!» (Legija zbuloi kush e ka vrarë Slavko Ćuruvija-n
<http://www.pressonline.rs/info/hronika/297014/legija-je-otkrio-ko-je-ubio-slavka-curuviju.html>

² Večerne Novosti, «Slučaj Ćuruvija: I ubice su mrtve,» (Rasti Ćuruvija: edhe vrasësit janë të vdekur!)
<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/hronika/aktuelno.291.html:316438-Slucaj-Curuvija-I-ubice-su-mrtve>

strategjik të Milošević-it ishte më se e domosdoshme që të viheshin në shërbim të kësaj strategjie edhe gazetarë, filozofë, sociologë, politologë, politikanë, analistë e historianë si Christophe Châtelot-ja, Renaud Girard-i, Regis Debray-ja, Bo Adami, Jürgen Elsässer-i, Patrick Barriot-i, John Laughland-i, Serge Halimi, Jean-Marie Lepen-i, Dominique Vidal-i, Bernard Lugan-i, Dominique Venner-i, Philippe Conrad-i, Jean-Arnauld Derens-i, Pierre Péan-i, Xavier Raufer-i, Christoph Blocher-i, Dick Marty dhe të ngjashëm si këta.

Për këtë arsye, mosbindja e gazetarëve serbë që të përcillnin direktivat e Ministrisë së Informimit të Milošević-it dhe të ligjeve të miratuara për këtë qëllim, u kushtuan shumë shtrenjtë atyre. Mbyllja e mediave të pavarura nga regjimi i Beogradit dhe aksionet e të “deleguarve të Milošević-it, të gjithëpushtetshmit, që ishin të autorizuar të vendosnin për çështjen e jetës dhe të vdekjes së njerëzve”, shkaktuan tragjedi të shumta.

Më lart e pamë se mediat serbe që nuk pranonin ta cilësonin UÇK-në si organizatë terroriste mbylleshin, ndërsa ata që kritikonin Milošević-in përjetonin dhunë të tmerrshme, që shkonte deri te likuidimi fizik!

Në kontekstin e ri që po shohim në Serbi, vetë serbët janë duke nxjerrë në shesh mekanizmat e përdorur nga ana e Shërbimit Sekret Serb për të fshehur krimet e kryera kundër civilëve serbë dhe shqiptarë në Kosovë, si dhe kundër atyre që kritikonin Milošević-in qoftë edhe “në ndonjë tarracë kafeneje”.

Në këtë kontekst u zbuluan nga vetë policët serbë fakte tronditëse të periudhës para ndërhyrjes së NATO-s, gjatë vitit 1998, në operacionet “për spastrimin e terrenit” në Kosovë. Policia serbe që udhëhiqej nga bindja se “më i mirë është shqiptari i vdekur, se shqiptari i gjallë”¹, vriste për pikë të qejfit edhe fëmijën në djep, siç ishte rasti i foshnjës Fitim Gëzim Ademajt, nga fshati Ratishtë e Poshtme, që nuk i kishte mbushur as katër muaj.

¹ Fond za humanitarno pravo, dëshmia e cituar e policit serb Slobodana Stojanović-it «Kanë bërë llamba nga kafkat e shqiptarëve», <http://www.hlc-rdc.org/?p=25433>



Edhe foshnja e vrarë në djep

Në këtë kontekst u takon gazetarëve, filozofëve, analistëve dhe historianëve që kishin hyrë në shërbim të strategjisë së fshehjes së krimeve më të përbindshme të kryera me urdhrin e Milošević-it, të tërhiqen publikisht dhe të distancohen nga puna që kanë bërë. Kuptohet, flas për ata që nuk kanë qenë plotësisht të vetëdijshëm për punën që bënin.

Siç e pamë më lart, publicistët, analistët dhe gazetarët e pavarur nga regjimi përbënin rrezik për kanalizimin e opinionit publik në drejtimin që dëshironte pushteti i Milošević-it. Për këtë arsye, sapo filluan sulmet ajrore të NATO-s, u ndërmorën të gjitha masat e nevojshme me qëllim t'i pengonin të shpreheshin.

Të nesërmen e goditjeve ajrore, me anë të Komunikatës së 25 marsit 1999, Ministria e Informimit të Serbisë njoftoi se “në bazë të nenit 8 të Ligjit për mbrojtjen e Republikës së Serbisë, Ministri i Informimit dekreton urdhrin për të përzënë gazetarët e mediave të huaja, që vijnë nga vendet që marrin pjesë në agresionin e forcave të NATO-s kundër Jugosllavisë ose nga territori i vendit që është

shfrytëzua për këtë agresion.”¹ Në përputhje me këtë dekret, “korrespondentët e mediave të shteteve perëndimore u morën në pyetje (nga strukturat e aparateve represive serbe) dhe u dëbuan nga Jugosllavia². I vetmi gazetar i huaj që mbeti pa u dëbuar ishte Paul Watson-i i «Los Angeles Time»-it. Fjala është për gazetarin kanadez, që Regis Debray-ja e paraqet si gazetar “antiserb”, që paska qëndruar “fshehurazi” gjatë luftës në Kosovë, pa lejen e pushtetit të Milošević-it (!) dhe që, së bashku me një gazetar serb “properëndimor” “rastësisht” qenkan takuar me Regis Debray-në për ta informuar “objektivisht” se në Kosovë para bombardimeve të NATO-s “nuk kishte pasur katastrofë humanitare”, “se numri i të zhvendosurve ishte i vogël”, se “civilët ishin vrarë nga UÇK-ja” e kështu me radhë. Me gjasë, Regis Debray-ja e konsideron lexuesin e letrës së tij “klient” për «Darkën e imbecilëve»!

Urdhri qeveritar i 25 marsit 1999 ishte vendim që Kosova të shndërrohej në një skenë, ku tragjedia shqiptare duhej të luhej në «Teatër me dyer të mbyllura për mediat». Vetëm “aktorët” që arrinin të iknin nga ky “teatër” dëshmonin për tmerret që përjetonin shqiptarët!

Mbyllja e Kosovës për gazetarët e huaj u dha mundësi të manipulonin jo vetëm pushtetarëve në Beograd, por edhe filozofëve, publicistëve, politologëve, sociologëve, historianëve e politikanëve të orientimeve politike të majta e të djathta, që kishin emërues të përbashkët «antiamerikanizmin», të shkonin deri në atë shkallë sa në këtë luftë Serbia të prezantohej si viktimë, ndërsa bombardimet e NATO-s t'i konsideronin si aksione frikacakësh. Kështu, Regis Debray-ja tentoi ta bindte presidentin francez që të mos i dërgonte forcat tokësore franceze, sepse “atje janë duke i pritur me padurim dhe lufta tokësore nuk është e njëjtë me atë që zhvillohet nga një lartësi 5000 metrash.” Ndërsa, Bernard Lugin-i

¹ *Les Cahiers du Journalisme*, Renaud de la Brosse, « La couverture médiatique de la guerre au Kosovo ou le journalisme impossible », qershor 2000, no 7, f.196-210

<http://archiv2.medienhilfe.ch/topics/delabrosse/CahiersK.pdf>, f.5 në versionin elektronik

² Po aty,

është më i drejtpërdrejtë dhe deklaroi publikisht se “Clinton-i është duke bërë një luftë frikacakësh. Ai nuk guxon ta dërgojë këmbësorinë amerikane që të ballafaqohet me këmbësorinë serbe, por përdor Tomahovkat, këto armë frikacakësh, kundër civilëve serbë. Le t’i dërgojë ushtarët e vet që të ballafaqohen si burrat me ushtrinë serbe e jo të bombardojë civilët.”¹ Ballafaqim burrëror me ushtrinë serbe! Contadictio in adjecto!

Se çfarë lufte burrërore bëjnë forcat serbë nuk do t’u referohem dëshmive të shqiptarëve, sepse ka rrezik që Serge Halimi t’i kualifikojë si “rrëfimet të tmerrshme të viktimave për të nxitur emocionet e opinionit publik.” Po sjell edhe një herë rrëfimet e oficerëve të ushtrisë dhe të policisë serbe, që ishin dëshmitarë të krimeve në Kosovë. Dëshmitë e atyre, që nuk pretendojnë të jenë “të paanshëm” në luftën e Kosovës, si Regis Debray-ja, por, që ishin pjesëtarë të aparateve represive të Serbisë dhe që nuk dëshirojnë të heshtin për atë që kanë parë.

Lexuesit i kujtohet rrëfimi i Slobodan Stojanović-it, policit serb që kishte qenë disa herë në Kosovë. Për dallim nga vitet tjera kur kishte marrë pjesë në aksionet kundër shqiptarëve, vitin 1998 e përshkuan si vit të tmerrshëm. “Gjatë tre muajve në Kosovë kam parë tmerre.”-rrëfen ai. “Para nesh ecte ushtria dhe që në mëngjes gjuante me raketa shumëtytëshe në drejtim të fshatrave kodrinore të Gllogovcit dhe vriste gjithçka që lëvizte (...). Në Gllogovc, pas pastrimit të terrenit, pashë një grup prej 400-500 shqiptarësh (gra, fëmijë dhe pleq). Dikush deshë të shtinte, por e pengova. Më vonë pashë tmerrin! Kufoma të copëtuara, shtëpi të djegura nga shpërthimet. Nuk munda ta paramendoja se një gjë e tillë kishte mundur të ndodhte... Në Prekazin e Epërm dhe të Poshtëm u vranë gra, fëmijë, kafshë dhe çdo gjë që lëvizte. Drenica digjej (...). Atje pashë plaçkitje të pronës, grabitje të traktorëve, vjedhje të veturave, të sharrave motorike, kultivatorë (...). Madje kanë prerë

¹ Radio Courtoisie, Emission i cituar «Libre Journal de Serge de Beketch», 07.04.1999, «Le vol du Kosovo. Avec Bernard Lugan, Dominique Venner et Philippe Conrad», Pjesa e dytë minuta e 28:00

edhe gishtërinj për t'ua marrë unazat. Me një fjalë, gjithçka që shihte syri, duart nuk e linin pa marrë.”¹

Ballafaqim “burrëror”, apo jo z. Lukan?

Tani ka dalë në shesh, nga vetë policët serbë, se në mesin e shumë krimeve që janë bërë në Kosovë para ndërhyrjes së NATO-s, rrëfimi rrëqethës i policit serb për llambat e tavolinës me koka shqiptarësh është dëshmia që tronditi edhe opinionin publik serb! Sipas kësaj dëshmie “një anëtar i Çetës së Pirotit, që i takonte Sektorit 87 të Njësive Speciale të Policisë, shqiptarit të vdekur ia kishte prerë kokën. Pastaj, për ditë të tëra e kishte zier në një tenxhere. Nga ajo i nxori katër dhëmbë prej ari, pastaj ka shkuar në shtëpi, kafkën e ka lyer me llak dhe nga ajo ka bërë një llambë tavoline (...). Të njëjtën gjë e ka bërë edhe me një grua të vvarë. Edhe asaj ia ka prerë kokën, në të njëjtën mënyrë e ka zier, e çoi në shtëpi dhe bëri llambë tavoline. Dëshironte të kishte një çift llambash. Njerëzit normalë ishin të tmerruar.”²

Sado që dëshmitë “për vrasësit, që luanin futboll me koka të prera, për kufoma të copëtuara”³ dhe rrëfime të tjera të tmerrshme të kësaj natyre mund t'u duken si të pavërteta Serge Halimi-t, Dominique Vidal-it dhe bashkëmendimtarëve të tjerë që konsiderojnë se publikimi i tyre ishte vetëm në funksion të “nxitjes së emocioneve të opinionit publik në favor të sulmeve ajrore të NATO-s”, tragjedia i tejkalonte përmasat e imagjinatës së njerëzve normalë.

Nuk e di nëse do të dalin të dëshmojnë vetë serbët që kanë parë “lojë futbollit me koka shqiptarësh” dhe të bindet Serge Halimi dhe bashkëmendimtarët e tyre se krimet në Kosovë nuk ishin “trillime në funksion të manipulimit të emocioneve”. Përkundrazi, format dhe përmasat e krimit i tmerronin oficerët ushtarakë dhe policët serbë, që e konsideronin veten normalë dhe që nuk dëshironin të heshtnin!

¹ Po aty

² Fond za humanitarno pravo, dëshmia e cituar e policit serb Slobodana Stojanović-it « Ubijalisku decu, žene, starce, čobane, ovce» (Kanë vvarë fëmijë, gra, pleq, çobanë, dhen....) në <http://www.hlc-rdc.org/?p=25448>

³ Serge Halimi et Dominique Vidal, «L'opinion ça se travaille...», Marseille, Agone Editeur, 2000, f.63-66

Edhe gjatë luftës kishte serbë që nuk pajtoheshin me këto krime dhe që pësuan për shkak të kritikave dhe të deklaratave se do të tregonin për atë që ndodhte në Kosovë. Lexuesi pati rastin të njëjhej me vrasjen e doktorit serb, Branimir Đokić-it, që e vrau polici serb Goran Stamenković – Stamenko, në vitin 1998, dhe e shpallën se ishte vrarë nga “terroristët e UÇK-së”! Përpos njerëzve të implikuar në krime, askush nuk mund ta dijë se sa njerëz të tjerë, që nuk pajtoheshin me regjimin e Milošević-it, janë vrarë nga «eskadronët e vdekjes» dhe për këto vrasje është fajësuar UÇK-ja?

Kush e farkoi «Patkoin»?

Në pjesën e sipërme të këtij shkrimi lexuesi pati mundësi të shihte se autorët që hedhin dyshime për vërtetësinë e planit «Patkoi», mbështeten në elemente që lidhen me autenticitetin e tij.

Edhe pse të gjithë janë në dijeni se ky plan u zbulua nga Shërbimi Sekret Bullgar dhe se nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të këtij shteti plani u bë i njohur edhe për vendet e tjera anëtare të NATO-s, autorët e lartpërmendur përsëritin qëndrimin propagandistik të Milošević-it dhe vënë theksin në atë “pse emri i këtij plani nuk ishte në gjuhën serbe, «Potkovicica», por në atë bullgare, «Potkova».

Sipas së njëjtës logjikë, në rast se ky plan do të ishte zbuluar nga UÇK-ja, ashtu siç pretendon Michel Collon-i në veprën e tij “Monopoly - NATO-ja në pushtimin e botës”¹ dhe do t’u ishte shpërndarë shteteve të NATO-s nëpërmjet një raporti në gjuhën shqipe, atëherë “argumenti” kryesor i kundërshtarëve të vërtetësisë së tij do të përqendrohej rreth asaj “pse emri i këtij plani nuk ishte në gjuhën serbe, «Potkovicica», por në atë shqipe, «Patkoi».

Me një fjalë, autorët që kontestojnë vërtetësinë e këtij plani këmbëngulin se “mungon dokumenti origjinal i këtij operacioni”, sepse nuk është gjetur dokumenti në gjuhën serbe dhe me nënshkrim të Milošević-it!

¹ Michel Collon, vepra e cituar, Monopoly - l’OTAN à la conquête du monde,

Në “mungesë të këtij dokumenti origjinal” që do të “kënaqte” mohuesit e ekzistimit të planit të spastrimit etnik të Kosovës, nuk do të ndalem në shkrimet e shumta që artikuloohen rreth faktit nëse ishte gjenerali serb, Momčilo Perišić-i, ai që dha informatat lidhur me këtë operacion, apo ishte zbulimi i këtij plani arsyeja e shkarkimit të tij nga funksioni i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Jugosllave. Mungon “dokumenti origjinal”!

Edhe deklarata e kolonelit të Armatës së Jugosllavisë, Dragan Vukšić-it, se “operacionin ‘Patkoi’ e kishte urdhëruar personalisht Milošević-i”, dikush, si Jürgen Elsässer-i, mund ta kundërshtojë se i “mungon origjinali”¹. Por lexuesit që ka mundësi të lexojë në gjuhën serbe i rekomandoj t’i hedhë një vështrim veprës «Fshehtësitë ushtarake - Pjesa e dytë» e autorit Vladan Vlačković-it për të parë revoltën e pushtetit serb, sidomos atë të ushtarakëve, ndaj deklaratave të tilla. Kjo do t’u mundësojë të krijojnë një ide të përafërt për rrezikun që u kanosej personave që dilnin jashtë kornizës së lejueshme për interpretimin e ngjarjeve në Kosovë.

Debati rreth “autenticitetit të dokumentit” të publikuar për operacionin «Patkoi» fsheh thelbin e problemit të politikës serbe të spastrimit etnik të Kosovës.

Çka ndodhi në të vërtetë gjatë periudhës 1998-1999? Edhe kësaj radhe, për arsyet e përmendura më lart, po sjell dëshmitë e ushtarakëve dhe policëve serbë!

Dëshmitë që do t’i sjell për lexuesin, janë dëshmi të një gazetari të pavarur serb, që ndër gazetatat e tjera për të cilat punonte, ishte edhe korrespondent i «AFP-së», sikurse Aleksandar Mitić-i, i Regis Debray-së. Çfarë coincidence! Por, ndryshe nga Aleksandar Mitić-i, që Debray-ja e cilëson si “properëndimor” për t’i dhënë kredibilitet deklaratave që ia atribuon atij, e që ishin identike me ato të pushtetit të Milošević-it, Miroslav Filipović-i,

¹ Të interesuarit rreth kësaj teme mund të informohen më gjerësisht në veprën “Fshehtësitë ushtarake, Pjesa e dytë” të autorit Vladan Vlačković-it. Vladan Vlačković, VOJNA TAJNA, 2. Deo, Tekstin e plotë e gjeni në faqen e internetit:
<http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Vojna%20Tajna%20-%202%20Deo.pdf>

gazetar i gazetës beogradase «Danas», korrespondent i «Agjencisë France-Presse» dhe analist i Institutit Raportues për Luftën dhe Paqen¹, u etiketua dhe u dënua si spiun i Perëndimit!

Në një shkrim të tij autorial, të bazuar në dëshmitë e eprorëve të Armatës Jugosllave që kishin marrë pjesë në luftën e Kosovës, Miroslav Filipović-i pohonte se në luftën e Kosovës, pjesëtarë të forcave të armatosura jugosllave kanë bërë vrasje masive kundër civilëve shqiptarë.

Publikimi i këtij shkrimi i tërboi autoritetet politike, ushtarake dhe policore në Serbi. Në mbledhjen e zgjeruar, të ftuar nga gjenerali Nebojša Pavković-i, shef i atëhershëm i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Jugosllave, në të cilën morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Dragoljub Ojdanić-i, si dhe njerëzit kyç të Prokurorisë Ushtarake, u kërkua arrestimi i Miroslav Filipović-it. “Një nga viktimat e këtij takimi përbindësh ishte Miroslav Filipović-i, që duhej t’u shërbente si shembull gazetarëve të tjerë që të mos shkruanin për atë që në Serbi të gjithë e dinin”² - konstaton Vladan Vlaković-i.

Nëse lexohen stenogramet e kësaj mbledhje, do të shihen reagimet tejet të ashpra të kreut ushtarak të Jugosllavisë kundër Miroslav Filipović-it. Unë po sjell vetëm qëndrimin e Ministrit të Mbrojtjes.

“Imagjinoni se çfarë njeriu është ai që pohon një gjë të tillë, që thotë se ushtria ka bërë një gjë të tillë, ai nuk duhet të dalë nga qelia e burgut sa të jetë gjallë. A e dini se çka do të thotë për opinionin publik ndërkombëtar kur qytetari i këtij vendi, aq më tepër kur flet me kompetencë dhe pohon diçka të tillë”³, shprehu mllëfin e vet ministri i Mbrojtjes Jugosllave, Dragoljub Ojdanić-i.

Për të gjithë ata që deklarorin të kundërtën e interpretimit zyrtar për luftën në Kosovë, deklarata e ministrit Ojdanić, është

¹ Institute for War and Peace Reporting.

² Vladan Vlaković, VOJNA TAJNA, 2. Deo, f.8

<http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Vojna%20Tajna%20-%202%20Deo.pdf>

³ Po aty, Stenogramet nga kjo Mbledhje e zgjeruar, f.18-19

domethënëse. Kërcënimi i Ojdanić-it dhe i strukturave të tjera të aparateve represive të regjimit, ndikuan drejtpërsëdrejti që pjesa më e madhe e tyre që dëshironin të flisnin për krimet në Kosovë, të tërhiqeshin dhe të heshtnin. Por, guximi intelektual i Miroslav Filipović-it ishte i pashembullt. Prandaj, le të ia lëmë fjalën atij!

“Ekzistimi i planit ‘Patkoi’ është përmendur disa herë dhe shumë shpejt është përgënjeshtuar nga pushteti. Njohuritë e mia për këtë plan datojnë që nga mesi i viteve 70-të”, deklaroi Filipović-i. “Një grup komunistësh serbë filluan të brengoseshin se çka do të bëhej me serbët kur të vdiste Tito-ja¹. Si të ruhej Jugosllavia dhe komunizmi në këtë vend dhe si të shpëtohej nga invadimi shqiptar. Atëherë u përpilua projekti ideor ‘Patkoi’, plan që përbëhej nga po aq patkonj të vegjël sa ka edhe fshatra shqiptar.

Ky plan parashihte që përreth çdo fshati të vendoseshin njerëz të armatosur në formë të patkoit, me ‘hapje’ nga Shqipëria, dhe t’u jepej vendasve afat prej disa dhjetëra minutash që me gjërat më të domosdoshme t’i lëshonin shtëpitë e tyre. Pastaj fshati digjej, ndërsa pronat plaçkiteshin dhe asgjësoheshin.

Në pjesën e ‘hapur’ të ‘Patkoit’, njerëzve u merreshin dokumentet dhe paratë tepricë dhe bëhej seleksionimi i tyre. Kështu, disa qindra mijëra njerëz do të shpërnguleshin nga Jugosllavia në Shqipëri. Shkatërrimi i shtëpive dhe krimet monstruoze, që do ta shoqëronin planin, do t’i dekurajonin për t’u kthyer edhe ata më të vendosurit. Edhe në rastin, kur do të shtrëngoheshim të kthenim një pjesë të popullsisë shqiptare, do t’i kthenim vetëm ata që do të dëshironim ne.

¹ Udhëheqësi i Jugosllavisë, diktatori komunist që udhëhoqi vendin nga viti 1945 e deri në 1980, kur vdiq!



*Shih videot: <http://www.youtube.com/watch?v=k7gEMEnpooE>
<http://www.youtube.com/watch?v=9dsUQQv6kvc>*

Milosević-i pranoi këtë zgjidhje ideore dhe gjatë sundimit të tij, ky 'Patkua' u shkri në plan operativ për realizimin e të cilit duhej, nëse jo ndonjë luftë e madhe, atëherë, së paku një konflikt lokal.

Prova e përgjithshme u zbatua në fillim të viteve të 90-të, në vendbanimet e bregut të djathtë të lumit Drina, kur banorët boshnjakë u detyruan të shpërnguleshin dhe një pjesë e territorit u pastrua etnikisht.”¹

Për vitin 1998 e pamë dëshminë e policit serb, Slobodan Stojanović-it, dhe nuk do t'i kthehemi edhe një herë. Gjithashtu në epilogun e kapitullit të tretë, lexuesi pati mundësi të lexojë dëshmitë e Ratomir Tanić-it, përfaqësuesit të ekipit serb në negociatat me përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës.

Një vit para se të ndërhynte NATO-ja rreth një çerek i popullsisë shqiptare të Kosovës ishte zhvendosur dhe kishte braktisur vendbanimet e veta. Edhe autorët që kanë tendencë të minimizojnë numrin e të dëbuarve, siç është rasti i Jürgen Elsässer-it,

¹ Republika, Ogledi, Nr. 263, Miroslav Filipović, «Dugi marš ka istini o zlocinima»
http://www.yuope.com/zines/republika/arhiva/2001/263/263_16.html

shkruajnë se rreth 100.000 shqiptarë kishin kërkuar strehim në shtetet e Evropës Perëndimore dhe 333.000 të tjerë ishin strehuar në shtetet fqinje ose brenda Kosovës.

Fushata e NATO-s, me kusht që të ishte me pak bombardime, ashtu siç e imagjinonin pushtetarët e Beogradit, përbënte një kontekst të favorshëm për realizimin e plotë të spastrimit etnik të Kosovës.

Në vazhdim të tekstit të tij, Miroslav Filipović-i sjell për lexuesit të dhënat se *“rreth 150.000 njerëz iu vërsulën fshatrave të Kosovës, prej të cilëve 23 mijë ushtarë, policë dhe rezervistë ishin nga Kraleva¹. Elita e njësisve tankiste pastroi fshat më fshat. Vetëm nga humanizmi i komandantit të çetës varej nëse do të kishte civilë të vrarë. Policia nuk e kishte këtë ‘dilemë humanitare’² Pas gati tre muajsh të shfrenimeve, serbët u shndërruan në kriminelët më të mëdhenj të fundit të shekullit XX. Kur u kthyen këta ushtarë, të gjithë kishin plot rrëfime dhe përjetime, në të cilat kishte shumë pak heroizëm. Kryesisht ishin rrëfime për katunde shqiptare të djegura, kolona njerëzish që iknin, kufoma...”³*

Edhe pse ishte i vetëdijshëm për rrezikun që i kanosej, Miroslav Filipović-i i publikoi këto rrëfime kur Milosević-i ishte ende në pushtet. Nuk ishte bërë as një vit nga vrasja e Slavko Ćuruvia-s dhe kujtimi ishte ende i freskët!

Ai u arrestua dhe u akuzua për “shpërndarje të gënjeshtreve dhe për spiunazh në favor të shteteve të Perëndimit”. Më 26 korrik 2000, në Gjykatën Ushtarake të Nishit⁴, me procedurë të shpejtë dhe në seancë me dyer të mbyllura, Miroslav Filipović-i u dënua me 7 vjet burg. Prova e vetme në mbështetje të akuzës ishte deklarata e dërguar nga Komanda e Armatës së Tretë dhe nga Komanda e Korpusit të Prishtinës, nëpërmjet së cilës ata pohonin se “asnjë pjesëtar i tyre nuk kishte kryer krime në Kosovë.”⁵

¹ Qytet në Serbi, prej nga vinte gazetari.

² Thonjëzat janë të Filipović-it

³ Republika, Ogledi, Nr. 263, Miroslav Filipović, shkrimi i cituar «Dugi marš ka istini o zlocinima»

http://www.yuope.com/zines/republika/arhiva/2001/263/263_16.html

⁴ Qytet në jug të Serbisë

⁵ Vladan Vlaković, VOJNA TAJNA, 2. Deo, f.8

Institucione dhe personalitete politike të Serbisë dhe të shteteve perëndimore, intelektualë dhe gazetarë të ndryshëm shprehën indinjatën e tyre për këtë dënim. Një përmbledhje e reagimeve kundër këtij dënimi mund të shihet në shkrimin «Liri për Miroslav Filipović-in»¹.

Reagimet ndaj dënimit të Miroslav Filipović-it ishin të shumta, siç ishin edhe kërkesat për lirin e tij. Nuk do të përmend të gjitha personalitetet që reaguesin ose mediat që i kushtuan një rëndësi të veçantë kësaj ngjarjeje. Në këtë shkrim po kufizohem vetëm në disa prononcime dhe në disa informata të publikuara në portalin elektronik «Le Courier des Balkans», themelues dhe udhëheqës i të cilit është Jean-Arnauld Dérens.

Ky portal i dha një publicitet të veçantë Apelit të Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Organizatës Botërore Kundër Torturës për lirin e menjëhershëm të Miroslav Filipović-it², si dhe aktivitetet e «Reporterëve pa kufi» për këtë çështje. Gjithashtu botoi tekstin integral,³ për përmbajtjen e të cilit ishte dënuar Filipović-i.

Me gjithë dëshmitë konkrete të oficerëve serbë për pasojat tragjike të aplikimit të planit «Patkoi» dhe publikimit të këtyre dëshmive edhe në portalin e tij, Jean-Arnauld Derens-i i vuri vetes për qëllim që të “informonte” lexuesin lidhur me vërtetësinë e këtij plani. Në veprën e tij «Kurthi i Kosovës», të cituar më parë, ai pohoi të njëjtën gjë që kishin shkruar shumë vjet më parë autorët e lartpërmendur. Ai përsëriti se “plani i famshëm «Patkoi», i përmendur nga përgjegjës të lartë të NATO-s, nuk ka ekzistuar

<http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Vojna%20Tajna%20-%202%20Deo.pdf>

¹ B92, «Sloboda za Miroslava Filipovića» (Liri për Miroslav Filipović-in) <http://www.b92.net/mediji/filipovic1.phtml>

² Serbie: Appel pour la libération immédiate de Miroslav Filipovic (FIDH/OMCT), 27-07-2000

<http://archives.rezo.net/archives/courrier-balkans.mbox/TJPYWLZ7HT4BWA62QGF6KFAOBSPBOUYU/>

³ Që paraprakisht ishte botuar nga Instituti Raportues për Luftën dhe Paqen (*Institute for War and Peace Reporting*), 4 prill 2000

asnjëherë, por, ka qenë një helmim¹ me informata tendencioze dhe të rrejshme nga propaganda e luftës së Aleancës Atlantike (...). Ky plan i rrejshëm, sipas të cilit gjoja parashihej dëbimi sistematik i shqiptarëve të Kosovës që në vitin 1998, për herë të parë u përmend nga ministri i Mbrojtjes Gjermane, Rudolf Scharping-u. Informata u mor pa asnjë dozë kritike nga shumica e mediave perëndimore. Për shembull gazeta «Le monde» e bëri lajm të vetin kryesor. Më vonë u zbulua se ishte informatë që nuk mbështetej në asgjë dhe që ishte montuar tërësisht nga Shërbimi Sekret Bullgar, i angazhuar në kampin e NATO-s.”²

Tetë vjet para se Jean-Arnault Derens-i të sillte “faktet” e tij se “plani i famshëm ‘Patkoj’ ishte trilluar nga propaganda e luftës së Aleancës Atlantike”, portali i tij «Le Courrier des Balkans», kishte publikuar dëshmitë e oficerëve serbë, të mbledhura nga Miroslav Filipović-i. Në këto dëshmi gazetari serb tregonte pa asnjë ambiguitet se, siç e kam cekur edhe më lart, “ky plan përbëhej nga po aq patkonj të vegjël, sa kishte edhe fshatra shqiptare dhe se parashihej në detaje ekzekutimi i tij: (...) vendosja njerëzve të armatosur përreth vendbanimeve në formë të patkoit..., urdhri që brenda disa minutave t’i braktisnin shtëpitë e tyre, plaçkitja e njerëzve dhe asgjësimi i pronave, që nuk mund t’i plaçkitnin, vrasjet dhe keqtrajtimet e njerëzve...”

U publikua gjithashtu dëshmia e tmerrshme se “gjatë një operacioni të pastrimit etnik të një fshati në juglindje të Kosovës, fshatarëve iu dha afat një gjysmë ore që ta braktisnin fshatin. Fshatarët ishin rreshtuar në dalje të fshatit, kur një rezervist me pseudonimin ‘Crni’ iu afrua një burri të moshuar që mbante në krahët e tij një fëmijë 3 ose 4 vjeç. Ia shkuli fëmijën nga krahët dhe i kërkoi këtij burri haraç 20.000 marka gjermane. Shqiptari kishte vetëm 5000 marka. ‘Crni’ ia ngjiti fëmijës për flokësh, nxori thikën dhe ia preu kokën. ‘5000 marka janë të mjaftueshme vetëm për trupin’, i tha ai dhe kaloi pranë fshatarëve të tjerë duke e mbajtur

¹ Autori përdor fjalën «intox» që nënkupton helmim të shpirtit përmes përhapjes së informatave tendencioze dhe të rrejshme

² Jean-Arnault Derens, vepra e cituar *Le piège du Kosovo*, f. 136-137

kokën e fëmijës për flokësh. Më vonë 'Crni' u shpall i çmendur, u lirua nga shërbimi ushtarak dhe u kthye në shtëpi. Megjithëse bëri këtë krim të tmerrshëm, ai ende është i lirë të shëtisë rrugëve”¹, Edhe pse kjo dëshmi u publikua në «Le Courrier des Balkans», Jean-Arnauld Derens-it përpiqet të “shpjegojë” se dëbimi i shqiptarëve të Kosovës nuk ishte projekt politik i pushtetit serb, sepse “realizmi politik i Milošević-it ia pamundësonte ta imagjinonte Kosovën pa shqiptarë!”² Por, sipas këtij historiani francez, qëllimi i dëbimit të shqiptarëve “ishte ushtarak: ‘ta pastronin terrenin’, duke i dëbuar civilët, për të luftuar më lehtë kundër UÇK-së.”³ Ky është përfundimi në të cilin del në veprën e vet!

Disa vite para se të publikoheshin “shpjegimet” e Jean-Arnauld Derens-it, propaganda e regjimit të Milošević-it kishte shpërndarë gënjeshtërën se në traditën e ushtrisë serbe “njerëzit e paarmatosur janë të shenjtë” dhe se gjoja ka pasur një “urdhër” që njësitë ushtarake dhe policore serbe të mos hapnin zjarr aty ku mund të rrezikohet jeta e qytetarëve⁴!

Në përputhje të plotë me këtë shtyllë propagandistike, lexuesi pati mundësi të shohë gënjeshtërën e Jean-Arnauld Derens-it në rastin e «Masakrës së Reçakut». Ai publikoi gënjeshtërën për gjoja “evakuimin e fshatarëve nga ky fshat nga ana e policisë serbe, për të qenë të lirë të luftonin kundër UÇK-së”. Dhe rrjedhimisht ky përfundim shpërndante si të vërtetë atë që propaganda serbe dëshironte ta paraqiste si të tillë: “gjoja forcat serbe nuk kishin vrarë civilë shqiptarë, por mbrojtësit e Reçakut!”

Gazetari serb, Miroslav Filipović-i, kishte marrë rrezikun që gjatë pushtetit despotik të Milošević-it ta denonconte publikisht planin «Patkoi» dhe të kërkonte dënimin e atyre që kishin kryer krime duke zbatuar operacionet e këtij plani në Kosovë. Për këtë

¹ "Que ceux qui ont commis ces atrocités soient jugés pour leurs crimes."

24.06.2000

http://www.liberation.fr/monde/2000/06/24/que-ceux-qui-ont-commis-ces-atrocites-soient-juges-pour-leurs-crimes_328448

² Jean-Arnauld Derens, "Le piège du Kosovo", Editions Non Lieu, 2008, f. 136

³ Po aty

⁴ Parathënja e këtij kapitulli

denoncim ai u akuzua nga Gjykata Ushtarake dhe u dënua me 7 vjet burg. Jean-Arnauld Derens-i, që ka krijuar portalin për t'u solidarizuar me gazetarët e Ballkanit, shpërndau si të vërteta qëndrimet propagandistike të pushtetarëve të Beogradit dhe rrjedhimisht u solidarizua me ata që e dënuan gazetarin serb si “spiun të Perëndimit”.

Në shtypin francez u publikua edhe dëshmia e oficerit serb, Dražen-it: “Kam parë me sytë e mi kur një rezervist i rreshtoi pranë një muri rreth 30 gra e fëmijë shqiptarë. Mendova se dëshironte thjesht t'i frikësonte. Por, ai u struk prapa një mitralozi kundërajror dhe ngrehu çarkun. Plumbat 1.3 cm i copëtuan trupat. I ngjante skenës së një filmi të keq, por që ndodhi në realitet (...). Tanket moderne u përdorën për të masakruar fëmijët dhe njësitë ushtarake të Armatës Jugosllave vranë së paku 800 fëmijë të moshës nën 5 vjeç.”¹

Krahas dëshmimeve të Miroslav Filipović-it, u publikuan edhe dëshmitë e Ratomir Tanić-it, që pohoi publikisht se “Milošević-i dhe Šainović-i² vepronin në atë mënyrë që ‘lufta kundër terrorizmit’ të kthehej në luftë kundër fshatrave dhe civilëve shqiptarë dhe në këtë mënyrë të dëboheshin këta njerëz nga Kosova, t'u merreshin dokumentet e identitetit, t'i fshinin nga evidenca, që në rast se na detyronin t'i kthenim të dëbuarit, do të pohonim se janë shqiptarë nga Shqipëria.”³ Fjala është për dëshmitë e një përfa-

¹ Libération, «Que ceux qui ont commis ces atrocités soient jugés pour leurs crimes» - Témoignages d'officiers recueillis par Miroslav Filipovic. (Ata që i bënë këto tmerre të gjykohen për krimet e tyre- Dëshmitë e oficerëve të mbledhura nga Miroslav Filipović-i), 24.06.2000
http://www.liberation.fr/monde/2000/06/24/que-ceux-qui-ont-commis-ces-atrocites-soient-juges-pour-leurs-crimes_328448

² Nikola Šainović-i, ish-Kryetar i Republikës së Serbisë dhe Nënkyetar i Qeverisë Federative të Jugosllavisë. Më 26 shkurt 2009 u dënua nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, me 22 vjet burg për përgjegjësitë në krimet e luftës kundër shqiptarëve në Kosovë.

³ Radio Europelibre, «Ratomir Tanic: Oui, il existait un plan de nettoyage ethnique du Kosovo»
<https://docs.google.com/document/d/1lBGqdCw5E9tFjZlQpn96ohv7UlnKXl3DNkCOECzEV2M/edit?pli=1>
Shih edhe Dëshmia e Ratomir Tanić-it në procesin e Milošević-it, , 14 maj, 15 maj, 16 maj dhe 21 maj 2002

qësuesi serb, që jo vetëm nuk është “i paanshëm”, por, përkundrazi, ai deklaroi haptazi se ka “qëndrim tejet negativ ndaj shqiptarëve, sepse ata paraqesin problem të caktuar për interesat kombëtare të Serbisë.”¹ Edhe një përfaqësues i tillë nxjerr në shesh se strategjia e pushtetit të Beogradit ishte lufta kundër civilëve shqiptarë në funksion të realizimit të planit «Patkoi».

Me gjithë këto dëshmi të botuara në gjuhën frënge, disa vite më vonë, Jean-Arnauld Derens-i shkruan për gjoja “objektiva ushtarake’ serbe të ‘pastrimit të terrenit’ nga civilët, me qëllim që të luftojnë më lehtë kundër UÇK-së!” Këtu nuk mund të flitet për mungesë informatash, por për pozicion të qartë në anën e atyre që ende dëshirojnë t’i mbajnë të fshehura krimet e regjimit serb në Kosovë për të akuzuar “imperializmin amerikan” si shkaktar të tragjedive në këtë pjesë të Evropës.

Vetëm disa muaj pasi u botua libri² i Serge Halimit dhe Dominique Vidal-it, në shtypin francez u publikuan dëshmitë e oficerëve serbë lidhur me krimet e kryera gjatë operacionit «Patkoi». Në intervistën për revistën “Syndikat”³, në tetor të vitit 2000⁴, Serge Halimi pati një mundësi të mirë që t’i rishikonte qëndrimet e tij dhe të pranonte se këndvështrimi ideologjik e kishte çuar në të kundërtën e asaj që pretendonte. Qasja e tij që t’i shihte informatat e botuara në media si të ishin dezinformata në funksion të manipulimit të opinionit publik e sollën në pozitë që t’i shpërndante dezinformatat serbe si të ishin fakte!

Në vend që të pranonte publikisht se kishte gabuar, ai në këtë intervistë vërsulet kundër Laurent Jefferin-it, drejtorit të redaksisë së gazetës «Le Nouvel Observateur», që punën e mediave në raport me luftën e Kosovës e kishte cilësuar si “punë shembullore” dhe

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

¹ Dëshmia e Ratimir Tanić, 16 maj 2002, f. 755

² Serge Halimi & Dominique Vidal & Henri Maler, *L’Opinion ça se trava-ille... Médias & les « guerres justes » : Kosovo, Afghanistan, Irak, Agon, 2006* (Botimi i pestë) Botimi i parë në vitin 2000

³ Serge Halimi, intervista e cituar «Entretien avec la revue Syndikat»

<http://www.homme->

[moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html](http://www.homme-moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html)

⁴ Tre muaj pasi ishte dënuar Miroslav Filipović-i

kundër Edwi Plenel-it, drejtorit të redaksisë të gazetës «Le Monde», që kishte pohuar se “puna e tyre ka qenë e përkryer.”¹

Serge Halimi përpiqet t’i “sqarojë” lexuesit e gazetës “Syndikat” pse drejtuesit e gazetave të lartpërmendura “një vit pasi kishin qenë të manipuluar, nuk mund të pohojnë se ndërkohë e kanë kuptuar që ishin të manipuluar dhe se informimi për të cilin kishin qenë përgjegjës, ishte propagandë e NATO-s.” Sipas Halimit, gazetarët që do të pranonin se kanë qenë të manipuluar, do të humbnin kredibilitetin e tyre. Pranimi i gabimit është i “rezervuar” vetëm për një kategori gazetarësh. “Mund të thuhet se ‘jemi mashtruar’, por nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë ata që pikërisht kur gabonin, afirmojnë se ‘në këtë rast nuk jemi duke gabuar’”²! Kjo pikëpamje e Serge Halimi-t nxjerr në shesh motivet personale të tij se për çfarë arsye ai nuk mund të pranojë se ka qenë i mashtruar nga propaganda serbe. Nëse në prezantimin mediatik të luftës së Kosovës ka mundur të mashtrohet, Serge Halimi e pranon se një gjë e tillë i ka ndodhur në fillim: “Kur i shihja imazhet i thosha vetes se gjendja është shqetësuese dhe se ndoshta do të duhej të veprohej. Por, kjo nuk më zgjati shumë, sepse kisha edukim politik dhe njohuri për SHBA-të që më mundësonin të mos besoja shumë në angazhimet humanitare të SHBA-ve.”³

Por, kur bëhet fjalë për veten e tij, Serge Halimi nuk mund të pranonte se kishte gabuar dhe se kishte qenë viktimë e manipulimit të propagandës së Milošević-it, sepse do ta kishte humbur “kredibilitetin e vet” në raport me ata që i kualifikonte “stalinistë, imbecilë...” dhe do të kishte rënë në kundërshtim me “edukimin politik dhe njohuritë që kishte për SHBA-të.”

Megjithatë, të pranohet se është bërë gabim, edhe në rastin kur ky gabim valëvitej si fakt i përgënjeshtimit të informatave të

¹ Serge Halimi, Entretien avec la revue Syndikat, octobre 2000
<http://www.homme-moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html>

² Po aty

³ Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (2/3), minuta prej 14:35-15:32
http://www.dailymotion.com/video/x4crvk_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

përhapur nga gazetarët “e manipuluar nga NATO-ja”, nuk e rrezikon kredibilitetin e gazetarit, sa e rrezikon vazhdimi i shpërndarjes së gënjeshtërs edhe kur e vërteta është zbuluar!

Dëshmitë e oficerëve dhe të policëve serbë për trupa të masakruar, për koka të prera, madje edhe për llamba tavolinash me koka të prera shqiptarësh, nuk janë të mjaftueshme për Serge Halimi-n dhe Dominique Vidal-in! Ata vazhduan të përsëritnin në të gjitha ribotimet e veprës së tyre “Opinionit përpunohet...”, se në funksion të nxitjes së “emocioneve të opinionit publik në favor të sulmeve ajrore të NATO-s, Scharping-u i merre për fakte rrëfimet e tmerrshme të viktimave (...) për vrasësit që luanin futboll me koka të prera, për copëtimin e kufomave (...).”¹

Nuk e di si do të reagojnë autorët në rast se del ndonjë dëshmitarë serbë që do të konfirmojë se është luajtur futboll me koka të prera shqiptarësh! Mendoj se nga frika për të mos e humbur “kredibilitetin e vet” do të vazhdojnë të ribotojnë të njëjtat gënjeshtër, si të ishin të vërteta.

Në botimin e pestë të “Opinionit përpunohet...”, Halim-it dhe Vidal-it, i bashkangjitet si bashkautor edhe Henri Maler-i². Në këtë botim, sa i përket luftës së Kosovës, ata i shtuan pjesën e titulluar: «Post-Skriptum-2006: Prova e budingut».

Për të përforcuar mendimin e tyre se “popujt e Ballkanit e shijojnë çdo ditë luftën e NATO-s dhe pasojat e saj” autorët i referohen kuptimit të proverbit të njohur anglez «Prova se budingut ekziston, qëndron në ngrënien e tij»³

Është pikërisht e kundërta: lufta e NATO-s krijoi kontekstin e ri historik që t’i jepej fund politikës hegjemoniste të Serbisë, që la shijen më të hidhur dhe më të përgjakshme për popujt e asaj që quhej Republikë Federative e Jugosllavisë.

¹ Serge Halimi et Dominique Vidal, «L’opinion çase travaille...», Marseille, Agone Editeur, 2000, f.63

Edhe në botimin e pestë të këtij libri në vitin 2006, i njëjti citat ndodhet në faqen 63, si në botimin e parë.

² Henri Maler-i është bashkëanimues i Shoqatës ACRIMED (Action-Critique-Médias- Aksion-Kritikë-Media)

³ «The proof of the pudding is in the eating »

Edhe pse faktet nxorën në shesh të kundërtën e asaj që kishin shkruar autorët e lartpërmendur, Serge Halimi dhe Dominique Vidal-i këmbëngulin se gjoja koha i vërtetoi pohimet e tyre! Në «Provën me anë të budingut», pa pikë paturpësie, gënjejnë se gjoja “shtatë vjet pas operacioneve perëndimore” na qenka qartësuar se debatet që në atë periudhë mobilizuan opinionin perëndimor, paskëshin qenë të pavërteta. Në mesin e gjoja “gënjeshtreve të trilluara për ta fajësuar Serbinë”, edhe në këtë botim përsëritet rasti i planit «Patkoi».

Sipas këtyre autorëve “është vërtetuar se ky plan paska qenë i farkuar nga shërbimet sekrete, për t’ua veshur udhëheqësve serbë se gjoja kanë kryer krime me paramendim! (...). Madje, edhe ministri gjerman i Punëve të Jashtme, Joshka Fischer-i, që me aq zhurmë e shfrytëzoi këtë gjatë luftës, preferonte të priste hapjen e arkivave jugosllave, para se të ishte i sigurt në prononcimin e tij. Arkivat në fjalë u hapën pas fitores së Vojislav Koštunica-s ndaj Slobodan Milošević-it, më 7 tetor 2000, por ish-lideri i të Gjellbërve heshti. Kjo heshtje nënkupton se arkivat nuk e kishin planin «Patkoi»¹. Pra, mungonte origjinali i planit!

Përzgjedhja e proverbit anglez për shtesën e librit në vitin 2006 është domethënëse. Por, nëse në vend të «Provës me anë të budingut» do të krijonim një metaforë të “provës me anë të patkoit”, atëherë do mjaftonin dëshmitë e oficerëve dhe të policëve serbë për të rikujtuar zjarrin e “farkëtarisë” së Beogradit, tymin e “Patkoit”, djersën dhe lotin, gjakun dhe dhembjen e shkaktuar nga “mbathja e patkoit” një populli që kishte trajtimin e kafshës.

Edhe këta autorë e pranojnë se në Kosovë ka sunduar “për dhjetë vjet aparteidi antishqiptar,”² por kjo nuk është e mjaftueshme për Serge Halimi-n, Dominique Vidal-it dhe Henri Maler-in. Përmbajtja nuk ka rëndësi për ta. Ata dëshirojnë të shohin “ambalazhin e budingut”! Nëse nuk gjendet origjinali i letrës ku shkruhet në gjuhën serbe “Potkovica” dhe e nënshkruar nga

¹ Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, vepra e cituar « L’Opinion ça se travaille... » 2006, f.106

² Po aty, f.102

Milošević-i, atëherë “përmbajta e patkoit” është e falsifikuar nga shërbimet sekrete për të manipuluar me emocionet e publikut!

Dymbëdhjetë vjet pas publikimit të detajeve të zbatimit të planit serb të spastrimit etnik të Kosovës, “kriminologu” francez, Xavier Raufer-i, shkruan se “në prill të vitit 1999 (dy javë para fillimit të bombardimeve ajrore kundër Serbisë¹) ministri gjerman i Punëve të Jashtme, Joschka Fischer-i, shpalli me pompozitet se ishte zbuluar plani sekret i Shtabit të Përgjithshëm Serb që synonte spastrimin etnik të Kosovës. Sipas këtij ministri, shqiptarët duhej të masakroheshin nga Armata Jugosllave dhe pastaj të dëboheshin drejt Maqedonisë dhe Shqipërisë.”² “Të masakroheshin e pastaj të dëboheshin!” Formulim i pashembullt që vetëm një “kriminolog” mund t’ia “zbulojë kuptimin”!

Xavier Raufer-i nuk ndalet me kaq! Deklaron me pompozitet se “falsifikimi lidhur me këtë plan ishte aq i madh sa edhe emri i përdorur për «patkoin», ishte fjala ‘potkova’, që nuk është fjalë serbe, por...kroate! Më vonë NATO-ja në mënyrë të turpshme deklaroi se nuk ishte në gjendje ta tregonte origjinën e historisë së «patkoit»”³.

Ky autor që pretendon se “i di” edhe dallimet fonetike serbe dhe kroate të fjalës «patkua», shkruan se ky plan qenka “shpallur me pompozitet nga ministri gjerman i Punëve të Jashtme, Joschka Fischer-i (!) dy javë para fillimit të bombardimeve ajrore kundër Serbisë (!), në muajin prill (!).

Të gjithë ata që kanë hulumtuar sadopak këtë ngjarje, e dinë se sulmet ajrore të NATO-s kundër aparateve represive serbe filluan më 24 mars 1999, pra një javë para muajit prill! Çdo studiues serioz do të kishte bërë përpjekje, që së paku, ta “vendoste” ngjarjen në kontekstin historik. Por, për Xavier Raufer-in kjo nuk ka rëndësi. Ajo që vlen, për të, kufizohet në shpalljen se “falsifikimi i këtij plani ishte në funksion të arsyesimit të luftës!”

¹ Tregues se sa i ka njohur zhvillimet lidhur me këtë luftë!

² Le nouvel Econmiste, Xavier Raufer, «Balkans, Boucherie et bidonnages» 15 shkurt 2011

<http://www.lenouveleconomiste.fr/balkans-boucherie-et-bidonnages-9201/>

³ Po aty

Katërmbëdhjetë vjet pas dëshmime të tmerrshme të publikuara nga Filipović-i dhe në kohën kur faqet e mediave serbe mbulohen me dëshmi rrëqethëse për krimet e kryera gjatë fushatës për pastrimin etnik të Kosovës, Pierre Péan-i përsërit informatat që i kishin cituar reciprokisht Serge Halimi, Dominique Vidal-i, Jürgen Elsässer-i, Régis Debray-ja, Jean-Arnault Dérens-i; Xavier Raufer-i dhe autorë që kontestonin vërtetësinë e planit «Patkoi». Edhe ky autor mbështet mendimin se plani “«Patkoi» u trillua për të bindur opinionin publik se eksodi i shqiptarëve nuk filloi me sulmet e NATO-s, por ishte rezultat i politikës kriminale të Slobodan Milosević-it”. Pierre Péan-i përsërit atë që autorët e mëparshëm e kishin shkruar nga disa herë secili dhe përpiqet ta bindë lexuesin se “ky plan nuk ka ekzistuar asnjëherë, se ‘Patkoi’ ishte farkëtuar nga gjermanët, që ishin bazuar në informatat e transmetuara nga Shërbimi Sekret Austriak, e ky i fundit i kishte siguruar këto informata nga burime të dyshimta të Shërbimit Sekret Bullgar!”¹

Ky autor nuk sjell asgjë të re pos përsëritjes së qëndrimeve të vjetra propagandistike në një kontekst të ri historik, që do ta trajtoj në kapitullin e ardhshëm.

¹ Pierre Péan, vepra e cituar, Kosovo: une guerre «juste» pour un Etat mafieux, f.154

EPILOGU I KAPITULLIT TË PESTË

«Pranverën e Bartolemeut kosovar 1999»¹

Tani kur edhe “zogjtë” e Milošević-it janë duke zbuluar “çerdhen” se ku janë bërë “vezët” për “budingun serb”, që duhej t’u shërbente si “provë atyre që e hëngrën” të ambalazhuar në uzinat e “Shtabit strategjik të Milošević-it”, një numër filozofësh, historianësh, sociologësh, kriminologësh, politikanësh e gazetarësh të një “edukimi politik” të caktuar vazhdojnë të rreshtohen në mbrojtjen e tezave të “fabrikuara” në këto “uzina”. Edhe pse ndërhyrjes ushtarake e NATO-s u bë për të shmangur katastrofën humanitare dhe spastrimin etnik të Kosovës, këndvështrimi ideologjik që dyshon në çdo veprim të amerikanëve i ka sjellë autorët e lart-përmendur në pozita të njëjta me propaganduesit e Milošević-it. Sado që ky krahasim t’i duket Serge Halimi-t si “stalinist ose imbecil”, realiteti është i tillë!

Të gjithë autorëve, që në portalet e tyre publikuan lajmin për dënimin e Miroslav Filipović-it dhe që kërkuan lirimin e tij nga burgjet e diktatorit Slobodan Milošević e nga ana tjetër vazhduan ta hanë dhe ta shpërndajnë “budingun” e prodhuar në kuzhinën e Beogradit, po u drejtohem me një pjesë të deklaratës së gazetarit serb pasi u lirua nga burgju. Analogjia është domethënëse! *“Të gjithë kanë protestuar kundër burgosjes dhe kundër dënimit tim, por askush nuk tha se unë kisha të drejtë!” - deklaroi Miroslav Filipović-i. “Nuk është në rregull që të heshtet ende për krimet ndaj civilëve shqiptarë, që kanë bërë pjesëtarët e forcave të armatosura dhe për të cilat përgjegjës janë funksionarët jugosllavë dhe serbë. Politikanët, gazetarët dhe shoqëria në tërësi nuk janë të gatshme të flasin për çështjen që ne si popull u kemi*

¹ Përndjekjen e shqiptarëve të Kosovës nga pushteti i Serbisë gazetari serb, Miroslav Filipović-i, e emërtoi “Pranvera e Bartolemeut kosovar 1999”, në analogji me «Masakrën e Shën Bartolemeut». «Masakra e Shën Bartolemeut», që filloi në natën e 24 gushtit 1572 në Paris, zgjati për javë të tëra dhe u shtri në më shumë se 20 qytete tjera të Francës. Kjo ngjarje shënoi një rën nga masakrat më të mëdha kundër protestantëve.

shkaktuar njerëzve të pafajshëm të popujve të tjerë, sidomos pjesës më të pambrojtur të popullsisë: fëmijëve dhe grave (...).

Jo vetëm që kam plotësisht të drejtë, por ato ngjarje që i kam përshkruar në rrëfimet e mia, janë lodra fëmijësh në krahasim me atë që u kanë bërë civilëve kosovarë djemt tanë. Gjatë kohës që isha në burg më kanë shkruar edhe priftërinj dhe murgj që kanë shërbyer në Kosovë. Në ditarrët e këtyre etërve përshkruhen, nga dita në ditë, mëkatet që bënin policët dhe ushtarët tanë. Ditarrët e këtyre priftërinjve dhe murgjve janë plot me shqiptarë të vrarë, shqiptare të dhunuara, fëmijë të vdekur dhe të djegur (...). Politikanët tanë, as që i komentojnë këto ngjarje e lëre më t'i dënojnë (...). Sado që dikush mendon se ky operacion ishte i justifikueshëm dhe i duhur në planin kombëtar, ose 'kombëtarisht i nevojshëm', qëllimi i operacionit «Patkoi» është kriminal.”¹

¹ Republika, Miroslav Filipović, «Dugi marš ka istini o zločinima», Nr. 263
http://www.yurope.com/zines/republika/arhiva/2001/263/263_16.html
<http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Vojna%20Tajna%20-%202%20Deo.pdf>
<http://pokretzapromene.blogspot.ch/2011/09/zaklela-se-zemlja-rajju-tajne-moraju-da.html>

KAPITULLI I GJASHTË

PROLOGU I KAPITULLIT TË GJASHTË

Masakër apo holokaust?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, periodikë të huaj të njohur-përrjashtoj ato franceze- iu kthyen sërish kësaj ngjarjeje disa muaj pas mbarimit të luftës dhe bënë hetime për të kuptuar se çfarë kishte ndodhur.

Më 23 shtator 1999, e përditshmja spanjolle El Pais publikoi një artikull të titulluar «Policët dhe juristët spanjollë nuk gjetën prova për gjenocid në veri të Kosovës».

Ja teksti i plotë:

«Krime lufte po, gjenocid jo! Ekipi i ekspertëve spanjollë- i përbërë nga funksionarë të kriminalistikës dhe juristë civilë- u tregua kategorik me të kthyer nga Istogu, zona veriore e Kosovës, e vendosur nën kontrollin e Legjionit. Të 187 kufomat e gjetura dhe të analizuar në nëntë vendbanime të vogla ishin varrosur në varreza individuale, në të shumtën e rasteve të orientuar nga Meka, për të respektuar besimin fetar të shqiptarëve të Kosovës. Kufomat nuk kishin shenja torturash. Nuk kishte asnjë varrezë masive... Së paku serbët nuk janë aq të këqij sa na i kanë përshkruar...»

Na thanë se jemi duke u nisur në zonën më të keqe të Kosovës dhe se duhej të përgatiteshim për të bërë autopsinë e 2000 kufomave, se do të duhej të punonin deri në fund të nëntorit. Rezultati është shumë më ndryshe. Zbuluam 187 kufoma dhe u kthyem” shpjegon Juan Lopez Palafox, përgjegjësi i seksionit antropologjik të kriminalistikës.

“Lexoj të dhënat e OKB-së, thotë Perez Pujol, drejtori i Institutit anatomik dhe juridik të Cartagena-s, dhe ata kanë filluar me shifrat prej 44.000 të vdekur, pastaj i zvogëluar në 22.000 dhe tani sillen rreth 11.000 të vrarë. Mezi pres të shoh në fund se sa do të dalin në të vërtetë!»¹

¹ Serge Halimi et Dominique Vidal, «L'opinion, ça se travaille....», f.46-47

«Spastrimi etnik» dhe gjenocidi

Në pjesën e mësipërme të këtij libri, lexuesi pati mundësi të shohë artikullimin mes propagandës së regjimit serb dhe autorëve të ndryshëm të shteteve perëndimore, për të hedhur poshtë vërtetësinë e ekzistimit të «Planit Patkoi».

Në vijim do të përpiqem të hedh dritë mbi arsyet e vërteta të mohimit të karakterit të qëllimshëm dhe të paramenduar të krimit kundër shqiptarëve të Kosovës dhe të nxjerr në shesh atë çka fshihet prapa tendencës për t'ua atribuuar “elementeve të pakontrolluara” nga strukturat shtetërore serbe, dhunën e ushtruar kundër shqiptarëve.

Më lart përmenda se politika e «spastrimit etnik», në formën e përpiluar nga regjimi i Milošević-it, filloi të zbatohet në Bosnje, kur banorët boshnjakë u detyruan të shpërngulen me dhunë¹. Përmasat e dhunës së ushtruar gjatë zbatimit të kësaj politike bënë që Asambleja e Përgjithshme e OKB-së të shprehë brengosjen e saj të thellë për përkeqësimin e gjendjes në Bosnje dhe Hercegovinë. Sipas rezolutës së 18 dhjetorit 1992 ky përkeqësim ndodhi “për shkak të intensifikimit të akteve të ndërmarra nga forcat serbe dhe malazeze për të pushtuar më shumë territore. Politika e pushtimit të territoreve të banuara nga myslimanët dhe kroatët e Bosnjës dhe Hercegovinës u manifestua me shkelje flagrante dhe të vazhdueshme të së drejtave të njeriut, rritje të numrit të refugjatëve si rezultat i dëbimit masiv nga shtëpitë e veta të civilëve të pambrojtur dhe zbatimit të politikës së neveritshme të «spastrimit etnik», që është një formë gjenocidi.”²

¹ Republika, Miroslav Filipović, artikulli i cituar «Dugi marš ...»

² Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 47/121, më 18.12.1992
http://www.un.org/french/documents/view_doc.asp?symbol=A/RES/47/121&TYPE=&referer=http://www.un.org/french/documents/ga/res/47/fres47.shtml&Lang=F

Cilësimi i politikës së «spastrimit etnik» si formë gjenocidi u bë edhe nga Konferenca Botërore e të Drejtave të Njeriut¹. Në raportin përfundimtar të kësaj Konference, pjesëmarrësit “vlerësuan se praktika e spastrimit etnik, si rezultat i agresionit serb kundër popullatës myslimane dhe kroate të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, përbën gjenocid dhe shkelje të rëndë të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit”²

Një nga vendimet e veçanta të kësaj Konference, që u shpreh përmes Deklaratës speciale për Bosnjën dhe Hercegovinën, kishte të bënte me kërkesën drejtuar komunitetit ndërkombëtar, organizatave ndërkombëtare dhe Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar thellimin e mëtejshëm të pasojave të politikës së gjenocidit dhe dënimin e personave të implikuar në zbatimin e gjenocidit në Bosnje dhe Hercegovinë³.

Këto kërkesa hasën në vesh të shurdhër të atyre që kishin përpiluar politikën e gjenocidit në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Jo vetëm që nuk u ndal intensiteti i dhunës, por, përkundrazi, në vitet në vijim dhuna u rrit me qëllim që të realizohej plotësisht projekti për ndryshimet demografike të territoreve të pushtuara.

Krimet në territoret e kontrolluara nga serbët e Bosnjës, rrethimi disavjeçar i Sarajevës, vrasjet masive në Srebrenica janë vetëm disa nga vendet ku u aplikua gjenocidi kundër boshnjakëve myslimanë. Në të njëjtën mënyrë u veprua kundër popullit kroat në Sllavininë Lindore, në Sllavininë Perëndimore, në Kraina, në Vukovar, në Dubrovnik dhe shumë qytete tjera të Kroacisë.

Politika e «spastrimit etnik» dhe akteve tjera të gjenocidit u aplikua edhe në Kosovë. Por, ndryshe nga sjellja e aktorëve kryesorë të skenës politike ndërkombëtare lidhur me situatën në

¹ Konferenca Botërore e të Drejtave të Njeriut u organizua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe u mbajt në Vjenë nga 14-25 qershor 1993.

² Nations Unis, Distr. Générale, A/CONF.157/24 (Part I), 13 octobre 1993 [http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf/\(Symbol\)/A.CONF.157.24+\(PART+I\).Fr?OpenDocument](http://www.unhcr.ch/huridocda/huridoca.nsf/(Symbol)/A.CONF.157.24+(PART+I).Fr?OpenDocument)

³ Po aty

Bosnje dhe në Kroaci, në rastin e Kosovës reagimet ishin shumë më të shpejta. Sa për ilustrim po përmend vetëm disa nga shembujt e shumtë. Kështu, Presidenti i SHBA-ve, Bill Clinton-i, Kryeministri i Britanisë së Madhe, Tony Blair-i, Ministri i Punëve të Jashtme i Britanisë së Madhe, Robin Cook-u, Presidenti i Francës, Jacques Chirac-u, Ministri i Mbrojtjes së Gjermanisë, Rudolf Scharping-u dhe shumë personalitete të skenës politike ndërkombëtare dënuan politikën e gjenocidit të aplikuar nga Serbia, ndërsa Milošević-in e cilësuan si “spastruesin etnik serial”¹ Në të njëjtën kohë ata premtuan se "operacioni i përbindshëm i spastrimit etnik, i planifikuar dhe i udhëhequr me cinizmin më të lartë dhe me mizoritë më të mëdha të regjimit serb (...) nuk do të triumfojë, sepse barbaria nuk mund të ketë fjalën e fundit. Drejtësia do të ngadhënjë dhe kriminelët do të japin llogari!”²

* * *

Para se të trajtoj çështjen e cilësimit të «spastrimit etnik» si formë gjenocidi dhe aplikimin e formave tjera të dhunës që përfshihen në nocionin «gjenocid» e shoh të udhës të ndalem shkurtimisht në nocionin «negacionizëm».

Autori Yves Torton-i, në shkrimin kushtuar problematikës së «negacionizmit», thekson se “ky neologjizëm³ shfaqet në një kontekst mjaft specifik: atë të përpjekjeve për të mohuar gjenocidin kundër hebrejve.”⁴

Nën pretekstin e rishikimit (revizionizmit) të historisë për të ardhur gjoja deri te e “vërteta” për «gjenocidin kundër hebrejve»,

¹ Florence Hartmann, *Paix et châtement*, (Paqja dhe ndëshkimi), Flammarion, 2007, f.16

² Anne-Sophie Paquez, La politique de la France au Kosovo était-elle “gaulliste” ?, f.42

<http://www.unige.ch/gsi/files/4914/0351/6343/paquez.pdf>

³ Për herë të parë përdoret nga historiani francez, Henry Rousso, në veprën «Le syndrome de Vichy (1944-1987)» Le Seuil, coll. «xx^e siècle», Paris, 383

⁴ Yves Torton, «La problématique du négationnisme», Revue l'Arche, numri i muajit maj, 2003

shih : <http://www.imprescriptible.fr/dossiers/ternon/negationnisme>

njerëz të profileve dhe të orientimeve të ndryshme rreshtohen në një front të përbashkët. Në këtë “front” gjejmë “ish-ushtarë të ushtrisë hitleriane të tipit të Warner Rademacher-it e Wilhelm Stäglich-it dhe njerëz të ekstremist të majtë, si Pierre Guillaume-i e Serge Thion-i; komunistë e socialistë si Paul Rassinier-i e Roger Garaudy¹, intelektualë të orientimit liberal, të orientimit konservator, të së djathtës ekstreme, neonazistëve (...) Aty gjenden autorë të përkatësisë nacionale gjermane, franceze, britanike, amerikane, italiane, suedeze, daneze, zvicerane, poloneze, ruse, spanjolle, marokene, jordaneze dhe të shumë nacionaliteteve të tjera. Sado paradoksale t’i duket dikujt, aty rreshtohen edhe hebrenj si Joseph Ginsburg, Roger-Guy Dommergue, David Cole, Stephen Hayard...”²

Përkundër dallimeve politike, ideologjike apo nacionale që kanë mes tyre, emëruet i përbashkët për të gjithë «negacionistët» që rishikojnë këtë aspekt të historisë së Luftës së Dytë Botërore është mohimi i vërtetësisë së «gjenocidit kundër hebrenjve». Për ta, “gjenocidi është një sajim i propagandës së aleatëve, është një gënjeshtër që ka për qëllim mashtrimin e publikut (...) Reich-i i III-të dëshironte t’i shpërngulte hebrenjtë e jo t’i likuidonte (...) Pohimet se janë vrarë mbi një milion hebrenj në Auschwitz janë gënjeshtër për të manipuluar opinionin publik... Në Auschwitz vdiqën maksimum 50.000 persona, kryesisht nga sëmundja e tifos (...) Nuk u gjet asnjë provë që të dëshmonte ekzistencën e dhomave të gazit... gazi është përdorur për të shfarosur pleshtat (...) Asnjë provë për krematorët... Nëse janë djegur kufomat, është bërë për shkak se kufomat bartnin me vete rrezikun e përhapjes së sëmundjes së tifos! Hitleri nuk ka urdhëruar e as ka pranuar që cilido

¹ Ky filozof komunist, ateist dhe ihtar i përbetuar i stalinizmit, konvertohet në krishtërizëm dhe pas disa vitesh eksperimentime me këtë religjion u konvertua në religjionin islam!

² Historical Revisionism – International and Independent Scientific Historical Research <http://vho.org/Intro/GB/index.html> dhe «Controverse sur l’extermination des juifs pas les Allemands», (Kundërthëniet lidhur me shfarosjen e hebrenjve nga gjermanët) http://archive.org/stream/LaControverseSurLexterminationDesJuifsParLesAllemands/bdf2_djvu.txt

qoftë të vritet për shkak të racës apo fesë së vet (...) Shkurt, pretendimi për gjenocid është gënjeshtër më tragjike dhe më makabre e të gjitha kohërave (...)"¹

Edhe pse «negacionizmi» lindi në një kontekst mjaft specifik, ky nocion merr përmasa shumë më të gjëra dhe mund të shërbejë për të analizuar qëndrimet që lidhen edhe me rastet tjera të mohimit të gjenocidit. Të gjithë atyre që u intereson të informohen për këtë nocion, shkrimi i lartpërmendur i Yves Torton-it jep një bazë të mjaftueshme për të orientuar hulumtimin. Në këtë analizë unë po kufizohem vetëm në disa përfundime që më duken të rëndësishme për të ndriçuar disa aspekte të temës që jam duke trajtuar.

Sipas analizës krahasuese që ndërmerr Yves Torton-i, “në të gjitha fazat e kryerjes së gjenocidit, fshehja e krimit e preokupon kriminelin (...) «Negacionizmi» nënkupton tërësinë e qëndrimeve të miratuara dhe shpjegimeve të dhëna për të mohuar vërtetësinë e gjenocidit ose një krimi kundër njerëzimit. Në këtë aspekt, mohimi i gjenocidit mund të konsiderohet si pjesë përbërëse e krimit, e ndërthurur me të, sepse përcakton strategjinë e shkatërrimit të së vërtetës dhe kujtesës. «Negacionizmi» nuk fillon me komplotin kriminal që projektonte vrasjen e një grupi njerëzor, por, kur gjenocidi është kryer, atëherë kur e vërteta del në shesh, «negacionizmi» synon të shkatërrojë bindjen lidhur me krimin dhe të futë dyshime për vërtetësinë e krimit (...) Si përfundim, «negacionizmi» është organizim i gënjeshtër në një sistem, funksioni i të cilit është shmangia nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë apo e tërthortë në kryerjen e gjenocidit.”²

¹ Përveç vepërës «Kundërthëniet lidhur me shfarosjen e hebrenjve nga gjermanët», informata të mjaftueshme për logjikën «negacioniste» të atyre që kërkojnë “rishikimin e historisë për t’i përmirësuar gënjeshtër për gjenocidin kundër hebrenjve” lexuesi mund t’i gjejë, në mestjerash, edhe në këto vepra të publikuara në internet:

Pierre Vidal-Naquet, «Les assassins de la mémoire» (Vrasja e Kujtesës) në: <http://www.anti-rev.org/textes/VidalNaquet87c/> dhe Bernard Comte, «Le génocide nazi et les négationnistes», (Gjenocidi nazist dhe negacionizmi) në : <http://www.phdn.org/negation/comte/IA.html>

² Revue l’Arche, Yves Torton, «La problématique du négationnisme», numri i muajit maj, 2003

shih: <http://www.imprescriptible.fr/dossiers/ternon/negationnisme>

Si në aspektin historik ashtu edhe në raport me opinionin publik ndërkombëtar, gjenocidi konsiderohet si krimi më i rëndë i mundshëm. Sidomos nga tragjedia që iu shkaktua popullit hebre gjatë Luftës së Dytë Botërore, ky krim ndërthen në vete një ngarkesë të madhe simbolike në kujtesën e popujve anekënd botës.

Pikërisht në funksion të shmangies së përgjegjësisë në kryerjen e gjenocidit, arsenali propagandistik i regjimit të Milošević-it dhe ata që shihnin te Slobodan Milošević-i “politikantin që i reziston imperializmit amerikan” e ngritën në sistem mohimin e gjenocidit në Bosnje, në Kroaci dhe në Kosovë. Në këtë kontekst duhet të shihen të gjitha artikujt, veprat, emisionet televizive dhe konferencat e mbajtura për të fshehur gjurmët e krimin.

* * *

Siç e përmenda më sipër, përmes rezolutës 47/121, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Konferenca Botërore e të Drejtave të Njeriut, që u organizua me kërkesën e kësaj Asambleje, e cilësuan politikën e «spastrimit etnik» si formë të gjenocidit dhe shkëlqje të rëndë të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit.¹

Kualifikimi i politikës së «spastrimit etnik» si formë gjenocidi përbën arsyen kryesore për të cilën autorët e ndryshëm mohojnë vërtetësinë e përpilimit dhe të zbatimit të një plani të tillë në Kosovë.

Edhe pse nga vetë serbët u publikuan dëshmi të shumta për planin e «spastrimit etnik» të Kosovës, Regis Debray-ja e Jean-Marie Le Pen-i, Serge Halimi e Bernard Lugan-i, Jürgen Elsässer-i e Udo Voigt-in, Christophe Blocher-i e Dick Marty, Jean-Arnault Dérens-i e Xavier Raufer-i, Pierre Péan-i dhe autorë të tjerë përpiquen ta “shpjegojnë” se dëbimi i shqiptarëve të Kosovës “nuk ishte projekt politik i pushtetit serb, por, plan i farkëtuar nga

¹ Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit u miratua dhe u propozua për nënshkrim dhe ratifikim apo aderim me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 260 A (III) të 9 dhjetorit 1948. Hyri në fuqi më 12 janar 1951

shërbimet e tjera sekrete, për t'ua veshur udhëheqësve serbë se gjoja kanë kryer krime me paramendim!” Madje, edhe në rastet kur këta autorë pranojnë se kishte shqiptarë të dëbuar nga forcat serbe, ata e cilësonin si rezultat të një strategjie ushtarake që synonte ‘pastrimin e terrenit’, për “të kursyer civilët shqiptarë” dhe “për të luftuar më lehtë kundër UÇK-së.”

Pa marrë parasysh se cilat janë motivet e secilit autor veç e veç, ajo që mund të konstatohet pa asnjë vështirësi në shkrimet apo në qëndrimet e tyre politike qëndron në faktin se të gjithë mohojnë gjenocidin në Kosovë, në të njëjtën mënyrë si Slobodan Milošević-i dhe propaganda zyrtare e regjimit të tij.

Për këta politologë e politikanë, sociologë e historianë, analistë e gazetarë, filozofë e kriminologë “u vërtetua se Plani «Patkoi» kishte qenë i rrejtshëm...se ishin mashtruar dhe i kishin mashtruar për gjenocidin në Kosovë...se tani e dimë që nuk ka pasur gjenocid, por vetëm masakra, të cilat nuk përngjajnë me gjenocidin...”¹

Me një fjalë, për «negacionistët », plani serb për «spastrimin etnik» të Kosovës nuk ka ekzistuar, sepse “origjinali” i këtij plani nuk u zbulua as pas “hapjes” së arkivave jugosllave!²

Ata që ishin aq të revoltuar kundër ndërhyrjes së NATO-s, me arsyen se kjo ndërhyrje ushtarake ishte bërë pa vendim eksplicit të Kombeve të Bashkuara, kur është fjala për të mbrojtur politikën e Milošević-it, të njëjtët autorë heshtin në tërësi rezolutën e OKB-së ku në mënyrë eksplicite theksohet se «spastrimi etnik» është formë e gjenocidit. Për këta autorë, krimi i gjenocidit lidhet vetëm me numrin e vrasjeve dhe ky “term” është i “rezervuar” vetëm për “indianët e Amerikës, për armenët, hebrenjtë dhe ruandezët.”³

¹ Serge Halimi, emisioni i cituar « Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3)» http://www.dailymotion.com/video/x4crrr_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

² Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, vepra e cituar, *L'Opinion ça se travaille...*, 2006, f.106

³ Po aty, f.105

Me qëllim që të “dëshmohej” se në Kosovë numri i të vrarëve ishte i vogël dhe se nuk mund të cilësohen si gjenocid, të “dëshmohej” se në Kosovë nuk ka pasur gjenocid, autorët në fjalë lëshohen në “analiza” krahasuese të shifrave të përmendura nga «natoistët»¹ dhe të dhënave lidhur me numrin e kufomave të zhvarrosura.

Për t'i paraqitur sa më të stërmadhuara shifrat e «natoistëve», në artikullin e titulluar «Kronika e një gjenocidi të shpallur»², Serge Halimi dhe Dominique Vidal-i sjellin deklaratat përmes të cilave shprehen brengosjet e “një përgjegjësi të administratës amerikane, i cili, më 18 prill 1999, citohej të ketë thënë për televizionin ABC se ndoshta dhjetëra mijëra të rinj ishin ekzekutuar... se, në të njëjtën frymë, Departamenti i Shtetit amerikan kishte shpallur që nuk kishte të dhëna për fatin e 500.000 kosovarëve dhe kishin shprehur frikën se mos ishin vrarë, ndërsa, një muaj më vonë, Ministri i Mbrojtjes, William Cohen-i, kishte theksuar se nuk dihej asgjë për fatin e 100.000 personave...”³

Në kapitullin paraprak përmenda vendimin qeveritar të Beogradit të 25 marsit 1999, mbi bazën e të cilit u dëbuan gazetarët e huaj nga Jugosllavia. Ky vendim synonte ta shndërronte Kosovën në një skenë ku tragjedia shqiptare luhej në «Teatër me dyer të mbyllura për mediat».

Sado e natyrshme të ishte brengosja për jetën e njerëzve, fati i të cilëve ishte në duart e “skenaristëve” që më parë kishin përgatitur dhe ekzekutuar tragjedinë e Vukovarit dhe Srebrenicës, për “armatën” e gazetarëve, politologëve, historianëve, publicistëve, politikanëve të orientimeve politike të majta e të djathta që kanë emëruar të përbashkët «antiamerikanizmin», këto deklaratat ishin në funksion të manipulimit të opinionit publik. Edhe më keq

¹ Neologjizëm që emërton mbështetësit e NATO-s

² Le monde diplomatique, Serge Halimi & Dominique Vidal, «Chronique d'un génocide annoncé», <http://www.monde-diplomatique.fr/cahier/kosovo/halimi>
Artikull i integruar në veprën e po të njëjtëve autorë *L'Opinion, ça se travaille...*

³ Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, vepra e cituar, *L'Opinion ça se travaille...*, 2006, f.42

se kaq! Me qëllim që të shtrohet terreni i manipulimit, deklaratat se “nuk dihej asgjë për fatin e qindra mijëra shqiptarëve” do të paraqiten në shkrimet e «antinatoistëve» sikur të ishin deklarata për qindra mijëra të vrarë!

Pas përfundimit të luftës dhe tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, publikimi i hipotezave për numrin eventual të të vrarëve do të shfrytëzohet për t'i krahasuar me shifrat e lartpërmendura.

Konkretisht “shifrat e shpallura nga Foreign Office, më 17 qershor 1999, se në Kosovë ishin vrarë përafërsisht 10.000 persona, shifër që do të përsëritet nga Clinton-i, më 25 qershor, ndërsa Bernard Kouchner-i, më 2 gusht, përmendi numrin e 11.000 kosovarë të zhvarrosur”¹ janë shifra që u cituan nga të gjithë autorët.

Serge Halimi dhe Dominique Vidal-i, në atë kohë gazetarë të «Le monde diplomatique»-ut, habiten pse “Le monde diplomatique-u, në numrin e muajit gusht, pohoi me shumë ngutje se «gjysma e 10.000 viktimave të supozuara ishin zhvarrosur”²

Për t'i banalizuar këto të dhëna, Serge Halimi dhe Dominique Vidal-i integruan në tërësi në veprën e tyre artikullin e botuar në gazetën «El Pais», më 23 shtator 1999, të titulluar «Policët dhe juristët spanjollë nuk gjetën prova për gjenocid në veri të Kosovës» dhe artikullin e filozofit anglez John Laughland-it³, të publikuar më 20 nëntor 1999 në gazetën «The Spektator»⁴.

“Sipas dëshmive të policëve dhe juristëve spanjoll, ata kishin ardhur në qytezën e Istogut⁵ të përgatitur për të bërë autopsinë e 2000 personave e realisht kishin zbuluar vetëm 187 kufoma!”⁶ Nga ana tjetër, John Laughland-i pohoi se Gjykata Ndërkombëtare e

¹ Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, vepra e cituar, *L'Opinion ça se travaille...*, 2006, f.45

² Po aty

³ Që ishte administrator i British Helsinki Human Rights Group

⁴ Serge Halimi et Dominique Vidal, *L'Opinion....*f.48-53

⁵ Istogundodhet në perëndim të Kosovës e jo në veri, siç pretendojnë “policët dhe juristët spanjollë që nuk kishin gjetur prova për gjenocid”!

⁶ Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, vepra e cituar, *L'Opinion ça se travaille...*, 2006, f.46-48

Hagës kishte zbuluar gjithsej 2108 kufoma, dhe kjo shifër është sa 1/5 e shifrës së shpallur nga Foreign Office-i, është sa 1/50 e shifrave të shpallur nga William Cohen-i dhe sa 1/250 e shifrave të shpallura nga Departamenti i Shtetit amerikan.”¹

Të njëjtat të dhëna i përdori edhe Patrick Barriot-i, koloneli i ushtrisë franceze i cili qëndroi në mision me trupat e OKB-së në Bosnje dhe Hercegovinë dhe gjatë procesit kundër Milošević-it shërbeu si dëshmitar i ftuar nga mbrojtja e tij!

Në veprën e tij «Djajtë u zgjidhën nga zinxhirët...»² Patrick Barriot-i shkruan: “E vërteta është se në fund të vitit 1999, ishin gjetur gjithsej 2018³ kufoma (serbë dhe të komuniteteve tjera)⁴ gjatë gjashtë muajve të hulumtimeve që bënë 500 kriminologët e Gjykatës Penale Ndërkombëtare.” Për të manipuluar me numrin e të vrarëve, Patrick Barriot-i përmend hipotezën e përgjegjësit të ekipit mjeko-ligjor spanjoll, Emilio Pérez Pujol-i, i cili kishte deklaruar se “llogariste që numri përfundimtar i viktimave të ishte maksimum 2500 persona, duke përfshirë edhe numrin e të vdekurve për arsye të pasqaruara dhe që nuk mund t’i vishen asnjë kampi të veçantë.”⁵

Një vit pas publikimit të letrës drejtuar presidentit francez, në veprën e titulluar «Emprise», Regis Debray-a shkruan se “krimi kundër njerëzimit nuk varet nga numri i kufomave.”⁶ Megjithatë, ai këmbëngul se “në Kosovë nuk ka pasur gjenocid”, se “Kosova nuk është Bosnje”⁷ sepse “atje një numër prej 500 kriminologësh nga shtete të ndryshme zbuluan dy mijë e njëqind e tetë⁸ kufoma e jo aq sa pretendonin Sekretari amerikan i mbrojtjes, presidenti

¹ Po aty, f.48

² Patrick Barriot, *Les diables sont déchainés: chronique des temps dehumanisants*, Editions l’Age d’Homme, 2000, f.226

³ Ndryshe nga autorët e tjerë, ky autor zvogëlon shifrën nga 2108 në 2018! Ndoshta gabim shtypi!

⁴ Ky dëshmitar që dëshmoi në mbrojtje të Milošević-it as që i përmend shqiptarët në mesin e viktimave.

⁵ Patrick Barriot, *Les diables sont déchainés...*, f.222

⁶ Regis Debray, *l’Emprise*, Gallimard, 2000, f.13

⁷ Po aty, f.13

⁸ Ndryshe nga të tjerët që sjellin shifra, Regis Debray -a numrin e shkruan me shkronja dhe këtu dallon nga të tjerët! Përndryshe, janë të njëjta referenca!

Clinton, shërbimet sekrete britanike etj.”¹ Për të mbështetur mohimin e gjenocidit në Kosovë Regis Debray-a bazohet në gazetatat «Sundy Times», «The Spectator» dhe gazeta të tjera të cituara më lart.

Pas publikimit të të dhënave që kishin për funksion të përgënjeshtroin shifrat e 10.000 të vrarëve, «negacionistët» e gjenocidit në Kosovë vazhdojnë listën e përgënjeshtimeve. Për të shpjeguar diferencën në mes të shifrave të shpallura për dhjetëra mijëra të vrarëve dhe 2108 kufomave që u gjetën gjatë asaj periudhe, sipas Serge Halimi-t e Dominique Vidal-it², «natoistët» “akuzojnë serbët se gjoja i kanë humbur gjurmët e krimit, duke përfshirë edhe krematorët.” Për t’i përgënjeshtuar pohimet e «natoistëve», këta dy gazetarë mbështeten në shkrimin e dy gazetarëve tjerë³, të cilët, më 31 dhjetor 1999, shkruan në «Wall Street Journal» se “tre xhandarë francezë, speleologë, kishin bërë hulumtime në minierën e Trepçës dhe nuk kishin gjetur asnjë kufomë. Një ekip tjetër kishte analizuar hirin dhe nuk kishin gjetur as dhëmbë të mbetur e as shenja të trupave të djegur.”⁴

Pesëmbëdhjetë vjet pas luftës, edhe pse dihet saktësisht se çfarë ka ndodhur në Kosovë, «negacionistët» e gjenocidit të aplikuar ndaj shqiptarëve vazhdojnë me të njëjtin avaz. Nga një autor te tjetri dhe nga një vepër te tjetra përsëriten të njëjtat fraza dhe citohen të njëjtët gazetarë për të ardhur te përfundimi se “nuk u gjet asnjë kufomë në furrat e shkritoreve të minierës...se nuk u gjet asnjë dhëmb njeriu... se as hiri nuk u gjet...” Shkurt, “fshehja e kufomave ishte gënjeshtëri e sajuar për të arsyetuar ndërhyrjen e NATO-s.”

Pas përmbyesjes së pushtetit të Milošević-it, Kryeministri i ri serb, Zoran Đinđić-i, i bëri publike operacionet e fshehjes së fakteve lidhur me krimet e bëra në Kosovë. Megjithatë, mbeturinat e regjimit të Milošević-it dhe «negacionistët» e lartpërmendur

¹ Regis Debray, vepër e cituar, *l'Emprise*, f.12

² Të njëjtin qëndrim kanë edhe autorët e tjerë.

³ Daniel Pearl dhe Robert Block,

⁴ Serge Halimi et Dominique Vidal, *L'Opinion, ça se travaille...*, f 55-56

vazhdojnë ta cilësojnë si gënjeshtër “fshehjen e kufomave të civilëve të vrarë në Kosovë”. Megjithëse mediat serbe publikuan dëshmi rrëqethëse për fatin e civilëve shqiptarë të vrarë nga forcat serbe dhe të fshehur me urdhër të strukturave shtetërore serbe, «negacionistët» që mohojnë gjenocidin në Kosovë këmbëngulin në qëndrimin se gjoja “fshehja e kufomave” ishte trillim i forcave të NATO-s për të arsyetuar mospërputhjen e shifrave të shpallura dhe realitetit të numrit të viktimave.

Sa për ilustrim po sjell për lexuesin një pjesë të shkurtër nga e përditshmja serbe, «Vreme». Në numrin e saj të 31 majit 2001, kjo gazetë botoi artikullin hulumtues të gazetarit Jovan Dulović-it, të titulluar «Si u fshehën gjurmët e krimit...»¹. Në këtë artikull, ndër të tjera, autori sjell detaje të raportit të Grupit punues që e kishte themeluar Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë për të ndriçuar operacionin «Thellësia 2»². Në bazë të këtij raporti, “në muajin mars të vitit 1999, në kabinetin e Slobodan Milošević-it, kryetarit të atëhershëm të RFJ-së, u mbajt një mbledhje në të cilën morën pjesë, krahas Milošević-it, edhe ministri i atëhershëm i Punëve të Brendshme, Vljako Stojiljković-i, shefi i Resorit për Siguri Publike në MPB të RS-së, Gjenerali Vlastimir Đorđević-i, shefi i Resorit të Sigurimit Shtetëror, Radomir Marinković-i dhe të tjerë³. Në këtë mbledhje Milošević-i urdhëroi Vljako Stojiljković-in që të ndërmerre të gjitha masat që të fshiheshin të gjitha gjurmët që mund të çonin në dëshmitë e ekzistencës së fakteve për krimet e kryera. Stojiljković-i e urdhëroi Vlastimir Đorđević-in që të kujdeset për zhvarrimin e civilëve të vrarë në Kosovë dhe fshehjen e kufomave për t’ua pamundësuar hetuesve të Gjykatës së Hagës t’i gjenin.”⁴ Edhe pse shumëkush ishte në dijeni të operacioneve për fshehjen e krimeve, këto operacione ishin shpallur si fshehtësi

¹ Vreme, «Kako su uklanjani tragovi zločina, gde su završili leševi iz hladnjače, da li je postojala "Dubina 1» (Si u hoqën gjurmët e krimit, ku përfunduan kufomat nga frigoriferët, a ka ekzistuar «Thellësia 1») Nr. 543, 31 Maj 2001
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=235705>

² «Dubina 2» në gjuhën serbe

³ Gazetari shtron pyetjen se kush fshihet prapa “të tjerëve” në Raportin e Grupit të punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

⁴ Vreme, artikulli i cituar: «Kako su uklanjani tragovi zločina...»

shtetërore. Gazetari serb, Jovan Dulović-i, përfundoi artikullin e tij hulumtues me hipotezën se koha do të dëshmonte për atë se sa ia kishin arritur qëllimit t'i fshihnin krimet e kryera në Kosovë!

Kjo sjellje e pushtetarëve të Beogradit është plotësisht e kup-tueshme kur dihet se “në të gjitha fazat e kryerjes së gjenocidit, fshehja e krimit e preokupon kriminelin...”¹ Qëllimi i një veprimi të tillë nga drejtuesit kryesorë të regjimit të Milošević-it ishte “shman-gia nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë apo e tërthortë në kryerjen e gjenocidit.”² Ndërsa, sa i përket mohimit të gjenocidit nga ana e autorëve të lartpërmendur qytetarë të shteteve perëndimore, dikujt mund t'i shkojë mendja se nuk kanë pasur mundësi t'i lexojnë shkrimet e shumta në gjuhën serbe lidhur me operacionet për fshehjen e fakteve. Në rast të tillë, ata kanë ardhur në konstatime të gabuara për shkak të “mungesës” së informatave. Fatkeqësisht realiteti është krejt ndryshe. «Negacionistët» e llojit të Regis Debray-së, Serge Halimi-t, Dominique Vidal-it, Jürgen Elsässer-it, Xavier Raufer-it, Pierre Péan-it, Jean-Arnault Dérens-it ishin në dijeni të plotë të fakteve, por, i heshtin me qëllim që të përpunojnë opinionin...

Po përmend vetëm një fakt që dëshmon se ata ishin në dijeni të plotë për djegien e kufomave të civilëve shqiptarë. Nga reagimet e shumta³ për operacionet e fshehjes së fakteve, reagimi i humanistes serbe, Nataša Kandić-it, themelueses dhe udhëheqëses së Fondit për të Drejtën Humanitare me qendër në Beograd, pati jehonë më të madhe se shkrimet e tjera që trajtojnë të njëjtën temë.

Shkrimi i saj me titull «Mačkatica si Auschwitz-i »⁴ u botua edhe në Portalin «Le courrier des Balkans», portal i themeluar dhe i udhëhequr nga Jean-Arnault Dérens-i.

¹ Yves Ternon, «La problématique du négationnisme», Revue l'Arche, numri i muajit maj, 2003

shih: <http://www.imprescriptible.fr/dossiers/ternon/negationnisme>

² Po aty

³ Nuk po ndalem në artikullin e Libération-it, «Charniers de la purification en Serbie» që trajton të njëjtën temë.

http://www.liberation.fr/evenement/2001/07/03/charniers-de-la-purification-en-serbie_370266

⁴ «Mačkatica kao Aušvic», teksti integral në:

<http://forum.cdm.me/archive/index.php/t-6219.html>

Në këtë artikull të përkthyer në gjuhën frënge me titull «Kosova: shërbimet sekrete serbe kanë fshehur krimet e luftës»¹, Nataša Kandić-i, sjell emrat e zinxhirit komandues që shkon nga kreu i shtetit, kryeministri, ministri i Punëve të Brendshme, shefi i Sigurisë Publike, shefi i Sigurimit shtetëror e deri te strukturat policore dhe të sigurisë në nivel lokal që ishin implikuar në djegien e kufomave të civilëve shqiptarë në furrat 4 dhe 5 të uzinës «Mačkatica» të Surdulica-s².

Katër muaj më vonë, i njëjti portal publikoi artikullin «Kosova: dëshmi të reja konfirmojnë djegien e trupave në Surdulica».³

Pas publikimit të dëshmive të shumta për djegien e trupave të civilëve shqiptarë, një numër prej atyre që ishin të implikuar në këto krime heshtën. Kishte edhe prej tyre që kërkuan falje publike. Vetëm një numër shumë i vogël i njerëzve të implikuar në këto krime, apo të atyre që duke fshehur krimin mendojnë se kanë kryer “detyrën patriotike”⁴, vazhdojnë ta mohojnë këtë krim të dyfishtë.

Kur trajtova rastin e vrasjes së vëllezërve Bytyqi, solla për lexuesin qëndrimin e gjeneralit serb, Vlastimir Đorđević-it, i cili në cilësinë e shefit të Resorit për Siguri Publike në MPB-së të RS-së, u dënua nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë me 27 vjet burg.

Ky gjeneral serb pranoi se ndihej fajtor për pjesëmarrjen në krimet kundër shqiptarëve të Kosovës dhe u kërkoi falje familjarëve të shqiptarëve të vvarë të Kosovës. Ai deklaroi publikisht se

¹ «Kosovo: les services secrets serbes ont couvert les crimes de guerre»
I përkthyer nga Thomas Claus
Publikuar në shtyp më 30 dhjetor 2004 dhe i vendosur në internet më 4 janar 2005
<http://balkans.courriers.info/article4945.html>
tekstin integral në gjuhën frënge mund ta lexoni edhe në:
<http://www.radicalparty.org/fr/content/kosovo-les-services-secrets-serbes-ont-couvert-les-crimes-de-guerre>

² Qytet në Jug të Serbisë

³ Kosovo: de nouveaux témoignages confirment les crémations de corps à Surdulica
26 prill 2005 në: <http://balkans.courriers.info/article5399.html>

⁴ Shprehje e përdorur nga Nataša Kandić-i

nuk kishte pasur fuqi t'i kundërvihet eprorit të vet, ministrit të Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, Vlastimir Stojiljković-it¹, në parandalimin e krimit dhe se ndihej fajtor që kishte marrë pjesë në operacionet e fshehjes së krimit..."²

Gjenerali i policisë serbe, Vlastimir Đorđević-i, që kishte zbatuar urdhrin për fshehjen e gjurmëve të krimit, kërkoi falje publike nga shqiptarët! Vetëm Serge Halimi, Jürgen Elsässer-i, Jean-Arnault Dérens-i, Xavier Raufer-i, Pierre Péan-i dhe «negacionistët» që mohojnë gjenocidin në Kosovë ngulin këmbë se "fshehja e kufomave" ishte trillim i forcave të NATO-s.

Ata nuk u ndalën me kaq. Mblodhën dhe ribotuan të gjithë artikujt që "hidhnin poshtë" pohimet se në Kosovë ka pasur gjenocid. Qëllimi i procedimit të këtillë është krijimi i përshtypjes se gjoja "zbulimet kishin dëshmuar (...) se numri i viktimave ishte shumë më i vogël" në krahasim me atë që kishin shpallur mbështetësit e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s.

Manipulime me gjoja përfundimin e hulumtimeve me "zbulimin e rreth 4000 shqiptarë dhe serbë të vrarë në Kosovë"³ është arrogancë e llojit të vet! Kjo arrogancë shoqërohet me një dimension manipulues, sepse statistikat e publikuara në një kontekst tjetër paraqiten si rezultate thuajse përfundimtare. Madje, Serge Halimi jo vetëm që revoltohet "pse nuk i gëzohemi këtij fakti", por, ai përpiqet të "shpjegojë" motivet pse nuk i gëzohemi numrit shumë më të vogël të viktimave në krahasim me atë që ishte shpallur. "U fsheh ky realitet dhe si pasojë e saj aktualisht

¹ I cili më 11 prill 2002, në ditën kur Kuvendi Federativ i Jugosllavisë miratoi ligjin për bashkëpunim me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, bëri vetëvrasje publikisht para ndërtesës së Kuvendit. Shih: B92, Vlastimir Stojiljković pucao sebi u glavu (Vlastimir Stojiljković-i goditi veten në kokë)

http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2002&mm=04&dd=11&nav_id=58055

² Kurir, «Priznao krivicu: Vlastimir Đorđević se izvinio žrtvama na Kosovu», (Pranoi fajin: Vlastimir Đorđević u kërkoi falje viktimave nga Kosova) <http://www.kurir-info.rs/priznao-krivicu-vlastimir-dordevic-se-izvinio-zrtvama-na-kosovu-clanak-787765>

³ Serge Halimi, Les médias pendant la guerre du Kosovo (2/3) http://www.dailymotion.com/video/x4crs7_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

pjesa më e madhe e njerëzve kanë përshtypjen se në Kosovë është kryer gjenocid. Sepse një gjë e tillë u është thënë shumë herë.”¹

Në të gjitha botimet dhe nga të gjithë autorët e lartpërmendur këmbëngulet në kor se gjoja “asgjë nuk ka mundur të zbulohet që të mbështetë akuzën për gjenocid, pos nëse banalizohet ky term duke e bërë sinonim të «masakrave» (...)»² se “në Kosovë nuk ka pasur gjenocid por masakra (...) dhe pse të krahasohen këta mijëra viktima me miliona indianë të Amerikës, me armenianë, hebrenj dhe ruandezë që ishin viktima të gjenocidit?”³

Cilësimi i krimeve serbe në Kosovë si «masakra» është i qëllimshëm, sepse ky nocion nuk bën pjesë në përkufizimin e krimin të gjenocidit.

Edhe në ribotimin e vitit 2006, pra shtatë vjet pas publikimeve të artikujve të integruar në veprën e tyre, Serge Halimi dhe Dominique Vidal-i i përsëritën në tërësi të gjitha të dhënat e lartpërmendura. Sa u përket shifrave të të vrarëve, i vetmi dallim qëndron në shtesën e titulluar «Pos-scriptum 2006: prova përmes budingut». Në këtë shtesë, autorët përmendin shifrën prej 3685 kufomave të zhvarrosura, shifër që ishte përmendur nga Prokurorja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Carla Del Ponte, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, më 12 nëntor të vitit 2000⁴! Në arsenalin e «negacionistëve» Serge Halimi dhe Dominique Vidal nuk mungon as ironia. Ata sjellin rastin e Laurent Joffrin, drejtorit të «Libération».

“Një vit pas luftës, drejtori⁵ i një të përditshme të madhe franceze pyet: «A ndryshojnë me të vërtetë gjërat nëse shpallen 4000 në vend të 10000 të vdekurve?» Për një propagandist, përgjigja është jo. Për një gazetar, përgjigja është po.”⁶ - i përgjigjen autorët e «Opinionin përpunohet...»

¹ Po aty

² Serge Halimi et Dominique Vidal, vepra e cituar, *L'Opinion, ça se travaille...* f.45

³ Po aty, f.105

⁴ Po aty, f. 105

⁵ Fjala është për Laurent Joffrin, drejtorin e «Libération»

⁶ Serge Halimi et Dominique Vidal, *L'Opinion, ça se travaille...f.105*

Për gazetarin e llojit të Serge Halimi-t shpallja e 3685 kufomave dallon nga numri 10.000 i të vrarëve dhe gjërat ndryshojnë sepse ai dhe lloji i tyre “nuk janë propagandistë”!

Edhe pse që nga raportimi i Carla Del Pontes kishin kaluar gjashtë vjet dhe shifrat ishin sqaruar për të gjithë ata që dëshironin të dinin përmasat reale të vrasjeve në Kosovë, «negacionistët» kufizohen qëllimisht në të dhënat e vitit 2000. Qëllimi i këtij kufizimi është i qartë: minimizimi i dhunës së ushtruar nga regjimi serb në Kosovë dhe mohimi i gjenocidit.

Këto informata do të përsëriten nga vepra në vepër dhe nga një autor në tjetrin deri në botimin e veprës së fundit të këtij lloji: veprën e Pierre Péan-it. Edhe pse kishin kaluar 14 vjet nga publikimi i parë i tyre, autori i pamfletit propagandistik «Kosova: një luftë e “drejtë” për një shtet mafioz» shpërndaui të njëjtat gënjeshtër. Ai dhe autorët e tjerë besojnë në teknikën e manipulimit me opinionin publik përmes përsëritjes së gënjeshtërës. Opinioni përpunohet, qoftë edhe përmes gënjeshtërave! Këtë gjë e dinë fare mirë të gjithë «negacionistët», sidomos autorët e veprës «Opinionin përpunohet...»

Sikur numri i të vrarëve të kishte qenë gënjeshtër në funksion të manipulimit për të arsytuar ndërhyrjen ushtarake të NATO-s dhe sikur realisht të dilnin parashikimet e atyre që mendonin se numri përfundimtar i viktimave të jetë maksimum 2500 persona, atëherë mund të pohoj më bindje të plotë se 8000-10000 familje shqiptare të Kosovës nuk do të jetonin me dhembjen e të afërmeve të vrarë gjatë kësaj lufte.

Të gjithë ata që kanë qenë të interesuar të njoftohen me përmasat e vrasjeve në Kosovë e dinë se numri i të vrarëve nga forcat serbe është 11.840 persona, prej të cilëve 1392 janë fëmijë, ndërsa 1739 gra¹. Kësaj shifre duhet t'i shtohet edhe shifra prej 1657² personave të cilët ende konsiderohen të zhdukur.

T'i kthehemi edhe një herë deklaratës së shefit të ekipit mjeko-ligjor spanjollë, Emilio Pérez Pujol-it, të cituar edhe në

¹ <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,145884>

² <http://koha.net/?id=27&l=33139>

Prologun e këtij kapitulli, se “policë dhe juristë spanjoll kishin shkuar në qytezën e Istogut të përgatitur për të bërë autopsinë e 2000 personave, e realisht kishin zbuluar vetëm 187 kufoma!”¹

Me qëllim që të sqarohet lexuesi për formën e manipulimit që bart me vete kjo deklaratë, më duhet të sjell të dhënat se qyteza e vogël e Istogut ishte nën “kompetencat” e Brigadës 125 të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave. Përveç Istogut, shtrirja territoriale e operacioneve të kësaj brigade përfshinte territorin e Leposaviqit, Zveçanit, Mitrovicës, Zubin Potokut, Skenderajt, Vushtrrisë, Klinës dhe Deçanit.

“Vetëm në territorin ku operonte Brigada 125 u vranë 1813 civilë shqiptarë ndërsa 216 persona konsiderohen ende të zhdukur. Në mesin e të vrarëve 236 ishin fëmijë ndërsa 327 ishin femra.”²

Këto të dhëna janë publikuar nga organizata joqeveritare serbe «Fondi për të Drejtën Humanitare» në Beograd, në dosjen e veçantë kushtuar krimeve të kësaj brigade. Burimet shqiptare flasin për numër edhe më të madh të vrarësh, por kjo çështje është sekondare në këtë rast. Në trajtimin e kësaj çështjeje do të ndalem më hollësisht rreth dosjes kushtuar Brigadës 125 dhe brigadave tjera të Motorizuara të Ushtrisë Jugosllave.

Të gjithë të interesuarit mund të shohin dosjen complete të krimeve të Brigadës 125 në faqen zyrtare të kësaj organizate joqeveritare serbe. Kjo dosje nxjerr në shesh se informimi i ekipeve mjeko-ligjore për rreth 2000 të vrarë në këtë pjesë të Kosovës përkonte me përmasat e krimeve të kryera. Është çështje tjetër pse dikujt i ka konvencuar të manipulojë me këto të dhëna sikur të ishin të dhëna “për Istogun, si zona më keqe e Kosovës”. Për lexuesin që nuk e njeh Kosovën po sqaroj se Istogu është një komunë shumë e vogël në perëndim të Kosovës e jo një zonë në veri të Kosovës, siç pretendojnë “policët dhe juristët spanjollë që nuk kishin gjetur prova për gjenocid”!

¹ Po aty, f.46-48

² Fond za humanitarno pravo, Dosije « 125. motorizovana brigada Vojske Jugoslavije”, f.1 (Dosja: Brigada e 125 e motorizuar e Ushtrisë së Jugosllavisë)
<http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/10/Dosije-125.pdf>

Nëse pyetjen e Laurent Joffrin-it, drejtorit të gazetës «Libération», e shtrojmë në raport me krimin e gjenocidit dhe sjellim shifrat e sakta, atëherë çështja është të dihet “a ndryshojnë me të vërtetë gjërat nëse shpallen 3685 në vend të 13497 të vrarëve dhe të zhdukurve?” Për një propagandist të regjimit të Milošević-it dhe për një «negacionist» të gjenocidit në Kosovë, përgjigja është po. Prandaj ata përpiqen të minimizojnë numrin. Ndërsa, për politologët, sociologët, juristët, historianët, analistët, gazetarët... përgjigja është jo!

Numri i të vrarëve mund të lidhet me përmasat e dhunës e jo me qëllimin. Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit përcakton se cilat akte hyjnë në këtë kategori krimi. Për këtë arsye, e shoh të udhës që shkurtimisht të ndalem në Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit, sepse kjo do të na mundësojë që të shohim mjetet e manipulimit që përdorin «negacionistët» për të mohuar gjenocidin në Kosovë.

Neni II i kësaj konvente përcakton format e dhunës dhe grupet shoqërore ndaj të cilëve aplikohet gjenocidi. Përveç vrasjeve të anëtarëve të grupit, kur ky akt bëhet me qëllim që grupi të shkatërrohet tërësisht apo pjesërisht, Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimin të Gjenocidit cilëson si forma të gjenocidit edhe cenimin e integritetit fizik ose mendor, nënshtrimin e qëllimshëm në kushte jetese që ndikojnë në shkatërrimin e grupit, pengimin e lindjeve të fëmijëve apo transferimin e foshnjave nga një grup te tjetri. Veprimet që përbëjnë gjenocidin kanë për qëllim shkatërrimin e tërësisht apo të pjesëshëm, fizik ose biologjik, të një grupi nacional, etnik, racor ose fetar, si të tillë¹.

Pra, sipas kësaj konvente “që të kualifikohet si gjenocid, akti kriminal duhet të jetë kryer me qëllim që të shkatërrohet tërësisht

¹ Teksti origjinal i Konventës:

<http://www.admin.ch/opc/fr/classified-compilation/19994549/201201250000/o.311.11.pdf>

Përkthimi shqip nuk është adekuat sepse në Nenin II mungon to gjalëshi “si të tillë”, e që është thelbësore për ta kualifikuar një akt kriminal si gjenocid.

http://kosovo.ohchr.org/repository/docs/Konventa_per_Parandalimin_dhe_Denimin_e_Krimin_te_Gjenocidit.pdf

ose pjesërisht një grup i caktuar nacional, etnik, racor ose fetar, si i tillë.”¹ Pra, është pikërisht «qëllimi» që të shkatërrohet tërësisht ose pjesërisht grupi «si tillë» ajo që e karakterizon gjenocidin dhe që e dallon nga krimet e tjera.

Në këtë përkufizim nuk përcaktohet asnjë numër, asnjë përqindje në bazë të së cilës shkatërrimi i pjesshëm i grupeve të lartpërmendura do të mund të konsiderohej si gjenocid. Në këtë kontekst po përmend studimin e Nicodème Ruhashyankiko-s, që u publikua si studim i Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së².

Në «Studimin e çështjes së parandalimit dhe ndëshkimit të krimit të gjenocidit» Ruhashyankiko-s thekson se “përkundër asaj që qëllimi i Konventës është parandalimi dhe ndëshkimi i akteve të gjenocidit të drejtuara kundër një numri të madh personash, asgjë nuk e ndalon që këto dispozita të interpretohen dhe të aplikohen në rastin e vrasjeve individuale. Edhe në rastet kur rezultati është vrasja e një personi të vetëm, fakti se qëllimi i kriminelit është drejtuar kundër jetës së më shumë se një anëtari të grupit nuk paraqet asnjë pengesë që dispozitat e Konventës të aplikohen edhe në këtë rast (...)”³

Megjithatë, një pjesë e autorëve mendojnë se për ta cilësuar krimin si gjenocid atëherë një numër më i madh personash duhet të jenë goditur nga ky veprim. “Disa flasin për «qindra» persona e të tjerë për «mijëra» viktimë”⁴, si kusht që të kualifikohet krimi si gjenocid.

Cilësimi i krimeve në Kosovë si gjenocid nuk ka për qëllim t’i “banalizojë” gjenocidet e aplikuara kundër popujve të tjerë në peri-

¹ Thomas Benages, *La Convention pour la Prévention et la Repression du Crime de Génocide à l’épreuve du Tribunal Pénal International pour l’Ex-Yougoslavie*, f.79

(teksti integral në: <http://tel.archives-ouvertes.fr/docs/00/66/25/79/PDF/2005CLF10281.pdf>)

² Kombet e Bashkuara, Këshilli Ekonomik dhe Social, e/cn.4/sub.2/416 4 korrik 1978

Nicodème Ruhashvankiko: *Study of the question of the prevention and punishment of the crime of genocide*

³ Po atë, f.15 & 52

file:///C:/Documents%20and%20Settings/IBM/Bureau/ruhshyankiko.pdf

⁴ Thomas Benages, vepra e cituar: *La Convention pour la Prévention*, f.143

dha të ndryshme kohore. Përkundrazi. Manipulimi me numrin e vrasjeve dhe heshtja e qëllimit për të shkatërruar shqiptarët e Kosovës, si «të tillë», paraqet një formë të banalizimit të krimeve me qëllim të mohimit të gjenocidit.

Sa i përket «qëllimit për të shkatërruar një grup nacional, etnik, racor ose fetar», që përbën thelbin e gjenocidit, nuk ka asnjë dallim mes gjenocidit të aplikuar nga regjimi i Hitler-it kundër hebrenjve dhe gjenocidit të aplikuar nga regjimi i Milošević-it kundër shqiptarëve të Kosovës. Dallimi qëndron në përmasat e realizimit të qëllimit. Nëse përmasat e gjenocidit në Kosovë janë pakrahasimisht më të vogla se përmasat e gjenocidit kundër hebrenjve, madje edhe në krahasim me përmasat e gjenocidit në Bosnje, ky realitet është si rezultat i “ndërgjegjësimit” të udhëheqësve të shtetit serb se pas ndërhyrjes ushtarake të NATO-s përgjegjësia për krimet e kryera ishte e pashmangshme. “Ndërgjegjësimit” i pushtetarëve të Beogradit se nuk mund t’i shpëtojnë ndëshkimit, i shtrëngoi që të ndërmarrin operacione për fshehjen e gjurmëve të krimeve dhe mohimin e qëllimit të pushtetit për të shkatërruar shqiptarët e Kosovës, si të tillë.

Kriminelët e regjimit të Beogradit dhe «negacionistët» e dinë se nëse nuk arrihet të dëshmohet «qëllimi» për të shkatërruar tërësisht apo pjesërisht shqiptarët e Kosovës, asnjë arsytim ideologjik apo politik nuk është i mjaftueshëm për ta kualifikuar krimin si gjenocid. Për këtë arsye, strategjia për të mohuar «qëllimin» dhe fshehja e gjurmëve u shndërruan “në sistem të shkatërrimit të së vërtetës dhe kujtesës... në sistem të shkatërrimit të bindjes lidhur me krimin dhe të futjes së dyshimit për vërtetësinë e krimin...”¹

Shtyllat kryesore rreth të cilit artikulohej ky sistem gënjeshttrash ishin mohimi i vrasjeve të civilëve shqiptarë në Reçak, mohimi i ekzistimit të «Planit Patkoi» që synonte «spastrimin etnik» të Kosovës, mohimi i qëllimit për të shkatërruar shqiptarët

¹ Yves Ternon, «La problématique du négationnisme», Revue l’Arche, numri i muajit maj, 2003
shih: <http://www.imprescriptible.fr/dossiers/ternon/negationnisme>

e Kosovës për shkak të përkatësisë së tyre etnike, mohimi i vrasjeve të civilëve shqiptarë apo minimizimi i përmasave të krimit e kështu me radhë.

Slobodan Milošević-i mohoi që pushteti i Beogradit kishte pasur për qëllim që të shkatërronte shqiptarët, mohoi se “ushtria dhe policia serbe kishin vrarë civilë të paarmatosur” dhe në rast se ishin vrarë civilë shqiptarë atëherë atë e kishin bërë “NATO-ja, terroristët e UÇK-së ose individë apo grupe që kishin qenë jashtë kontrollit shtetëror serb”!

Njëllonj si Milošević-i, edhe Regis Debray-ja mohoi vrasjen civilëve shqiptarë nga policia dhe ushtria serbe dhe krimet e vitit 1998 ia atribuoi UÇK-së, ndërsa ato të vitit 1999 “NATO-s, UÇK-së dhe individëve e grupeve të ‘pakontrolluara’ nga pushteti qendror i Beogradit.” Vetëm në raport me mohimin e gjenocidit në Kosovë mund të kuptohen shkaqet pse ky filozof francez shpërndau gënjeshtrenë se “në vitin 1998 ishin vrarë 1700 ushtarë shqiptarë të UÇK-së, 180 policë serbë dhe 120 ushtarë serbë!” Pra, saktësisht 2000 persona të vrarë, pjesëtarë të forcave të armatosura të të dyja palëve dhe asnjë civil i vrarë gjatë operacioneve luftarake! Kur është fjala për civilët e vrarë, për kategorinë që shqetësohej opinionin publik ndërkombëtar, Regis Debray-ja i “paanshëm” shpërndau dezinformatën e Shtabit strategjik të Milošević-it, përmes të cilës stigmatizohej UÇK-ja se gjoja kishte “rrembyer 380 persona, prej të cilëve 103 ishin liruar, ndërsa të tjerët kishin vdekur ose konsideroheshin të zhdukur.”

Edhe pse Vuk Drašković-i, dhe personalitete tjera të Serbisë denoncojnë publikisht strategjinë e aplikuar nga pushteti i Beogradit për të vrarë civilë të pafajshëm dhe për t’ua veshur këto krime UÇK-së, Regis Debray-ja manipulon edhe me emrin e këtij kundërshtari politik të Milošević-it se gjoja i paska thënë atij se “ishin arrestuar dhe paditur rreth 300 individë të ‘pakontrolluar’ nga pushteti për dhunën e ushtruar në Kosovë”!

Gënjeshtrenë për aktpadinë ndaj 300 pjesëtarëve që kishin bërë krime kundër civilëve shqiptarë të Kosovës e shpërndanë shërbimet sekrete serbe (ushtarake dhe policore) dhe në mediat në

shtetet perëndimore e përcollën intelektualët e kalibrit të Regis Debray-së. Në një deklaratë publike për «TV Mreža», 13 vjet më vonë, më 12 qershor 2012, gjenerali serb, i cili pas daljes në “pension” në vitin 2004 u angazhua në politikë në kuadër të Partisë Radikale Serbe, Božidar Delić-i, theksoi se “vetë kishte nënshkruar 300 kallëzime penale kundër ushtarëve dhe eprorëve që kishin qenë nën komandën e tij në atë kohë.”¹

Gjatë periudhës së luftës së Kosovës Božidar Delić-i ishte komandant i Brigadës 549 të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave. Sipas pohimit të tij “gjatë vitit 1998 dhe vitit 1999 ushtarët e Brigadës 549 vranë tetë civilë shqiptarë!”²

Gënjeshtër për ngritjen e aktpadisë penale kundër 300 pjesëmarrësve të Brigadës 549 për vrasjen e tetë civilëve shqiptarë synonte dy qëllime: së pari, të mohoj faktin se vrasjet e shqiptarëve, ishin qëllim i forcave policore dhe ushtarake serbe dhe realizim sistematik i një plani për ndryshimin e strukturës demografike të Kosovës. Qëllimi i dytë ishte minimizimi i përmasave të krimeve dhe fshehja e gjurmëve të gjenocidit.

13 vjet pas përfundimit të luftës, komandanti i kësaj brigade, i cili arriti të bëhet Nënkryetar i Parlamentit të Serbisë dhe anëtar i «Komitetit për Kosovë», tani nga pozicioni i “politikantit”, Božidar Delić-i, përhap gënjeshtërën për gjoja vetëm tetë civilë shqiptarë të vrarë nga Brigada 549! Jo vetëm që nga 300 kallëzimet penale nuk u dënua askush, as madje për tetë shqiptarët e vrarë që pohon Božidar Delić-i, por, “asnjë pjesëtar i kësaj brigade, qoftë vrasësit e drejtpërdrejtë, qoftë eprorët e Brigadës 549, askush nuk u përgjig për vrasjet në Kosovë”³.

¹ TV Mreza - Slučaj Dikovic (Tv Mreza-Rasti Dikovic)

Deklarata e plotë mund të shihet në:

<http://www.youtube.com/watch?v=rj1GPyhKGos&list=UUKDo3onD-oKCYs8DVlDd-eg&index=8&feature=plcp>

Deklarata e cituar nga Fondi për të Drejtën Humanitare,

Fond za humanitarno pravo, Dosije “549. motorizovana brigada Vojske Jugoslavije“, f.6

<http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/03/Dosijea-549.-Motorizovana-brigada-Vojske-Jugoslavije.pdf>

² Dosja Brigada 549..., f.11

³ Dosja Brigada 549..., f.10

Për të zhveshur të vërtetën para opinionit publik serb, Fondit për të Drejtën Humanitare publikoi «Dosjen për Brigadën 549 të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave.»¹

Sipas të dhënave të kësaj organizate joqeveritare serbe, Brigada 549, që operonte në komunat e Prizrenit, Gjakovës, Rahovecit dhe Suharekës nuk është përgjegjëse vetëm për tetë civilë shqiptarë të vrarë. Por, “kjo brigadë është përgjegjëse për vrasjen e 2174 personave civilë shqiptarë, prej të cilëve 459 kufoma u gjetën në varrezat masive në Serbi², ndërsa 375 persona ende konsiderohen të zhdukur.”³

Në këtë dosje të Fondit për të Drejtën Humanitare përshkruhen tmerret që kjo brigadë ka shkaktuar në Kosovë dhe jepen detaje për operacionet e vrasjeve vetëm në tetë fshatra të Kosovës.

Në të gjitha rastet e krimeve masive të përshkruara në këtë dosje, aksioni fillonte në orët e hershme të mëngjesit. Në intervalin kohor mes orës 03h00-06h00 forcat policore dhe ushtarake rrethonin fshatin, bombardonin shtëpitë me artileri, me tanke dhe me tërë arsenalin e armatimit që zotëronin dhe, në fund, grupe të vogla prej 3-5 ushtarësh dhe policësh hynin nëpër shtëpi, i keqtrajtonin, i poshtëronin dhe i frikësonin në mënyrat më brutale shqiptarët që kishin mbetur gjallë nga bombardimi. Disa i vrisnin në prani të familjes ndërsa të tjerët i nxirrnin jashtë shtëpive. Plaçkitez çdo gjë që kishte vlerë dhe që mund të bartej, asgjësoheshin dokumentet e identitetit të personave, bëhej seleksionimi dhe ndarja e burrave dhe fëmijëve të moshës mbi 13 vjeçare nga gratë dhe fëmijët. Gratë, fëmijët e moshës nën 13 vjeç dhe pleqtë dëboheshin për në Republikën e Shqipërisë ndërsa ata që ndale-

¹ Fond za humanitarno pravo, Dosije “549. motorizovana brigada Vojske Jugoslavije“, f.6

<http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/03/Dosijea-549.-Motorizovana-brigada-Vojske-Jugoslavije.pdf>

² Nga varreza masive e Batajnicës (afër Beogradit) u zhvarrosën 429 kufoma, ndërsa nga varreza masive e Perućes u zhvarrosën 30 kufoma civilësh shqiptarë. Të dhënat janë të Fondit për të Drejtën Humanitare

³ Dosja Brigada 549..., f.3

<http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/03/Dosijea-549.-Motorizovana-brigada-Vojske-Jugoslavije.pdf>

shin poshtëroheshin, keqtrajtoheshin dhe në fund ekzekutoheshin në grupe. Në fund, kufomat e tyre digjeshin ose dërgoheshin në varreza kolektive në vendndodje të fshehta¹.

Kështu, dosja fillon me rastin e vrasjes së civilëve në fshatin Bellacërkë, ku u vranë 65 civilë shqiptarë. Nga 54 kufoma të zhvarrosura, autopsia e të cilave ishte bërë nga Seksioni i Mjekësisë ligjore i Universitetit të Glazgow (Skoci), 47 ishin kufoma meshkujsh (prej të cilëve tre ishin fëmijë) dhe shtatë kufoma femrash (katër vajza të reja)². Një vend i veçantë në dosje i kushtohet tragjedisë që përjetuan familjet Zhuniqi dhe Spahiu të këtij fshati. “Pesë anëtarë të familjes Zhuniqi (Çlirim, Lumturie, Dhurata, Dardane dhe Dardan), dhe shtatë anëtarë të familjes Spahiu (Xhemajl, Qamile, Fiqirie, Ilirjana, Marigona, Labinot dhe Lirim) u vranë në këtë fshat dhe nga këto familje shpëtoi vetëm fëmija 4 vjeçar, Shkodran Zhuniqi.”³

Qëllimi për të shkatërruar pjesërisht shqiptarët me qëllim që të zvogëlonin numrin e tyre në Kosovë nuk kurseu as invalidët⁴.

Në fshatin Celinë, në një skenar të ngjashëm, u ekzekutuan 81 civilë shqiptarë⁵. Nga 78 kufoma që u gjetën pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, 18 kufoma ishin të djegura⁶.

Në mesin e të vrarëve, 13 persona ishin fëmijë të moshës nën 18 vjeç. Tragjedia e vërtetë goditi familjen Zeqiri të këtij fshati, të cilës ju vranë tetë fëmijët: Alma (18 muajshe), Albani (5 vjeç), Bledari (8 vjeç), Besarti (10 vjeç), Albulena (11 vjeç), Suzana (11 vjeç), Burbuqja (13 vjeç), Nazlija (16 vjeç). Krahas fëmijëve të familjes Zeqiri, në këtë fshat u vranë edhe Ramazan Salihu (8 vjeç), Alban Rexhepi (14 vjeç), Bedrush Hasani (15 vjeç), Mejreme Salihu (15 vjeç) dhe Gëzim Salihu (17 vjeç)⁷.

¹ Dosja Brigada 125, ndër të tjera edhe në f.1

² Dosja Brigada 549, f.14

³ Dosja Brigada 549, f.12

⁴ Siç ishte rasti me invalidin Mustafë Morina nga Bellacërkës apo dy të paralizuar të fshatit Krushë e Vogël (Liman dhe Sahit Jasharin) Dosja Brigada 549, f.13 dhe f.19.

⁵ Dosja Brigada 549, f.15

⁶ Dosja Brigada 549, f.19

⁷ Dosja Brigada 549, f.17

Në rrugën kryesore të fshatit Krushë e Vogël burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët. Djemtë e moshës mbi 13 vjeç u urdhëruan t'i bashkohen grupit të burrave.



Nga kolona e grave dhe fëmijëve u ndanë katër fëmijë (vëllezërit Burim e Lirim Batusha dhe Visar e Enver Batusha) dhe i detyruan t'i bashkohen grupit të burrave.

120 civilë shqiptarë, në mesin e të cilëve edhe Mehmet Shehu (13 vjeç), Xhelal Shehu (13 vjeç), Abdyl Baliu (72 vjeç)...¹ u futën në stallën e Qazim Batushës dhe, përmes dritareve, filluan të shtinin me armë për disa minuta rresht. Pastaj u kontrollua stalla nga brenda dhe vazhduan të shtinin kundër atyre që jepnin shenja jete². Në fund, kufomat u dogjën³.

Edhe në fshatin Krushë e Madhe, e njëjta formë krimi. Vetëm në stallën e Selami Elshanit u vranë 18 civilë, kufomat e të cilëve u mbuluan me sanë dhe u dogjën⁴. Sipas burimeve të Fondit për të Drejtën Humanitare edhe në vendet tjera të këtij fshatit forcat serbe vranë gjithsej 204 civilë shqiptarë⁵.

Në shtëpinë e Musli Gashit të fshatit Tërnjë ishin strehuar 15 gra dhe vajza. Të gjitha u ekzekutuan. Fondi për të Drejtën Humanitare, në faqen 25 të kësaj dosje, sjell emrat e këtyre femrave të ekzekutuara. Pastaj Batalioni i prapavijës mori me vete kufomat e grave dhe vajzave dhe i varrosi në varreza masive në rrethin e Dragashit. Në fshatin Tërnjë forcat serbe vranë 36 civilë shqiptarë. Ende nuk janë gjetur kufomat e 20 personave të vrarë në këtë fshat⁶. Në Landovicë, në të njëjtën formë u ekzekutuan 17 civilë shqiptarë⁷. Në Lubizhdë të Hasit u vranë 53 civilë⁸. Në fshatin Mejë u vranë 277 civilë ndërsa në fshatin Koreticë 67...⁹

Shkurt, gënjeshtër për gjoja 300 kallëzimet penale dhe minimizimi i numrit të të vrarëve u bë në funksion të shmangies së përgjegjësisë së drejtpërdrejtë apo të tërthortë në kryerjen e gjenocidit. Duke parë zhvillimet për 15 vitet që pasuan përfundimin e luftës, mund të konstatojmë me keqardhje se në këtë

¹ Dosja Brigada 549, f.19

² Dosja Brigada 549, f.19

³ Dosja Brigada 549, f.20, Në faqen 21 të Dosjes për krimet e Brigadës 549 sillen emrat e 111 civilëve të ekzekutuar në këtë stallë.

⁴ Dosja Brigada 549, f.23

⁵ f.24 Burimet shqiptare sjellin të dhënat për 241 civilë të vrarë

⁶ Dosja Brigada 549, f.26

⁷ Dosja Brigada 549, f.27

⁸ Dosja Brigada 549, f.28

⁹ Dosja Brigada 549, f.35 Për ata që u interesojnë detajet, në faqen 36-37 të Dosjes për Brigadën 549 sillen emrat e të ekzekutuarve.

aspekt ia kanë arritur qëllimit. Jo vetëm që “asnjë pjesëtar i kësaj brigade nuk u përgjigj për vrasjen e 2174 civilëve shqiptarë në komunitatet e Prizrenit, Gjakovës, Rahovecit dhe Suharekës, por, përkundrazi, të gjithë eprorët¹ e Brigadës 549 u ngritën në funksione.”²

Përkundër të gjitha fakteve, mbrojtësit e regjimit të Milošević-it dhe «negacionistë» të tjerë të gjenocidit në Kosovë, edhe në rastet kur fajësohen serbët për vrasje të civilëve shqiptarë, vazhdojnë t'i paraqesin vrasjet sikur janë kryer vrasje nga njerëz “të pakontrolluar prej pushtetit qendror të Beogradit”.

Edhe kësaj radhe do të sjell për lexuesin të dhënat e publikuara nga Organizata Joqeveritare serbe, Fondi për të Drejtën Humanitare. Materiali i titulluar «Dosja e Lubiša Diković-it» që flet për krimet e «Brigadës 37 të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave»³ e zhvesh më së miri pretendimin për “elementet e pakontrolluara” që bënë krime në Kosovë.

Fjala është për Brigadën e 37 të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave që ishte e stacionuar në Raška dhe ishte nën komandën e Lubiša Diković-it⁴. Disa njësi luftarake të kësaj brigade ishin të pranishme në Kosovë që nga maji i vitit 1998.

“Para se këto njësi të dërgoheshin në Kosovë, shumë oficerë ushtarakë të Brigadës 37, në mesin e të cilëve edhe nënkolonelët Slobodan Stoišić-i dhe Miodrag Đorđević-i, kanë rekrutuar dhe trajnuar grupe kriminelësh.

Me kërkesë të shërbimeve të fshehta ushtarakë dhe policore, gjykatat liruan nga burgjet shumë kriminelë të dënuar për vrasje. Nënkoloneli Stoišić-i i pajisi me uniforma, armë të mira, mjete kimike dhe mjete të tjera të nevojshme për likuidime, dokumente

¹ Në faqet 37-40 të Dosjes së Brigadës 549, Fondi për të Drejtën Humanitare sjell emrat e zinxhirit komandues që ishte implikuar në këto krime.

² Dosja Brigada 549..., f.10

³ Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubise, (Dosja e Lubiša Diković-it) <http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2012/01/Januar-23-2012-Dikovic-Ljubisa-Dosije.pdf>

⁴ Qytet në jug të Serbisë.

dhe simbole të përkatësisë së Sigurimit Ushtarak¹. Kriminelët u integruan në Sigurimin ushtarak dhe ishin nën komandën e Slobodan Stoišić-i dhe Miodrag Đorđević-i². Pas trajnimit, në muajin korrik të 1998 ata u dërguan në Kosovë.

Më 7 mars 1999, disa ditë para se të përmbylleshin bisedimet e filluara në Konferencën Ndërkombëtare të Rambouillet-së, Brigada 37 u transferua tërësisht në Kosovë. Kjo brigadë vepronte si mbështetje zjarri për futjen e njërive ushtarake dhe policore në fshatrat shqiptare ku kryheshin vrasje masive të civilëve shqiptarë, plaçkitje dhe asgjësime pronash³.

Transferimi i tërësishëm i kësaj Brigade nga Raška në Kosovë ishte tregues për qëndrimin e regjimit të Beogradit për të vazhduar logjikën e luftës dhe realizimin e planit të gjenocidit në Kosovë.

Në të njëjtën mënyrë siç vepronte Brigada 549, edhe Brigada 37 i fillonte operacionet në orët e hershme të mëngjesit, granatimet me tërë arsenalin e armatimit që posedonin, hyrjen në grupe të vogla ushtarësh dhe policësh në shtëpitë e shqiptarëve, bastisjet, plaçkitjet, keqtrajtimet, nxjerrjen e fshatarëve të mbijetuar nga shtëpitë e tyre, seleksionimin e njerëzve të cilët duhet të vriteshin dhe të atyre që do të dëboheshin nga Kosova.

Në këtë shkrim po sjell vetëm disa nga rastet e përshkruara në Dosjen e Fondit për të Drejtën Humanitare. Të gjithë lexuesit që janë të interesuar për të ditur lidhur me detajet e tërësishme të dosjeve të krimeve që forcat serbe bënë në Kosovë u sugjeroj të shohin në rubrikën «dosjet» të faqes zyrtare të Fondit për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd⁴.

¹ Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubiše, (Dosja e Lubiša Diković-it), f.2 <http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2012/01/Januar-23-2012-Dikovic-Ljubisa-Dosije.pdf>

² Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubiše, (Dosja e Lubiša Diković-it), f. 2

³ Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubiše, (Dosja e Lubiša Diković-it), f. 4

⁴ Humanitarian Law Center, Dossiers <http://www.hlc-rdc.org/?cat=290&lang=de>
Dosjet janë në gjuhën angleze dhe serbe.

Po përmend rastin e fshatit Kozhicë. Në shtëpinë e Abedin Durmishit, banor i këtij fshati, forcat serbe ngujuan 115 vajza të reja, gra, fëmijë dhe plaka. Në katin përdhes i mbyllën 31 femra dhe fëmijë. Pastaj sollën edhe 88 fëmijë shqiptarë, 28 prej të cilëve i mbyllën në katin përdhes ndërsa 60 në katin e dytë. Pastaj, u seleksionuan 27 gra dhe fëmijë dhe u dërguan në fshatin Qirez. Disa prej grave ishin shtatzëna (4 muajsh-8 muajsh)¹ Këto gra u dhunuan, u keqtrajtuat seksualisht dhe në fund u vranë.

Pesë vajza të reja: Zahide Xhema (19 vjeçare), Lumnie Zymberi (20 vjeçare) Antigona Dibrani (20 vjeçare), Bukurie Dibrani (20 vjeçare) Mirishahe Dibrani (17 vjeçare) dhe tri gra: Miradije Dibrani, Tahire Shllaku dhe Fahrije Ademi u hodhën në tri bunarët e fshatit Qirez. Kufomat e tyre u zbuluan në muajin korrik të vitit 1999².

Fondi për të Drejtën Humanitare në faqet 5-8 të Dosjes për Ljubiša Diković-in sjell detajet për ekzekutimin e 250 civilëve shqiptarë, prej të cilëve 25 ishin të mitur. Nga 25 të miturit e ekzekutuar, emrat e të cilëve publikohen në faqen 8 të kësaj dosje, 24 kufoma u gjetën, ndërsa kufoma e Nuredin Dvoranit, i lindur më 28 maj 1982, nuk u gjet dhe ende konsiderohet i zhdukur³.

Në fshatin Vërboc, i njëjti skenar. Bombardime që në orët e hershme të mëngjesit. Fshatarët e tmerruar u përpoqën të fshiheshin në pyllin afër fshatit. Pasi depërtuan në fshat, policia dhe ushtria serbe vazhduan përgjatë ditës kërkimet në pyll. Që t'ua pamundësonin qëndrimin në pyll ata i vunë zjarrin pyllit dhe ekzekutuan çdo person që gjetën. Gjithsej 92 civilë shqiptarë të këtij fshati u vranë⁴. Në fshatrat Dashec, Baks, Çikatovë e Vjetër dhe Izbicë i njëjti skenar.

¹ Në dosje përmenden Fahrije Zymberi dhe Violeta Shalaku që ishin shtatzana në muajin e tetë. Dosije Diković Ljubiše 37, f.5, fusnota 11.

² Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubiše, (Dosja e Lubiša Diković-it), f. 5

³ Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubiše, (Dosja e Lubiša Diković-it), f. 8

⁴ Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubiše, (Dosja e Lubiša Diković-it), f. 9-10 (emrat e të vranëve u publikuan në faqen 10)

Lubiša Diković-in ishte përgjegjës për këto akte gjenocidare sepse ishte komandues dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në aksione. Krahas implikimit në vrasje, ky komandant i Ushtrisë serbe ishte edhe përfitues nga plaçkitja e pasurisë së shqiptarëve të Kosovës. Në dosjen për krimet e Brigadës 37 të Motorizuar të Ushtrisë Jugosllave përmendet se nga “mijëra mjete automobili-stike, autobusë, kamionë, traktorë që u ishin plaçkitur shqiptarëve të Kosovës dhe që ishin shitur në Novi Pazar dhe në Raška¹, Lubiša Diković-i kishte përvetësuar një Landrover të shtrenjtë amerikan, një Mercedes 300 dhe u bë pronar i mijëra krerëve të kafshëve që u ishin plaçkitur fshatarëve shqiptarë².

Pas tërheqjes nga Kosova, më 16 qershor 1999 Slobodan Milošević-i e dekoroi me dekoratën Heroi i popullit³. Ndërsa më 12 dhjetor 2011 Kryetari i Republikës së Serbisë, Boris Tadić-i, e emëroi Lubiša Diković-in në postin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë serbe. Presidenti serb, Boris Tadić-i, që propozonte për Kosovën autonomi nën juridiksionin e Serbisë, konsiderohej nga Dick Marty dhe «negacionistët» e gjenocidit në Kosovë si të ishte “demokrat”, propozimin e të cilit duhej ta merrnim si “një shans”⁴, nuk gjeti asnjë ushtarak tjetër serb për ta caktuar në krye të Ushtrisë serbe, pos kriminelit Lubiša Diković-it! Ky ishte një mesazh i qartë se strukturat e reja të pushtetit në Serbi veprojnë me mentalitetin e vjetër dhe janë tërësisht të implikuar në fshehjen dhe mohimin e gjenocidit që ky shtet aplikoi kundër shqiptarëve të Kosovës.

Në pjesën e mësipërme përmenda dosjen e krimeve të shkaktuara në zonën ku operonte Brigada 125 e Motorizuar e Ushtrisë Jugosllave. Vetëm në komunat e vogla të Leposaviqit, Zveçanit,

¹ Dy qytete në Serbinë jugore

² Fond za humanitarno pravo, Dosije Diković Ljubiše, (Dosja e Lubiša Diković-it), f.4

³ E-Novine, FHP optužuje generala Ljubišu Dikovića, «Načelnik Generalštaba-heroj ili zlikova» (Shefi i Shtabit të Përgjithshëm-hero apo kriminel) <http://www.e-novine.com/srbija/vesti/57638-Naelnik-Generaltaba---heroj-ili-zlikovac.html>

⁴ Réseau Voltaire, intervista e cituar e Dick Marty-t: «L'indépendance du Kosovo n'a pas été décidée à Pristina»

Mitrovicës, Zubin Potokut, Skenderajt, Vushtrrisë, Klinës, Istogut dhe Deçanit “u vranë 1813 civilë shqiptarë ndërsa 216 ende konsiderohen të zhdukur. Në mesin e të vrarëve 236 ishin fëmijë ndërsa 327 ishin femra.”¹

Në dosjen e krimeve të kësaj Brigade, lexuesi mund të njihet me vrasjet masive në fshatin Oshlan, Dubravë, Obri, Skenderaj, Lubeniq, Krelan, Staradran, Qyshk, Pavlan dhe Zahaq.

Asnjë pjesëtar i Brigadës 125 nuk është përgjegjur për krimet që kanë kryer personalisht e as për shkak të përgjegjësisë komanduese². Në faqet 6-7 të kësaj dosje, Fondi për të Drejtën Humanitare publikon emrat e kuadrit komandues të Brigadës 125 që ishin përgjegjës për krimet.

Me një fjalë, krimet e kryera në Kosovë nuk kanë qenë jashtë kontrollit të strukturave politike, ushtarake dhe policore serbe, por ishin rezultat i një plani që synonte shkatërrimin e shqiptarëve si të tillë dhe ndryshimin e strukturës së popullsisë së Kosovës. Të gjitha aktet e dhunës që forcat serbe kryen ndaj shqiptarëve të Kosovës (vrasjet, plagosjet, keqtrajtimet, dhunimet seksuale, poshtërimet, cenimet e integritetit fizik dhe mental të tyre, dëbimit nga Kosova etj) kishin për qëllim të shkatërronin fizikisht një pjesë të shqiptarëve për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

Vrasja sistematike e civilëve të paarmatosur shqiptarë, vrasja e fëmijëve, e grave dhe e pleqve që nuk paraqisnin asnjë rrezik ushtarak dhe që nuk shfaqën asnjë rezistencë përballë operacioneve për dëbimin e shqiptarëve të Kosovës, dëshmon se qëllimi i pushtetit të Beogradit ishte të shkatërrohen shqiptarët e Kosovës, si të tillë.

Krahas vrasjeve që synonin shkatërrimin fizik të shqiptarëve të Kosovës, forcat serbe aplikuan edhe formën e «gjenocidit biologjik». Gjenocidi biologjik është më i fshehtë, nuk manifestohet me viktima të mëdha. Kjo formë e gjenocidit kontribuon në shkatë-

¹ Fond za humanitarno pravo, Dosije «125. motorizovana brigada Vojske Jugoslavije», f.1
<http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/10/Dosije-125.pdf>

² Dosja Brigada 125, f.1-2

rrimin e popullsisë dhe modifikimin e konsiderueshëm të strukturës demografike të një vendi, pa shkaktuar humbje të dukshme në njerëz.

Në përputhje me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, cenimi i integritetit fizik dhe mental të anëtarëve të një grupi nacional, etnik, racor apo religjioz përbën akt të gjenocidit. Sot askush nuk mund ta kontestojë faktin se dhunimi dhe dhuna seksuale mbi një femër përbën cenim të rëndë të integritetit fizik apo mental të personit të dhunuar. Dhunimet seksuale në Bosnje, në Kroaci dhe Kosovë u bënë si mjet bashkëkohor i luftës dhe synonin “shkaktimin e dëmeve të pariparueshme ndaj anëtarëve të grupit. Aq më tepër kur ky keqtrajtim është bërë me atë qëllim.”¹ Dhunimi dhe dhuna seksuale përbëjnë shkelje të Konventës së lartpërmendur sepse Dhunimi i shkakton viktimës traumatizëm dhe plagë të pashlyera psikologjike.

Në veprën e tij të titulluar «Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit në sprovë të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë» Thomas Benages thekson se “Dhunimet si armë për të shkatërruar gratë si mjet që riprodhon grupin, apo me qëllim që të krijojë fëmijën e padëshiruar (pjellë të dhunimit), përbëjnë bazën e inkriminimit për gjenocid për shkak se shprehet në formën e «masave që synojnë pengimin e lindjes në kuadër të grupit.»²

Duke u bazuar në faktin se dhunimi paraqet një cenim të rëndë të integritetit fizik dhe mental të viktimës, Gjykata Penale Ndërkombëtare për Rwandën e cilësoi dhunimin si formë e gjenocidit. Ndërsa, për Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë do të flas më poshtë.

Vetëm «negacionistët» e gjenocidit në Bosnje, në Kroaci dhe në Kosovë e mohojnë faktin se dhunimi i femrave përbën akt të gjenocidit biologjik.

¹ Thomas Benages, La Convention pour la Prévention et la Répression du Crime de Génocide à l'épreuve du Tribunal Pénal International pour l'Ex -Yugoslavie, f.152 (teksti integral në:
<http://tel.archives-ouvertes.fr/docs/00/66/25/79/PDF/2005CLF10281.pdf>)

² Po aty, f. 155

“Gjatë luftës në Kosovë u dhunuan 20.400 femra shqiptare”¹ me qëllim që të goditet “gruaja, simboli i vazhdimësisë biologjike të grupit. Këto akte kishin për qëllim të goditej femra si nënë e ardhshme, qoftë për ta cenuar integritetin e saj fizik dhe moral, qoftë për ta penguar të krijojë vazhdimësinë e grupit”.

Sipas Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit nuk duhet të ketë miliona të vrarë për ta cilësuar krimin si gjenocid. Vrasja e 1392 fëmijëve shqiptarë, vrasja e 1739 grave shqiptare, vrasja e rreth 10.000 civilëve të tjerë shqiptarë të të gjitha moshave, dhunimi i 20.400 femrave shqiptare dhe zhdukja e 1657 kufomave civile dëshmojnë se forcat serbe aplikuan gjenocidin fizik dhe biologjik në Kosovë.

Vetëm njerëzit e strukturave politike, ushtarake dhe policore serbe që ishin të implikuar në kryerjen e gjenocidit mundohen ta mohojnë se qëllimi i regjimit të Serbisë ishte shkatërrimi i shqiptarëve të Kosovës, si të tillë.

Vetëm «negacionistët» e regjimit të Milošević-in, që ishin ngarkuar të fshehin gjurmët e krimit të gjenocidit, dhe «negacionistët» e verbuar nga ideologjia e «anti-amerikanizmit» e minimizojnë krimin dhe përpiqen ta paraqesin si të “paparamenduar”. Pra, sipas tyre, qëllimi që të shkatërrojnë shqiptarët përmes vrasjeve, dhunimeve dhe dëbimeve vetëm për shkak të pranisë së tyre etnike në Kosovë ishte i “paplanifikuar”!

Ti kthehemi edhe një herë çështjes së Planit të «spastrimit etnik».

Për «negacionistët» që mohojnë se Serbia aplikoi politikën e gjenocidit në Kosovë, “«spastrimi etnik» i Kosovës nuk ka ekzistuar”, por ka qenë “trillim i natoistëve për të arsyetuar agresionin kundër një shteti sovran”. Sipas tyre, qëllimi i zhvendosjes së popullsisë shqiptare ishte ushtarak dhe human: ‘ta pastronin terrenin’ për të luftuar më lehtë kundër UÇK-së²! dhe “të mbroheshin civilët shqiptarë”, sidomos në fshatra, ku “UÇK-ja përzihej dhe

¹ <http://koha.net/arkiva/?page=1,13,145884>

² Jean-Arnaud Derens, “Le piège du Kosovo”, Editions Non Lieu, 2008, f. 136

shkrihej me popullsinë civile.”¹ Mund të vazhdohet me citate të ngjashme nga autorë të ndryshëm, por, thelbi dhe mesazhi mbetet i njëjtë: “regjimi Beogradit nuk ka pasur «qëllim» që t’i shkatërrojë shqiptarët «si të tillë», as tërësisht e as pjesërisht”, por, “UÇK-në, si organizatë terroriste”!

Të gjitha interpretimet që synojnë të paraqesin dhunën e ushtruar në Kosovë sikur të ishte “pasoje e hakmarrjes serbe kundër ndërhyrjes së NATO-s”, si “rezultat i aksioneve individuale apo grupeve të pakontrolluara prej pushtetit të Milošević-it”, apo si rezultat i çkado qoftë tjetër pos qëllimit për të shkatërruar tërësisht apo pjesërisht shqiptarët e Kosovës, si të tillë, ka për qëllim të fshehtë gjurmët e krimit të gjenocidit.

Krahas mohimit të qëllimit për t’i shkatërruar shqiptarët e Kosovës si të tillë, zëdhënësit e regjimit të Milošević-it dhe “avokatët” e tyre të profileve të ndryshme intelektuale (gazetarë, filozofë, sociologë, politologë, politikanë, analistë, historianë...) përpiqen me çdo kusht të kufizojnë krimin e gjenocidit vetëm në numrin e vrasjeve dhe ta minimizojnë në maksimum këtë numër.

Në bazë të Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit vrasjet përbëjnë vetëm një formë të aksioneve gjenocidare. Për këtë arsye, në këtë konventë theksohet nocioni «shkatërrim»² fizik ose biologjik i grupit.

Sa i përket procesit të shkatërrimit në Kosovë, historiani dhe politologu francez, Jacques Sémelin-i, e cilëson si tepër të kufizuar polemikën që zhvillohet për numrin e të vrarëve pas ndërhyrjes së NATO-s. Sipas Jacques Sémelin-it “përllogaritja³ e pasojave të operacionit të «spastrimit etnik» është tepër e kufizuar për të shprehur realitetin e shkatërrimeve të shkaktuara në Kosovë nga

¹ Shih letrën e Regis Debray-së

² I cili “si term është shumë më i gjerë se «vrasja», sepse ngërthen në vete edhe praktikate prishjeve dhe djegieve të shtëpive, godinave fetare, ndërtesave kulturore me qëllim që të asgjësohet prania e tjetrit-armikut” shih: Semelin Jacques, Du massacre au processus génocidaire (Nga masakra te procesi gjenocidial)

<https://www.unitar.org/ny/sites/unitar.org.ny/files/procgenocid.pdf>

³ Statistikat për 3000, 10.000, 100.000 të vrarë nuk shprehin përmasat reale të shkatërrimit në Kosovë, thekson ky autor.

viti 1998 (nëse jo që nga viti 1990) për numrin e të zhdukurve, familjeve të zhvendosura, grave të dhunuara, shtëpive të shkatërruara etj.”¹

Me qëllim që të mohohet kualifikimi i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së se «spastrimi etnik» përbën një formë gjenocidi, «negacionistët» Jean-Arnauld Derens-i dhe Cathrine Samarya përpiqen të tërheqin debatin në kuptimet semantike të dy nocioneve në gjuhën frënge: «purification ethnique»² dhe «nettoyage ethnique»³. Edhe pse këta autorë theksojnë se në shumë gjuhë ekziston vetëm një fjalë për këtë veprim dhe sjell shembullin anglez, «ethnic cleansing», atë kroat dhe serb, «etničko čišćenje», ata insistojnë në dallimin francez të këtyre dy termeve. Frëngjishtja, sipas Derens-it dhe Samary-së, “dallon këto dy fjalë në përputhje me qëllimin e aksionit të ndërmarrë. Nëse jo në mënyrë të qartë, atëherë në mënyrë të nënkuptueshme termi «purification ethnique» është i lidhur me politikën eugjeniste dhe raciale (pastrimin e racës ariane, që nuk synonte dëbimin e hebrenjve dhe romëve, por zhvendosjen në kampet e vdekjes, për t'i zhdukur nga toka «parazitët»). Për këtë arsye, kjo ngërthente një karakter gjenocidar, sepse zhdukja fizike e një populli përbën synimin e saj. Ndërsa, shprehja «nettoyage ethnique» përdoret në rastet kur qëllimi nuk është zhdukja fizike e një populli, por dëbimi i tij me dhunë, që mund të nënkuptojë forma të ndryshme të poshtërimit, në mesin e të cilave edhe dhunimi- që konsiderohet si krim lufte nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë- si dhe vrasjet selektive me qëllim që të realizohet homogjenizimi kombëtar i territorit (...) Thelbi kryesor i dhunës së shkaktuar në ish-Jugosllavi nuk ishte «spastrimi etnik» i një race, por kemi të bëjmë me «pastrimin etnik» të territoreve. Qëllimi kryesor i dhunës nuk ishte zhdukja e një komuniteti, por dëbimi i tij.”⁴ Me një fjalë, sipas tyre, nuk ka pasur gjenocid as në Kroaci, as në Bosnje e as në Kosovë!

¹ Po aty

² Spastrimi etnik

³ Pastrimi etnik

⁴ Jean-Arnauld Derens & Cathrine Samary, vepra e cituar *Les 100 portes des Conflits Yougoslaves*, f.238-239

Kufizimi i krimit të gjenocidit në zhdukjen fizike të një populli dhe fshehja e qëllimit për të shkatërruar tërësisht apo pjesërisht njërin nga grupet e saktësuara me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit është baza mbi të cilin ndërtohet «negacionizmi» i gjenocidit në Kosovë.

Edhe pse rezolutat dhe qëndrimet e lartpërmendura të OKB-së e cilësojnë «spastrimin etnik» si gjenocid, “zbulimi” i Jean-Arnauld Derens-i dhe Cathrine Samary-së se në Kroaci, në Bosnje dhe në Kosovë nuk është përdorur «spastrimi etnik» por «pastrimi etnik» u mundëson të konstatojnë se atje nuk ka pasur gjenocid por “homogjenizim kombëtar të territorit”! Këtë “zbulim” ua mundësuan dallimet semantike në gjuhës frënge të fjalëve «purification ethnique» dhe «nettoyage ethnique»! Jean-Arnauld Derens-i dhe Cathrine Samary-a e dinë fare mirë se politika e «spastrimit etnik» nuk u hartua në Francë, por, në Serbi dhe se politika e «etničko čišćenje»-s¹ ishte politikë që synonte gjenocidin në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë. Fundi i fundit, dallimet semantike që mundohen t’i aplikojnë Jean-Arnauld Derens-i dhe Cathrine Samary-a mund të kenë kuptim vetëm në kuadër të «negacionizmit», si neologjizëm që lindi në hapësirën linguistike franceze!

Sipas mendimit tim, nuk ka asnjë dallim mes «negacionistëve» që pretendojnë se hebrenjtë vdiqën nga sëmundja e tifos e jo nga gjenocidi i nazistëve gjermanë dhe «negacionistëve» që pretendojnë se Serbia nuk ka aplikuar gjenocid në Kosovë. Nuk e përjashtoj mundësinë që ky lloj i intelektualëve të angazhuar ideologjikisht të mundohet të arsyetojë maskat e forcave të armatosura ushtarake dhe policore serbe si “masa preventive kundër sëmundjes së tifos”! Madje edhe djegien e kufomave të shqiptarëve të Kosovës të mundohen ta shesin të ambalazhuar me këtë gënjeshtër!

¹ Shprehja serbe për politikën e spastrimit etnik



Ushtarët “mbrohen” nga rreziku i infektimit!

Krahas mbështetjes në termin «nettoyage ethnique» për të pohuar se Serbia nuk ka pasur qëllim zhdukjen fizike as të kroatëve, as të muslimanëve të Bosnjës e as të shqiptarëve të Kosovës, «negacionistët» shtojnë edhe “faktet” se Milošević-i nuk pranoi asnjëherë të ketë pasur një qëllim të tillë dhe se “plani për spastrimin etnik nuk u zbulua as pas hapjes së arkivave jugosllave.”¹ Në të njëjtën mënyrë si «negacionistët» që mohojnë gjenocidin kundër hebrenjve me arsyetimin se “urdhri i veçantë për shfarosjen e hebrenjve të Evropës, i dhënë nga Hitleri, nuk u zbulua asnjëherë (...)”² «negacionistët» që mohojnë gjenocidin në Kosovë mbështeten te “fakti” se nuk ka prova që dëshmojnë qartazi për këtë qëllim të regjimit të Beogradit. «Negacionistët» e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës ngulin këmbë se gjoja pohimet për aplikimin e gjenocidit nga regjimi i Milošević-it janë “propagandë lufte” në funksion të manipulimit të opinionit publik për të arsyetuar ndërhyrjen ushtarake të NATO-s. Në mbështetje të kësaj teze ata këmbëngulin në “faktin” se gjoja sikur të kishin

¹ Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, *L’Opinion ça se travaille...* Agon, 2006, f.106

² Florence Hartmann, vepra e cituar, *Paix et châtiment*, f.125

ekzistuar këto plane, do të ishin zbuluar pas përmbysjes së pushtetit të Milošević-it dhe “hapjes së arkivave pas fitores së Vojislav Koštunica-s ndaj Slobodan Milošević-it, më 7 tetor 2000.”¹

Por, çështja e “provave eksplicite” që do të dëshmonin qëllimin gjenocidar, është më e komplikuar se “hapja e arkivave”. Në këtë kontekst më duket domethënës të sjell dëshmitë e Florence Hartmann-it, zëdhënëses së Prokurores së Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte-s.

Në veprën e saj «Paqja dhe ndëshkimi» ajo thekson se “zyrtarët serbë ishin të bindur se arkivat e Këshillit Suprem të Mbrojtjes së Jugosllavisë mund të shpinin deri te dënimi i Serbisë për gjenocid.”²

Për të ilustruar këtë pohim, Florence Hartmanne sjell qëndrimin e ministrit serb të Punëve të Jashtme, Goran Svilanović-it, i cili në zyrën e Carla Del Ponte-s, më 3 tetor 2003, përpikëj të arsyetonte shkaqet e refuzimit të dorëzimit të arkivit të Këshillit Suprem të Mbrojtjes së Jugosllavisë. Në këtë takim, Goran Svilanović-i theksoi se “nëse ne ju ndihmojmë ta dënoni Milošević-in për gjenocid, atëherë edhe shteti ynë do të dënohet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për gjenocid dhe do të duhet t'i paguajmë miliarda dollarë dëmshpërblim...”³

Udhëheqësit e rinj të Beogradit deklarorin haptazi se “interesi jetësor nacional” i tyre ishte t'i fshihnin Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të gjitha informatat që mund ta inkriminonin Serbinë për krimet e gjenocidit. Ajo që është edhe më neveritëse në strategjinë e regjimit të Vojislav Koštunica-s për të fshehur faktet e gjenocidit serb në Kroaci, në Bosnje dhe në Kosovë lidhet me qëndrimet e pushtetit në Beograd se gjoja “drejtësia dhe e vërteta e dëmtojnë stabilitetin në regjion dhe veprojnë kundër paqes.”⁴

Megjithatë, fshehja e provave të gjenocidit nga ana e autoriteteve të Beogradit mund të jetë e kuptueshme për arsye të

¹ Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, vepra e cituar, *L'Opinion ça se travaille...*f.106

² Florence Hartmann, vepra e cituar *Paix et châtiment*, f.118

³ Po aty, f.118

⁴ Po aty, f.118

vazhdimësisë së strukturave të regjimit të Milošević-it në pushtetin “e ri”. Por, ajo që është e “pakuptueshme” në këtë strategji lidhet me marrëveshjen e gjyqtarëve të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë me autoritetet e Serbisë për t’i mbajtur provat të fshehura nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe nga publiku.

Florence Hartmann-i denoncon marrëveshjen dhe për herë të parë publikohen të dhëna precize lidhur me këtë hipokrizi të drejtësisë ndërkombëtare.

Vërtetësinë e marrëveshjes në mes të Gjykatës së Hagës dhe Serbisë askush nuk e kundërshtoi. As Gjykata e Hagës që ngriti akuzë kundër Florence Hartmann-it për publikimin e dokumenteve konfidenciale nuk e mohon vërtetësinë e strategjisë së fshehjes së provave të krimit. Megjithatë, për publikimin e detajeve të kësaj marrëveshje, sidomos pjesët e faqeve 120-122 të botimit në gjuhën frënge¹, Florence Hartmann-i u dënua me një gjobë prej 7000 eurosh².

Akuza dhe dënimi i Florence Hartmann-it kishte për funksion frikësimin e atyre që nuk pranonin pazarllëqet politike në kurriz të drejtësisë. Lexuesit që i interesojnë hollësi rreth kësaj akuze mund të informohet në faqen e internetit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish- Jugosllavinë³.

Vepra «Paqja dhe ndëshkimi» e Florence Hartmann-it ofron mundësi të mirë që lexuesi të njihet me tërë presionin politik që u ushtrua ndaj Gjykatës Penale Ndërkombëtare për t’i hequr Serbisë akuzën për gjenocid. Marrëveshjet për fshehjen e implikimit të shtetit serb në krimet e gjenocidit në Kroaci, në Bosnje dhe në Kosovë, nuk mundën ta pengojnë daljen në shesh se “Milošević-i, jo vetëm që ishte bashkautor i partiturës vdekjeprurëse të spastrimit etnik dhe arkitekt i luftës, por deri në fund ishte dirigjenti i tyre!”⁴

¹ Faqet 113-115 të botimit në gjuhën shqipe

² International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia IT-02-54-R77.5
http://www.icty.org/x/cases/contempt_hartmann/cis/fr/cis_hartmann_fr.pdf

³ ONU, TPIY, Hartmann (IT-02-54-R77.5)

http://www.tpiy.org/case/contempt_hartmann/27

⁴ Florence Hartmann, vepra e cituar *Paix et châtiment*, f.115

Përkundër kësaj, «negacionistët» serbë që mbështesin regjimin e vjetër të Beogradit vazhdojnë të mohojnë gjenocidin për t'i shmangur pasojat, ndërsa, «negacionistët» që kanë “edukim politik” dhe këndvështrim ideologjik «antiamerikanizmin», e mohojnë gjenocidin në Kosovë vetëm e vetëm për të përgënjeshtuar ata që mbështetën ndërhyrjen e NATO-s. Ky verbim ideologjik i solli deri në atë shkallë sa të pohojnë se gjoja “hapja e arkivave pas fitores së Vojislav Koštunica-s zbuloi se plani serb për spastrimin etnik të Kosovës nuk kishte ekzistuar.”¹

Në vitin 2008, pra, një vit pas botimit të librit të Florence Hartmann-it dhe pikërisht kur kjo autore u dënua nga Gjykata e Hagës, ish-prokurorja e kësaj gjykate, Carla del Ponte, botoi librin «Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës». Në këtë libër ajo konfirmoi pohimet e zëdhënësës së saj lidhur me strategjinë e pushtetit të ri të Beogradit për mosdorëzimin e Arkivit të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes. Në veçanti, kapitulli 8 i këtij libri, i titullar «Beograd: 2003 dhe 2004»,² jep të dhëna precize për një varg takimesh zyrtare në të cilat autoritetet e Beogradit aplikojnë strategji të ndryshme për të zvarritur dorëzimin e provave për gjenocid.

Përkundër fakteve se Serbia, në kundërshtim me obligimet që kishte si shtet, nuk i dorëzoi pjesët e arkivit që do të dëshmonin në mënyrë të qartë se ky shtet kishte aplikuar gjenocid, dhe se heqja e akuzës për gjenocid ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe statutin e Gjykatës së Hagës, «negacionistët» e llojit të Serge Halimi-t, Dominique Vidal-it, Cathrine Samary-së e Jean-Arnauld Derens-it duartrokasin ndryshimin e aktakuzës sikur të ishte dëshmi e vërtetësisë. Madje këta dy të fundit shprehin entuziazmin e tyre se “dhunimet seksuale konsiderohen si krim lufte nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë”³ e jo akte gjenocidi!

¹ Serge Halimi & Dominique Vidal me Henri Maler, vepra e cituar *L'Opinion ça se travaille...*, f.106

² Carla Del Ponte, vepra e cituar, *La traque, les criminels de guerre et moi*, f. 321-367

³ Jean-Arnauld Derens & Cathrine Samary, vepra e cituar *Les 100 portes des Conflits Yougoslaves*, f.238-239

Ndryshimi i aktakuzës dhe heqja e krimit të gjenocidit është rezultat i një raporti forcash politike e jo vërtetësi e asaj që ka ndodhur në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë.

Gjykata Penale Ndërkombëtare për Rwandën i cilësoi dhe i dënoi dhunimet seksuale të Hutu-ve ndaj Tutci-ve si akte gjenocidi për shkak të faktit se dhunimi paraqet cenim të rëndë të integritetit fizik dhe mendor të viktimës. Të konsiderohen si krime lufte¹ aktet e njëjta që bënë në Bosnje, në Kroaci dhe në Kosovë forcat ushtarake dhe policore serbe dëshmon për një raport të caktuar të forcave politike dhe për presionin që iu bë Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për të hequr akuzën për gjenocid.

Mijëra fëmijë, gra, burra dhe pleq shqiptarë, të vrarë me qëllim që të shkatërrohen shqiptarët në Kosovë, si të tillë, dhe mijëra femra të dhunuara seksualisht me qëllim të cenimit të integritetit fizik dhe psikologjik të gruas shqiptare përbëjnë thellësinë e hendekut të krimit të gjenocidit që ndan Kosovën dhe Serbinë.

Po e përsëris se kur bëhet fjalë për «qëllimin që të shkatërrohet një grup nacional, etnik, racor ose fetar», që përbën thelbin e gjenocidit, nuk ka asnjë dallim mes gjenocidit të aplikuar nga regjimi i Hitler-it kundër hebrenjve dhe gjenocidit të aplikuar nga regjimi i Milošević-it kundër shqiptarëve të Kosovës. Dallimi qëndron në përmasat e realizimit të qëllimit.

Këto përmasa do të ishin shumë më të mëdha sikur të mos ishte vendosmëria e shteteve pjesëmarrëse në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s që të pamundësojnë “triumfin e barbarisë në Evropë.”²

Përballë kësaj vendosmërie të aleancës veriperëndimore, regjimi i Milošević-it u detyrua të tërhiqej nga Kosova. Nënshkrimi i «Marrëveshjes Ushtarako-Teknike»³ në Kumanovë shënoi fundin

¹ Sipas të drejtës penale ndërkombëtare «krimet e luftës» janë kategoria më e lehtë e përgjegjësisë në krahasim me «krimet kundër njerëzimit», ose me «gjenocidin» si formë më e rëndë e krimit kundër njerëzimit.

² Cituar nga Anne-Sophie Paquez, *La politique de la France au Kosovo était-elle “gaulliste”?*, Jacques Chirac, 2e intervention radiotélévisée diffusée sur TF1, 7 avril 1999, f.42

<http://www.unige.ch/gsi/Bienvenue/publications/euryopa/paquez.pdf>

³ Military Technical Agreement between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia, 9 June 1999

<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>

e strukturave politike të pushtetit të instaluar nga Milošević-i në Kosovë dhe tërheqjen e forcave të armatosura (ushtarake dhe policore) nga Kosova.

Një ditë pas «Marrëveshjes Ushtarako-Teknike», më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi Rezolutën 1244, përmes të cilës përcaktohej korniza e prezencës civile dhe e sigurisë në Kosovë deri në përcaktimin e statusit politik përfundimtar¹. Kjo marrëveshje i dha fund luftës në Kosovë!

Përfundimi i luftës në Kosovë hapi “dyert e teatrit” ku ishte vënë në skenë gjenocidi kundër shqiptarëve. Të parët që u kthyen në vend ishin “aktorët” që në këtë “skenar tragjik” përbënin kolonat e spastrimit etnik. Për shkak të afërsisë gjeografike, të dëbuarit që kishin gjetur strehim në viset e banuara me shqiptarë në Maqedoni, në Shqipëri, në Mal të Zi dhe në Bosnje u kthyen javën e parë, ndërsa qindra mijëra të tjerë u kthyen nga shtetet e demokracive perëndimore e në veçanti nga Zvicra, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, SHBA-të, Kanada, Australia ku kishin gjetur strehim të përkohshëm dhe trajtim tejet human. Nga data 12 qershor e deri në muajin gusht të vitit 1999 rreth një milion shqiptarë që ishin dëbuar me dhunë u kthyen në Kosovë.

Ata gjetën një vend të rrënuar. Pasojat e gjenocidit në Kosovë ishin shumë të mëdha. Krahas numrit të madh të të vrarëve dhe të të zhdukurve, numër që dikujt mund t’i duket i vogël nga këndvështrimi i tij «negacionist», në Kosovë ishin shkatërruar “100.589 shtëpi, 358 shkolla, 30 shtëpi kulture, 93 biblioteka, 123 institucione shëndetësore, 220 objekte të kultit fetar (215 xhami, teqe, tyrbe dhe 5 kisha katolike)...”²

¹ OKB, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 1244
<http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15025.pdf>

² <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,145884>

EPILOGU I KAPITULLIT TË GJASHTË

Në prologun e këtij kapitulli solla deklaratat e ekipit spanjoll të ekspertëve të fushës së kriminalistikës dhe juristë civilë të cilët kishin hulumtuar terrenin e “Istogut, zonës më të keqe” dhe ku kishin gjetur vetëm 187 kufoma. Ata kishin “zbuluar se kufomat ishin varrosur në varreza individuale, në të shumtën e rasteve të orientuar nga Meka, për të respektuar besimin fetar të shqiptarëve të Kosovës dhe se kufomat nuk kishin pasur shenja torturash. Me një fjalë, nuk kishte asnjë varrezë masive... Së paku serbët nuk janë aq të këqij sa na i kanë përshkruar...” deklaruan ekspertët.

Në epilog të këtij kapitulli po sjell dëshminë e Dominique Lecomte, udhëheqëses së Institutit Mjeko Ligjor të Parisit, e cila qëndroi në Kosovë me mandat të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë.

«Në greminën e vdekjes»

Një sprovë në mes aq sprovave tjera: sapo u zhyta në greminën e vdekjes. Vetëm të vdekur! Sapo kaluam shtatë ditë punë në një varrezë masive, një fushë ku toka ishte rrotulluar në thellësi.



Varrezë masive

Ka afër njëqind e pesëdhjetë trupa burrash, sidomos burra të vranë me plumb, shumica e të cilëve vinin nga pushkët e luftës, plumbat e të cilave provokonin shkatërrime të brendshme të tmerrshme. Disa kishin vonuar deri sa kishin vdekur dhe kishin përfunduar me nga një plumb në zverk. Shumë kishin qenë duke ikur sepse ishin vranë pas shpine.

Gjatë tërë kësaj kohe thosha: «Është luftë dhe çdo luftë shkakton të vdekur.»(...)

Gjatë njëzet viteve kam parë çdo ditë tmerre, por kam përshtypjen se ky mision i pasluftës i tejkalon të gjitha. Kam para syve gjurmët më të llahtarshme të natyrës njerëzore(...)

Në fushën tjetër janë të varrosur rrëmujshtëm, në mushama të gjelbërta, njerëz sipas të gjitha gjasave nga qyteti, sepse ishin të veshur mirë. Gati të gjithë kishin gjurmë torturash. Nyjet e duarve dhe të këmbëve u ishin thyer(...)

Fryma të zihej nga era e djegies, e bërllokut dhe e të vdekurve që lëshonin shtëpitë e rrënuara dhe pa kulm (...)

«Në fund të bunarit ka gra», tha njëri që ishte tepër i shqetësuar. Kishte të drejtë! Me të vërtetë ishte pika kulmore e tmerrit! Do të bëjmë çdo gjë që t'i nxjerrim.



*Bunar me
kufoma civilësh
shqiptarë*

Materiali i rëndë i xhenios, me të cilët bashkëpunonim që disa ditë, u vu në lëvizje. Hapi një të çarë për të depërtuar në fund të bunarit. Lopatëzat depërtuan dhe e hapën. Pastaj nxorën gërmadha dhe trupa grash të varura si kukulla në thonjtë e lopatës. Unë e drejtoja makinën që trupat të vendoseshin me kujdes mbi mushamatë në tokë.

Janë të ruajtura mirë, por, duhet punuar shpejt sepse dekompozimi dhe mizat fitojnë në kohë. Unë dhe kolegu im, këmbadoras, i zhveshëm kufomat, teshat ishin përplot me ujë. Mushamatë janë të shtrira që të na mbrojnë nga shikimet. Ekzaminimi mjekësor është shumë i mundimshëm: këto gra ishin dhunuar dhe hedhur për së gjalli në bunar, ku janë mbytur.

Në këtë fshat, çdo gjë është bërë rrafsh: burrat e grumbulluar janë vrarë me mitraloz pranë një muri të bërë shoshë nga plumbat (...) Në një fshat tjetër, kanë hyrë në një shtëpi dhe kanë vrarë të gjithë anëtarët e familjes: gjaku i thatë shihet gjithkrah, gratë dhe fëmijët janë vrarë në sy të burrave, të cilët pastaj u vranë në rrugë, me nga një plumb pas shpine.

Me kujtohet një vend ku të gjitha shtëpitë ishin rrënuar. Një burrë na tregonte goditjet e plumbave në mur dhe grumbullin e hirit në oborr, duke na shpjeguar se plaku që ruante shtëpinë ishte vrarë me një plumb dhe ishte djegur në zjarrin e shtëpisë. Nga shtëpia në shtëpi na tregonte të njëjtin skenar dhe në fund na dërgoi te një tendë e bardhë që kishin ngritur organizatat humanitare ndërkombëtare, ku strehohej familja e tij. Dëshironte të na kënaqte me diçka dhe na solli një tabaka me gota me shurup dhe nga një shtambë i mbushi me ujë.

«Është ujë bunari»- na tha ai.

Për një çast u ndala. Shikimi im u kryqëzua me të kolegut tim. Në kujtesë kam dramën e bunarit dhe e kam të vështirë ta pi këtë gotë. Gotën e mbajta në dorë për një kohë të gjatë sepse kisha frikë mos lëndoja nikoqirin. Kolegu im, duke parë hutimin tim, e mori dhe e piu me një gjest miqësie dhe ndarje dhimbjeje. Më

vinte turp! Atë ditë u largova me kokën poshtë sepse me të vërtetë nuk u tregova e guximshme (...)

Që disa ditë pa ndërprerë karrocat e mbingarkuara me burra, gra, fëmijë dhe pleq mbushën rrugët. Rifilloi jeta.

Skelet ngjiteshin në kulm, tullat renditeshin njëra mbi tjetrën, trarët e djegur ndërroheshin... Shtëpitë dukeshin si të plagosur luftime, me plot plagë të lidhura dhe me fasha.

Brenda dy muajsh, Kosova i ngjante vendeve tjera. Bari u kosit shpejt e shpejt, sepse duhej siguruar sana për dimër.

Me të kthyer në Paris mendoj se një problem i ri do të më dalë: do të më duhet të pajtohem me qenien njerëzore¹!

Sado që dikujt mund t'i duket se "drejtësia dhe e vërteta e dëmtojnë stabilitetin në regjion dhe se gjoja veprojnë kundër paqes"² një gjë është e sigurt: pa njohjen e përmasave reale të gjenocidit në Kosovë dhe pa ndëshkimin e kriminelëve të implikuar në këtë krim, ndërtimi i urave të bashkëpunimit ndërshtetëror në këtë pjesë të Evropës është iluzion. Ardhmëria evropiane e kësaj pjese të Ballkanit nuk ndërtohet me gënjeshtër!

¹ Dominique Lecompte, *Quai des ombres- Vingt ans au service des morts*, Edition Fayard, 2012, f.209-218

² Florence Hartmann, *Paix et châtement*, (Paqja dhe ndëshkimi), Flammarion, 2007, f.118

KAPITULLI I SHTATË

PËRCAKTIMI I STATUSIT FINAL TË KOSOVËS PROLOGU I KAPITULLIT TË SHTATË

Sa i përket çështjes së Kosovës, e drejta ndërkombëtare më duket plotësisht e qartë. Edhe neutraliteti gjithashtu. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara flet në tri vende për integritetin territorial serb dhe thotë se Kosova është krahinë serbe që do të administrohet përkohësisht nga ndërkombëtarët. Rusia nuk do ta kishte pranuar asnjëherë këtë rezolutë nëse ajo nuk fliste për integritetin territorial të Serbisë. Kjo rezolutë është edhe sot në fuqi, sepse vetëm Këshilli i Sigurimit mund ta modifikojë apo anulojë...

...Pra, në rastin e Kosovës kemi shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe të rezolutës 1244. Në të drejtën ndërkombëtare vetëvendosja e popujve i nënshtrohet një sërë kushtesh. Një popull, që te njihet si i tillë, duhet të ekzistojë. Kosova nuk përbën një rast të tillë. Kombet e Bashkuara nuk kanë njohur kurrë më parë një vend që është ndarë nga një vend tjetër kundër dëshirës së vendit pjesë e të cilit ishte...

Asnjëherë nuk e kuptova pozicionin e Zonjës Calmy-Rey! Do të kishte qenë e kuptueshme sikur ajo t'i referohej një autonomie, një zgjidhje konfederate të ngjashme si modeli zviceran. Nuk e kuptoj pse Këshilli Federal nuk priti më shumë. Diçka nuk e kam të qartë. Pavarësia e Kosovës nuk u vendos në Prishtinë. Shumica e vendeve nuk e kanë njohur dhe nuk do ta njohin Kosovën...¹

¹ Réseau Voltaire, intervista e cituar e Dick Marty-t : « L'indépendance du Kosovo... »

Prania ndërkombëtare në Kosovë

Siç e theksova edhe në pjesën e mësipërme të këtij libri, «Marrëveshja Ushtarake-Teknike»¹, e nënshkruar më 9 qershor 1999 në Kumanovë të Maqedonisë për tërheqjen e forcave të armatosura ushtarake dhe policore serbe nga Kosova, shënoi, në të njëjtën kohë, fundin e strukturave politike të pushtetit të instaluar nga Milošević-i në Kosovë. Krahas këtij vendimi shumë të rëndësishëm që i dha fund luftës në Kosovë, duhet të përmend rëndësinë e faktit që, më 10 qershor të vitit 1999, Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi Rezolutën 1244 për situatën në Kosovë².

Kjo rezolutë përbën bazën juridike të pranisë ndërkombëtare (civile dhe të sigurisë) në Kosovë. E vlen të theksohet se në pikën 9 të kësaj rezolute përcaktohen përgjegjësitë e pranisë ndërkombëtare të sigurisë që do të vendosej dhe që do të vepronte në Kosovë, pas tërheqjes së forcave serbe.

Në mesin e përgjegjëseve të këtij misioni përfshihej pengimi i ripërtëritjes së armiqësive; ruajtja dhe, atje ku ishte e nevojshme, imponimi i armëpushimit; parandalimi i kthimit në Kosovë të forcave ushtarake, policore e paramilitare serbe dhe demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; krijimi i një ambienti sigurie në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të ktheheshin të sigurt në shtëpitë e tyre ; garantimin e sigurisë dhe të rendit publik ; mbikëqyrjen e procesit të deminimit ...³

Prania ndërkombëtare e sigurisë iu besua KFOR-it⁴ ndërsa prania civile u formatua si Mision i Përkohshëm i Administratës së

¹ Military Technical Agreement between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia, 9 June 1999

<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>

² OKB, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 1244

<http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15025.pdf>

³ Më gjerësisht shih Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, paragrafi 9

⁴ Kosovo Force, Forcë ushtarake shumëkombëshe ku krahas shteteve anëtare të NATO-s edhe Rusia bënte pjesë në këtë mision.

OKB-së në Kosovë (UNMIK)¹, nën drejtimin e një Përfaqësuesi Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP)².

Përgjegjësitë kryesore të pranisë civile ndërkombëtare konsistonin në përkrahjen për krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtjesore në Kosovë deri në zgjidhjen përfundimtare; organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në zgjidhjen politike; të ndihmohet një proces politik me qëllim që të përcaktohet statusi i ardhshëm i Kosovës dhe në një fazë përfundimtare, mbikëqyrjen e kalimit të pushtetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës te institucionet e themeluara me marrëveshje politike...³

Gjatë gjithë periudhës kalimtare, periudhë që i paraprin përcaktimit të statusit final, Kosova mbetej formalisht pjesë e Federatës Jugosllave. E shoh të arsyeshme ta theksoj këtë gjë sepse ruajtja e integritetit territorial të Jugosllavisë, gjatë fazës kalimtare, do të shërbejë si argument manipulimi edhe gjatë periudhës së përcaktimit të statusit politik final. Këtij aspekti do t'i kthehem më vonë. Tani për tani po ndalem në momentet më të rëndësishme të administrimit ndërkombëtar të Kosovës dhe do të përmend vetëm ngjarjet që më duken më të rëndësishme për problematikën tonë. Lexuesit që i interesojnë informacione më të hollësishme për çështjet që do të trajtoj më poshtë mund t'u referohet burimeve të cituara, të cilat paraqesin një bazë solide për hulumtime të temave specifike.

¹ Në vijim do të përdor shkurtesën UNMIK, The United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

² Në vijim do të përdor shkurtesën PSSP për titullin Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

³ Më gjerësisht shih Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, paragrafi 11

«Standardet para statusit»

Kthimi i të dëbuarve, ndërtimi i shtëpive të rrënuara dhe krijimi i institucioneve të përkohshme të Kosovës ishin prioritet i UNMIK-ut gjatë tri viteve të para pas përfundimit të luftës.

Sa i përket krijimit të institucioneve të përkohshme, vlen të përmendet se pas mbajtjes së zgjedhjeve të para të lira në Kosovë, zgjedhjeve komunale të 28 tetorit të vitit 2000, krijimi i bazës kushtetuese për ndërtimin e institucioneve të vetëqeverisjes së përkohshme të Kosovës paraqet ngjarjen më të rëndësishme në procesin e implementimit të misionit të UNMIKU-t. Më 15 maj 2001, PSSP të OKB-së, Hans Haekkerup-i¹, nënshkroi rregulloren² që krijoi Kornizën Kushtetuese, bazën e re kushtetuese të Kosovës. Edhe në fjalën hyrëse të Kornizës Kushtetuese, Hans Haekkerup-i theksoi: “ Korniza Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë përshkruan institucionet të cilat do të lihen në duar të liderëve kosovarë dhe nëpunësve publikë pas zgjedhjeve, më 17 nëntor 2001. Ky është vërtet një dokument historik: Ai do ta drejtojë popullin e Kosovës drejt themelimit të strukturave demokratike dhe implementimi i tij i suksesshëm do të ndihmojë në masë të madhe procesin e përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës.”³

Në fillim të vitit 2002, UNMIK-u, përmes PSSP të OKB-së, Michael Steiner-it⁴, bëri publik strategjinë që u bë e njohur si strategjia që synonte «standardet para statusit». Kjo strategji fokusohej në realizimin e përparimeve të rëndësishme në tetë fusha specifike para se të fillonin bisedat për statusin përfundimtar të Kosovës:

¹ Ish Ministër i Mbrojtjes së Danimarkës, PSSP i Kosovës janar 2001 - janar 2002

² Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9

³ Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme të Kosovës, f.2
http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:jVhfMSP5gLLJ:www.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf+&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch

⁴ Që ishte në këtë funksion gjatë vitit 2002-2003

1. Funksionimi i institucioneve demokratike
2. Shteti ligjor (policia/drejtësia)
3. Liria e lëvizjes
4. Kthimet dhe integrimi
5. Ekonomia (legjislacioni, ekuilibri buxhetor, privatizimi)
6. Të drejtat pronësore (tapitë e rregullta dhe kthimi i pronës)
7. Dialogu me Beogradin
8. Trupat Mbrojtëse të Kosovës (respektimi i mandatit të tyre, pjesëmarrja e minoriteteve)¹

Mirëpo, më 10 dhjetor të vitit 2003, në ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Përfaqësuesi i ri Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Harri Holkeri², zyrtarizoi dokumentin e titulluar «Standardet për Kosovën».

Përmbushja e standardeve të lartpërmendura u shtrua si “detyrë e përbashkët e Misionit të Kombeve të Bashkuara dhe e Institucioneve të vetëqeverisjes në Kosovë, ndërsa mesi i vitit 2005 u përcaktua si periudhë e vlerësimit të tyre.”³

Në seancën e 4880 të 12 dhjetorit 2003 Këshilli i Sigurimit i OKB-së i dha mbështetje dokumentit «Standardet për Kosovën», respektimi i të cilave u cilësua si “kusht paraprak i bisedimeve për statusin final të Kosovës.”⁴

¹ SENAT, «Une avancée prudente et délicate vers un statut final» (Avancim i kujdeshëm dhe delikat drejt statusit final)
<http://www.senat.fr/rap/r03-316/r03-3167.html>

² Ish-Kryeministër i Finlandës (1987-1991), Kryetar i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (2000-2001) dhe udhëheqës i Misionit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (2003-2004), i cili vdiq në vitin 2011.

³ Zëri i Amerikës, «Publikohet dokumenti i Standardeve për Kosovën», 10.12.2003
<http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-a-2003-12-10-4-1-85537332/372595.html>

⁴ OKB, Këshilli i Sigurimit, Communiqué de presse, CS/2600, 12.12.2003
<http://www.un.org/News/fr-press/docs/2003/CS2600.doc.htm>

Por, shpërthimi i trazirave të 17 dhe 18 marsit 2004 në Kosovë¹ nxori në shesh problemet e shumta që shtroheshin për zgjidhje. Një ndër konstatimet që më së shumti përsëritej në analizat e shkaqeve të shpërthimit të këtyre trazirave lidhej me statusin politik të Kosovës. Përkundër përparimeve që ishin bërë në shumë drejtime, mospërcaktimi i statusit politik shihej si pengesë për zhvillimin ekonomik, politik dhe të sigurisë në Kosovë. Ky konstatim do të integrohet më vonë edhe në raportet e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe atë të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës².

Si pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre trazirave, PSSP të OKB-së, Harri Holkeri, dha dorëheqje dhe në vend të tij, më 16 qershor 2004, u emërua diplomati danez, Søren Jessen-Petersen-i.

Administratori i ri e gjeti Kosovën në vllugun e përgatitjeve për zgjedhjet e përgjithshme të 23 tetorit 2004, të cilat ishin shpallur para fillimit të trazirave të lartpërmendura³.

Në këtë kontekst e vlen të përmendet për lexuesin se si rezultat i këtyre zgjedhjeve dhe marrëveshjes politike në mes LDK-së, që kishte fituar shumicën e deputetëve për Kuvendin e Kosovës, dhe AAK-së, që përfaqësonte forcën e tretë politike në Kosovë, në seancën e 3 dhjetorit 2004, Kuvendi i Kosovës zgjodhi Ramush Haradinajn kryeministër të Kosovës.

¹ Gjatë të cilave u vranë 19 civilë (11 shqiptarë dhe 8 serbë), u plagosën mbi 900 të tjerë, u shkatërruan qindra shtëpi dhe monumente të kultit fetar ortodoks...
Shih: <http://koha.net/?id=27&l=3195>
<http://tempsreel.nouvelobs.com/monde/20040317.OBS6076/emeutes-au-kosovo-sept-morts.html>
<http://www.hrw.org/fr/news/2004/07/26/kosovo-lotan-et-lonu-incapables-de-prot-ger-les-minorit-s>

² Në rubrikën Dokumentet zyrtare shih Raportet e Sekretarit të Përgjithshëm t
<http://www.un.org/fr/peacekeeping/missions/unmik/reports.shtml>
Conseil de l'Europe, Assamblé Parlamentaire, Resolution 1595(2008)
<http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=/Documents/AdoptedText/tao8/FRE/S1595.htm>

³ BBC, Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë më 23 tetor 2004
http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2004/03/040314_kosovo-elections.shtml

Kryeministri Haradinaj dhe Carla Del Ponte

Zgjedhja e Ramush Haradinajt, njërit nga udhëheqësit e UÇK-së, kryeministër i Kosovës, ngjalli reagime të shumta në Serbi. Por kjo nuk ndikoi që të vazhdojë puna e konsolidimit të institucioneve të Kosovës.

Kështu, më 17 dhjetor 2004, Søren Jessen-Petersen, në emër të UNMIK-ut dhe Ramush Haredinaj, në emër të Qeverisë së Kosovës, “shpallën marrëveshjen për vendosjen e standardeve që ishin prioritet për Kosovën dhe masave të parapara për jetësimin e tyre.”¹

Përballë kësaj situate, shtypi i Beogradit aktualizoi të gjitha akuzat e moçme që regjimi i Milloshević-it i kishte përgatitur kundër këtij udhëheqësi të luftës çlirimtare në Kosovë.

Për të mos u shmangur shumë nga tema që po trajtoj, nuk do të sjell reagimet serbe lidhur me zgjedhjen e Ramush Haradinajt në krye të Qeverisë së Kosovës. Po ndalem vetëm në veprën e Carla Del Pontes, «Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës»², sepse qëndrimeve serbe për luftën e UÇK-së dhe udhëheqësit e saj ajo u dha formën juridike të aktakuzës.

Për t'u shitur si profesioniste të cilës nuk i shpëtojnë as “detajet”, madje citon edhe proverbin se “dreqi me të vërtetë fshihet në detaje”³, Prokurorja e Përgjithshme e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte, sjell për lexuesit e librit të vet “detajin” se “më 16 qershor 2004, danezi Søren Jessen-Petersen-i, i cili për një kohë të gjatë kishte punuar në gjirin e Kombeve të Bashkuara, zëvendësoi Michael Steiner-in në krye të UNMIK-ut. Sikurse edhe të huajt e tjerë që ishin ngarkuar të sillnin rendin në Kosovë”- vazhdon Del Ponte - “ai përpiquej të vendoste lidhjet me udhëheqësit shqiptarë lokalë, te të cilët

¹ OKB, «Des normes prioritaires définies pour le Kosovo» (Standadet me prioritet të përcaktuara për Kosovën)
<http://www.un.org/apps/newsFr/storyF.asp?NewsID=9667&Cr=Kosovo&Cr1=MINUK#.U-xzLbizWQl>

² Carla Del Ponte, vepra e cituar *La traque, les criminels de guerre et moi*, f.649

³ Po aty, f.481

shpresonte të mbështetej për të përmirësuar sigurinë në këtë regjion të copëtuar nga dhuna, t'i forcote institucionet qeverisëse dhe ta përgatiste Kosovën për statusin e ardhshëm të saj.”¹

Dikujt mund t'i duket se Carla Del Pontes i shpëtoi “një detaj” kur harroi se Michael Steiner-in, PSSP të OKB-së për Kosovë për periudhën 2002-2003, e zëvendësoi Harri Holkeri dhe pas dorëheqjes së tij, siç e pamë më lart, Søren Jessen-Petersen-i u emërua në këtë funksion.

Heshtja e Harri Holkeri-t, që ishte PSSP të OKB-së nga data 23 korrik e vitit 2003 e deri në dorëheqjen e tij më 25 maj 2004, të këtij përfaqësuesi ndërkombëtar që zyrtarizoi dokumentin e emërtuar «Standardet për Kosovën» dhe që ishte në qendër të vëmendjes pas trazirave të marsit të vitit 2004, është “detaj” që nuk mund të harrohej. Sidomos nuk mund të harrohej nga Prokurorja e Përgjithshme e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë që kishte zyrën e vet edhe në Prishtinë.

Po theksoj se marrëveshja² mes Søren Jessen-Petersen-it dhe Ramush Haradinajt ishte marrëveshje në vazhden e angazhimeve për realizimin e standardeve si parakusht për fillimin e bisedimeve për përcaktimin e statusit final të Kosovës.

Nënçmimi që Carla Del Ponte i bën angazhimit të Përfaqësuesve Specialë të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në përgjithësi dhe Søren Jessen-Petersen-it në veçanti është “detaj ku me të vërtetë fshihet puna e drejt”. Banalizimi i punës së të ngarkuarve për të përfaqësuar praninë civile ndërkombëtare në Kosovë si punë e “të huajve që ishin të ngarkuar të kthenin rendin në Kosovë” bëhej me qëllim që të fshihet “detaji” se prania civile ndërkombëtare në Kosovë kishte për mision që së bashku me “shqiptarët vendas”³, të krijonin kushtet paraprake për përcaktimin e statusit final të saj!

Ajo që e pengonte Carla Del Ponte-n ishte “detaji” se “shqiptari vendas” me të cilin dëshironte të koordinonte punët

¹ Po aty, f.480

² E datës 17 dhjetor 2004

³ Siç i pëlqen t'i quajë kjo prokurore

Søren Jessen-Petersen-it për të vazhduar implementimin e misionit të përkohshëm ndërkombëtar ishte një komandant i luftës çlirimtare të Kosovës.

Zgjedhja e Ramush Haradinajt në krye të Qeverisë së Kosovës për mandatin kur duhej të përmbylleshin vlerësimet rreth realizimit të «standardeve për Kosovën» dhe kur pritej të fillonte procesi për përcaktimin e statusit final ishte shkurajuese për të gjitha qarqet që shpresonin ta kthenin Kosovën nën juridiksionin serb.

“Detaji” se “më 3 dhjetor 2004, Kuvendi i Kosovës zgjodhi Ramush Haradinajn si kryeministër të Kosovës”¹ nuk i shpëtoi as Carla Del Ponte-s. Por, ndryshe nga ata që pakënaqësitë e veta i shprehnin përmes deklaratave, Carla Del Ponte ishte në pozitë të urdhëronte hetime për cilindo personalitet publik. Dhe ashtu veproi edhe në këtë rast.

Ajo mobilizoi tërë personelin që kishte në dispozicion në kuadër të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për të përgatitur aktakuzën kundër Ramush Haradinajt.

“Konfirmimi i aktakuzës kundër Ramush Hardinajt më 4 mars 2005”² dhe shpërndarja e këtij lajmi më 5 mars 2005 dikujt mund t’i duket “një detaj” i rastësishëm! Por, të mos harrojmë se kemi të bëjmë me një prokurore që e di fare mirë se “në detaje fshihet dreqi”! Dhe nuk është e vetmja që e di këtë proverb latin! Por, nuk duhet të harrojmë se «Në vendin e proverbave, mbretër janë fshehësit e kuptimit të proverbit»³.

¹ Carla Del Ponte, vepra e cituar, La traque, les criminels de guerre et moi, f.480

² Po aty, f.480

³ Për këtë aspekt, që nuk ka lidhje me temën tonë, lexuesit që i intereson mund të shohë:

Almuth Grésillon, Poliphonie, proverbe et détournement, ou un proverbe peut en cacher un autre

http://www.persee.fr/web/revues/home/prescript/article/lgge_0458-726x_1984_num_19_73_1168

Péter Barta, Au pays des proverbes, les détournements sont rois.

Contribution à l'étude des proverbes détournés du français (II)

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:vNNbXEifKToJ:www.paremia.org/wp-content/uploads/06-Barta.pdf+&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch>

Të gjithë njohësit e historisë së luftës së Kosovës e dinë se datat 4 dhe 5 mars janë ngulitur thellë në vetëdijen e shqiptarëve si data në të cilat ndodhi akti i parë i gjenocidit serb në Kosovë. Krahas përkujtimit për çdo vit të kësaj tragjedie që shkaktoi regjimi i Milošević-it, populli shqiptar i Kosovës përkujton heroizmin e pashembullt të komandantëve të UÇK-së, Adem e Hamzë Jasharit, të cilët, në një raport forcash tejet të pabarabarta, dëshmuar rezistencën më sublime të një populli liridashës. Përmes vrasjes së këtyre dy komandantëve të UÇK-së, regjimi i Beogradit dëshironte të vriste aspiratën e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi nga Serbia.

Po sjell për lexuesin që nuk është i informuar se më 4 dhe 5 mars të vitit 1998 forcat e mëdha policore dhe ushtarake serbe rrethuan fshatin Prekaz të Drenicës. Fjala është për ngjarjet që ndodhën më 4 dhe 5 mars 1998, për të cilat komandanti i pensionuar i policisë serbe, Slobodan Stojanović-i, dëshmoi se “në Prekazin e Epërm dhe të Poshtëm u vranë gra, fëmijë, kafshë dhe çdo gjë që lëvizte atje ...”¹; fjala është për të njëjtën ngjarje për të cilën Ratomir Tanić-i, përfaqësues i delegacionit serb në bisedimet me Kosovën², deklaroi se “në vend të arrestimit të vëllezërve Jashari dhe të tjerëve, forcat tona sulmuan shtëpitë ku ata jetonin dhe masakruan gratë, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes. Në vend që të kufizoheshin aksionet në caqet e caktuara, u sulmuan edhe fqinjët e tyre...”³

Fjala është për datat kur populli shqiptar i Kosovës i përkujton këto ngjarje me dhembje dhe krenari, përderisa regjimi i Milošević-it zyrtarisht i interpretonte si “suksese në luftën kundër terrorizmit”⁴

¹ Fond za humanitarno pravo, «Svedočenje Slobodana Stojanovića (2): Ubijali su decu, žene, starce, čobane, ovce», (Dëshmi e Slobodan Stojanović-it: kanë vrarë fëmijë, gra, pleq, çobanë, dhen....) në <http://www.hlc-rdc.org/?p=25448>

² Më gjerësisht për dëshminë e tij lexuesi u njoftua në Epilogun e Kapitullit të tretë, në Kapitullin e Katërt dhe atë të pestë.

³ Dëshmia e Ratomir Tanić-inë procesin Gjyqësor kundër S. Milošević-it, 14 maj 2002, f. 718-719

⁴ <http://news.bbc.co.uk/2/hi/world/monitoring/64947.stm>

Të përzgjidhen datat 4 dhe 5 mars për të konfirmuar dhe shpërndarë lajmin për aktakuzën kundër njërit prej udhëheqësve të UÇK-së që ishte zgjedhur kryeministër, është një “detaj” që as “dreqit” nuk do t’i shkonte ndër mend që të bënte përzgjedhje më provokuese për ndjenjat e shqiptarëve.

Edhe më provokuese është fakti se të gjitha “detajet” e lëndës kundër Ramush Haradinajt janë “detaje” të publikuara nga Shërbimi Sekret Serb dhe të “detajuara” në një aktakuzë të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Për më tepër edhe vetë Carla Del Ponte pohon në librin e vet se gjatë vizitave në Beograd “u njoftua për aktivitetet kriminale të anëtarëve të UÇK-së”¹, “për njerëzit që ishin zhdukur në Kosovë në mes të vitit 1998 dhe 2001”², “për rrëmbimin e burrave, grave dhe fëmijëve...”³, “për listën me 200 emra rrëmbyesish, të gjithë anëtarë të UÇK-së”⁴, “për ekzekutimet e supozuara në afërsi të liqenit të Radoniqit dhe listën për 196 vendeve të ekzekutimeve të mundshme...”⁵

Që nga cilësimi i shoqërisë shqiptare “si shoqëri klanore që nuk njeh asgjë tjetër përveç ligjit të vet të hakmarrjes”⁶, stigmatizimi i UÇK-së si “ndërmarrje kriminale që kishte për qëllim që të forconte kontrollin mbi Zonën e Dukagjinit dhe realizimin e dëbimit me forcë ose eliminimin praktik të civilëve serbë që qëndronin në territorin e kësaj zone të kontrolluar nga UÇK-ja”⁷ e deri te rastet e veçanta të “rrëmbimeve dhe vrasjeve të civilëve serbë, shqiptarë, romë dhe civilë të tjerë të dyshuar si bashkëpunëtorë të forcave serbe apo që nuk e mbështesnin UÇK-në...”⁸ të gjitha ishin “detaje” të sajuara dhe të botuara në «Librin e Bardhë» të Shërbimit Sekret Serb. Pikërisht mbi bazën e këtyre “detajeve” Carla Del Ponte ngriti padinë kundër Ramush Haradinajt.

¹ Carla Del Ponte vepra e cituar, La traque, les criminels de guerre et moi, f.455

² Po aty, f.455

³ Po aty, f.455

⁴ Po aty, f.456

⁵ Po aty, f.464

⁶ Po aty, f.460

⁷ Po aty, f.481-482

⁸ Po aty, f.481

Megjithatë, përkundër bindjes së plotë se ishte tërësisht i pafajshëm, Ramush Haradinaj dha dorëheqje nga funksioni i kryeministrit, u bëri thirrje qytetarëve të Kosovës për qetësi të plotë dhe u paraqit në Hagë, në Gjykatën Penale Ndërkombëtare që të ballafaqohet me drejtësinë.

Vendimi i Ramush Haradinajt të tërhiqet nga posti i Kryeministrit të Kosovës me qëllim që t'i mundësojë lirshëm drejtësisë ndërkombëtare të bëjë punën e vet dhe thirrja e tij publike drejtuar popullit të Kosovës për qetësi dhe respektim të rendit, pati jehonë tejet pozitive. Personalitete të ndryshme ndërkombëtare e përshëndetën¹ këtë qëndrim që shkonte në drejtim të vazhdimit të stabilizimit të gjendjes në Kosovë, si kusht i domosdoshëm për t'u përmbyllur procesi i përcaktimit të statusit të ardhshëm politik të saj.

Por, nuk duhet të lihet në heshtje fakti se apeli i Ramush Haradinajt për qetësi i zhgënjeu ata që prisnin turbullira dhe destabilizim të situatës, të cilat do të shfrytëzoheshin për ta paraqitur Kosovën si vatër të vazhdueshme krizash!

E vlen të theksohet se as Carla Del Ponte nuk e fshehu zhgënjimin e saj. Nga të gjitha deklaratat përshëndetëse të ndërkombëtarëve në Kosovë, deklaratën e Shefit të UNMIK-ut, Søren Jessen-Petersen, i cili përmes një komunikate për shtyp përshëndeti veprimin e Ramush Haradinajt, Carla Del Ponte e merr si “shenjë dobësie² të ndërkombëtarëve përball shqiptarëve.” Madje, ajo shkon edhe më larg në konstatimet e saj! “Elozhet e Jessen Petersenit duket se nënkuptojnë që UNMIK-u është i pafuqishëm,

¹ Për reagimet lidhur me dorëheqjen e Ramush Haradinajt nga posti i Kryeministrit të Kosovës një sintezë mund të gjendet në shkrimet: «Haradinaj udhëtoi për në Hagë!»,

<http://www.parajsa.com/forum/t/haradinaj-udhatoi-par-na-haga> dhe «Kryeministri i Kosovës jep dorëheqjen për t'u përballur me akuzat për krimet e luftës në Hagë»

<http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2005/03/09/feature-01>

² Rreth kësaj mënyre të interpretimit të marrëdhënieve mes shqiptarëve dhe përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare shih më gjerësisht në veprën e Carla Del Ponte, *La traque, les criminels de guerre et moi*, Editions Heloise d'Ormesson, botimi frëngjisht, tetor 2009, ff. 485-490

se është në mëshirën e shqiptarëve, të cilët praktikisht e kishin tredhur gjatë protestave të 2004.”¹

Status quo-ja dhe statusi final i Kosovës

Sado që të përpiqet Carla Del Ponte “të fshehë dreqin prapa detajeve” një gjë nuk mund të fshihet: përmes aktakuzës kundër Kryeministrit të Kosovës synoheshin trazira të reja, të cilat do të ndikonin në shtyrjen e fillimit të procesit të përcaktimit të statusit final të Kosovës.

Megjithatë, në qarqet politike dhe diplomatike dominonte mendimi se ruajtja e status quo-së ngërthente në vete rreziqe² për destabilizimin e situatës në Kosovë dhe më gjerë. Me një fjalë, përcaktimi i statusit politik final të Kosovës shtrohet si element thelbësor “për të siguruar paqen dhe stabilitetin afatgjatë të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës në tërësi.”³

Me qëllim që të bëhej një bilanc i realizimit të standardeve dhe të shmangej ndonjë rrezik eventual për paqen dhe sigurinë e Kosovës dhe të rajonit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan-i, përmes raportit⁴ të 23 majit 2005, shprehu haptazi qëllimin e tij për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme që “të përpilohej një raport global për situatën në Kosovë.”⁵ Për këtë arsye, në qershor të vitit 2005, ai e ngarkoi Kai Eide-n, përfaqësuesin e Misionit permanent të Norvegjisë pranë NATO-s, që të jetë i dërguari special i tij dhe të bëjë një shqyrtim të situatës së tërësishme të Kosovës.

Pas një hulumtimi tremujor, ambasadori Kai Eide dorëzoi raportin e vet. Më 7 tetor 2005, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e shtroi këtë raport për shqyrtim në Këshillin e Sigurimit⁶.

¹ Carla Del Ponte vepra e cituar, *La traque, les criminels de guerre et moi*, f.487

² UNMIK, «Apporter la paix au Kosovo»,
<http://www.paixbalkans.org/minuk.htm>

³ Paragrafi 1 i Rezolutës 1595 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

⁴ Kombet e Bashkuara, doc.S/2005/335, 23 majit 2005

⁵ Po aty

⁶ Kombet e Bashkuara, doc.S/2005/635 i datës 7 tetor 2005

Në seancat 5289 dhe 5290 të KS të OKB-së, të 24 tetorit 2005, Këshilli i Sigurimi u shpreh i kënaqur me raportin e përpiluar nga i dërguari special Kai Eide dhe aprovoi përfundimet e ambasadorit Eide, sipas të cilit kishte ardhur koha që të kalohet në fazën tjetër të procesit politik. Pas shqyrtimit të situatës globale të ekspozuar në këtë raport, Këshilli i Sigurimit u pajtua se përcaktimi i statusit final të Kosovës ishte i domosdoshëm dhe vendosi t'i japë dritë jeshile fillimit të këtij procesi. Në të njëjtën kohë, Këshilli i Sigurimit kërkoi që sa më shpejt të caktohej një i dërguar special që do të udhëhiqte këtë proces dhe rikonfirmoi mbështetjen e objektivave për një Kosovë multietnike, demokratike dhe faktor stabiliteti në rajon¹.

Në përputhje me këtë vendim, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, përmes letrës² së 31 tetorit 2005, e njoftoi Këshillin e Sigurimit se kishte ndër mend të caktonte Martti Ahtissari-n³, si të dërguar special për të udhëhequr bisedimet, ndërsa Albert Rohan-in⁴, si zëvendës të tij.

Martti Ahtissari tanimë ishte i njohur për angazhimin e tij në përfundimin e luftës, si bashkautor i planit të paqes⁵.

Propozimet e Kofi Annan-it u mbështetën⁶ nga Këshilli i Sigurimit dhe që nga 10 nëntori 2005 Martti Ahtissari dhe Alber

¹ Kombet e Bashkuara, doc. S/PRST/2005/51, 24 tetor 2005

² Kombet e Bashkuara, doc.S/2005/708 i datës 31 dhjetor 2005

³ Martti Ahtissari ka qenë president i Finlandës gjatë periudhës 1994-2000. Pas përfundimit të mandatit si president i shtetit, ai themeloi Iniciativën për Menaxhimin e Krizave Crisis Management Initiative (CMI), president i të cilës ishte ai vetë. Para emërimit si i dërguar special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB, deri në shtator të vitit 2005, Martti Ahtisaari ishte edhe nënkryetar i East-West Institute dhe anëtar i grupit këshillues Open Society Institute.

⁴ Drejtori i Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (1977-1981) dhe Drejtori i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austrisë (1996-2001)

⁵ Le monde diplomatique, « Plan de paix de MM. Tchernomyrdine et Ahtisaari » (Plani i paqes i Tchernomyrdin-it dhe Ahtisaari-t), në : <http://www.monde-diplomatique.fr/cahier/kosovo/ok2juin-fr>

⁶ Shih letrën (Kombet e Bashkuara, doc.S/2005/709, 10 nëntor 2005) përmes të cilës Kryetari i Këshillit të Sigurimit, Andrey I. Demisov-i, njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së për mbështetjen e Këshillit të Sigurimit për propozimet lidhur me Martti Ahtisaarin dhe Albert Rohan-in.

Rohan-i ishin të ngarkuarit zyrtarë për të udhëhequr bisedimet mes Serbisë dhe Kosovës. Letrës mbështetëse, Kryetari i Këshillit të Sigurimit, Andrey I. Demisov-i, i bashkëngjiti edhe Parimet orientuese të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

Lexuesit që i intereson të lexojë tërësinë e parimeve orientuese të Grupit të Kontaktit mund t'i gjejë në faqen e internetit¹ të Kombeve të Bashkuara. Unë po përmend vetëm ato që më duken domethënëse për temën që po trajtoj.

Në parimet orientuese të Grupit të Kontaktit theksohet se “rregullimi i statusit të Kosovës duhet të konsolidojë sigurinë dhe stabilitetin rajonal, duke garantuar në këtë mënyrë që Kosova të mos kthehet në gjendjen e para marsit të vitit 1999. Çdo zgjidhje e njëanshme që rezulton nga përdorimi i forcës nuk do të jetë e pranueshme. Nuk do të ketë ndryshime të territorit të tanishëm të Kosovës, që do të thotë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe se nuk do të ketë bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër apo me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve regionalë do të respektohet plotësisht.”²

Negociatat e Vjenës

Arrestimi i Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt dhe gjendja shëndetësore e Presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugovës ndikuan drejtpërsëdrejti në vonimin e fillimit të negociatave për përcaktimin e statusit final të saj.

Një muaj pas vdekjes së Presidentit Rugova³ dhe zgjedhjes së Fatmir Sejdiut si president⁴ i Kosovës, në Vjenë të Austrisë filluan negociatat mes delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë.

¹ Kombet e Bashkuara, doc. S/2005/709, 10 nëntor 2005, f. 2-3
http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:VuvkRRIMIVkJ:www.operationspaix.net/DATA/DOCUMENT/3398~v~Lettre_adressee_au_Secretaire_general_par_le_President_du_Conseil_de_securite_au_sujet_de_la_nominacion_de_l_Envoye_special_charge_de_diriger_le_proce.pdf+&cd=2&hl=fr&ct=clnk&gl=ch

² Po aty, f.3

³ Presidenti Rugova vdiq më 21 janar 2006

⁴ Fatmir Sejdiu u zgjodh në këtë funksion më 10 shkurt 2006.

Si gjatë Konferencës së Rambujesë, ku delegacioni serb ishte i përbërë nga njerëz që nuk kishin kompetenca të merrnin vendime, në të njëjtën mënyrë, qeveria e re e Beogradit aplikoi metodat e vjetra. Në bisedime për statusin final të Kosovës në Vjenë, Serbia dërgoi zyrtarë të niveleve të ulëta të Ministrisë së Punëve të Jashtme¹. Ndërsa delegacioni i Kosovës përbëhej nga Fatmir Sejdiu (Presidenti i Kosovës), Agim Çeku (Kryeministër), Kolë Berisha (Kryetar i Kuvendit të Kosovës), Hashim Thaçi (Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, partisë më të madhe opozitare), Veton Surroi (Kryetar i Partisë ORA dhe publicist i njohur i Kosovës)² Lutfi Haziri (ministër, LDK) dhe Blerim Shala nga shoqëria civile. Ekipi i Kosovës, që u emërua «Ekip i Unitetit», ishte përfaqësimi më i lartë i mundshëm dhe në të njëjtën kohë tregues se Kosova i ishte qasur këtyre negociatave me seriozitetin më të lartë.

Duke filluar nga data 20 shkurt e vitit 2006 e deri më datë 8 shtator të të njëjtit vit, të dy delegacionet zhvilluan 11 raunde bisedimesh. Gjatë këtyre bisedimeve, delegacioni i Serbisë dhe delegacioni i Kosovës trajtuan çështje të ndryshme që lidheshin me decentralizimin e funksioneve qeverisëse dhe të administratës në Kosovë, çështjet e trashëgimisë kulturore, vendet e kultit religjioz, çështje ekonomike dhe çështje lidhur me të drejtat e minoriteteve.

Përveç përfaqësimit në nivel të ulët të delegacionit të Serbisë në krahasim me delegacionin e Kosovës, në analizën e lartpërmendur Marc Weller-i thekson se “delegacioni serb nuk ishte i përgatitur për t’u angazhuar në diskutime thelbësore.” Madje, “pala serbe nganjëherë përpiqej të provokonte delegacionin e Kosovës duke ngritur debate historike dhe kohë pas kohe edhe duke fyer me qëllim që t’i shtynte t’i braktisnin bisedimet.”³

¹ European Union, Institute for Security Studies, Chaillot Paper, decembre 2008, No114

Marc Weller, «Negotiating the final status for Kosovo», f.28

Shih: www.iss.europa.eu/uploads/media/cp114.pdf

Studimi i integruar në botimin shqip: Marc Waller, *Shtetësia e kontestuar*, Botues Koha, qershor 2011, f. 326

² Po aty, studimi anglisht f. 27, botimi shqip f.325

³ Po aty, studimi anglisht f. 27, botimi shqip f.325

Një nga ngjarjet më të rëndësishme që ndodhi gjatë këtyre negociatave, e që nuk ishte pa efekt në propozimin e të Dërguarit special për të udhëhequr këto bisedime, lidhej me Malin e Zi. Ky shtet, i cili kishte mbetur ende i lidhur në një sistem federal me Serbinë nga të gjitha ish republikat që përbënin Federatën e Jugosllavisë, shpalli referendum për pavarësinë e vet. Në referendumin e organizuar më 21 maj 2006, 55.5 % e votuesve mbështetën ndarjen e Malit të Zi nga Serbia dhe krijimin e shtetit të pavarur të Malit të Zi¹.

Përkundër kundërshtimeve të mëdha nga ana e Serbisë dhe alarmit për rrezikun e destabilizimit rajonal në rast të ndarjes së Malit të Zi². Parlamenti malazez, më 3 qershor 2006, e shpalli Malin e Zi shtet të pavarur dhe sovran³.

Ndarja e Malit të Zi nga Serbia ua humbi shpresat të gjithë atyre që ende mendonin të krijonin një «federatë të vogël», si mbetje e ish-Federatës Jugosllave, në të cilën do të inkuadronin edhe Kosovën.

Mosgatishmëria serbe që të angazhohej në bisedime për çështjet thelbësore, bëri që pas 11 raundeve të negociatave “në shumicën e çështjeve për të cilat ishte biseduar, palët qëndronin shumë larg njëra-tjetrës.”⁴

Siç e përmenda më lart, delegacioni serb bënte provokime të llojeve të ndryshme, vetëm e vetëm që ta detyronte delegacionin e Kosovës t'i ndërpriste bisedimet. Këto fyerje dhe provokime, që bëheshin larg syve të publikut, ishin të nivelit të ulët. Provokimin

¹ BBC, «Montenegro declares independence», (Mali i Zi shpall pavarësinë)
<http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/5043462.stm>

² Shih shkrimin e Ivan Janković-it « Zašto Crna Gora treba da bude nezavisna?» (Pse Mali i Zi duhet të jetë i pavarur?)
<http://katalaksija.com/2006/05/04/zasto-crna-gora-treba-da-bude-nezavisna/>

³ Vimeo, «Proglashenje nezavisnosti Crne Gore», 3 jun 2006 (Shpallja e pavarësisë së Malit të Zi, 3 qershor 2006)
<http://vimeo.com/67519137>

⁴ OKB, Raportet S/2006/707 dhe S/2007/906
shih: <http://www.un.org/docs/sc/sgrep07.htm>

më të madh që bëri pala serbe gjatë procesit të këtyre negociatave, erdhi nga kreu i institucioneve shtetërore të Serbisë.

Me qëllim t'i vinin ndërmjetësuesit ndërkombëtarë para aktit të kryer, Qeveria e Serbisë vendosi të hartonte kushtetutën e re me procedurë të përsheptuar, pa debat publik dhe pa pritur epilogun e negociatave.

Më 14 shtator të vitit 2006 Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë debatoi lidhur me projektin e kushtetutës së re. Sa i përket vendit, gjuhës dhe terminologjisë së përdorur nga deputetët serbë krijohej përshtypja se ishim në kohën e Milošević-it. Kështu, për historianin dhe funksionarin e partisë Liberale Demokratike të Serbisë, Nikola Samardžić-in, debatet që u dëgjuan nga foltorja e Kuvendit serb dëshmonin se gjërat ishin edhe më keq se në kohën e Milošević-it. “Milošević-i kishte të njëjtin parlament dhe megjithatë sillte vendime më të buta dhe më të arsyeshme nga ato fjalë që i dëgjua në foltore.”¹

Mediatizimi i skajshëm i kësaj çështjeje e shtyri gazetaren serbe, Svetlana Lukić-i, të shprehë revoltën e vet përmes ironisë: “Atë që dëgjua atë ditë në kuvend dhe ajo që u vendos aty është kuintesenca e çmendurisë dhe e shkëputjes nga realiteti. Me sa po shoh, në preambulë të kushtetutës së re do të shënohen fjalët e arta se Kosova ka qenë serbe që nga Shpërthimi i madh (Big Bangu) e deri te Tkurrja e Madhe e universit. Do të kishte qenë mirë që tërë kushtetuta të përbëhej vetëm nga kjo fjali për Kosovën, pastaj do të kishim mundur ta bënim emblemë, të cilën do ta mbanim përherë, ndërsa ata me lëkurë më pak të ndjeshme do të mundnin të bënëin tatuazh këtë fjali, kuptohet në vendet e dukshme...”². Ndërsa, atë me çka bombardohej opinioni publik i Serbisë, intelektualit serb nga Beogradi, Miljenko Dereta-n, e përshkruan në këtë mënyrë: “ Sa herë që zgjohem, e ndjej se, si në filmin *Dita e marmotës*³, gjërat përsëriten. Ja ditëve të fundit

¹ Radio Pešcanik, «govore: Miljenko Dereta, Vesna Pešić i Nikola Samardžić», 15.09.2006, <http://pecscanik.net/2006/09/tangent-a-srca/>

² Po aty

³ Fjala është për filmin amerikan «Groundhog Day» të regjisorit Harold Ramis

Kosova është temë kryesore. Flitet me të njëjtën gjuhë, me të njëjtën terminologji, me të njëjtat ide si para 5, 10, 15, 20 vitesh. Asnjë zgjidhje nuk ofrohet, pos status quo-së...Unë nuk e di nëse ekziston një qeveri tjetër, kudo qoftë në botë, e cila çdo ditë demonstroi paaftësinë e saj për të zgjidhur problemet dhe mosgatishmërinë për të zgjidhur problemet... Unë kam lindur në diçka që është quajtur Jugosllavi dhe në qoftë se jeta ka bërë që kjo hapësirë në të cilën kam lindur, të cilën e kam përjetuar si hapësirë time, pjesë-pjesë të zvogëlohet dhe pjesë të saja të largohen nga kjo hapësirë, dhe nëse ishte e pranueshme një gjë e tillë, atëherë pse të jetë e papranueshme edhe në rastet tjera. Për mua, në këtë moment, Kosova është sikurse Sllovenia. Nëse Sllovenia mundi të ndahet nga Jugosllavia, pse nuk mund të ndahet edhe Kosova?”¹

Miljenko Dereta nuk ishte intelektual i vetëm serb që mbështeste pavarësinë e Kosovës. Nikola Samardžić-i deklaroi, në cilësinë e funksionarit të partisë Liberale Demokratike të Serbisë, se “ne jemi e vetmja parti e cila me vendosmëri ka ripohuar se pavarësia e Kosovës, jo vetëm që është realitet i ardhmërisë, por është një e drejtë të cilën e kanë shumica shqiptare. Është në interes të Serbisë që të çlirohet nga një territor të cilin nuk mund ta qeverisë dhe ku serbët kanë interesat e tyre historike, kulturore dhe ekonomike, interesa të cilat Serbia nuk mund as t’i imponojë e as t’i zbatojë me dhunë”²

Edhe për sociologun dhe politikanen³ serbe, Vesna Pešić-in, referendumi për kushtetutën e re të Serbisë bëhet “vetëm e vetëm që të thuhet se Kosova është e jona... Çështja e statusit të Kosovës do të vendoset pavarësisht se çka do të shkruajmë në kushtetutën tonë. E dimë se në atë kushtetutë do të shkruhet që Kosova është pjesë e territorit të shtetit të Serbisë. E çka nëse do të bëhej një rezolutë e re e Kombeve të Bashkuara, dhe një ditë do të bëhet, në

¹ Radio Pešćanik, emisioni i cituar, «Govore: Miljenko Dereta, Vesna Pešić i Nikola Samardžić»

² Po aty

³ Gjatë periudhës 1992-2007 ishte aktiviste dhe udhëheqëse e Lidhjes Qytetare serbe, ndërsa gjatë viteve 2007-2011 kaloi në Partinë Liberale Demokratike të Serbisë, pas shkrirjes së Lidhjes Qytetare serbe në këtë parti.

të cilën do të thuhet se Kosova nuk është më territor i këtij shteti. Çka nëse shtetet tjera fillojnë ta njohin Kosovën e pavarur, në qoftë se Bashkimi Evropian e njeh këtë shtet dhe nëse e njohin edhe Shtetet e Bashkuara përderisa në kushtetutën tonë shkruan se territori i shtetit tjetër është pjesë e shtetit tonë?! Kjo do të kishte qenë një lloj sikur Austria të shkruante në kushtetutën e vet se Sllovenia është pjesë e territorit të saj¹. Ky skenar nuk është i pamundur, edhe pse ende nuk është sjellë vendimi për statusin e Kosovës. Unë nuk besoj se ky vendim do të bëhet në përputhje me kushtetutën tonë... Kur shtetet tjera ta njohin Kosovën çka do të bëjmë atëherë? Si do të hyjmë në Evropë? ... Nga vrasja e Zoran Đinđić-it ne praktikisht ia kemi kthyer shpinën Evropës. Duhet të thuhet haptazi: Serbia e sotme dhe udhëheqja e saj e sotme nuk dëshirojnë të shkojnë në Evropë, ata nuk e dëshirojnë një gjë të tillë.”²

Përkundër kritikave të shumta në opinionin publik serb, Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë, në një seancë të veçantë të thirrur më 30 shtator 2006, miratoi njëzëri propozimin për Kushtetutën e re të Serbisë. Të nesërmen, më 1 tetor, Kryetari i Kuvendit të Serbisë, Predrag Marković-i, shpalli organizimin e referendumit për 28 dhe 29 tetor 2006³.

Qëllimin e vërtetë të përpilimit të kushtetutës së re e shpalli zyrtarisht Kryeministri i Serbisë, Vojislav Koštunica. Një ditë para mbajtjes së referendumit ai deklaroi se “miratimi i Kushtetutës së re të Serbisë përmes referendumit që do të mbahet nesër dhe të dielën, do të dëshmojë vullnetin e qytetarëve që Kosova të mbetet pjesë përbërëse e Serbisë.”⁴

¹ Aluzioni për pretendimet e të drejtës historike kur një territor i caktuar, në një periudhë të caktuar, ka qenë pjesë e një shteti të caktuar. Sllovenia dikur ka qenë pjesë e Mbretërisë Austro-Hungareze!

² Radio Pešćanik, emisioni i cituar, «govre: Miljenko Dereta, Vesna Pešić i Nikola Samardžić»

³ Šta donosi predlog novog ustava Srbije (Çka sjell propozimi i kushtetutës së re) Shih: http://www.b92.net/info/dokumenti/index.php?nav_id=213697

⁴ Qeveria e Serbisë, «Koštunica: Jendnostrano priznanje Kosova je pravno nasilje» (Pranimi i njëanshëm i Kosovës është dhunë mbi të drejtën) http://www.mfa.gov.rs/Srpski/Bilteni/Srpski/b301006_s.html#N3

Ashtu siç ishte organizuar referendumi në funksion të manipulimit ashtu edhe përfundoi. Edhe pse të dhënat flisnin për pjesëmarrjen¹ e qytetarëve që nuk e legjitimonte këtë referendum, autoritet shtetërore të Serbisë publikuan shifrat se 51.4 % e votuesve kishin votuar për Kushtetutën e re të Serbisë. Edhe pse nuk u fsheh se asnjë shqiptar nuk kishte marrë pjesë në këtë referendum, manipulimi me përqindjen e pjesëmarrjes arriti kulmin kur u tha “se dalja më e madhe e votuesve ishte në Kosovë, 90.1%²!!!

Shkurt, “Serbia përpiquej të mbyllte të gjitha gjasat për çfarëdo zgjidhje të negociuar kur në mënyrë të njëanshme e kishte ndryshuar kushtetutën e vet në mes të procesit për statusin final të Kosovës³.

Pas miratimit të Kushtetutës së re të Serbisë dhe në përputhje me dispozitat e saj, më 10 nëntor 2006, Presidenti i Serbisë, Boris Tadić-i shpalli zgjedhjet e lira të jashtëzakonshme. Këto zgjedhje u mbajtën më 21 janar 2007 dhe fitues i tyre doli Partia Radikale Serbe. Vlen të theksohet se kjo parti udhëhoqëz zyrtarisht nga themeluesi i saj, Vojislav Šešel-i, i cili që nga viti 2003 ishte i burgosur në Hagë, i akuzuar për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte⁴. Në përputhje me rezultatin e këtyre zgjedhjeve, Tomislav Nikolić-i, nënkryetari i kësaj partie, u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Serbisë. Të gjitha partitë tjera serbe u bashkuan për të penguar krijimin e Qeverisë nga ana e Partisë Radikale Serbe. Qeveria e re e udhëhequr nga Vojislav Koštunica⁵ u krijua më 15

¹ Shih pjesën e reagimeve për referendumin: Politika, «LDP: Na referendum izašlo 49,7 odsto»

<http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Referendum/t10734.lt.html>

² Politika, «Ustav potvrđen: "Za" glasalo 51,4 odsto birača» (U vërtetua kushtetuta: 51.4 % e zgjedhësve votuan “PO”)

<http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Referendum/t10734.lt.html>

³ Marc Weller, vepra e cituar, botimi anglisht, f. 73, botimi shqip, f. 380 (citimi nga botimi anglisht)

⁴ Fondacion Robert Schuman, «Les ultranationalistes arrivent en tête, des élections législatives en Serbie»

<http://www.robert-schuman.eu/fr/oeo/0609-les-ultranationalistes-arrivent-en-tete-des-elections-legislatives-en-serbie>

⁵ Që njihet si Qeveria Koštunica II

maj 2007, vetëm disa minuta para se të përfundonte afati ligjor për krijimin e qeverisë.

Megjithatë, as manipulimet e natyrave të ndryshme, as referendumi për Kushtetutën e re të Serbisë e as zgjedhjet e jashtëzakonshme nuk mundën ta pengojnë vazhdimin e punës që bënin ndërmjetësuesit ndërkombëtarë gjatë procesit të negociatave të Vjenës. Më 2 shkurt 2007¹ i dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Martti Ahtisaari, ua dorëzoi të dy delegacioneve pakon e propozimeve lidhur me statusin final të Kosovës dhe ftoi palët të angazhohen në një proces konsultimesh.



Përfaqësuesit e Kosovës marrin propozimin e Ahtisaari-t

¹ shih raportin e Sekretarit të ri të përgjithshëm të KB-së, Ban Ki-moon-it, S/2007/134, 9 mars 2007



Përfaqësuesit e Serbisë marrin propozimin e Ahtisaari-t

Përfaqësuesit e Kosovës¹ u deklaruan pozitivisht për pakon e propozimeve, ndërsa përfaqësuesit e Serbisë u shprehën kategorikisht kundër. Kështu, Presidenti serb, Boris Tadić-i, deklaroi se “Serbia dhe ai vetë në cilësinë e presidentit të shtetit, nuk do ta pranojnë kurrë pavarësinë e Kosovës”² ndërsa për Kryeministrin serb, Vojislav Koštunica “Ahtisaari ishte antiserb dhe proshqiptar”, i cili “kishte propozuar qëndrime të njëanshme.”³

Jo vetëm që u cilësua si “antiserb dhe proshqiptar”, por, shpifjet kundër Ahtisaari-t shkuan aq larg sa ai u akuzua nga qarqet serbe se gjoja kishte marrë para nga «mafia shqiptare» për të mbështetur pavarësinë e Kosovës! Duke u bazuar në gazetën «Focus» të serbëve të Bosnjës, Televizioni shtetëror i Serbisë informoi opinion e vet publik se gjoja “Shërbimi Informativ Gjerman, BDN-ja, kishte zbuluar se mafia shqiptare e kishte blerë

¹ Le monde, «Serbes et Albanais divisés sur le plan Ahtisaari (Serbët dhe shqiptarët të përçarë për planin e Ahtisaari-t)», 03.02.2007
http://www.lemonde.fr/europe/article/2007/02/03/serbes-et-albanais-divises-sur-le-plan-ahtisaari_863211_3214.html

² Po aty

³ Cituar nga Milena Dieckhoff, L'individu dans les relations internationales : Le cas du médiateur Martti Ahtisaari, Harmattan, 2012, f. 74

planin e Ahtisaari-t për pavarësinë e Kosovën për një shumë prej 40 milion euro. Burimi i gazetës së serbëve të Bosnjës pohonte se pjesa më e madhe e kësaj shume parash i ishte dhënë Ahtisaari-t në dorë, me çanta ngjyrë argjendi, ndërsa dy milion euro ishin derdhur në llogarinë e tij bankare.”¹

Përkundër faktit se këto shpifje ishin përgënjeshtuar, mediat serbe dhe ato proserbe vazhdonin të mbanin në faqet e tyre “skandalin e shitjes së Ahtisaari-t”. Nuk do të zgjatem në qindra shkrime të së njëjtës natyrë, sepse të gjitha shkrimet që shpërndajnë këtë gënjeshtër synojnë të krijojnë hutim lidhur me propozimet për statusin final të Kosovës. “Zbulimi i lidhjes së Martti Ahtisaari-t me mafien shqiptare dhe korrupsioni për të blerë mbështetjen për pavarësinë e Kosovës janë të mjaftueshme për të dyshuar në besueshmërinë e ‘raportit’ të tij”² përfundon ekipi i gazetës serbe «Press».

Në këtë kontekst, kur institucionet e Serbisë dhe qarqet proserbe ishin mobilizuar për të kundërshtuar mundësinë e pavarësimin të Kosovës dhe stigmatizonin çdo personalitet që mbështeste këtë pavarësi, Carla Del Ponte, përmes fillimit të procesit gjyqësor kundër ish Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt, u përpoq të tërheqë vëmendjen në atë që propagandonte Beogradi për “serbët e Kosovës, si viktima të shqiptarëve”.

Përzgjedhja e momentit të fillimit të procesit gjyqësor më 5 mars 2007 (përsëri 5 marsi sikur në kalendar të mos kishte datë tjetër!) dhe vënia e UÇK-së në bankën e akuzës në momentet vendimtare për fatin e ardhmërisë politike të Kosovës janë “detaje” të rëndësishme që mund të na ndihmojnë të shohim se pas cilave “detaje” fshihej Carla Del Ponte dhe aderimi i saj në strategjinë e stigmatizimit të aspiratës për pavarësi politike të shqiptarëve të Kosovës!

¹ Index, «Albanska mafija kupila Ahtisaarijev plan za Kosovo» (Mafija shqiptare e ka blerë planin e Ahtisaari-t për Kosovën)
<http://www.index.hr/vijesti/clanak/albanska-mafija-kupila-ahtisaarijev-plan-za-kosovo/351638.aspx>

² Press, Ekipii Gazetës, «Skandalozno otkriće Nemačke obaveštaine službe BND» (Zbulim skandaloz i Shërbimit të Informimit të Gjermanisë, BND-s’)
<http://www.pressonline.rs/info/politika/14102/albanci-kupili-ahtisarija.html>

Fillimi i procesit të gjykimit të Ramush Haradinajt më 5 mars 2007, pra pesë ditë para raundit të fundit të bisedimeve të parapara të zhvilloheshin në Vjenë, më 10 mars 2007, pati efekte propagandistike që delegacioni serb të fortifikohet në qëndrimet e veta mohuese.

“Bisedimet e fundit nuk sollën asnjë rezultat pozitiv”¹ në përafrimin e qëndrimeve të palës serbe dhe asaj shqiptare, deklaroi Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Në Mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të datës 26 mars 2007, Ban Ki-moon-i, shtroi për shqyrtim «Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës»², që ishte përgatitur nga Martti Ahtisaari dhe ekipi i tij. Në këtë raport theksohej se “pas më shumë se një viti bisedimesh të drejtpërdrejta, negociatave bilaterale dhe konsultimesh mes ekspertëve, u bë e qartë se palët nuk ishin të gatshme të merreshin vesh për statusin final të Kosovës.”³ Krahas kësaj, Ban Ki-moon-i tërhoqte vëmendjen se “Martti Ahtisaar-i kishte bindjen e fortë se ishin shterur të gjitha mundësitë që të gjendej një rrugëdalje e negociuar dhe e pranueshme nga të dyja palët. Vazhdimi i bisedimeve, në cilëndo formë qoftë, nuk do të mundësonte të dilej nga ky qorrsokak. Ka ardhur koha që të rregullohet statusi i Kosovës!”⁴

Në fund të raportit të vet, Martti Ahtisaari përfundoi se “duke shqyrtuar historinë e re të Kosovës dhe realitetin e tanishëm dhe duke zhvilluar negociata me të dyja palët, kam arritur te përfundimi se opsioni i vetëm i qëndrueshëm për Kosovën është pavarësia e saj. Fillimisht kjo pavarësi duhet të jetë e mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare.”⁵

¹ Shih raportine Sekretarit të përgjithshëm të KB-së S/2007/395 të datës 29 qershor 2007

² Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 26 mars 2007 http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:od4KU6e9n5QJ:www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal_-_Propozimi_gjith%25EBp%25EBrfshir%25EBs_-_albanian_final.pdf+%&cd=2&hl=fr&ct=clnk&gl=ch

³ Shih letrën e Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së drejtuar presidentit të Këshillit të Sigurimit, S/2007/168, 26 mars 2007, <http://www.un.org/docs/sc/sgrep07.htm>

⁴ Po aty

⁵ Po aty

Përfundimet e të dërguarit special u shoqëruan me tekstin¹ përfundimtar të propozimit të tij gjithëpërfshirës që kishte të bënte me statusin e Kosovës, i cili, sipas fjalëve të tij, vendoste strukturat e kësaj mbikëqyrje ndërkombëtare dhe hidhte bazat e një Kosove të pavarur².

Këto propozime përfshinin edhe krijimin e një komisioni të veçantë që do të përgatiste kushtetutën e Kosovës, mbajtjen e zgjedhjeve të lira për krijimin e autoriteteve qendrore dhe komunale, përfundimin e mandatit të UNMIK-ut pas një periudhe kalimtare prej 120 ditësh, transferimin e tërësishëm të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv nga autoritetet e misionit ndërkombëtar te autoritetet qeverisëse të Kosovës³.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së aderoi⁴ tërësisht në rekomandimet e formuluar nga Martti Ahtisaari. Propozimet që njihen si «Pako e Ahtisaari-t», u mbështetën edhe nga Belgjika, Franca, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore si dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në frymën e «Pakos së Ahtisaari-t», këto shtete përpiluan një Projekt⁵ rezolutë, e cila u tërhoq më 17 korrik 2007 për arsye të gjasave të mëdha që të pengohet nga Rusia, si anëtare e Këshillit të Sigurimit që kishte të drejtën e vetos.

¹ OKB, Doc. S/2007/168, Add. 1, 26 mars 2007

² OKB, Doc. S/2007/168, paragrafi 5

³ OKB, Doc. S/2007/168, Add. 1, 26 mars 2007, art.15.1

⁴ Shih letrën e tij drejtuar presidentit të Këshillit të Sigurimit të KB-së të datës 26 mars 2007, Doc. S/2007/168

⁵ Doc. S/2007/437 Prov.

Déjà vu në Rambuje: Vazhdimi i negociatave! Edhe 120 ditë negociata!

Përkundër konkluzionit të Martti Ahtisaari-t se “vazhdimi i bisedimeve, në cilëndo formë qoftë, nuk do të mundësonte të dilej nga ky qorrsokak”, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara kërkoi nga Grupi i Kontaktit që të bënte edhe një përpjekje për t'i përafuar pikëpamjet diametralisht të kundërta të palëve negociuese.

Lexuesit që i intereson të dijnë më shumë për këtë periudhë të negociatave i sugjeroj analizën në gjuhën angleze të autorit Marc Weller-it, të botuar në numrin 114 të revistës «Chaillot Paper»¹ ndërsa lexuesit shqiptar Kapitullin e 13 të veprës² së të njëjtit autor.

Për temën që po trajtoj më duket e mjaftueshme të theksoj se negociatat e reja, të parapara të zhvilloheshin gjatë 120 ditësh dhe të përfundonin më së voni deri më 10 dhjetor 2007, duhej të zhvilloheshin nën drejtimin e një «Treshje» të përbërë nga përfaqësuesit e SHBA-ve, Ruisë dhe BE-së.

Treshja e ngarkuar nga Grupi i Kontaktit, që përbëhej nga ambasadori gjerman Wolfgang Ischinger-i,³ Alexander Bostan-Harchenko⁴ dhe Frank Wiesner-i,⁵ zhvilloi këto negociata nga 9 gushti deri më 3 dhjetor 2007.

Pas tri⁶ takimeve të para që «Treshja» zhvilloi me palët në Londër, Beograd, Prishtinë dhe Vjenë, më 27 shtator të 2007, në New York, «Treshja» raportoi para Ministrave të Grupit të Kontaktit, Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Përfaqësuesit të lartë të BE-së, Presidencës së BE-së, Komisarit evropian për

¹ European Union, Marc Weller, studimi i cituar «Negotiating the final status for Kosovo», pjesa e pestë, f. 57-67

² Marc Waller, vepra e cituar, *Shtetësia e kontestuar*, f. 361-390

³ Përfaqësues i BE-së

⁴ Përfaqësues i Ruisë

⁵ Përfaqësues i SHBA-ve

⁶ 10-12 Gusht – Takimi i parë i Treshes me palët (Beograd dhe Prishtinë)
30 Gusht – Takimi i dytë i Treshes me palët (Vjenë)
18-19 Shtator – Takimi i tretë i Treshes me palët (Londër)

Zgjerim, Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe një përfaqësuesi të UNOSEK-ut.

Pas këtij takimi, Ministrat e Grupit të Kontaktit lëshuan një Deklaratë¹ për Kosovën, në të cilën, ndër të tjera, thuhej:

“Ministrat kanë rikujtuar se një zgjidhje e shpejtë e statusit të Kosovës është përcaktuese për stabilitetin dhe sigurinë e Ballkanit Perëndimor dhe të Evropës në tërësi. Ministrat kanë ripohuar vendosmërinë e tyre për të gjetur një zgjidhje të negociuar dhe të miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Ministrat kanë shprehur mirënjohjen e tyre për përpjekjet e vazhdueshme të UNMIK-ut dhe KFOR-it për krijimin e një Kosove shumëkombëshe, paqësore dhe demokratike. Ata kanë mbështetur në tërësi mendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së se status quo-ja nuk është e qëndrueshme. Kjo çështje ka pasoja të dëmshme për zhvillimin politik, social dhe ekonomik të Kosovës dhe për stabilitetin themelor të rajonit. Prandaj është e domosdoshme të gjendet menjëherë një zgjidhje.”²

Të nesërmen, më 28 shtator, në New York, u organizua takimi i parë i drejtpërdrejtë i palëve. Takimet e drejtpërdrejta do të vazhdojnë edhe në Bruksel³, në Vjenë⁴ dhe në Baden⁵ të Austrisë.

Më 7 nëntor 2007 “Komisioni Evropian nënvizoi domosdoshmërinë e rregullimit të statusit të Kosovës pa humbur kohë me qëllim që të mundësohej zhvillimi politik dhe ekonomik i territorit dhe të garantohej stabiliteti regjional.”⁶

¹ Déclaration des ministres du Groupe de Contact sur le Kosovo, New York, 27 septembre 2007
http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:oCS-WfneogEJ:www.diplomatie.gouv.fr/fr/IMG/pdf/070927groupe_de_contact_francais_bis.pdf+&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch

² Po aty

³ Më 14 tetor 2007 dhe 20 nëntor 2007

⁴ Më 22 tetor 2007 dhe më 5 nëntor 2007

⁵ 26, 27 dhe 28 nëntor 2007

⁶ Cituar në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, të datës 3 janar 2008, f.5, paragrafi 16
Nations Unies, Conseil de sécurité, S/2007/768
Rapport du Secrétaire général sur la Mission d'administration intérimaire des Nations Unies au Kosovo

Në frymën e propozimeve të Pakos së Ahtisaari-t për ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme të Kosovës, më 17 nëntor 2007 u zhvilluan zgjedhjet e lira dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës dhe për pushtetin komunal. Këto ishin zgjedhjet e pesta të organizuara që nga vendosja e UNMIK-ut në Kosovë.

“Zgjedhjet u organizuan nga Komisioni Qendror Zgjedhor i Kosovës, nën autoritetin e UNMIK-ut dhe në bashkëpunim të ngushtë me OSBE-në. Si rrjedhojë e një fushate elektorale të drejtë dhe të qetë, votimi u zhvillua pa incidente. Këshilli i Evropës konfirmoi rregullsinë dhe i cilësoi si zgjedhje që u zhvilluan në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.”¹

Në kontekstin e negociatave të lartpërmendura e shoh të rëndësishme që të sjell për lexuesin se në pikën tetë të raportit të vet, Ban Ki-moon-i theksonte se “gjatë gjithë fushatës elektorale, Ekipi i unitetit të Kosovës vazhdoi të merrte pjesë në negociatat e udhëhequra nga Treshja për statusin final të Kosovës. Përfaqësuesit e «Ekipit të Unitetit» e përsëritën shpesh se çdo vazhdim i ri i bisedimeve ishte i papranueshëm dhe se një datë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës duhej të caktohej sa më shpejt. Ky afat duhet të ishte menjëherë pas 10 dhjetorit² dhe në marrëveshje me bashkësinë ndërkombëtare. Kjo kishte bërë që të lindin shpresat se Kosova do të bëhej e pavarur në një të ardhme të afërt. Opinioni publik ushtronte një presion të madh ndaj qeverisë së re dhe kuvendit të ri për të bërë sa më shpejt atë që ishte e domosdoshme të bëhej, për ta deklaruar pavarësinë pas kalimit të atij afati.”³

Në këtë raport, Ban Ki-moon-i nxirrte në pah faktin se banorët e Kosovës ende shpresonin që do të gjendej një zgjidhje e shpejtë për statusin final. Për këtë arsye ai tërhoqi vërejtjen se “Status quo-ja nuk ka gjasa të mbijetojë” dhe “nëse vazhdon ky qorrrokak, ngjarjet në terren mund të imponojnë logjikën e tyre,

<http://www.un.org/fr/peacekeeping/missions/unmik/reports.shtml>
Documents → Rapports du Secrétaire général → S/2007/768, 3 janar 2008

¹ Po aty, Kaptina III, paragrafi 3 i raportit.

² Afati i fundit kur duhej të dorëzohej raporti përfundimtar i rezultateve të bisedimeve të Treshes

³ Raporti i 3 janarit 2008, Kaptina III, paragrafi 8 i raportit.

që do të komprometonte rëndë arritjet e deritanishme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.”¹

Për të shmangur përkeqësimin e situatës në Kosovë dhe në rajon, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së kërkoi që “Këshilli i Sigurimit dhe komuniteti ndërkombëtar ta kenë si prioritet përparimin e procesit të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës.”² Sepse “pasiguria dhe humbja e një dinamike të favorshme në procesin e përcaktimit të statusit të ardhshëm, krijojnë një rrezik për destabilizimin e Kosovës e të rajonit dhe paraqet një rrezik potencial për sigurinë e personelit të Kombeve të Bashkuara.”³

Përfundimi i negociatave për statusin politik të Kosovës

As fushata elektorale e as zgjedhjet nuk i ndalën negociatat. «Treshja» e intensifikoi punën e vet gjatë muajve tetor dhe nëntor të vitit 2007.

Pas takimeve të drejtpërdrejta të palëve mes tyre, më 3 dhjetor, «Treshja» organizoi takime të veçanta me palët në Beograd dhe në Prishtinë. Më 4 dhjetor kjo «Treshje» i dorëzoi raportin e vet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, përmes të cilit e njoftonin për përfundimin e tyre se “përkundër bisedimeve të ngjeshura, palët nuk arritën deri te një marrëveshje për statusin përfundimtar të Kosovës dhe se asnjëra palë nuk ishte e gatshme të bënte lëshime rreth çështjeve thelbësore.”⁴

Konstatimi i «Treshes» se misioni i saj kishte dështuar e solli Këshillin e Sigurimit në pikën e njëjtë ku ishte pas dorëzimit të propozimeve të Martti Ahtisaari-t: në pamundësi që të miratonte një rezolutë që do të kërkonte aplikimin e Planit të Ahtisaari-t.

Në këtë kontekst më duket e rëndësishme të theksoj se të gjitha informacionet flisnin se shpallja e pavarësisë nga institu-

¹ Pa aty, Kaptina XIII, paragrafi 33 i raportit

² Po aty,

³ Pa aty, Kaptina XIII, paragrafi 34 i raportit

⁴ Nations Unis, Conseil de sécurité, Doc. S/2007/723

cionet e reja të Kosovës do të jetë një akt i pashmangshëm siç ishte i pashmangshëm edhe kundërshtimi i Serbisë dhe i Rusisë. Megjithatë, përpjekjet diplomatike nuk u ndalën. Përkundrazi, “ato u intensifikuan që të shmangej çfarëdo provokimi që do të rriste tensionet në regjion dhe t’u pamundësohej Serbisë dhe Rusisë që ta pengonin rrjedhën e skenarit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.”¹

Në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, fituese doli Partia Demokratike e Kosovës, e udhëhequr nga Hashim Thaçi².

Në përputhje me rezultatin e këtyre zgjedhjeve, më 4 dhe 9 janar 2008 u formua Kuvendi i ri Kosovës dhe u zgjodhën: Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi³, Kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi. Ngritja e institucioneve të reja të Kosovës shënon fundin e institucioneve që kishin status të përkohshëm.

Publikimi i Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së më 3 janar 2008 dhe fillimi i krijimit të institucioneve të reja të Kosovës, më 4 janar 2008, ndikuan që autoritetet serbe të bëjnë përpjekjet e fundit që të pengojnë shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Kështu, më 4 janar 2008, pra, në të njëjtën ditë kur u mblodh Kuvendi i Kosovës për të krijuar institucionet e qëndrueshme të Kosovës, Përfaqësuesi i Përhershëm i Serbisë në OKB, Pavle Jevremović-i, i dërgoi një letër⁴ Kryetarit të Këshillit të Sigurimit.

¹ RTL.be, «Kosovo : l'UE veut négocier les conditions de la proclamation d'indépendance» (Kosovë : BE dëshiron t'i negociojë kushtet e shpalljes së pavarësisë), 19 Novembre 2007

<http://www.rtl.be/info/monde/europe/59875/kosovo-l-ue-veut-negocier-les-conditions-de-la-proclamation-d-independance>

² Ish-drejtuksi politik i UÇK-së dhe udhëheqës i delegacionit shqiptar në Konferencën e Rambouillet-së, Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës që nga themelimi i saj.

³ Historian, njëri nga gjashtë udhëheqësit politikë të UÇK-së, zëdhënësi i parë publik i saj, anëtar i delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambouillet-së, anëtar i Grupit Politik dhe Strategjik gjatë negociatave të Vjenës dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Demokratike të Kosovës që nga themelimi i saj.

⁴ Nations Unies, Conseil de Sécurité, S/2008/7, 7 janvier 2008
Lettre datée du 4 janvier 2008, adressée au Président du Conseil de sécurité par le Représentant permanent de la Serbie auprès de l'Organisation des Nations Unies

www.un.org/Docs/journal/asp/ws.asp?m=S/2008/7

Përmes kësaj letre, Përfaqësuesi serb dha vërejtjet e veta lidhur me raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të datës 3 janar 2008

Në këtë letër, Pavle Jevremović-i theksonte se “Serbia synonte një autonomi substanciale, e jo vetëm zgjidhje për statusin e Kosovës. Ky propozim, sipas tij, është propozim për pajtim që i bëhet minoritetit shqiptar të Kosovës. Republika e Serbisë nuk do të pranojë asnjë kërkesë për shkëputje nga njëri apo tjetri minoritet prej 27 minoriteteve që janë qytetarë të saj. Propozimi për autonomi substanciale duhet të respektojë Kushtetutën e Republikës së Serbisë, dispozitat e të drejtës ndërkombëtare - Kartën e Kombeve të Bashkuara, Aktin final të Helsinkut, qëndrimin e shprehur në Rezolutën 1244 për statusin e ardhshëm të Kosovës...”¹

Përdorimi i termit minoritet për shqiptarët e Kosovës dhe vënia në të njëjtin nivel të mbi 2 milion shqiptarëve me 27 minoritetet tjera që jetonin në shtetin serb dëshmon se institucionet e “reja” të shtetit serb nuk ishin larguar nga terminologjia e regjimit të vjetër të Milošević-it.

Në përputhje të plotë me frymën e vjetër të trajtimit të «Çështjes së Kosovës», Pavle Jevremović-i kritikoi anëtarët e OKB-së dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut të cilët “në raportet e tyre për Kosovën i trajtojnë serbët e krahinës si një ‘minoritet nacional’ përderisa ata janë populli shumicë në shtetin e Serbisë. Kjo terminologji, përtej asaj se është e pasaktë, dëshmon gjithashtu për mbështetjen e pavarësisë së Kosovës”² theksoi ai.

Përfaqësuesi i përhershëm i Serbisë në OKB kritikoi në veçanti “pohimet që përmbante raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së e që mund të interpretohen si presion në favor të zgjidhjes së shpejtë të pavarësisë së Kosovës.”³ Kritikën e veta, Pavle Jevremović-i, i përqendroi sidomos në paragrafët 8, 33 dhe 34 të raportit të Ban Ki-moon-it dhe tërheqja e shpeshtë e vërejtjes

¹ Po aty, paragrafi 2

² Po aty, paragrafi 11

³ Po aty, paragrafi 6

për rrezikun e destabilizimit të Kosovës dhe të regjionit nëse vonohej procesi i përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Ai u revoltua përse “nuk ishte përmendur asnjëherë rreziku i destabilizimit që mund të rezultojë nga shpallja e pavarësisë së Kosovës.”¹

Me qëllim të sensibilizimit për rrezikun nga shpallja eventuale e pavarësisë së Kosovës, Presidenti i Serbisë, Boris Tadić-i, udhëtoi për New York. Më 16 janar 2008, në seancën e 5821 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Presidenti serb “u tërhoqi vëmendjen të pranishmëve se Karta e Kombeve të Bashkuara garanton parimin e respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve ndërkombëtarisht të njohura dhe nënvizoi se Serbia është njëri prej shteteve ndërkombëtarisht të njohura. Ai kërkoi nga të gjitha shtetet që të shmangin inkurajimin për një vendim në favor të pavarësisë së Kosovës dhe përsëriti se vendi i tij nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e saj. Përkundrazi, ai u zotua se do të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për ta ruajtur integritetin territorial dhe sovranitetin e Serbisë.”²

Megjithatë, Boris Tadić-i sqaroi se ruajtja e integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit përjashton përdorimin e mjeteve të dhunës dhe luftën dhe ky qëllim do të realizohej “përmes mjeteve demokratike dhe instrumenteve juridike e diplomatike.”³

Ngjashëm si në përfundim të Konferencës së Rambouillet-së kur në vend të nënshkrimit të Projekt marrëveshjes së propozuar nga ndërmjetësuesit ndërkombëtarë, serbët dorëzuan një dokument të ri për autonominë e Kosovës në kuadër të Serbisë, në të njëjtën mënyrë edhe Përfaqësuesi i përhershëm i Serbisë në OKB, Pavle Jevremović-i, edhe Presidenti i Serbisë, Boris Tadić-i, shprehën “gatishmërinë e shtetit serb për një autonomi substanciale që respekton Kushtetutën e Serbisë!”

¹ Po aty, paragrafi 6

² Nations Unis, Conseil de sécurité, CS/9227, 16 janvier 2008
<http://www.un.org/News/fr-press/docs/2008/CS9227.doc.htm>

³ Po aty

Në muajin shkurt u bë edhe një përpjekje për të penguar shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Konkretisht, më 12 shkurt 2008, Përfaqësuesi i përhershëm i Serbisë në OKB, Pavle Jevremović-i, i dërgoi një letër¹ Kryetarit të KS të OKB-së, përmes të cilës kërkoi nga Këshilli i Sigurimit që “të mblidhej urgjentisht për të shqyrtuar situatën tejte të rënduar në krahinën serbe të Kosovës dhe Metohisë, ku jemi duke asistuar në aktivitetet e fundit që janë duke bërë institucionet e përkohshme të administratës autonome me qëllim të shpalljes së njëanshme të pavarësisë.”² Ambasadori Pavle Jevremović-i njoftoi gjithashtu se në këtë mbledhje parashihej të merrte pjesë Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić-i.

Në të njëjtën ditë edhe Përfaqësuesi i përhershëm i Federatës ruse në OKB, Vitaly Churkin-i, përmes një letre³ të veçantë, mbështeti kërkesën e Serbisë për një mbledhje urgjente të Këshillit të Sigurimit “për të shqyrtuar rrjedhën e rrezikshme të ngjarjeve në Kosovë (Serbi) ku Institucionet e përkohshme të administratës autonome përgatiten të shpallin njëanshëm pavarësinë.”⁴

Në të njëjtën ditë kur parashihej mbajtja e Mbledhjes së Këshillit të Sigurimit për kërkesën serbe dhe ruse, Qeveria e Serbisë thirri një mbledhje të jashtëzakonshme.

Në mbledhjen e 14 shkurtit 2008, ajo mori vendimin përmes të cilit anulohet çdo akt joligjor dhe çdo veprim i organeve të

¹ Nations Unies, Conseil de Sécurité, S/2008/7, 7 janvier 2008
Lettre datée du 12 février 2008, adressée au Président du Conseil de sécurité par le Représentant permanent de la Serbie auprès de l’Organisation des Nations Unies (Letra e datë 12 shkurt 2008, e Përfaqësuesit të Përhershëm të Serbisë në OKB, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit)
Doc.S/2008/92
<http://www.un.org/fr/peacekeeping/missions/unmik/reports.shtml>

² Po aty

³ Nations Unies, Conseil de Sécurité, S/2008/7, 7 janvier 2008
Lettre datée du 12 février 2008, adressée au Président du Conseil de sécurité par le Représentant permanent de la Fédération de Russie auprès de l’Organisation des Nations Unies ((Letra e datë 12 shkurt 2008, e Përfaqësuesit të Përhershëm të Ruisë në OKB, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit)
Doc.S/2008/93
<http://www.un.org/fr/peacekeeping/missions/unmik/reports.shtml>

⁴ Po aty

përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë që do të mund të cenonte sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën dhe integritetin e saj territorial.

Në pikën e parë¹ të këtij vendimi, Qeveria e Serbisë si masë preventive kundër shpalljes eventuale të pavarësisë “anuloi aktin e shpalljes së njëanshme dhe të paligjshme të pavarësisë së Kosovës, sepse është në kundërshtim me Kushtetutën e Serbisë, me Kartën e OKB-së dhe me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit.”² Gjithashtu, Qeveria e Serbisë e përsëriti kërkesën për një mbledhje të jashtëzakonshme³ të Këshillit të Sigurimit, “në të cilën do të anulohet menjëherë akti i shpalljes së njëanshme dhe jashtëligjore të pavarësisë së Kosovës.”⁴ Në të njëjtën pikë të vendimit u kërkuua nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë “që të parandalojë akte të tilla duke i anuluar dhe duke i shpallur të pavlefshme.”⁵

Në pikën tetë të vendimit të vet, Qeveria e Serbisë kërkoi nga të gjitha shtetet anëtare të OKB-së ta respektojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Serbisë.

Më 14 shkurt 2008, në përgjigje të kërkesës serbe dhe ruse, Këshilli i Sigurimit i OKB-së u mbledh në një seancë private. Për arsye të statusit privat të saj, proces verbalet e kësaj seance nuk janë publikuar. Në faqen zyrtare të internetit të OKB-së, në rubrikën proces-verbalet⁶, publikohet vetëm një komunikatë zyrtare në të cilën thuhet se, “në seancën private 5835, anëtarët e Këshillit të Sigurimit dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë patën shkëmbime mendimesh.”⁷

¹ Nga nëntë pikat që kishte ky vendim.

Shih vendimin në tërësi: Nadlanu, «Poništena nezavisnost» (U anulua pavarësia)

<http://www.nadlanu.com/pocetna/Ponistena-nezavisnost.a-20725.43.html>

² Po aty

³ Pika 7 e vendimit të Qeverisë së Serbisë

⁴ Po aty

⁵ Po aty

⁶ Nations Unis, Conseil de Sécurité, Proces-verbales des séances

<http://www.un.org/fr/sc/meetings/records/2008.shtml>

⁷ Po aty

Në këtë seancë, sipas burimeve të publikuara nga Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë, “Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić-i, u bëri thirrje të gjitha shteteve që t’i japin mbështetje mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë dhe të mos lejojnë shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës.”¹ Krahas kërkesave drejtuar të gjitha shteteve për të “mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë”, Vuk Jeremić-i ia kërkoi që Këshilli i Sigurimit “të dënonte qëllimin e qartë të pushtetit të Prishtinës për ta shpallur në mënyrë të njëanshme, të jashtëligjshme dhe të padrejtë Kosovën të pavarur.”² Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë kërkoi në mënyrë ultimatumit që përmes një vendimi të veçantë “Këshilli i Sigurimit të vërtetojë sovranitetin dhe integritetin e Serbisë, duke përfshirë edhe Kosovën.”³

Edhe në rast të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Vuk Jeremić-i kishte përgjigjen se çka duhej të bëhej. Ai kërkoi nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit Përgjithshëm, Joachim Rucker-i⁴ që të shfrytëzojë të gjitha kompetencat e tij dhe në rast se Kuvendi i krahinës shpallte pavarësinë, ai duhej ta shpallte këtë akt si të pavlefshëm dhe ta shpërbënte Kuvendin e Kosovës.”⁵ Edhe Vitalij Churkin-i kërkoi të njëjtën gjë nga Joachim Rucker-i. Për më tepër, Përfaqësuesi rus deklaroi se “Joachim Rucker-i e kishte për detyrë ta shpallte të pavlefshëm një vendim të tillë.”⁶

¹ Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë, «Hitna vanredna sednica SB UN iza zatvorenih vrata»

(Mbledhje urgjente e KS të OKB-së me dyer të mbyllura)

http://www.mfa.gov.rs/Srpski/Bilteni/Srpski/b150208_s.html#N9

² Po aty

³ Po aty

⁴ Diplomati gjerman që zëvendësoi Søren Jessen-Petersen pasi ai kishte përfunduar mandatin e tij në Kosovë. Joachim Rucker-i e mori funksionin nga 1 shtatori 2006

(<http://www.un.org/apps/news/fr/storyF.asp?NewsID=12788&Cr=&Cr1=#.VA16K7izWQk>)

⁵ Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë, artikulli i cituar, «Hitna vanredna sednica...»

⁶ Po aty

Në të njëjtën mënyrë sikurse Presidenti i Serbisë, Boris Tadić-i, edhe Vuk Jeremić-i deklaroi se “Serbia do të përdorte të gjitha mjetet e mundshme, përveç mjeteve ushtarake, për të mbrojtur kushtetutën, demokracinë dhe integritetin territorial.”¹

Sa i përket kësaj seance të jashtëzakonshme, më duket e rëndësishme të sjell edhe qëndrimet e përfaqësuesve të SHBA-ve² dhe të Britanisë së Madhe³. Ata tërhoqën vëmendjen se “pas asaj që kishte përjetuar Kosova gjatë regjimit dhe qeverisjes së Milošević-it, një gjë ishte e sigurt: Beogradi nuk mund të qeverisë më me Kosovën. Kosova përbën një rast unik dhe Plani i Ahtisaarit për pavarësi të mbikëqyrur është zgjidhja më e mirë që është ofruar.”⁴

Statusi final i një territori dhe qëndrimi restriktiv i Këshillit të Sigurimit

Kërkesat e diplomatëve serbë dhe rusë “për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë” dhe për të “dënuar qëllimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës” u bënë me shpresë se Këshilli i Sigurimit do të vepronte si në rastet e Rhodezisë Jugore⁵, të Republikës turke të Qipros Veriore dhe të Republikës Serbska-s të Bosnjës.

Po ndalem shkurtimisht te këto tri raste sepse hedhin dritë në një aspekt të së drejtës ndërkombëtare: ndihmojnë të ndriçohet praktika restriktive e Këshillit të Sigurimit të OKB-së sa i përket statusit final të një territori të caktuar.

Po sjell rastin e Rhodezisë së Jugut, e cila më 11 nëntor 1965 shpalli pavarësinë e vet nga Britania e Madhe. Të nesërmen e këtij

¹ Po aty

² Alejandro Daniel Wolff, i ciligjatë periudhës 2005-2010 ushtroi funksionin e Përfaqësuesit të përhershëm të SHBA-ve në OKB dhe të zëvendësit të tij

³ Robert John Sawers, që ishte Përfaqësuesi i përhershëm i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe në OKB në periudhën 2007-2009

⁴ Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë, artikulli i cituar, «Hitna vanredna sednica...»

⁵ Tani pjesë e Zimbabuesë

akti, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, përmes rezolutës 216, të 12 nëntorit 1965, e “dënoi deklaratën e njëanshme të shpalljes së pavarësisë nga një minoritet racist në Rhodëzinë e Jugut”¹ dhe “kërkoi nga të gjitha shtetet që të mos e njohin regjimin minoritar racist dhe të paligjshëm të Rhodëzisë së Jugut.”² Të njëjtin qëndrim e përsëriti edhe në rezolutën 217, të 20 nëntorit 1965, përmes të cilës “dënohet uzurpimi i pushtetit nga një minoritet i Rhodëzisë së Jugut dhe deklarata e pavarësisë, e proklamuar nga ky minoritet, u kualifikua si akt pa asnjë vlerë ligjore.”³

Ngjashëm u veprua edhe në rastin e Republikës turke të Qipros Veriore, autoritetet e të cilës, më 15 nëntor 1983, shpallën pavarësinë e tyre nga pjesa tjetër e Qipros. Tri ditë më vonë, më 18 nëntor, Këshilli i Sigurimit i OKB-së solli Rezolutën 541 që lidhej me këtë akt.

Në këtë rezolutë “u shpreh keqardhje për shpalljen e ndarjes së një pjese të territorit të Republikës së Qipros, u konsiderua si akt i pavlefshëm dhe u kërkua anulimi i tij.”⁴ Këshilli i Sigurimit nuk u kufizua me kaq. Ai “kërkoi nga të gjitha shtetet që ta respektonin sovranitetin, pavarësinë, integritetin territorial dhe mosinkuadrin e Republikës së Qipros”⁵ si dhe “të mos njohin shtet tjetër qipriot, pos Republikës së Qipros.”⁶

Meqenëse ndarja e ishullit të Qipros vazhdonte të konsiderohej një problem i pazgjidhur, më 29 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara solli rezolutën 1251 përmes së cilës rikonfirmoi kërkesën e saj të shprehur në rezolutat e mëparshme për respektimin e sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Qipros. “Këshilli i Sigurimit përsëriti qëndrimin e vet se zgjidhja e problemit të Qipros duhet të bazohet

¹ Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 216, 12 nëntor 1965, paragrafi 1

² Po aty, paragrafi 2

³ Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 217, 20 nëntor 1965, paragrafi 3

⁴ Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 541, 18 nëntor 1983, paragrafi 2

⁵ Po aty, paragrafi 6

⁶ Po aty, paragrafi 7

në Qipron si një shtet sovran, me personalitet ndërkombëtar dhe shtetësi unike, pavarësi dhe integritet territorial të garantuar dhe dy komunitete politikisht të barabartë... Rregullimi i kësaj çështje duhet të përjashtojë bashkimin e tërësishëm apo të pjesshëm me një vend tjetër apo çfarëdo forme të ndarjes apo shpërndarjes.”¹

Edhe në vitin 2004, në kontekstin e përpjekjeve të Republikës së Qipros për t’u integruar në strukturat e Bashkimit Evropian, Kombet e Bashkuara propozuan «Planin Annan».² Ky plan kishte për qëllim të bashkonte dy shtetet e ndara të Qipros në një shtet të unifikuar mbi bazat e federalizmit³.

Edhe në rastin e shpalljes së pavarësisë së Republika Serbska-s, Këshilli i Sigurimit reagoi ashpër. Në rezolutën 787 të datës 16 nëntor 1992 fillimisht u shpreh preokupimi i thellë për shkak të kërcënimit që bëhej kundër integritetit territorial të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe u theksua se Bosnja dhe Hercegovina, si shtet anëtar i OKB-së, i gëzon të drejtat e parapara me Kartën e OKB-së⁴.

Këshilli i sigurimit “riafirmoi me forcë thirrjen e vet që të respektohet me përpikëri integriteti territorial i Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ripohoi se asnjë entitet i shpallur në mënyrë të njëanshme dhe asnjë zgjidhje e imponuar kundër integritetit të lartpërmendur nuk do të pranohet.”⁵

¹ Kombete Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 1251, 29 qershor 1999, paragrafi 11

² Atyre që u intereson, «Planin Annan» mund ta gjejnë edhe në këtë adresë interneti:

Basis for a comprehensive settlement of the Cyprus problem

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:oyA8FvWWav8J:www.kypros.org/proposal.pdf+&cd=2&hl=fr&ct=clnk&gl=ch>

³ «Planin Annan» u hodh në referendum më 24 prill 2004. Plani u pranua nga qipriotët turq (65 %) por u refuzua nga qipriotët grekë (76%) dhe si rezultat i këtij votimi plani dështoi.

Shih: Le Monde diplomatique, Niels Kadritzke, «Occasion perdue pour les Chypriotes» (Rast i humbur për qipriotët), maj 2004,

<http://www.monde-diplomatique.fr/2004/05/KADRITZKE/11170>

⁴ Kombet e Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, Rezoluta 787, 16 nëntor 1992 (S/RES/787)

⁵ Po aty, paragrafi 3

Siç shihet, në të tri rastet e lartpërmendura, Këshilli i Sigurimit kishte qëndrim të qartë kundër shpalljeve të pavarësive dhe kërkonte ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të shteteve në fjalë. Në rastin e Kosovës, përkundër përpjekjeve serbe dhe ruse, Këshilli i Sigurimit nuk mori asnjë qëndrim lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës e që do të konfirmonte sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën. Përkundrazi, që nga dorëzimi i Raportit të Martti Ahtisaari-t, i cili, në emër të Kombeve të Bashkuara, udhëhoqi negociatat mes Serbisë dhe Kosovës, në Këshillin e Sigurimit dominonte mbështetja për përfundimet e këtij raporti se opsioni i vetëm i qëndrueshëm për Kosovën është pavarësia e saj. Gjithashtu hidhej poshtë përpjekja për ta paraqitur pavarësinë e Kosovës si një precedent që do të shkaktonte dëme të mëdha në ruajtjen e sigurisë në botë! Shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk do të përbënte asnjë precedent ndërkombëtar, sepse kemi të bëjmë me një rast që nuk mund të shkëputet nga konteksti historik. Ky kontekst historik shtron domosdoshmërinë që përcaktimi i statusit final të Kosovës të shihet në kuadër të procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave, në kuadër të të cilit shteti i pavarur i Kosovës do të shënonte lindjen e shtetit të shtatë të krijuar nga shpërbërja e dhunshme e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë¹.

Nga të gjitha mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së kushtuar përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, del në shesh fakti se në mesin e anëtarëve të tij kishte divergjenca në çështje të caktuara. Vetëm në një çështje kishte konsensus të përgjithshëm: status quo-ja përbënte rrezik për stabilitetin e Kosovës dhe të rajonit.

¹ Emrin që ky shtet e ka mbajtur gjatë periudhës 1945-1992

Shpallja e pavarësisë së Kosovës

Përmes një letre të përbashkët, më 17 shkurt 2008, Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi kërkuan nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, që të thërriste një mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendit.

Në seancën e pasdites të datës 17 shkurt, në prani¹ të 109 deputetëve nga 120 deputetët që kishte Kuvendi i Kosovës, kryeministri Thaçi lexoi «Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës»².



Kryeministri Thaçi duke lexuar Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës³

Në hyrje të «Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës » u theksua në mënyrë të veçantë se “Kosova është një rast special që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është precedent

¹ Dhjetë deputetët e minoritetit serb nuk ishin të pranishëm në këtë seancë

² «Deklarata e Pavarësisë së Kosovës»

http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:ahLoSXoztJIJ:www.kuvendikosoves.org/common/docs/Dek_Pav_sh.pdf+&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch

³ Shpallja - Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

http://www.youtube.com/watch?v=aSdout_wP9s

për cilëndo situatë tjetër”¹. Vendimi që qartësonte statusin politik të Kosovës ishte në funksion të sqarimit të popullit të Kosovës për të ardhmen e tij. Për të mos veçuar pjesë nga kjo deklaratë, të cilat mund të shihen si të shkëputura nga konteksti, po sjell për lexuesin 12 paragrafët e kësaj deklaratë.

1. *Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.*

2. *Ne e shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe do të krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.*

3. *Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do t'i zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*

4. *Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundshme një kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definoohen me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.*

¹ Hyrjen dhe tërësinë e Deklaratës lexuesi mund ta lexojë në faqen e internetit: http://www.mfa-ks.net/repository/docs/Dek_Pav_sh.pdf

5. Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi European. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë.

6. Për arsye të kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen europiane. Për këtë arsye, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin European sapo që të jetë e mundur dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim europian dhe euroatlantik.

7. Ne i shprehim mirënjohje Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe ndërtimin e institucioneve të demokracisë. Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara gjersa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

8. Me pavarësinë vie detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t'i përmbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, akteve tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtarë ashtu siç janë paraparë në

Aneksin VIII të Planit të Ahtisaarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të të gjithë fqinjve tanë. Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

9. *Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.*

10. *Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Europës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Europën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avansuar të ardhmen tonë të përbashkët europiane.*

11. *Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përprjekjet tona për t'i kontribuar marrëdhënieve të fqinjësisë dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.*

12. *Ne, nëpërmjet kësaj, afërmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërish e*

obliguar të plotësojë dispozitatat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.¹



Kryeministri, Kryetari i Kuvendit dhe Presidenti i Kosovës nënshkruajnë Deklaratën e pavarësisë

Shpallja e pavarësisë së Kosovës u shoqërua me një entuziazëm të jashtëzakonshëm të masave të gjëra të popullit shqiptar. Manifestimet anekënd Kosovës kaluan pa asnjë incident. Këtë gjë e theksoi Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-moon-i. Në seancën e 18 shkurtit të Këshillit të Sigurimit, duke folur për çështjen e sigurisë në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë, ai deklaroi se në tërë Kosovën, me dhjetëra mijë persona e kremtuan aktin e shpalljes së pavarësisë në mënyrë paqësore².

¹ Po aty

² Nations Unies, Conseil de sécurité, S/PV.5839, f.2-3



Prishtinë, kremtimi i shpalljes së pavarësisë

Të nesërmen, më 18 shkurt, në pjesën e banuar me serbë “në veri të Mitrovicës, 9000 persona manifestuan në mënyrë paqësore kundër deklaratës së pavarësisë. Në Kosovë mbretëron qetësia.”¹ Ban Ki-moon-i përmendi vetëm dy raste shqetësuese: hedhja e granatave që kishte shkatuar vetëm dëme materiale². Përndryshe, “Qetësia mbretëronte në tërë Kosovën”- deklaroi Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së gjatë kësaj seance të Këshillit të Sigurimit.

Një ditë pas vendimit të Kuvendit të Kosovës, më 18 shkurt, filluan njohjet e pavarësisë së Kosovës. Mbretëria e Bashkuar, Franca, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia, Afganistani dhe Shqipëria ishin shtetet e para që njoftuan autoritetet e Kosovës për njohjen e pavarësisë së shtetit më të ri të Kosovës.

Shih Proces-verbalet e seancës 5839 të 18 shkurtit 2008
<http://www.un.org/fr/sc/meetings/records/2008.shtml>

¹ Po aty

² U dëmtuan disa vetura të UNMIK-t

Reagimet e Serbisë për vendimin e Kuvendit të Kosovës

Menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës mediat serbe njoftuan se Kryetari i Serbisë, Boris Tadić-i, Kryeministri serb, Vojislav Koštunica dhe shefi i Partisë Radikale serbe, Tomislav Nikolić-i¹, ishin takuar dhe ishin marrë vesh që të mbajnë një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Serbisë lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës².

Në këtë mbledhje të jashtëzakonshme, Kuvendi i Serbisë duhej të shqyrtonte vendimin e Qeverisë së Serbisë, të datës 14 shkurt, “për veprimet jashtëligjore të organeve të përkohshme të Prishtinës me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.”³

Gjatë këtij takimi, personalitetet kyçe të institucioneve të Serbisë u morën vesh që qeveria dhe partitë parlamentare të organizojnë një protestë në Beograd me moton : «Kosova është Serbi»⁴.

Krahas këtyre marrëveshjeve, secili nga bartësit e institucioneve të shtetit serb u prononcua lidhur me realitetin e ri të krijuar në Kosovë. Kështu, në deklaratën e vet, presidenti serb, Boris Tadić-i, theksoi se “Serbia kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe se do të reagojë me mjete paqësore, diplomatike dhe juridike me qëllim të anulohet ky vendim i institucioneve të përkohshme të Kosovës. Serbia do të kërkojë nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë që ta anulojnë menjëherë këtë vendim që është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.”⁵

Shumë më ashpër u prononcua Kryeministri i Serbisë, Vojislav Koštunica. Ai “i akuzoi Presidentin e SHBA-ve, George

¹ Partisë që kishte fituar zgjedhjet e 21 janarit 2007

² B92, BETA, TANJUG, «Srbija poništava nezavisnost» (Serbija anulon pavarësinë)
http://www6.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2008&mm=02&dd=17&nav_category=640&nav_id=285213

³ Po aty

⁴ Po aty

⁵ Po aty

W.Bush dhe evropianët që e ndoqën diktatin amerikan për krijimin e shtetit të rrejtshëm të Kosovës.”¹

Në fjalimin e tij historik kundër SHBA-ve dhe vendeve të BE-së, fjalim që u hoq² nga faqet e internetit, Vojislav Koštunica nuk e shihte krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës si vullnet politik të popullit shqiptar, por, si një “shtet të rrejtshëm” që u krijua si rezultat i komplotit ndërkombëtar kundër Serbisë. Për kryeministrin serb, shpallja e pavarësisë së Kosovës nxori në shesh “të vërtetën pse Serbia u rrënuar egërsisht nga bombardimet e NATO-s: krijimi i një shteti të rrejtshëm për interesat ushtarake të NATO-s. Në themelet e shtetit të rrejtshëm të Kosovës qëndrojnë bombat...”³ Shkurt, për kryeministrin serb, “fajtorë kryesorë për këtë gjendje janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet evropiane që ndoqën diktatin amerikan”. “SHBA-të dhe këto shtete të Evropës do të shkruhen me shkronja të zeza në historinë e Serbisë si dhe në çdo histori të së drejtës ndërkombëtare... Nëse SHBA-të kanë arritur ta poshtërojnë dhe ta detyrojnë BE-në ta ulë kokën dhe t’i shkelë parimet mbi të cilat mbështetej, Serbia nuk do të nënshtrohet”⁴ - kërcënoi Vojislav Koštunica.

Pas fjalimit të Koštunica-s, “Qeveria e Serbisë urdhëroi ambasadorin e saj të kthehet urgjentisht nga Washingtoni në Beograd. Kjo masë do të vlejë edhe për shtetet tjera që do ta njohin pavarësinë e njëanshme të Kosovës.”⁵

Pas fjalimit agresiv të Vojislav Koštunica-s “rreth 2000 serbë protestuan para ambasadës amerikane në Beograd. Protestuesit gjuanin me gurë dhe fishekzjarre në drejtim të ndërtesës së ambasadës, duke thyer xhamat e dritareve. Policia speciale ndërhyri dhe i shpërndau protestuesit.”⁶

¹ Po aty

² Po aty

³ Po aty

⁴ Po aty

⁵ Po aty

⁶ «Skupstina Srbije odlucno ponistila odluku o nezavisnosti Kosova i Metohije - Moleban za spassrpskog naroda - Protesti sirom Srbije» (Kuvendi i Serbisë e anuloi vendimin për pavarësi të Kosovës dhe Metohisë- Lutja për popullin serb - Protesta anë e mbanë Serbisë)

Më 18 shkurt, Kuvendi i Serbisë u mbledh që të shqyrtojë vendimin e qeverisë serbe për anulimin e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Nga 234 deputetët e pranishëm, 225 prej tyre votuan për miratimin e këtij vendimi¹. Duke vepruar në këtë mënyrë, Kuvendi i Serbisë shpresonte të zhbënte “të gjitha aktet dhe vendimet e organeve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, që shpallën pavarësinë”, sepse, sipas kuvendit serb “veprimet e tilla e rrënonin sovraniteti dhe tërësia territoriale të sanksionuara me Kushtetutën e Serbisë, Kartën e OKB-së, Rezolutën 1244 dhe rezolutat tjera të Këshillit të Sigurimit...”²

Ky vendim i Kuvendit të Serbisë u miratua në ditën kur Këshilli i Sigurimit të OKB-së duhej të mbledhej në një seancë kushtuar shpalljes së pavarësisë së Kosovës, që ishte ftuar nga Përfaqësuesit permanentë të Serbisë dhe të Federatës Ruse. Edhe pse bëhet një shkëputje e vogël kronologjike, këtë aspekt, që hyn në kuadër të reagimeve diplomatike, do ta trajtoj më poshtë. Tani po ndalem në dinamikën e reagimeve në Republikën e Serbisë.

Pos demonstratës së parë që u zhvillua më 17 shkurt para Ambasadës së SHBA-ve, demonstrata të përmasave më të vogla pati edhe në disa qytete tjera të Serbisë dhe në pjesën veriore të Mitrovicës, në Kosovë. Por, demonstrata e 21 shkurtit, që u organizua nga institucionet shtetërore dhe partitë parlamentare të Serbisë mobilizuan një masë të madhe protestuesish³.

http://www.kosovo.net/news/archive/2008/February_19/files/1203399296_681y2ffyc8_msg-14323-1.txt

¹ Po aty

² Po aty

³ Numri i pjesëmarrësve ndryshon nga një burim informativ te tjetri. Flitet për shifra që shkojnë nga disa dhjetëra mijë pjesëmarrës deri te disa qindra mijë.



Manifestuesit me fotografinë e Radovan Karadžić-it¹

Në këtë manifestim, ku dominonin parullat antiamerikane dhe antiperëndimore, fjalën e morën Kryeministri i Serbisë, Vojislav Koštunica, shefi i opozitës serbe, Tomislav Nikolić-i, Kryeministri i Republikës Serbska të Bosnjës, Milorad Dodik-u, personalitete publike, aktorë, sportistë të sporteve të ndryshme...²

Mobilizimi i figurave publike me origjinë serbe, sidomos i atyre që ishin ndërkombëtarisht të njohur, kishte për qëllim që të dëshmonte se “populli serb, i cili është popull hyjnor, ka edhe njerëzit e vet të mëdhenj në sistemin shkencor të botës.”³

Pos hyjnizimit të popullit serb, në fjalimin e tij, Emir Kosturica⁴ glorifikoi vlerat e popullit serb në krahasim me vlerat e popujve tjerë, madje i shpalli si “vlera që qëndrojnë në themelet e

¹ Udhëheqës i krimeve në Bosnje dhe, në atë kohë, i kërkuar nga Gjykata e Hagës. U arrestua më 21 korrik 2008 dhe pret të gjykohet për gjenocidin në Bosnje.

² Politika, «Reč je data, dok živimo - Kosovo je Srbija» (Është dhënë fjala, deri sa të jemi gjallë - Kosova do të jetë Serbi, 21.02.2008 <http://www.politika.rs/rubrike/Politika/RECH-JE-DATA-DOK-ZIVIMO-KOSOVO-JE-SRBIJA.lt.html>

³ Po aty, (fjala e Emir Kusturica-s)

⁴ Regjisor filmi, Laurat i dyfishtë i «Palmës së Artë»

civilizimit” dhe akuzoi serbët që “mohojnë një gjë të tillë, si njerëz të shitur për pak para.”¹

Ky mobilizim shkoi deri në atë shkallë sa ata të cilët nuk mundën të ishin pjesëmarrës në këtë manifestim dërguan telegrame solidariteti që “Kosova të mbetet përjetësisht nën sovranitetin e Serbisë.”² Kishte edhe personalitete që përmes video konferencave dërguan mbështetjen e tyre, siç ishte rasti me tenistin e njohur në përmasa botërore, Novak Djoković-in³. Nuk mungoi në këtë tubim as basketbollisti serb Dejan Bodiroga, për të cilin shtypi serb shkroi se kishte refuzuar të luajë në NBA të SHBA-ve dhe kishte preferuar ligat evropiane. Ai deklaroi me mburrje: “Kam luajtur shumë ndeshje për vendin tim, por, kjo ndeshje është më e rëndësishme për Serbinë. Kjo ndeshje nuk ka përfunduar, kjo ndeshje do të luhet deri në fitoren përfundimtare të Serbisë sepse Kosova është Serbi. Unë dhe të gjithë ne, si të krishterë ortodoksë dhe serbë, e kemi për detyrim të luftojmë për atdheun tonë dhe të mburremi me të. Kosova ka qenë, është dhe do të mbetet Serbi.”⁴ - u mundua t'i siguronte të pranishmit ky sportist, që politikën e ngatërronte me lojën e basketbollit!

Pas tubimit protestues, “Vojislav Koštunica, Tomislav Nikolić-i, Princi i Serbisë, Aleksandar II Karadžorčević-i dhe shumë manifestues tjerë u tubuan në sheshin e Tempullit Sveti Sava në Beograd për të asistuar në lutjen e organizuar nga Kisha ortodokse serbe «për shpëtimin e popullit serb»”⁵

Gjatë kësaj lutje u theksua: “Kisha shumë herë ka lëshuar komunikata për të pohuar se Kosova dhe Metohija kanë qenë dhe duhet të mbeten pjesë përbërëse e Serbisë. Çdo zgjidhje tjetër do të përbënte shkelje të drejtësisë së Zotit dhe të drejtësisë së njerëzve,

¹ Politika, artikulli i cituar «Reç je data, dok živimo - Kosovo je Srbija», (Fjala e Emir Kusturica-s)

² Politika, artikulli i cituar «Reç je data, dok živimo - Kosovo je Srbija»


³ Novak Djokovic- Kosovo je srce Srbije (Kosova është zemra e Serbisë)
http://www.youtube.com/watch?v=iKSrOg_pcvU

⁴ Po aty (fjala e Dejan Bodiroga-s)

⁵ http://www.kosovo.net/news/archive/2008/February_19/files/1203399296_681y2ffyc8_msg-14323-1.txt

gjithashtu do të ishte shprehje e dhunës me pasoja afatgjata për Ballkanin dhe për Evropën në tërësi.”¹

Krahas diskurseve agresive kundër SHBA-ve dhe shteteve që kishin njohur apo kishin deklaruar se do të njihnin pavarësinë e Kosovës, manifestuesit e 21 shkurtit sulmuan disa përfaqësi diplomatike. Kështu, Ambasadës së Turqisë, iu thyen xhamat e dritareve, iu hoq flamuri turk dhe u vendos flamuri i Serbisë²; Ambasadës së Bosnjës dhe Hercegovinës iu thye dera e hyrjes; Ambasadës së Kroacisë iu shkatërruan dritaret ndërsa Ambasadës së SHBA-ve iu vu zjarri³.



Ambasada e SHBA-ve pas sulmit

¹ Po aty

² Politika, artikulli i cituar «Reç je data, dok živimo - Kosovo je Srbija»

³ Shih videon: Paljenje Američke Ambasade u Beogradu (Djegia e Ambasadës Amerikane në Beograd)

<http://www.youtube.com/watch?v=YcNCLyhyEFs>



Beograd, McDonald-it i vihet zjarri

Përveç përfaqësive diplomatike, manifestuesit sulmuan edhe përfaqësitë e ndërmarrjeve të huaja, bankave, McDonald-in etj...

Reagimet diplomatike të Serbisë

Krahas dhunës së shprehur gjatë protestës së organizuar nga institucionet shtetërore dhe partitë¹ parlamentare, Serbia u angazhua edhe në planin diplomatik.

Në të njëjtën mënyrë siç u kërkua mbajtja e seancës së 14 shkurtit 2008, me shpresë se Këshilli i Sigurimit do ta dënonte qëllimin e Kosovës për shpallje të pavarësisë, Përfaqësuesi i përhershëm i Serbisë në OKB, Pavle Jevremović-i, dhe Përfaqësuesi i përhershëm i Federatës Ruse në OKB, Vitaly Churkin-i, më 17 shkurt, kërkuan që të mbahet një mbledhje urgjente, në të cilën duhej të shqyrtohej shpallja e pavarësisë së Kosovës².

¹ Përveç Partisë Liberale Demokratike të Serbisë që bojkotoi këto manifestime.

² Shih: Letter dated 17 February 2008 from the Permanent Representative of Serbia to the United Nations addressed to the President of the Security Council United Nations Security Council, Doc.S/2008/103

Në seancën¹ e 18 shkurtit 2008, ku ishte i pranishëm edhe Presidenti i Serbisë, Boris Tadić-i, Këshilli i Sigurimit i OKB-së shtroi në rend të ditës kërkesat e përfaqësuesve serbë dhe rusë.

Njëllëj siç pati deklaruar Ministri serb i Punëve të Jashtme, Vuk Jeremić-i, në seancën e 14 shkurtit 2008, edhe presidenti serb, Boris Tadić-i, e cilësoi pavarësinë e Kosovës si “akt të paligjshëm dhe shkelje flagrante të rezolutës 1244 dhe parimeve të sanksionuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Sipas fjalëve të përfaqësuesve serbë, “kjo rezolutë dhe e drejta ndërkombëtare duhej të garantonin sovranitetin dhe integritetin e Serbisë.”²

Por, nga seanca e 14 shkurtit 2008 te ajo e 18 shkurtit 2008, edhe pse kishin kaluar vetëm katër ditë, realiteti kishte ndryshuar rrënjësisht: Kosova kishte shpallur pavarësinë e vet dhe kjo pavarësi, që në ditën e parë, ishte njohur nga disa shtete³.

Përderisa Jeremić-i ngulte këmbë që të dënohej qëllimi i shpalljes së pavarësisë, si masë parandaluese, Tadić-i kërkonte nga Këshilli i Sigurimit që të anulonte shpalljen e pavarësisë së Kosovës; përderisa Jeremić-i kërkonte nga të gjitha shtetet që t'i jepnin mbështetje mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të shtetit të Serbisë, Boris Tadić-i kërkonte nga shtetet që e

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:KenTm6HXkCkJ:www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%257B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%257D/kos%2520S%25202008%2520103.pdf+&cd=3&hl=fr&ct=clnk&gl=ch>

dhe

Letter dated 17 February 2008 from the Permanent Representative of the Russian Federation to the United Nations addressed to the President of the Security Council

United Nations Security Council, S/2008/104

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:tvOWCly7wNMJ:www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%257B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%257D/Kos%2520S%25202008%2520104.pdf+&cd=4&hl=fr&ct=clnk&gl=ch>

¹ Shih Proces-verbalet e seancës 5839 të 18 shkurtit 2008

<http://www.un.org/fr/sc/meetings/records/2008.shtml>

² Po aty

³ Shpallja u bë ditën e djelë, më 17 shkurt 2008. Të nesërmen, më 18 shkurt, pavarësinë e Kosovës e njohën: Mbretëria e Bashkuar, Franca, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia, Afganistani dhe Shqipëria.

kishin njohur Kosovën, si shtet të pavarur dhe sovran, t'i anulonin vendimet e tyre "jomiqësore ndaj Serbisë"¹

Krahas këmbënguljes se gjoja "rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara e konfirmonin sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Serbisë, duke përfshirë edhe Kosovën dhe Metohinë" Tadić-i u "rikujtoi" anëtarëve të Këshillit të Sigurimit "se Serbia ishte një nga shtetet themeluese të OKB-së."²

Përmes kësaj mënyre veprimi, presidenti serb përpiqej të përvetësonte faktin se Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë kishte qenë një nga shtetet themeluese të OKB-së, ndërsa Serbia kishte qenë vetëm njëra nga elementet përbërëse të kësaj federate.

Për ata lexues që nuk janë të informuar po sjell të dhënat se Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë përbëhej nga tetë njësi federative: gjashtë republika (Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) dhe dy krahina autonome (Kosova dhe Vojvodina).

Tetë njësi që përbënin këtë federatë kishin territorin e vet, administratën e vet që vetëqeverisej, organet legjislativë, ekzekutive dhe të drejtësisë, kishin kushtetutat e veta...

Pas procesit të shpërbërjes së kësaj federate, shpërbërje me pasojë të mëdha në njerëz dhe shkatërrime materiale, u krijuan shtatë shtete të pavarura. Vetëm Vojvodina mbeti nën thundrën e Serbisë!

Boris Tadić-i mundohej ta linte në heshtje faktin se nga shpërbërja e dhunshme e asaj federate, që kishte qenë njëra nga shtetet themeluese të OKB-së, ishin krijuar gjashtë shtete tjera të pavarura para se Kosova ta shpallte pavarësinë e vet. Duke fshehur këtë fakt, presidenti serb, përpiqej ta paraqiste rastin e Kosovës si "precedent që dëmton, në mënyrë të pariparueshme, rendin botëror."³

¹ Nations Unies, Conseil de sécurité, S/PV.5839
Shih Proces-verbalet e seancës 5839 të 18 shkurtit 2008, f.24
<http://www.un.org/fr/sc/meetings/records/2008.shtml>

² Po aty, f. 4

³ Po aty, f. 5

Ky qëndrim i Boris Tadić-it u mbështet vetëm nga përfaqësuesi rus, Vitali Churkin-i¹, dhe nga përfaqësuesi i Viet Nam-it, Le Luang Minh². Madje edhe përfaqësuesi i Kinës³, Wang Guangya, dhe ai i Indonezisë, Mohammad Marty Muliana Natalagawa, të cilët shprehnin keqardhje pse nuk ishin bërë ende përpjekje për të gjetur një zgjidhje përmes negociatave, çështjen e statusit final të Kosovës e shihnin si “rast me karakter të veçantë”⁴ dhe “të pandashëm nga konteksti i shpërbërjes së ish Republikës Federale të Jugosllavisë.”⁵

Trajtimi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës si një precedent u hodh poshtë edhe nga përfaqësues të shteteve tjera anëtarë të Këshillit të Sigurimit. Kështu, përfaqësuesi i Belgjikës, Johan Verbeke-u, tërhoqi vërejtjen se “askush nuk mund ta injorojë faktin se pavarësia e Kosovës lidhet me kontekstin historik të shpërbërjes së Jugosllavisë, që rezultoi me krijimin e shteteve të reja të pavarura. Pavarësia e Kosovës duhet të shihet vetëm në kuadër të këtij procesi dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet si precedent.”⁶ Ndërsa, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, John Sawers, vuri në dukje se Qeveria e vendi i tij u bazua në “rrethanat unike që e përshkuan shpërbërjen e dhunshme të Jugosllavisë dhe në administrimin e pashembullt të Kosovës nga ana e OKB-së, dhe në bazë të këtyre rrethanave Qeveria britanike vlerësoi se Kosova është një rast *sui generis*, që nuk mund të krijojë asnjë precedent.”⁷ Ai gjithashtu deklaroi se “rezoluta 1244 nuk vinte asnjë kufi sa i përkiste zgjidhjes së çështjes së statusit dhe se paragrafi 11 pika (a) e kësaj rezolute theksonte qartazi se autonomia substanciale, të cilën Kosova duhej ta gëzonte në kuadër të Republikës Federale të Jugosllavisë, ishte një rregullim i përkohshëm derisa të gjendej një zgjidhje përfundimtare.”⁸

¹ Po aty, f. 7

² Po aty, f. 15

³ Po aty, f. 8

⁴ Po aty, f. 8

⁵ Po aty, f. 11

⁶ Po aty, f.9

⁷ Po aty, f.14

⁸ Po aty, f.13

E njëjta pikëpamje u mbrojt edhe nga Ambasadori amerikan në OKB, Zalmay Khalilzad. Ai deklaroi se e kuptonte frikën që shprehin disa se mos pavarësia e Kosovës do të shërbente si precedent për pjesë të tjera në botë. Por- vazhdoi ai- “Është realitet se Kosova përbën një rast të veçantë, i cili është trajtuar si i tillë nga OKB-ja që nga viti 1999. Siç e kemi përsëritur shumë shpesh, shpartallimi i dhunshëm dhe jokonsensual i Jugosllavisë, politika e dhunës dhe spastrimi etnik i aplikuar nga Milošević-i, të cilat e shtynë komunitetin ndërkombëtar të veprojë, miratimi i rezolutës 1244 (1999) nga Këshilli i Sigurimit, në bazë të së cilës Serbia nuk e ushtronte më autoritetin normal qeverisës, dhe atë prej kohësh, dhe procesi politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, që u bë nën mbikëqyrjen e OKB-së, janë po aq faktorë domethënës që e veçojnë Kosovën nga konfliktet dhe situatat tjera. Të gjitha këto bëjnë që rasti i Kosovës të mos konsiderohet precedent për regjionet tjera. Njohja e pavarësisë së Kosovës nga shteti im është bazuar në situatën e veçantë që e karakterizon Kosovën tani. Ne asnjëherë nuk e kemi parë, nuk e shohim dhe nuk do ta shohim shembullin e Kosovës si një precedent për konfliktet tjera”¹ - tha, ndër të tjera, ambasadori amerikan.

Edhe për ambasadorin kroat, Nevel Jurica-n, “vendimi i Parlamentit të Kosovës për të shpallur pavarësinë e Kosovës nuk duhet të konsiderohet si rast i izoluar. Që nga fillimi ishte rast unik, *sui generis*, që kërkonte zgjidhje unike.”² Kurse, Ambasadori i Francës, Jean-Maurice Ripert, deklaroi: “Kosova e shpalli pavarësinë e vet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe i takon çdo shteti ta njohë apo të mos e njohë shtetin e ri. Presidenti i Republikës së Francës, Nicolas Sarkozy e njoftoi përmes një letre Presidentin e Kosovës se Franca e njohu Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur.”³ Ambasadori francez u ndal edhe në çështjen e përpjekjeve për ta paraqitur Kosovën si një precedent. Ai, pa asnjë ambiguitet deklaroi: “Rasti i Kosovës përbën një situatë unike, që

¹ Po aty, f. 20

² Po aty, f.17

³ Po aty, f. 20

shënon fundin e një procesi historik të veçantë: shpërbërja e ish-Jugosllavisë gjatë viteve 90 që u pasua me një periudhë të administratës ndërkombëtare nën mburojën e OKB-së.”¹

Duke dashur të hidhte poshtë fajësimin e regjimit të Slobodan Milošević-it për faktin se shqiptarët e Kosovës nuk mund të vazhdonin të jetonin në shtetin e Serbisë, Presidenti serb, Boris Tadić-i, nxori në shesh të vërtetën se, përtej divergjencave lidhur me interpretimin e rezolutës 1244 dhe të drejtës ndërkombëtare, ekzistonte një konsensus i përgjithshëm në tavolinën e diskutimeve në Këshillin e Sigurimit: vullneti politik i shqiptarëve të Kosovës për pavarësi nga Serbia. Presidenti serb ua tërhoqi vërejtjen të pranishmëve: “Përfaqësuesit e disa shteteve në këtë tavolinë vazhdojnë të na thonë se Slobodan Milošević-i është përgjegjës për situatën në Kosovë dhe se pavarësia është rezultat i gabimeve të tij. Do t’ju përgjigjesha se jemi më 19 shkurt² 2008 dhe Slobodan Milošević-i nuk është më dhe se në vitin 1999, kur ai ishte në pushtet, Kosova nuk e fitoi pavarësinë. Dëshiroj të rikujtoj këtu, përpara këtij organi të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, se gjatë dekadave të tëra, madje edhe para Slobodan Milošević-it, shqiptarët e Serbisë kërkuan pavarësinë dhe aktivisht punuan për t’u ndarë.”³

Në këtë çështje, Boris Tadić-i kishte plotësisht të drejtë: vullneti politik i popullit shqiptar të Kosovës qëndronte në themelet e kësaj pavarësie. Por, vullneti politik për t’u ndarë nga Serbia nuk mund të konsiderohet faj që do të arsyetonte aplikimin e politikës së gjenocidit nga regjimi i Beogradit, të kohës së Slobodan Milošević-it, apo shfajësimin që mendohej t’i bënte kësaj politike regjimi i Beogradit, i kohës së Boris Tadić-it.

Vullneti politik i popullit të Kosovës duhej të njihej në të njëjtën masë si edhe vullneti i njëjësive tjera që përbënin ish Federatën e Jugosllavisë!

¹ Po aty, f. 21

² Për Boris Tadić-in koha ecte shumë shpejt! Apo e kishte kapluar ankthi dhe nuk dinte se çka do të sillte dita e nesërme, 19 shkurti!

³ Nations Unies, Conseil de sécurité, S/PV.5839

Shih Proces-verbalet e seancës 5839 të 18 shkurtit 2008, f.4

Pikërisht për këtë arsye, Përfaqësuesi i Përhershëm i Kostarikës, Jorge Urbina, në këtë seancë të Këshillit të Sigurimit, konfirmoi se shteti i tij e kishte njohur pavarësinë e Kosovës sepse “ishin të bindur se nuk ekzistonte asnjë bazë e fortë që do ta përjashtonte një zgjidhje të tillë dhe se në këtë situatë duhet të merrej parasysh vullneti i popullit të Kosovës, i cili, pas spastrimit etnik, e sheh të pamundshme të jetojë në një shtet ku shumica janë serbë.”¹ Është interesant të përmendet hipoteza e Jorge Urbina-se “të ndara në dy shtete të pavarura, Serbia dhe Kosova do të jenë në gjendje të rivendosin dialogun dhe të fillojnë rrugën e bashkëpunimit.”² Kjo hipotezë ishte diametralisht e kundërt me hipotezën që shihte në pavarësinë e Kosovës rrezik për stabilitetin në Ballkan.

Krahas respektimit të vullnetit të shumicës së popullsisë së Kosovës, pjesa dërrmuese e diskutuesve vunë theksin se pavarësia ishte shpallur në përputhje me Propozimin gjithëpërfshirës të Marti Ahtissari-t.

Kështu, në fjalën hyrëse të seancës së 18 shkurtit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-moon-i i njoftoi të pranishmit se “Përfaqësuesi Special i tij për Kosovën e kishte informuar se në Kuvendin e Kosovës, 109 deputetët e pranishëm e kishin miratuar deklaratën e pavarësisë. Në deklaratën e pavarësisë Kosova i pranonte pa asnjë rezervë obligimet që rridhnin nga propozimi i detajuar për rregullimin e statusit të Kosovës, i përpiluar nga i Dërguari special i imi, Marti Ahtisaari.”³

Në të njëjtën frymë, Ambasadori i Belgjikës nënvizoi: “Para një viti, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm, Marti Ahtisaari, na e prezantoi raportin dhe rekomandimet e veta. Pavarësia e mbikëqyrur nga komuniteti ndërkombëtar hasi në mbështetjen e një pjese të madhe të bashkësisë ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Sekretarin e përgjithshëm të OKB-së dhe të Bashkimit Evropian. Belgjika gjithmonë ka vlerësuar se propozimi i Ahtisaari-i është opsion i vetëm realist dhe i qëndrueshëm.

¹ Po aty, f. 18

² Po aty, f. 18

³ Po aty, f. 2

Belgjika i gëzohet angazhimeve të shprehura nga autoritetet e Kosovës për të jetësuar dispozitat e planit të Ahtisaari-t¹.

Përputhshmëria e vendimit të Kuvendit të Kosovës për pavarësi me Propozimet e Martti Ahtisaari-t për pavarësi të mbikëqyrur u përmend nga shumica e diskutuesve në seancën e 18 shkurtit.

Në përmbyllje të këtij aspekti po sjell pjesë nga fjala e Përfaqësuesit të Italisë, Aldo Mantovani-t, sepse më duket se i ndërthen në mënyrë të sintetizuar një numër çështjesh rreth temës që po shqyrtoj.

“Deklarata e pavarësisë e Kuvendit të Kosovës nuk na ka gjetur të papërgatitur” - deklaroi ai. “Kjo rrjedhë e ngjarjeve është rezultat i përpjekjeve maksimale dhe të mundimshme që vuri në zbatim komuniteti ndërkombëtar me shpresë që të tejkalohen dallimet mes palëve të përfshira drejtpërsëdrejti. Ne u kemi dhënë mbështetje të fortë negociatave të gjata që fillimisht u zhvilluan nga i Dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm, Kryetari Ahtisaari, pastaj nga Treshja. Siç na ka siguruar përfaqësuesi i Bashkimit Evropian në kuadër të kësaj Treshjeje, Ambasadori Ischinger, ishin hulumtuar të gjitha rrugët e mundshme. Vazhdimi i negociatave nuk kishte asnjë kuptim, sepse të gjitha mjetet për t’i pajtuar të dyja palët ishin shqyrtuar. Asgjë nuk na premtonte se do të arrihej deri te një zgjidhje e përbashkët edhe në rast se i vazhdonim bisedimet për disa muaj, apo edhe për disa vite. Fatkeqësisht, ishin shterur të gjitha mjetet për të gjetur një zgjidhje të negociuar.

Shpesh kemi deklaruar shqetësimin tonë se moszgjidhja e situatës nuk mund të vazhdonte gjatë dhe, sa i përket çështjes së sigurisë, kemi shprehur brengosjen për rrezikun që ndërthente në vete vazhdimi i status quo-së. Gjatë debatit të muajit dhjetor, kur u shqyrtua raporti i Treshes, Italia deklaroi pikërisht në këtë sallë, siç është theksuar shumë shpesh këtu në OKB dhe në instanca tjera multilaterale, se është plotësisht kundërthënëse të kërkohet vazhdimi i bisedimeve përderisa pohojmë se status quo-ja në

¹ Po aty, f. 9

Kosovë është e paqëndrueshme. Pasiguria në rritje e dëmton popullsinë vendore dhe prania ndërkombëtare në terren. Ishte në interes të të gjithëve që statusi i Kosovës të përcaktohej qartazi. Ne duhet të kalojmë në një fazë të re.

Ne e kemi thënë prej kohësh dhe mbetemi të bindur se, nëse status quo-ja është e paqëndrueshme dhe një zgjidhje e negociuar është e pamundur të gjendet, atëherë pavarësia e mbikëqyrur ndërkombëtarisht, e tillë siç është propozuar nga i dërguari special për Kosovën, është mjete i vetëm realist për të siguruar stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë dhe në tërë regjionin.”¹

Thirrja e Presidentit të Serbisë në seancën së Këshillit të Sigurimit të datës 18 shkurtit drejtuar shteteve që të mos e njihnin pavarësinë e Kosovës nuk e ndërpreu procesin e njohjeve të reja².

Më 21 shkurt Këshilli i Ministrave të Evropës njohu zyrtarisht pavarësinë e Kosovës. Pas kësaj mbledhjeje, Kryetari i Këshillit të Ministrave të BE-së, Romano Prodi, deklaroi se “njohja e pavarësisë së Kosovës nuk e dobëson aspak miqësinë dhe dashurinë që kemi për Serbinë... dhe Serbia nuk duhet të ndihet e braktisur nga Evropa.”³ Por, ky vendim duhet të shihet në kontekstin historik ku “pavarësia e Kosovës është një përfundim i pashmangshëm, sepse Kosova nuk mund të mbetet përgjithmonë nën administrimin ndërkombëtar dhe kosovarët nuk dëshironin më të qëndronin nën dominimin e Serbisë.”⁴

Përkundër efekteve të vogla që dëshmoi rreth bllokimit të procesit të pavarësimit të Kosovës, diplomacia serbe bëri edhe një përpjekje të re më 6 mars 2008. Përfaqësuesi Permanent i Serbisë në Kombet e Bashkuara i dorëzoi Këshillit të Sigurimit letrën⁵

¹ Po aty, f.10

² Nga seanca e 18 shkurtit e deri në fillim të muajit mars Kosovën e njohën edhe Australia, Senegali, Letonia, Gjermania, Estonia, Italia, Danimarka, Luksemburgu, Peru, Belgjika, Polonia, Zvicra, Austria, Irlanda, Suedia, Holanda, Islanda, Sllovenia dhe Finlanda.

³ Le nouvel observateur, «Indépendance, Kosovo»
<http://actu-monde.nouvelobs.com/independance-kosovo.html>

⁴ Po aty.

⁵ Nations Unies, Conseil de sécurité, S/PV.5839
Shih Proces-verbalet e seancës 5850 të 11 marsit 2008
<http://www.un.org/fr/sc/meetings/records/2008.shtml>

përmes së cilës kërkohet një mbledhje urgjente që të shqyrtohet gjoja “përkeqësimi i situatës në krahinën serbe të Kosovës dhe Metohisë” pas “shpalljes së njëanshme të pavarësisë.”

Në seancën e 5850 të Këshillit të Sigurimit, të datës 11 marsit 2008, që ishte thirrur me kërkesën serbe, Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić-i përsëriti se shteti i tij nuk do ta pranonte pavarësinë e Kosovës dhe tërhoqi vërejtjen se “rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit ua imponon shteteve anëtare obligimin e detyrueshëm në bazë të Kapitullit VII që të respektojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Serbisë.”¹

Pasi i dha të drejtë vetes ta interpretojë në këtë mënyrë rezolutën 1244, Vuk Jeremić-i kërkoi nga shtetet të cilat e kishin njohur pavarësinë e Kosovës që ta rishikojnë dhe ta anulojnë vendimin e tyre, ndërsa, vendeve që ende nuk e kishin marrë një vendim të tillë “të qëndronin pranë Serbisë, ta ndihmonin në vazhdimin e mbrojtjes së sistemit ndërkombëtar sa nuk ishte shkatërruar në tërësi.”²

Në fjalën e tij Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë shfrytëzoi rastin që të sqarojë qëndrimin e Qeverisë së Serbisë lidhur me dhunën e shprehur gjatë manifestimit të 21 shkurtit. Duke lënë në heshtje të plotë faktin se ky manifestim u organizua nga Qeveria e Serbisë dhe partitë tjera parlamentare, Vuk Jeremić-i u përpoq që të minimizojë përmasat e pjesëmarrësve në dhunën. Për ministrin serb, “vetëm një numër i vogël manifestuesish të tubuar në Beograd aplikuan dhunë gjatë sulmeve ndaj ambasadave të huaja, kundër dyqaneve në qendër të qytetit dhe ndërtesave publike. Në emër të qeverisë sime ju shpreh keqardhje vendeve të cilave u janë dëmtuar ambasadat.”³ Ministri serb nuk tha asnjë fjalë lidhur me nxitjen e manifestuesve nga Kryeministri i qeverisë së tij, e as për fjalimet antiamerikane dhe antievropiane që u mbajtën nga personalitetet e jetës politike, kulturore dhe sportive të Serbisë me rastin e këtij manifestimi. Ai nuk nguroi të përsëritë

¹ Po aty, f.1

² Po aty, f.1

³ Po aty, f.3

se “kultura, bindjet dhe historia e Serbisë janë thellësisht evropiane“ dhe se shteti i tij kishte “vullnet dhe gatishmëri për të nënshkruar menjëherë Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Bashkimin Evropian.”¹

Pas dëgjimit të fjalës së tij, seanca e Këshillit të Sigurimit përfundoi pa debatuar askush!

Përkundër asaj se askush nuk deshi të fliste në këtë seancë, Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë nuk kishte asnjë mundësi të fshihte faktin se “qeveria e tij” kishte kërkuar nga presidenti serb që të shpërbente parlamentin për shkak të divergjencave të mëdha në kuadër të koalicionit qeveritar.

Dallimet në nuanca që u shfaqën në qëndrimet politike të bartësve të institucioneve të Serbisë, pas 17 shkurtit 2008, sidomos dallimet mes Presidentit të Serbisë, Boris Tadić-it, dhe Kryeministrit të Serbisë, Vojislav Koštunica-s, shkuan duke i acaruar marrëdhëniet e koalicionit qeveritar. Shkaqet e këtij acarimi lidhen drejtpërsëdrejti me divergjencat e thella që u krijuan pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës². Boris Tadić-i, edhe pse kundërshtonte pavarësinë e Kosovës, nuk hiqte dorë nga ambiciet për ta integruar Serbinë në Evropë, përderisa Vojislav Koštunica përsëriste të njëjtin qëndrim nacionalist si gjatë regjimit të Milošević-it.

Këto divergjenca bënë që në një seancë të jashtëzakonshme, të mbajtur më 10 mars, Qeveria e Serbisë të bëjë publike se “për shkak të mungesës së një politike unike dhe të përbashkët të qeverisë së koalicionit rreth çështjes së Kosovës u kërkua nga Presidenti i Serbisë ta shpërndanjë parlamentin dhe të thërrasë zgjedhjet e jashtëzakonshme për datën 11 maj 2008³.

Më 13 mars, presidenti serb shpërndau parlamentin e Serbisë dhe shpalli mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme më 11 maj

¹ Po aty, f.4

² Le nouvel observateur, përmbledhja e shkrimeve e cituar më lartë, «Indépendance, Kosovo»

Le président serbe Boris Tadic dissout le parlement - 13 mars 2008

³ Blic, «Vlada predložila raspuštanje Skupštine» (Qeveria propozon shpërndarjen e parlamentit)

Tanjug, Beta, 10 mars 2008

<http://www.blic.rs/Vesti/Politika/33477/Vlada-predlozila-raspustanje-Skupstine/print>

2008¹. Në fjalën e tij në Kuvendin e Serbisë, Boris Tadić-i vuri theksin se “zgjedhjet janë rrugë demokratike në të cilën qytetarët do të tregojnë se si do të duhej të zhvillohet Serbia viteve të ardhshme.”²

A do të vendosnin si në zgjedhjet e janarit 2007, kur radikalët e Vojislav Šešel-i fituan zgjedhjet, apo besimi do t'i jepej një koalicioni të forcave që deklaroheshin si pro-evropiane?

Reagimet e huaja ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës

Reagimet lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës nuk u kufizuan vetëm në qëndrimet e shteteve dhe institucioneve ndërkombëtare. Në të njëjtën gjatësi valësh me qëndrimet e nacionalistëve dhe radikalëve serbë, për të cilët “njohja e pavarësisë së Kosovës nxorri në shesh të vërtetën se prapa bombardimeve të NATO-s qëndronin motivet për krijimin e një shteti të rrejshëm për interesat ushtarake të NATO-s... dhe qëllimi i SHBA-ve për ta poshtëruar dhe detyruar BE-në që ta ulë kokën dhe t'i shkelë parimet mbi të cilat mbështetej...”³ edhe gazetarë, publicistë, filozofë, politologë, sociologë, historianë e politikanë, qëndrimet e të cilëve u shqyrtuan në kapitujt e mëparshëm të këtij libri, u mobilizuan sërish, si në kohën e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s.

Në vend që pavarësia e Kosovës të shihej si aspiratë dhe vullnet politik i shqiptarëve të Kosovës, krijimi i shtetit të ri në Evropë u paraqit si rezultat i një komploti të përgatitur nga SHBA-të, të cilin e mbështetën shtetet që iu nënshtruan vullnetit amerikan dhe që ngërthen rreziqe për paqen dhe stabilitetin.

Kështu, pas apelit serb që të mos njihej pavarësia e Kosovës, Kryetari i Frontit Nacional të Francës, Jean-Marie Le Pen-i përvetësoi qëndrimin e propagandës serbe se njohja e pavarësisë së Kosovës do të ishte gabim historik me pasojë të pallogaritshme dhe se gjoja

¹ DW, «Raspuštena Skupština - raspisani izbori» (Shpërndahet parlamenti-u caktuan zgjedhjet)

<http://www.dw.de/raspuštena-skupština-raspisani-izbori/a-319058>

² Po aty

³ B92, artikulli i cituar, «Srbija poništava nezavisnost»

“Kosova e pavarur do të ishte tempull i krimit të organizuar në zemër të Evropës.”¹ Për të qenë pak më “origjinal” në krahasim me propagandën e regjimit të Beogradit, Le Pen-i alarmoi për gjoja “rrezikun që i kanosej Evropës nga një Kosovë e pavarur”, sepse, ajo “do të shndërrohej në një bazë për islamizimin e kontinentit². Pohimi se Kosova 2 milionëshe mund të rrezikojë islamizimin e një kontinenti me mbi 600 milion banorë nuk mund të shitet as për barcaletë! Për mendimin tim, trajtimi i evropianëve si “të paqëndrueshëm në bindjet e tyre”, të cilët gjoja “janë detyruar nga amerikanët që ta ulin kokën dhe të heqin dorë nga parimet e tyre” dhe që “rrezikohen të islamizohen nëse Kosova bëhet shtet i pavarur” është tallja më e madhe që mund t’u bëhet evropianëve!

Pa asnjë dallim përmbajtësor nga lideri i të djathtës ekstreme në Francë, edhe dy parti të orientimit të majtë (Partia Komuniste e Francës dhe Partia e Majtë³) mbajtën qëndrim të njëjtë.

Për Partinë Komuniste të Francës, “përshpejtimi i Shteteve të Bashkuara dhe i shumë shteteve evropiane, në mesin e të cilëve edhe Franca, ta shtyjnë Kosovën të deklarojë pavarësinë e vet nuk do të bëjë asgjë tjetër pos t’i acarojë edhe më tepër tensionet me Serbinë dhe t’i inkurajojë ambiciet e shumta për shpëputje në Ballkan, në Mesdhe dhe në Kosovë⁴. Ndërsa, lideri i Partisë së Majtë të Francës, Jean-Luc Mélenchon-i, shkon shumë më larg në qëndrimet ekstreme se vetë ekstremistët serbë.

Sipas tij, “ disa vite pas ndërhyrjes së NATO-s ‘për të ndalur masakrat e bëra nga serbët’, ndërhyrje që u bë pa mandatin e OKB-së, u lejua pavarësia e Kosovës. Në të vërtetë u urdhërua një gjë e tillë!”⁵ - saktëson Mélenchon-i.

¹ Le nouvel observateur, përmbledhja e shkrimeve e cituar më lart, «Indépendance, Kosovo»

«Kosovo: les réactions-21 février 2008»

² Po aty

³ Parti de Gauche, e themeluar nga një grup i ndarë nga Partia Socialiste e Francës dhe nën udhëheqjen e Jean-Luc Mélenchon-it.

⁴ Le nouvel observateur, përmbledhja e shkrimeve e cituar më lart, «Indépendance, Kosovo»

«Kosovo : les réactions-21 février 2008»

⁵ Le blog de Jean-Luc Mélenchon, «Kosovo no! Cuba si!»

<http://www.jean-luc-melenchon.fr/2008/02/20/kosovo-no-cuba-si/>
dhe

Krahas injorimit të plotë të faktit se pavarësia e Kosovës ishte vullnet politik i shumicës së popullit të saj dhe këmbënguljes se gjoja “kjo pavarësi ishte urdhëruar nga amerikanët”, Mélenchon-i shprehet i “neveritur nga spektakli i paturpësisë”, siç e quan ai procesin “që i shpuri ta njihnin Kosovën me klithje gëzimi, përderisa po vulosej akti i parë i tragjedisë që ngërthen në vete shekulli i ri.”¹

Pas “neverisë” vjen revolta e tij! Me klithje zemërimi, Jean-Luc Mélenchon-i çirret se gjoja “që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, për herë të parë u krijua një «shtet»² absolutisht i paqëndrueshëm, pa asnjë bazë historike, me administratë të korruptuar deri në palcë, tërësisht në duar të mafies dhe i krijuar në kuadër të kufijve të një shteti tjetër. Dhe një gjë e tillë u bë pas ndërhyrjes ushtarake!”³

Për liderin e Partisë së Majtë dhe kandidatin për President të Francës në zgjedhjet e vitit 2012, Jean Luc Mélenchon-in, Kosova është «shtet i pavlerë»⁴ i cili udhëhiqet nga horrat që bënin tregti me organe njerëzish...”⁵ Përveç cilësimit me përbuzje të shtetit të Kosovës si “shtet prapanicë”, ai këmbëngul se “urdhri amerikan” për pavarësinë e Kosovës është “poshtëruar për bashkimin evropian”⁶ ndërsa, për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Franca, Mélenchon-i fajëson Presidentin Sarkozy, të cilin e akuzon se “i ka çnderuar francezët, duke qenë i pari që bëri menjëherë të njëjtën gjë.”⁷

Libération, «Il faut briser le tyran pour l'empêcher de briser la révolution» (Duhet të thyhet tirania për ta penguar që të thejë revolucionin), 21 mars 2011 http://www.liberation.fr/monde/2011/03/21/il-faut-briser-le-tyran-pour-l-empêcher-de-briser-la-revolution_723004

¹ Po aty

² Thonjëzat janë të Mélenchon-it

³ Po aty

⁴ Mélenchon-i përdor fjalën frënge «croupion» që do të thotë prapanicë e shpezëve. Kjo fjalë ka kuptimin figurativ edhe të gjërave pa vlerë. Nëqoftëse Mélenchon-i është fshehur pas prapanicës për të fyer shtetësinë e Kosovës është e drejtë e tij! Mund të futet ku të dojë.

⁴ Le bolg de Jean-Luc Mélenchon, artikulli i cituar, «Kosovo no! Cuba si!»

⁵ Libération, intervista e cituar «Il faut briser le tyran...»

⁶ Bashkimit Evropian meshkronja të vogla dhe në thonjëza janë të Mélenchon-it.

⁷ Po aty

Por, përkundër këtij “çnderimi” që u paska bërë njohja e pavarësisë së Kosovës dhe “nënshtrimi i ‘bashkimit evropian’ karshi fundosjes të së drejtës ndërkombëtare, ka “pesë kombe të mëdha të Evropës që nuk i ‘nënshtrohen tiranisë’ amerikane dhe që i japin shpresë Mélenchon-it se “mund të thyhet tirania dhe të shpëtohet pa u thyer revolucioni”¹ i tij!

Për dallim nga Jean Luc Mélenchon-i, i cili braktisi Partinë Socialiste për të formuar Partinë e Majtë të Francës, eseisti francez, Alain Soral-i braktisi Partinë Komuniste dhe fillimisht u integrua në komitetin Qendror të Frontit Nacional të Le Pen-it, në vitin 2007, të cilin e braktisi dy vjet më vonë dhe u paraqit në listën antisioniste në zgjedhjet evropiane të vitit 2009. Aktualisht identifikohet si « nacional- socialist ». Metamorfozë e çuditshme e kësaj lëkundjeje nga një ekstrem në tjetrin!

Ngjashëm siç kishte vepruar disa vite më parë Regis Debray-ja, «nacional - socialisti» francez vizitoi Serbinë dhe Kosovën për t’u njohur me realitetin. Pas kësaj vizite, qëndrimit “në mesin e patriotëve serbë” dhe pjesëmarrjes në një miting në Beograd kundër Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, në të cilin edhe e mori fjalën, Alain Sorel-i erdhi te përfundimi: “Kosova nuk ekziston! Ajo është Serbi e pushtuar, ku patriotët serbë janë pre e amerikanëve, e mafies shqiptare dhe e parasë saudite...”²

«Nacional- socialisti» francez, Alain Sorel- i, përpiqet t’i sqarojë lexuesit e vet se kjo gjendje erdhi si pasojë e “strategjisë së manipulimit dhe shkatërrimit të kombeve që udhëhoqi «Perandoria»»³. Dhe luftën kundër regjimit të Milošević-it ai e interpreton si luftë kundër Serbisë, si shteti i parë i krishterë në Evropë, që është bombarduar pas vitit 1945 nga një aleancë e “krishterë”⁴.

Sikurse Jean Marie Le Pen-i, Jean Luc Mélenchon-i dhe Alain Sorel-i që përçonin stigmatizimin serb për shtetësinë e

¹ Libération, artikulli i cituar, «Il faut briser le tyran pour l’empêcher de briser la révolution»

² Alain Sorel, «Le Kosovo n’existe pas!»

http://woTRACEAFG.voila.net/soral_kosovo.htm

³ Po aty, Alain Sorel-i i cilëson SHBA-të si “Perandori”

⁴ Po aty

Kosovës si qendër e rrezikshme e krimit të organizuar, Xavier Raufer-i e kualifikon Kosovën si “prototip të shtetit mafioz”¹ ndërsa Pierre Péan-i tërë luftën e Kosovës e sheh “si luftë të «drejtë» të amerikanëve në funksion të krijimit të një shteti mafioz!”²

Edhe një ekstremist tjetër i djathtë, neonazisti i Frontit të Ri të Belgjikës, Hervé Van Laethem³ dhe publicisti belg i orientimit të majtë, Michel Collon-i, u shprehën kundër pavarësisë së Kosovës. Madje, Hervé Van Laethem mori pjesë personalisht në manifestimet e nacionalistëve serbë kundër pavarësisë së Kosovës, të organizuar në Bruksel⁴.

Edhe për Alain de Benoist-i⁵, njëri nga përfaqësuesit më të njohur të lëvizjes «E Djathta e Re», ndërhyrja e NATO-s kundër regjimit të Milošević-it ishte agresion kundër Serbisë. Bombardimi i Beogradit u bë në funksion të mbështetjes së ndarjes së Kosovës dhe pavarësisë e saj...⁶

Njohja e pavarësisë së Kosovës nga SHBA-të dhe shtetet e tjera do të shërbejë si shkas për të gjithë ata të cilët e shihnin luftën e NATO-s kundër regjimit të Milošević-it si mjet amerikan për të depërtuar në Evropë që të mobilizohen për të argumentuar se e tëra ishte komplot i amerikanëve.

Këndvështrimi antiamerikan bëri që të injorohet tërësisht vullneti politik dhe angazhimi i shqiptarëve për pavarësi edhe për publicistin dhe gazetarin gjerman, Jürgen Elsässer-in. Edhe për të

¹ Geolinks, La Republique du Kosovo
<http://www.geolinks.fr/geopolitique/fiche-pays-kosovo/>

² Pierre Péan, vepra e cituar, *Kosovo : une guerre «juste» pour un Etat mafieux*, f.366

³ Résistances «Nationalistes serbes soutenus par l'extrême droite belge», (Nationalistët serbë të mbështetur nga e majta ekstreme belge...)
<http://www.resistances.be/nation07.html>

⁴ Po aty

⁵ Filozof, politolog dhe gazetar francez

⁶ Blogélément pour la civilisation européenne, «Ukraine : la fin de la guerre froide n'a jamais eu lieu»
<http://blogelements.typepad.fr/blog/2014/03/laffaire-ukrainienne-est-une-affaire-complexe-et-aussi-une-affaire-grave-a-une-autre-epoque-et-en-dautres-circonstan.html>

nuk ishte populli shqiptar por, “Shtetet e Bashkuara ishin ata që përgatitën procesin e deklarimit të njëanshëm të pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt... Duke vepruar kështu, SHBA-të pranuan se operacionet luftarake të vitit 1999 ishin luftë pushtuese, të cilat u hapën rrugë të gjitha kërkesave separatiste në botë¹.

Interpretimi i pavarësisë së Kosovës si rezultat i një komploti amerikan dominoi në të gjitha qarqet «antiamerikaniste». Lexuesit i kujtohet se ithtarët e këtij këndvështrimi ia atribuuan amerikanëve dështimin e negociatave në Konferencën e Rambouillet-së, të cilët, sipas tyre, në vend të negociatave, i dorëzuar Serbisë i kishin një ultimatum, për të cilin ishin të sigurt se ajo do ta refuzonte.”²

Sipas kësaj logjike, përderisa dështimi i negociatave në Rambouillet kishte për qëllim të shërbente si pretekst për të ndërhyrë ushtarakisht dhe për ta dominuar Evropën, dështimi i negociatave të Vjenës kishte për qëllim krijimin e shtetit të Kosovës, “ku ishte vendosur baza më e madhe ushtarake amerikane në botë”³

Kështu, historiani dhe gazetari francez, Jean-Arnauld Derens-i, në një shkrim të titulluar «Kosova: pavarësia, e pastaj?», të publikuar në «Le monde diplomatique»-un⁴ i banalizoi skajshmërisht përpjekjet për të gjetur një zgjidhje për statusin final të Kosovës duke i cilësuar këto «negociata»⁵, si të mos ishin “asgjë tjetër pos teatër i atyre që shtiren.”⁶ Kuptohet, “fajtor” për një gjendje të tillë nuk mund të jetë askush tjetër pos SHBA-ve, të cilat

¹ Réseau Voltaire, Jürgen Elsässer, «L'indépendance du Kosovo est la mèche d'un baril de poudre» (Pavarësia e Kosovës është fitil për fuçi baroti)
<http://www.voltairenet.org/article155095.html>

² Serge Halimi, emisioni i cituar «Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3),

³ Réseau Voltaire, La Boîte de Pandore balquanique, Hyrja e intervistës që gazetarja Silvia Cattori bëri me Dick Marty -n
<http://www.voltairenet.org/article155903.html>

⁴ Le monde diplomatique, Jean-Arnauld Dérens, «Kosovo : l'indépendance, et après?», 17 février 2008

<http://www.monde-diplomatique.fr/carnet/2008-02-17-Kosovo>

⁵ Thonjëzat janë të autorit.

⁶ Po aty

“i kishin përcaktuar rregullat që në fillim të lojës”, e kishin përcaktuar “rezultatit final - pavarësinë e Kosovës” dhe “nuk ishte ndërmarrë asnjë përpjekje konkrete për të gjetur një kompromis...”¹

Jean-Arnauld Derens-i nuk e përmend fare se “cili opsion ishte dhe mbetej i papranueshëm” për popullsinë shumicë së Kosovës dhe nuk përcaktohen se cili duhej të ishte “kompromisi” që duhej gjetur. Por, atij i mjafton të kufizohet vetëm në atë se “opsioni i pavarësisë ishte dhe mbetej i papranueshëm për Beogradin” dhe se gjoja rezoluta 1244 “e njëhte qartazi sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën.”²

Por, edhe pse u identifikua tërësisht me interpretimin serb për zhvillimet rreth Kosovës, Jean-Arnauld Derens-i shkon edhe përtej këtij interpretimi. Kështu, po përmend vetëm shembullin kur Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić-i, e shtroi si pyetje “nëse do të mundte krahina të zhvillohej në mënyrë të qëndrueshme pa Beogradin?”³ Jean-Arnauld Derens-i përgjigjet pa ambiguitet: “Kosova e pavarur nuk kishte asnjë perspektivë ekonomike.”⁴

Ai, me “keqardhje” deklaroi se nuk janë bërë përpjekje për të gjetur një “kompromis” mes palëve! Edhe pse nuk e pohon në mënyrë qartë se cila do të ishte forma e këtij “kompromisi”, tërësia e qëndrimeve të këtij gazetari dhe historiani, sidomos qëndrimet e tij që nga implikimi i SHBA-ve për t’i dhënë fund politikës së gjenocidit në Kosovë, lë të supozohet se për Jean Arnauld Derens-in “kompromis” ishte kthimi i sovranitetit të Serbisë mbi Kosovën, në përputhje me interpretimin serb të Rezolutës 1244.

Në këtë kontekst është interesant të përmendet rasti i Catharine Samary-së, ekonomistes franceze dhe asaj që konsiderohet si eksperte e Ballkanit. Për të, fakti se deri ditën kur shkroi artikullin

¹ Po aty.

² Po aty.

³ Shih Proces-verbalet e seancës 5850 të 11 marsit 2008 Nations Unies, Conseil de sécurité, S/PV.5839, f.2

⁴ Le monde diplomatique, Jean-Arnauld Dérens, artikulli i cituar, «Kosovo: l’indépendance, et après»?

e saj “vetëm 54 shtete të OKB-së e kishin njohur pavarësinë e Kosovës, prej të cilave 22 nga 27 shtete të BE-së, dëshmonte se rezoluta 1244 e OKB-së, e nënshkruar nga Milošević-i në fund të luftës, ishte ende në fuqi! Kjo rezolutë e mban Kosovën në status krahine autonome. Serbia që mbështetet në këtë rezolutë ka kërkuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë mendimin e saj lidhur me deklarin e pavarësisë¹.

Në zinxhirin e prononcimeve lidhur me pavarësinë e Kosovës nuk mungoi as Carla Del Ponte.

Carla Del Ponte, e cila e kishte përfunduar² mandatin e Prokurores së Përgjithshme në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe ishte emëruar ambasadore e Zvicrës në Argentinë që nga 1 janari i vitit 2008, me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës i dha një intervistë ekskluzive Swissinfo-s.

Në këtë intervistë³ Carla Del Ponte, në “cilësinë e juristes”, u mundua të japë mendimin e saj “tërësisht profesional”⁴ për aktin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Dhe ky mendim “tërësisht profesional” e pruri ish-prokuroren e përgjithshme, Carla Del Ponte- n deri te pohimi se “Kosova nuk gëzonte një autonomi të vërtetë sepse ajo u vendos nën kontrollin e NATO-s dhe të OKB-së... dhe se ekzistonte një rezolutë e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që kishte të bënte me Kosovën.”⁵

Pas këtij zbulimi “tërësisht profesional” Carla Del Ponte deklaroi se “situata në Kosovë është shumë e veçantë dhe kjo çështje speciale dhe e veçantë kërkon një përgjigje speciale dhe të veçantë. Megjithatë, për mua si juriste-dhe këtu e jap mendimin

¹ Cathrine Samary, «Kosovo 1999-2009, Quelques mensonges de la pseudo guerre humanitaire»

² Pas tetë viteve në funksionin e Prokurores së Përgjithshme, mandati i saj përfundoi më 31 dhjetor 2007.

³ SWISSINFO, «Le Kosovo est un cas particulier» (Kosova një rast i veçantë), 11 mars 2008

<http://www.swissinfo.ch/fre/-le-kosovo-est-un-cas-particulier-/6488070>

⁴ Shprehje e përdorur nga Carla Del Ponte, përmes të cilës ajo dëshiron të na bindë për “neutralitetin” e saj në këtë çështje!

⁵ SWISSINFO, Intervista e lartpërmendur e Carla Del Pontes «Le Kosovo est un cas particulier»

tim tërësisht profesional- pavarësia e Kosovës nuk më duket aspak në përputhje me dispozitat e vendosura nga tradita e të drejtës ndërkombëtare.”¹ Madje, këmbëngul Del Ponte, “kur Kosova e shpalli pavarësinë e vet Këshilli i Sigurimit nuk mori asnjë vendim, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së kërkoi që t’i referohemi rezolutës 1244.”²

Shpresa se mosnjohja eventuale e pavarësisë së Kosovës nga shtetet tjera dhe mbajtja eventuale në fuqi e Rezolutës 1244 do ta kthenin procesin prapa, mbetej tepër prezent në qarqet pro-serbe dhe në qarqet antiamerikane. Këtë shpresë nuk e fsheh as Dick Marty.

Dick Marty, siç u përmend në pjesën e mësipërme të këtij libri, në kohën e ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër regjimit të Beogradit, në cilësinë e anëtarit të Partisë Radikale Demokratike zvicerane, së bashku me 19 deputetë të parlamentit zviceran, i rekomanduan Këshillit Federal të Zvicrës masat që duhej të ndërmerreshin për t’i dhënë fund luftës në Kosovë. Në mesin e masave të propozuara nga Dick Marty qëndronte kërkesa e ndërprerjes së bombardimeve kundër regjimit të Beogradit, kërkesë e kamufluar nën plafin e “armëpushimit mes palëve” dhe “vendosjen e një trupe neutrale për të ruajtur paqen”, në përbërje të së cilës nuk mund të ishin forcat e shteteve që kishin sulmuar Serbinë, sidomos nuk mund të ishin amerikanët që kishin komanduar me NATO-n në një aksion ilegal, pa miratimin e OKB-së.”³

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, i njëjti Dick Marty, por, kësaj radhe në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Politikën e Jashtme të Këshillit të Shteteve të Konfederatës Helvetike, në një intervistë ekskluzive të publikuar më 12 mars 2008, deklaroi se “pavarësia e Kosovës nuk është vendosur në Prishtinë!”⁴ Në intervistën me gazetaren Silvia Cattori, Dick Marty shprehu

¹ Po aty

² Po aty

³ L’Assemblée fédérale - le Parlement suisse, Rekomandimi 99.3171, deponuar nga Dick Marty, i cituar më lart

⁴ Réseau Voltaire, Intervista e cituar, Dick Marty : « L’indépendance du Kosovo n’a pas été décidée à Pristina »,

pakënaqësinë e tij pse Zvicra u përshpejtua ta njëhte Kosovën si shtet të pavarur sepse neutraliteti i Zvicrës ishte i qartë! Ai u deklarua se “nuk e kuptonte pozicionin e Zonjës Calmy-Rey”¹, e cila, sipas tij, do të ishte dashur të angazhohej “për një autonomi për Kosovën, apo ndonjë zgjidhje konfederate të ngjashme si modeli zviceran.”²

Vendimi për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Zvicrës ishte edhe më i “pakuptueshëm” për Dick Marty-n, për arsye se, siç thotë ai, “shumica e vendeve nuk e kanë njohur dhe nuk do ta njohin Kosovën.”³

Nga data 17 shkurt 2008, kur u shpall pavarësia e Kosovës, e deri më datën 12 mars 2008, kur u publikua intervista e tij, shtetin e ri të Kosovës e kishin njohur 26 vende të botës. Është e vërtetë se brenda tri javësh shumica e shteteve anëtare të OKB-së nuk e kishin njohur pavarësinë e Kosovës. Por, hipoteza se “shumica e vendeve nuk do ta njohin Kosovën” të cilën Dick Marty e paraqet si vendim të prerë, nxjerr në shesh dëshirën që realiteti të përshatet me ëndrrat e tij. Sidomos kjo nxjerr në shesh qartazi “neutralitetin” e Dick Marty-t.

Para se Dick Marty të deklaronte një gjë të tillë, 15 nga 26 shtete që kishin njohur pavarësinë e Kosovës, ishin anëtare të Bashkimit Evropian. Pra, shumica e shteteve të BE-së tashmë e kishin njohur realitetin e ri. Sot, kur po e shkruaj këtë kapitull, Kosova është e njohur nga 107 shtete anëtare të OKB-së, nga gjithsejt 197 shtetet e kësaj organizate. Nga 107 shtetet që njohon Kosovën shtet të pavarur, 34 shtete janë anëtare të Këshillit të Evropës (nga 47 gjithsejt) ndërsa 23 anëtare të BE-së (nga 28 shtete që përbëjnë këtë strukturë). Pra, shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, shumica e shteteve të Këshillit të Evropës dhe shumica e shteteve të OKB-së e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe nuk ia kanë plotësuar dëshirën militantit Dick Marty-t!

¹ Po aty

² Po aty

³ Po aty

Lexuesi pati mundësi ta shohë më hollësisht implikimin e drejtpërdrejtë të Dick Marty-t gjatë luftës së Kosovës dhe kërkesave për ndërprerjen e bombardimeve kundër regjimit të Slobodan Milošević-it. Me të njëjtin zell militanti, nga njëra anë u rikujton të tjerëve domosdoshmërinë që të respektohet “neutraliteti” përderisa vetë angazhohet tërësisht për ruajtjen e Kosovës nën sovranitetin e Serbisë.

Nga pozicioni i Kryetarit të Komisionit për Politikën e Jashtme të Këshillit të Shteteve të Konfederatës Helvetike, Dick Marty mundohet t’i arsyetojë qëndrimet e veta duke u mbështetur në dy aspekte: “ndryshimet” në Serbi dhe e drejta ndërkombëtare.

Sa i përket ndryshimeve në Serbi, Dick Marty shpall me pompozitet se “Serbia e tanishme nuk ka të bëjë aspak me Serbinë e Miloshević-it.”¹ Në mbështetje të këtij pohimi, ai sjell argumentin se “në janar të vitit 2008 në Serbi pati zgjedhje, të cilat u vlerësuan nga të gjithë vëzhguesit ndërkombëtar si zgjedhje të lira dhe demokratike. Serbët dëshmuan një pjekuri dhe një guxim të jashtëzakonshëm: ata zgjodhën kandidatët pro-evropianë edhe pse kjo nuk ishte e lehtë për ta, pas dhjetë vjet bllokade nga ana e Evropës.”²

Për këtë “pjekuri dhe guxim të madh që treguan serbët duke zgjedhur kandidatët pro-evropianë” në “zgjedhjet e janarit të vitit 2008” (!!!) ata meritonin diçka tjetër nga ajo, që sipas tij, u ofroi “bota perëndimore”. Për këtë arsye, ai revoltohet pa masë me atë “çka bëri bota perëndimore”, çështje që e shtron në formën e pyetjes ironike dhe të cilës i përgjigjet po vetë. “Menjëherë pas këtyre zgjedhjeve” kjo botë perëndimore ”e nxiti Kosovën drejt pavarësisë duke e shtyrë Serbinë drejt kampit rus dhe duke e poshtëruar atë. Për mua, kjo është absurde!”³ - shpreh zemërimin e vet Dick Marty.

Duke lexuar këto deklaratat, lexuesit mund t’i duket absurde që Kryetari i Komisionit për Politikën e Jashtme të Këshillit të

¹ Po aty,

² Po aty

³ Po aty

Shteteve të Konfederatës Helvetike, lëshohet në format më të ulëta të manipulimit me opinionin e lexuesve të intervistës së tij. Sidomos me lexuesit që nuk e dinë se zgjedhjet në Serbi nuk u mbajtën në janar të vitit 2008, por, më 21 janar të vitit 2007. Dikujt mund t'i duket se ndoshta kemi të bëjmë me ndonjë gabim shtypi dhe se ndoshta në vend të vitit 2007 është shtypur gabimisht 2008! Por jo! Këtu kemi të bëjmë me manipulim të qëllimshëm.

Në pjesën e sipërme të këtij kapitulli u analizua konteksti i mbajtjes së zgjedhjeve të 21 janarit 2007 dhe u soll rezultati i këtyre zgjedhjeve. Të gjithë ata që nuk kanë pasur mundësi t'i përcjellin këto zhvillime politike në Serbi patën mundësi të shohin se këto zgjedhje nuk "i fituan kandidatët pro-evropianë", siç gënjen Dick Marty, por, përkundrazi, zgjedhjet i fitoi Partia Radikale e Serbisë, e themeluar dhe e udhëhequr nga Vojislav Šešel-i, i cili që nga viti 2003 është i burgosur në Hagë, i akuzuar për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte dhe në pritje të gjyqimit¹.

Nuk ka asgjë absurde në veprimin manipulues të militantit Dick Marty. Çdo gjë është logjike në përputhje me logjikën e «antiamerikanizmit» që e karakterizon atë.

Jo vetëm që pavarësia e Kosovës dhe njohja e saj nuk e "shtynë Serbinë drejt kampit rus", siç gënjen përsëri Dick Marty, por, përkundrazi, në zgjedhjet e jashtëzakonshme që u mbajtën më 11 maj 2008, fitoi «Lista për Serbinë Evropiane»².

Nuk do të lëshohem në spekulime lidhur me hipotezat se deri në cilën shkallë ka ndikuar pavarësia e Kosovës që një pjesë e mirë e elektoratit serb të vetëdijësohet për domosdoshmërinë e orientimit drejt "botës perëndimore". Atë që mund ta them tani për tani ka të bëjë me faktin se njohja e pavarësisë së Kosovës nga shumica e shteteve të Bashkimit Evropian nuk e "shtynë Serbinë drejt kampit rus"!

¹ Fondacioni Robert Schuman, artikulli i cituar, «Les ultranationalistes arrivent en tête, des élections législatives en Serbie»

² Mondo, «Konačni rezultat parlamentarnih izbora» (Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare)
<http://mondo.rs/a99517/Info/Specijali/Izbora-2008/Konacni-rezultati-parlamentarnih-izbora.html>

Këtë gjë e dinte edhe Dick Marty kur mundohej të manipulonte me opinionin e lexuesve të vet. Por, atij i nevojitej një gënjeshtër e tillë për të arsyetuar kritikën që ia adreson BE-së.

Ai e shprehu haptazi revoltën e tij pse “bota perëndimore” nuk ka bërë diçka tjetër. “Sidomos Bashkimi Evropian, ka mundur të bëjë një deklaratë drejtuar të gjitha vendeve të regjionit dhe t’u thotë: ju propozojmë të gjithëve një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkimin Evropian dhe Kosova do të gëzojë një autonomi të zgjeruar. Presidenti serb, Boris Tadić-i erdhi në Këshillin e Evropës dhe përkundër asaj se ishte e vështirë për të, ai deklaroi përpara përfaqësuesve të 47 shteteve: «Ne jemi dakord t’ia njohim Kosovës autonominë më të gjerë të mundshme». Nuk e kuptoj pse nuk e kemi shfrytëzuar këtë rast.”¹

“Neutralitet” e jo shaka! Përsëritjen e qëndrimit të vjetër të propagandës së Miloshević-it për një autonomi në kuadër të Serbisë dhe të dizajnuar nga Beogradi, Dick Marty e sheh si rast i mirë që qenka dashur të shfrytëzohet. Për më tepër, ky propozim i ri i modelit të vjetër për “zgjidhjen” e statusit të Kosovës, paraqitet si diçka që paska qenë “e vështirë të pranohet nga Presidenti serb, Boris Tadić-i, e megjithatë, ai e kishte bërë një hap të tillë!

Dick Marty-t nuk i intereson se çka ishte e vështirë të pranohet nga populli shqiptar i Kosovës. Fundi i fundit, për këtë politikan “neutral” të Zvicrës, populli shqiptar i Kosovës nuk është popull! Në gjuhën e këtij militanti, ata konsiderohen vetëm si “shqipfolës”² sepse, sipas interpretimit të tij, “Në të drejtën ndër-

¹ Réseau Voltaire, Interview et citation, Dick Marty : « L’indépendance du Kosovo n’a pas été décidée à Pristina »

² Asssemblée fédérale,

« Rapport de la Délégation parlementaire suisse auprès du Conseil de l’Europe, du 31.12.2008 »

http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:b2264FDLmpEJ:www.parlament.ch/sites/kb/2009/Rapport_de_la_commission_DCE_09.014_2008-12-30.pdf+%&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch, f. 9

dhe « Débat d’actualité: les conséquences de la déclaration d’indépendance du Kosovo » (16 avril 2008) – Dick Marty

<http://www.parlament.ch/d/organe-mitglieder/delegationen/deler/sessionen-archiv/april-2008/Seiten/default.aspx>

kombëtare vetëvendosja e popujve i nënshtrohet një sërë kushtesh. Një popull, që të njihet si i tillë, duhet te ekzistojë. Kosova nuk përbën një rast të tillë. Kombet e Bashkuara nuk kanë njohur kurrë më parë një vend që është ndarë nga një vend tjetër kundër dëshirës së vendit pjesë e të cilit ishte...."¹

“Sa i përket Çështjes së Kosovës e drejta ndërkombëtare është plotësisht e qartë” për Dick Marty! Në të njëjtën frymë sikurse bartësit e institucioneve shtetërore të Serbisë², Kryetari i Komisionit për Politikën e Jashtme të Këshillit të Shteteve të Konfederatës Helvetike, Dick Marty, këmbëngul se “Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara flet në tri vende për integritetin territorial serb dhe thotë se Kosova është krahinë serbe që do të administrohej përkohësisht nga ndërkombëtarët. Rusia nuk do ta kishte pranuar asnjëherë këtë rezolutë nëse ajo nuk fliste për integritetin territorial të Serbisë. Kjo rezolutë edhe sot është në fuqi, sepse vetëm Këshilli i Sigurimit mund ta modifikojë apo anulojë.”³ Për këtë arsye, sipas tij, shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe njohja e saj janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Krahas përvetësimit të interpretimit serb të së drejtës ndërkombëtare, Dick Marty shpreh revoltën e tij për prezantimin e “UÇK-së si të ishte një organizatë e virgjër dhe bamirëse.”⁴

Prandaj, në fund të intervistës së vet, ai alarmoi për rrezikun nga helmimi me një propagandë të tillë. Për Dick Marty-n dhe ata që e konsideronin UÇK-në si “instrument i amerikanëve për t’u mundësuar atyre krijimin dhe mbajtjen e bazës ushtarake më të madhe në botë”, UÇK-ja është “organizatë kriminale, që provokoi luftën, që vrau civilë të pafajshëm...”

¹ Réseau Voltaire, Intervista e cituar, Dick Marty : « L’indépendance du Kosovo... »

² Lexuesi mund t’i krahasojë qëndrimet e Dick Marty-t me qëndrimet e Ministrisë të Punëve të Jashtme të Serbisë të shprehura në Këshillin e Sigurimit dhe të cituara më lart! Nuk kanë asnjë dallim!

³ Réseau Voltaire, Intervista e cituar, Dick Marty : « L’indépendance du Kosovo... »

⁴ Po aty.

«Jeta përbëhet nga detajet, por një detaj mund të ndryshojë një jetë»¹

Një muaj pas intervistës “tërësisht profesionale”, Carla Del Ponte botoi kujtimet e saj për periudhën kur ishte Prokurore e Përgjithshme e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Në kujtimet e saj nuk mungoi as Ramush Haradinaj. Por një “detaj” nuk mundi ta përfshinte në librin e vet!

Një javë para publikimit të librit të Carla Del Ponte-s, më 3 prill 2008, përfundoi procesi i ish-Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt. Ai u lirua nga të gjitha akuzat si i pafajshëm! Ky fakt mund t’i duket një “detaj” Prokurores së Përgjithshme, Del Ponte-s. Por, ajo që “kërkon dreqin prapa detajeve” duhet ta dijë shprehjen e njohur të Goyer Rémi-t se «Jeta përbëhet nga detajet, por, një detaj mund të ndryshojë një jetë!» “Detajet” e veprimeve të prokurorëve të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë ndryshuan jetën e Ramush Haradinajt dhe të familjes së tij! Ai, për shkak të logjikës së atyre që “kërkojnë dreqin” kaloi mbi shtatë vjet i mbyllur dhe i ndarë nga familja, miqtë dhe nga skena politike e Kosovës.

Botimi i librit autobiografik të Carla Del Ponte-s, fillimisht në italisht, «La caccia, Io E I Criminali Di Guerra»², më 11 prill të 2008, në një rën nga shtëpitë botuese me famë³ në Itali dhe publiciteti i madh që e shoqëroi publikimin e tij bënë që idetë e saj të shihen si një «boom» i vërtetë.

Vlen të theksohet se nga tërë vepra e saj, mediat fokusuan vëmendjen në një element që trajton Carla Del Ponte: supozimet për trafikim të organeve njerëzore që gjoja ishte bërë nga udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Duke u bazuar në burimet e gazetarëve “të besueshëm”, të cilët nuk ia dhanë asnjëherë identitetin e dëshmitarëve as Carla

¹ Goyer Rémi, poet i shekullit XIX

² *Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës*. Në vijim do të mbështetem në botimin frëngjisht.

³ Shtëpia Botuese «Giorgio Feltrinelli», Milano

Del Ponte-s, Prokurorja e Përgjithshme e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, që në vitin 2003, zhvilloi hetime për thëniet se “oficerë të rangut shumë të lartë dhe të rangut të ndërmjetëm të UÇK-së ishin tërësisht në dijeni të trafikimit me organe, madje edhe vetë merrnin pjesë aktive në këtë trafikim.”¹ Këto burime anonime, por të “besueshme”, kishin njoftuar UNMIK-un se “gjatë muajve të verës të vitit 1999, shqiptarët e Kosovës i kishin ngarkuar nëpër kamionë treqind persona të rrëmbyer, të cilët i kishin çuar në anën tjetër të kufirit të Kosovës, në veri të Shqipërisë.”² Nga Ky numër ishte bërë përzgjedhja e të burgosurve më të rinj dhe më të shëndetshëm, të cilët ishin ushqyer mirë, ishin kontrolluar rregullisht nga mjeku dhe ishin transferuar në qendra të tjera arresti në qytetin Burrel dhe rrethinën e tij. Në një shtëpi të verdhë, ku njëra nga dhomat ishte shndërruar në klinikë kirurgjike të improvizuar, të burgosurve u nxirreshin organet. Pastaj këto organe përcilleshin në mënyrë të fshehtë drejt aeroportit të Rinasit, afër Tiranës, prej nga u dërgoheshin klinikave jashtë vendit, për t’u transplantuar pacientëve të pasur që kishin paguar për këtë ‘shërbim’.³

Përmasat e efekteve që shkaktoi kjo “informatë”, bëri që edhe ish-zëdhënësja e Prokurores së Përgjithshme, Florence Hartmann-i të deklarohet publikisht dhe ta cilësojë veprimin e Carla Del Ponte-s si të papërgjegjshëm.

Në një shkrim të publikuar në gazetën «Le Temps» dhe të titulluar «Carla Del Ponte dhe thashethemet për trafikimin me organe në Kosovë»⁴, Florence Harmann-i shpreh habinë e vet se si është e mundshme që “Carla Del Ponte, puna e të cilës konsistonte që të kërkohet e vërteta, përkundër pengesave, dhe në këtë mënyrë

¹ Carla Del Ponte, vepra e cituar, *La traque, les criminels de guerre et moi*, f.457

² Po aty, f.456

³ Po aty, f.456-457

⁴ Le Temps, Florence Hartmann, «Carla Del Ponte e les rumeurs de trafic d’organes au Kosovo», 16 prill 2008
http://www.letemps.ch/Page/Uuid/db652f96-aa10-11dd-bf59-ad3d6140ad87/Carla_Del_Ponte_et_les_rumeurs_de_trafic_dorganes_au_Kosovo

të luftohet mohimi dhe manipulimi, sot të na fundosë në kohën më të errët të propagandës.”¹

Aktualizimin e një çështjeje të mbyllur para pesë vjetësh, të mbyllur për arsye se nuk u gjet as prova më e vogël, revoltoi ish-zëdhënësen e Carla Del Ponte-s. Për Florence Harmann-in “të flitet sot, përderisa për pesë vjet nuk u soll asnjë element i ri që do ta mbështeste këtë tezë, është papërgjegjësi.”² Ndërsa “është jo dinjitoze emërtimi, në mënyrë të nënkuptueshme, i atyre që urdhëruan një krim të padëshmuar, nën arsyetimin se disa liderë shqiptar të Kosovës kanë qenë të dyshuar për krime tjera.”³

Sado “skandaloze”, të “papërgjegjshme” dhe “jo dinjitoze” të kualifikoheshin veprimet e Carla Del Ponte-s, libri i saj bëri bujë në opinionin publik dhe u shërbeu si pretekst të gjitha qarqeve që ishin të mobilizuara në kulm kundër pavarësisë së Kosovës.

Sulmet u orientuan kryesisht kundër Hashim Thaçit, ish-udhëheqësit politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili në funksionin e Kryeministrit të Kosovës, kishte shpallur pavarësinë e Kosovës, dhe kundër njerëzve më të shquar të UÇK-së që ishin të angazhuar në skenën politike.

Rreth librit të Carla Del Ponte-s dhe sulmeve që u bënë mbi bazën e këtij libri do të ndalem më gjerësisht në kapitullin e ardhshëm. Tani po kufizohem vetëm në disa aspekte.

Më 15 prill 2008, deputeti rus i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Konstantin Kosachev-i, dorëzoi propozimin për rezolutë⁴ lidhur me “trajtimin çnjerëzor të personave dhe tregtinë ilegale me organet e njerëzve.”⁵

¹ Po aty

² Po aty

³ Po aty

⁴ Conseil de l'Europe, Asssemblée Parlementaire, Doc. 11574, 15 avril 2008
Traitement inhumain de personnes et trafic illicite d'organes humains au Kosovo

<http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-ViewHTML.asp?FileID=11868&lang=fr>

⁵ Po aty,

Deputetët nënshkrues¹ të këtij propozimi u mbështetën vetëm në thëniet e Carla del Ponte-s dhe në propozimin e tyre citohet nga libri i saj se gjoja “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në vitin 1998, kishte rrëmbyer më shumë se 300 serbë, romë, shqiptarë dhe pjesëtarë të grupeve tjera etnike, të cilëve u ishin hequr organet vitale, që u dërguan nga Aeroporti i Rinasit në klinikat jashtë shtetit, për t’u transplantuar pacientëve që paguanin.”²

Sipas autorëve të kësaj rezolute, në mesin e “viktimave të UÇK-së kishte edhe qytetarë të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe sidomos moldavianë, rusë dhe rumunë”³

Një ditë pas kësaj projekt-rezolute, në sesionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të mbajtur nga 14 deri më 18 prill 2008, delegacioni parlamentar zviceran dhe ai suedez, propozuan të hapet debat lidhur me «pasojat e shpalljes së pavarësisë së Kosovës». Gjatë këtij debati, që u zhvillua më 16 prill 2008, një vend të rëndësishëm zë fjala e Dick Marty-t.

Ishte një rast i volitshëm për të që t’i përsëriste qëndrimet e mëparshme. Në fillim të fjalës së tij, Dick Marty tërhoqi vërejtjen se “ajo që është shqetësuese lidhet me bilancin e veprimeve ndërkombëtare në Kosovë.”⁴ Sipas tij ky bilanc është tejet negativ. “Pas dhjetë vjet të administrimit ndërkombëtar, Kosova gjendet pa një shoqëri të mirëfilltë civile. Të gjithë ata që preokupohen për kriminalitetin e dinë se Kosova-mjerisht!- ka qenë gjithmonë, e ndoshta sot më shumë se dje, një qendër e kriminalitetit ndërkombëtar e kriminit të organizuar (...) gjendja ekonomike është katastrofike (...) minoritetet nuk mund të jetojnë në Kosovë, pos të mbrojtur nga trupat e huaja...” Dhe, kuptohet, këtë gjendje të keqe, sipas tij, e krijoi pikërisht ndërhyrjen ndërkombëtare në Kosovë

¹ Propozim rezoluta është nënshkruar nga 17 deputet: 2 rus, 2 ukrainas, 1 serb, 1 azerbajxhanas, 1 gjeorgjian, 1 polak, 1 hungarez, 1 qipriot, 1 belg, 1 zviceran, 1 britanik, 1 holandez, 1 portugez dhe 1 finlandez.

² Po aty

³ Po aty, pika e dytë e projekt rezolutës

⁴ Raporti i cituar Asssemblée fédérale, «Rapport de la Délégation parlementaire suisse auprès du Conseil de l'Europe, du 31.12.2008», f. 9

dhe mosrespektimi i së drejtës ndërkombëtare. “Kjo filloi me bombardimet e NATO-s, bombardime në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, që u bënë pa miratimin e Këshillit të Sigurimit (...) dhe pas shkeljes flagrante të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit që garantonte integritetin territorial të Serbisë...!”¹

Nuk mund ta di saktësisht se deri në cilën shkallë ndikoi fjalimi i Dick Marty-t, i mbajtur në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës më 16 prill 2008, por, ajo që konstatohet pas këtij fjalimi është fakti se hetimet lidhur me thëniet për “trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim kundërligjor të organeve njerëzore në Kosovë” iu ngarkuan Dick Marty-t.

Në qëndrimin propagandistik të regjimit të Beogradit dhe të atyre që për shkak të verbërimit nga «antiamerikanizmi» u rreshtuan përkrah kësaj propagande, “shkelja e të drejtës ndërkombëtare dhe sidomos e rezolutës 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së” përbëjnë shtyllat kryesore për t’ia mohuar legjitimitetin shtetit të ri të Kosovës.

Të inkurajuar nga qëndrimet e qarqeve antiamerikane që shihnin “në shtetin e Kosovës bazën më të madhe ushtarake të SHBA-ve në botë” Serbia ndërmoi iniciativën për të gjetur mbështetje në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Në sesionin e 63 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të datës 8 tetor 2008, Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić-i, shtroi për miratim një projekt-rezolutë² përmes të cilës kërkohet që kjo asamble të kërkonte mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Në fjalën e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, ministri serb i punëve të jashtme i shtroi motivet e kësaj kërkesë. Ndër të tjera, ai theksoi se “më 17 shkurt 2008, institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes autonome të krahinës jugore serbe të Kosovës dhe Metohisë e shpallën njëanshëm pavarësinë. Ne e larguam mundësinë që të përdorim forcën dhe t’i vëmë sanksione

¹ Po aty,

² OKB, Asambleja e Përgjithshme, Projekt-rezoluta A/63/L.2

ekonomike kësaj krahine që kërkonte ndarjen. Serbia ka vendosur që ta mbrojë sovranitetin e vet dhe integritetin e saj territorial duke iu drejtuar diplomacisë dhe të drejtës ndërkombëtare... Sa i përket legalitetit të kësaj deklarate të njëanshme të pavarësisë, ne vendosëm të kërkojmë mendimin konsultativ nga GJND-ja. Duke e bartur këtë çështje në Gjykatë, “Republika e Serbisë vlerëson se mund të shmanget që kriza e Kosovës të mos përbëjë një precedent skajshmërisht problematik në regjionet tjera të botës apo të ambicieve për shpëtim në shumë situata ekzistuese... Ne mendojmë gjithashtu se mendimi konsultativ i Gjykatës, do të ofronte një mendim politikisht neutral dhe vendeve të shumta të cilët ende pyesin se si ta konsiderojnë shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës karshi të drejtës ndërkombëtare do tu jepte mundësi të gjenin përgjigje nga këndvështrimi juridik.”¹

Më 8 tetor 2008 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën² përmes të cilës kërkoi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë³ të japë mendim konsultativ lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Konkretisht, kësaj gjykate iu kërkua që t’i përgjigjej pyetjes: «A është shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?».

Të nesërmen, më 9 tetor, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon-i ia dërgoi këtë kërkesë Kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë⁴.

¹ Shih Proces verbalet e sesionit të 63 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të datës 8 tetor 2008 (A/63/PV.22)

http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/63/PV.22&Lang=F

² Me 77 vota për, 6 vota kundër dhe 74 abstenime projekt-rezoluta A/63/L.2 u miratua dhe mori formën e një rezolute të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (Rezoluta A/63/3, 8 tetor 2008)

Shih Proces verbalet e sesionit të 63 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të datës 8 tetor 2008 (A/63/PV.22)

http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/63/PV.22&Lang=F

³ Organi kryesor i drejtësisë së Kombeve të Bashkuara

⁴ Cour Internationale de Justice

«Conformité au droit international de la déclaration unilatérale d’indépendance relative au Kosovo (requête pour avis consultatif)»

<http://www.icj->

[cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&code=kos&case=141&k=21&p3=0](http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&code=kos&case=141&k=21&p3=0)

EPILOGU I KAPITULLIT TË SHTATË

Më 22 korrik të vitit 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli vendimin¹ lidhur me kërkesën «A është shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare».

Fillimisht GJND-ja e shqyrtoi aktin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në raport me të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare.

Në argumentimin e vet rreth kësaj çështje, GJND-ja solli faktet se “shpalljet e pavarësive ishin të shpeshta gjatë shekujve XVIII, XIX dhe XX, të cilat shpesh u shoqëruan me reagime të ashpra të shteteve nga të cilat ndaheshin. Disa prej këtyre shpalljeve rezultuan me krijimin e shteteve të reja, ndërsa disa të tjera jo. Në përgjithësi, në praktikën e shteteve shpallja e pavarësisë së një shteti nuk konsiderohet si shkelje e të drejtës ndërkombëtare. Përkundrazi, nga praktika e shteteve e kësaj periudhe del qartazi se e drejta ndërkombëtare nuk i ndaloi assesi shpalljet e pavarësive.”²

Në të njëjtin paragraf, GJND-ja sjell shembullin e krijimit të shumë shteteve të reja gjatë periudhës së dytë të shekullit XX dhe thekson se “e drejta ndërkombëtare kishte ndryshuar shumë, sidomos në raport me vetëvendosjen e popujve të shtypur, të dominuar dhe të shfrytëzuar.”³

Përveç këtyre rasteve që lidhen me periudhën e antikolonializmit, GJND-ja përmend edhe faktin e krijimit të shteteve jashtë këtij konteksti historik. “Dhe nga tërë praktika e shteteve nuk del një rregull e re e të drejtës ndërkombëtare që do ta ndalonte shpalljen e pavarësisë.”⁴

¹ Cour Internationale de Justice, Recueil des arrêts, «Avis consultatifs et ordonnance, Conformité au droit international de la déclaration unilatérale d'indépendance relative au Kosovo», Avis consultatif du 22 juillet 2010»
<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:9gmsceYi1toJ:www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf+&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch>

² Po aty, shih paragrafin 79

³ Po aty

⁴ Po aty

GJND-ja u përgjigjet edhe atyre që pohojnë se gjoja “ndalimi i shpalljes së pavarësive ngërthehet në parimin e integritetit territorial të shteteve.”¹ Sa i përket kësaj çështje, GND-ja theksoi se në rastet kur Këshilli i Sigurimit i OKB-së i kishte dënuar shpalljet e pavarësive të vendeve të caktuara, “këtë e kishte bërë jo për arsye se ato ishin shpallur të pavarura në mënyrë të njëanshme, por, për shkak të përdorimit të dhunës apo të shkeljeve të rënda të normave të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare.”²

Për këtë aspekt të problematikës lexuesi pati mundësi të njihet më gjerësisht kur u sollën shembujt e Rhodezisë së Jugut, të Republikës turke të Qipros Veriore dhe të Republika Serbska-s. Për këto situata, Këshilli i Sigurimit kishte qëndrim të qartë kundër shpalljeve të pavarësive dhe kërkonte ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të shteteve nga të cilat dëshironin të ndaheshin. Ndërsa, në rastin e Kosovës, përkundër përpjekjeve serbe dhe ruse, Këshilli i Sigurimit nuk mori asnjë qëndrim lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës e që do të konfirmonte sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën.

Pasi shqyrtoi të gjitha argumentet që kishin të bënin me këtë aspekt të kërkesës së shtruar në emër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, dhe duke konstatuar se e drejta e përgjithshme ndërkombëtare nuk përmbante asnjë pengesë për të shpallur pavarësinë, GJND-ja shpalli përfundimin e vet se “deklarata e pavarësisë së Kosovës, e datës së 17 shkurtit 2008, nuk e ka shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare.”³

Në vijim të vendimit të GJND-së, paragrafi 85-121, shqyrtohet përputhshmëria e aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe me Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

GJND-ja përsëriti faktin se Rezoluta 1244 përbënte bazën juridike të vendosjes në Kosovë të misionit civil ndërkombëtar (UNMIK-u) dhe atij të sigurisë (KFOR-i), që kishin për qëllim krijimin e

¹ Po aty, paragrafi 80

² Po aty, paragrafi 81

³ Po aty, paragrafi 84

kushteve të sigurisë së nevojshme, mbikëqyrjen e procesit të krijimit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes autonome dhe demokratike, duke pritur një zgjidhje politike (Rezoluta 1244, paragrafi 11).

Duke u bazuar në praktikën e mëparshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ku precizohen kushtet restriktive sa i përket statusit final të një territori të caktuar, GJND-ja sjell rastin e Qipros, kur Këshilli i Sigurimit rikonfirmoi pozicionin e vet se "zgjidhja e çështjes së Qipros duhet të mbështetet në Qipron si një shtet sovran, me personalitet ndërkombëtar dhe shtetësi unike, pavarësinë e saj dhe integritetin territorial të garantuar."¹

Rezoluta 1251 e Këshillit të Sigurimit, përmes të cilës konfirmohej se zgjidhja duhej të shihej në kuadër të sovranitetit dhe integritetit territorial të Qipros, u miratua më 29 qershor 1999. D.m.th. 19 ditë pas miratimit të rezolutës 1244 për Kosovën!

Përmbajtja e Rezolutës 1244 dëshmon se Këshilli i Sigurimit nuk e përcaktonte statusin final të Kosovës dhe kjo rezolutë nuk përmbante asnjë pengesë për të shpallur pavarësinë, më 17 shkurt 2008².

Për këtë arsye "grykëta doli në përfundim se rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit nuk paraqiste pengesë që autorët e deklaratës së 17 shkurtit 2008 ta shpallin pavarësinë e Kosovës nga Republika e Serbisë dhe rrjedhimisht, deklarata e pavarësisë nuk e ka shkelur rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit."³

Në fund të vendimit të vet, GJND-ja trajton përputhshmërinë e aktit të shpalljes së pavarësisë me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Për këtë çështje, ajo sjell faktet e përmendura nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në raportin⁴ e tij se "në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, të cilat u cilësuan nga të gjithë

¹ Po aty, paragrafi 114

² Po aty, paragrafi 118

³ Po aty, paragrafi 119

⁴ Conseil de Sécurité, doc. S/2007/768 të 3 janarit 2008

<http://www.un.org/fr/peacekeeping/missions/unmik/reports.shtml>

vëzhguesit ndërkombëtarë si të drejta dhe demokratike, Kosova krijoi institucionet e saja qendrore dhe lokale.”¹

Kuvendi i Kosovës, i krijuar në seancat e 4 dhe 9 janarit 2008, hodhi bazën legjitime dhe “autorët që shpallën pavarësisë e Kosovës nuk e kanë shkelur Kornizën Kushtetuese të Kosovës.”²

Pra, duke u mbështetur në argumentet e trajtuara dhe të ekspozuara në 121 paragrafë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli vendimin e vet se akti “i miratimit të deklaratës së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurtit 2008, nuk e ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit e as Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Prandaj, miratimi i kësaj deklarate nuk ka bërë shkeljen e asnjë rregulle të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare.”³

¹ Cour Internationale de Justice, cituar më lart, «Avis consultatifs et ordonnance... Avis consultatif du 22 juillet 2010», , Paragrafi 73

² Po aty, paragrafi 121

³ Po aty, paragrafi 122

PJESA E DYTË

**KUMBARIA E
«MAFIES SHQIPTARE»**

KAPITULLI I PARË

PROLOGU I KAPITULLIT TË PARË

“Shoqëria kosovare nuk është shoqëri e prekur nga kriminaliteti i organizuar, por shoqëri që bazohet te kriminaliteti i organizuar!”

“Ndarja precize territoriale dhe klanore e pjesës më të madhe të territorit të shoqërisë shqiptare i kontribuon ruajtjes së traditës që ka të bëjë me strukturën e organizuar hierarkike, me mbylljen e saj me botën e jashtme dhe me respektimin e rregullave të brendshme disiplinore tejet rigoroze. Zbatimi i kësaj discipline mundësohet falë aplikimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit, që edhe sot është në fuqi. Ai që shkel këtë kod klanor përballat me pasojat për tradhti dhe prishje marrëveshjeje...”

E veçanta e modelit të përbashkët për organizimin e brendshëm të strukturave terroriste dhe kriminale shqiptare është respektimi i parimit të ndarjes territoriale, gjithnjë duke respektuar sferat e interesit dhe zonat e ndikimit të disa familjeve.

Kështu për shembull, në Drenicë dominojnë familjet Geci, Kodra, Jashari, Selimi dhe shumica e përfaqësuesve të UÇK-së vijnë nga këto familje. E njëjta gjë vlen edhe për rajonin e Metohisë, ku familja Haradinaj ka pozitë dominuese.

Shumica e veprimeve kriminale në Kosovë dhe Metohi ndodhin brenda klaneve familjare që kontrollojnë pjesë të caktuara të territorit. Klanet janë të lidhura dhe kanë bashkëpunim të fortë me grupe të ngjashme kriminale nga vende të tjera të Evropës, para së gjithash nga Turqia, Shqipëria dhe Bullgaria, për shkak se territoret e këtyre vendeve paraqesin drejtimet kryesore nëpërmjet të cilave zhvillohet tregtia ilegale (...).

Zhvillimi i ndjenjës së identitetit kolektiv të shqiptarëve, sidomos të atyre nga Kosova dhe Metohia, është kusht i domosdoshëm për t'u marrë me kriminalitetin e organizuar. Pikërisht ky element, që bazohet në përkatësinë në një grup të caktuar, ka ndërlidhur kriminalitetin e organizuar shqiptar me idealet politike, ushtarake dhe me terrorizmin (...).

Prapa motiveve ideologjike dhe kombëtare për krijimin e një shteti të vetëm shqiptar, pavarësisht nëse do të quhet “Shqipëria e Madhe” ose “Kosova e Madhe”, fshihen interesat e disa strukturave kriminale, që përpiqen të bëhen pjesë e proceseve ekzistuese politike dhe ekonomike për të legalizuar punët e tyre kriminale (...).

Për të realizuar marrjen e kontrollit të drogës afgane, mafia shqiptare krijoi dy rrugë të reja alternative: Rrugën jugore, që shkon nga Turqia nëpërmjet Bullgarisë, Maqedonisë, Kosovës e Shqipërisë, deri në Itali dhe në vende të tjera të Evropës Perëndimore dhe Rrugën veriore, nga Turqia nëpërmjet Bullgarisë, Rumanisë e Hungarisë deri në Çeki, Sllovaki dhe në vendet të tjera të Evropës Perëndimore (...)

Në kontrollimin e këtyre dy rrugëve nga mafia shqiptare një rol të veçantë luan emigracioni shqiptar. Përveç tregtisë me lëndë narkotike, mafia shqiptare vuri nën kontrollin e saj edhe prostitucionin ndërkombëtar, tregtinë ilegale të armëve, të cigareve dhe të mallrave të tjera akcizë, të automobilëve të vjedhur, trafikimin me njerëz dhe shitjen e organeve njerëzore (...).

Shkurt, terrorizmi dhe mafia shqiptare janë problem jo vetëm i Serbisë, por i tërë rajonit, prandaj në luftën kundër tyre është i domosdoshëm një bashkëpunim i gjerë ndërkombëtar në të gjitha nivelet (...).”

Qeveria e Serbisë, «Libri i Bardhë për terrorizmin shqiptar dhe për krimin e organizuar»¹

Në këtë kapitull lexuesi do të ketë mundësi të shohë burimin e nocioneve: «fondamentalizmi islamik shqiptar», «marksizëm-leninizmi stalinist i UÇK-së» dhe «mafia shqiptare», si tri nocione që u përpiluan dhe shpërndanë me anë të “librave të bardhë “ të Shërbimit Sekret Serb me qëllim që të nxinin shqiptarët.

¹ Vlada Srbije: *Bela knjiga o albanskom terorizmu* , f.7, 8, 23, 29
<http://fr.scribd.com/doc/63883383/Vlada-Srbije-Bela-knjiga-o-albanskom-terorizmu-2003-opsti-deo>
Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji
<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

«Librat e bardhë» dhe strategjia e nxirjes së shqiptarëve!

Paralelisht me planin për ndryshimin e strukturës demografike të Kosovës, regjimi i Serbisë përgatiti strategjinë e fshehjes së gjurmëve të krimit. Për këtë qëllim u krijua Shtabi Strategjik i kontrolluar drejtpërsëdrejti nga Milošević-i, në përbërjen e të cilit ishin pjesëtarë të Shërbimit Sekret të Serbisë, me në krye Radomir Marković-in, ish-shefin e këtij shërbimi.

Në kapitullin paraprak lexuesi pati mundësi të njihej me disa aspekte të kësaj strategjie, pasojat e së cilës ndihën edhe sot.

Në këto momente kur jam duke shkruar këtë kapitull, në qytetin Raška¹ u rrënuar ndërtesa që ishte ndërtuar mbi një varrezë masive.

Siç e përmenda më lart, Brigada e 37-të e Motorizuar e Ushtrisë Jugosllave, që operonte në Kosovë që nga viti 1998, më 7 mars 1999 u transferua tërësisht nga Raška në Kosovë dhe qëndroi deri në fund të luftës. Pas përfundimit të luftës, kjo brigadë u kthye në Raška duke lënë pas vetes krimet më të përbindshme dhe duke u munduar t'i fshehtë gjurmët e tyre.

Cili do të jetë rezultati përfundimtar i hulumtimeve të eki-peve mjekoligjore mbetet të shihet. Ajo që mund të thuhet pa asnjë mëdyshje ka të bëjë me faktin se pesëmbëdhjetë vjet pas luftës, mbi një mijë familje shqiptare jetojnë në ankth të përditshëm për fatin e anëtarëve të familjeve të tyre, të zhdukur gjatë luftës.

Në vend të përgjegjësisë për krimet e bëra në Kosovë, komandanti i atëhershëm i kësaj brigade, Lubiša Diković-i, u shpall hero i popullit nga Slobodan Milošević-i. Edhe pas përmbyesjes së regjimit të Slobodan Milošević-it, ky komandant nuk dha përgjegjësi penale as për implikimin e tij në vrasje e as për fshehjen e gjurmëve të krimit. Përkundrazi, ai u ngrit pandërprerë në karrierën ushtarake dhe dymbëdhjetë vjet më vonë, ky hero i Milošević-it, u emërua Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë

¹ Qytet në jug të Serbisë, ku ishte stacionuar Brigada e 37 e Motorizuar e Ushtrisë Jugosllave para luftës së Kosovës dhe ku u tërhoq pas 12 qershorit 1999

Serbe! Shpërblimin me funksionin më të lartë ushtarak ia dha presidenti “demokrat” i Serbisë, Boris Tadić-i!¹

Avancimet e shumta të kuadrove ushtarake, policore dhe të Shërbimit Sekret Serb që kishin kryer krimet më të përbindshme në Kosovë jo vetëm që dëshmojnë të kundërtën e pretendimeve të Dick Marty-t se gjoja “Serbia e tashme nuk ka të bëjë aspak me Serbinë e Milošević-it!”, por, kjo nxjerr në shesh arsyet pse Tadić-i nuk mund të propozonte për Kosovën më shumë se propozimet që i kishte bërë Serbia në kohën e Milošević-it!

Sa i përket politikës së mosndëshkimit të krimit në Serbi, lexuesi ka pasur mundësi të njihet gjatë tërë kësaj vepre. Tani po ndalem në aspektin e strategjisë së regjimit të Beogradit që të stigmatizojë shqiptarët e Kosovës, sidomos të atyre që i rezistonin dominimit të saj në Kosovë.

Është tepër interesante të bëhet një analizë e konteksteve politike në skenën ndërkombëtare për të parë “harmonizimin” e stigmatizimit të shqiptarëve me të gjitha “etiketat” negative që ishin “në modë” në kohë të caktuar.

Kështu, për shembull, në periudhën historike të krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan, shqiptarët stigmatizoheshin si “mbeturina të Perandorisë Otomane, që dëshironin ta ruanin praninë e Turqisë në Evropë”; pas Luftës së Dytë Botërore, në kohën kur Jugosllavia socialiste kishte marrëdhënie të shkëlqyera me Bashkimin Sovjetik, shqiptarët u cilësuan si “antikomunistë” dhe “shërbëtorë të nazistëve dhe të fashistëve”; pas prishjes së marrëdhënieve të Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik² shqiptarët u akuzuan si “stalinistë”; pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 u akuzuan si “nacionalistë”, si “irredentistë”, si “separatistë” e kështu me radhë.

Në kohën e shpërthimit të luftës së armatosur dhe të shpartallimit të Federatës Jugosllave “terrorizmi me motive fetare” ishte kualifikimi më negativ në kontekstin politik ndërkombëtar. Për këtë arsye, në rrafshin ndërkombëtar, stigmatizimi i UÇK-së si

¹ Temë e trajtuar gjerësisht në Kapitullin e gjashtë të pjesës së parë.

² Në vitin 1948

“organizatë terroriste me pikëpamje fundamentaliste islamike” përbënte një nga shtyllat kryesore të orientimit propagandues të Shtabi Strategjik të pushtetit të Milošević-it.

Në funksion të kësaj strategjie, Sigurimi Shtetëror i Serbisë përgatiti materialin e titulluar «Libri i Bardhë: Terrorizmi i separatistëve shqiptarë në Kosovë dhe në Metohi»¹, të cilin e botuan të përkthyer në gjuhën angleze² dhe në gjuhën frënge³, në shtator të vitit 1998. Këtë material propagandistik Ministria e Punëve të Jashtme, e asaj që kishte mbetur nga Jugosllavia, ua shpërndau falas institucioneve me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare, institucioneve shtetërore të shteteve anëtare të OKB-së, mediave ndërkombëtare, bibliotekave universitare dhe personaliteteve me peshë në fusha të ndryshme intelektuale.

Versioni i këtij «Libri të Bardhë» u ribotua nga regjimi i Milošević-it në vitin 1999⁴ dhe në vitin 2000⁵, ndërsa në vitin 2001 dhe 2003⁶, i plotësuar dhe i modifikuar në përputhje me ndry-

¹ Министарство иностраних послова Југославије, Бела књига: Тероризам Албанских сепаратиста на Косову и Метохији, Министриа е Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Beograd, shtator 1998, f.125 (versioni elektronik), shih: <http://www.srpskapolitika.com/Izdvajamo/bela-knjiga/knjiga-1.html>

² Versioni në gjuhën angleze: Terrorisme in Kosovo and Metohija and Albania-WHITE BOOK- Federal Ministry of Foreign Affairs, Belgrade, shtator 1998, f.218

³ Versioni në gjuhën frënge: *Le terrorisme au Kosovo et en Metohie et en Albanie (Livre Blanc)*, Ministère Fédéral des Affaires Etrangères, Belgrade, shtator 1998, f. 226

⁴ Веpra е ситуар, *Злочини албанских терориста 1995-1998*

⁵ Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija : documents and evidence 1 January 1998 - 10 June 1999*, III, Part One & Part Two p. 1023, Belgrade, 2000

⁶ Vlada Srbije: *Albanski terorizam i organizovani kriminalna Kosovu i Metohiji*, Beograd, dhjetor 2003, f.189 (versioni elektronik) shih: <http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>
Albanian Terrorism and Organized Crime in Kosovo and Metohija (K&M)
BIA (Security Information Agency), Belgrade, September 2003
<http://www.kosovo.net/albterrorism.html>
Albanian Terrorism and Organized Crime in Kosovo and Metohija (K&M)
White paper published by the Serbian government, September 2003
<http://arirusila.files.wordpress.com/2008/07/albanian-terrorism-and-organized-crime-in-kosovo-and-metohija-km.pdf>

shimin e konteksteve politike ndërkombëtare, u publikua nga regjimi i “ri” i Beogradit.

Përderisa në versionin e parë të këtij materiali dominonin “etiketimet” politike dhe ideologjike (separatizmi dhe fundamentalizmi islamik), në versionet e mëvonshme shtohet stigmatizimi i bartësve të aspiratave politike të shqiptarëve të Kosovës si të ishin “grupe kriminale” dhe “mafioze”. E vetmja gjë që mbetet e përherëshme në të gjitha publikimet e Beogradit, lidhur me mobilizimet e shqiptarëve të Kosovës, është kualifikimi i shqiptarëve si “terroristë”.

Në përputhje me këndvështrimin se “terrorizmi është kërcënim global, viktimë e të cilit mund të jetë çdo shtet, qoftë i madh ose i vogël”¹, autorët e «Librit të Bardhë» vënë theksin në domosdoshmërinë e koordinimit të “luftës kundër tij si në rrafshin global, ashtu edhe në atë rajonal dhe nacional.”²

Duke e prezantuar veten si viktimë e “terrorizmit shqiptar”, autoritetet e Beogradit kërkojnë që ky “terrorizëm” të konsiderohet si një problem jo vetëm i Serbisë, por “i tërë rajonit, prandaj në luftën kundër tij është i domosdoshëm një bashkëpunim i gjerë ndërkombëtar në të gjitha nivelet.”³

Që të sigurohet mbështetja ndërkombëtare në luftë kundër “terrorizmit shqiptar”, organizatat politike që veprojnë në Kosovë paraqiten si “grupe terroriste që përdorin dhunën kundër popullsisë civile serbe, shqiptare dhe pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike që jetojnë në krahinë si dhe kundër policisë e Ushtrisë Jugosllave (...) Krahas aksioneve terroriste në nivelin lokal ata vendosin lidhje me grupet terroriste islamike që veprojnë në planin global dhe financohen në mënyrë të ngjashme si grupet e tjera terroriste, duke siguruar mjetet financiare me dhunë ose nga trafiket me drogë.”⁴

¹ Versioni në gjuhën frënge i *Le terrorisme au Kosovo...*, Belgrade, shtetëmbre 1998, f. 12-13; Versioni në gjuhën angleze f.11-12 ndërsa versioni elektronik në gjuhën serbe, f.2

² Po aty

³ Po aty

⁴ Po aty, versioni në gjuhën frënge, f.17, versioni anglez, f.15-16, versioni serb f.2

Para se të trajtoj përmasat e ndikimit të kësaj propagande, e shoh të udhës të ndalem në disa nga shtyllat e strategjisë serbe të stigmatizimit të UÇK-së. Kjo do të më mundësojë të nxjerr në pah faktet se nocionet: «fondamentalizmi islamik i UÇK-së», «marksizëm-leninizmi stalinist i UÇK-së» dhe «mafia shqiptare» janë sajuar nga Shtabi Strategjik i Milošević-it në funksion të legjitimitetit të agresionit të tyre ushtarak dhe policor në Kosovë.

UÇK-ja dhe «fondamentalizmi islamik»

Misionet diplomatike të Jugosllavisë kishin shpërndarë në të gjitha vendet me peshë në skenën politike ndërkombëtare materialin e përgatitur nga shërbimet sekrete të Serbisë, nëpërmjet të cilit “informonin” se “më tepër se 1000 mercenarë të huaj nga Shqipëria, Arabia Saudite, nga Jemeni, nga Afganistani, nga Bosnja e Hercegovina dhe nga Kroacia ishin të angazhuar në radhët UÇK-së.”¹

Për ta “shitur” më lehtë stigmatizimin e luftës çlirimtare të Kosovës si të ishte një luftë fetare, autorët e “librave të bardhë” shpërndanë gënjeshtren se gjoja “në Konferencën e 18-të Islamike, të mbajtur në Pakistan në vitin 1998, separatizmi shqiptar në Kosovë ishte cilësuar si “xhihad” dhe të gjitha vendet myslimane ishin ftuar për çlirimin e territoreve të pushtuara myslimane! (...) Në përputhje me këtë thirrje një numër islamikësh fanatikë nga Afganistani, Algjeria, Egjipti, Çeçenia, Irani dhe nga vende të tjera iu përgjigjën thirrjes dhe u përfshinë në shtabet e njëjësive komanduese të UÇK-së në Kosovë si instruktorë për stërvitje speciale ushtarake të disa formacioneve të UÇK-së.”²

¹ Po aty, versioni në gjuhën frënge, f.207, versioni anglez, f.199, versioni serb f.9

² Vlada Srbije: Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji, f.41

<http://fr.scribd.com/doc/63883383/Vlada-Srbije-Bela-knjiga-o-albanskom-terorizmu-2003-opsti-deo>

Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji

<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

Versioni anglisht, f.36

Përmes kësaj gënjeshtre synohej të manipulohesh ajo kategori e njerëzve që kishin frikë nga fundamentalizmi islamik dhe nuk kishin njohuri për zhvillimet reale. Në të njëjtën kohë, kjo gënjeshtër u shërbente politikanëve të llojit të Jean-Marie Le Pen-it që “frikësonin” evropianët me rrezikun që u kanosej të islamizoheshin nga Kosova e pavarur, apo gazetarëve dhe publicistëve që kërkonin të stigmatizonin mbështetjen që i jepej luftës çlirimtare të Kosovës sikur të ishte luftë me konotacion fetare.

Të vetëdijshëm se realiteti ishte krejtësisht ndryshe, sajuesit e kësaj gënjeshtre shpresonin se informatat nuk do të verifikoheshin. Të gjithë atyre që u ka interesuar e vërteta për pohime të tilla, kanë pasur mundësi të vërtetojnë se Konferenca e 18 Islamike nuk u mbajt në Pakistan, siç pretendohesh në këtë «Libër të Bardhë», por në Arabinë Saudite¹ dhe në datat 13-16 mars 1989. Pra, dhjetë vjet para Luftës së Kosovës! Madje, jo vetëm lufta e Kosovës që nuk ka mundur të përmendet dhjetë vjet para se të fillojë por, në këtë Konferencë Kosova nuk është përmendur fare.

Sa i përket Pakistanit, në këtë shtet është mbajtur Konferenca e 21-të Islamike nga 25-29 prilli 1993². Pra, edhe Konferenca islamike në Pakistan është mbajtur para shpërthimit të luftës në Kosovë dhe rrjedhimisht nuk kishte mundësi që të kualifikohej si “xhihad” një luftë që ende nuk kishte filluar. Gjatë Konferencës islamike të mbajtur në Pakistan në vitin 1993, në kuadër të rezolutës 7/21-P, kushtuar situatës në Bosnje e Hercegovinë, në pikën 28 të saj, përmendet edhe Kosova. Përmes kësaj rezolute “kërkohej nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së që të ndërmerret hapat e nevojshëm për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes, tani më

¹ La dix-huitième conférence islamique des ministres des affaires étrangères Riyadh, Royaume Diarabie Saoudite, 6 au 9 Cha'abane 1409-H, (13-16 mars 1989)

<http://www.oic-oci.org/french/conf/fm/18/18%20icfm-main.htm>

² La vingt-et unième conférence islamique des ministres des affaires étrangères (Session de l'unité et de la coopération islamiques pour la paix, la justice et le progrès

Karachi, République islamique du Pakistan

4-8 Zul-Oaada 1413 (25-29 avril 1993)

<http://www.oic-oci.org/french/conf/fm/21/21%20icfm-main.htm>

të tendosur, në Kosovë, në Vojvodinë, në Sanxhak dhe në Republikën e Maqedonisë.”¹

Siç shihet qartazi, qëndrimet e shprehura në këtë rezolutë nuk dallojnë aspak nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit i OKB-së. Përkundrazi, janë më pak të ashpra se qëndrimet e shprehura përmes rezolutave të Këshillit të Sigurimit.

Ndërsa në vitin 1998, në kohën kur zhvillohej lufta në Kosovë, Konferenca Islamike mbajti mbledhjen e radhës në Katar. Gjatë sesionit të 25 të kësaj organizate u miratua rezoluta 19/25-P² që kishte të bënte me situatën në Kosovë. Kjo rezolutë nuk përmbante asnjë cilësim të luftës së Kosovës si “xhihad” apo “thirrje drejtuar vendeve myslimane për çlirimin e territoreve të pushtuara myslimane”, siç gënjente propaganda serbe.

Propaganda për gjoja lidhjet e UÇK-së me ideologjinë e ekstremizmit fetar islam dhe për gjoja “instruktorë të fundamentalizmit islamik, që stërvitnin ushtarët e UÇK-së”, nuk gjeti mbështetje të gjerë, siç kishin shpresuar udhëheqësit e propagandës së regjimit të Beogradit. Përveç disa artikujve në gazeta³, ku shihej ndikimi i kësaj propagande, përpjekjet për të paraqitur UÇK-në si “organizatë terroriste me pikëpamje fundamentaliste islamike” kishin dështuar. Zhgënjimin e autoriteteve serbe për këtë dështim e shprehu publikisht ministri i Informacionit të Republikës së Serbisë, Goran Matić-i. Në një intervistë ekskluzive për gazetën “Medjunarodna politika”⁴ ai deklaroi se “është e pabesueshme se si fundamentalistët islamikë cilësohen si terroristë vetëm kur vrasin

¹ Rapport et résolution sur les affaires politiques, les minorités musulmanes, les questions juridiques, et de l'information adoptés par la vingt-et unième conférence islamique des ministres des affaires étrangères

<http://www.oic-oci.org/french/conf/fm/21/21%20icfm-political-fr.htm>

² Session Du Conseil Des Ministres Des Affaires Etrangères des Etats membres de l'OCI, 15-17 mars 1998

<http://www.oic-oci.org/french/conf/fm/25/Resolutions25-P.htm#19>

³ Të llojit të Xavier Raufer-it, vepra e cituar *La Mafia albanaise...*, f.127-128; Alexandre del Valle, «Réalité sur l'UCK», 26.12.1999, shih:

<http://www.mai68.org/textes/uck-par-del-valle.htm>; të gazetës «Marianne», apo te disa autorëve të lartpërmendur.

⁴ Përkthimi shqip: Politika ndërkombëtare.

amerikanë. Ndërsa, kur vrasin qytetarë të pafajshëm të Jugosllavisë ata cilësohen si luftëtarë të drejtësisë.”¹

Dështimi i propagandës për “instruktorë fundamentalistë islamikë që stërvitnin ushtarët e UÇK-së” dhe sidomos qëndrimet e institucioneve ndërkombëtare kundër dhunës së forcave të armatosura policore dhe ushtarake serbe e tërbuan pushtetin e Beogradit.

Ky tërbim mori përmasat e një histerie, veçanërisht pas denoncimit që William Walker-i i bëri vrasjes së civilëve shqiptarë në fshatin Reçak. Kualifikimi i Walker-it se ajo që kishte ndodhur në këtë fshat “ishte krim kundër njerëzimit” dhe se “ata që kishin dhënë urdhër për këtë krim duhej të jepnin llogari para drejtësisë” bëri që “instruktorët e fundamentalizmit islamik që stërvitnin ushtarët e UÇK-së” të harroheshin përkohësisht nga propaganda e Beogradit. Ata u “zëvendësuan” me “instruktorë ose specialistë me mbiemra amerikanë ose anglezë që kishin ardhur të stërvitnin ushtarët e UÇK-së...”. Sipas qëndrimit të ri propagandistik të regjimit serb, “ekspertët që stërvitnin ushtarët e UÇK-së kanë mundur të jenë instruktorë të Walker-it ose mercenarë të shërbimeve dhe të organizatave të tjera anglo-amerikane.”²

Lexuesit i kujtohet³ zhurma që bënë patologët e ekipit mjekoligjor serb për gjoja “zbulimin” se “tri kufomat e paidentifikuara në Reçak kishin shenja në trupat e tyre që dëshmonin se nuk kanë qenë myslimanë ose pjesëtarë të popujve që bëhen synet pas lindjes.”⁴

E tërë puna e “synetit” sillej rreth strategjisë që “komploti antiserb” t’u atribuohet “shërbimeve të huaja sekrete” të shteteve perëndimore.

¹ Radio Jugosllavia, «Double standard?», 29.08.1998

<http://www.srpska-mreza.com/Kosovo/atrocities/Klecka-2.html>

² Večernje novosti, artikulli i cituar, «SLUČAJ RAČAK PET GODINA POSLE ...»

<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.69.html:154641-SLU268AJ-RA268AK-PET-GODINA-POSLE-INSCENIRANOG-MASAKRA--Laz-u-sluzbi-tomahavka---4>

Në Kapitullin e tretë është trajtuar hollësisht manipulimi me gjoja “zbulimin e listës së 126 terroristëve” të brigadës që kishte Shtabi i UÇK-së në Reçak.

³ Edhe kjo çështje është trajtuar në Kapitullin e tretë

⁴ RTV Serbisë, dokumentari i cituar « Kosovo : Račak Laži i istine »

Krahas stigmatizimit të shërbimeve sekrete amerikane dhe britanike, si të implikuar në “përgatitjen e terroristëve shqiptarë”, nuk mungojnë autorët që implikojnë edhe shërbimin sekret francez¹ dhe atë gjerman² në lidhjet me UÇK-në.

Për ta kompletuar akuzën se gjoja “komploti kundër Serbisë vjen nga jashtë”, shteti serb denoncoi edhe “tolerancën” e shteteve të demokracive perëndimore në raport me “terroristët shqiptarë”. Këto akuza u drejtuan në veçanti kundër “tolerancës” së autoriteve gjermane dhe zvicerane. Sipas «Librit të Bardhë» “autoritetet gjermane ia kishin lënë UÇK-së kazermat e braktisura të NATO-s (në Hanover, në Nüremberg, në Bon dhe në Frankfurt) dhe qindra kampe të azilkërkuesve, ndërsa autoritetet e Zvicrës, i paskëshin lejuar “kampet paramilitare private, sallat e gjuajtjes me armë dhe klubet e sporteve luftarake për nevojat e UÇK-së.”³ Me një fjalë, sipas propagandës serbe, shumë shtete perëndimore ishin mobilizuar në komplotin kundër Serbisë!

Përkundër asaj se pas krimeve në fshatin Reçak “instruktorët anglo-amerikanë” dolën në rrafshin e parë propagandistik të regjimit të Milošević-it, ndërimi i “instruktorëve islamikë fondamentalistë” me “instruktorët anglo-amerikanë” nuk e hoqi tërësisht propagandën serbe që synonte përafrimin e UÇK-së me grupet terroriste islamike. Në të gjitha ribotimet e mëvonshme të “librave të bardhë” ky stigmatizim mundohet të mbahet gjallë duke u ilustruar me “argumente të reja”.

Duke shpresuar se konteksti i ri ndërkombëtar, i krijuar pas atentateve të 11 shtatorit 2001, ishte i favorshëm për të shpërndarë propagandën e moçme të “lidhjeve” të UÇK-së me ideologjinë “fondamentaliste islamike”, propaganda e pushtetit të “ri” të Beogradit aktivizoi arsenalin e vjetër propagandistik. Në botimin e vitit 2003 të “Librit të Bardhë” u përsërit deklarata e Milošević-it në fjalën hyrëse⁴ të procesin gjyqësor kundër tij se gjoja “në vitin

¹ Pierre Péan, vepra e cituar, *Kosovo: une guerre...*, f.121-141

² Réseau Voltaire, «L'UÇK, une armée kosovare sous encadrement allemand» (UÇK-ja - Ushtria kosovare nën drejtimin gjerman)
<http://www.voltairenet.org/article615.html>

³ Versioni në gjuhën frënge i «Le terrorisme au Kosovo...», f. 209, Versioni në gjuhën angleze f.204, ndërsa versioni elektronik në gjuhën serbe, f.9

⁴ Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi

1995 Osama Bin Laden-i kishte qëndruar në Shqipëri, si mysafir i presidentit të atëhershëm, Sali Berishës.”¹

Shërbimet sekrete serbe shpërndanë “informatën” se gjoja “në atë kohë janë formuar bazat për mbështetje logjistike dhe për përkrahje financiare të organizatës Al Kaeda dhe celulat e saj në Kosovë dhe në Metohi.”² Sipas kësaj propagande, përveç Bin Ladenit “në atë takim kanë qenë të pranishëm edhe Muhamet Al-Zawahiri, vëllai i ideologut të Al Kaedas, Ajman Al-Zawahiri-t, ndërsa nga pala shqiptare, përpos presidentit Berisha, të pranishëm ishin edhe Bashkim Gazideda, ish-shef i policisë sekrete të Shqipërisë, Hashim Thaçi dhe Ramush Haradinaj...”³

Shpërndarja e kësaj dezinformate synonte pezmatimin e opinionit publik perëndimor e në veçanti opinionin amerikan që kishte mbështetur luftën kundër regjimit të Milošević-it. Gënjeshtra se Osama Bin Laden-i kishte qëndruar në Kosovë dhe se gjoja kishte krijuar bazat e Al Kaedas në këtë pjesë të Evropës ishte gënjeshtra më skandaloze që trilloi Shërbimi Sekret Serb. Fatkeqësisht, edhe pse shumica e autorëve që e përmendin këtë “informatë” theksojnë se është “e pabesueshme që Bin Laden-i të ketë qëndruar në Shqipëri”⁴, kjo “informatë” gjeti një vend të konsiderueshëm në mediat dhe në veprat e autorëve të ndryshëm perëndimorë. Dhe si e tillë, ajo paraqet një mundësi për vazhdimin e manipulimeve me lexuesit e painformuar.

Procesi kundër Slobodan Milošević-it, Traskriptet e seancave:
Fjala hyrëse e të akuzuarit Slobodan Milošević-it, 15 shkurt 2002, f. 241
<http://www.hlc->

[rdc.org/Transkripti/Milosevic/Transkripti/Transkripti%20sa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20%28%29/Transkript%20sa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20-%2015.%20februar%202002..pdf](http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/Transkripti/Transkripti%20sa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20%28%29/Transkript%20sa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20-%2015.%20februar%202002..pdf)

¹ Vlada Srbije: Albanski terorizmi i organizovani kriminalna Kosovu i Metohiji, f.40

<http://fr.scribd.com/doc/63883383/Vlada-Srbije-Bela-knjiga-o-albanskom-terorizmu-2003-opsti-deo>

<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>, ndërsa versioni anglisht, f. 35

² Po aty, f.40

³ Po aty, f.40

⁴ Si për shembull, Jean-Arnauld Derens, RFI, « Pour Slobodan Milosevic, la meilleure des défenses reste l'attaque », 31.10.2001, http://www1.rfi.fr/actu/fr/articles/022/article_11319.asp dhe « Le piège du Kosovo », f.196)

UÇK-ja dhe “ideologjia marksiste-leniniste”

Sado e pabesueshme t'i duket dikujt që një grup i caktuar të stigmatizohet në të njëjtën kohë si “fondamentalist islamik” dhe si i majtë ekstrem i tipit stalinist të Enver Hoxhës, pra ekstremist fetar dhe ithtar i ideologjisë që kishte ndaluar besimin fetar në Shqipëri, teksti i përgatitur nga shërbimet sekrete jugosllave dhe serbe kundër UÇK-së është shembull i këtij “paradoksi propagandistik”¹.

Për ta përforcuar idenë e përkatësisë ideologjike të ekstremit të majtë, më shumë se gjysma e «Librit të Bardhë», botimi i vitit 1998, i kushtohet influencës ideologjike të Shqipërisë së periudhës komuniste të udhëheqësit të UÇK-së në Kosovë. Në përputhje me këtë qëllim, një rol tepër i rëndësishëm iu vesh Shërbimit Sekret të Shqipërisë. Që ky rol të jetë i besueshëm për lexuesit e painformuar, arsenali propagandistik serb “zbuloi” njeriun kyç të Sigurimit shqiptar, Xhavit Halitin², si ndërlidhje me UÇK-në.

Në vijim do të ndalem shkurtimisht në rastin e Xhavit Halitit, sepse është domethënëse për ndikimin e gënjeshtreve të përpiluara në laboratorët e propagandës serbe dhe të përçuara nga “sinapsat” e lartpërmendura të këndvështrimit ideologjik të «antiamerikanizmit».

E shoh të udhës të informoj lexuesin, në mënyrë “telegrafike”, se Xhavit Haliti është i lindur më 8 mars 1956 në fshatin Novo Sellë të Pejës, në Kosovë. Në vitin 1981, si student i Universitetit të Prishtinës, u arrestua për pjesëmarrje në demonstrata. Në vitin 1983 u detyrua të shkonte në shërbimin ushtarak. U arrestua për motive politike dhe u dënua me një vit e gjysmë burg. Pas vuajtjes së dënimit u kthye në Kosovë. Në nëntor të vitit 1985, pas fushatës së arrestimeve që ndërmorën forcat policore serbe kundër veprimtarëve të rezistencës, Xhavit Haliti u detyrua të

¹ Vlada Srbije: *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, Për stigmatizimin si e majtë ekstreme shih f. 12 ndërsa për fondamentalizmin islamik në faqet 40-44
<http://fr.scribd.com/doc/63883383/Vlada-Srbije-Bela-knjiga-o-albanskom-terorizmu-2003-opsti-deo>
<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>
versioni anglisht, f. 3 dhe 35-37

² Xhavit Haliti ishte njëri nga gjashtë përfaqësuesit politikë të UÇK-së.

kalonte në klandestinitet dhe në mars të vitit 1986 u largua nga Kosova dhe kërkoi strehim politik në Zvicër.

Ky sqarim i shkurtër është më shumë se i domosdoshëm, sepse në shkrimet e atyre që kanë rënë nën ndikimin e propagandës serbe, “prapa emrit të rrejshëm të Xhavit Haliti fshihet një nga mendjet kryesore të UÇK-së, që vjen nga veriu i Republikës së Shqipërisë dhe njeri i Shërbimit Sekret Shqiptar (Sigurimi).”¹ Christophe Chiclet-i dhe Kolë Gjeloshaj nuk janë të vetmit që shpërndajnë gënjeshtret e sajuara nga Shërbimi Sekret Serb. Kështu, Pierre Arnold-i, Kolonel Lejtenant, hulumtues në Qendrën Strategjike Evropiane për Siguri Inteligjente, plasoi gënjeshtren se gjoja në të kaluarën “Xhavit Haliti kishte qenë shef i Shërbimit Special i Tiranës (Sigurimit).”² Ndërsa për Xavier Raufer-in dhe Stéphane Quéré-në “Xhavit Haliti (...) gjatë kohës së regjimit stalinist në Shqipëri kishte qenë këshilltar i Enver Hoxhës, ndërsa sot është i lidhur me shërbimet e veçanta dhe me qeverinë e Tiranës.”³

Përveç historianëve, sociologëve, kriminologëve, gazetarëve dhe analistëve të ndryshëm që shpërndanin gënjeshttra për udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të UÇK-së, të njëjtën gjë e bënë edhe disa “shërbime inteligjente” të shteteve perëndimore!

Po përmend dy raporte që janë publikuar në internet dhe që shërbejnë si referencë për një numër të madh autorësh: «Raporti sekret informativ i KFOR-it amerikan dhe i NATO-s»⁴ dhe «Raportin e Shërbimit Sekret të Gjermanisë (BND-së)»⁵.

¹ *Confluence Méditerranée*, Christophe Chiclet et Kolë Gjeloshaj, Biographies, No 30 Été 1999,

Editions l’Harmattan, f. 178

Shkrimi është publikuar edhe në internet: http://www.revues-plurielles.org/_uploads/pdf/9_30_19.pdf

² Pierre Arnold, « Kosovo: une république en kit-Quel crédit accorder à la classe politique kosovare? »

http://www.esisc.org/upload/publications/analyses/kosovo-une-republique-en-kit-quel-credit-accorder-a-la-classe-politique-kosovare/KOSOVO%20_%20UNE%20REPUBLIQUE%20EN%20KIT.pdf

³ Xavier Raufer-in dhe Stéphane Quéré, vepra e cituar, *La mafia albanaise...*, f. 95

⁴ SECRET Rei USA KFOR and NATO. J2 SPECIAL PROJECTS, Mars 2004, f.41

⁵ BND Kosovo Feb 2005 vs Vertraulich

Sa i përket disa aspekteve tjera të këtyre raporteve, të cilët citohen shumë shpesh nga autorë të ndryshëm, do të flas më poshtë. Tani po kufizohem vetëm në informatat që përmbajnë për Xhavit Halitin.

Pos disa të dhënave që publikohen në funksion të rritjes së besueshmërisë së raportit, si numri i telefonit i Xhavit Halitit, adresa e tij, pjesëmarrja në tubime publike të Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar kryesie i së cilës ishte, gati të gjitha¹ informatat e tjera ishin informata të nxjerra nga «Libri i Bardhë», botimi i vitit 2003. Madje, “Raporti sekret informativ i KFOR-it amerikan dhe i NATO-s” shkoi aq larg sa edhe fotografinë e Xhavit Halitit e kishte marrë nga ky botim i “librit të bardhë” ! Me të vetmin ndryshim se versioni elektronik i librit të përpiluar nga Shërbimi Sekret Serb është “bardh e zi”, ndërsa në Raportin e “KFOR-it amerikan” Xhavit Haliti paraqitet me “ngjyra”! Ndoshta kjo metodë mund t’i kursejë nga akuza për “plagjiaturë” ose nga përdorimi i teknikës “copy-paste” të “mbledhjes” së informatave!

АЛБАНСКИ ТЕРОРИЗАМ И ОРГАНИЗОВАНИ КРИМИНАЛ НА КОСОВУ И МЕТОХИЦИ



129. ЦАВИТ (Мехмет) ХАЉИТИ, звањи "Зека"

Рођен 08.03.1956. године у Новом Селу, општина Пећ.

Осамдесетих година, био је члан илегалних екстремних организација које су, у својим платформама, прецизирале циљеве отцепљења КиМ из састава Републике Србије и његовог прикључења Албанији. Након неуспелог покушаја његовог хапшења у Приштини, када је, пружајући оружани отпор, рањено једног припадника РЈДБ, отишао је у Швајцарску, где је добио статус политичког азиланта. Постао је члан ужег руководства НПК за подручје западне Европе, а као једна од водећих личности тадашње ОВК, био је члан делегације са КиМ у Рамбуџу. Члан је председништва ДПК и посланик Скупштине Косова.

Почетком 1991. године, директно је организовао убацивање веће количине оружја и муниције на подручје Пећи, при чему је као везе ковретио Ѓима Авиметаја, из Стрвца, општина Печани.

SECRET Rel USA KFOR and NATO

J2 SPECIAL PROJECTS

TARGET FOLDER



10 Mar 2004

1. IDENTIFICATION

1.1. Basic info

NAME	HALITI
FIRST NAME	Xhavit
ID Number	Unknown
Also Known As	ZEKA Ozekao
Ethnicity	K-ALBANIAN
Nationality	Unknown

Xhavit Haliti në «Librin e Bardhë» serb Xhavit Haliti në Raportin e KFOR-it amerikan

<http://fr.scribd.com/doc/22922472/Bnd-Kosovo-Feb-2005-vs-Vertraulich>

¹ Krahaso me informatat e publikuara në faqet 162-163 të «Librit të Bardhë» Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji <http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

Edhe në këtë raport, që pretendon të jetë i “mirinformuar”, Xhavit Haliti vihet në lidhje me Shërbimin Informativ Shqiptar (SHISH) dhe me Sigurimin, strukturë që i parapriu SHISH-it. Por, për nga funksioni ai vihet në një shkallë të ulët! Në faqen 6 të këtij raporti, në pikën 5.4 të tij, theksohet se Xhavit Haliti, para luftës së Kosovës, kishte qenë truprojë dhe shoqërues i Fatos Klosit, shefit të Shërbimit Informativ Kombëtar të Shqipërisë!

Të njëjtat informata i publikoi edhe Raporti i lartpërmendur i Shërbimit Sekret të Gjermanisë në faqen 7, në pikën 2.1.

Këto gënjeshtër të kamufluara si “informacione sekrete” por, që shpërndahen falas edhe përmes internetit, kanë mundësi të “shiten si të vërteta” te lexuesit e vendeve të huaja, të cilët nuk e dinë se fizikani i njohur i Shqipërisë, Fatos Klosi, para luftës së Kosovës ka qenë profesor universiteti dhe pas përfundimit të funksionit drejtues në kuadër të Shërbimit Informativ Shtetëror, në vitin 2002, iu kthye Katedrës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës¹.

Praktikisht, para se të shpërthente lufta në Kosovë, as Xhavit Haliti e askush tjetër nuk ka mundur të jetë “truproje dhe shoqërues” i Fatos Klosit në funksionin që nuk e ka pasur! Në cilësinë e profesorit universitar ai më së paku ka pasur nevojë për “truproje apo shoqërues”.

Mund të sjell me dhjetëra citate të kësaj natyre që nxjerrin në shesh manipulimin me njerëzit që nuk e dinë se Xhavit Haliti as ka lindur në veri të Shqipërisë, as ka qenë në Shqipëri para se të vdiste Enver Hoxha e as ka pasur moshën për të qenë këshilltar i Enver Hoxhës. Nga mosha 20-vjeçare, kur u regjistrua në Universitetin e Prishtinës (1976) e deri në vitin 1986, kur u detyrua të largohej nga Kosova, Xhavit Haliti ka qenë vazhdimisht në aktivitet kundër regjimit të Beogradit dhe i përndjekur prej tij. Enver Hoxha vdiq më 11 prill 1985. Sikur t’i dinin këto të dhëna, nuk e përjashtoj mundësinë që manipuluesit e lartpërmendur dhe të llojit të tyre, të hidhnin hipotezën se “diktatori i Shqipërisë vdiq nga mërzia se nuk e kishte parë asnjëherë këshilltarin e tij!”

¹ Aktualisht është shef i kësaj katedre

UÇK-ja dhe «krimi i organizuar»

Që të shmanget mundësia e daljes në shesh të paradoksit që vë në të njëjtin rrafsh ekstremizmin fetar dhe të majtën ekstreme, autorët që përpiluan “librat e bardhë” për të nxirë shqiptarët, sajuan nocionin «mafia shqiptare».

Në strategjinë e Shërbimit Sekret të Beogradit “krimi i organizuar” doli si ura ndërlidhëse e “fondamentalizmit islamik” dhe “marksist-leninistëve të tipit stalinistë”. Kjo ndërlidhje përshkon të gjitha botimet e shërbimeve sekrete serbe. Por, në botimin e “Librit të Bardhë» të vitit 2003, Qeveria e re e Serbisë e vendosi “krimin e organizuar” në titullin e librit¹.

Qëllimin e botimit në këtë formë e bënë publik autoritetet më të larta shtetërore serbe. Në konferencën për shtyp të datës 7 dhjetor 2003, të mbajtur në sallën e Kuvendit të Republikës së Serbisë, në praninë e shumë gazetarëve vendës dhe të huaj, kryeministri i Serbisë, Zoran Živković-i², i shoqëruar nga zëvendës-kryeministri dhe shefi i Qendrës Koordinuese për Serbinë Jugore dhe për Kosovën dhe Metohinë, Nebojša Čović-i, si dhe nga shefi i Shërbimit Sekret Serb (BIA)³, Miša Milićević-i, publikuan «Librin e Bardhë» të titulluar «Terrorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar në Kosovë dhe Metohi»⁴.

Në këtë konferencë për gazetarët kryeministri serb deklaroi se “qëllimi i publikimit të këtij libri është t’u ndihmohet atyre që duhet të veprojnë kundër kriminalitetit të organizuar, para se gjithash UNMIK-ut dhe KFOR-it (...). Është përfolur se gjoja nuk ka prova të mjaftueshme për të ndërmarrë veprime të tilla, se u

¹ *Albanski terorizam i organizovani kriminalna Kosovu i Metohiji* (Terrorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar në Kosovë dhe Metohi)

² I cili u emërua në këtë funksion pas vrasjes së kryeministrit të mëparshëm Zoran Đinđić-it

³ Bezbednosno Informativna Agencija (Agjencia Informative e Sigurisë) ishte emërimi i ri i Shërbimit Sekret të Serbisë

⁴ Vepra e cituar *Albanski terorizam i organizovani kriminalna Kosovu i Metohiji* <http://www.srpskadijaspora.info/vest.asp?id=4093>
Albanian Terrorism and Organized Crime in Kosovo and Metohija (K&M) White paper published by the Serbian government, September 2003
<http://www.kosovo.net/albterrorism.html>

mungojnë faktet konkrete e kështu me radhë. Libri «Terrorizmi Shqiptar dhe Kriminaliteti i Organizuar në Kosovë dhe Metohi» ofron mjaft sqarime dhe fakte për krimet e kryera në Kosovë dhe Metohi, të cilat mund të jenë mjaft interesante edhe për punën e Gjykatës në Hagë¹ - theksoi Zoran Živković-i.

Përveç “ndihmës” që autoritetet e Serbisë dëshironin t’i jepnin UNMIK-ut dhe KFOR-it, udhëheqësit e lartpërmendur shtetërorë serbë pretendonin se “materialet e këtij libri mund të jenë një ndihmë e madhe për policitë e disa vendeve të Evropës Perëndimore, ku segmentet e kriminalitetit të organizuar si prostitucioni, tregtia me njerëz dhe droga janë në lidhje të drejtpërdrejtë me grupet kriminale nga Kosova dhe Metohija.”²

Është interesant të theksohet se në këtë konferencë për shtyp, për herë të parë publikisht pranohet se «Libri i Bardhë» ishte përpiluar nga shërbimet sekrete. Të gjithë të pranishmit i thurën lëvdata të veçanta shefit të Shërbimit Sekret Serb, Miša Milićević-it, sepse “falë pjesëtarëve të kësaj agjencie dhe ndihmës së shërbimeve të tjera vendore të sigurisë, të cilët mblodhën intensivisht materialet dhe të dhënat, u publikua ky libër.”³

Nebojša Čović-i përsëriti orientimin strategjik të përcaktuar nga regjimi i vjetër i Beogradit, pjesë e të cilit kishte qenë edhe vetë, e që konsiston në mobilizimin ndërkombëtar kundër “terrorizmit shqiptar”. “Terrorizmi në Kosovë dhe Metohi nuk është vetëm problem yni, por, i tërë rajonit, prandaj në luftën kundër tij është i domosdoshëm bashkëpunimi i gjerë ndërkombëtar në të gjitha nivelet” - theksoi Čović-i.

Gjatë konferencës për gazetarët nuk mungoi optimizmi se për shkak të “sqarimeve” që bën ky libër, “të dhënat për strukturën e organizimit terrorist të ekstremizmit shqiptar, të dhënat për viktimat, veprimtaria e mafies shqiptare në botë, si dhe lista e terroristëve dhe e strukturave të organizuara kriminale në Kosovë

¹ Konferenca për gazetarë për librin «Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji» <http://www.srpskadijaspora.info/vest.asp?id=4093>

² Po aty

³ Po aty

dhe Metohi, do të ndihmojë të përcaktohen standardet për trajtimin e njëjtë të terrorizmit në të gjitha hapësirat dhe përgjigjja ndaj këtij libri do të jetë forcimi i luftës jo vetëm në rajon por edhe në tërë Evropën.”¹

Optimizmin, se kësaj radhe propaganda e tyre do të kishte ndikim më të madh sesa botimet paraprake të «Librit të Bardhë», Nebojša Čović-i dhe Miša Milićević-i e mbështesin në gjoja “ndryshimet e mëdha demokratike që kishin ndodhur në Beograd në krahasim me Kosovën dhe që duhet të përkrahen nga bota, sepse ndryshime të tilla nuk kanë ndodhur në Prishtinë. Në Kosovë dhe Metohi të gjithë liderët politikë janë në të njëjtën kohë edhe udhëheqës të klaneve kriminale”² theksoi Nebojša Čović-i.

“Serbia e tashme nuk ka të bëjë aspak me Serbinë e Milošević-it!” e përsërit Dick Marty pas pesë vitesh pa e cituar burimin e referimit.

Meqë ndryshimet e personave në strukturat udhëheqëse të Serbisë mundohen të paraqiten si “ndryshime të mëdha demokratike” e shoh të udhës të ndalem rreth kësaj çështjeje. Është e rëndësishme të shihet se kush flet për “ndryshime demokratike” dhe çka nënkuptojnë këto ndryshime në qëndrimet e udhëheqësve të “rinj” të Beogradit dhe argatëve të tyre në perëndim!

Nebojša Čović-i ishte komunist i shquar i partisë së Milošević-it, i cili me mbështetjen e këtij të fundit ushtroi funksionin e drejtorit në disa ndërmarrje publike. Në vitin 1993, me përkrahjen e drejtpërdrejtë të Milošević-it, Nebojša Čović-i u bë kryetar i Këshillit bashkiak të Beogradit, ndërsa në vitin 1994 u caktua në postin e kryetarit të bashkisë së kryeqytetit të Serbisë. Këtë funksion e ushtroi deri në vitin 1997.

Pasi u dëbua nga rrethi i ngushtë i Milošević-it, Nebojša Čović-i formoi Alternativën Demokratike, të cilën në vitin 2000 e shkriu në Partinë Social-Demokrate të Serbisë. Në qeverinë e parë pas Milošević-it, ai u emërua bashkëkryetar, ndërsa në Qeverinë e Zoran Đinđić-it mori funksionin e zëvendëskryeministrit dhe në të

¹ Po aty

² Po aty

njëjtën kohë u caktua shef i Qendrës Koordinuese për Serbinë Jugore dhe për Kosovën dhe Metohinë. Këtë funksion e ruajti edhe pas vrasjes së kryeministrit serb, Zoran Đinđić-it.

Në cilësinë e këtij funksioni, Nebojša Čović-i u takua disa herë edhe me Carla Del Ponte-n të cilës ia dorëzoi dosjen e përgatitur nga Departamenti i Jurisprudencës që funksiononte në kuadër të qendrës koordinuese që udhëhiqej prej tij. Mbi 27 mijë faqe¹ të përgatitura nga Shërbimi Sekret Serb “me të dhëna për strukturën e organizimit terrorist të ekstremizmit shqiptar, të dhëna për viktimat, për veprimtarinë e mafies shqiptare në botë... për listën e terroristëve dhe strukturave të organizuara kriminale në Kosovë... për liderët politikë të Kosovës që ishin në të njëjtën kohë edhe udhëheqës të klaneve kriminale... për trafikimin e organeve njerëzore të serbëve të burgosur... dhe mjaft sqarime dhe fakte për krimet e kryera në Kosovë, të cilat mund të jenë mjaft interesante edhe për punën e Gjykatës në Hagë...”²

Për takimet e Carla Del Ponte-s me Nebojša Čović-in dhe udhëheqësit tjerë të Beogradit si dhe për ndikimin e saj nga këto burime informatash do të flas më poshtë. Tani po vazhdoj me atë çka fshihej realisht prapa pretendimeve për gjoja “ndryshimet e mëdha demokratike që kishin ndodhur në Beograd”.

Po ndalem shkurtimisht në Shërbimin Sekret të Serbisë, në atë shërbim që kishte përgatitur “Librin e Bardhë për terrorizmin shqiptar dhe krimin e organizuar në Kosovë”.

Edhe pse do të ishte shumë e vlefshme të nxirrej në shesh tërësia e strukturës së Shërbimin Sekret të Serbisë dhe mënyrës së funksionimit të tij, në këtë vepër do të ndalem vetëm në disa të dhëna që nxjerrin në shesh se pas përmbysjes së Milošević-it nga pushteti dhe ekstradimit të tij në Hagë, strukturat e Shërbimit Sekret të Serbisë mbetën të paprekura.

¹ Miroslav Antić, «Obmane Delponteove» (Mastrimet e Del Ponte-s)
<https://www.mail-archive.com/sim@antic.org/msg09784.html>

² Terminologjia që u përdor në konferencën e lartpërmendur për «Librin e Bardhë»

Në hulumtimin ekskluziv për gazetën beogradase «Vreme», Dejan Anastasijević-i theksoi se kur bëhet fjalë për Shërbimin Sekret Serb nuk duhet të harrohet se kemi të bëjmë “me një organizatë që për dekada të tëra ka qenë mjeti i mbikëqyrjes politike dhe i shtypjes. Gjatë sundimit të Milošević-it kjo organizatë u bë tërësisht e kriminalizuar.”¹

Një nga objektivat e pushtetit të udhëhequr nga Zoran Đinđić-i ishte reforma e këtij shërbimi. Ai u vra më 12 mars 2003. Nuk mund të thuhet se deri në cilën shkallë vrasja e kryeministrit serb nga njerëzit e këtij shërbimi ndikoi në pamundësimin e reformës. Ajo që është e sigurt në këtë rast lidhet me faktin se pjesë të tëra të Sigurimit Shtetëror, që kishte përgatitur dhe ekzekutuar atentatet kundër Ivan Stambolić-it, Vuk Drašković-it, Slavko Ćuruvija-s, ishin të implikuara edhe në vrasjen e Zoran Đinđić-it.

Gazetari hulumtues serb, Dejan Anastasijević-i, alarmoi se përkundër faktit që “u dëshmuua se 15 të akuzuarit për atentatin kundër kryeministrit serb ishin zyrtarë aktivë ose bashkëpunëtorë shumëvjeçarë të BIA-s, Qeveria e Serbisë edhe sot e kësaj dite nuk e sheh nevojshme të ndryshojë diçka thelbësore në këtë shërbim.”²

Alarmi për rrezikun që paraqiste Shërbimi Sekret Serb desh i kushtoi shumë shtrenjtë Dejan Anastasijević-i. Ai dhe familja e tij i shpëtuan atentatit që u bë ndaj tyre³.

Ky gazetar serb denoncoi faktin se, përveç udhëheqësit të Njësisë për Operacione Speciale, Milorad Ulemek-Legija-s, zëvendësit të tij, Dušan Maričić Gumar-it dhe shefit të Shërbimit, Radomir Marković-it, asnjë nga pjesëtarët e Sigurimit Shtetëror nuk u largua nga detyra. Përkundrazi, me anë të rokadave dhe të transferimeve të kuadrove nga një drejtori në tjetrën, një pjesë e

¹ Vreme, Dejan Anastasijević, «Večni plamen» (Flaka shekullore), Nr. 666, 09.10.2003 <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=354426>

² Po aty

³ Për këtë atentat shih artikullin “Pokušaj Ubistva Dejana Anastasijevića i njegove porodice” (Përpjekje për t’i vrarë Dejan Anastasijević-in dhe familjen e tij) Vreme | br 850 | 15. april 2007, <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=495476>

madhe e pjesëtarëve të këtij shërbimi, që ishin të implikuar në krime, ishin avancuar në funksione edhe më të larta.

Nuk po sjell skemën organizative të dhjetë drejtorive të Shërbimit Sekret Serb dhe lëvizjet e personelit në funksion të ruajtjes së kuadrove të shkolluara dhe të edukuara në frymën e regjimit diktatorial të Milošević-it. Po ndalem vetëm në shembullin e Qendrës së Shërbimit Sekret për kryeqytetin serb, për shkak të rolit të madh që ka luajtur kjo qendër në rrjedhat politike të Serbisë.

Deri më 5 tetor të vitit 2000, në krye të Qendrës së Shërbimit për qytetin Beograd ishte Milan Radonjić-i, i akuzuar për atentatin ndaj Vuk Drašković-it, kundërshtarit të Milošević-it. Milan Radonjić-i u lirua nga akuza në “mungesë provash”!

Në krye të Seksionit të Parë të Kundërzbulimit të Qendrës Beograd ishte Goran Živković-i, ndërsa në krye të Seksionit të Dytë ishte Miša Milićević-i. Të dy u morën në pyetje për vrasjen e kryeministrit serb dhe të dy u liruan në “mungesë provash”!

Në vend të ndëshkimit, ata fillimisht u shkarkuan nga detyrat që kishin në kuadër të Shërbimit për Beogradin si Qendër dhe, pak kohë më vonë, u emëruan në funksionet më të larta të Shërbimit Sekret të Serbisë! Kështu, “ish-shëfi i Seksionit të Dytë të Kundërzbulimit për Beogradin, Miša Milićević-i, u emërua shëf i Agjencisë Informative të Sigurisë (BIA), ndërsa ish-shëfi i Seksionit të Parë të Kundërzbulimit të Qendrës Beograd, Goran Živković-i, u bë zëvendësshëf i Agjencisë Informative të Sigurisë (BIA).”¹

Mund të vazhdoj me listën e shembujve që tregojnë se nëpërmjet rokadave të tilla të kuadrove Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të Serbisë mbeti i njëjtë si gjatë sundimit të Slobodan Milošević-it. Mendoj se shembulli i mësipërm është domethënës se për çfarë “reformë demokratike të shërbimit sekret” pretendojnë autoritetet e Beogradit.

Është pikërisht i njëjti Miša Milićević-i, njëri ndër kuadrot më besnikë të Milošević-it, i arrestuar dhe i marrë në pyetje për vrasjen e

¹ Dejan Anastasijević, artikulli i cituar, «Večni plamen»

kryeministrit serb, i cili së bashku me kryeministrin e “ri” serb, Zoran Živković-in dhe zëvendëskryeministrin, Nebojša Čović-in, përpiqeshin të bindnin gazetarët vendës dhe të huaj se në Serbi kanë ndodhur “ndryshime të mëdha demokratike”.

Me një fjalë, strukturat e vjetra të regjimit të Milošević-it, të kamufluar me petkun e funksioneve të reja dhe në një kontekst të ri historik që karakterizohet me tërheqjen e forcave politike, ushtarake dhe policore serbe nga Kosova, i përcaktuan vetes si qëllim t’i “informojnë” institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe shtetet e demokracive perëndimore për rrezikun që i kanosej rajonit dhe botës nga «mafia shqiptare».

Botimet publike paraqesin vetëm një pjesë të asaj që institucionet e ndryshme shtetërore jugosllave dhe serbe shpërndajnë në gjuhë të ndryshme për “të sqaruar” botën për këtë rrezik.

Sipas Nebojša Čović-it “librat e bardhë” të publikuar nga autoritetet e Beogradit “paraqesin vetëm segmente nga ajo masë e madhe të dhënash që kanë në zotërim organet shtetërore të Serbisë dhe që shpjegojnë gjenezën e lindjes së problemeve në Kosovë.”¹

E megjithatë, nga tërë ajo “masë e madhe të dhënash” gjatë periudhës 1998-2003, herë në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, herë në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë, u shpërndanë në formë librash mbi 2000 faqe materiale² dhe 27 mijë faqe në formë CD-sh. Para se të trajtoj disa nga efektet e kësaj propagande, po ndalem edhe në disa aspekte të përmbytjes së “librave të bardhë”.

¹ Vepra e cituar, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*

² Vetëm botimi në gjuhën angleze i muajit mars të vitit 2000 ishte në dy vëllime dhe kishte 1023 faqe!

UÇK-ja dhe «mafia shqiptare»

Sajimi i «kriminalit të organizuar», si urë ndërlidhëse midis fundamentalist islamik» dhe «marksist-leninistëve të tipit stalinist», paraqitet në mënyrë që të jetë në përputhje me rezultatet e disiplinave shkencore rreth nocionit të «mafies». Duke shfrytëzuar rezultatet e analizave antropologjike, sociologjike dhe historike për mafien italiane, autorët e «Librit të Bardhë» të Shërbimit Sekret Serb interpretojnë realitetin e Kosovës në përputhje me nocionet që u përdorën për të analizuar realitetin italian të kohës kur lindi mafia.

Ngjashëm si në Sicili, ku shteti italian nuk arriti t'i imponojë normat e veta legjitime në jug të vendit, sipas propagandës serbe, në veri të Shqipërisë dhe në Kosovë mbijetoi një formë e modelit feudal të organizimit shoqëror në të cilin familja, fisi, klani dhe kodet e moçme u rezistuan depërtimit të normave ligjore të shtetit.

Në vijim po sjell një pjesë të gjatë nga «Libri i Bardhë», që do të na mundësojë, më pas, të shohim ndikimin e tij në stigmatizimin e shqiptarëve.

Sipas “hulumtimeve” të Shërbimit Sekret Serb “*ndarja precize territoriale dhe klanore e pjesës më të madhe të territorit të shoqërisë shqiptare i kontribuon ruajtjes së traditës që ka të bëjë me strukturën e organizuar hierarkike, mbylljes së saj me botën e jashtme dhe respektimit të rregullave të brendshme disiplinore tejet rigorozë. Zbatimi i kësaj discipline mundësohet falë aplikimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit¹, që është në fuqi edhe sot². Ai që shkel këtë kod klanor përballet me pasojat për tradhti dhe prishje marrëveshjeje... E veçanta e modelit të përbashkët për organizimin e brendshëm të strukturave terroriste dhe kriminale*

¹ Njëri nga burimet e të drejtës zakonore shqiptare që kishte shtrirje në pjesën veriore të territoreve shqiptare. Krahas Kanunit të Lekë Dukagjinit, e drejta zakonore shqiptare bazohej edhe në Kanunin e Skënderbeut, në Kanunin e Malësisë së Madhe dhe në Kanunin e Labërisë.

² Vepra e cituar: *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, f.9

shqiptare është respektimi i parimeve për ndarjen territoriale, duke respektuar gjithnjë sferat e interesit dhe zonat e ndikimit të disa familjeve¹.

Shumica e veprimeve kriminale në Kosovë dhe Metohi ndodhin brenda klaneve familjare që kontrollojnë pjesë të caktuara të territorit. Klanet janë të lidhura dhe kanë bashkëpunim të fortë me grupe të ngjashme kriminale nga vende të tjera të Evropës, para së gjithash nga Turqia, Shqipëria dhe Bullgaria, për shkak se territoret e këtyre vendeve paraqesin drejtimet kryesore nëpërmjet të cilave zhvillohet tregtia ilegale².

Marrëdhëniet në gjirin familjar karakterizohen me një disiplinë të rreptë, që arrihet me ndëshkim në rast mosrespektimi të rregullave të brendshme, kështu që frika garanton besnikërinë pa kushte ndaj klanit. Për këtë arsye, e drejta dhe ligjet pozitive konsiderohen si dytësore, si jo të rëndësishme ose si jo të detyrueshme. Duke pasur parasysh faktin se klanet bazohen në lidhje gjaku, që është faktor që përkufizon numrin e anëtarëve, lidhjet ndërmjet tyre janë shumë të forta, ndërsa hyrja dhe infiltrimi i personave të tjerë është gati i pamundshëm. Pjesëtarë të bashkësive të tjera etnike pranohen vetëm si kryerës të disa punëve sekondare ose të vogla. Përveç kësaj, familjet mafioze shqiptare janë të organizuara në 3, 4 ose më shumë nivele, që u mundëson ruajtjen e aftësive vepruese të organizatës edhe në raste të zbulimit të ndonjërit nga anëtarët ose edhe të grupit në tërësi.

Zhvillimi i ndjenjës së identitetit kolektiv të shqiptarëve, sidomos të atyre nga Kosova dhe Metohia, është kusht i domosdoshëm për t'u marrë me kriminalitet të organizuar. Pikërisht ky element, që bazohet në të qenit pjesë e një grupi të caktuar, ka ndërlidhur kriminalitetin e organizuar shqiptar me idealet politike, ushtarake dhe me terrorizmin.³

¹ Po aty, f.8

² Po aty, f.23

³ Vlada Srbije: *Albanski terorizam i organizovani kriminalna Kosovu i Metohiji*, f.7-8

<http://fr.scribd.com/doc/63883383/Vlada-Srbije-Bela-knjiga-o-albanskom-terorizmu-2003-opsti-deo>

Kështu për shembull, në Drenicë dominojnë familjet Geci, Kodra, Jashari, Selimi, dhe shumica e përfaqësuesve të UÇK-së vijnë nga këto familje¹. E njëjta gjë vlen edhe për rajonin e Metohisë, ku familja Haradinaj ka pozitë dominuese².

Me një fjalë, sipas “Librit të Bardhë” serb “prapa motiveve ideologjike dhe kombëtare për krijimin e një shteti të vetëm shqiptar, pavarësisht nëse do të quhet «Shqipëria e Madhe» apo «Kosova e Madhe», fshihen interesat e disa strukturave kriminale, që përpiqen të bëhen pjesë e proceseve ekzistuese politike dhe ekonomike për të legalizuar punët e tyre kriminale.”³

Për të qenë më “bindës” në këtë propagandë, shërbimet sekrete serbe “sqarojnë” gjenezën e luftës së Kosovës! Sipas tyre, “para fillimit të konflikteve të armatosura në territorin e ish-Jugosllavisë, shumica e tregut evropian dhe një pjesë e tregut në SHBA është furnizuar me lëndë narkotike nga kontrabanda përmes të ashtuquajturës Rruga Ballkanike.”⁴ Por, “tregtarët shqiptarë të drogës, që përpiqeshin të merrnin kontrollin e heroinës afgane në tregun evropian, provokuan luftën në jug të Ballkanit.”⁵

“Për të realizuar marrjen e kontrollit të drogës, mafia shqiptare depërtoi nëpërmjet rrugëve të reja deri në Evropën Perëndimore, duke tejkaluar zonat e kapluara nga lufta. Në këtë mënyrë janë krijuar dy rrugë të reja alternative, Rruga Jugore që fillon nga Turqia nëpërmes Bullgarisë, Maqedonisë, Kosovës e Shqipërisë, deri në Itali dhe në vende të tjera të Evropës Perëndimore. Ndërsa Rruga Veriore fillon nga Turqia nëpërmes

<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

Versioni anglisht, f.7-8

¹ Po aty, f.8, shënimi 19

² Po aty, f.26

³ Po aty, f.7-8

⁴ Po aty, f.29. Kjo rrugë ilustron edhe me hartë (fig. 10), f. 29

⁵ Procesi i gjykimit të Milošević-it, seanca e 18 shkurtit 2002
«Uvodna reč optuženog Miloševića» (Fjala hyrëse e të akuzuarit Milošević)
<http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/Transkripti/Transkripti%20osa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20%282%29/Transkript%20osa%20sudjenja%20Slobodanu%20Milosevicu%20-%2018.%20februar%202002..pdf>

Bullgarisë, Rumanisë e Hungarisë deri në Çeki, Sllovakia dhe në vendet e tjera të Evropës Perëndimore.”¹ Në kontrollin e këtyre dy rrugëve nga mafia shqiptare një rol të veçantë luan emigracioni shqiptar. Në të gjitha shtetet e lartpërmendura pjesëtarët e emigracionit shqiptar u nënshtrohen torturave të tmerrshme që anëtarët e mafies shqiptare aplikojnë kundër bashkatdhetarëve të tyre për t’i detyruar të bashkëpunojnë me ta dhe të ndihmojnë terrorizmin në Kosovë e Metohi, në jug të Serbisë dhe në Maqedoni².

Gjatë konflikteve në Kosovë dhe Metohi, mafia shqiptare bëri përzgjedhjen e refugjatëve që u vendosën në Evropën Perëndimore dhe në Amerikën Veriore. Krahas qëllimit për të krijuar përshtypjen se këta njerëz u dëbuan nga pushteti i Serbisë, strategjia e mafies shqiptare synonte krijimin e bazave në vendet mikpritëse dhe përforcimin e lidhjeve për aktivitetet e ardhshme kriminale³.

Përveç tregtisë me lëndë narkotike, mafia shqiptare vuri nën kontrollin e saj edhe prostitucionin ndërkombëtar, tregtinë ilegale të armëve, të cigareve dhe të mallrave të tjera akcizë, të automobilave të vjedhur, trafikimin me njerëz dhe shitjen e organeve njerëzore⁴.

«Libri i bardhë për terrorizmin shqiptar dhe kriminalitetin e organizuar në Kosovë»⁵

¹ Edhe kjo rrugë ilustruhet me hartë (fig. 11), f. 29

² Po aty, f.38

³ Po aty, f.38

⁴ Vlada Srbije: *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, f. 23

<http://fr.scribd.com/doc/63883383/Vlada-Srbije-Bela-knjiga-o-albanskom-terorizmu-2003-opsti-deo>

<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

Versioni anglisht në PDF f.15

⁵ Qeveria e Republikës Federative të Jugosllavisë, *Бела књига: Тероризам Албанских сепаратиста на Косову и Метохији*, Ministria e Punëve të Jashtme e Jugosllavisë, Beograd, shtator 1998,

Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija : documents and evidence 1 January 1998 - 10 June 1999, III, Part One & Part Two p. 1023, Beograd, march 2000,

Strukturat e mafies shqiptare sipas «Librit të Bardhë»

Për ta ilustruar “funksionimin klanor” të shoqërisë shqiptare të Kosovës dhe “ndarjen precize territoriale”, në të cilën “familjet e caktuara kontrollojnë një vend të caktuar dhe aktivitetet kriminale në atë vend”, Shërbimi Sekret Serb publikoi strukturat e këtyre “familjeve mafioze shqiptare”.


Sipas skemës së sajuar nga ky shërbim, në Kosovë ekzistojnë shumë “familje të vogla kriminale”. Por, këto “familje të vogla” janë nën ndikimin dhe kontrollin e «Klanit të Drenicës», «Klanit të Dukagjinit» dhe «Klanit të Llapit», tri “familjeve të mëdha kriminale që dominojnë Kosovën.”

Me qëllim që të ndërldhin luftën çlirimtare të Kosovës me krimin e organizuar, autorët e “librave të bardhë” pohojnë se klanet e lartpërmendura e kanë ndarë Kosovën në tri zona interesi: zonën e Drenicës, të Dukagjinit dhe të Llapit. Në të tri zonat, që korrespondojnë me tri zona operative të strukturës ushtarake të UÇK-së gjatë luftës së Kosovës, “aktivitetet kriminale udhëhiqen dhe kontrollohen nga ish-udhëheqës të UÇK-së, të cilët pas luftës u transformuan në udhëheqës të strukturave politike.”

Për këtë arsye, kujtdo që i intereson të hulumtojë se kush e kontrollon një veprimtari të caktuar kriminale në një krahinë të caktuar, duhet të shikojë se cili ishte komandat i asaj zone operative të UÇK-së gjatë luftës së Kosovës. Në funksion të kësaj, pas faqes 22 të «Librit të Bardhë», të botimit të vitit 2003, si shtojcë publikohet skema organizative e komandantëve të Zonave Operative të UÇK-së.

Dr. Radoljub Etinski, Chef Legal Adviser at the Federal Ministry of Foreign Affairs,
Qeveria e Serbisë, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, Beograd, 2003


Komandatët e Zonave Operative të UÇK-së
(Viti 1999)



«Libri i Bardhë», figura 1

Kjo skemë organizative e komandantëve të zonave operative të UÇK-së pasohet me skemën organizative të strukturave kriminale.

Renditja e klaneve të organizuara kriminale



«Libri i Bardhë», figura 2

Në tërë «Librin e Bardhë» dhe sidomos në rreth 150 faqe të tij¹ Shërbimi Sekret Serb përpiqet të “ofrojë mjaft sqarime dhe fakte për krimet e kryera në Kosovë dhe në këtë mënyrë t'i ndihmojë ata që duhet të luftojnë kundër kriminalitetit të organizuar në Kosovë, dhe para së gjithash të ndihmohet KFOR-i, UNMIK-u dhe Gjykata e Hagës.”²

¹ Nga faqja 46 deri në faqen 189


² Vepra e cituar, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji* <http://www.srpskadijaspora.info/vest.asp?id=4093>

“Faktet” e vetme që sjellin përpiluesit e «Librit të Bardhë» janë “fjalët” e shërbimeve sekrete serbe për tregtitë e paligjshme që bëjnë “klanet e organizuara kriminale” të renditura në figurën dy.

Nuk do ta rëndojmë librin me citate të stigmatizimit të personave që figurojnë në këtë skemë si të ishin “bartës” të “familjeve të krimit të organizuar” në Kosovë. Po ndalem vetëm në «Klanin e Drenicës», për arsye se u bë objekt i sulmeve më të ashpra pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Për ta bërë sa më “bindëse” se gjoja kemi të bëjmë me një “strukturë mafioze”, Shërbimi Sekret Serb, e paraqet skemën organizative në një formë ku dallohet “koka e Organizatës”, Hashim Thaçi dhe “tetë” degëzimet e trupit.

Klani kriminal i "Luginës së Drenicës"



«Libri i Bardhë», figura 7

Kufizimi në “kokën” dhe në “tetë” degëzime të «Klanit të Drenicës» bëhet me qëllim që të aludohet në «oktapodin», që figurativisht simbolizon mafien! Madje, për të mos e prishur “imazhin e oktapodit” në skemë nuk figurojnë disa figura që në brendi të «Librit të Bardhë» stigmatizohen si njerëz kyç të këtij “klani”¹.

«Klani i Drenicës», i cili në disa raste paraqitet edhe me emërtimin «Grupi i Drenicës», përshkon tërë materialin stigmatizues të Shërbimit Sekret Serb. Por, përveç stigmatizimit të «Grupit të Drenicës», si emërtim i përgjithshëm, në «Librin e Bardhë» stigmatizohen veç e veç “bartësit”² e këtij «grupi».

Që nga Hashim Thaçi, i cili konsiderohet si “koka”, “organizatori”, “shefi” i “organizatës kriminale të «Grupit të Drenicës»”³, Xhavit Haliti, që konsiderohej “ndër figurat qendrore të krimit të organizuar në Kosovë dhe «Grupit të Drenicës»”⁴ e deri te Azem Sylja⁵, Kadri Veseli⁶, Fatmir Limaj⁷ dhe personalitete tjera të UÇK-së, stigmatizohen nga Shërbimi Sekret Serb si anëtarë të një “organizate terroriste dhe kriminale”.

Ky “grup” akuzohet për veprimtari “kriminale” të kryera para, gjatë dhe pas përfundimit të luftës së Kosovës. Sa i përket periudhës para dhe gjatë luftës në Kosovë, «Grupit të Drenicës» i ngarkohen vrasjet, rrëmbimet, burgosjet, keqtrajtimet e civilëve të komuniteteve të ndryshme që jetonin në Kosovë, duke vënë theksin e veçantë mbi serbët dhe shqiptarët «besnikë» ndaj Serbisë. Krahas vrasjeve dhe keqtrajtimeve të njerëzve, këtij

¹ Për shembull, në këtë skemë mungon emri i Kadri Veselit, Shefi i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe ai i Fatmir Limajt, njërit nga udhëheqësit e Luftës Çlirimtare të Kosovës, të cilëve Serbimi Sekret Serb u ngarkon një numër të madh të “veprave kriminale”.

² Shih sidomos faqet: 48-49, 66-67, 74-76, 94-98, 113-115, 120-121, 144-149, 155-156, 162-163

Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji
<http://www.srpskadijaspora.info/vest.asp?id=4093>

³ Vepra e cituar, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, f.156 <http://www.srpskadijaspora.info/vest.asp?id=4093>

⁴ Po aty, f.163

⁵ Po aty, f.48-49

⁶ Po aty, f. 66-67

⁷ Po aty, f.114-115

“grupi” i ngarkohen edhe “kontrabanda me armë, trafikimi me narkotikë, me prostitucion, trafikimi me qeniet njerëzore si dhe shitja e organeve njerëzore!”¹

Pas përfundimit të luftës, listës së veprimtarive kriminale, Shërbimi Sekret Serb ia shtoi edhe “kontrollin mbi tregtinë e naftës, derivateve të naftës, cigareve dhe mallrave tjerë me akcizë, të cilat u lehtësuan me depërtimin e «Grupit të Drenicës» në strukturat e pushtetit lokal dhe qendror.”²

Të gjithë atyre që u intereson të shohin se deri në cilat përmasa përpiluesit e të ashtuquajturave raporte sekrete të agjencive inteligjente perëndimore, të publikuara edhe në internet, janë mbështetur në thëniet e Shërbimit Sekret Serb për të përpiluar “raportet e tyre”, kanë mundësi të binden se kemi të bëjmë me përvetësim e sajimeve serbe si të ishin rezultate të “zbulimeve të tyre”. Të gjithë emrat e kriminelëve, “familjet kriminale”, strukturat e tyre, raportet mes tyre dhe marrëdhënjet me pushtetin politik janë kopjuar nga «librat e bardhë».

Nuk e di nëse mund të quhet “plagjiaturë” kjo formë e veprimit të “shërbimeve inteligjente” që përzgjedhën dhe publikuan materiale propaganduese serbe në emër të “Shërbimit Sekret Informativ të KFOR-it amerikan dhe NATO-s”, në emër të “Shërbimit Sekret të Gjermanisë” dhe një numër raportesh tjera të kësaj natyre të “shërbimeve inteligjente” të shteteve perëndimore.

Pas një analize krahasuese të përmbajtjes së këtyre raporteve me burimin serb të informatave del qartë se nuk është dashur ndonjë “inteligjencë” e madhe nga këto “agjenci” për të kopjuar propagandën serbe. Madje nuk kanë pasur nevojë as për përkthyes, sepse «librat e bardhë» dhe disketat me “27000 faqe materiale për krimet e shqiptarëve të Kosovës” ishin botuar dhe shpërndarë falas në disa gjuhë të botës.

¹ Po aty, shih ndër të tjera, faqen 23-25.

Në versionin anglisht të «Librit të Bardhë» shih f.15-17

Albanian terrorism and organized crime in Kosovo and Metohija

BIA (Security Information Agency), Belgrade, September 2003

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:vQzR9voTrH8J:www.kosovo.net/albterrorism.html+&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch>

.kosovo.net/albterrorism.html+&cd=1&hl=fr&ct=clnk&gl=ch

² Po aty

Kumbaria e «mafies shqiptare»

Nëpërmjet paraqitjes së shoqërisë shqiptare si shoqëri që funksionon sipas modelit feudal¹ autorët e «Librit të Bardhë» u përpoqën të përcaktojnë një model të interpretimit të asaj që ndodhte në Kosovë. Por, që ky model interpretimi të pranohej si model i besueshëm edhe nga qarqet e caktuara ndërkombëtare, Shtabi Strategjik i Milošević-it u përkujdes që përkthimet e «Librit të Bardhë» të shpërndareshin sa më shumë që ishte e mundshme. Sidomos, shpërndarja falas në gjuhën angleze dhe në gjuhën frënge u bë në mesin e gazetarëve, filozofëve, sociologëve, politologëve, politikanëve, analistëve e historianëve që kishin “një edukim politik” të veçantë dhe këndvështrim të caktuar ideologjik të dominuar nga «antiamerikanizmi».

Është fakt i pamohueshëm se në rastin e luftës së Kosovës, “*kumbaria*”², si formë marketingu, ku publiciteti bëhet me kosto shumë të vogël, paraqet formën më efikase të shpërndarjes së propagandës serbe. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër Serbisë krijoi kontekstin që intelektualët e fushave të ndryshme, por me qëndrim kundër NATO-s, të jenë të predispozuar të hyjnë në procesin e *kumbarisë* dhe të promovojnë «produktet» e sajura nga Shërbimet Sekrete Serbe.

Ndryshe nga praktika e *kumbarisë* që aplikojnë ndërmarrjet ekonomike si *Nike*, *Adidas*, *Boos*, *Coca Cola* etj, që afishojnë haptazi se janë prodhues të produkteve të caktuara, në politikë ndodh shpesh që publiciteti i «produkteve» të bëhet pa treguar «ndërmarrjen prodhuese». Në rastet kur kemi të bëjmë me stigmatizimin e një pale në një konflikt të caktuar, fshehja e «ndërmarrjes prodhuese» bëhet me qëllim që «produkti» të mos konsiderohet si “i njëanshëm” por, si “eliksir” për të “shpëtuar shpirtin nga manipulimi”!

¹ "Familja" "Klani", "Fisi" dhe "Kanunit"

² Kumbariasia zakon i lashtë për të zgjeruar rrethin e miqësisë apo si praktikë fetare njihet nga shumëkush. Ndërsa, «kumbaria» (parrainage në gjuhën frënge, sponsoring në gjuhën angleze) si nocioni i marketingut mbulon praktikat e mbështetjes së sportistëve të njohur, klubeve të njohura, njerëzve me influencë për t'u bërë publicitet produkteve të ndërmarrjeve të caktuara.

Kështu, Régis Debray-ja e thotë haptazi se “për të shmangur mundësinë e manipulimit nga përkthyesit që simpatizonin UÇK-në në Maqedoni dhe në Shqipëri, ai kishte kërkuar nga pushteti serb të kishte përkthyesin e vet, veturën e vet dhe t’i mundësohej të shkojë të bisedojë me cilindo që dëshironte...”. Ky filozof francez “harroi” të tregonte se kush ia siguroi veturën dhe përkthyesin “që nuk e simpatizonte UÇK-në, por, si për çudi (!) nuk harroi të theksonte se “pushteti serb e kishte respektuar kontratën me të.”¹

Përpos Régis Debray-së, dyshime në dëshmitë e shqiptarëve që iknin nga Kosova dhe në “mungesën e objektivitetit” të “përkthyesve që simpatizonin UÇK-në” shfaqën edhe Christophe Châtelot-ja, Renaud Girard-i, Bo Adami, Jürgen Elsässer-i, Serge Halimi, Dominique Vidal-i, Jean-Arnauld Derens-i, Pierre Péan-i, Xavier Raufer-i, dhe të ngjashëm si këta.

Shpërndarja e mosbesimit ndaj “përkthyesve lokalë” kishte për qëllim të arsyetonte angazhimin e “përkthyesve nga vendet e tjera” që “nuk ishin simpatizantë të UÇK-së” dhe në këtë mënyrë të fshihej fakti se qëndrimet e tyre bazoheshin në sajimet e shërbimeve sekrete serbe.


Siç e theksuam edhe më lart, pas luftës 78-ditëshe që aleanca veriperëndimore bëri kundër regjimit të Milošević-it, strukturat politike, ushtarake dhe policore të këtij regjimi u detyruan të tërhiqeshin nga Kosova. Rrethanat e reja krijuan kontekstin e “pushtimit” të Kosovës nga ata që dëshironin të kuptonin të vërtetën se çka kishte ndodhur atje.

Në këtë kontekst, “përkthyesit që nuk e simpatizonin UÇK-në” dhe «librat e bardhë» serbë të përkthyer në gjuhë të huaja patën një ndikim të madh. Sidomos “ndikimi” është qartë te ata që dëshironin ta përgënjeshtonin NATO-n.

Ndikimi i «librave të bardhë» ishte i pakontestueshëm. Mjafton t’i hedhim një sy internetit dhe të shohim përmasat e këtij ndikimi. Nëse, për shembull, në makinën kërkuese “google” kërkohen të dhëna për «mafien shqiptare», miliona tituj afishohen

¹ Le monde, letra e cituar e Régis Debray-së, “Lettre d’un voyageur au président de la République”

brenda disa sekondash. Për një kohë të shkurtër, vetëm në gjuhën frënge, u afishuan dhjetë milionë e gjashtëqind mijë rezultate, ku Kosova paraqitet si “parajsë e mafies”!



Bëhet fjalë për artikuj, raporte të shërbimeve inteligjente të shteteve që kishin dërguar forcat e tyre ushtarake në kuadër të KFOR-it dhe libra të autorëve të ndryshëm të mbështetur ekskluzivisht në të dhënat e “librave të bardhë” të Shërbimit Sekret Serb. Një analizë krahasuese e këtyre teksteve do të nxirrte në shesh se teknika «copy-paste» nga «librat e bardhë» dhe parafrazimi i propagandës serbe ishin metodat kryesore për sajimin e shkrimeve ku produktit serb «mafia shqiptare» i bëhet publicitet si të ishte realitet i pakontestueshëm.

Në vazhdim të këtij libri do të ndalem vetëm në disa autorë, që ishin më të zëshëm në “argumentimet” e tyre se “NATO-ja ishte mbështetur te kriminelët lokalë që përbënin UÇK-në për të organizuar trazirat në Kosovë dhe për të nxitur përdorimin joproportional të dhunës nga ana e Beogradit”¹. Sipas këtij qëndrimi, kjo u shfrytëzua si pretekst për ta sulmuar Serbinë dhe krijoi

¹ Jürgen Roth, MAFIA, Le gouvernement kosovar et le crime organisé (Mafia, Qeveria kosovare dhe krimi i organizuar, Artikulli i publikuar në: *Weltwoche* n°43 (2005). Versioni francez : *Horizons et débats*.
<http://www.voltairenet.org/article156405.html>

“parakushtet për krijimin e Kosovës si shteti i parë 100% mafioz në Evropë”¹.

Nga autorë të ndryshëm që u angazhuan në *kumbarinë* e nocioneve të krijuara nga Shërbimi Sekret Serb më duket interesant të përmend rastin e historianit zviceran, Oliver Jens Schmitt². Ky historian, në veprën e titulluar «Kosova - histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike»³, thekson domosdoshmërinë e të qenit vigjilent kur trajtohen tema lidhur me krimin e organizuar, sepse Qeveria Serbe dhe qarqet ruse kishin strategjinë “për t’i kriminalizuar shqiptarët e Kosovës dhe për t’i paraqitur ata si kriminelë dhe tregtarë droge. Kjo strategji godiste edhe politikanët kryesorë shqiptarë të Kosovës, kundër të cilëve Serbia përpiqej të zbatonte urdhër arrestet nëpërmjet Interpolit.”⁴

Në vend që të ishte vigjilent për atë që u sugjeronte të tjerëve, Oliver Jens Schmitt-i përdori të njëjtat terma që përdorëshin nga propaganda serbe dhe ruse për t’i kriminalizuar shqiptarët! Për më tepër, ky historian zviceran shpërndau propagandën për "kontrollin e plotë të shqiptarëve mbi disa fusha të caktuara të kriminalitetit, siç janë tregtia me drogë, emigrimi ilegal dhe tregtia me njerëz.”⁵

Oliver Jens Schmitt-i nuk kufizohet me kaq! Ai përsërit propagandën e Beogradit se gjoja “UÇK-ja ishte financuar pjesërisht nga paratë e krimit të organizuar të shqiptarëve të Kosovës”⁶ dhe thëniet e tilla i paraqet si të ishin “fakte të nxjerra nga hulumtimet e vëzhguesve neutralë që kishin përpiluar «Raportin e Europolit»”⁷!

¹ Jürgen Roth «Kosovo, premier Etat 100% mafieux en Europe- Le gouvernement kosovar et le crime organisé»
https://fr.groups.yahoo.com/neo/groups/projets_algerie/conversations/topics/9645

² Kritika për shumë aspekte që trajton ky historian mund të gjenden në veprat: Jakup Krasniqi, «Një histori e kontestuar», Shtëpia Botuese Buzuku, Prishtinë, 2013, f.224 dhe Ibrahim Kelmendi, «Trileri i O.J. Schmitt për Kosovën», Shtëpia Botuese Buzuku, Prishtinë, 2013, f.368

³ Oliver Jens Schmitt, *Kosova- Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Botimi shqip, KOHA, 2012, Prishtinë, f. 309

⁴ Po aty, f. 227

⁵ Po aty, f.228

⁶ Po aty, f.257

⁷ Po aty, f.257

«Raporti i Europolit»¹, që konsiderohet nga Schmitt-i si “raport i vëzhguesve neutralë”, nuk është as raport i Europolit e as neutral. Ky raport, si edhe raporti i “KFOR-it amerikan” dhe ai i Shërbimit Sekret Gjerman që u trajtuan më lart, nuk është asgjë tjetër pos parafrazim i «Librit të Bardhë» të Shërbimit Sekret Serb, botimi i vitit 2003. Sikur Oliver Jens Schmitt-i të kishte zbatuar rezervat e veta ndaj informatave që rrjedhin nga burimet serbe dhe ruse “për implikimin e UÇK-së në krime dhe financimin e luftës nga paratë e krimit të organizuar”, atëherë ai do të kishte bërë një analizë krahasuese të «Librit të Bardhë» dhe të «Raportit të Europolit» para se të shpërndante propagandën serbe dhe ruse që kriminalizonte shqiptarët.

Jo vetëm që nuk e trajtoi me rezerva stigmatizimin që u bëhej shqiptarëve dhe UÇK-së në Raportin e publikuar në emër të Europolit, por, ky historian e shpërndau propagandën serbe me “ambalazhin” e Europolit! Kështu “shitet më lehtë” te ata që nuk e njohin realitetin! E kur është fjala për “vigjilencën”, Oliver Jens Schmitt-i, në të njëjtën mënyrë si zëdhënësit e regjimit serb, alarmon, në emër të Raportit të ambalazhuar me firmën e Europolit, për domosdoshmërinë e rritjes së vigjilencës, sepse “krimi i organizuar shqiptar konsiderohet gjithnjë e më shumë si kërcënim për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”²

Shumë para Oliver Jens Schmitt-it, Xavier Raufer-i, Drejtor i Qendrës për Hulumtime të Kërcënimeve kriminale në Paris, i njohur për lexuesin nga kapitujt paraprakë, dhe kriminologu francez, Stéphane Quéré-ja, publikuan veprën e titulluar «Mafia shqiptare, një rrezik për Evropën»³.

Të vetëdijshëm për përmbajtjen skandaloze të këtij libri, në parathënien e tyre, autorët përpiqen t’i bindin lexuesit se “nuk ka asgjë raciste dhe antishqiptare” në veprën e tyre dhe se “të flitet për mafien shqiptare, nuk do të thotë se bëhet loja e Milošević-it”.

Kur lexon pohimet e tilla me të drejtë shtrohet pyetja se çka i bën këta autorë të kenë frikë se mund të perceptohen si racistë

¹ I publikuar në dhjetor të vitit 2004

² Oliver Jens Schmitt, vepra e cituar, *Kosova- Histori e shkurtër ...*, f. 228-229

³ Xavier Raufer dhe Stéphane Quéré, vepra e cituar *La mafia albanaise...*, f.141

antishqiptarë. Mirëpo, arsyet e kësaj frike qartësohen në përmbajtjen e librit të tyre! Jo vetëm që përsërisin atë që shkruhet kundër shqiptarëve dhe kundër UÇK-së në “librat e bardhë”, por, njollosjen që u bën shqiptarëve Shërbimi Sekret Serb, Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja e ngritën në një shkallë edhe më të lartë.

Kështu, me qëllim që të plotësohen kriteret e nevojshme që të cilësohet kriminaliteti i grupeve shqiptare si «mafie» në kuptimin e plotë të fjalës, Shërbimi Sekret Serb këmbëngul se “shoqëria shqiptare është shoqëri klanore dhe forma e organizimit të grupeve kriminale bazohet mbi parimet e një disipline të çeliktë.”¹

Për të përforcuar këtë qëndrim të propagandës serbe autorët e lartpërmendur pohojnë se “në Shqipëri, sidomos në veriun malor të vendit që ishte i izoluar gjatë gjithë shekullit XX, mund të thuhet se mbijetoi, gati në mënyrë **kimikisht të pastër**, një shoqëri klanore tradicionale, që respekton traditën e vjetër shekullore të nderit dhe të hakmarrjes. Në krahasim me shumicën e mafieve të tjera, që këto rregulla dhe ligje i kanë të nënkuptueshme ose i transmetojnë gojarisht, në Shqipëri ky kod nderi ose «Kanuni»² është shkruar në broshurë dhe shitet edhe në kioskat e gazetave.”³

Shumica e autorëve të shquar për “antiamerikanizëm” dhe “kundër NATO-s”, që u cituan gjatë gjithë këtij libri, promovojnë produktet e sajara nga Shërbimi Sekret Serb, duke ua fshehur burimin. Por, të shkohet deri në atë shkallë, siç bëjnë Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja, sa të pohohet se në veri të Shqipërisë ka mbijetuar gati në mënyrë **kimikisht e pastër** një shoqëri klanore, nuk është asgjë tjetër pos “zbulim kimik” të cilit i vjen era! Kundërmon racizëm!

Edhe pse hulumtime të panumërta dëshmojnë se struktura e farefnisës (ose e klaneve, siç i pëlqen dikujt ta quajë) te shqiptarët ka evoluuar, si edhe te shoqëritë tjera në Ballkan, autorët, që u nevojiten “argumente” për të stigmatizuar UÇK-në si “organizatë

¹ Qeveria e Serbisë, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, f.3 Beograd, 2003

² Autorët përdorin tekstualisht fjalën Kanun!

³ Xavier Raufer dhe Stéphane Quéré, vepra e cituar, *La mafia albanaise...* f.34

mafioze" dhe të denoncojnë NATO-n si mbështetëse të «mafies shqiptare», këmbëngulin në funksionimin klanor të shoqërisë shqiptare!

Lexuesve frankofonë, të cilëve u intereson të dinë më shumë rreth strukturave shoqërore dhe kërkesave politike të shqiptarëve, sidomos për periudhën e krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan, u sugjeroj të lexojnë veprën e Nathalie Clayer-it, «Në origjinat e nacionalizmit shqiptar»¹. Kjo autore thekson se para shekullit XIX, “në tërë shoqërinë e cepit perëndimor të Gadishullit Ballkanik, përkatësia një familjeje ose një fisi ishte një shenjë shumë e fuqishme identifikuese (...) Por, “Kosova, që nga shekulli XIX, nuk ishte zonë klanore dhe është keqpërdorim të përshkruhet si e tillë.”²

Përkundër hulumtimeve të shumta që nxjerrin në shesh se funksionimi klanor i shoqërisë shqiptare ka përfunduar që në shekullin e XVIII-të, autorë të këndvështimit të caktuar ideologjik manipulojnë me këtë “produkt” që kishte nxjerrë në treg Shërbimi Sekret Serb, si të ishte realitet i shoqërisë shqiptare.

Krahas zbulimit të ekzistimit të “shoqërisë klanore shqiptare, kimikisht të pastër”, Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja, shkoqitën nga gazetatat e ndryshme botërore fragmente artikujsh që konfirmojnë thëniet e Shërbimit Sekret Serb se gjoja “Ushtria Çlirimtare e Kosovës është një narkogueriles e financuar nga rruga e Ballkanit, që merret me trafikimin e drogës, me emigracionin ilegal, me tregtinë me armë, me veturat e vjedhura, me tregtinë me cigare dhe me alkool, me kontrabandën me naftë, me plaçkitje të shkallës shumë të lartë, me rrëmbime dhe me kërkime haraçesh, me vrasje me porosi, me falsifikime dokumentesh zyrtare, me pastrim parash të kriminalitetit...”³

Edhe në mozaikun e veprave kriminale që i vishen UÇK-së, Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja dallojnë nga të gjithë

¹ Nathalie Clayer-it, *Aux origines du nationalisme albanais*, Paris, 2007

² Po aty, f.27

³ Vepra e Xavier Raufer-it dhe e Stéphane Quéré-së *La mafia albanaise ... është plot e përplot me thënie të tilla*. Shih. f. 31, dhe f.91 citatet e lartpërmendura.

kumbarët e nocionit «mafia shqiptare». Këta autorë që pretendojnë se nuk i karakterizon “racizmi antishqiptar”, si askush tjetër më parë, i fyejnë shqiptarët.

Në pamfletin e tyre propagandistik, ata vijnë në përfundim se “trafikimi me qeniet njerëzore është specialitet kriminal i shqiptarëve (...). Në kampet e Shqipërisë, policët janë të implikuar në rrëmbimin e vajzave të reja ose i blejnë nga prindërit e tyre për t’i dërguar në qendrat e trajnimit për prostitucion. Pas trajnimit të duhur, këto gra të reja u shiten tjetërkujt dhe shkojnë të punojnë në Londër, në Hamburg, në Paris...”¹

Më duhet të bëj një digresion të vogël dhe të sqaroj lexuesin se kur flasin për “kampet e Shqipërisë” këta autorë e kanë fjalën për qendrat ku u strehuan 443.300 shqiptarë të dëbuar nga Kosova. Vendit më të varfër të Evropës i ra si barrë të mbajë mbi supet e veta pjesën më të madhe të pasojave të politikës së spastrimit etnik dhe të gjenocidit serb në Kosovë. T’i atribuohet policisë shqiptare “impikimi në rrëmbimin e vajzave të reja” ose “i blerjes nga prindërit e tyre për t’i dërguar në qendrat e trajnimit për prostitucion” është përbuzja më e madhe që mund t’i bëhet shtetit shqiptar.

Ky qëndrim fyes ndaj shqiptarëve shpjegon frikën që shprehin autorët në parathënien e librit të tyre se mund të konsiderohen si “racistë antishqiptarë”. Çdo lexues mund ta gjykojë vetë raportin e racizmit antishqiptar dhe të qëndrimeve të këtyre autorëve. Sa më përket mua, atë që mund të them pa asnjë ngurrim ka të bëjë me shpifjet më të ulëta që dikush ka mundur t’i bëjë «familjes shqiptare»: Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja ua atribuojnë prindërve shqiptarë implikimin në shitjen e fëmijëve të tyre për prostitucion!

T’u vishet prindërve shqiptarë, viktimave të politikës së gjenocidit serb në Kosovë, shitja e fëmijëve të tyre për t’i dërguar në “qendrat e trajnimit për prostitucion” që të përgatiten për “punë si prostituta në Londër, në Hamburg, në Paris...” është më shumë se racizëm! Për mendimin tim, këtu kemi të bëjmë me prostitucion të shpirtit në shërbim të strategjisë së stigmatizimit të shqiptarëve.

¹ Po aty, f.57

Xavier Raufer-i nuk kënaqet me kaq! Ai në intervistën dhënë gazetës «Le nouvel Observateur», të datës 16 shkurt 2000, përpiket të shpjegojë edhe “arsyet e marrjes së shqiptarëve me prostitucion”!

“Si të fitohet një frangë nga zero franga?” shtron si pyetje Xavier Raufer-i dhe jep përgjigje se “nuk ka rrugë tjetër pos tregtisë me femra! Mjafton të rrëmbejë kushërirën e vet. Sot 10 vajza që punojnë në Marécheaux¹ të Paris-it, brenda disa muajsh i sjellin kodoshit të tyre rreth 5 milionë franga. Këto para ata mund t'i investojnë në heroinë ose ekstazi.”²

Sikur Xavier Raufer-i të kishte shprehur frikën e vet se mos «mafia shqiptare» i ofron shuma parash dhe arrin t'ia blejë femrat e familjes së vet që “t'ia trajnojë për prostitucion” dhe “t'ia punësojë në bulevardet e Londrës, të Hamburgut, të Parisit” do të më ishte dhimbsur dhe do ta konsideroja si viktimë e propagandës serbe! Sikur Xavier Raufer-i të kishte shprehur frikën e vet se mos «mafia shqiptare» e bind që t'i “rrëmbejë kushërirat e veta dhe t'i punësojë në Marécheaux të Paris-it”, me qëllim që t'i “ndajnë fitimet prej miliona frangash”, do t'i kisha thënë të mos ketë frikë se «mafia shqiptare» nuk ekziston, se «mafia shqiptare» është nocion i sajuar nga Shërbimi Sekret Serb për të stigmatizuar shqiptarët.

Por, jo! Xavier Raufer-i është tërësisht i angazhuar në *kumbarinë* e nocioneve të «Librit të Bardhë» për t'i prezantuar shqiptarët si “terroristë”, si “kriminelë”, si “trafikantë”, si “mafiozë”...

Është i njëjti Xavier Raufer që për civilët e vrarë në «Masakrën e Reçakut» deklaroi se kanë mundur të jenë “guerilë të UÇK-së të vrarë gjatë luftimeve anekënd Kosovës, të grumbulluar dhe të vendosur njëri mbi tjetrin, për nevojat e show-ut...”³.

¹ Bulevardet e Marécheaux-së e përbëjnë një tërësi të pandërprerë bulevardesh prej 33.7 km

² Nouvel Observateur, «Kosovo, ce paradis de la mafia, Un entretien avec Xavier Raufer», (Kosova, kjo parajsë e mafies, Një intervistë me Xavier Raufer-in), 16 shkurt 2000

³ Le nouvel Economiste, Xavier Raufer, «Balkans, Boucherie et bidonnages», 15 shkurt 2011, <http://www.lenouveleconomiste.fr/balkans-boucherie-et-bidonnages-9201/>

“Shqiptarët bëjnë show me kufomat e të vrarëve, shesin fëmijët e tyre, bëjnë biznes me fëmijët e tyre, rrëmbejnë kushërirat e veta, vetëm e vetëm për të fituar 1 frangë nga zero franga”! Dhe pas gjithë kësaj Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja pretendojnë se “nuk ka asgjë raciste dhe antishqiptare” në shkrimet e tyre! Varet se çka kuptojnë me racizëm këta autorë!

Ndërsa, sa i përket frikës së këtyre autorëve se mos po konsiderohen se “bëjnë lojën e Milošević-it”, po sjell vetëm një shembull: qëndrimin e tyre identik me qëndrimin e propagandës së regjimit të Beogradit lidhur me dëbimin e shqiptarëve nga Kosova.

Kur është fjala për spastrimin etnik të Kosovës lexuesi pati mundësi të informohej gjerësisht në kapitullin e pestë dhe të gjashtë të librit tim. Propagandës serbe se gjoja dëbimi i shqiptarëve të Kosovës “nuk ishte projekt politik i pushtetit serb, por plan i farkuar nga shërbimet e tjera sekrete, për t’ua veshur udhëheqësve serbë se gjoja kanë kryer krim me paramendim”, Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja i shtojnë edhe një aspekt të ri: aspektin e strategjisë së «mafies shqiptare» për t’u shtrirë në përmasa planetare!

Sipas këtyre autorëve, në funksion të kësaj strategjie, “mafia shqiptare seleksionoi me kujdes refugjatët që udhëtuan drejt shteteve perëndimore dhe, si rastësisht¹ shumica e të ashtuquajturve refugjatë zgjodhën të mbesin në vendet mikpritëse... Përmasat e shpërnguljes masive të shqiptarëve dhe vendosja e tyre e organizuar nga mafia shqiptare, ku familje të caktuara shqiptare, banorët e një fshati të caktuar ose anëtarët e një klani të veçantë u vendosën në qytete të caktuara të Italisë, të Zvicrës, të Francës, të Spanjës, të Austrisë, të Gjermanisë, të Belgjikës, të shteteve të Skandinavisë, të Britanisë së Madhe, të Çekisë, të Polonisë, të Hungarisë ... u bënë me qëllim që të vinin nën kontrollit të plotë kriminalitetin në nivel planetar!”²

Përsëritja fjalë për fjalë e interpretimit të regjimit të Milošević-it për atë që kishte ndodhur në Kosovë, fyerja e shqiptarëve

¹ Ironizojnë autorët

² Po aty, në f.60-89 lexuesi mund të njoftohet gjerësisht për këtë interpretim të dëbimit të shqiptarëve nga Kosova.

në mënyrën më të ulët dhe stigmatizimi i shqiptarëve me nocionet e sajara nga ky regjim, për këta autorë “kimikisht të pastër”, “nuk do të thotë se bëhet loja e Milošević-it”.

Angazhimi maksimal i Xavier Raufer-it dhe Stéphane Quéré-së në *kumbarinë* e nocionit «mafia shqiptare» i revoltion kur autorë të tjerë nuk bëjnë publicitetin e këtij produkti të Shërbimit Sekret Serb! Autorët revoltohen pse “perëndimorët e fshehin të vërtetën”! Sipas tyre, as NATO-ja, as OKB-ja, as BE-ja nuk njof-tojnë, në çdo raport të tyre, për «mafien shqiptare». Xavier Raufer-it dhe Stéphane Quéré-ja klithin se “si është e mundur që në Raportin njëzet e dy faqesh të Bashkimit Evropian nuk u përmend asnjëherë shprehja *mafia shqiptare*.”¹

“Revolta” e këtyre autorëve nuk kufizohet vetëm ndaj evropianëve. Ata revoltohen në veçanti kundër zyrtarëve të SHBA-ve, që “e kishin ndihmuar UÇK-në që në vitin 1998, sidomos duke u paraqitur si punëtorë humanitarë të OSBE-së, organizatë që udhë-hiqej në atë kohë nga William Walker-i”². Sipas këtyre autorëve “në pranverën e vitit 1999, senatori Charles Grassley (R-lowa) kërkoi nga Bill Clinton-i një vlerësim për trafikimin me narkotikë të UÇK-së. Përgjigjja që i referohej CIA-s dhe DSHA-së³ se “asnjëra nga këto dy agjenci nuk disponon informata që do të dëshmonin se UÇK-ja është e implikuar në çfarëdo lloji aktiviteti kriminal ose të ketë lidhje të drejtpërdrejta me ndonjë shoqëri të organizuar kriminale”⁴, nuk u shkoji për shtat këtyre autorëve. Ata mundohen ta interpretojnë si “qëndrim që fsheh ndihmën që i është dhënë «mafies shqiptare», ndihmë që është në kundërshtim me US Foreign Assistance Act të vitit 1961, me anë të cilit ndalohet formalisht t’i jepet ndihmë një entiteti që ka lidhje me trafikantët e drogës.”⁵

“Revolta” e Xavier Raufer-it për shkak se “të tjerët” nuk e përmendin shprehjen «mafia shqiptare» ose e mohojnë impli-

¹ Po aty, f.104-105. Teksti është shkruar në kursiv nga autorët.

² Po aty, f.103

³ Departamentit Amerikan të Shtetit

⁴ Xavier Raufer dhe Stéphane Quéré, vepra e cituar, *La mafia albanaise*. f.103-104

⁵ Po aty, f.103

kimin e UÇK-së në aktivitete kriminale është një farsë e llojit të vet. Xavier Raufer-i është pseudonimi i eseistit francez Christian de Bongain-i, që, për arsye të cilat i di ai, ka zgjedhur të fshihet prapa këtij pseudonimi. Ky autor, deri para implikimit të SHBA-ve në luftën e Kosovës dhe ndërhyrjes së NATO-s kundër Serbisë, kur shkruante me identitetin e vet si Christian de Bongain-i, kishte qëndrime krejtësisht tjera. Në hulumtimin¹ që kishte bërë për Qendrën e Hulumtimeve për Kërcënimet Kriminale Bashkëkohore, ai këmbëngulte se “superfuqitë kriminale, ato të vërtetat, janë shumë të pakta në numër. Në kuptimin e saktë të fjalës, ka vetëm dy superfuqi kriminale: Cosa Nostra në Sicili dhe Triada në botën kineze. Shumë më tepër se grup gangsterësh, këto entitete që shfaqen në shoqëritë e prapambetura janë shtete brenda shtetit, disponojnë territorin e caktuar, popullsinë e nënshtruar, ligjet e veta, forcat ushtarake...”².

Pas inkuadrimit të SHBA-ve në luftën e Kosovës, autori që fshihet prapa pseudonimit Xavier Raufer-it, “harroi” përfundimet e veta të dikurshme! Duke u fshehur pas një identiteti tjetër, ndoshta mendoj se do ta fshehë faktin se në hulumtimet e tij të mëparshme asnjëherë nuk e kishte përmendur, as “krimin e organizuar shqiptar” e as «mafien shqiptare». Kur e lexoj “revoltën” që shpreh Xavier Raufer-i ndaj atyre që “bëjnë raporte dhe nuk e përmendin asnjëherë «mafien shqiptare»” më shkon mendja se mos vallë ky person, i “revoltuar” ndaj vetvetes pse nuk e kishte përmendur «mafien shqiptare», në shenjë revolte kishte ndërruar emrin dhe kishte vendosur të fshihej pas “emrit të ri”, Xavier Raufer!

Së paku me këtë emër, ai jo vetëm që nuk harron të përmendë «mafien shqiptare», por ky produkt u shfaq si realitet i pakontestueshëm edhe në titullin e librit³ të Xavier Raufer-it dhe të Stéphane Quéré-së!

¹ Xavier Raufer, *Les Mafias, puissances singulières*, Centre de recherche des Menaces Criminelles Contemporaines - © MCC 1993
<http://www.drmmc.org/IMG/pdf/41b3ad18ab2bb.pdf>

² Po aty

³ Xavier Raufer dhe Stéphane Quéré, vepra e cituar, *La mafia albanaise...*

Citatit të mësipërm kur shkruante si Christian de Bongain-i për *superfuqitë kriminale* Xavier Raufer-i ia hoqi “Cosa Nostra”-n dhe “Triadën kineze”, dhe në vend të tyre futi sajimin serb: «mafia shqiptare».

Njëlloj sikurse autorët e «librave të bardhë» të propagandës serbe, autorët e lartpërmendur shpërndanë “zbulimet” se «mafia shqiptare» “lindi në shoqërinë primitive shqiptare, ku klanet kishin mbijetuar në formë ‘kimikisht të pastër’, që bazohej në traditat e vjetra të hakmarrjes dhe në kodin e nderit të quajtur “Kanun”¹... dhe ku “popullsia u nënshtrohet ligjeve të terrorit të kësaj mafie (...). Pas tërheqjes së forcave serbe, mafia shqiptare u vendos në territorin e Kosovës, u lidh me pushtetin politik, u shndërrua në superfuqi kriminale dhe u bë rrezik për Evropën...”².

Rrezikun nga «mafia shqiptare» dhe nga “terrorizmi i UÇK-së” Shërbimi Sekret Serb e kishte bërë publik nëpërmjet “librave të bardhë”, të botuar dhe të ribotuar disa herë gjatë periudhës 1998-2003. Për dallim nga propaganda serbe që trumbetonte se “terrorizmi shqiptar, i ndërlidhur me format më të ndryshme të kriminalitetit të organizuar paraqiste rrezik të vazhdueshëm për sigurinë e qytetarëve të tyre dhe stabilitetit politik jo vetëm të Serbisë por edhe të vendeve të tjera të rajonit” Xavier Raufer-i dhe Stéphane Quéré-ja vënë theksin e veçantë në “rrezikun që i kanoset kontinentit evropian”, sidomos për shkak të ndërlidhjes së «mafies shqiptare» me pushtetin politik dhe mobilizimit rreth kërkesave politike.

“Depërtimi i «mafies shqiptare» në strukturat e pushtetit” dhe “deklarimet e hapura të ish-udhëheqësve të UÇK-së për Kosovën si shtet të pavarur”, i tmerronin Xavier Raufer-in dhe Stéphane Quéré-në!

¹ Në strategjinë e tyre të manipulimit me njerëzit që nuk e dinë, autorët i kushtojnë një vend të rëndësishëm Kanunit të Lekë Dukagjinit duke e zhveshur nga konteksti historik dhe duke e paraqitur si aktual dhe në fuqi në “shoqërinë primitive” shqiptare. Në vend të fjalës “primitive” autorët përdorin fjalën greke “arkaike”.

² Këto ide dominojnë që nga titulli i librit e deri në përfundimin e tij.

Për të qenë bindës në “shqetësimin e tyre për rrezikun që i kanosej Evropës”, këta autorë manipulojnë me të dhëna të ndryshme për të dëshmuar se “shteti i pavarur i Bosnjës, i krijuar në bazën ushtarake amerikane të Dayton-it, është anti-model i shtetit, që nuk përbën asgjë tjetër pos një patchwork-u¹ kantonesh etnikisht të pastra dhe të kriminalizuara, që jetojnë ekskluzivisht nga ndihmat e huaja dhe industria kriminale.”² Prandaj, për të shmangur “ankthin më të rëndë të shndërrimit të Kosovës në një Bosnje të dytë (...), udhëheqësit e lartë perëndimorë, prej të cilëve varet fati i Kosovës, munden ende ta marrin veten, ta përcaktojnë një politikë të qartë rajonale, realiste dhe të aplikueshme, të ngrenë në gjendje gatishmërie për luftë përfaqësitë e tyre lokale, ta përcaktojnë dhe ta ndjekin armikun kryesor: mafien shqiptare.”³

Lexuesi mund të shohë se alarmi që japin këta dy autorë për rrezikun nga “krijimi i shtetit të Kosovës” është alarm i kumbarëve të nocioneve të fabrikuara në laboratorët e Shërbimit Sekret Serb. Xavier Raufer dhe Stéphane Quéré-ja nuk janë të vetmit!

Po sjell rastin e Céline Bardet-it, e cila nga muaji gusht i vitit 2006 qëndroi për 20 muaj si këshilltare për çështje juridike në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës⁴. Njësoj si Carla Del Ponte, edhe kjo “këshilltare juridike” botoi kujtimet e veta për luftën që kishte bërë “kundër kriminelëve të luftës!” Nga kujtimet e saj të publikuara në veprën «Një grua kundër kriminelëve të luftës»⁵ po shkoqis disa qëndrime që mund të na ndriçojnë se nga cili këndvështrim i ka dhënë “këshillat juridike” kjo juriste!

Për fillimin e luftës në Kosovë ajo fajëson “terroristët e UÇK-së”, të cilët, sipas saj, provokuan “një fushatë terroriste që kishte për cak udhëheqësit dhe përfaqësuesit serbë.” Për pasojë, “në vitin

¹ Patchwork-u është një teknikë e qepjes së copave të pëlhurave të madhësive, të formave dhe të ngjyrave të ndryshme.

² Xavier Raufer dhe Stéphane Quéré, vepra e cituar, *La mafia albanaise...*, f.109

³ Po aty, f.109

⁴ Në atë kohë kjo ministri drejtohej nga Fatmir Rexhepi (deri në mars 2007) dhe Blerim Kuçi, që e zëvendësoi deri në janar 2008.

⁵ Céline Bardet *Une femme contre les criminels de guerre* Edition du Toucan, Paris, mars 2011, f.247

1998 vendi ishte i djegur dhe i përgjakur. Dhuna e UÇK-së kundër popullsisë civile serbe, rome dhe shqiptarëve që konsideroheshin si disidentë u shtua...”¹ Kjo tablo e errët vazhdoi edhe pas përfundimit të luftës. “Pas tërheqjes së trupave serbe nga Kosova dhe vendosjes së KFOR-it dhe UNMIK-ut vendi mbeti në duart e njerëzve që vinin nga klandestiniteti, për të cilët dihej botërisht se ishin të implikuar në aktivitete mafioze dhe se kishin marrë pjesë në shumë akte dhune gjatë luftës.”²

Pas përshkrimit zi e më zi të Kosovës, të cilës, sipas autores “i ka munguar përjetësisht bukuria”³ Céline Bardet-i del në përfundim se “Kosova është një vend i gangrenizuar nga mafia, nëpërmjet të cilës kalojnë trafiket më neveritëse që mund të imagjinohen dhe të cilat janë vendosura nën tiraninë e një kodi nderi shumë të vjetër, Kanunit, që konsiderohet superior ndaj ligjeve dhe ku *omerta*⁴ dhe *vendeta* janë fjalët kryesore.”⁵ Për të manipuluar me opinionin dhe për të fajësuar shqiptarët në tërësi, kjo “këshilltare juridike” e stafit ndërkombëtar, që kishte ardhur të “ndihmonte” Ministrinë e Punëve Brendshme të Kosovës, deklaroi se “Kosova është një komunitet i vogël, mjaft special, ku të gjithë njihen mes tyre. Është shoqëri klanore. Brenda klanit gjërat dihen, por shumë pak informata dalin jashtë klanit, sepse në këtë vend, ligji i heshtjes është ngritur në rangun e vlerave morale.”⁶

Dy milion shqiptarë të Kosovës trajtohen si “klan ku të gjithë njihen mes tyre”, ku të gjithë janë në dijeni të krimeve dhe ku “askush nuk flet”.

Nëse “Kosova është një vend i gangrenizuar nga mafia, nëpër të cilin kalojnë trafiket më neveritëse që mund të imagjinohen”, vend që të “mahnit dhe brengos në të njëjtën kohë”, vend që të “ngjall kureshtjen dhe që është i zymtë në të njëjtën kohë. Vend ku

¹ Po aty, f.106-107

² Po aty, f.108

³ Po aty, f.111

⁴ Autorja në libër përdor shprehjet të mafies siciliane «omerta» dhe «vendeta» që do të thotë ligji i imponimit të heshtjes dhe hakmarrja.

⁵ Po aty, f.110

⁶ Po aty, f.115

ka “ tregti me armë, me drogë, me femra, madje edhe me organe njerëzore, ku ka terrorizëm ... vend ku ka nga të gjitha dhe gjithçka në përmasa të tmerrshme”¹ atëherë përgjegjësia kolektive e shqiptarëve të Kosovës është e pashmangshme.

A mund të imagjinohet krijimi i shtetit të pavarur për një shoqërinë kosovare, e cila sipas propagandës serbe dhe atyre që ishin angazhuar në kumbarinë e nocioneve stigmatizuese kundër UÇK-së, “nuk është shoqëri e prekur nga kriminaliteti i organizuar, por shoqëri që bazohet te kriminaliteti i organizuar.”

Për Céline Bardet-in, “këshilltare juridike” në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, “shqiptarët duhet të dëshmonin se ishin një komb e jo një bandë hajdutësh, siç i cilësonin ata që kundërshtonin pavarësinë e tyre.”² E cili është qëndrimi i autores rreth shqiptarëve? I konsideron si “komb” apo është dakord me etiketimin serb të shqiptarëve si “bandë hajdutësh”?

Në të gjitha rastet që i jepet mundësia, Céline Bardet-i angazhohet në procesin e kumbarisë së nocioneve që stigmatizojnë shqiptarët në përgjithësi dhe UÇK-në në veçanti se gjoja në ballë të luftës së Kosovës ishte vendosur “një hordhi brutalësh që nuk zmbropsej para asnjë dhune, që sulmonte pa dallim minoritetin serb dhe shqiptarët e dyshuar si bashkëpunëtorë të armikut dhe që konsideroheshin heronj të kësaj lufte të fëlliqtë.”³

E përmenda rastin e Céline Bardet-it sepse nuk është as juristja e vetme e as këshilltarja e vetme ndërkombëtare që kishte ardhur ta ndihmonte Kosovën e pasluftës e që identifikojë tërësisht me interpretimin e propagandës së Milošević-it për ngjarjet dhe personalitetet e Kosovës.

Që nga tërheqja e trupave policorë, ushtarakë dhe politikë të regjimit serb nga Kosova, kumbarët e lartpërmendur të nocioneve të «Librit të Bardhë» nuk i ndalën kumbarat e alarmit për rrezikun nga «mafia shqiptare». Përkundrazi, ato u intensifikuan sidomos gjatë procesit të negociatave kur statusi politik final i Kosovës u shtrua në rend të ditës, vazhduan pas shpalljes së pavarësisë së saj,

¹ Po aty, f. 117-118

² Po aty, f. 136

³ Po aty, f.134

nuk u ndalën gjatë periudhës në pritje të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e aktit të shpalljes së pavarësisë dhe mbahen aktuale edhe sot e kësaj dite.

Carla Del Ponte dhe “trafikimi i organeve njerëzore në Kosovë”

Në kapitullin paraprak përmenda faktin se botimi i librit autobiografik të Carla Del Ponte-s, pati një jehonë jashtëzakonisht të madhe. Është interesant se mediat përqendruan vëmendjen kryesisht në supozimet për “trafikimin e organeve njerëzore” që gjoja ishte bërë nga udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në shumicën e rasteve nuk folën për përfundimet e Carla Del Pontes për këto supozime.

Në të njëjtin kapitull solla kontekstin historik të publikimit të këtij libri dhe reagimet lidhur me këtë publikim. Nga tërësia e reagimeve veçova atë të ish-zëdhënëses së Prokurores së Përgjithshme, Florence Hartmann-it. Duke e parë se publikimi i gjërave të tilla në librin e Del Ponte-s nuk kishte asnjë lidhje me profesionalizmin që duhet ta karakterizojë një prokurore, Florence Hartmann-i e cilësoi veprimin e Carla Del Ponte-s si të papërgjegjshëm sepse “puna e Carla Del Pontes konsiston në kërkimin e të vërtetës (...) e ajo sot na ka fundosur në kohën më të errët të propagandës”¹

Krahas qëndrimit të Florence Hartmann-it, lexuesi u njoftua për mobilizimin e qarqeve serbe dhe ruse në kuadër të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe dorëzimin e Projekt rezolutës për hetimet lidhur me supozimet e Carla Del Pontes. Në këtë kontekst përmenda faktin se një ndër efektet e supozimeve për trafikimin e organeve ishte edhe iniciativa e Delegacioneve parlamentare zvicerane dhe suedeze, për të hapur debat në sesionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës lidhur me «pasojat e shpalljes së pavarësisë së Kosovës».

¹ Le Temps, Florence Hartmann, artikulli i cituar, «Carla Del Ponte et les rumeurs de trafic d’organes au Kosovo»

Tani do të ndalem në disa aspekte të këtij libri që janë lënë tërësisht në heshtje: burimet mbi bazën e të cilave Carla Del Ponte publikoi çështjen e supozimeve për “trafikim të organeve njerëzore.”

Publikimi i kujtimeve të Carla Del Ponte-s nuk u prit me entuziazëm prej njërit nga protagonistët e librit të saj: Nebojša Čović-it. Përkundrazi, ish-Zëvendës Kryeministri i Serbisë, që në të njëjtën kohë ishte edhe shef i Qendrës Koordinuese për Serbinë Jugore dhe për Kosovën dhe Metohinë në Qeverinë e Serbisë, u shpreh me përbuzjen më të madhe për publikimin e “vonshëm” të librit dhe revoltën pse Carla Del Ponte nuk i kishte publikuar në kohën kur kishin menduar autoritetet e Beogradit.

Sipas Nebojša Čović-it “Carla Del Ponte është munduar ta ‘pastrojë biografinë’ e vet, meqenëse e ka brejtur ndërgegjija.”¹ Në prononcimin e tij ai akuzoi ish-Prokuroren e Përgjithshme të Hagës pse “nuk i hapi hetimet lidhur me kampet që ishin krijuar në Shqipëri dhe ku ishin transferuar serbët edhe pse është dashur ta bëjë një gjë të tillë. Ajo ka ditur për ekzistimin e tyre dhe për të gjitha gjërat e neveritshme që u kanë bërë serbëve”² - tha Čović-i

Ai i rikujtoi opinionit publik serb se Carla Del Ponte-s i ishin dhënë informacionet e duhura “por, ajo nuk kishte ndërmarrë asgjë.” Madje, Čović-i hedh dyshime se “Carla Del Ponte nuk ka lejuar të hulumtohen varrezat masive të serbëve”³!

Revolta e Nebojša Čović-it është e kuptueshme kur dihet se sa shpresa të mëdha kishte mbështetur në efektet që mund të kishin materialet e përgatitura nga Shërbimi Sekret Serb e që u përmendën më gjerësisht në pjesën e sipërme të këtij kapitulli.

Dosjet me mbi 27 mijë faqe⁴ të përgatitura nga Shërbimi Sekret Serb që iu dorëzuan Carla Del Ponte-s nga Departamenti i Jurisprudencës, i cili funksiononte në kuadër të qendrës koordinuese që udhëhiqej nga Nebojša Čović-i, nuk i dha rezultatet në kohën kur mund të ndikohej në përcaktimin e statusit final të

¹ Glas javnosti, «Del Ponteova pred srpskim tužilaštvom» (Del Ponte para Prokurorisë serbe)

<http://www.glas-javnosti.rs/node/17467/print>

² Po aty

³ Po aty

⁴ Miroslav Antić, artikulli i cituar «Obmane Delponteove»

Kosovës. Kjo shpjegon revoltën e jo vetëm të Nebojša Čović-it për “botimin e vonshëm” të librit të Carla Del Ponte-s.

Edhe Kryetari i Komisionit Parlamentar të Serbisë për Kosovën, Milovan Drecun-i, shprehu pakënaqësinë e tij për këtë vonesë. Ai akuzoi se gjoja “KFOR-i dhe UNMIK-u anashkaluan me vetëdije të plotë faktet për tregtinë me organet e njerëzve. Edhe Tirana zyrtare ka qenë në dijeni për ekzistimin e kampeve në territorin e saj”¹ - deklaroi Milovan Drecun-i. Ai saktëson se “gazetari amerikan me prejardhje serbe, të cilin e kam takuar në Kosovë dhe Metohi, më tregoi se kishte bërë një reportazh për këto kampe dhe se një zyrtar shqiptar i kishte pohuar, pa asnjë problem, se kampet kishin ekzistuar në veri të vendit. Edhe burimet e mia nga «Šiptari»² më kanë folur për fabrikën e gomave në Suharekë, ku ishin mbyllur dhe torturuar serbët. Jam munduar të flas për këtë gjë publikisht, por më kanë shtrënguar nga të gjitha anët që të hesht. Arsyet pse KFOR-i dhe UNMIK-u heshtnin për këtë çështje qëndron në faktin se nuk kanë dashur t'i tregojnë botës se «Šiptari»t që aq shumë i kishin mbrojtur nga serbët ishin kriminelë të neveritshëm.”³

Lexuesit i kujtohet se fjala është për të njëjtin Milovan Drecun të cilin Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë e akuzoi në Gjykatën për Krime Luftë në Beograd për manipulime mediatike në funksion të nxitjes së krimeve, për përhapjen e urrejtjes ndërnacionale dhe ndërfetare si dhe për nxitjen e diskriminimit dhe armiqësive për gjoja “ekzekutimin e civilëve serbe në fshatin Kleçkë”⁴. Është i njëjti Milovan Drecun i cili për gënjeshtren se gjoja gazetarët amerikanë të «Associated Press»-it kishin deklaruar se në “Reçak nuk kishte pasur civilë të vrarë” u dekoruan nga komandanti i Armatës së Tretë Jugosllave, Nebojša Pavković-i⁵.

Tani, nga pozita e Kryetarit të Komisionit Parlamentar të Serbisë për Kosovën deklaroi se “gazetari amerikan me prejardhje serbe e kishte informuar për kampet në Shqipëri”!

¹ Po aty

² Milovan Drecun-i përdor emërtimin nënçmues «šiptari» për shqiptarët

³ Po aty

⁴ Temë që u trajtua në Kapitullin e parë të librit.

⁵ Po rikujtojse Nebojša Pavković-i u dënua me 22 vjet burg për krimet gjatë luftës në Kosovë

Ky manipulues që ishte i implikuar në forma të ndryshme në kryerjen e krimeve në Kosovë, i implikuar drejtpërdrejt në torturat që u ushtruan kundër vëllezërve Mazreku për t'i detyruar të pranonin se gjoja kishin vrarë civilë serbë dhe se gjoja i kishin djegur në «krematorët e gëlqeres» në fshatin Kleçkë¹, flet se gjoja një “gazetar amerikan me prejardhje serbe” dhe «Šiptari»-t e tij e kishin njoftuar për “keqtrajtimin e civilëve serbë dhe për trafikimin e organeve të njerëzve”!

Edhe Vladimir Božović-i, i cili ka pasur disa funksione në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, shprehu revoltën e vet për disa çështje. Në kohën kur kishte qenë shef i Drejtorisë për Jurisprudencë në Qendrën Koordinuese të udhëhequr nga Čović-i dhe kishte “bashkëpunuar me ekspertë të rëndësishëm të mjekësisë ligjore, si Slaviša Dobričanin-i, Vukašin Otašević-i dhe bashkëpunëtorët e tyre, ishte takuar disa herë me Carla Del Ponte-n dhe biseda ishte orientuar në përgatitjen dhe sigurimin e dëshmive materiale kundër UÇK-së.”²

Në kapitullin kushtuar vrasjes së civilëve shqiptarë në fshatin Reçak lexuesi ka mundur të njihet hollësisht se për çfarë “ekspertësh” bëhet fjalë. Në bazë të deklaratave të Vladimir Božović-it, “drejtorja e tij me ekipin e ekspertëve kishin punuar që nga vitit 2001 e deri në vitin 2002 për të përgatitur materialet për trafikimin me organet e njerëzve në Kosovë.”³ Materialet e përmbledhura u sistematizuan në një “disketë me 27 mijë faqe për krimet e komandantëve të UÇK-së, e cila iu dorëzua hetuesve të Hagës”⁴

Është interesante të përmendet se Vladimir Božović-i është i vetmi funksionar i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë që deklaroi se kishin “vendosur bashkëpunim të mirë me departa-

¹ Rast i trajtuar në Kapitullin e parë të librit

² Politika, Biljana Baković, «Za trgovinu organima Beograd saznao pre devet godina» (Për tregtinë me organe Beogradika qenë në dijeni para nëntë vitesh), 02.01.2011
<http://www.politika.rs/rubrike/Hronika/Za-trgovinu-organima-Beograd-saznao-pre-devet-godina.lt.html>

³ Po aty

⁴ Miroslav Antić, artikulli i cituar, «Obmane Delponteove»

mentin e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut të UNMIK-ut, në krye të së cilës ishte amerikani Clint Williamson (...) Clint Williamson, ishte i informuar deri në detaje për aktivitetet e departamentit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut të UNMIK-ut dhe me punën e tij ishim shumë të kënaqur. Pastaj Clint Williamson-i u bë ambasadori për krime lufte, që ishte shumë e rëndësishme për ne.”¹

Këto deklarata janë domethënëse kur dihet se Clint Williamson-i u emërua që të udhëhiqte hetimet për supozimet lidhur me “trafikimin e organeve njerëzore”. Këtë çështje do ta trajtoj në kapitullin e fundit të librit tim.

Megjithatë mungesa e rezultateve në arrestimin e kuadrit të lartë të UÇK-së për gjoja “tregtinë me organet e njerëzve që ua kishin nxjerrë civilëve serbë të burgosur” i zhgënjeu edhe hartuesit e kësaj gënjeshtre. Ky zhgënjim del nga deklarata e Vladimir Božović-it, ish shefit të Drejtorisë për Jurisprudencë në Qendrën Koordinuese për Kosovën dhe Metohinë në Qeverinë e Serbisë.

Ai tregoi se “Dokumentacioni i plotë i nën-komitetit për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur, përkatësisht departamentit ligjor të Qendrës Koordinuese të Kosovës dhe Metohisë, mbeti në godinën e qeverisë federale dhe atë e morën Sanda Rašković–Ivić dhe njerëzit e saj. Sipas njohurive që kam, më vonë një pjesë e dokumentacionit u shkatërrua, ndërsa një pjesë ngeli aty dhe për fatin e saj nuk di asgjë. Por, e di se pas kësaj kohe asgjë nuk është punuar, vdiq çdo aktivitet” tregon me zemërim Vladimir Božović-i.

Të asgjësosh një pjesë të dokumenteve për “krimet më të neveritshme” që pretendohej se u ishin bërë serbëve në kampet e Shqipërisë dhe të bësh që aktiviteti për ndriçimin e këtyre krimeve të rënda “të vdesë” në Beograd, është dëshmi se edhe trilluesit e kësaj gënjeshtre ishin të bindur se askush nuk u besonte “përrallave dhe legjendave”² të tyre!

Përkundër akuzave dhe pakënaqësive që shprehën politikanët serbë për gjoja heshtjen e Carla Del Ponte-s, ajo, megjithatë, ndërmori hapat e nevojshme për të ndriçuar këto krime të supozuara.

¹ Po aty

² Shprehje e Carla Del Pontes

Sipas pohimeve të saj të shprehura në libër, Carla Del Ponte kishte urdhëruar zhvillimin e hetimeve që në vitin 2003. Ajo përmend takimet e shpeshta që kishte pasur me Nebojša Čović-in, Zëvendëskryeministrin e Serbisë dhe anëtarët e nën-komitetit serb për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur. Ajo përmendi edhe takimin që e kishte pasur gjatë vizitës së saj të parë në Beograd, më 25 gusht 2001, “me familjarët e personave të rrëmbyer dhe të atyre që llogariteshin si të zhdukur në Kosovë”. Carla Del Ponte e përshkruan këtë takim të pazakontë sepse familjarët e këtyre personave “ishin tubuar në brendi të ndërtesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme... Kryetari i shoqatës që tubonte këto familje serbe nga Kosova, Ranko Djinović-i, na njoftoi shkurtimisht për njerëzit që ishin zhdukur në Kosovë gjatë periudhës 1998 dhe 2001; Ranko Djinović-i na tha se Shoqata e tij kishte prova që dëshmonin për aktivitetet kriminale të anëtarëve të UÇK-së; akuzonte udhëheqësit më të lartë të UÇK-së, Hashim Thaçin, Drejtorin politik të milicëve dhe Agim Çekun, komandantin e saj, si përgjegjës për rrëmbimet dhe vrasjet në Kosovë; se shoqata e tij kishte përpiluar një listë emrash të rreth 200 rrëmbyesish¹, të gjithë i takonin UÇK-së dhe në fund kërkoi të hetoheshin krimet e kryera pas ardhjes së KFOR-it në Kosovë, në qershor të vitit 1999. Unë i premtova se do bëja çdo gjë që do të mundja, por, doja që ai ta nxiste qeverinë jugosllave që ta mbështeste kërkesën për shtrirjen e mandatit të gjykatës për këto krime të supozuara.”²

Të kërkohet “që të nxitet qeveria jugosllave për të mbështetur shtrirjen e mandatit që të hetohen krimet” e sajuara prej tyre është hipokrizi e llojit të vet! Por, Carla Del Ponte nuk ndalet vetëm në këtë kërkesë hipokrite! Ajo kërkon që “UNMIK-u, autoritetet lokale të Kosovës dhe të Shqipërisë, të shoqëruara edhe nga shërbimet e policisë serbe të hulumtojnë për këto krime të supozuara dhe në rastin e caktuar t’i ndjekin.”³

Të kërkosh që “UNMIK-u, autoritetet lokale të Kosovës dhe të Shqipërisë të shoqërohen nga shërbimet e policisë serbe” për të

¹ Bela Knjiga e viti 2003 përmban 156 emra të terroristëve shqiptarë!

² Carla Del Ponte, vepra e cituar, *La traque, les criminels de guerre et moi*, f. 455-456

³ Po aty, 271

hulumtuar “krimet” që i visheshin UÇK-së e që ishin kryer nga këto shërbime policore, është paturpësi e llojit të vet! Kërkesa e Carla Del Pontes që UNMIK-u, autoritetet lokale të Kosovës dhe të Shqipërisë të mbështeten në shërbimet policore serbe është kërkesë për të arsyetuar, tërthorazi, mbështetjen e vet te këto burime. Përveç këtij rasti, Carla Del Ponte nuk e përmend më faktin se për “krimet e UÇK-së” ishte njoftuar nga njerëzit që kishin përgatitur dhe shpërndarë «Librin e Bardhë». Edhe për “tregtinë me organet e të burgosurve serb” ishte njoftuar nga të njëjtit njerëz që i kishin dorëzuar “disketën me 27 mijë faqe materiale për krimet e komandantëve të UÇK-së” dhe «Librin e Bardhë», në të cilin akuza për “trafikim të organeve njerëzore”¹ përbën një rën nga akuzat e shumta të propagandës serbe.

Carla Del Ponte e arsyeton fillimin e hetimeve për shkak të informatave që ishin siguruar nga burimet e gazetarëve “të besueshëm”, të cilët nuk ia dhanë asnjëherë identitetin e dëshmitarëve as Carla Del Ponte-s!

Madje, edhe vetë Prokurorja e Përgjithshme që urdhëroi hetimet shkruan se është mbështetur në “burime, të cilat gazetarët i identifikojnë vetëm si shqiptarë të Kosovës” dhe në bazë të të cilave dyshohej se “disa nga të burgosurit më të rinj dhe më të shëndetshëm, ishin ushqyer mirë, ishin kontrolluar rregullisht nga mjeku dhe pastaj ishin transferuar në qendra të tjera arresti, në qytetin Burrel dhe rrethinën e tij dhe ishin grumbulluar në një barakë, pas një shtëpie të verdhë, një dhomë e së cilës ishte shndërruar në klinikë kirurgjike të improvizuar ku u janë nxjerrë organet. Pastaj këto organe ishin përcjellë në mënyrë të fshehtë drejt aeroportit të Rinasit afër Tiranës, prej nga u ishin dërguar klinikave jashtë vendit për t’iu transplantuar pacientëve të pasur që kishin paguar për këtë shërbim.”²

¹ Vlada Srbije: Albanski terorizam i organizovani kriminalna Kosovu i Metohiji, f. 23

<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

Versioni anglisht, f.15

² Carla Del Ponte, vepra e cituar *La traque, les criminels de guerre et moi*, f. 457

A bëhet fjalë për të njëjtin “gazetar amerikan me origjinë serbe” që i dha informatat Milovan Drecun-it apo për «Šiptari»-t e “tij” që i kishin treguar për “krimet më të neveritshme të UÇK-së” nuk mund ta dimë, sepse këta “dëshmitarë” nuk iu treguan as hetuesve të Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Hagës! Mbetën të “fshehtë” nga të gjithë të tjerët!

Çka është më e “keqja”, sipas Milovan Drecun-it, edhe në Serbi nuk ka pasur një klimë të favorshme të dëgjohen “gjëra” të tilla! Madje ai paraqitet si viktimë edhe në Serbi, sepse gjoja e “kanë detyruar nga të gjitha anët që të heshtë!”

Praktika e “fshehjes” së burimeve e karakterizon edhe Carla Del Ponte-n. Në veprën e saj «Përndjekja: Unë dhe kriminelët e luftës», pa e cituar burimin e informatave, ajo përsëriti fjalë për fjalë qëndrimet e «Librit të Bardhë» të Shërbimit Sekret Serb se “shoqëria shqiptare është aq e lidhur, sa është tejet e vështirë të rekrutohen përkthyes vendorë, e lëre më informatorë ose dëshmitarë shqiptarë. Shumica e klaneve shqiptare nuk njohin asgjë tjetër pos ligjit të tyre tradicional të hakmarrjes, që i ekspozon anëtarët e tjerë të familjes para raprezaljeve.”¹

Identifikimi me këtë qëndrim të Shërbimit Sekret Serb bëri që Prokurorja e Përgjithshme e Gjykatës së Hagës të urdhërojë hetime pa pasur as dëshmitarë e as prova për krimet e supozuara! Madje, ajo urdhëroi zhvillimin e hetimeve “edhe pse hetuesit e gjykatës e kuptuan se informatat e gazetarëve ishin relativisht jo të sakta dhe se materialet që kishin grumbulluar hetuesit e Zyrës së Prokurorit nuk përmbanin informata veçanërisht për Shqipërinë.”²

¹ Po aty, f.460

² Po aty, f.458

EPILOGU I KAPITULLIT TË PARË

Këto lloj historish të burgosurish të vrarë nga trafikantët e organeve rikthehen mjaft shpesh në zonat e konflikteve, por shumë rrallë ka prova konkrete për t'i argumentuar këto tregime të cilat përfundojnë si legjenda të thjeshta¹.

Kaluan shumë muaj para se gjykata dhe UNMIK-u të shkonin në Shqipërinë qendrore dhe ta vizitonin shtëpinë e verdhë, atë shtëpi për të cilën burimet e gazetarëve pretendonin se të burgosurit ishin vrarë për organet e tyre².

Burimet nuk na kishin treguar për vendin e varreve të viktimave të supozuara dhe ne nuk gjetëm asnjë trup. Delegacioni ynë nuk kishte arritur ta bindë askënd nga shtëpia e verdhë dhe nga rrethina e saj që të vinte dhe të na jepte dëshminë e vet, të na jepte informata të besueshme³.

Në këtë situatë, avokatët dhe hetuesit e ngarkuar për çështjet që kishin të bënin me UÇK-në u shtrënguan të konstatojnë se nuk kishin elemente të mjaftueshme provash për të vazhduar punën e tyre⁴. Prandaj, në mungesë të burimeve apo mjeteve për t'i identifikuar dhe për t'i gjetur, në mungesë të kufomave dhe provave tjera që i lidh të akuzuarit e rangut të lartë me këto akte, të gjitha rrugët e hetimit ishin mbyllur⁵.

¹ Po aty, f.470

² Po aty, f.469

³ Po aty, f.470

⁴ Po aty, f.471

⁵ Po aty, f.471

KAPITULLI I DYTË

PROLOGU I KAPITULLIT TË DYTË

“Dëshmitari okular i trafikimit me organet e serbëve të rrëmbyer nga UÇK-ja”

Më 7 shtator 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi me 98 vota pro, 10 kundër dhe vetëm 1 abstenim amendamentet kushtetuese që shënojnë fundin e pavarësisë së mbikqyrur¹. Të njëjtën ditë, në Beograd, Prokurori serbe për krime luftime, Vladimir Vukčević-i, i deklaroi Agjencisë Tanjug se prokuroria që drejtohej prej tij kishte dëshminë e një dëshmitari okular për nxjerrjen dhe trafikimin e organeve njerëzore në Kosovë².

Sipas prokurorit serb, fjala është për dëshminë e një ushtari të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili sqaroi se kishte marrë pjesë në nxjerrjen dhe tregtinë me organe njerëzore të serbëve të rrëmbyer gjatë luftës në Kosovë, në vitin 1998 dhe 1999³.

Dëshmitari përshkruan në mënyrë rrëqethëse se si një serbi të zënë rob i ishte nxjerrë zemra në një vend afër qytetit të Kukësit, në veri të Shqipërisë, dhe organi është transportuar në Aeroportin e Rinasit, afër Tiranës për t'u shitur në tregun e zi⁴.

Si në rastin e «Krematorit të Kleçkës»⁵, kur gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i, improvizoi marrjen në pyetje të Bekim Mazrekut në prani të gazetarëve për të dëshmuar lidhur me gjoja vrasjen e civilëve serbë dhe djegien e tyre në «furrat e gëlqeres» dhe intervistën ekskluzive për Radio Televizionin e Serbisë që

¹ Shqiptarja «Fundi i pavarësisë së mbikqyrur»
<http://www.shqiptarja.com/kosova/2727/fundi-i-pavaresise-se-mbikqyrur-vetevendosja-kerkoi-heqjen-e-nen-1-3-117481.html>

² Večernje novosti, «Imamo svedoka o uzimanju organa» (Kemi dëshmitarë për marrjen e organeve), 09.09.2012
<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/dosije/aktuelno.292.html:396228-Imamo-svedoka-o-uzimanju-organa>

³ Po aty

⁴ Po aty

⁵ Që u shqyrtua në Kapitullin e parë të Librit I

kishte zhvilluar Milovan Drecun-i me këtë “dëshmitar”, Prokuroria serbe për krime lufte përgatiti një emision special për “trafikimin e organeve të nxjerra nga serbët e zënë rob”.

Tri ditë më vonë, Radio Televizioni i Serbisë transmetoi emisionin special të titulluar «Anatomia e krimit»¹ në të cilin opinioni publik i Serbisë pati mundësi të shihte intervistën që kishte zhvilluar gazetari i saj me këtë “dëshmitarë të mbrojtur”. Ky emision, siç e kishin paraparë ata që e përgatitën, tronditi opinionin publik serb.

“Mysafir special” i këtij emision special ishte Zëvendës Prokurori i Prokurorisë serbe për krime lufte, Bruno Vekarić-i.

Gjatë këtij emisioni, Bruno Vekarić-i sqaroi se Prokuroria vendosi ta publikonte dëshminë e “dëshmitarit të mbrojtur”, sepse kishte frikë se rasti mund të heshte. Ai theksoi se kjo dëshmi, para se të bëhej publike, ishte verifikuar nga ekspertë të mjekësisë dhe se ishte cilësuar si dëshmi e besueshme. Sado tronditëse që të jetë, dëshmia është e vërtetë tha Bruno Vekarić-i!

Shpresoj se në këtë kapitull lexuesi do të ketë mundësi të shohë se deri në cilat përmasa mund të shkojnë sajimet e një sistemi të “drejtësisë” së dirigjuar nga politika, që nuk është në gjendje të çlirohet nga logjika e regjimit të vjetër totalitar.

¹ RTS 1- «Anatomia zlocina-Trgovina organima srba sa Kosmeta», 10.09.2012
http://www.youtube.com/watch?v=yYgj4JH-_Ag

Raporti i Dick Marty-t

Siç e përmenda më lart, pas publikimit të veprës së Carla Del Ponte-s, me iniciativën serbe dhe ruse, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës u dorëzua propozimi për një rezolutë lidhur me “trajtimin çnjerëzor të personave dhe tregtinë ilegale me organet e njerëzve në Kosovë.”

Propozim rezoluta¹ e dorëzuar nga deputeti rus, Konstantin Kosachev-i, zgjoi interesim të madh, sidomos në kuadër të Komisionit për Çështjet Juridike dhe të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës.

Ky Komision emëroi Dick Marty-n të jetë, në të njëjtën kohë, raportues, i ngarkuar që të propozojë një draft fillestar të rezolutës dhe të përpilojë një raport për këtë çështje.

Para se të vazhdoj shtjellimin e temës, më duket me interes të përsëris qëndrimin e Dick Marty-t të mbajtur në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, më 16 prill 2008. Gjatë fjalimit të tij në këtë seancë, Dick Marty deklaroi se gjoja “të gjithë ata që shqetësohn për kriminalitetin e dinë se, mjerisht, Kosova ka qenë gjithmonë, e ndoshta sot më shumë se dje, qendër e kriminalitetit ndërkombëtar të krimit të organizuar.” Nëse kësaj deklarate i shtojmë edhe revoltën e tij të shprehur disa ditë më parë për “prezantimin e UÇK-së si të ishte një organizatë e virgjër dhe bamirëse” atëherë shtrohet pyetja se cilat ishin kriteret që përcaktuan që Dick Marty të emërohej në këto detyra. Sipas mendimit tim, emërimi i senatorit zviceran, Dick Marty-t, që të udhëhiqte hulumtimin rreth thënieve të Carla Del Pontes, mund të ishte çdo gjë, pos emërim “neutral”.

Pesë muaj pasi Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë mori vendimin se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e kishte shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, as Kornizën Kushtetuese të Kosovës dhe asnjë rregull të aplikueshëm të së drejtës ndërkombëtare, Dick

¹ Conseil de l'Europe, Assemblée Parlementaire, dokumenti i cituar, Doc. 11574, 15 avril 2008

Marty, më 12 dhjetor 2010, dorëzoi projekt-raportin për «Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin kundërligjor me organe njerëzore në Kosovë». Më 16 dhjetor propozimi që prezantoi Dick Marty u miratua unanimisht nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, ndërsa më 7 janar 2011 u dorëzua në formën e Rezolutës¹, të cilën Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e miratoi më 25 janar 2011.

Për të mos lënë asnjë dyshim lidhur me atë se çka nënkupton me fjalën «Kosovë», Dick Marty që në titullin e projekt-raportit, fjalën «Kosovë» e shënon me yll (*) për ta sqaruar në fund të faqes.

Në sqarimin që jep, ai saktëson se në tekstin që prezanton si raport, “të gjitha referimet që kanë të bëjnë me Kosovën, qoftë territori, qofshin institucionet apo popullata e saj, duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykuar statusin e Kosovës.”²

Dick Marty kërkon që të mos paragjykohet statusi i Kosovës!
Contradictio in adjecto!

Në pjesën e mësipërme të librit solla faktet se ai që asnjëherë nuk e kishte ngritur zërin për të kërkuar ndërprejjen e sulmit ushtarak dhe policor serb në Kosovë, e çori gurmazin duke kërkuar që të ndërpriteshin bombardimet kundër caqeve të ushtrisë dhe policisë serbe, të cilat i cilësonte si “sulme i paligjshëm kundër Serbisë”;

¹ Conseil de l'Europe, Assemblée Parlementaire, Doc. 12462, 07 janvier 2011
Le traitement inhumain de personnes et le trafic illicite d'organes humains au Kosovo
<http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-FR.asp?FileID=12608&lang=fr>

² Conseil de l'Europe, Assemblée Parlementaire ,
Commission des questions juridiques et des droits de l'homme,
«Traitement inhumain de personnes et trafic illicite d'organes humains au Kosovo», sqarimi pas paragrafit 6
<http://assembly.coe.int/asp/apfeaturesmanager/defaultArtSiteVoir.asp?ID=964>
Në vijim të shënimeve në fund të faqes ky raport do të emërohet shkurtimisht:
Raporti i Dick Marty-t

Ai, për të cilin shqiptarët e Kosovës nuk janë popull të cilit i takon e drejta për vetëvendosje, por, “shqipfolës” që kishin shpallur “pavarësinë në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare”;

Ai, për të cilin “Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara flet në tri vende për integritetin territorial serb dhe thotë se Kosova është krahinë serbe që do të administrohej përkohësisht nga ndërkombëtarët”;

Ai që deklaroi se “shumica e vendeve nuk e kanë njohur dhe nuk do ta njohin Kosovën” nxori në shesh paragjykimet e veta për Kosovën si territor, institucione dhe popullsi nën sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë;

I njëjti Dick Marty, me dinakërinë që e karakterizon, përmes kërkesës për të mos e “paragjykuar statusin e Kosovës”, u përpoq të mbajë gjallë interpretimin serb të rezolutës 1244, sipas të cilës “Kosova është pjesë e Serbisë”!

Pas kërkesës që Kosova të konsiderohet në përputhje me interpretimin që kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës i bëjnë rezolutës 1244, Dick Marty i kushton një rëndësi të veçantë “argumentimit” pse kishin dështuar hetimet e ndërmarra nga Gjykata e Hagës për krimet e supozuara të UÇK-së.

Në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën terminologji të përpiluar nga shërbimet sekrete serbe, Dick Marty e sheh këtë dështim si rezultat të dy faktorëve: faktorëve që lidhen me shoqërinë shqiptare dhe ndihmën politike dhe diplomatike të vendeve perëndimore dhe sidomos ndihmën e SHBA-ve.

Sa i përket faktorëve që lidhen me funksionimin e shoqërisë shqiptare, në paragrafin 53 të raportit të tij, Dick Marty deklaroi se “kemi konstatuar se strukturat e njëjta të UÇK-së në rajonet e Kosovës prej nga vinin komandantët e tyre, ishin ndërtuar, në masë të madhe, sipas një hierarkie ku mbizotëronte besnikëria dhe kodi i nderit i klaneve apo familjeve të zgjeruara të etnisë shqiptare, e që formojnë një tërësi rregullash të njohura me emrin Kanun.”¹ Jo vetëm kaq, ai dhe bashkëpunëtorët e tij kishin

¹ Po aty, paragrafi 53

“konstatuar se njësitë kryesore të UÇK-së dhe komandat e zonave të tyre operative përkatëse, ishin pothuajse një kopje e strukturave që kontrollonin disa forma krimi të organizuar në territoret ku vepronte UÇK-ja.”¹

Për ta bërë edhe më të “kapshme” për lexuesin, Dick Marty deklaroi se “gjërat janë shumë të thjeshta. Për ta kuptuar se kush i udhëhiqte tregtitë e ndryshme dhe aktivitetet e kontrabandës që lulëzonin në rajon, mjafton ta dimë se kush komandonte në atë zonë të caktuar të Kosovës apo Shqipërisë.”²

Këtu lexuesi e sheh se me të vërtetë gjërat janë tepër të thjeshta: Dick Marty identifikohet tërësisht me propagandën serbe të publikuar në «librat e bardhë»! Me të vetmin dallim se nuk e përmend emrin e burimit të vërtetë të informatave dhe mungon paraqitja figurative e skemës së “klaneve të mafies shqiptare” që bazohen në Kanun!

Për të fshehur gjurmët e burimeve të vërteta, Dick Marty thotë se është mbështetur “te personeli që ka punuar për vite të tëra në Kosovë dhe që ishin bërë vrojtuesit më të nderuar në lëmin e drejtësisë në regjion!”³ Por, ai nuk tregoi nëse bëhej fjalë për juristët serbë që ishin tërhequr në Serbi bashkë me forcat ushtarake dhe policore serbe, juristë të llojit të Danica Marinković-it, apo për juristë ndërkombëtarë të llojit të Céline Bardet-it, që kishin ardhur të “ndihmonin” Kosovën! Ai u kufizua vetëm në pohimet se këta juristë i kanë treguar “se ishte jashtëzakonisht e vështirë të infiltrohej te rrjetet shqiptare të krimit të organizuar («mafia shqiptare»), e cila ishte e vendosur në Shqipëri dhe në vendet fqinje, kryesisht në Kosovë dhe «ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë», si dhe në gjirin e diasporës shqiptare. Madje, infiltrimi në mafien shqiptare është edhe më i vështirë se infiltrimi te mafia italiane.”⁴

Dick Marty e di fare mirë se nuk mund të infiltrohesh në diçka që nuk ekziston në realitet e që është sajim i shërbimeve

¹ Po aty, paragrafi 54

² Po aty, paragrafi 55

³ Po aty, paragrafi 26

⁴ Po aty, paragrafi 26

sekrete serbe në funksion të stigmatizimit të shqiptarëve. Por, duke u munduar të fshehë infiltrimin e tij në kumbarinë e nocioneve të përpiluara nga Shërbimi Sekret Serb, Dick Marty fajëson shqiptarët për pamundësinë e “infiltrimit të mafia shqiptare”. Në veçanti ai fajëson “besnikërinë dhe kodin e nderit të klaneve shqiptare” sepse, sipas tij, për shkak të kësaj mënyre të funksionimit të shoqërisë shqiptare “ekzekutuesit e thjeshtë që ndodhen në shkallën më të ulët të hierarkisë së rrjeteve kriminale, më përë pranojnë të qëndrojnë me dhjetëra vite në burg, ose të dënohen për mosbashkëpunim me drejtësinë, sesa ta dorëzojnë ndonjë anëtar të klanit të tyre.”¹

Për të njëjtat arsye, mosbesimin ndaj përkthyesve shqiptarë të shprehur nga Carla Del Ponte, Dick Marty e ngriti në atë shkallë saqë përkthyesit i shpalli si burim të dështimit të çdo hetimi të krimeve të kryera në Kosovë! Në raportin e tij, pa përmendur emrin e asnjë përgjegjësi të administratës ndërkombëtare në Kosovë, Dick Marty shkruan se “përgjegjësit e administratës ndërkombëtare i kishin treguar atij për pamundësinë e mbajtjes së besueshmërisë së burimeve të tyre për shkak se është dashur të bazohen në përkthyesit lokalë, që shpeshherë kanë shpërndarë informacione për njerëzit që po hetoheshin. Si rezultat i kësaj, EULEX-it i është dashur të angazhojë përkthyes nga vende të tjera në mënyrë që t'i vazhdojnë hetimet e tyre më të ndjeshme.”²

Në vend që të pranohej realiteti se nuk mund të gjendeshin fakte për diçka që nuk kishte ndodhur realisht, Dick Marty, njëlloj sikurse ata që kishin hyrë në kumbarinë e nocionit «mafia shqiptare», fajëson KFOR-in dhe UNMIK-un se gjoja nuk i kishin kushtuar seriozitetin e duhur krimeve të UÇK-së...

Përveç fajësimit të KFOR-it dhe të UNMIK-ut, ai u mundua të shpjegojë edhe motivet e kësaj mungese serioziteti të ndër-kombëtarëve në raport me krimet e supozuara të UÇK-së. Sipas këtij shpjegimi, gjatë luftës kundër forcave serbe “shtetet perëndimore ishin kufizuar nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë në

¹ Po aty, paragrafi 26

² Po aty, paragrafi 7 i shqyrtimeve preliminare.

terren, duke parapëlqyer që goditjet në caqe t'i bënin nga ajri. Kështu, UÇK-ja ishte bërë aleat i tyre i domosdoshëm për operacionet tokësore. Për këtë arsye, aktorët ndërkombëtarë kanë zgjedhur t'i mbyllin sytë për krimet e luftës që ka bërë kjo e fundit.”¹ Me një fjalë, refuzimi që t'i marrin të gatshme sajimet e propagandës serbe, apo përfundimi i hetimeve për shkak të mungesës së provave, nga Dick Marty cilësohet si “mungesë e vullnetit që të konfrontohen me aleatët e tyre që zhvilluan luftën në tokë!”

Nëse “shtetet perëndimore dhe SHBA-të nuk kanë vullnet të përballen me UÇK-në” Dick Marty është i gatshëm që të dëshmojë të kundërtën e asaj “që propagandohej nga vendet perëndimore për UÇK-në, si të ishte një organizatë e virgjër dhe bamirëse.”

Pasi u bëri marketing sajimeve të Shërbimit Sekret Serb për “funksionimin klanor të shoqërisë shqiptare” ai u ndal te UÇK-ja.

Lexuesit i kujtohet se, sipas «Librit të Bardhë» serb, “prapa motiveve ideologjike dhe kombëtare për krijimin e një shteti të vetëm shqiptar, pavarësisht nëse do të quhej «Shqipëria e Madhe» apo «Kosova e Madhe», fshiheshin interesat e disa strukturave kriminale, që tentojnë të bëhen pjesë e proceseve ekzistuese politike dhe ekonomike për të legalizuar punët e tyre kriminale.”²

Në përputhje të plotë me këtë orientim propagandistik të regjimit të Milošević-it, Dick Marty u përpoq fillimisht të hedhë poshtë “imazhin që ishte krijuar për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si një ushtri guerilase që ka luftuar trimërisht për të mbrojtur të drejtat e bashkatdhetarëve të tyre për të jetuar në territorin e Kosovës”³ dhe deklaroi se ai dhe ekipi i tij “kishin zbuluar se ky imazh është në kundërshtim me realitetin!”⁴

Nga paragrafi i 29 i raportit politik që mban emrin e Dick Marty-t e deri në paragrafin 92 të tij kemi një sintezë të «Librit të Bardhë» që paraqet imazhin e sajuar nga Shërbimi Sekret Serb si imazh “i vërtetë” i UÇK-së!

¹ Po aty, paragrafi 7 i shqyrtimeve preliminare

² Vlada Serbije, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, f.7-8

<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

³ Raporti i Dick Marty-t, paragrafi 31

⁴ Po aty, paragrafi 31

Pra, të kamufluar me plafin e “rezultateve të detajuara të hulumtimit”, 67 paragrafë nga 176 që përmban ky raport¹ i kushtohen “fraksioneve të UÇK-së dhe lidhjet e saj me krimin e organizuar.”²

Me qëllim që të përgatiste terrenin për t’u dukur e besueshme gënjeshtër për “tregtinë me organet njerëzore të serbëve të rrëmbyer në Kosovë, të cilëve u ishin nxjerrë organet në klinikat e improvizuara në Shqipëri dhe pastaj ishin dërguar për klientët që paguanin shtrenjtë në shtetet perëndimore”, në këtë pjesë të raportit, Dick Marty tërheq vëmendjen se gjoja “para, gjatë dhe pas luftës së Kosovës, UÇK-ja kishte vepruar kryesisht në Shqipërinë Veriore, atje ku forcat policore serbe nuk kishin qenë të vendosura asnjëherë.”³

Për të pohuar një gjë të tillë, Dick Marty, në paragrafin 38 të raportit të tij sqaroi se në këtë rast ata ishin mbështetur “në burimet e tyre të afërta me UÇK-në dhe në dëshmitë e anëtarëve të UÇK-së që ishin burgosur nga policia serbe.”

Nga veriu i Shqipërisë, “terroristët e UÇK-së” kishin arritur t’i fusnin armët dhe municionin “kontrabandë, të ngarkuar në kuaj dhe rrugëve malore” dhe i kishin shpërndarë në rajone të ndryshme të Kosovës, për të kryer, siç i cilësonte policia serbe, “sulme terroriste kundër forcave të sigurisë serbe.”⁴

Dick Marty, i cili identifikohet tërësisht me interpretimin serb, nuk e la anash as qëndrimin e “shqiptarëve kosovarë dhe qytetarëve shqiptarë për të cilët operacionet e kontrabandës ishin akte heroike⁵. Në një shoqëri ku “mbizotëron besnikëria dhe kodi i nderit i klaneve” nuk mund të ketë qëndrim tjetër për kriminalitetin dhe kontrabandën, pos himnizimit të tyre! E thjeshtë apo jo?! Dick Marty sqaron se “gjërat janë tepër të thjeshta për t’u kuptuar”! Aq më tepër kur “shoqërisë shqiptare të Kosovës, edhe

¹ Pra, më shumë se 1/3 e raportit

² Pjesa 3 e raportit

³ Po aty, paragrafi 36

⁴ Po aty, paragrafi 39

⁵ Po aty, paragrafi 39

pas dhjetë vjet administrimi ndërkombëtar, i mungon shoqëria e mirëfilltë civile!”¹

Kjo logjikë interpretimi ndërtohet në atë mënyrë që gjërat të duken të “qarta” dhe të “kuptueshme”! Në një shoqëri “pa shoqëri civile, ku klanet mafioze kanë imponuar ligjin e heshtjes” ku “komandantët e zonave operative të UÇK-së ishin kopje e strukturave që kontrollonin krimin e organizuar në territoret ku vepronte ajo” ku “pas tërheqjes së forcave serbe komandantët e UÇK-së morën pushtetin politik në duart e veta”², pra “në një shoqëri të tillë klanore ku përveç krimit nuk funksion asgjë, edhe mafia nuk është e ndërtuar me hierarki piramidale, në majë të së cilës do të ishte vetëm një «kumbar», por, në Kosovë funksionojnë një varg piramidash me një numër «kumbarësh» në krye të tyre.”³

Dick Marty dhe ekipi i tij përpiqen të ekspozojnë gjenezën e “strukturave kriminale” në Kosovë, dhe sipas “burimeve” të tyre ky fenomen është i ndërlidhur me fraksionet e UÇK-së. Në paragrafin 48 të raportit të tij, Dick Marti deklaroi me pompozitet se “fraksionet e UÇK –së, që ishin të pranishëm qysh në vitin 1998, u bënë edhe më të dukshme pas vdekjes së komandantit të njohur katundar të UÇK-së, Adem Jasharit.”⁴

“Komandanti katundar”! Senatori zviceran, Dick Marty, nuk u kursye në përdorimin e terminologjisë përbuzëse ndaj shqiptarëve edhe pse një historian zviceran, Oliver Jens Schmitt-i, kërkonte nga ata të cilët i kushtohen ndriçimit të ngjarjeve lidhur me Kosovën që “të jenë vigjilentë, sidomos kur trajtohen tema lidhur me krimin e organizuar, sepse Qeveria serbe dhe qarqet ruse kishin strategjinë “për t’i kriminalizuar shqiptarët e Kosovës dhe për t’i paraqitur si kriminelë dhe tregtarë droge.”⁵

Njëloj si Oliver Jens Schmitt-i, i cili përkundër kësaj kërkese për vigjilencë, edhe vetë përdori “terminologjinë serbe dhe ruse

¹ «Rapport de la Délégation parlementaire suisse auprès du Conseil de l'Europe du 31.12.2008», cituar më lart

² Raporti i Dick Marty-t, paragrafi 84

³ Vlada Srbije, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, f.38-39

⁴ Raporti i Dick Marty-t, paragrafi 48

⁵ Oliver Jens Schmitt, vepra e cituar, f. 227

për t'i kriminalizuar shqiptarët e Kosovës” dhe përbuzi “kultin e katundarit Adem Jashari”¹, edhe për Dick Marty-n “Adem Jashari është një katundar, që ka kontrabanduar armë nga Shqipëria në Kosovë dhe pas vrasjes u fut në folklorin popullor si shprehje romantike e çlirimit të Kosovës”²

Krahas përdorimit të termit “katundar” në kuptimin përbuzës të fjalës, në raportin e Dick Marty-t, grupet e vogla të UÇK-së cilësohen si “grupe që përbëhen nga një bërthamë besnike e rekrutëve dhe mbështetësve të ardhur nga disa klane apo familje të lidhura ngushtë dhe të udhëhequra nga njëri prej anëtarëve të vetëshpallur anëtarë themelues të UÇK-së.”³ Të mos harrojmë se ata “kishin konstatuar (...) se komandat e zonave të tyre operative përkatëse, ishin pothuajse një kopje e strukturave që kontrollonin disa forma krimi të organizuar në territoret ku vepronte UÇK-ja.”⁴

Megjithatë, për t’u treguar “i kujdesshëm” dhe “jo përgjithësues” ndaj stigmatizimit të UÇK-së, Dick Marty nuk e mohoi se “një numër ushtarësh trima kanë qenë të gatshëm për të shkuar në front dhe për t’i bërë ballë kundërshtarit dhe nëse ishte nevoja edhe të vdisnin për çështjen e atdheut të pavarur të shqiptarëve kosovarë”⁵. Por, “luftëtarët e tillë nuk përbënin shumicën e UÇK-së.”⁶

Edhe pse nuk e thotë shkoqur, nga tërësia e qëndrimeve të mëparshme të Dick Marty-t dhe nga raporti i “tij” del qartë se për këtë kumbar të nocioneve të sajuara nga Shërbimi Sekret Serb, shumica e luftëtarëve të UÇK-së “janë terroristë, kriminelë, mafiozë...”

Në këtë raport ai nuk la pa përmendur shumicën e “klaneve mafioze” të ekspozuara në «Librin e Bardhë» serb. Por, nga të gjitha “strukturat e UÇK-së që depërtuan në proceset politike dhe

¹ Rreth këtij trajtimi përbuzës dhe ndarjes katundar/qytetar të shoqërisë së Kosovës nga Oliver Jeans Schmitt-i shih veprën e tij të cituar f.285-286. Për një trajtim kritik ndaj këtij qëndrimi shih më gjerësisht veprën e Jakup Krasniqit: «Një histori e kontestuar», Shtëpia Botuese Buzuku, Prishtinë, 2013, f.118-124

² Raporti i Dick Marty-t, paragrafi 48 dhe shënimi 16

³ Po aty, paragrafi 49

⁴ Po aty, paragrafi 54

⁵ Po aty, paragrafi 32

⁶ Po aty, paragrafi 32

ekonomike” në Kosovë, Dick Marty veçoi «Grupin e Drenicës» si më të rrezikshmin në krahasim me “strukturat e tjera mafioze që sundonin” në Kosovë.

Për t’u dalluar nga burimi i vërtetë i informatave, në raportin “e vet” ai nuk e inkorporoi skemën organizative që kishte publikuar Shërbimi Sekret Serb për «Grupin e Drenicës», edhe pse ishin kopjuar me besnikëri të plotë të gjitha thëniet e «Librit të Bardhë». Emrat, mbiemrat, lidhjet e tyre dhe llojet e veprimtarive kriminale që u vishen personave të apostrofuar nga Shërbimi Sekret Serb u kopjuan tërësisht nga Dick Marty. Është interesante të theksohet se përmes referimeve në “degët” e një “lumi informatash”, autorët e raportit në fjalë përpiqen të fshehin “plagjiaturën” për burimin e vërtetë të “informatave” («Libri i Bardhë»). Në funksion të kësaj fshehjeje, Dick Marty deklaroi me mburrje se gjatë “hulumtimit” të tij ai ishte mbështetur “në shërbimet e informimit të NATO-s dhe të katër shteteve.”¹ Por, së paku njëri nga këta katër shërbime të inteligjencës ku pretendon të jetë mbështetur Dick Marty e pranon se është bazuar në të dhënat e ofruara nga Shërbimi Sekret Serb. Në raportin e Shërbimit Sekret të Gjermanisë (BND-së)², që u përmend më lart, në faqen 14, pika 2.2.1 thuhet qartë se burim informate ishte Shërbimi Sekret Serb (BIA).

Përderisa Dick Marty i referohet raportit të Shërbimit Sekret të Gjermanisë, ai duhet ta ketë lexuar se ku i ka marrë informatat ky shërbim. Por, Dick Marty-t nuk i bëhet vonë për këtë punë. Për të ngarkuarin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe për ekipin që udhëhiqej prej tij, e vetmja gjë e rëndësishme që kishin “zbuluar” gjatë “hulumtimit” të tyre, kishte të bënte me “konstatimin se prijësi i këtij grupi, apo, nëse e përdorim terminologjinë që karakterizon rrjetet kriminale, «kumbara» e këtij grupi ishte Hashim Thaçi.”³

¹ Gjermanisë (BDN), Italisë (SISMI), Britanisë së Badhe (MI6) dhe Greqisë (EYP)

² BND Kosovo Feb 2005 vs Vertraulich

<http://fr.scribd.com/doc/22922472/Bnd-Kosovo-Feb-2005-vs-Vertraulich>

³ Raporti i Dick Marty-t, paragrafi 58

Krahas përdorimit të termit «kumbar» për ta stigmatizuar Hashim Thaçin si “mafioz”, Dick Marty nuk la pa përmendur as figurën metaforike të strukturës mafioze, «oktapodin». Në paragrafin 67 të raportit të “tij”, ai e cilësoi Hashim Thaçin si “më i rrezikshmi nga «kumbarët e oktapodit» të UÇK-së.”¹

Dick Marty dhe trafikimi i paligjshëm me organet njerëzore

Raporti që u publikua në emër të Dick Marty-t ngërthen në vete një sintezë të materialit propagandues dhe stigmatizues që Shërbimi Sekret Serb kishte shpërndarë për «Grupin e Drenicës». Që nga Hashim Thaçi, si “më i rrezikshmi nga «kumbarët e oktapodit» të UÇK-së”² e deri te personalitete tjera të UÇK-së, si Xhavit Haliti, Azem Sylja, Kadri Veseli, Fatmir Limaj e të tjerë, të gjithë cilësohen si pjesëtarë të një “organizate terroriste dhe kriminale” të cilëve ua vesh veprat më të shëmtuara të vrasjeve, rrëmbimeve, burgosjeve dhe keqtrajttimeve të civilëve të komuniteteve të ndryshme që jetonin në Kosovë.”³

Përveç vrasjeve dhe keqtrajttimeve të njerëzve, «Grupit të Drenicës» i ngarkohen edhe “kontrabanda me armë, trafikimi me drogë⁴, tregtia me cigare⁵, kontrolli mbi tregtinë e derivateve të naftës⁶, marrja me prostitucion⁷, trafikimi me qeniet njerëzore⁸ si dhe shitja e organeve njerëzore.”⁹

Në këtë raport, përmendja e formave të ndryshme të veprimtarive kriminale dhe lidhja e këtyre veprimtarive me udhëheqësit e UÇK-së u bë në funksion të “përgatitjes së terrenit”

¹ Po aty, paragrafi 67

² Po aty, paragrafi 67

³ Po aty, paragrafët 72

⁴ Po aty, paragrafi 66

⁵ Po aty, paragrafi 71 shënimi 28

⁶ Po aty, paragrafi 71 shënimi 28

⁷ Po aty, paragrafi 134

⁸ Po aty, paragrafi 65

⁹ Po aty, paragrafët 159-167

për të shtruar bazat e krimit më të shëmtuar që mund t'u vishej udhëheqësve të një lufte çlirimtare: “nxjerrja e organeve nga të burgosurit serbë dhe shitja e këtyre organeve në tregun e zi të shteteve perëndimore”!

Në paragrafin 74 të raportit të tij ai akuzon “udhëheqësit e «Grupit të Drenicës» si “përgjegjës për dy seri të krimeve: për udhëheqjen e qendrave të paraburgimit të UÇK-së në territorin shqiptar; dhe për përcaktimin e fatit të burgosurve në këto ndërtesa, duke përfshirë zhdukjen e shumë civilëve të rrëmbyer në Kosovë dhe të marrë përtej kufirit, në Shqipëri.”¹

Dick Marty, i cili u ngarkua nga Komisioni për Çështje Juridike dhe të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës për të udhëhequr hulumtimin rreth thënieve të Carla Del Ponte-s për supozimet rreth një “trafiku me organe të serbëve që ishin rrëmbyer nga UÇK-ja” ishte në dijeni të vërejtjeve të shumta që iu bënë ish-Prokurores së përgjithshme të Gjykatës së Hagës.

Ndër vërejtjet e shumta që iu bënë Carla Del Ponte-s për publikimin e kësaj çështjeje lidhej me vështirësitë teknike që paraqiste transportimi i “organeve” nga veriu i Shqipërisë deri te aeroporti i Rinasit. Konkretisht, në kohën kur supozohej se ishte kryer tregtia me organe, nga veriu i Shqipërisë e deri në aeroport duheshin së paku 12 orë udhëtim dhe mjete transportuese të përshtatshme për atë terren.

Që të shmangej një kundërthënie e tillë, Dick Marty-t deklaroi se “ gjatë hulumtimit tonë, ne kemi identifikuar të paktën gjashtë vende burgimi në Shqipëri, të vendosura në një zonë që shtrihej nga Cahani në rrëzë të malit Pashtrik, pothuajse në pikën më veriore të Shqipërisë, e deri tek rruga bregdetare në Durrës, përgjatë bregdetit të Mesdheut në perëndim të Shqipërisë.”²

Në vazhdim të raportit “përshkruhen karakteristikat kryesore të vendeve të burgimit të UÇK-së në kohën e luftës ... dhe burgosjet pas konfliktit nga anëtarë dhe bashkëpunëtorë të UÇK-së.”³

¹ Po aty, paragrafi 74

² Po aty, paragrafi 93

³ Po aty, paragrafi 101

Gjatë këtij përshkrimi Dick Marty nuk la pa hequr edhe kundërthëniet që lidheshin me pohimet se gjoja nxjerrja e organeve ishte bërë në shtëpinë e njohur si «Shtëpia e Verdhë» (apo Shtëpia K).

Fillimisht ai bëri përshkrimin zi e më zi të akteve kriminale që gjoja ishin bërë në këtë shtëpi, si vrasja e të burgosurve serbë, shfrytëzimi seksual i femrave nga pjesëtarët e UÇK-së dhe nga fshatarët e fshatit Rripë¹. Pas këtij përshkrimi, Dick Marty pohoi se “ka prova të mjaftueshme për të gjitha krimet por, UÇK-ja kishte imponuar heshtjen e banorëve të fshatit Rripë qoftë përmes kërcënimeve, qoftë përmes “përfitimeve” duke u ofruar shuma të konsiderueshme parash, alkool, drogë dhe prostituta.”²

Përkundër kësaj, Dick Marty ngul këmbë se gjoja “ka prova”, por provat janë “zhdukur përmes varrosjeve dhe zhvarrosjeve të kufomave”³ dhe ndriçimin e këtyre krimeve e vështirëson sjellja e banorëve të fshatit Rripë, të cilët nuk pranojnë të dëshmojnë për arsye të “frikës, apo për shkak të korrupsionit përmes parave, alkoolit, drogës dhe prostitutave” !!! Dhe kjo formë e prezantimit të “fakteve” konsiderohet si “bindëse” dhe puna e ekipit që përpiloi raportin cilësohet si hulumtim “serioz”!

Sa i përket “zbulimit” në lidhje me «Shtëpinë e Verdhë», Dick Marty mburret se dëshmitë e tyre kanë nxjerrë në shesh një dimension të operacioneve të ndërmarra nga UÇK-ja të cilin nuk e kanë vërejtur as ekipi i gazetarëve amerikanë, as prokurorja e Gjykatës së Hagës, Carla Del Ponte e as zbulimet e vazhdueshme mediatike rreth kësaj çështje⁴.

Në raport “sqarohet” se kjo shtëpi “nuk mund të llogaritet si pika e fundit, apo destinacioni i fundit në transportin e të burgosurve dhe qendrave të ndalimit, të cilat ishin të ndërlidhura njëra me tjetrën. Roli i saktë i kësaj shtëpie dhe rëndësia e saj në të gjitha operacionet, ndoshta ka qenë i keqinterpretuar deri më tani.”⁵ Pra, Dick Marty “zbuloi” se kjo shtëpi ku ishin nxjerrë

¹ Po aty, paragrafët 141-148

² Po aty, paragrafët 145-147

³ Po aty, paragrafi 147

⁴ Shih paragrafin 149

⁵ Po aty, paragrafi 151

organet por, sipas tyre, “«Shtëpia e Verdhë» ka qenë një ‘stacion i ndërmjetëm’, ku të burgosurit ishin mbajtur deri në momentin e transferimit për në qendrën ku i priste fati përfundimtar.”¹

Ky “zbulim” u bë në funksion të mënjanimit të dyshimeve që kishte krijuar pohimi se “organet u ishin nxjerrë” në një largësi gjeografike 10-12 orë nga aeroporti i vetëm ndërkombëtar i Shqipërisë. Për ta afruar vendin e “nxjerrjes së organeve” sa më afër aeroportit të Rinasit, Dick Marty dhe ekipi i tij “zbuluan” se vendi i fundit, ku supozohej të ketë marrë fund “përzgjedhja” e të burgosurve, “ishte një shtëpi dy kateshe, që kishte shërbyer si strehë për të besuarit e UÇK-së dhe për grupet e organizuara kriminale të cilat merreshin me tregti droge.”² Në këtë “strehë” që ndodhej “në aksin Fushë-Krujë” (sic!) “grupi i vogël i përzgjedhur i robërve të UÇK-së ishte takuar me vdekjen e tyre.”³ Sipas “burimeve” në të cilat ishte mbështetur ekipi që përpiloi raportin në fjalë, “aksi rrugor Fushë-Krujë ishte zgjedhur si i përshtatshëm për ndërtesat e kësaj natyre për shkak të afërsisë me aeroportin kryesor që i shërbente Tiranës.”⁴ Duke e përcaktuar vendin e “klinikës së operacioneve” në afërsi të aeroportit për lexuesin e raportit bëhej më e besueshme sepse “edhe vizitat e ndërkombëtarëve edhe dërgimi i organeve ishte i realizueshëm më lehtë.”⁵

Duke pasur lidhësen në mes, toponimi i qytetit Fushë-Krujë ka krijuar përshtypjen te Dick Marty, te ekipi i tij dhe te “burimet e besueshme” që e kanë informuar sikur të ishin dy vendbanime të veçanta! Duke mos ditur ku ta lëshojnë gënjeshtren për destinacionin final të serbëve të burgosur, ata e “vendosën” diku në “aksin rrugor” në mes vendbanimeve “Fushë” dhe “Krujë”! Informata të “besueshme” e jo shaka!

Sikur të kishin qenë më seriozë Dick Marty dhe ekipi i tij, do ta kishin kuptuar se Fushë-Kruja është një qytet e jo dy vendbanime të lidhura me një aks rrugor! Por, Dick Marty-t nuk i bëhet

¹ Po aty, paragrafi 152

² Po aty, paragrafi 158

³ Po aty, paragrafi 159

⁴ Po aty, paragrafi 167

⁵ Po aty, paragrafi 167

vonë për të gjitha rrugët e gabueshme ku kërkonte gjurmët e krimeve e lëre më për “aksin rrugor Fushë-Krujë”!

Pas “zbritjes” nga malet e veriut të Shqipërisë në “fushë afër aeroportit”, Dick Marty i kushton një vëmendje të veçantë procedurave mjekësore të nxjerrjes së organeve për transplantim.

Një nga kritikantët e shumta që iu bë librit të Carla Del Ponte-s, kritika që vinin kryesisht nga specialistët të kirurgjisë, kishte të bënte me thëniet se gjoja “viktimize që u ishte nxjerrë vetëm njëra veshkë, ishin qepur dhe ishin kthyer në kolibe ku mbaheshin në pritje të shtrohen në tavolinën e operacionit një herë tjetër për t’ju nxjerrë organet tjera vitale.”¹

Për të shmangur kritikantët e kësaj natyre, Dick Marty deklaroi se “nuk kishin gjetur asnjë element që do të vërtetonte thëniet sipas të cilave disa viktimize u ishte nxjerrë njëra veshkë, pastaj ishin qepur dhe ishin burgosur sërish para se t’ia nxirrnin edhe veshkën tjetër.”²

Pas “konsultimeve të drejtpërdrejta me ekspertët”³ Dick Marty hedh poshtë “skepticismin nëse operacioni i tillë ishte i mundshëm në atë kohë në Shqipëri” dhe “sipas ekspertëve të mirënjohur për transplantimin e organeve, procedura e nxjerrjes së veshkave nga kufomat ishte i mundshëm, efikas dhe me rrezik të vogël.”⁴

Ai dhe ekipi i tij “gjatë hulumtimit” kishin “zbuluar” se UÇK-ja kishte “aplikuar pikërisht metodën e nxjerrjes së organeve nga kufomat”! Jo vetëm kaq, por Dick Marty dhe ekipi i tij konfirmojnë se “dëshmitë mbi të cilat janë bazuar përfundimet tona, flasin për një metodologji të besueshme dhe koherente për vrasjen e të gjithë të burgosurve, zakonisht me nga një plumb në kokë, para se të bëheshin operacion për heqjen e njëres apo më shumë organeve. Ne mësuam se bëhej fjalë kryesisht për tregti të "veshkash të nxjerra nga kufomat", që do të thotë se veshkat janë nxjerrë pas vdekjes e jo përmes një serie procedurash të sofistikuar kirur-

¹ Carla Del Ponte, vepra e cituar *La traque, les criminels de guerre et moi*, f. 457

² Raporti i Dick Marty, shënimi 41.

³ Paragrafi 166, shënimi 43

⁴ Po aty.

gjikale që kërkojnë kushte klinike të kontrolluara, për shembull, përdorimi intensiv i anesteziës.”¹

Dick Marty dhe ekipi i tij pretendojnë se mbështeten në “dëshmitarë” për të shkruar gjëra të tilla në raport, por në të njëjtin raport deklarojnë se askush nuk dëshiron të dëshmojë sepse “UÇK-ja kishte imponuar heshtjen qoftë përmes kërcënimeve, qoftë përmes përfitimeve duke u ofruar shuma të konsiderueshme parash, alkooli, droge dhe prostituta.”²

Mirëpo, kritikrat e Dick Marty-t nuk kufizohen vetëm në “heshtjen që «Grupi i Drenicës» u kishte imponuar shqiptarëve”. Kritika të ashpra shprehin edhe ndaj “tërë atij komuniteti ndërkombëtar në Kosovë duke filluar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara dhe fuqitë tjera aleate perëndimore e deri te autoritetet e drejtësisë të cilat ushtrojnë veprimin e tyre nën ombrellën e Bashkimit Evropian. Të gjithë i kanë informatat e njëjta për krimet e kryera nga «Grupi i Drenicës», por asnjëri prej tyre nuk është i gatshme të reagojë ndaj një situatë të tillë dhe të kërkojnë llogari nga përgjegjësit e këtyre veprimeve.”³

Në raport kritikohen autoritetet e Shqipërisë dhe sidomos prokuroria shqiptare, kritikohet administrata e Kosovës, kritikohen SHBA-të dhe fuqitë tjera perëndimore, “pa ndihmën e të cilëve Hashim Thaçi nuk do të kishte mundur të ngjitej në këtë pozitë”⁴ e as «Grupi i Drenicës», nuk do të kishte marrë pushtetin në Kosovë! Kritika kundër UNMIK-ut dhe EULEX-it. Kritika kundër “Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, për arsye se kjo gjykatë, kur çështja u mbyll për mungesë provash, i shkatërroi materialet, pasi i kishte fotografuar⁵. Por, i njëjti Dick Marty dhe ekipi që udhëhoqej prej tij, nuk thanë asnjë fjalë të vetme për faktin se “një pjesë e dokumentacionit të përgatitur nga autoritetet serbe ishte shkatërruar, ndërsa një pjesë mbeti në godinën e qeverisë federale të Jugosllavisë, të kontrolluar nga

¹ Po aty, paragrafi 162

² Po aty, paragrafët 145-147

³ Po aty, paragrafi 71

⁴ Po aty, paragrafi 60

⁵ Shih paragrafin 17

serbët dhe për fatin e të cilës nuk dihet asgjë tjetër pos faktit se vdiq çdo aktivitet”¹ lidhur me këto krime të supozuara.

Jo! Dick Marty nuk bën asnjë vërejtje ndaj autoriteteve të Serbisë, Prokurorisë për krime lufte dhe Shërbimit Sekret Serb! Për më tepër ai shpreh keqardhje për dështimin e përpjekjeve të mëdha që kishte bërë Prokuroria speciale e Beogradit për krime lufte dhe falënderimi i vetëm që jepet në këtë raport i drejtohet “prokurorit special serb për gatishmërinë dhe bashkëpunimin që kishte treguar.”²

Reagimet lidhur me Raportin e Dick Marty-t

Siç u theksua në fillim të këtij kapitulli, më 12 dhjetor 2010 Dick Marty dorëzoi një projekt paraprak për rezolutë që duhej të miratohej në emër të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Projekt Raportin lidhur me “trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e kundërligjshëm me organe njerëzore në Kosovë”³.

Katër ditë më vonë, më 16 dhjetor, këto projekte paraprake u miratuan unanimisht dhe pas debateve të 7 janarit 2011 dhe të 25 janarit 2011 raporti i Dick Marty-t hyri në fuqi si raport zyrtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Krahas kësaj, Asambleja Parlamentare miratoi Rezolutën 1782 për “hetimin e thënieve lidhur me trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin kundërligjshëm me organe njerëzore në Kosovë”⁴.

¹ Miroslav Antić, artikulli i cituar, «Obmane Delponteove»

² Raporti i Dick Marty-t, paragrafët 17-18

³ Conseil de l’Europe, Assemblée Parlementaire, AS/Jur(2010)46, 12 décembre 2010

Commission des questions juridiques et des droits de l’homme
Traitement inhumain de personnes et trafic illicite d’organes humains au Kosovo

<http://assembly.coe.int/asp/apfeaturesmanager/defaultArtSiteVoir.asp?ID=964>

⁴ Conseil de l’Europe, Assemblée Parlementaire

<http://assembly.coe.int/Mainf.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta11/FRES1782.htm>

Më 16 dhjetor 2010, në të njëjtën ditë kur Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës miratoi projektet paraprake të dorëzuara nga Dick Marty, në Zvicër, 34 deputetë të Grupit Unioni Demokratik i Qendrës dorëzuan një «postulat»¹ drejtuar Këshillit Federal të Zvicrës.

Nocioni «postulat» është i njohur kryesisht si nocion matematik, që konsiston në domosdoshmërinë e pranimit paraprak të një parimi si të «vërtetë», pa pasur nevojë për ta demonstruar vërtetësinë e tij.

Në të drejtën zvicerane «postulati» është kërkesë e deputetëve drejtuar Këshillit Federal, që ky institucion shtetëror të shqyrtojë mundësinë t'i dorëzojë Parlamentit të Zvicrës për miratim një ligj apo një masë të caktuar.

Kur shihet përmbajtja e «postulatis» të deputetëve zviceranë, del në shesh se «postulati» i 34 deputetëve zviceranë është i ngjashëm me «postulatin» matematik! Në tekstin e «postulatis» të tyre, deputetët nënshkruan e “informojnë” Këshillin Federal se “më 16 dhjetor 2010, Këshilli i Evropës u njoftua me raportin e Dick Marty-t lidhur me trafikimin e organeve në Kosovës”, se “thëniet që përmban ky raport lidhur me trafikimin e organeve në Kosovë janë shumë të vërteta”² dhe rrjedhimisht nuk kanë nevojë të vërtetohen!

Për këtë arsye, nënshkruarit e këtij «postulati» e lusim Këshillin Federal të Zvicrës:

1. Që ta rishikojë politikën e vet karshi Kosovës,
2. Që të mendojë një politikë të re ndaj Kosovës, e cila duhet të marrë parasysh më mirë se deri tani interesat legjitime të Serbisë dhe të minoritetit serb në Kosovë,
3. Që të presë rastin e favorshëm për të kontribuar në skenën politike ndërkombëtare në kërkim të një zgjidhjeje të re, të drejtë dhe të pranueshme për konfliktin mes Serbisë me Kosovës³.

¹ L'Asssemblée fédérale - Le Parlement suisse, 10.4066- Postulat
Rapport de Dick Marty sur un trafic d'organes au Kosovo et la politique étrangère de la Suisse
http://www.parlament.ch/f/suche/pages/geschaefte.aspx?gesch_id=20104066

² Po aty

³ Po aty

Në argumentimin e tyre, deputetët nënshkruar të «postulatit» përsërisin akuzat që përmban raporti dhe shkoqisin sidomos akuzën se “rolin qendror në këto aktivitete kriminale e ka «Grupi i Drenicës», kumbara i të cilit nuk është askush tjetër pos, Hashim Thaçit, Kryeministrit aktual të Kosovës.

Sipas përpiluesve të «postulatit» “në dritën e këtij realiteti tronditës dalin në shesh dy gjëra: Së pari, kultura, qeverisja dhe praktikrat e autoriteteve të Kosovës janë shumë larg nga kushtet minimale që duhet t’i plotësojë një shtet ligjor. Dhe së dyti, procesi që çoi në njohjen e diskutueshme të Kosovës pati si pasojë diskriminimin sistematik të Serbisë në krahasim me Kosovën. Këto dy elemente arsyetojnë rishikimin e politikës së Këshillit Federal ndaj Kosovës”¹.

Më 23 shkurt 2011 Këshilli Federal e hodhi poshtë këtë «postulat». Lexuesit që i intereson argumentimi i plotë pse një kërkesë e tillë u hodh poshtë mund ta gjejë në referencat që kam dhënë në fund të faqes. Unë po kufizohem në faktin se momenti i dorëzimit dhe sidomos përmbajtja e këtij «postulati» nga miqtë e Dick Marty-t është tregues shtesë për motivet e vërteta të përpilimit të këtij raporti: rishikimi i njohjes së pavarësisë së Kosovës!

Në këtë drejtim, diplomacia e Serbisë nuk mbeti mbrapa. Ministria e Punëve të Jashtme serbe mobilizoi tërë arsenalin e moçëm për t’i paraqitur serbët si “viktima” të luftës në Kosovë! Po përmend vetëm disa nga aktivitetet e kësaj ministrie në lidhje me kontekstin e ri të krijuar pas miratimit të raportit të Dick Marty-t.

Kështu, në seancën e 16 shkurtit 2011 të Këshillit të Sigurimit, kur në rend të ditës ishte shqyrtimi i Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (S/2011/43), Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić-i shtroi kërkesën për krijimin e një mekanizmi drejtësie që do të merrej me krimet e supozuara nga Dick Marty².

¹ Po aty

² Nations Unies, Conseil de Sécurité, S/PV.6483, Seanca 6483, 16 shkurt 2011
http://www.un.org/fr/documents/view_doc.asp?symbol=S/PV.6483

Të njëjtën kërkesë ai e përsëriti edhe gjatë vizitës së tij në Paris¹, më 3 mars 2011, në letrën² që i dërgoi Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, më 19 prill 2011 dhe në seancën³ e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 12 maj 2011.

Në të gjitha qëndrimet, që nga Rezoluta 1782 e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, përfaqësuesve të përhershëm të shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së e deri te Ministrat e Punëve të Jashtme të Serbisë dhe të Kosovës⁴ askush nuk e kundërshtoi domosdoshmërinë e hetimeve për të ndriçuar supozime të tilla.

Divergjencat lindën kur duhej të përcaktohej se nën mandatin e cilit institucion duhej të zhvilloheshin hetimet.

Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić-i theksoi se gjoja “EULEX-i nuk ishte i kualifikuar për të zhvilluar hetime të tilla, sepse mandati i tij nuk e lejonte të zhvillonte hetime jashtë Kosovës” dhe këmbëngulte që “OKB-ja të krijojë një mekanizëm hetimi ad hoc e që do t’i përgjigjej vetëm Këshillit të Sigurimit”. Franca, Anglia dhe SHBA-të ishin të favorshme që hetimet të zhvilloheshin nga EULEX-i, përderisa shtetet që nuk e njihnin pavarësinë e Kosovës, sidomos Rusia dhe Kina, kërkonin që mandatin ta ketë OKB-ja⁵.

Në përputhje me Rezolutën 1782 të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, “John Clint Williamson u emërua shef i TASK Forcës Speciale të EULEX-it për të udhëhequr hetimet lidhur me thëniet për tregti me organe njerëzore.”⁶

¹Trafic d’organes: la Serbie réclame une enquête de l’ONU
[http://www.genethique.org/fr/content/trafic-d’organes-la-serbie-réclame-une-enquête-de-l’onu#.VDQGYrizWQl](http://www.genethique.org/fr/content/trafic-d'organes-la-serbie-reclame-une-enquete-de-l'onu#.VDQGYrizWQl)

²Nations Unies, Conseil de Sécurité, S/PV.6534, Seanca 6534, 12 maj 2011, f.15
http://www.un.org/fr/documents/view_doc.asp?symbol=S/PV.6534

³Po aty, f.4-8

⁴Po aty, f.8-12

⁵Lexuesit që i interesojnë referencat e lartpërmendura mund të lexojë qëndrimet e secilit përfaqësues që mori fjalën në këto seanca të KS të OKB-së.

⁶Bruxelles 2, «Un Américain chef de la task force d’enquête à Eulex Kosovo» (Një amerikan në krye të task forcës hetuese të Eulex-it në Kosovë), 29 gusht 2011

<http://www.bruxelles2.eu/2011/08/29/un-america-in-chef-de-la-task-force-denquete-a-eulex-kosovo.html>

Zgjedhja e një amerikani në krye të hetimeve për këto krime lufte, siç shihet edhe nga titulli që solla në referencë, bëri zhurmë të madhe mediatike. Por, nuk duhet të harrohet se fjala është për personin që udhëhoqi Departamentin e Drejtësisë dhe të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut gjatë periudhës 2001-2002. I njëjti person për të cilin Vladimir Božović-i, kuadër i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, deklaronte se kishin pasur bashkëpunim të mirë dhe “ishte shumë i kënaqur me punën e tij.”¹

Krahas asaj se John Clint Williamson ishte në dijeni me problemin, ai kishte edhe mbështetjen e institucioneve të Bashkimit Evropian. Përmes Rezolutës 1782, Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës kërkonte nga “shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet tjera që t’i japin EULEX-it mjetet e nevojshme, si në logjistikë ashtu edhe me personel shumë të kualifikuar, për t’i bërë ballë misionit jashtëzakonisht kompleks dhe të rëndësishëm që i është besuar².

Përmes kësaj rezolute kërkohet nga autoritetet e Serbisë që “të bashkëpunojnë ngushtë me EULEX-in, sidomos duke i dhënë të gjitha informatat që mund të ndihmojnë në ndriçimin e krimeve të bëra gjatë luftës dhe pas luftës në Kosovë.”³ Ndërsa nga “autoritetet e Shqipërisë dhe administrata kosovare” u kërkua që “të bashkëpunojnë pa rezervë me EULEX-in dhe autoritetet serbe në suazën e procedurave me qëllim që të ndriçohen krimet e bëra në Kosovë.”⁴

Në mënyrë të veçantë u kërkua që “të fillojë një hetim serioz dhe i pavarur, në mënyrë që të zbulohet e gjithë e vërteta rreth këtyre pretendimeve (...), që hetimi të shtrihet deri në vërtetimin e supozimeve sa i përket trafikimit të organeve, të cilat thuhet se janë bërë gjatë kësaj periudhe, në pjesën e territorit shqiptar⁵.

Me qëllim që puna e ekipit që do të hetojë pretendimet e raportit të jetë sa më efikase, Asambleja e Përgjithshme kërkoi nga Gjykata

¹ Po aty

² Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rezoluta 1782, paragrafi 19.1.2

³ Po aty, paragrafi 19.19.4.2

⁴ Po aty, paragrafi 19.5.1

⁵ Po aty, paragrafi 19.5.3

Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë që “të bashkëpunojë tërësisht me EULEX-in, sidomos duke i lënë në dispozicion informatat dhe elementet e provave që kanë në zotërim e që mund ta ndihmojnë EULEX-in që t’i ndjekë përgjegjësit e krimeve.”¹

Në kërkim të provave për tregtinë me organe njerëzore

Kërkesa e Asamblesë parlamentare drejtuar Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë nxorri në pah një varg problemesh. Cilat informata dhe cilat elemente të provave duhej t’i dorëzonte Gjykatës, e cila i kishte mbyllur hetimet pikërisht për mungesë informatash dhe mungesë provash?! Çka mund të dorëzonte kjo gjykatë, të cilën Dick Marty e akuzonte “për shkatërrim të materialeve të kësaj lënde...”

Mund të vazhdojmë me një varg pyetjesh të kësaj natyre që nxjerrin në shesh se prapa akuzave për gjoja “shkatërrimin e provave” fshihet tendenca e humbjes së gjurmëve të sajimit serb që i atribuonte krimet më të përbindshme shqiptarëve në përgjithësi dhe UÇK-së në veçanti.

Meqenëse “zhdukja e provave dhe e dëshmive” është aktualizuar e shoh të udhës t’i përsëris disa nga rastet që u trajtuan në pjesën e parë të librit.

Akuzat për “prova të shkatërruara” lexuesi pati mundësi t’i shihte që nga kapitulli i parë i kësaj vepre e deri në fund. Në kapitullin e parë lexuesi pati mundësi të njihej me rastin e procesit të montuar gjyqësor kundër vëllezërve Mazreku, dënimin e tyre me nga 20 vjet burg, dhe në fund lirin e tyre nga Gjykata Supreme e Serbisë si të pafajshëm. Gjithashtu solla kontekstin e krijuar pas botimit të librit të Carla Del Ponte-s. Nga qarqet e regjimit të vjetër të Beogradit që ishin ende në strukturat më të larta të pushtetit të ri, ky publikim u pa si një kontekst i favorshëm për të kërkuar lëndën, të cilën Gjykata Supreme e Serbisë e kishte hedhur si të

¹ Po aty, paragrafi 19.3

pabazë dhe i kishin liruar si të pafajshëm Luan e Bekim Mazrekun. Danica Marinković-i,¹ gjykatësja hetuese më e besueshme e Milošević-it për rastet e Kosovës, e njohur për lexuesin, kërkoi rigjykimin e vëllezërve Mazreku!

Në të njëjtën frymë, zëvendësprokurori i Serbisë për Krime Luftë, Bruno Vekarić-i, këmbënguli disa herë që të kthehej procesi i rigjyimit të vëllezërve Mazrekut në Gjykatën e Nishit. Por, kryetari i Gjykatës së Lartë të Nishit, Zoran Krstić, sqaroi, se: “mungon procesverbali origjinal i marrjes në pyetje gjatë procesit hetimor dhe dokumentet thelbësore për këtë rast, të cilat Gjykata e Qarkut në Prishtinë refuzon t’i japë!”² Për ta bërë bindëse “humbjen e provave” zëvendësprokurori i Serbisë për Krime Luftë, Bruno Vekarić-i, iu drejtua zyrtarisht autoriteteve të EULEX-it në Kosovë që t’ia dorëzonte gjykatës në Nish tërësinë e dokumenteve lidhur me këtë rast, me qëllim që të vihej drejtësia në vend! As UNMIK-u e as Gjykata e Qarkut të Prishtinës, nuk u kursyen nga akuzat për “zhdukjen eventuale të provave dhe të dëshmime”!

Atyre nuk u bëhet vonë se njerëzit shtrojnë pyetjen se mbi bazën e cilave “prova” u dënuan këta dy të rinj, më 18 prill 2001, në Gjykatën e Qarkut në Nish! Nëse realisht janë zhdukur dosjet e këtij procesi të montuar atëherë është e qartë se pas shpalljes së pafajësisë së tyre nga vetë gjykata serbe, askush tjetër nuk kishte pasur interes t’i asgjësonte gjurmët e krimit të institucioneve hetimore dhe gjyqësore të Serbisë përpos falsifikatorëve dhe montuesve të dosjeve gjyqësore kundër civilëve shqiptarë.

Lexuesit i kujtohet se si në rastin e «Krematorit të Kleçkës» edhe në rastin e «Masakrës së Reçakut» kur doli në shesh sajimi i propagandës serbe, ata këmbëngulin se gjoja “i kishin pasur provat, por ishin shkatërruar!” Madje, për të qenë “më bindës” në pohimet e kësaj natyre, shefi i ekipit të mjekësisë ligjore serbe për këtë rast, Slaviša Dobričanin-i solli të dhëna më “të sakta” për asgjësimin e fakteve! Sipas tij “ekipi finlandez kishte bërë më shumë se 3000 fotografi dhe 10 orë videofilma, ndërsa teknikët e

¹ Tani gjyqtare në Gjykatën e Lartë të Kragujevcit

² Politika, artikulli i cituar, «Zločinci iz Klečke „nisu na Kosovu”»

ekipit serb të kriminalistikës kishin bërë 18000 fotografi dhe disa qindra videofilma. Por, fatkeqësisht, një pjesë e fotografive, e videofilmave dhe raporti i patologëve finlandezë, që i takonin zonjës Marinković¹, u zhdukën përgjithmonë nga bombardimi që iu bë ndërtesës së SPB-së krahinore në vitin 1999 nga NATO-ja. Sikur dikush ngutej që t'i zhdukte sa më parë!"²

Duke mos u koordinuar mes tyre, gjykatësja hetuese Danica Marinković-i, lidhur me provat e kësaj lënde, deklaroi: "Pas përfundimit të hetimeve ia kam dhënë dosjen complete prokurorit publik të autorizuar për këtë rast. Dhe lënda duhet të jetë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në të cilën ne aktualisht nuk kemi qasje, e ndoshta ju mund të vini deri te ajo lëndë. Pasi kam përfunduar hetimet dhe kam marrë rezultatet dhe mendimet lidhur me autopsinë, i kam dorëzuar prokurorit publik të Qarkut në Prishtinë dokumentacionin e plotë, më 1 mars 1999. Kjo është lënda Kri 14/99."³

Pra, sipas gjykatësës hetuese Danica Marinković-i, dokumentacioni plotë i lëndës së Reçakut ndodhej në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ndërsa eksperti i mjekësisë ligjore, Slaviša Dobričanin-i pretendonte se ishte zhdukur përgjithmonë nga bombardimi që iu bë ndërtesës së SPB-së krahinore nga NATO-ja!

Po i rikujtoj lexuesit se ndërtesa e Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme të Prishtinës u dëmtua pjesërisht gjatë bombardimeve të NATO-s. Por ajo gjendej 1070 metra larg ndërtesës së Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ku gjendeshin "provat e shkatërruara". Pra pretendimet serbe nuk janë serioze.

Edhe pse Vladimir Božović-i, kuadër i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, deklaroi se "dokumentacioni i plotë i nënkomitetit për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur, i përgatitur nga ekspertët e mjekësisë ligjore si Slaviša Dobričanin-i, Vukašin Otašević-i e të tjerë si këta dhe që ishte dorëzuar në ndërtesën e qeverisë federale, ishte shkatërruar pjesërisht ndërsa për pjesën

¹ Gjykatësja hetuese e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

² Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, Dëshmitari Slaviša Dobričanin, seanca e 8 prillit 2005, f.572 dhe seanca e 13 prillit 2005, f. 677

³ Po aty, 275

tjetër nuk dinte asgjë”¹, prapë se prapë akuzat për “zhdukjen e provave” u drejtohen të tjerëve!

Meqë përmenda rastin e vëllezërve Mazreku dhe kërkesën e zëvendësprokurorit të Serbisë për Krime Luftë, Bruno Vekarić-it, drejtuar zyrtarisht autoriteteve të EULEX-it në Kosovë që t'i dorëzonin Serbisë tërësinë e dokumenteve lidhur me këtë rast e shoh të udhës të përsëris një ngjarje nga kapitulli kur trajtova çështjen e «Krematorit të Kleçkës». Të përmend faktin kur gjykatësja hetuesja Danica Marinković improvizoi marrjen në pyetje të Bekim Mazrekut në prani të gazetarëve për të “dëshmuar” për vrasjen e civilëve serbë dhe djegien e tyre në “furrat e gëlqeres”! Propaganda e regjimit të Beogradit nuk u kënaq me kaq! Ata transmetuan një emision ekskluziv për Radio Televizionin e Serbisë, në të cilin Milovan Drecun-i, zhvilloi një intervistë me “dëshmitarin okular”, Bekim Mazrekun!

Këtë veprim të Milovan Drecun-it Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë e cilësoi si “manipulim mediatik në funksion të përhapjes së urrejtjes ndërnacionale dhe ndërfetare, në nxitjen e diskriminimit dhe të armiqësive, me çka kanë krijuar parakushtet psikologjike për dhunën dhe për krimet më brutale.”² Për këtë arsye, kjo shoqatë gazetarësh të pavarur serb ngriti padi kundër Milovan Drecun-it, më 1 korrik 2009, në Gjykatën për Krime Luftë në Serbi.

Prokurori serb për krime lufte, Vladimir Vukčević-i, dhe Zëvendësprokurori i Serbisë për Krime Luftë, Bruno Vekarić-i u përkujdesën që Milovan Drecun-i të mos ketë asnjë pasojë. Përkundrazi, ai sot është Kryetar i Komisionit Parlamentar të Serbisë për Kosovën!

¹ Politika, artikulli i cituar, «Za trgovinu organima Beograd saznao pre devet godina»

² Tërësia e padisë së Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur mund të konsultohet në këtë faqe interneti: <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=875112&print=yes>

«Anatomia e krimit»

Siç e përmenda në Prologun e këtij kapitulli, Prokurori serb për krime lufte, Vladimir Vukčević-i, i deklaroi Agjencisë Tanjug se prokuroria që drejtohej prej tij kishte në zotërim dëshminë e një dëshmitari okular për nxjerrjen dhe trafikimin e organeve njerëzore në Kosovë.¹ Tri ditë më vonë, Radio Televizioni i Serbisë transmetoi emisionin special të titulluar «Anatomia e krimit»² në të cilin, opinioni publik i Serbisë, pati mundësi të shihte intervistën që zhvilloi gazetari i saj me këtë “dëshmitar të mbrojtur”. Krahas “dëshmitarit okular”, si “mysafir special” i këtij emisioni ishte Zëvendësprokurori i Prokurorisë serbe për krime lufte, Bruno Vekarić-i. Kopje e spektaklit mediatic me Bekim Mazrekun! E njëjta logjikë, i njëjti skenar, vetëm personazhet ishin tjerë!

Megjithatë efekti u arrit. Në Serbi tërë javën vazhdoi “histeria mediatike” e provokuar nga deklaratat e dëshmitarit të Prokurorisë për krime lufte lidhur me tregtinë e organeve gjatë luftës në Kosovë. «Ia nxorën zemrën për së gjalli», «I kam nxjerrë zemrën serbit», «Ende i shoh në ëndërr piskamat e viktimave serbe»... janë vetëm disa nga titujt në ballinat e gazetave serbe!³

Qëllimi i transmetimit të këtij “emisioni ekskluziv” nuk ishte vetëm sensibilizimi i opinionit publik të Serbisë. Prokurori për krime lufte, Vladimir Vukčević-i deklaroi tri ditë pas transmetimit televiziv të “intervistës” se “priste reagimet e ekipit për hetime që udhëhiqej nga Clint Williamson-i lidhur me tregtinë me organe njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri.”⁴ Nuk vonoi shumë dhe mediat

¹ Večernje novosti, «Imamo svedoka o uzimanju organa» (Kemi dëshmitarë për nxjerrjen e organeve)

² RTS 1 - «Anatomia zlocina-Trgovina organima srba sa Kosmeta», 10.09.2012 http://www.youtube.com/watch?v=yYgj4JH-_Ag

³ E-Novine, «Medicinski i pravni stručnjaci osporavaju Vukčevićeve dokaze - Svedočenje o vađenju organa je budalaština» (Ekspertët e mjekësisë dhe drejtësisë kontestojnë provat e Vukčević-it. Dëshmi për nxjerrjen e organeve është marrëzi), 14.09.2012

<http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/71372-Svedoenje-vaenju-organa-budalatina.html>

⁴ BLIC, «Vukčević ocekuje reakciju međunarodnog tima i Vilijamsona», (Vukčević-i pret reagimet e ekipit ndërkombëtar të Williamson-it), 13.09.2012 <http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/342578/Vukcevic-ocekuje-reakciju-medjunarodnog-tima-i-Vilijamsona>

serbe njoftuan se “Shefi i ekipit të EULEX-it, që heton tregtinë me organe të njerëzve në Kosovë, informoi se do të udhëtojë për në Beograd që të njihet me pjesët e dëshmisë së dëshmitarit të Prokurorisë serbe për krime luftarë¹. Të njëjtën gjë e konfirmoi edhe zëvendësprokurori serbe, Bruno Vekarić-i, i cili saktësoi se “gjatë vizitës së tij në Beograd, Williamson-i do të ketë mundësi të bisedojë edhe me ‘dëshmitarin e mbrojtur’.”²

Në Serbi, krahas reagimeve që bëheshin për të nxitur urrejtjen dhe për të shpërndarë gënjeshtat e sajuara nga regjimi i Beogradit, nuk munguan as reagimet kundër kësaj forme manipulimi. Nga reagimet e kësaj natyre, që nuk ishin të pakta, po citoj shkrimin e gazetares Tatjana Tagirov. Kjo gazetare e të përditshmes serbe «Novosti», në shkrimin e titulluar “Marrëzitë e Prokurorisë për krime luftarë”³ “fyerje të inteligjencës së qytetarëve të Serbisë”⁴ përshkrimin e “procedurave mjekësore” për të siguruar një organ njerëzor për tregun e zi të organeve. “Nuk ishte hera e parë që Prokuroria, përmes RTS-së, tallet me inteligjencën e qytetarëve”⁵ deklaroi kjo gazetare.

Fatkeqësisht, këtë tallje me inteligjencën që bënte regjimi i “ri” i Beogradit, e që nuk dallonte nga logjika e vjetër e funksionimit, nuk e kuptonin ata që ishin verbuar nga «antiamerikanizmi».

Gati të gjithë autorët që ishin angazhuar në kumbarinë e nocioneve të krijuara nga Shërbimi Sekret Serb për t’i stigmatizuar shqiptarët e shfrytëzuan maksimalisht Raportin e Dick Marty-t dhe deklaratën e “dëshmitarit të mbrojtur” të prokurorisë serbe

¹ Kurir, «Tužilac Vilijamson stize kod Vukčevića» (Gjykatësi Williamson mbërrin te Vukčević-i)

12.09.2012

<http://www.naslovi.net/2012-09-12/kurir/tuzilac-vilijamson-stize-kod-vukcevic-a/3850263>

² «Tužilac Euleksa Vilijamson uskoro u Beogradu» (Hetuesi i EULEX-it së shpejti në Beograd), 12.09.2012

<http://www.naslovi.net/2012-09-12/mondo/tuzilac-euleksa-vilijamson-uskoro-u-beogradu/3849173>

³ Novosti, Nr. 666, «Budalaštine Tužilaštva za ratne zločine» (Marrëzitë e Prokurorisë për Krime Luftarë)

<http://arhiva.novosti.com/2012/09/budalastine-tuzilastva-za-ratne-zlocine/>

⁴ Po aty

⁵ Po aty

për krime lufte për të treguar me gisht “krimet e UÇK-së” që gjoja ishin kryer nën drejtimin e Hashim Thaçit, “kumbarës më të rrezikshme nga «kumbarët e oktapodit» të Kosovës!”¹

Duke i marrë për të vërteta “provat” e sajuara në Beograd ata shfrytëzuan rastin që të akuzojnë “diplomacinë e SHBA-ve dhe fuqive tjera perëndimore, pa ndihmën e të cilëve Hashim Thaçi nuk do të kishte mundur të ngjitej në pozitën ku ishte.”²

Denoncimi i “ndihmës politike dhe diplomatike të SHBA-ve dhe fuqive tjera perëndimore për «mafien shqiptare»” përshkon shkrimet e shumicës së autorëve, veprat e të cilëve u trajtuan përgjatë tërë këtij libri. Nuk do t’i citoj të gjitha, sepse, fundi i fundit, nuk ndryshojnë nga njëra-tjetra. Po ndalem vetëm te pamfleti propagandistik i Pierre Péan-it, «Kosova: një luftë e “drejtë” për një shtet mafioz»³. Për këtë autor, lufta e Kosovës nuk është luftë e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, por është “një luftë e drejtë amerikane për krijimin e një shteti mafioz!”⁴

U kufizova në këtë vepër sepse ky autor e fillon angazhimin e vet në kumbarinë e nocioneve të sajuara në funksion të stigmatizimit të shqiptarëve në mënyrën më dramatike të mundshme. Ai sjell në “preambulë” të librit të vet dëshminë e “dëshmitarit të mbrojtur” të transmetuar nga Radio Televizioni i Serbisë, gjatë të cilës “një mjek shqiptar, ish-ushtar i UÇK-së” flet se si “një serbi të zënë rob ia nxori zemrën” për të bërë *business*.

Jo vetëm në preambulë, por më shumë se 1/3 e librit të tij i kushtohet “tregtisë me organe të organizuar nga UÇK-ja”⁵.

Po sjell në tërësi publikimin që ky autor i bën kësaj “dëshmie”, sepse kjo nxjerr në shesh në mënyrën më të mirë të mundshme faktin se verbimi ideologjik nga «antiamerikanizmi» e ka sjellë edhe këtë autor në pozitën e propaganduesit të nocioneve dhe interpretimeve që u sajuan në kohën e Milošević-it dhe që vazhdojnë edhe nga regjimi i “ri” i Beogradit.

¹ Raporti i Dick Marty-t, paragrafi 67

² Po aty, paragrafi 60

³ Pierre Péan, vepra e cituar, *Kosovo : une guerre «juste» pour un Etat mafieux*

⁴ Po aty, f.366

⁵ Sidomos dhjetë kapitujt e fundit (kapitujt 21-30) dhe 40 faqe aneks!

Në tekstin e deklaratës së “dëshmitarit të mbrojtur” të Prokurorisë serbe për krime të luftës disa nga fjalët do t’i shënojmë me ngjyrë të theksuar për t’i dalluar nga teksti tjetër, me qëllim që të tërheq vëmendjen e lexuesit për kundërthëniet logjike të pohimeve të tilla, të cilat do të trajtohen më poshtë.

Zemra rrihte ende

*“Disa minuta më pas ata sollën një djalë të ri, për afërsisht 19-20 vjeçar, me duar të lidhura pas shpinës. Nuk ishte ushtar i UÇK-së dhe, kuptohet, unë nuk kisha të drejtë të bëja pyetje. Fundi i fundit, kush isha unë? Një i ri karshi eprorëve të vet. **I burgosuri u zgjidh** nga dy ushtarët që e sollën, pastaj e vendosën në tavolinë mjekësore ashtu siç vendosen pacientët. **Pastaj i thirrën edhe dy persona të tjerë që t’i mbanin këmbët e të burgosurit që të mos lëvizte.***

*Mjeku që më udhëzonte si të veprojmë **ia grisi bluzën në dy copë duke e lënë lakuriq, siç e kishte lindur nëna!** Një nga mjekët e pranishëm solli **një çantë të zezë**, të tillë siç e mbajnë mjekët. **Ishte diçka e re për mua.** Nga brendia e kësaj çante nxori instrumentet kirurgjikale. **Ishte hera e parë që shihja skalpel, bisturi dhe çdo gjë që është e nevojshme për të kryer një operacion kirurgjik.** Atëherë ndodhi një zënkë. Mjeku më i vjetër filloi të bërtiste dhe ta shajë mjekun më të ri, të cilit i thoshte: «biri im». E kuptova se ishin të afërt. Më zgjati një skalpel. Filloi të më vinte keq dhe të ndija përbuzje. Si në një ëndërr të keqe, një ankth pa fund. Edhe sot e kësaj dite më kujtohen skenat e asaj dite dhe më vijnë të njëjtat emocione. Mjeku që më udhëzonte më tha se çka duhej të bëja. Të bëja një vijë të drejtë në trupin e të burgosurit, që nga fyti e deri te fundi i brinjëve, dhe ta prisja duke ndjekur vijën. Mjeku tjetër kishte sjellë një kuti. Në të kishte fasha dhe një shishe qelqi të bardhë prej nga dilte erë alkooli, të cilën e vëreja kur filluam ta pastrojmë lëkurën. Pasi e pastrova atë pjesë të trupit ai më tha: «Shpejto, nuk kemi shumë kohë!»*

E vërejtja se djali i ri në tavolinë nuk ishte shqiptar. Si e vërejtja këtë gjë? Kur iu afrova me skalpelin tim ai u mundua të çlirohej dhe atyre që e mbanin iu desht ta shtrëngonin edhe më fort. Filloi të ulërinte për ndihmë, ta thërriste zotin në ndihmë, të lutej: «zot, mos më prisni fytyrën, mos më vrisni!» Meqë isha një ushtar i ri, i nënshtruar urdhrave të një eprori të lartë, isha i detyruar t'ia filloja. Ia nisa ashtu siç **kisha mësuar ta bëja gjatë stazhit (për kirurgji)**: vendosa dorën e majtë mbi gjoks për ta mbajtur dhe me dorën e djathtë mora skalpelin dhe fillova ta pres. Kur skalpeli mbërriti në pjesën e poshtme të trupit, gjaku filloi të rridhte rrëke. Kur mbërrita përafërsisht në mes të prerjes djali filloi të ulërinte që të mos e vrisnim dhe u alivanos. Isha aq i tmerruar sa **nuk e di nëse shtirej apo kishte vdekur**. Nuk e di nëse kishte vdekur, por ai nuk mbrohej më dhe nuk lëvizte. Kur e përfundova më thanë të bëja edhe një prerje transversale në pjesën e poshtme të trupit. Pastaj u desh të bëhet edhe një prerje në pjesën e sipërme të trupit. Këtë prerje e bëri mjeku sepse e hetoi se isha i tmerruar dhe më dridhej dora. Ai më tha: «Mos u mërzhit, jam unë këtu». Para se ta merrte bisturinë – nuk ndihem mirë kur e kujtoj këtë skenë - plasi një zënkë tjetër mes mjekut dhe të afërmit të tij. Ky i fundit kishte harruar instrumentet për prerjen e brinjëve. Për të dalë sa më shpejt nga kjo situatë e mundimshme m'u kujtua se e kisha bajonetën e kallashnikovit që mund të kryente punë. Për ta përfunduar sa më shpejt dhe për t'i dhënë fund kësaj pune, **e shndërrova bajonetën time në instrument kirurgjik**.

Mjeku më tregoi se ku duhet t'ia prisja brinjët. I futi duart ndër brinjë dhe më tha: «Ndiqe shenjën që të tregon dora ime dhe preje. Të mbetet ta çosh përgjatë dorës sime». Për anën e djathtë ai tha: «do ta presim indin aty ku brinjët dhe pjesa tjetër e trupit janë një». Tërë kohën më thoshte të isha i vëmendshëm, të kujdesesha që të mos dëmtohet AJO. E «ajo» ishte zemra! Kështu veprova. Pastaj kaloi në anën tjetër të tavolinës dhe i futi duart në thellësi të kraharorit. Në atë moment erdhi një mjek tjetër i cili më tha: «duhet të përfundojmë shpejt. Nuk kemi shumë kohë.» Ky mjek solli një kuti, të cilën e vendosi pranë meje. **Dhe aty për herë të parë pashë një organ njeriu**. Më kaploi tmërri.

Do t'ju shpjegoj pse pati grindje në mes të mjekëve. Njëri prej tyre kishte harruar pinceta **që ndërpresin rrjedhjen e gjakut nga venat dhe enët e tjera të gjakut**. Për të bërë lidhjen në dy vende ne **filluam të përdorim fije najloni** në vend të tyre. Të najlonit **që përdoret për peshkim**. I bëmë tri herë nga dy lidhje dhe u ndalëm. **I premë venat dhe kur e mora në duart e mia, zemra vazhdonte të rrihte**. I lamë duart dhe shpejt e shpejt hapëm frigoriferin vogël që mund të mbahet në dorë. Në fund të tij kishte një vend të rregulluar apostafat për këtë gjë. **Mjeku nxori një kuti plastike, të llojit të njëjtë si ato që përdoreshin gjatë stazhit tim**. Pastaj e vendosëm kutinë që kishte zemrën, lëng dhe akull dhe e mbyllëm me lloj-lloj penjsh, llastika dhe lidhëse tjera, që nuk mund t'i përshkruaj me saktësi, me qëllim që të mos përmysej kutia. Pas disa minutash më ftuan që të shkoj në një sallë ku ishin eprorët e mi. Një komandant i UÇK-së, nga më të njohurit, më tha: «Ta heq kapelën! Në Kosovë kemi nevojë për ushtarë si ti! Pikërisht kështu do të ngadhënjëm!» Dhe më dha urdhër të merrja frigoriferin e dorës që kishte zemrën dhe ta vendosja pranë një veture. «Vendose te Volvo-ja»-më tha ai. Volvo-ja kishte ngjyrë të gjelbër të mbyllur. Shoferi e hapi gepekun dhe më tha ta vendosja frigoriferin në anën e majtë, në një skaj të izoluar afër rrotës ndihmëse. Pasi e vendosa frigoriferin, e lidha mirë që të mos lëvizte gjatë udhëtimit.

Kur më pyetët më parë sesi dhe kur e kuptova se transplantimi nuk ishte i destinuar për ndonjë përgjegjës të lartë të organizatës (...) ¹ Mendoja se zemra ndoshta i është dedikuar ndonjërit me grada të larta, të cilin e kishim dërguar në spitalin ushtarak dhe i cili kishte vdekur gjatë transferimit të tij. Mendoja se zemra do të shkonte në Tiranë. Por, jo! Nuk ndodhi kështu! Vazhduam udhëtimin deri në aeroportin e Rinasit, afër Tiranës. Kur kemi mbërritur atje dhe, kur u hap porta, pamë ushtarë shqiptarë në uniforma. Aty pamë një aeroplan. Një person doli prej tij, me pamje të hijshme dhe me mjekër të mbajtur mirë. Nuk ishte shqiptar. **Aeroplani privat kishte ngjyrat turke!**

¹ «Dëshmitari i mbrojtur» e ndërpret rrëfimin!

Atëherë e kuptova se bëhej fjalë për biznes e jo për mbrojtje të atdheut. Tregti me organe. Para të mëdha. Asgjë të përbashkët me idealet që mbroja. Por, bëhej fjalë për diçka të tmerrshme.”¹

Pasi e përfundon dëshminë e “dëshmitarit të mbrojtur”, të këtij “mjeku shqiptar, ish-ushtar i thjeshtë i UÇK-së” i cili pohon se “ka marrë pjesë në këtë krim të urdhëruar nga eprorët e tij”, Pierre Péan-i shtron pyetjen nëse ishte kjo “*dëshmi e montuar nga shërbimet sekrete serbe, ashtu siç pohojnë një numër i protagonistëve të Çështjes shqiptare*”?²

Rreth kësaj dëshmie, Pierre Péan-i deklaroi se nuk mund të gjejë fjalë që do të mund të komentonin fjalët e kësaj dëshmie që të rreqeth. Krejt ky tmerr është bërë për biznes!³

Ndërsa, sa i përket vërtetësisë së kësaj dëshmie ai është i bindur se “lexuesi do ta krijojë opinionin e vet sapo ta mbyllë librin e tij.”⁴

Libri i Pierre Péanit mund të jetë me interes që të studiohet si shembull i kumbarisë së nocioneve të përpiluara nga shërbimet sekrete serbe e sidomos shembull i shpërndarjes së raporteve të sajuara mes nocionit «mafia shqiptare» dhe ambicieve politike të shqiptarëve të Kosovës. Por, mendoj se lexuesi nuk ka nevojë ta lexojë tërë librin e Pierre Péan-it për të vërejtur kundërthëniet e mëdha që përmban kjo dëshmi.

Nuk ka nevojë të lexohet tërë libri për të parë absurditetin e pohimeve se “një mjek” që ka bërë një “stazh në kirurgji” “sheh për herë të parë një organ njeriu!” Dhe tmerrohet!!! Është e tmerrshme se, në të njëjtën mënyrë siç “tallesh prokuroria serbe për krime lufte me inteligjencën e qytetarëve”⁵ të Serbisë, në të njëjtën mënyrë, Pierre Péan-i, mundohet të tallet me inteligjencën e lexuesve frankofon.

Cili lexues do ta gëlltisë gënjeshtren se një mjek, që ka bërë edhe stazh në kirurgji, sheh për herë të parë skalpel, bisturi dhe instrumente tjera që përdoren për operacione! Cili lexues do të

¹ Pierre Péan, vepra e cituar, Kosovo: une guerre «juste» pour un Etat mafieux f.9-13

² Po aty, f.13

³ Po aty, f.13

⁴ Po aty, f.13

⁵ Shprehje e gazetares serbe Tatjana Tagirov

besojë se një mjek, sado i tronditur që të jetë, nuk mund ta dijë nëse “pacienti shtiret apo është i vdekur”! Cili mjek do të pohonte se zemra e nxjerrë vazhdon të rrahë¹!

Nëse dikush nga lexuesit mund të besojë se një operacion aq i ndërlikuar mund të bëhet pa anestezi, nuk ka lexues që mund ta gëlltisë absurditetin që fillimisht pacientit i zgjidhen duart e pastaj angazhohen dy vetë për t’i mbajtur këmbët që të mos lëvizë!!! Është e qartë se një gjë e tillë i duhej skenaristit të këtij “produksioni” për të krijuar imazhet ku “pacienti përpëlitet dhe hedh shkelma për t’i shpëtuar copëtimit”!

Të mos flasim për pretendimet për harrimin e picetave dhe përdorimin e najlonit të peshkatarëve për t’i mbyllur enët e gjakut! Najlon peshkatarësh! Ndoshta mendonin të gjuanin në ujërat e turbullta mediatike që krijoi publiciteti i Raportit të Dick Marty-t! A ka më absurde se të “humbet kohë” për t’i mbyllur enët e gjakut një personi që i është nxjerrë zemra! Aq më tepër kur “dëshmitari i mbrojtur” dëshmon se eprorët e urdhërojnë disa herë të shpejtojë se nuk kishin kohë!

Prerjen e brinjëve me bajonetë kallashnikovi! Kush e beson? Këtë po e lë për fund! Çka mund të thuhet për shprehjen se pacientit **“ia grisën bluzën në dy copë duke e lënë lakuriq, siç e kishte lindur nëna!”** Nuk përjashtohet mundësia që këtë shprehje tipike serbe ta përdor edhe ndonjë shqiptar, por, gjatë përshkrimit të zhveshjes së pacientit, nuk u përmendën pantallonat dhe nga dëshmia e “dëshmitarit” del se nëna e kishte lindur këtë “pacient” me pantallona veshur!

Së paku gjatë leximit të kësaj dëshmie lexuesi mësoi se dikush mund ta njohë një aeroplan në bazë të ngjyrave, madje ta identifikojë nëse është aeroplan privat apo jo! Mësoi se ekzistonin ngjyra turke! Shpresoj se lexuesi nuk është habitur nga ky zbulim! Është e qartë se ai që ia qep me najlon peshkatarësh enët e gjakut personit të cilit i është nxjerrë zemra, është në gjendje t’i identifikojë edhe ngjyrat turke!

¹ Përveç disa shtangimeve që mund të shfaqen gjatë sekondave të para e që nuk mund të definohen si rrahje zemre !

Çka ka pasur në mendje ai që e sajoi një shprehje aq të palogjikshme si pohimi për ngjyrat turke? Nëse ka menduar për ngjyrat e flamurit turk, i cili përbëhet nga ngjyra e kuqe dhe ajo e bardhë, ngjyra që nuk janë monopol identifikimi i asnjë kombi dhe i asnjë flamuri, atëherë shtrohet pyetja pse ky “ish-ushtar i UÇK-së” nuk deklaroi se kishte njohur “ngjyrat zvicerane” të aeroplanit “privat”? Sepse edhe flamuri i shtetit të Zvicrës, si dhe i dhjetëra shteteve tjera përbëhet vetëm nga këto dy ngjyra! T’i atribuohet ky aeroplan “privat” Zvicrës do kishte qenë edhe më koherent me propagandën serbe, sepse autoritetet e Zvicrës u akuzuan nga Shërbimi Sekret i Serbisë se gjoja i paskëshin lejuar “kampet paramilitare private, sallat e gjuajtjes me armë dhe klubet e sporteve luftarake për nevojat e UÇK-së.”¹

Në këtë kontekst, përpiluesit të dëshmisë që u shfaq në emër të “dëshmitarit të mbrojtur” nuk e sheh të udhës të kalohej përtej Adriatikut, por ishte më e lehtë në drejtim të Detit të Zi! Ndoshta në kërkim të ujërave të turbullta për të peshkuar, krijuesit e këtij rrëfimi kishin nevojë për ngjyrën e Detit të Zi!

Por, nuk është koha e peshkimit në ujëra të turbullt! Ata që dëshirojnë të informohen objektivisht kanë mundësi ta bëjnë këtë. Pikërisht për shkak “të mundësive të mëdha që ofron interneti”, edhe pse Dick Marty tërhoqte vërejtjen se “asnjëherë nuk kemi qenë më të rrezikuar të shndërrohemi në viktime të helmimit nga informatat.”² Ndoshta për shkak se, siç thotë një shprehje popullore shqiptare, «e ka mizën nën kësulë»!

Ata që kanë dashur të informohen objektivisht kanë pasur dhe kanë mundësi të shohin se përballë kësaj propagande absurde as intelektualët serbë nuk mbetën pa reaguari. Më lart përmenda rastin e gazetares serbe Tatjana Tagirov, e cila veprimet e mësipërme i cilësoi si “marrëzi të Prokurorisë për krime lufte”³.

¹ Versioni në gjuhën frënge i librit të cituar « Le terrorisme au Kosovo.... », f. 209, Versioni në gjuhën angleze f.204, ndërsa versioni elektronik në gjuhën serbe, f.9

² Réseau Voltaire, intervista e cituar, « Dick Mary, L’indépendance du Kosovo n’a pas été décidée à Pristina »

³ Novosti, artikulli i cituar, « Budalaštine Tužilaštva za ratne zločine »

Kjo gazetare nuk ishte e vetmja që reagoi kundër manipulimit me opinionin publik. Humanistja e njohur serbe, Nataša Kandić, në intervistën që dha për Radion Evropa e Lirë, hodhi dyshime rreth tregimit të këtij “dëshmitari”. Për drejtoreshën e Fondit për të drejtën humanitare në Serbi, është e pabesueshme të ketë ndodhur ashtu. As edhe në filmat e zhanrit horror, që kanë çmimin fare të lirë, një skenar i tillë nuk mund të shihet¹.

Reaguan edhe avokatë si Dragoljub Todorović-i dhe Đorđe Dozet-i të cilët theksuan se kjo formë manipulimi dhe sidomos nxjerrja e « dëshmitarit të mbrojtur » para kamerave paraqet shkelje të rëndë të procedurave legale. Aq më tepër kur Prokuroria serbe për krime lufte nuk ishte e ngarkuar të zhvillonte hetime për këtë rast.”²

Vërejtje të shumta u bënë lidhur me shpjegimin që “dëshmitari i mbrojtur” u bëri procedurave të nxjerrjes së organit për transplantim! Operimi nga ai që kishte bërë vetëm stazh kirurgjike, përderisa mjeku me përvojë asiston operacionin, mungesa e anesteziës, mungesa e instrumenteve kirurgjikale dhe zëvendësimi i tyre me bajonetë, lidhja e enëve të gjakut me najlon që përdorej për peshkim³ ishin vetëm disa nga vërejtjet që bënë rreth besueshmërisë e këtij rasti!

Në kapitujt paraprakë lexuesi pati mundësi të njëjhej me angazhimin e “ekspertëve të mjekësisë ligjore”, në shërbim të regjimit të Milošević-it. Ndyshe nga praktika e regjimit të vjetër, kur patologët dhe ekspertët e forenzikës si Slaviša Dobričanin-i,

¹ Radio Slobodna Evropa, « Sumnje u uverljivost svedoka navodne trgovine organima » (Dyshime për vërtetësinë e dëshmitarit lidhur me gjoja tregëtinë me organe)

<http://www.slobodnaevropa.org/content/sumnje-u-uverljivost-svedokanavodne-trgovine-organima/24706268.html>

dhe <http://www.hlc-rdc.org/?p=21038>

² Artikulli i cituar, « Sumnje u uverljivost svedoka navodne trgovine organima » <http://www.slobodnaevropa.org/content/sumnje-u-uverljivost-svedokanavodne-trgovine-organima/24706268.html> dhe <http://www.hlc-rdc.org/?p=21038>

³ Slobodna Evropa, « Sumnje u uverljivost svedoka navodne trgovine organima » (Dyshime për vërtetësinë e dëshmitarit lidhur me gjoja tregëtinë me organe) <http://www.slobodnaevropa.org/content/sumnje-u-uverljivost-svedokanavodne-trgovine-organima/24706268.html> dhe <http://www.hlc-rdc.org/?p=21038>

Vujadin Otašević-i, Dušan Dunjić-i, Miloš Tasić-i përpiqeshin t'i fshihnin krimet, regjimi i ri i Beogradit, gjeti një ekspert mjekësie, një kirurg, për t'ia atribuuar krimin shqiptarëve.

Për t'i dhënë fuqi besueshmërisë së deklaratave të “dëshmitarit të mbrojtur”, skenaristët e emisionit special “Anatomia e Krimit” intervistuan edhe kirurgun, Dragoš Stojanović-in. Në bazë të asaj që u tha para se t'ia jepnin fjalën, qëllimi i kësaj interviste ishte të merrnin mendimin e një eksperti të kirurgjisë nëse ishte e mundur të kryhej nxjerrja e organeve në mënyrën se si e kishte përshkruar “dëshmitari i mbrojtur”.

Dragoš Stojanović-i, i cili e kishte parë intervistën ende pa u transmetuar nga Radio Televizioni i Serbisë, në cilësinë e “ekspertit të njohur”, deklaroi se “përshkrimi i dëshmitarit të mbrojtur është i besueshëm (...) Në parim, teknikisht dhe teknologjikisht është e mundur që të bëhet ashtu. ”Edhe rreth vendosjes së zemrës në frigorifer dhe transportimi i duken të besueshme dhe autentike. Parimisht të gjitha këto i përkasin disa aspekteve procedurale, që natyrisht bëhen në një mënyrë specifike. Në parim, çdo gjë që thuhet në këtë dëshmi përputhet me metodat se si bëhet një gjë e tillë, kur duhet të bëhet në bazë të metodave të sofistikuar.”¹

Të gjithë kirurgët e dinë se, nëqoftëse zemra e nxjerrë nga një pacient nuk transplantohet menjëherë apo nëse nuk vendoset në aparaturë speciale që do ta mbanjë në funksionim deri në momentin e transplantimit, ajo zemër, mund të bëhet e pa përdorshme!

Edhe në qarqet mjekësore serbe u shpreh habi se si ishte e mundur që dikush nga mjekët të deklarojë si të besueshëm versionin e dëshmitarit se mund të nxirret zemra pa anestezi, nga një stazhier kirurgjie, me bajonetë ... !”²

Arsyet pse nuk do të vazhdoj me citimet e të gjitha reagimeve do të dalin në shesh nga përmbajtja e epilogut të këtij kapitulli. Jam i bindur se ky epilog do ta sqarojë lexuesin për shumë aspekte të “anatomisë së krimeve” që i visheshin UÇK-së.

¹ RTS, emisioni special i cituar, «Anatomija Zlocina»

² Artikulli i lartpërmendur «Sumnje u uverljivost svedoka navodne trgovine organima»

EPILOGU I KAPITULLIT TË DYTË

Kirurgu i njohur serb i kirurgjisë vaskulare, Goran Kronja, i cili ka qenë shef i ekipit për transplantimin e organeve në Akademinë Spitalore Ushtarake në Beograd, në intervistën për «Svedok» reagoi¹ lidhur me emisionin sensacional të Radio Televizionit të Serbisë, të titulluar «Anatomia e krimit».

Po sjell për lexuesin pjesë nga deklaratat e këtij kirurgu sepse është një dëshmi e mirë se logjika e moçme e regjimit “të vjetër” të Beogradit për sajimin e krimeve dhe stigmatizimin e shqiptarëve, logjikë që vazhdon edhe nga “regjimi i ri”, nuk gëlltitet me lehtësi as nga intelektualët serbë.

Marrëzia e Prokurorisë serbe për krime lufte²

“Tregimet për trafikimin e organeve në Kosovë janë marrëzi. Ku janë provat materiale? Ajo për çka dyshohet se është bërë në Kosovë dhe Metohi dhe në Shqipëri, për nga lloji është transplantim kadaverik.³ Në këtë aspekt, e vetmja gjë e logjikshme është se organi është marrë nga njeriu i gjallë dhe pastaj është lënë të vdesë. Sipas mendimit tim, nëse kjo është e vërtetë atëherë kjo veprimtari është e përbindshme dhe ky krim do të ishte krimi më i rëndë i shekullit 20. Por, nëse një gjë e tillë nuk ka ndodhur, atëherë është i përbindshëm edhe mendimi në atë drejtim. Truri që e ka menduar një gjë të tillë duke u bazuar në indikatorë të paverifikuar, të pabesueshëm është gjithashtu përbindshëm.

Jam i bindur se në Kosovë nuk janë nxjerrë organe. Jam i bindur se ky tregim nuk qëndron. Është e mundshme që ka pasur krime, është e mundshme që të rrëmbyerve t’ua kenë shkukur organet, është e mundshme që t’i kenë copëtuar... Por, jo për t’i përdorur si material transplantimi.

¹ E-Novine, artikulli i cituar, «Svedočenje o vađenju organa je budalaština»

² Titulli i gazetës serbe «Novosti», «Budalaštine Tužilaštva za ratne zločine», Nr. 666,

<http://www.novosti.com/2012/09/budalastine-tuzilastva-za-ratne-zlocine/>

³ Kur organi për transplantim është nxjerrë nga një njeri i vdekur.

E dimë se me organe për transplantim bëhet tregti. Por kjo është një çështje tjetër. Që të shitet cilido organ qoftë duhet t'i plotësojë disa kriteret mjekësore rigorozë dhe të ndërlikuara. Organi nuk mund të nxirret në çfarëdo dhome dhe prej njeriut të gjallë. Është e pakuptimtë! Pohimet e këtij dëshmitari se e ka nxjerrë zemrën nga njeriu i gjallë për ta shitur më vonë janë thjesht budallallëk dhe unë habitem pse Prokuroria për krime lufte e ka marrë një gjë të tillë si të ishte e vërtetë. Zemra e nxjerrë në atë mënyrë, siç e ka përshkruar dëshmitari, është e pavlefshme. Nuk ekziston kirurg që mund të transplantojë një organ pa origjinë, pa analiza paraprake mjekësore. O njerëz, afati i qëndrueshmërisë së zemrës nga koha e ndërprerjes së rrahjeve e deri te transplantimi është maksimumi 12 orë. Ky është një detaj logjik që lidhet me pohimet se “tregtia me organe”, “shtëpia e verdhë” e kështu me radhë kanë ndodhur në Shqipërinë Veriore. Në atë kohë, nga Kukësi dhe Burreli (“Shtëpia e Verdhë”) e deri në Tiranë, ku ndodhej aeroporti më i afërt, është dashur të kesh dhjetë orë të mira në dispozicion dhe veturë të mirë terreni sepse rrugët ishin jashtëzakonisht të këqija. E të mos flasim për kushtet e sterilizimit që lypen.

Prokurori për krime lufte, Vladimir Vukčević-i thotë se para se të bëhej publike kjo dëshmi “janë konsultuar shumë ekspertë mjekësorë, me qëllim që të tregojnë nëse mund të kryhej ndërhyrja ashtu si e tregonte dëshmitari. Kjo ndërhyrje, ku e vetmja gjë e rëndësishme është të merrej organi dhe të paketohej në mënyrë të sigurt, nuk duhet të ngatërrohet me metodën e transplantimit të organit.”

Sigurisht që një veprim i tillë, që me aq lehtësi prokurori e cilësoi si “ndërhyrje kirurgjike”, mund të ndodhë, siç mund të ndodhë që njeriu i gjallë të ngulet në hunj. Megjithatë, “paketimi i sigurt” është diçka tjetër. Nga tregimi i dëshmitarit del se këtu nuk kemi të bëjmë me kurrfarë “paketimi të sigurt”. Kjo është e qartë edhe për secilin spektator të vëmendshëm të televizionit dhe lexuesit e gazetave, e lere më për “shumë ekspertë mjekësorë” që na i paska konsultuar Prokuroria për krime lufte.

Prokurori për krime lufte Vladimir Vukčević-i flet për gjoja “respektimin e procedurave mjekësore”! Për çfarë procedurash mjekësore dhe për çfarë “paketimi të sigurt” flet ai? Kush janë ata “shumë ekspertë mjekësorë që janë konsultuar” që të na tregonin se si është e mundur që dikujt t’i hapet krahbarori me bajonetë Kallashnikovi. Me bajonetë, e cila është e konceptuar për të prerë telat me gjemba, më parë mund ta dëmtosh zemrën sesa ta nxjerrësh për transplantim. Madje edhe te njeriu i vdekur, e jo më te njeriu i gjallë i cili lëviz, dridhet dhe ulërin. Dëmtimi i zemrës mund të ndodhë edhe me instrumentet më të sofistikuar kirurgjike nga dora e pashkathët e lëre më nga bajoneta.

Siç shihet, Prokuroria për krime lufte sërish ka rrëshqitur. Për më tepër, nuk është hera e parë.

Organi që eksplantohe¹ duhet të nxirret në mënyrë që të mos dëmtohet as fizikisht e as biokimikisht. Organi i nxjerrë pastrohet mirë, mbushet me konservans dhe futet në kontejner të sterilizuar dhe të mbushur me akull. Madje edhe manipulimi me kontejnerin duhet të jetë i sterilizuar. Paralelisht me këtë proces zhvillohet edhe procesi i pranimit nga recipienti, respektivisht pranuesi i organit. Veshka duhet të transplantohet brenda 24 orëve ndërsa mëlçia brenda dhjetë orësh. Sa kam punuar në Akademinë Spitalore Ushtarake veshkën e kemi “fatur” brenda 45 minutave e deri në një orë.

Në rastet kur kemi të bëjmë me transplantim kadaverik procesi i konservimit të organit fillon ende pa u nxjerrë nga trupi. Fillimisht instalohen kanilat, nëpërmjet të cilave veprohet me konservues dhe organi ftohet. Në këtë rast nuk duhet të harrohen edhe problemet tjera teknike për sigurimin e sasisë së nevojshme të akullit të sterilizuar. Sigurimi i akullit të sterilizuar paraqiste problem të madh edhe për Akademinë Spitalore Ushtarake. Vetëm për një transplantim shpenzohet nga 30kg e deri në 40kg akull i sterilizuar. Pra, për nxjerrjen e organeve duhen kushte të sterilizuara, mbështetje e mirë laboratorike dhe mjete shumë të shtrenjta. Deri para pak kohësh në Serbi, që jemi shumë më mirë të pajisur se Kosova, vetëm në Akademinë Spitalore Ushtarake në Beograd ka pasur laborator për përgatitjen e mjeteve. Mendoj se

¹ Nxirren

në Kosovë nuk janë nxjerrë organe. Jam i bindur se ky tregim është i paqëndrueshëm.

Pohimet e Prokurorisë serbe për krime luftime në rastin më të mirë mund të konsiderohen si mendjelehtësi, nëse jo politikisht të motivuara me qëllim që të provokohet sensacion për një lëndë gjyqësore që ende nuk ka lëvizur më larg se indikacionet.

Ajo që është e pakuptueshme lidhet me atë pse askush nga kolegët e mi kirurgë nuk e ka ndjerë nevojën që të ngrihet dhe të tregojë publikisht për mungesën e logjikës dhe për kundërthëniet e qarta mjekësore që dalin nga tërë ky tregim. Ka mjaft kirurg të mirë që do të kishin mundur ta bënë një gjë të tillë.

I kam pyetur disa prej tyre për këtë gjë. Privatisht më thanë se vërejtjet e mia janë të drejta dhe se këtu diçka nuk është në rregull. Por, nuk dëshirojnë të shprehen publikisht. Ndoshta ka ndonjë lidhje me politikën¹ - shprehet Goran Kronja, ish-shefi i ekipit për transplantime organesh në Akademinë Spitalore Ushtarake në Beograd.

Vërejtjeve të kirurgut të njohur serb të kirurgjisë vaskulare, që ka bërë mbi 200 transplantime të organeve, nuk kam çka t'i shtoj asnjë. Ndërsa, për dilemat e tij nëse heshtja e kirurgëve tjerë në Serbi ka lidhje me politikën, mendoj se Goran Kronja nuk e ka lexuar shkrimin e gazetarit serb, Miroslav Filipović-i, «Marshi i gjatë drejt së vërtetës për krimet»². Lexuesit i kujtohet se Miroslav Filipović-i përjetoi pasoja të rënda nga regjimi i Beogradit për shkak se kishte ngritur zërin kundër krimeve serbe në Kosovë. Në kontekstin e shprehjes së habisë nga ana e kirurgut serbe Goran Kronja-s pse kirurgët tjerë serbë nuk reagojnë ndaj budallallëqeve për trafikimin e organeve po sjell kritikën që kishte bërë Miroslav Filipović-i i 13 vjet më parë ndaj sjelljes së intelektualëve,

¹ Svedok, «Ekskluzivno: Prof. dr Goran Kronja, Sumnjam da su otetim Srbima na Kosovu, nelegalno uzimani (i prodavani) organi» (Dyshoj se serbëve të Kosovës u janë marrë dhe janë shitur organet në mënyrë të paligjshme)
<http://www.svedok.rs/index.asp?show=75508>

Vreme, Miloš Vasić, «Kasapljenje i medicina» (Kasaphana dhe mjekësia)
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=1075917>

² Republika, Miroslav Filipović, artikulli i cituar «Dugi marš ka istini o zlocinima»
http://www.yuorpe.com/zines/republika/arhiva/2001/263/263_16.html

institucioneve kulturore, fetare dhe akademike të Serbisë që kishin hyrë në shërbim të regjimit të Milošević-it.

“Është vështirë të gjendet institucion kombëtar që të jetë munduar ta ruajë popullin serb nga kryerja e krimeve. Në veçanti është e vështirë të gjenden institucione që nuk e kanë nxitur popullin serb të kryejë krime. Ku ka qenë Akademia e Shkencave, ku ka qenë Kisha, ku ka qenë Universiteti, ku kanë qenë partitë politike? Çka ndodhi me Kishën e cila paralajmëroi se do t’i hapë dosjet e krimeve serbe në Kosovë? Ku mbeti paralajmërimi i Kishës se në emër të popullit serb do të pendohet dhe do të kërkojë falje nga viktimat tona?...”

Në përfundim Milošević-in moti e kanë quajtur «kasap të Ballkanit» dhe e kanë krahasuar me Hitler-in. Gjermania e para Luftës së Dytë nuk mund të krahasohet me Serbinë e fillimit të viteve të nëntëdhjeta. Kur Hitler-i filloi të çartet dhe t’i ngjajë një kafshe të tërbuar, e braktisën një numër i intelektualëve, i shkencëtarëve dhe i artistëve më eminentë të popullit gjerman. Edhe pse Serbinë e Milošević-it e braktisën një numër artistësh, shkencëtarësh dhe intelektualësh, shumica e tyre u vunë në shërbim të tij, përkundër asaj se e dinin se me urdhrin e tij, me miratimin e tij ose së paku me dijeninë e tij, çdo ditë “nga dora serbe” pësonin qindra njerëz të pafajshëm. Tani, të kërkohet nga këta njerëz që të flasin për krimet që janë bërë, do të thotë të kërkohet nga ata që ta pranojnë fajësinë e tyre.”

***Miroslav Filipović, “Marshi i gjatë drejt
së vërtetës për krimet” f.27-28***

KAPITULLI I TRETË

PROLOG I KAPITULLIT TË TRETË

Pesë vjet pas shpifjeve që shpërndau Shërbimi Sekret Serb përmes të ashtuquajturit «Libër i Bardhë» për gjoja “trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja” dhe po aq vite pasi Carla Del Ponte, në mungesë të provave, kishte ndërprerë hetimet lidhur me supozimet për një krim të tillë, botimi i librit të saj «Përndjekja: unë dhe kriminelët e luftës» i dha zjarr propagandës që akuzonte UÇK-në për krimet më të përbindshme.

Publikimi i librit të Carla Del Pontes, pikërisht në kohën kur debati rreth ligjshmërisë së aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishte në qendër të vëmendjes, u dha pretekst kundërshtarëve të pavarësisë që të drejtojnë gishtin akuzues drejt ish-drejtimesve të UÇK-së, që udhëhiqnin shtetin më të ri në botë. Nga data e publikimit të këtij libri e deri më 22 korrik të vitit 2010, kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë duhej të merrte vendimin lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë, stigmatizimi i UÇK-së si “organizatë terroriste dhe kriminele” dhe propaganda për gjoja “trafikimin e organeve njerëzore” nuk u hoq nga arsenal i propagandistik që kishte për synim dëmtimin e imazhit të Kosovës.

Edhe pas vendimit të kësaj gjykate se “miratimi i deklaratës së pavarësisë së Kosovës nuk kishte shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, as Kornizën Kushtetuese të Kosovës dhe asnjë rregull tjetër të aplikueshëm të së drejtës ndërkombëtare”¹ propaganda për gjoja “trafikimin e organeve njerëzore” vazhdoi me intensitet të njëjtë.

Mirëpo, në kohën kur mendohej se ishin shterur të gjitha burimet e propagandës, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dick Marty shtroi për diskutim raportin që e kishte përpiluar për “trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin

¹ Po aty, paragrafi 122

kundërligjor të organeve njerëzore në Kosovë”. Po u rikujtoj lexuesve se ky raport u kërkuar me këmbënguljen e qarqeve serbe dhe ruse në kuadër të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës¹.

Miratimi i këtij raporti nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës në vitin 2011 pati efekte tejet të dëmshme për imazhin e Kosovës. Në përputhje me miratimin e këtij raporti nga Asambleja e Përgjithshme, në shtator të vitit 2011 Bashkimi Evropian krijoi një Task Forcë Hetimore Speciale e cila u ngarkua për të hetuar vërtetësinë e Raportit të Dick Marty-t.

Rihapja e hetimeve shërbeu si argument për të mbajtur në fokus të vëmendjes së opinionit publik pohimet e raportit për “krimet e tmerrshme kundër civilëve serbë”.

Pas më shumë se gjashtë vite propagande për “trafikimin e organeve”, kryeprokurori i Task Forcës Hetimore Speciale, Clint Williamson-i, shpalli rezultatet e hetimeve në konferencën e shtypit të mbajtur në Bruksel më 29 korrik 2014.

Gjatë kësaj konference, kryeprokurori Williamson sqaroi se “(...) Task Forca Hetimore Speciale (TFHS) zhvilloi hetime të hollësishme për pohimet e raportit të Dick Marty-t. Gjatë dy viteve e gjysmë të këtij hetimi u morën në pyetje qindra dëshmitarë nëpër vendet e Evropës dhe gjetiu. U shqyrtuan mijëra faqe dokumentesh të përpiluara nga organizata dhe individë të shumtë që ishin të angazhuar në Kosovë gjatë periudhës ku është përqendruar hetimi ynë, por, edhe pas asaj periudhe (...). Prokurorë, hetues, oficerë ligjorë, analistë dhe specialistë të tjerë nga 18 shtete të BE-së, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara kanë punuar në rrethana tronditëse për të zhvilluar këtë hetim (...) Qeveria e Serbisë ka bërë gjithçka që ka mundur për të na ndihmuar në këtë proces e sidomos kryeprokurori për krimet e luftës, Vladimir

¹ Conseil de l'Europe, Assemblée Parlementaire, dokumenti i cituar, doc. 11574, 15 prill 2008

Vukčević-i, i cili, së bashku me zyrën e tij, na kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë...”¹

“Përkundër ndihmës së madhe” - vazhdon Kryeprokurori Williamson - “detyra e TFHS-së ishte tepër sfiduese. Ne po shqyrtojmë ngjarjet që ndodhën afërsisht 15 vjet më parë dhe për të cilat ekzistojnë shumë pak, ose aspak, prova materiale. Shumë dëshmitarë, të cilët ne besojmë se kishin informata që mund të kishin lidhje me hetimin tonë, kanë vdekur ose janë aq të drobitur saqë nuk janë në gjendje të japin dëshmi. Po ashtu disa dëshmitarë të mundshëm, të identifikuar nga ana e TFHS-së, nuk janë intervistuar sepse vendndodhjet e tyre aktuale nuk mund të zbuloheshin (...) Sa i përket pjesës së raportit që ka tërhequr shumicën e vëmendjes, për shkak të natyrës së saj sensacionale, e që lidhet me pretendimet e vrasjeve për qëllimet e nxjerrjes dhe të trafikimit të organeve njerëzore, ne kemi ardhur te konkluzioni se, për të ndjekur veprat të tilla penale, duhet një nivel provash që ende nuk e kemi siguruar. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që këto prova nuk do të materializohen dhe sigurisht ne do të vazhdojmë t’i kërkojmë ato. Kështu, në asnjë mënyrë nuk e kemi hedhur poshtë vërtetësinë e këtyre pretendimeve. Megjithëse unë ende nuk e ndjej se ka bazë mjaft të fortë të provave për të ardhur te përfundimi se mund të ngrihet aktakuza në lidhje me këtë aspekt të lëndës...”²

Përkundër ndihmës së madhe që kanë pasur nga të katër anët e botës, ndihmës së prokurorëve, hetuesve, oficerëve ligjorë, analistëve dhe specialistëve nga 18 shtete të BE-së, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës TFHS-ja nuk kishte gjetur prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzë për vrasje me qëllim

¹ Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task force, 29 July 2014 (Deklarata e kryeprokurorit të Task Forcës hetimore speciale, 29 korrik 2014)

http://www.sitf.eu/images/Statement/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_EN.pdf

http://www.sitf.eu/images/Statement/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_ALB.pdf

² Po aty

të nxjerrjes dhe të trafikimit të organeve njerëzore. Duke u bazuar në hetimet që kishin bërë, kryeprokurori Williamson konsideron se “kumtesat që janë dhënë nga disa njerëz, që linin të nënkuptohej se qindra njerëz ishin vrarë për qëllimin e trafikimit të organeve, janë krejtësisht të pabaza.”¹ Megjithatë, ai “beson se një praktikë e tillë ka mundur të ndodhë në një shkallë shumë të kufizuar dhe që një numër i vogël njerëzish është vrarë për qëllimin e nxjerrjes dhe trafikimit të organeve të tyre.”²

Prandaj, duke u mbështetur në “bindjet e veta”, edhe pse nuk ka prova, edhe pse nuk ka dëshmitarë, edhe pse dëshmitarët kanë vdekur ose janë drobitur deri në atë shkallë sa nuk janë në gjendje të japin dëshmi (...) kryeprokurori Williamson nuk e hedh poshtë vërtetësinë e pohimeve për trafikim organesh dhe do të vazhdojnë t’i kërkojmë provat për këto krime!

Çdo njeri ka të drejtë të shprehë mendimin e vet. Por, kur një prokuror, i ngarkuar të hetojë një dosje aq delikate siç është pretendimi për “trafikim organesh”, edhe pse nuk gjeti asnjë provë për të ngritur aktakuzë, vendos që në përputhje me “mendimet e veta” të mos mbyllë këtë çështje, atëherë del qartë se ky veprim nuk është gjë tjetër pos rrëshqitje nga fusha e drejtësisë në rrafshin e propagandës politike.

Është interesante të theksohet se kryeprokurori Clint Williamson falenderon në veçanti Vladimir Vukčević-in, i cili kishte qenë bashkëbiseduesi operativ kryesor i Williamson-it në bisedimet me Qeverinë serbe. Ishte Kryeprokurori për krime lufte i Serbisë i cili “zbuloi ish-ushtarin e UÇK-së që dëshmoi se si ia kishte nxjerrë zemrën me bajonetë kallashnikovi një të riu serb dhe se si e kishin transportuar nga Veriu i Shqipërisë në Aeroportin e Rinasit”; është i njëjti Vladimir Vukčević, i cili tre ditë pas transmetimit televiziv të “intervistës së dëshmitarit të mbrojtur” deklaroi se “pret reagimet e ekipit për hetime që udhëhiqet nga Clint Williamson-i lidhur me tregtinë me organe

¹ Po aty

² Po aty

njerëzish në Kosovë dhe Shqipëri”¹; është i njëjti person për të cilin gazetarja serbe Tatjana Tagirov-a deklaroi se “tallej me inteligjencën e qytetarëve të Serbisë” duke u ofruar “dëshmi” që të krijojnë mendimin se krime të tilla ishin kryer nga UÇK-ja.

Lexuesi pati mundësi të shohë në kapitullin paraprak se “dëshmitë” e ofruara nga Prokuroria për Krime Luftë e Serbisë, u cilësuan edhe nga kirurgu i njohur serb, Goran Kronja, si “marrëzi të Prokurorisë serbe për krime luftë”.

Nuk e di se deri në cilën shkallë “marrëzitë e Prokurorisë serbe për krime luftë” kanë ndikuar te kryeprokurori i Task Forcës Hetimore Speciale, Clint Williamson-i, që të krijojë mendimin se ka mundur të ndodhë një krim aq i shëmtuar. Por, ajo që mund të thuhet lidhur me qëndrimin për t’u mbajtur e hapur një lëndë për të cilën nuk u gjetën prova për 15 vjet hetime që nga koha kur u sajua legjenda për “trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja”, nuk është asgjë tjetër pos përpjekje për të mbajtur gjallë “marrëzitë” e sajua në Beograd!

Në mungesë të provave, në mungesë të dëshmitarëve dhe në mungesë të çdo gjëje që do t’i mundësonte kryeprokurorit Williamson të përgatiste një aktakuzë për “trafikim organesh” ai e orientoi hetimin e Task Forcës Hetimore Speciale në drejtim tjetër, me shpresë se do të jetë më i suksesshëm!

“Edhe pse nuk ka qenë përgjegjësia jonë kryesore”- deklaroi Williamson-i gjatë konferencës- “ne e kemi ndjerë për detyrim të fortë të bëjmë gjithçka që kemi mundur për të mësuar për fatin e njerëzve që u zhdukën në vitet 1998 dhe 1999 dhe vendndodhjet e të cilëve ende nuk dihen. Për fat të keq, deri tani ne kemi sjellë vetëm pak informata që do të na drejtonin në vendet ku ishin varrosur trupat ose që do të ndriçonin fatin e atyre të cilët u zhdukën.

Me gjithë vështirësitë për t’i siguruar provat “ne besojmë se TFHS-ja do të jetë në gjendje të ngrejë një aktakuzë kundër

¹ BLIC, «Vukčević ocekujë reakciju međunarodnog tima i Vilijamsona», (Vukčević-i pretreagimet e ekipit ndërkombëtar të Williamson-it), 13.09.2012 <http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/342578/Vukcevic-ocekujë-reakciju-medjunarodnog-tima-i-Vilijamsona>

zyrtarëve të lartë të caktuar të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këta individë mbajnë përgjegjësinë për fushatën e persekutimit që ishte drejtuar kundër popullsisë serbe, rome dhe pakicave të tjera në Kosovë si dhe kundër bashkëkombësve shqiptarë të Kosovës gjatë viteve 1998 dhe 1999, të cilët i etiketuan si bashkëpunëtorë të serbëve (...) dhe janë përgjegjës për veprat e persekutimit që përfshinin vrasje të paligjshme, rrëmbime, zhdukje të detyruara, burgime të paligjshme në kampe në Kosovë dhe në Shqipëri, dhunë seksuale, forma të tjera të trajtimit çnjerëzor, zhvendosje me dhunë ...”¹

Shpresoj se lexuesi e sheh se qëndrimi i ekspozuar në këtë konferencë nuk dallon në asnjë fjalë nga propaganda që është shpërndarë vazhdimisht nga regjimet e Beogradit për ta stigmatizuar UÇK-në. Ky aspekt u trajtua përgjatë tërë këtij libri, duke filluar nga kapitulli i parë. Edhe ky kapitull i kushtohet të njëjtës çështje, sepse përbën shtyllën kryesore rreth të cilës është artikulluar e tërë strategjia e stigmatizimit të luftës çlirimtare të popullit shqiptar të Kosovës.

Vrasja, rrëmbimi dhe zhdukja e civilëve në luftën e Kosovës

Analiza dhe raporte të shumta dëshmojnë në mënyrë të pakontestueshme se gjatë konflikteve të armatosura, sidomos që nga Lufta e Dytë Botërore, shumica dërmuese e viktimave janë civilë të vendeve ku zhvillohen konfliktet.

Për këtë arsye shpërthimet e luftërave të armatosura mobilizojnë institucionet ndërkombëtare, ato regjionale si dhe mijëra organizata joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Krahas thirrjeve për ndërprerjen e armiqësive, kërkesa të veçanta u drejtohen palëve në konflikt për të respektuar Konventën e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë gjatë kohës së luftës.

¹ Deklarata e cituar e kryeprokurorit të Task Forcës hetimore speciale http://www.sitf.eu/images/Statement/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_EN.pdf

E njëjta gjë ndodhi edhe me luftërat që u zhvilluan gjatë shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave. Agresionet e Ushtrisë Jugosllave kundër Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjës e Hercegovinës mobilizuan opinionin publik ndërkombëtar dhe institucionet me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare kundër politikës së gjenocidit që orkestronte Beogradi. Komandimi i këtyre agresioneve nga Beogradi bënë që gishti i përgjegjësish kryesore të drejtohet drejt Slobodan Milošević-it dhe strukturave tjera të pushtetit që kontrolloheshin prej tij.

Duke dashur ta shmangë revoltën e opinionit publik ndërkombëtar, Shtabi Strategjik i Milošević-it aplikoi një strategji të “re” në luftën e Kosovës!

Përkundër faktit se askush nuk e mohonte se në Kosovë vriteshin civilë, si rezultat i kësaj strategjie lindën divergjenca të mëdha rreth asaj se cilët ishin këta civilë dhe kush i vriste ata.

U desh të pritej përfundimi i luftës që të dalin në shesh krimet e përbindshme të kryera kundër civilëve në Kosovë.

Në këtë kontekst, në pjesët e mësipërme të këtij libri, lexuesit i sollëm deklaratat e Ratomir Tanić-it, përfaqësuesit të partisë «Demokracia e Re» në ekipin serb të negociatave me Kosovën. Ratomir Tanić-i, i cili deklaroi haptazi se “kishte qëndrim tejet negativ ndaj shqiptarëve, sepse ata paraqesin problem të caktuar për interesat kombëtare të Serbisë”¹ dhe për të cilin “UÇK-ja është organizatë terroriste”, në një intervistë ekskluzive për Radion Evropa e lirë² shprehu pakënaqësitë e veta lidhur me strategjinë e aplikuar nga regjimi i Milošević-it. “Ta izolosh terrorizmin është një çështje krejt tjetër nga vrasja e grave dhe e fëmijëve. Forcat tona të sigurisë nuk bënë luftë kundër terroristëve. Ata luftën e bënë kundër popullatës civile. Kështu filloi konflikti etnik në mars

¹ Procesi gjyqësor kundër Milošević-it, Dëshmia e Ratomir Tanić-it, seanca e 16 majit 2002, f. 755

² *Radio Europe Libre*, Ratomir Tanić: "Oui, il existait un plan de nettoyage ethnique du Kosovo", 7 mars 2001
<https://docs.google.com/document/d/1lBGqdCw5E9tFjZlQpn96ohv7UlnKXl3DNkCOECzEV2M/edit?pli=1>

të vitit 1998 (...) ¹ Milošević-i dhe Šainović-i² vepronin në mënyrë që 'lufta kundër terrorizmit' të kthehej në luftë kundër fshatrave dhe civilëve shqiptarë. Qëllimi i kësaj strategjie ishte të dëboheshin këta njerëz nga Kosova, t'u merreshin dokumentet e identifikimit dhe t'i fshinin nga gjendja civile. Më vonë, në rast se imponohej t'i kthenim të dëbuarit, ne do të pohonim se nuk janë nga Kosova por nga Shqipëria"³- sqaroi Ratomir Tanić-i.

Politikën e spastrimit etnik dhe të gjenocidit në Kosovë e trajtova më gjerësisht në disa kapituj të këtij libri. Në këtë kapitull po kufizohem vetëm në aspektin e kryerjes së krimeve nga Shërbimi Sekret Serb dhe veshjen e këtyre krimeve UÇK-së me qëllim që ta stigmatizojnë si "organizatë terroriste".

Politika e kryerjes së krimeve kundër popullsisë civile ishte denoncuar edhe nga intelektualë serbë. Lexuesi pati mundësi të njihet me fatin e gazetarit serb, Miroslav Filipović-it. Për shkak të ngritjes së zërit kundër krimeve të Serbisë në Kosovë dhe denoncimit publik se "eskadronët e përbërë nga serbë sulmonin serbët dhe pronat e tyre në Kosovë dhe akuzonin shqiptarët me qëllim që të ngrisin tensione ndëretnike"⁴, Miroslav Filipović-i u dënua me 7 vjet burg.

Dënimi i gazetarit serb që u distanca publikisht nga krimet e kryera në Kosovë pati efekte në imponimin e heshtjes së atyre që dinin se çka kishte ndodhur në Kosovë. Përkundër "ndryshimeve" në Serbi, heshtja e krimeve dhe fshehja e gjurmëve të tyre mbretëroi deri pak kohë më parë.

Pesëmbëdhjetë vjet pas gjenocidit në Kosovë, personalitete të skenës politike të Serbisë nxorën në shesh logjikën e regjimit të Beogradit mbi të cilën ishin bazuar pushtetarët e Serbisë gjatë

¹ Po aty

² Nikola Šainović-i, ish-kryetar i Republikës së Serbisë dhe nënkryetar i Qeverisë Federative të Jugosllavisë. Më 26 shkurt 2009 u dënua nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, me 22 vjet burg për përgjegjësitë në krimet e luftës kundër shqiptarëve në Kosovë.

³ Vreme, Miloš Vasić, «Privatni nihilizam i ideološke fikcije» (Nihilizmi privat dhe fiksionet ideologjike) <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=323038>

⁴ Republika, Ogleđi, Nr. 263, artikulli i cituar, Miroslav Filipović, «Dugi marš ka istini o zlocinima»

luftës në Kosovë. Sidomos, dolën në shesh struktura, funksionimi dhe qëllimet e Shtabit Strategjik të Milošević-it.

Në dhjetor të vitit të 2013, Aleksandar Vučić-i, në atë kohë zëvendëskryeministër e aktualisht

kryeministër i Qeverisë së Serbisë, deklaroi publikisht në emisionin televiziv “Teška reč” në TV Pink se: “në Serbi pushteti vriste edhe ata që mendonin ndryshe, edhe kundërshtarët e vet. Ky është një problem i tmerrshëm për vendin tonë. Ka shumë gjëra të tmerrshme, me të cilat duhet të ballafaqohemi...”¹

Gjatë këtij emisioni, kryeministri serb përmendi rastin e vrasjes së gjashtë të rinjve serbe në kafenenë «Panda» të Pejës, në vitin 1998. Ai hodhi poshtë akuzat që drejtoreshin kundër shqiptarëve dhe për këtë krim fajësoi pushtetin e Beogradit. Është interesant se Aleksandar Vučić-i pranoi se kishte qenë pjesë e atij pushteti, por mohoi të këtë qenë i implikuar në krime të tilla².

Deklarata e Aleksandar Vučić-it krijoi një kontekst të ri në Serbi. Përveç personaliteteve publike të skenës politike serbe filluan të dëshmojnë publikisht edhe pjesëmarrës në krimet e kryera në Kosovë³.

Këto prononcime dhe dëshmi nxorën në shesh një pjesë të vogël të “shumë gjërave të tmerrshme”⁴ që kishte bërë ky regjim.

Po përmend reagimin e Vuk Drašković-it, kryetarit të Lëvizjes së Ripërtërimit Serbe, i njohur si kundërshtar politik i Milošević-it. Po u rikujtoj atyre që kanë harruar se ky politikan serb, në momentet kur opinioni publik ndërkombëtar ishte tmerruar nga krimet kundër njerëzimit që ishin bërë në Reçak⁵ dhe reagimet kishin arritur kulmin me kërkesa për ndërhyrje ushtarake

¹ Radijo-Televizija Srbije, «Vučić: Država je ubila Čuruviju» (Shteti e ka vrarë Čuruvija-n), 29.12.2013

<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1482926/Vu%C4%8Di%C4%87%3A+Dr%C5%BEava+je+ubila+%C4%86uruviju.html>

² Më gjerësisht shih Kapitullin e dytë të pjesës së parë të librit

³ Në epilogun e Kapitullit të parë të librit tim solla dëshminë publike të policit serb, Slobodan Stojanović-it

⁴ Shprehje që përdori Aleksandar Vučić-i

⁵ E kryer më 15 janar 1999. Shih Kapitullin e tretë të Pjesës së Parë

kundër Serbisë¹, më 18 janar 1999, u emërua zëvendëskryeministër i Jugosllavisë dhe u ngarkua të udhëhiqte marrëdhëniet me jashtë. Këtë funksion e ushtroi deri më 29 prill 1999, në kohën kur Vuk Drašković-i u shkarkua për shkak të kritikave publike kundër qeverisë dhe këmbënguljes së tij që të pranoheshin kushtet për ndërprerjen e bombardimeve².

Në intervistën e titulluar “Milošević-i urdhëroi Radeta-n dhe Legia-n t’i vrasin fëmijët serbë”³, Vuk Drašković-i i dha një mbështetje të fuqishme Aleksandar Vučić-it. Në këtë intervistë, ish-zëvendëskryeministri jugosllav, Vuk Drašković-i, bëri publike mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe të marrjes së vendimeve kriminale për të nxitur urrejtjen kundër shqiptarëve dhe për të stigmatizuar UÇK-në.

Ai sqaroi se “Milošević-i dhe Shtabi i tij strategjik kishin sjellë vendim që të kryheshin një varg krimesh kundër civilëve serbëve dhe shqiptarë në Kosovë.”⁴

Vrasja e civilëve serbë ishte më e besueshme t’u atribuohet “terroristëve” shqiptarë se sa vrasja e civilëve shqiptarë. Për këtë arsye, vrasja e civilëve shqiptarë shoqërohej me “sqarimin” se gjoja bëhej fjalë për “shqiptarë besnik ndaj regjimit të Beogradit”.

Në krye të eskadronit të vdekjes, siç e quan Vuk Drašković-i strukturën që ishte ngarkuar t’i kryente këto krime, “ishte caktuar Milorad Ulemek-Legija, udhëheqësi i Njësisë për Operacione

¹ Kjo temë u trajtua gjerësisht në Kapitullin e tretë të Pjesës së Parë

² Le monde, «Vuk Draskovic nommé vice-premier ministre de la RFY», (Vuk Drašković-i u emërua zëvendëskryeministër), 20.01.1999
http://www.lemonde.fr/archives/article/1999/01/20/vuk-draskovic-nomme-vice-premier-ministre-de-la-rfy_3532258_1819218.html
dhe

Les Echos, «Le vice-Premier ministre Vuk Draskovic limogé du gouvernement yougoslave» (Zëvendëskryeministri Vuk Drašković-i u shkarkua nga qeveria Jugosllave), 29.04.1999

http://www.lesechos.fr/29/04/1999/LesEchos/17889-024-ECH_le-vice-premier-ministre-vuk-draskovic-limoge-du-gouvernement-yougoslave.htm

³ Kurir, artikulli i cituar, «Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu!»

⁴ Kurir, artikulli i cituar, «Rade Marković dao nalog da se ubiju srpska deca u Peći 1998?!»

Speciale¹. Legija, emër me të cilin njihet ky kriminel, i merrte urdhrat nga Radomir Marković-i, shefi i atëhershëm i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë.”²

Krahas publikimit të fakteve se Shtabi strategjik i Milošević-it kishte marrë vendimin për vrasjen e civilëve serbë dhe shqiptarë dhe publikimit të emrave të strukturës komanduese dhe operative të «eskadronit të vdekjes», ish-zëvendëskryeministri jugosllav, Vuk Drašković-i, bëri publik edhe qëllimin e këtyre akteve kriminale. “Përmes një varg sulmesh terroriste të kryera nga Shërbimi i Sigurisë Shtetërore, të cilat duhej t’i visheshin UÇK-së, do të arriheshin dy qëllime: UÇK-ja do të paraqitej në sytë e bashkësisë ndërkombëtare si organizatë terroriste dhe vrasja e civilëve të pafajshëm do t’u jepte zjarr ndjenjave antishqiptare në Kosovë dhe në tërë Serbinë.”³

Për të ilustruar me shembull konkret këtë strategji të dyfishtë të regjimit të Milošević-it, Vuk Drašković-i theksoi se “në funksion të kësaj strategjie, Sigurimi Shtetëror i Serbisë, me në krye Radomir Marković-in, me ndihmën e Milorad Ulemek-Legija-s, më 14 dhjetor 1998 kreu masakrën kundër gjashtë djelmohave serbë në kafenenë «Panda» në Pejë.”⁴

Sa u përket rezultateve të qëllimit për të ngritur tensionet ndëretnike, lexuesi pati mundësi t’i shohë në disa kontekste kur u trajtuan mobilizimet e popullit serb kundër “terrorizmit shqiptar”. Ndërsa sa i përket qëllimit të stigmatizimit të “UÇK-së si organizatë terroriste”, drejtuesit e Shtabit strategjik të Milošević-it ishin të vetëdijshëm se pa angazhimin e një numri intelektualësh të shteteve të demokracive perëndimore në procesin e shpër-

¹ Në serbisht JSO (Jedinica za specialne operacije)

² Shefi i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, Radomir Marković-i dhe shefi i eskadronit të vdekjes, Milorad Ulemek-Legija, u dënuan nga Gjykata e Qarkut në Beograd me nga 40 vjet burg për dhënien e urdhrat, porosinë e vrasjeve të shumta në Serbi dhe kryerjen e vrasjeve. Dënimi prej 40 vjetësh është dënimi maksimal që parasheh Kodi Penal i Serbisë.

³ Artikulli i cituar «Milošević-i e urdhëroi Radeta-n dhe Legia-n që t’i vrasin fëmijët serbë» («Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu!»)

⁴ Po aty

ndarjes së nocioneve të sajuara nga ky regjim, efektet do të ishin shumë më të vogla. Për këtë qëllim, materialet e përgatitura nga shërbimet sekrete serbe u përkthyen në disa gjuhë të huaja dhe u shpërndanë falas si «Libër i Bardhë».

Nuk po i përmend të gjithë historianët e politologët, filozofët e sociologët, gazetarët e publicistët, qofshin të orientimit të djathtë apo të majtë, të cilët hynë në kumbarinë e nocioneve të përgatitura nga Shërbimi Sekret Serb dhe shpërndarjen e asaj skeme të interpretimit të ngjarjeve në Kosovë që kishte përgatitur ky shërbim. Gjatë tërë këtij libri u analizuan qëndrimet e tyre. Në përmbyllje të librit tim po rikujtoj vetëm disa raste që më duken domethënëse në raport me propagandën për gjoja vrasjen e civilëve nga ana e UÇK-së.

Që nga procesi i montuar gjyqësor për «Rastin Kleçka»¹, kur regjimi i Milošević-it dhe ithtarëve të tij propagandonte për “qindra civilë serbë, ‘shqiptarë besnikë ndaj Serbisë’ dhe pjesëtarë të grupeve tjera etnike të Kosovës” që gjoja “ishin vrarë nga UÇK-ja” dhe pas vrasjes gjoja ishin djegur në «Krematorin gëlqeror», lexuesi pati mundësi të njëjët me mekanizmat e dhunës që përdorshin për t’i detyruar shqiptarët të pranonin veprat që nuk i kishin kryer. Tërë dhuna e ushtruar në proceset hetimore konsistonte që të gjendeshin persona të cilët do të pranonin se ishin ushtarë të UÇK-së dhe se gjoja kishin vrarë civilë të pafajshëm. Kjo do t’i siguronte “provat” se “UÇK-ja është organizatë terroriste”!

Gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Nish doli në shesh se eshtrat e ekspozuara nga gjykatësja hetuese Danica Marinković-i nuk ishin eshtra të serbëve, për vrasjen e të cilëve ngarkoheshin vëllezërit Mazreku, por, ishin eshtra civilësh të pidentifikuar!

Largimi i Milošević-it nga pushteti krijoi kontekstin e favorshëm që të ndriçohet ky rast. Gjykata Supreme e Serbisë anuloi vendimin përmes të cilit Gjykata e Qarkut në Nish kishte dënuar Luan dhe Bekim Mazrekun me nga 20 vjet burg dhe i shpalli të pafajshëm.

¹ Është trajtuar gjerësisht në Kapitullin e parë të librit

Edhe pse nuk mundën të identifikohen personat e vrarë, eshtrat e të cilëve u ekspozuan si “mbetje nga Auschwitz-i shqiptar”, mbeturinat e regjimit të Milošević-it vazhdojnë të propagandojnë se ata janë vrarë nga UÇK-ja¹!

E njëjta gjë ndodhi edhe pas vrasjes së gjashtë të rinjve serbë dhe malarez në Pejë².

Instalimi i klimës së terrorit në qytetin e Pejës në dhjetor të vitit 1998 dhe torturimi i më se 100 shqiptarë për të “gjetur dorasit e krimit” rezultuan me ngritjen e një procesi të montuar gjyqësor për të dëshmuar se “UÇK-ja ishte organizatë terroriste”.

Lexuesi pati mundësi të njëjtoj me përjetimet e Gazmend Bajramit (20 vjeç), Vllaznim Përgjegjajt (19 vjeç), Xhevdet Bajramit (21 vjeç), Beqir Loxhajt (27 vjeç), Agron Kollçakut (26 vjeç) dhe Behar Bajrit (18 vjeç). Të gjithë të pranishmit në sallën ku u mbajt seanca gjyqësore kundër këtyre gjashtë të rinjve shqiptarë patën mundësi të shihnin gjurmët e torturave mesjetare të aplikuara kundër tyre për t'i detyruar t'i pranonin krimet që nuk i kishin kryer.

Njëmbëdhjetë muaj pas arrestimit të tyre, Gjykata e Qarkut të Leskovcit ua hoqi akuzën për vrasjen e gjashtë të rinjve serbë dhe malarez dhe “i dënoi me nga një vjet burg për vrasjen e shumë policëve!”³

“Terroristë të UÇK-së”, që “kishin vrarë shumë policë” u dënuan vetëm me nga një vit burg!

Nuk besoj të ketë ndonjë vend në botë që pjesëtarët e një organizate terroriste, për të cilët pretendohej të kenë vrarë shumë policë, të mund të dënohen vetëm me nga një vit burg! Ky vendim i Gjykatës së Qarkut të Leskovcit dëshmoi në mënyrë më të qartë të mundshme se bëhej fjalë për një proces të montuar gjyqësor në funksion të stigmatizimit të UÇK-së.

¹ Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f.925

² Rast i trajtuar hollësisht në Kapitullin e dytë

³ Vendimi Gjyqësor K.br 41/99 të 09.11.1999

Strategjia e stigmatizimit të UÇK-së si “organizatë terroriste që vret civilë të pafajshëm” nuk mbeti pa efekte edhe në qarqe të caktuara ndërkombëtare. Po rikujtoj rastin e shkrimtarit dhe filozofit francez, Regis Debray-së. Aspekte të ndryshme të shkrimit të tij të publikuar si «Letër e një udhëtari Presidentit të Republikës»¹ u analizuan në disa kapituj të librit tim. Në këtë kontekst po i kthehem edhe një herë çështjes së pasojave në njerëz që shkaktoi agresioni serb në Kosovë dhe shpërndarjen e dezinformatave që bëri Regis Debray-ja.

Sa i përket pasojave të luftës, Këshilli për mbrojtjen e të drejtave e të lirive të njeriut në Kosovë publikoi të dhëna për vrasjen e mbi 2500 civilëve shqiptarë vetëm gjatë ofensivave serbe të vitit 1998. Megjithatë, në shumicën e raporteve të organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave e të lirive të njeriut kjo shifër zvogëlohet në një shifër të papërcaktuar: rreth 2000 civilëve shqiptarë².

As Regis Debray-ja nuk e mohoi numrin e të vrarëve. Por, ai e interpretoi në një mënyrë krejt tjetër. Ky filozof dhe shkrimtar, i cili pretendonte “se ishte i paanshëm” në konflikt, u mundua ta paraqesë gënjeshtren si realitet që “ishte botërisht i ditur”! Për ta shitur si të vërtetë manipulimin me numrin e të vrarëve, Regis Debray-ja i “rikujton” presidentit francez dhe opinionit publik se gjoja “në vitin 1998 ishin vrarë 1700 ushtarë shqiptarë, 180 policë dhe 120 ushtarë serbë!” Shifrat rreth 2000 civilëve shqiptarë të vrarë nga forcat serbe u shndërruan në saktësisht 2000 persona të vrarë, pjesëtarë të forcave të armatosura të të dyja palëve! Jo vetëm që u mundua ta zvogëlojë numrin e shqiptarëve të vrarë në 1700 persona, por, edhe në mesin e këtyre 1700 personave nuk kishte asnjë civil shqiptar të vrarë nga forcat serbe!

Identifikimi me këtë qëndrim dëshmon jo vetëm për anshmërinë e tij, por, edhe më keq se kaq. Ai identifikohet tërësisht me strategjinë e stigmatizimit ekstrem të propagandës serbe, ku

¹ Le monde, Régis Debray, artikulli i cituar, « Lettre d'un voyageur au président de la République »

² Ky aspekt u trajtua më gjerësisht në Pjesën e Parë të librit.

“çdo shqiptar është terrorist” dhe rrjedhimisht “çdo shqiptar i vrarë është një terrorist më pak!”

Regis Debray-ja e thotë haptazi se u bë gabim që u intervenua kundër Serbisë sepse faji nuk është në Beograd, por “në rrugët, kafenetë, shitoret e Prishtinës”. Ai vazhdon me fajësimin e shqiptarëve dhe i paraqet si “njerëz që nuk ngjallin asnjë ndjenjë sigurie”. Madje, shqiptarët gjoja e paskëshin “sulmuar shumë ashpër, një apo dy herë”, dhe nga rreziku që i kanosej prej tyre e paskëshin shpëtuar oficerët serbë!”¹ Prandaj, sipas kësaj “logjike” në të cilën aderon Regis Debray-ja, njerëzit “e rrugëve, kafeneve dhe shitoreve të Prishtinës”, që na “e paskëshin sulmuar” edhe atë, nuk mund të konsiderohen civilë! Nëse ka civilë të vrarë dhe të plagosur, “ata janë vrarë dhe plagosur nga UÇK-ja ose nga bombardimet e NATO-s”, të cilën e konsideron si “organizatë që nuk është asgjë tjetër pos nënshttrim ushtarak dhe politik i Evropës perëndimore ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës.”²

Fshehjes së numrit të civilëve të vrarë shqiptarë, Regis Debray-ja i shtoi edhe manipulimin me statistikat për pasojat e civilëve serbë në Kosovë!

Duke pretenduar se informatat i kishte siguruar prej “opozitarëve” të regjimit të Beogradit, nga gazetari me “origjinë serbe, por, properëndimor” dhe nëpërmjet “gazetarit perëndimor, por, antiserb”, Regis Debray-ja shpërndau gënjeshtren se gjoja “UÇK-ja kishte rrëmbyer 380 persona, prej të cilëve 103 ishin liruar, ndërsa të tjerët kishin vdekur ose konsideroheshin të zhdukur.”³

Vetëm Regis Debray-ja e di të vërtetën se kush qëndron prapa gënjeshtres për gjoja “380 civilët të rrëmbyer nga UÇK-ja”. Kjo gënjeshtër e tejkalon edhe propagandën zyrtare të Shtabit Strategjik të Milošević-it. Katër muaj para “vizitës” së Regis Debray-së në Maqedoni, Kosovë e Serbi dhe para se ai t’i takonte “burimet e sigurta të informatave” të cilët i kishin treguar se “UÇK-

¹ Po aty

² Po aty

³ Letra e cituar

ja i kishte rrëmbyer 380 persona ...”¹, propaganda e regjimit të Milošević-it kishte publikuar librin e titulluar «Krimet e terroristëve shqiptarë 1995-1998»².

Në përputhje me strategjinë e lartpërmendur të Shtabit Strategjik të Milošević-it, në këtë libër publikohen listat e civilëve të vrarë ose të rrëmbyer, vrasja dhe rrëmbimi i të cilëve u vishej “terroristëve shqiptarë të UÇK-së”.

I kërkoj falje lexuesit për arsye se në vijim të trajtimit tim do të ndalem në disa të dhëna statistikore. Sado të lodhshme që të jenë për t’u lexuar e shoh të domosdoshme sepse sqarimi i tyre ndihmon në ndriçimin e një pjese të realitetit. Sidomos, do t’i mundësojë lexuesit ta kuptojë më mirë se çka fshihet prapa akuzave drejtuar UÇK-së për vrasjen e civilëve.

***«Gënjeshtra çmohet më shume se e vërteta:
pothuajse të gjithë janë gati ta besojnë»***

Paul Léautaud

Në krahasim me propagandën për vrasjen e qindra civilëve serbë dhe malazez, në librin «Krimet e terroristëve shqiptarë 1995-1998» numri i civilëve të vrarë u zvogëlua dukshëm. Sipas këtyre listave, 32 civilë të vrarë ishin të përkatësisë serbe dhe malazeze³, 65 civilë të vrarë ishin shqiptarë⁴ dhe 8 civilë të vrarë u përkisnin grupeve të tjera etnike⁵. Edhe numri i atyre që konsideroheshin si të rrëmbyer apo të zhdukur nga UÇK-ja u zvogëlua në krahasim me propagandën për një numër që shkante në 380 civilë serbë dhe malazez. Në listën e të rrëmbyerve dhe të zhdukurve ishin 153 civilë serbë⁶, 59 shqiptarë¹ dhe 19 pjesëtarë të grupeve tjera etnike².

¹ Letra e cituar

² Впрае cituar, Злочини албанских терориста 1995-1998, Приштина, Јанар 1999, f. 241

³ По аты, f.113-114

⁴ По аты, f.115-118

⁵ По аты, f.119

⁶ По аты, f.120-126

Nëse i mbledhim shifrat e të gjitha listave të publikuara nga Shërbimi Sekret Serb, për të gjitha krimet që i vishen “UÇK-së dhe terroristëve shqiptarë” që nga viti 1995 e deri më 31 dhjetor 1998, totali del më i vogël se shifrat e publikuara nga Regis Debray-ja për “380 persona të rrëmbyer nga UÇK-ja”.

Propaganda e shpërndarë nga Regis Debray-ja për gjoja “380 civilë të rrëmbyer nga UÇK-ja” vetëm për vitin 1998, e vë këtë intelektual të verbuar nga «antiamerikanizmi» në pozita më ekstreme se ekstremistët serbë të Shtabit Strategjik të Milošević-it.

Në «Librin e Bardhë» të Shërbimit Sekret Serb, të botuar dhe të shpërndarë në mars të vitit 2000, domethënë 9 muaj pas përfundimit të luftës, publikohen listat e civilëve të vrarë, të rrëmbyer dhe të zhdukur që i atribuohen UÇK-së. Edhe në këtë botim, që përfshin periudhën nga 1 janari 1998 deri më 10 qershor 1999, pra deri në datën që për Serbinë konsiderohet përfundimi i luftës, numri zyrtar i serbëve që pretendohej se ishin rrëmbyer apo zhdukur nga UÇK-ja u zvogëlua edhe më tej. Në krahasim me botimin paraprak, në botimin e vitit 2000 ky numër u zvogëlua në fiks “100 civilë serbë dhe malazet të rrëmbyer dhe të zhdukur.”³

Në listën përfundimtare të civilëve të rrëmbyer, Shërbimi Sekret Serb i kohës së Milošević-it përmend emrat e 11 personave, të cilëve nuk ka mundur t’ua përcaktojë moshën (!) por për të cilët “e dinë se i kanë rrëmbyer dhe zhdukur terroristët e UÇK-së!”

Që të duket sa më tragjik “veprimi i terroristëve shqiptarë”, në listën e personave të “rrëmbyer” përmenden njerëz të moshave të shtyra, të cilët nuk kanë qenë në gjendje të mbrohen. Në këtë listë përmenden emrat e Miroslav Šmigić-it, 80 vjeçar, Sultana Šmigić-it, 76 vjeçare, Aleksandar Šmigić-it, 75 vjeçar, Jovan Vasić-it 74 vjeçar, Vitko Kostić-it, 70 vjeçar, Stajko Andjelković-it, 69 vjeçar, Darinka Vujošević-i, 69 vjeçare, Dragoljub Vošić-i, 69 vjeçar, Živorad Krstić-i, 68 vjeçar, Radomir Vošić-i, 67 vjeçar e kështu me radhë.

¹ Po aty, f.127-129

² Po aty, f.130

³ Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f.960-967

Është interesant se që nga data 1 janar 1998 e deri më 10 qershor 1999, në Librin Amëz të të vdekurve në komunën e Deçanit, të Pejës, të Rahovecit, të Skenderajt dhe të Drenasit, pra në komunat ku intensiteti i luftës ishte më i madh, asnjë serb nuk ishte regjistruar si i vdekur nga vdekje natyrore! Unë kam dyshimet e mia lidhur me këtë “rastësi”. Sa është e besueshme le të gjykojë vetë lexuesi!

Edhe numri i të rrëmbyerve dhe i të zhdukurve të pjesëtarëve të grupeve tjera etnike u zvogëlua! Nga 19 që ishin publikuar në janar të vitit 1999, në botimin e vitit 2000, për të njëjtën periudhë kohore, ky numër zbriti në 12 persona!

Vetëm numri i civilëve shqiptarë u rrit! Nga 59 që ishin publikuar në botimin e janarit të vitit 1999, në botimin e vitit 2000, ky numër u rrit në 77 persona!

Në «Librin e Bardhë» nuk mungojnë as emrat e të vvarëve, të rrëmbyerve dhe të zhdukurve, pjesëtarë të forcave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe pjesëtarë të forcave të armatosura të saj të cilët u vranë, u rrëmbyen apo u zhdukën nga “terroristët e UÇK-së”.

Fillimisht, në listën e të rrëmbyerve dhe të zhdukurve, Shërbimi Sekret Serb i regjimit të Milošević-it përmend edhe 14 policë¹ të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë që ishin “rrëmbyer dhe zhdukur nga terroristët shqiptarë”.

Përveç rrëmbimit apo zhdukjes së 14 pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, u publikua edhe lista e 274 pjesëtarëve të kësaj ministrie të vvarë në “aksionet terroriste të separatistëve shqiptarë”² dhe lista e 40 ushtarëve³ të Armatës Jugosllave, “të vvarë, të rrëmbyer apo të zhdukur gjatë periudhës nga 1 janari i vitit 1998 e deri më 24 mars 1999”.

Nga 40 ushtarët e vvarë, emrat e të cilëve publikohen në këtë listë, 34 thuhet se ishin vvarë deri më 13 nëntor 1998. Sipas kësaj liste, vetëm gjashtë ushtarë të Armatës Jugosllave ishin vvarë deri

¹ F. 973-974

² F. 932-956

³ F. 978-981

në fillimin e bombardimeve të NATO-s! Lista që qarkullonte për 120 ushtarët e Armatës Jugosllave, të vrarë gjatë vitit 1998, listë që i ishte dhënë Regjis Debray-së, u zhduk!

Shpresoj se pasi të ketë përfunduar së lexuari këtë kapitull, lexuesi do të ketë të qartë se motivet e fshehjes së emrave të policëve dhe ushtarëve të vrarë gjatë luftimeve me UÇK-në qëndronin në minimizimin e humbjeve të forcave policore dhe ushtarake serbe dhe këto humbje t'ia vishnin NATO-s!

Përfundimi i luftës dhe rrëzimi i Slobodan Milošević-it nga pushteti krijuan premisat që pushteti i ri në Beograd të ndriçonte periudhën e luftës. Megjithatë, siç e trajtova edhe në kapitujt paraprakë, strukturat e aparateve të dhunës mbetën të njëjta si në kohën e regjimit të përparshëm. Rokadat në strukturat udhëheqëse nuk e cenuan aspak mënyrën e vjetër të funksionimit.

Në të njëjtën logjikë si gjatë regjimit të vjetër, Shërbimi Sekret Serb përgatiti botimin e ri të «Librit të Bardhë» për “krimet e terroristëve shqiptarë” dhe në emër të Qeverisë së “re” të Serbisë, në nëntor të vitit 2001, u publikua vëllimi i titulluar «Viktimat e terrorizmit shqiptar në Kosovë dhe Metohi»¹.

Sipas deklaratave të Nebojša Čović-it, ish-komunist i regjimit të Milošević-it i konvertuar në “demokrat” pasi u dëbua nga rrethi i Slobodan Milošević-it, qëllimi i këtij botimi dhe i botimeve që do të publikohen në emër të qeverisë së re të Serbisë ishte që t'u “ofroheshin UNMIK-ut, KFOR-it dhe të gjithë të interesuarve të dhënave për strukturën e organizimit terrorist të ekstremizmit shqiptar, të dhëna për viktimat, për veprimtarinë e mafisë shqiptare në botë (...) të dhëna që do ndihmonin të përcaktoheshin standardet për trajtimin e njëjtë të terrorizmit në të gjitha hapësirat dhe të forcohej lufta kundër terrorizmit jo vetëm në rajon por edhe në tërë Evropën.”²

¹ Vlada Republike Srbije, *Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji* (Ubijena, oteta i nestalalica, januar 1998 - novembar 2001
<http://www.arhiva.srbija.gov.rs/vesti/2002-05/25/326656.html>

² Vepra e cituar, *Albanski terorizam i organizovanikriminal na Kosovo i Metohiji*

Për dallim nga “librat e bardhë” që u botuan gjatë periudhës së sundimit të Milošević-it në vitin 1998, 1999 dhe në vitin 2000, të dhënat që përmbante botimi i ri i vitit 2001, për të njëjtën periudhë kohore, janë tërësisht të ndryshme nga tri botimet e para.

Kështu, në vend të 75 civilëve të vrarë të përkatësisë etnike serbe dhe malazeze sa ishin publikuar si shifra zyrtare nëntë muaj pas përfundimit të luftës, në botimin e vitit 2001 kjo shifër u rrit në 87 persona për të njëjtën periudhë kohore. Edhe numri i civilëve shqiptarë të vrarë u rrit nga 196 në 230, ndërsa ai i pjesëtarëve të grupeve tjera etnike nga 15 persona të vrarë u rrit në 18 persona¹.

Jo vetëm mospërputhja e shifrave që i heq seriozitetin propagandimit të këtyre listave, por edhe emrat që përfshihen në një listë nuk përputhen me emrat e listës tjetër. U hoqën nga lista e civilëve serbë të vrarë Vukosava Vulošević-i dhe Slavko Škrkić-i dhe u shtuan edhe 14 emra të tjerë! E njëjta gjë u bë edhe me listën e të rrëmbyerve dhe të zhdukurve. Po përmend vetëm listën e pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë që figurojnë si të rrëmbyer ose të zhdukur. Në listën e publikuar në vitin 2000 ishin 14 policë që konsideroheshin si “të rrëmbyer ose të zhdukur” ndërsa në botimin e vitit 2001 kjo shifër u zvogëluar në 13! Përpos këtij ndryshimit, nga lista e vitit 2000 u hoqën emrat e policëve Duško Dolašević, Djordje Balošević dhe Boban Matić dhe listës së re iu shtuan tre emra të rinj: Velko Marković-i, Dragan Vučetić-i dhe Nebojša Djuritić-i!

Edhe më skandaloze janë ndryshimet lidhur me listat e pjesëtarëve të vrarë të kësaj ministrie. Në publikimin e marsit të vitit 2000, regjimi i Milošević-it publikoi emrat e 274 policëve të vrarë në “aksionet terroriste të separatistëve shqiptarë”², ndërsa në botimin e vitit 2001 ky numër u zvogëluar³ në 230!

¹ Shih tabelën në: Vlada Republike Srbije, vepra e cituar, *Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji*
<http://www.arhiva.srbija.gov.rs/vesti/2002-05/25/326656.html>

² Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f. 932-956

³ Vepra e cituar, *Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji* f.105-133

Më poshtë do të shohim nëse u “ringjallën” 44 policët që ishin shpallur të vrarë nga UÇK-ja dhe ku “humbën” emrat e policëve Duško Dolašević-it, Djordje Balošević-it dhe Boban Matić-it. Tani për tani po vazhdoj me diferencat që shfaqen në listat me emrat që pretendohet se i ka vrarë, rrëmbyer apo zhdukur UÇK-ja. Po vazhdoj me manipulimin e numrit të ushtarëve të Armatës Jugosllave të vrarë në luftë me UÇK-në.

Siç e pamë më lart, lidhur me pjesëtarët e Armatës Jugosllave që ishin vrarë nga “terroristët shqiptarë”, në botimin e vitit 2000, regjimi i Beogradit përpiqej t’i fshehë në maksimum pasojat e luftës me UÇK-në. Ata kishin deklaruar 40 ushtarëve të vrarë deri në ndërhyrjen ushtarake të NATO-s.

Në botimin e vitit 2001, Qeveria e Serbisë publikoi emrat e 351 ushtarëve të vrarë dhe 30 ushtarëve të “rrëmbyer apo të zhdukur gjatë luftimeve me terroristët shqiptarë”¹. Në sqarimin që jepet në fund të faqes së kësaj liste thuhet qartë se “në listën e këtij botimi nuk janë përfshirë pjesëtarët e Armatës Jugosllave që kanë humbur jetën nga bombardimet e NATO-s.”²

Përkundër minimizimit të numrit të ushtarëve dhe policëve serbë të vrarë nga UÇK-ja, ata pranojnë, varësisht nga botimi, se janë vrarë rreth 600-700 pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Armatës Jugosllave. Është interesant të theksohet se në asnjë botim të “librave të bardhë” nuk u publikua emri i asnjë të vrari, të plagosuri, të rrëmbyeri apo të zhdukuri që ka qenë pjesëtar i grupeve paramilitare që “operonin me veshje civile”!

Mospublikimi i të dhënave për këtë kategori kriminelësh është domethënëse sepse hap shtegun e ndriçimit të faktit se, ndryshe nga botimet që u bënë në emër të qeverisë së Serbisë gjatë regjimit të Milošević-it, Qeveria e re e Serbisë publikoi edhe listën

¹ Po aty, lista e ushtarëve të vrarë në f. 65-104 ndërsa lista e ushtarëve të rrëmbyer ose të zhdukur f.253-256

² Vlada Republike Srbije, vepra e cituar, *Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji*, f.65

e 709 serbëve dhe malazezve të vrarë dhe 1002 civilëve të zhdukur nga 11 qershori i vitit 1999 deri më 1 nëntor 2001¹!

Propagandën për vrasjet, rrëmbimet dhe zhdukjet e civilëve serbë, malazez, shqiptarë dhe të grupeve tjera etnike pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova dhe vendosjes së KFOR-it do ta trajtoj më poshtë. Tani të shohim listën e civilëve që pretendohet se ishin vrarë nga UÇK-ja deri më datën 10 qershor 1999.

Siç e pamë, nga një botim në tjetrin të dhënat ndryshonin. Numri i të vrarëve u rrit në krahasim me botimin e vitit 1999. Nga 32 civilë serbë dhe malazez si të vrarë nga UÇK-ja gjatë periudhës 1995-1998, që ishin publikuar në botimin e vitit 1999, në fund të luftës numri i tyre kishte arritur në 75 të vrarë² në botimin e viti 2000 dhe 87 në atë të vitit 2001; nga 65 civilë shqiptarë të vrarë, të cilët cilësohen në këto libra si “besnikë ndaj regjimit të Beogradit”³, numri i tyre arriti në 196 persona ndërsa në botimin e 2001 ky numër u rrit në 230. Sidhe nga 8 civilë të vrarë, pjesëtarë të grupeve tjera etnike, numri kishte arritur në 15 persona⁴ dhe në fund, në vitin 2001, ky numër arriti në 18 persona! Flas për të dhënat që u referohen të njëjtës periudhë!

Krahas emrave të 286 civilëve të vrarë nga të gjitha grupet etnike në Kosovë, në faqet 925-927 të botimit të vitit 2000 përmenden “vendet ku janë gjetur 100 civilë të vrarë, identiteti i të cilëve nuk ishte zbuluar por dihej vetëm se janë vrarë nga terroristët shqiptarë!”⁵

Nuk do të ndalem te propaganda serbe që përmend vendet ku ishin gjetur “100 civilë të vrarë, të pidentifikuar” por, që e dinin se “ishin vrarë nga UÇK-ja”. Shpresoj se në fund të këtij kapitulli lexuesi do ta kuptojë se kush i ka vrarë ata! Tani, po ndalem vetëm në emrat që përmendin, sepse manipulimi me emra

¹ Shih tabelën në: Vlada Republike Srbije, vepra e cituar, *Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji*

² Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f. 904-909

³ Po aty, f. 909-923

⁴ Po aty, f. 923-924

⁵ Po aty, f.925

është treguar më i suksesshmi në përhapjen e gënjeshtres se gjoja civilët e përmendur në këto lista ishin vrarë nga UÇK-ja.

Cili nga lexuesit e huaj e di se kush janë Ivan Radević-i, Ivan Obradović-i, Dragan Trifović-i Vukota Gvozdenović-i, Svetislav Ristić-i dhe Zoran Stanojević-i që janë të renditur në numrat rendorë 36-41 në listën e civilëve serbë¹ që pretendohet se janë vrarë nga UÇK-ja? Jam i bindur se edhe ata që e kanë lexuar Kapitullin e Dytë të Pjesës së Parë të librit tim i kanë harruar emrat e gjashtë të rinjve serbë dhe malazez, të vrarë nga Shërbimi Sekret Serb në Kafenenë «Panda» në Pejë.

Ndriçimi i vrasjes së këtyre gjashtë të rinjve, vrasje që ishte bërë me urdhër të Shërbimit Sekret Serb është vetëm një pjesë e vogël e asaj që kishte bërë «eskadroni i vdekjes» me qëllim që “UÇK-ja të paraqitej në sytë e bashkësisë ndërkombëtare si një organizatë terroriste dhe t’u jepej zjarr ndjenjave antishqiptare në Kosovë dhe në tërë Serbinë.”²

Megjithatë, zbulimi i këtij rasti u bë falë gatishmërisë së ish-shefit të Shërbimit Sekret Serb, Radomir Marković-it, që t’i ndriçojë vrasjet e kryera nga ky shërbim me shpresë se do të përfitojë në uljen e dënimit prej 40 vjet burg. Por, refuzimi i autoriteteve serbe që t’ia ulin dënimin Radomir Marković-it ndikoi që ky kriminel, “në kërkesën për falje të dënimit që ia drejtoi Kryetarit të Serbisë, Tomislav Nikolić-it, të kërcënojë se **do ta rrëzojë Serbinë në gjunjë nëse publikon listën e krimeve të bëra kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë.**”³

Është interesant të përmendet se pikërisht në kohën kur personalitete nga strukturat më të larta politike dhe shtetërore të Serbisë dhe intelektualë serbë të fushave të ndryshme denoncojnë krimet kundër civilëve serbë dhe shqiptarë në Kosovë, të cilat regjimi i Milošević-it i kishte kryer në funksion të stigmatizimit të UÇK-së; në kohën kur dëshmitarë serbë, pjesëmarrës të drejt-

¹ Po aty, f.906

² Kurir, artikulli i cituar, «Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu!»

³ Shkrimi i cituar i gazetës Kurir, «Rade Marković dao nalog ... »

përdrejtë në këto tragjedi, dëshmojnë se kush kishte dhënë urdhër për këto krimet mizore; në kohën kur Shefi i Shërbimit Sekret Serb deklaroi se “nëse e publikon listën e krimeve të bëra kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, Serbia do të rrëzohet në gjunjë”, në këtë kohë, të gjithë ata që ishin angazhuar në kumbarinë e nocioneve të sajuara nga Shërbimi Sekret Serb vazhdojnë të trumbetojnë se këto krime janë kryer nga UÇK-ja! Sado paradoksale t’i duket dikujt, një pohim i tillë është plotësisht logjik në përputhje me verbërimin e tyre ideologjik!

Çështja e zhdukjes së kufomave që u përdor në kuadër të strategjisë së zhdukjes së gjurmëve të krimit krijoi trauma më të mëdha për familjarët e atyre që u futën në kategorinë e «të zhdukurve».

Në kapitujt paraprakë u trajtua gjerësisht kjo strategji dhe u hodh dritë mbi motivet e atyre që mohonin vërtetësinë e saj. Është neveritëse kur sheh se përkundër fakteve të panumërta që dolën në dritë për vrasjen dhe zhdukjen e gjurmëve të civilëve shqiptarë të vrarë në kuadër të politikës së gjenocidit në Kosovë, ka ende persona që vazhdojnë ta mohojë apo minimizojnë këtë realitet të dhimbshëm; përkundër fakteve se shumë nga pjesëmarrësit në këto krime kanë dëshmuar për tmerret që përjetuan shqiptarët, madje Shefi i Resorit për Siguri Publike në MPB të RS-së, gjenerali Vlastimir Đorđević-i, i cili për krimet e kryera ndaj shqiptarëve të Kosovës u dënua nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë me 27 vjet burg, u kërkoi falje publike shqiptarëve për krimet që ishin bërë ndaj tyre dhe për faktin se nuk i ishte kundërvënë strategjisë së fshehjes së krimit¹, kumbarët e përmendur gjatë tërë librit tim këmbëngulin se “zhdukja e kufomave ishte gënjeshtër natoiste”!

Është neveritëse kur sheh se pikërisht në kohën kur edhe vetë serbët filluan t’i ndriçonin krimet e kryera nga regjimi i Milo-

¹ Shih më gjerësisht: Kurir, « Priznao krivicu: Vlastimir Đorđević se izvinio žrtvama na Kosovu », (Pranoi fajin: Vlastimir Đorđević u kërkoi falje viktimave nga Kosova)

<http://www.kurir-info.rs/priznao-krivicu-vlastimir-dordevic-se-izvinio-zrtvama-na-kosovu-clanak-787765>

šević-it, Dick Marty, përmes raportit të lartpërmendur, u shndërrua në «kumbarën më të rrezikshëm» nga të gjithë ata që ishin angazhuar në funksion të kumbarisë së nocioneve që stigmatizonin UÇK-në si përgjegjëse e këtyre krimeve. Ai i ngriti në akuzë shpifjet që kishte përgatitur Shërbimi Sekret Serb kundër udhëheqësve të UÇK-së.

Krahas të gjitha shpifjeve kundër UÇK-së që ngërthen në vete ky raport, që ishin objekt i analizës në kapitullin paraprak, Dick Marty bën edhe një shpifje të rëndë lidhur me personat që u zhdukën gjatë luftës së Kosovës.

Në paragrafin e 12 të Raportit të tij, Dick Marty e paraqet çështjen e të zhdukurve si çështje më urgjente humanitare. Mirëpo, përmbajtja e këtij paragrafi nxjerr në shesh se Dick Marty nuk brengoset aq shumë për “humanizëm”, por këtë çështje e përmend për të manipuluar.

Ai përmend se “nga 6005 dosjet e hapura nga Kryqi i Kuq për persona të zhdukur, përafërsisht 1400 persona janë gjetur të gjallë dhe 2500 trupa të tjerë janë gjetur dhe identifikuar. Shumica e mbetjeve mortore janë identifikuar si shqiptarë kosovarë.”¹

Manipulimet lidhur me numrin e të vrarëve dhe të atyre që konsideroheshin të zhdukur i trajtova gjerësisht në kapitullin për gjenocidin në Kosovë. Dick Marty i kthehet kësaj çështje në një formë të re! Ai nuk e mohon se “shumica e mbetjeve mortore janë shqiptar kosovar”! Por, përmes formës së papërcaktuar të fjalës “shumica”, Dick Marty përpiqet të krijojë përshtypjen se numri i “të tjerëve” është i madh!

Jo vetëm për numrin e atyre që ishin identifikuar si të vrarë, por, edhe “për fatin e 1869 personave të zhdukur gjatë konfliktit”, për të cilët nuk dihej asgjë deri në kohën kur e shkroi raportin, Dick Marty përpiqet të manipulojë. Ai thotë se “dy të tretat e këtij numri janë me origjinë shqiptare.”² Pra, 1/3 e këtij numri, që përbën një shifër rreth 600 persona, nënkuptohet të kenë qenë serbë dhe pjesëtarë të grupeve tjera etnike!

¹ Raporti i Dick Marty-t, paragrafi 12

² Po aty, i njëjti paragraf

Por, publikimi i shifrave përfundimtare nga Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë përmes «Librit të Bardhë» të vitit 2000, dhe shifrat zyrtare për 100 civilë serbë të zhdukur dhe për 12 pjesëtarë të grupeve tjera etnike, apo shifrat e publikuara nga Qeveria e Serbisë në vitin 2001, për 155 serbë dhe malazez të zhdukur, e zhvesh më së miri manipulimin me statistika që përpiqet të bëjë Dick Marty!

Dick Marty, që aq shumë i pëlqen të përmendë se bazohet në publikimet e shërbimeve inteligjente të shteteve të ndryshme, që nuk lë rast pa falënderuar autoritetet e Serbisë, këtë herë i la në heshtje shifrat e Shërbimit Sekret Serb që ishin publikuar në emër të qeverisë së Serbisë. Në këtë rast ai preferon të “bazohet në pohimet e Kryqit të Kuq dhe Zyrës për persona të zhdukur dhe forenzikë!

Propaganda e autoriteteve të reja serbe për personat e vrarë dhe të zhdukur pas vendosjes së trupave të KFOR-it në Kosovë gjeti një vend të rëndësishëm në raportin e Dick Marty-t.

Përkundër asaj se është i shtrënguar të pranojë se burimi ku ai mbështetet, Zyra për persona të zhdukur dhe forenzikë, ka rezerva¹ ndaj pohimeve për të zhdukurit pas datës 12 qershor 1999, Dick Marty ngul këmbë se “470 persona, prej të cilëve 95 janë shqiptarë ndërsa 375 jo-shqiptarë, shumica serbë, janë zhdukur pas kësaj date.”²

Madje, edhe për statistikat e shqiptarëve që ishin zhdukur gjatë luftës Dick Marty “zbulon” se shumë prej tyre “ishin zhdukur nga UÇK-ja pas përfundimit të luftës!”

Për të “argumentuar” një qëndrim të tillë, në paragrafin 13 të raportit të tij, Dick Marty deklaroi se “kur flitet për të zhdukurit, është me rëndësi të theksohet se shumë familje të shqiptarëve kosovarë që kanë humbur ndonjë të afërm të tyre pas 12 qershorit të vitit 1999, kanë deklaruar një datë më të hershme të zhdukjes, nga frika se të dashurit e tyre mund të konsideroheshin si ‘tradhtarë’, të ndëshkuar nga UÇK-ja.” Krahas frikës që u atribuon

¹ Po aty, shënimi 10 në fund të faqes

² Po aty, paragrafi 12

familjarëve të personave të zhdukur, Dick Marty nuk e lë pa përmendur edhe “përfitimin material” në këtë rast. Sipas “zbulimit” të tij, “ligji kosovar për dëmshpërblimin e familjeve të ‘dëshmorëve’ nuk i përfshin personat e vdekur pas ardhjes së KFOR-it në Kosovë”¹ dhe familjarët e personave të zhdukur i fshehin vrasësit e vërtetë për qëllime përfitimi material!

Fyerjeve të rënda që kishte bërë Xavier Raufer-i duke shpifur se gjoja “shqiptarët bëjnë show me kufomat e të vrarëve, shesin fëmijët e tyre për prostitucion, bëjnë biznes me fëmijët e tyre, rrëmbejnë kushërirat e veta për t’i “punësuar” si prostituta vetëm e vetëm për të fituar 1 frangë nga zero franga”², Dick Marty ua shton “fshehjen e vrasësve të familjarëve të tyre për të përfituar materialisht”! Një ide perverse e këtyre përmasave bëhet jo pse Dick Marty nuk i njeh shqiptarët, por, me qëllim që të shfajësohej Serbia për krimet e kryera në Kosovë dhe të stigmatizoheshin sidomos ata udhëheqës të UÇK-së “që ishte ngritur në pushtet falë mbështetjes së SHBA-ve dhe fuqive tjera përëndimore.”³

Arroganca e Dick Marty-t shkon edhe më larg se kaq. Për të fshehur kriminelët e vërtetë dhe për t’ia veshur këto krime UÇK-së ai mundohet t’i paraqesë si realitet i pakontestueshëm! Madje, që të zhvendosë vëmendjen, Dick Marty akuzon autoritetet e Kosovës dhe të Shqipërisë për “mungesë bashkëpunimi në ndriçimin e fatit të serbëve të zhdukur, madje edhe kosovarëve shqiptarë që besohet se janë viktimat e krimeve të kryera nga anëtarët e UÇK-së.”⁴ Refuzimi i autoriteteve shqiptare dhe atyre të Kosovës që të pranojnë gënjeshtren e lartpërmendur për realitet, te Dick Marty “ngjall dyshime serioze sa i përket vullnetit politik për të zbuluar të vërtetën e plotë rreth këtyre ngjarjeve.”⁵

¹ Po aty, paragrafi 13

² Temë e trajtuar në Kapitullin e shtatë

³ Raporti i Dick Marty-t, ndër të tjera edhe paragrafi 60

⁴ Po aty, paragrafi 14

⁵ Po aty

E vërteta e plotë për këto ngjarje!

Cilën “të vërtetë të plotë” dëshiron të zbulojë Dick Marty? Për mungesën e cilit vullnet politik shpreh ai dyshime? E vërteta e plotë rreth këtyre ngjarjeve dihet: vrasja e civilëve në Kosovë ishte bërë me urdhër të Shtabit Strategjik të Slobodan Milošević-it për të stigmatizuar UÇK-në. Vetëm ata që janë të interesuar ta mbajnë gjallë propagandën e Milošević-it mundohen ta lënë në heshtje faktin se shumica e rasteve që figurojnë në listën zyrtare serbe u ndriçuan se ishin kryer nga «eskadroni i vdekjes» që komandohej nga Shefi i Shërbimit Sekret Serb.

Sikur t’i kishte interesuar e “vërteta e plotë”, Dick Marty do të interesohej, për shembull, të dinte se ku mbetën 44 policët të cilët figuronin në listën e 274 policëve të vrarë nga UÇK-ja në botimin zyrtar të Qeverisë së Serbisë, në vitin 2000. A u “ringjallën” sepse në listën e vitit 2001 nuk figuronin në listën e policëve të vrarë? Apo pse u hoqën emrat e Duško Dolašević-it, Djordje Balošević-it dhe Boban Matić-it nga “lista e policëve të rrëmbyer dhe të zhdukur”?

Sikur të kishte qenë i interesuar, Dick Marty do të kishte zbuluar me lehtësi të madhe se policët e vrarë që ishin hequr nga lista e të vrarëve nuk ishin “ringjallur”, por ishin “transferuar” në listën e CIVILËVE të vrarë apo të zhdukur nga UÇK-ja!

Përsëri po i kërkoj falje lexuesit që po e rëndoju analizën me detaje rreth këtyre listave. Por, përmes këtyre “detajeve” është munduar të fshihet “puna e drejtë”, siç do të thoshte Carla Del Ponte!

Sikur t’u kishte hedhur një sy të vëmendshëm listave, Dick Marty do të kishte zbuluar se:

- **Milan Jovanović-i**, i cili në botimin e vitit 2000 figuron në listën¹ e policëve të vrarë, në numrin rendor 5, në botimin e vitit 2001 figuron në listën e civilëve të

¹ Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f.932

rrëmbyer pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë. Dhe ky person figuron si i rrëmbyer dy herë. Në numrin rendor 334 ai u rrëmbye më 18 qershor 1999 në fshatin Babush të Ferizajt, ndërsa në numrin rendor 335, i njëjti person u rrëmbye më 22 qershor 1999 në Ferizaj!¹

- Polici **Srečko Majanović**-i, sipas botimit të vitit 2000, numër rendor 48, f. 936, u plagos më 1 gusht 1998, u transferua në Akademinë Spitalore Ushtarake në Beograd, ku vdiq më 4 gusht 1998. Në botimin e vitit 2001, ai figuron në listën e civilëve të vrarë me numër rendor 44. f. 26;
- Polici **Zoran Vasiljević**-i, i cili në botimin e vitit 2000 figuron në listën² e policëve të vrarë, në numrin rendor 81, në botimin e vitit 2001 figuron në numrin rendor 84, faqe 266, në listën e civilëve të rrëmbyer apo të zhdukur “pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”;
- Polici **Srdjan Stojković**-i, i cili në botimin e vitit 2000 figuron në listën³ e policëve të vrarë, në numrin rendor 269, faqe 955, në botimin e vitit 2001 figuron në numrin rendor 872, faqe 338, në listën e civilëve të rrëmbyer apo të zhdukur “pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”;
- Polici **Predrag Mitić**-i, sipas botimit të vitit 2000, i vrarë më 15 maj 1999, në numër rendor 234, në botimin e vitit 2001, në numrin rendor 353, f. 170, shpallet si civil i vrarë në një “datë të papërcaktuar, pas ardhjes së forcave të KFOR-it në Kosovë”!
- Polici **Djordje Ristić**-i, në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 235, shpallet i vrarë më 15 maj 1999, ndërsa në botimin e vitit 2001, në numrin rendor 493, f. 183, ky person figuron në listën e civilëve të vrarë, “në një datë që nuk dihet, pas vendosjes së KFOR-it në Kosovë”;

¹ Vepra e cituar, Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji, f. 289

² Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f.932

³ Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija, f.932

- Polici **Vasilije Stanković**-i, në botimin e vitit 2000, në numrin rendor 233, shpallet i vrarë më 15 maj 1999, ndërsa në botimin e vitit 2001, në numrin rendor 562, f. 189, figuron në listën e civilëve të vrarë, “në një datë që nuk dihet, pas vendosjes së KFOR-it në Kosovë”;

Mund të vazhdoj me fatin e policëve **Sladjan Milosavljević**-it, **Predrag Milosavljević**-it, **Ljubiša Mitrović**-it, **Nebojsa Jeftić**-it, **Dragan Stanković**-it dhe shumë policëve tjerë të vrarë që ishin hequr nga lista e punonjësve të vrarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe që ishin “transferuar” në listën e civilëve të vrarë apo të zhdukur nga UÇK-ja.

Mund të sjell hollësira për fatin e policëve që në botimin e vitit 2000 figuronin në listën e policëve të rrëmbyer ose të zhdukur dhe të cilët, në botimin e vitit 2001, u “transferuan” në listën e civilëve të vrarë pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë: Djordje Balošević-i në numrin rendor 13, faqe 220, Duško Dolašević-i, numrin rendor 49, faqe 225, ndërsa Boban Matić-i figuron në numrin rendor 94, faqe 231. Përfundimi është i njëjtë: manipulim me listat për të manipuluar me opinionin publik.

“Transferimi” i emrave të policëve të vrarë dhe të atyre që konsideroheshin të zhdukur nga lista e policëve të vrarë dhe të zhdukurve në listën e civilëve të vrarë përbën vetëm një pjesë të realitetit të këtyre listave. Sa është numri i policëve që erdhën nga të gjitha qytetet e Serbisë për të luftuar në Kosovë, që u vranë në luftë me UÇK-në dhe emrat e tyre nuk u publikuan asnjëherë? Sa prej tyre u regjistruan në listën e civilëve të vrarë apo të zhdukur?

Çka mund të thuhet për autoritetet qeveritare të Serbisë të cilat nuk nguruan që emrat e policëve të publikuar si policë të vrarë t’i “transferojnë” në kategorinë e “civilëve të vrarë”. Kur nuk nguruan ta bëjnë një gjë të tillë, lexuesi mund të imagjinojë se çka u bë me ata policë të vrarë, emrat e të cilëve nuk ishin publikuar më parë!

Sa është numri i vërtetë i ushtarëve të Armatës Jugosllave që u vranë në Kosovë e që regjimi i Milošević-it i fshehu për t’ua veshur vrasjen e tyre NATO-s? Dallimi i numrit të ushtarëve të

vrarë, emrat e të cilëve u publikuan në dy botimet zyrtare të Qeverisë së Serbisë, botimi i vitit 2001 në krahasim me atë të vitit 2000, është 341 ushtarë të vrarë më tepër!

Sikur t'i kishte lexuar listat e publikuara të civilëve të vrarë, të rrëmbyer apo të zhdukur, Dick Marty do të kishte kuptuar se diçka nuk është në rregull që autoritetet më të larta shtetërore të publikojnë dosje me të dhëna jo të plota për qytetarët e vet! Së paku do të kishte shtruar pyetjen se kush qëndron prapa personit në numrin rendor 31 në listën e të vrarëve pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë. Në këtë numër rendor publikohet vetëm mbiemri (Bjelić) ndërsa emri nuk i dihet!¹ Dihet vetëm se është nga Vojvodina dhe se është vrarë me 13 qershor 1999. Për ata që nuk e dinë po përmend faktin se Vojvodina është rreth 400 km në veri të Kosovës dhe në kufirin e Serbisë me Hungarinë dhe Kroacinë! Çfarë ka lypur ky farë Bjelić-i në Kosovë, një ditë pas përfundimit të luftës? A ka pasur anëtarë të familjes që do ta shpallnin zhdukjen e tij dhe së paku t'u tregonin autoriteteve serbe emrin e saktë të tij. Në këtë mënyrë do ta shpëtonin shtetin serb të mos dukej qesharak që dy vjet e gjysmë pas datës kur pretendohet se ishte zhdukur ky person, ende nuk e paskan mësuar emrin e tij!

Kush qëndron pas numrave rendorë 34-35 ku sillet vetëm e dhëna se janë “bashkëshortët Bogdanović”?

E në numrin rendor 46? Një i vrarë për të cilin nuk e dinë as nga cili vend është, as moshën e as emrin. Jepet vetëm mbiemri i tij (Bukumirović) dhe thuhet se “është vrarë së bashku me policin Milorad Bulatović-in.”² Kujtdo që i lexon të dhënat për këtë “civil” të vrarë do t'i shkonte ndër mend të verifikonte nëse jepen të dhëna plotësuese në rastin kur sqarohet vrasja e policit Milorad Bulatović-it. Por, më kot! Nuk ka asnjë të dhënë plotësuese sepse Milorad Bulatović-it nuk figuron në listën e publikuar të policëve të vrarë. Edhe ky polic i vrarë figuron vetëm në listën e civilë të vrarë!

¹ Vepra e cituar, *Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji*, f.141

² Po aty, f. 142

E njëjta gjë edhe për Vujinović-i që figuron në numrin rendor 73: emri nuk i dihet¹! Vučić-i, numër rendor 92, emri nuk i dihet²! Zlatković³, pa emra! Jovanović⁴, pa emër! Kizić⁵, pa emër! Marušić⁶, pa emër! Pešić⁷, pa emër! Rajčić⁸, pa emër! Stojanović⁹, pa emër! Dhe shumë persona tjerë pa emra. Boško¹⁰, pa mbiemër! Živko¹¹, pa mbiemër! Zoran¹², pa mbiemër! Ivica¹³, emri i babës Velimir, por asnjërit nuk i dihet mbiemri! Ilija¹⁴, pa mbiemër! Stoja¹⁵, pa mbiemër!...

Në numrat 703-709 janë shtatë persona të cilëve nuk u publikohet as emri e as mbiemri!

U mungojnë emrat, u mungojnë mbiemrat, u mungojnë emrat dhe mbiemrat e megjithatë shpallen si civilë të vrarë nga UÇK-ja pas vendosjes së forcave të KFOR-it në Kosovë!

E njëjta gjë përsëritet edhe në listën e personave të rrëmbyer dhe të zhdukur pas vendosjes së KFOR-it në Kosovë: persona pa emra, persona pa mbiemra, persona pa emra e pa mbiemra por që pretendohet të jenë rrëmbyer apo zhdukur nga UÇK-ja!

Gjatë tërë luftës në Kosovë pushteti i Beogradit në asnjë rast nuk e pranonte se njësitë kriminale të njohura me emrat «Škorpion», «Šakali», «Tigrovi», «Žute ose», «Knindže», «Crvene beretke» e të tjera ishin nën kontrollin e pushtetit. Një pjesë e krimeve më të tmerrshme u bënë nga këto njësi që cilësoheshin si njësi “paramilitare”.

¹ Po aty, f.145

² Po aty, f.147

³ Po aty, f.156

⁴ Po aty, f.161

⁵ Po aty, f. 162

⁶ Po aty, f.167

⁷ Po aty, f. 179

⁸ Po aty, f.182

⁹ Po aty, f.193

¹⁰ Po aty, f.201

¹¹ Po aty, f.202

¹² Po aty, f.202

¹³ Po aty, f.202

¹⁴ Po aty, f.202

¹⁵ Po aty, f.202

Do t'i isha lutur lexuesit që ka mundësi të konsultojë internetin që të ndalen dhe të shohin një video të shkurtër prej 1 minute e 20 sekondash për të parë bashkëveprimin e forcave qeveritare dhe të atyre "paramilitare" në shkatërrimin e Kosovës! Video (<http://www.youtube.com/watch?v=k7gEMEnpooE>) e sugjeroj jo për të bindur dikë se këto njësi bashkëvepronin dhe ishin nën drejtimin e shtetit serb. Për këtë çështje kam sjellë argumente të mjaftueshme në kapitullin për gjenocidin. Kjo video sjell pamje ku pjesëtarët e agresorëve serbë, me uniforma dhe pa uniforma plaçkitin dhe djegin fshatra shqiptarë!

Në kontekstin që po trajtoj, dëshiroj të tërheq vëmendjen se shteti që nuk pranonte se i kishte nën kontroll këto njësi "paramilitare" nuk publikonte as pasojat që kanë patur këto njësi kur janë përballur me UÇK-në. Për këtë arsye, në botimet zyrtare të qeverisë serbe, kategoria e "paramilitarëve të vrarë, të rrëmbyer apo të zhdukur" nuk ekziston. Por, një pyetje shtrohet lidhur me ta: në cilën listë u renditën "paramilitarët" e vrarë apo të zhdukur gjatë luftës në Kosovë?

Sa prej personave të lartpërmendur që nuk u dihej emri apo mbiemri, ose të atyre që nuk u dihej as emri e as mbiemri ishin "paramilitarë" të vrarë me "veshje civile"? Sa prej atyre që figurojnë në listën e të zhdukurve ishin "paramilitarë"? Apo kush fshihet prapa emrave Dika, Daniela, Dejan, Ilia, Momo, Slaviša dhe Slobodan që figurojnë në faqen 349, të cilëve nuk u dihet mbiemri, por që janë zhdukur nga UÇK-ja?

Përderisa "paramilitarët" nuk mund të figuronin as në listën e pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë e as në listën e Armatës Jugosllave, atëherë e vetmja kategori që mbetet ku mund të sistematizoheshin humbjet e "paramilitarëve serbë" ishin "listat e civilëve të vrarë, të rrëmbyer apo të zhdukur nga UÇK-ja"!

Mospublikimi i plotë i të gjitha emrave të policëve dhe ushtarëve të vrarë gjatë luftës me UÇK-në, "transferimi" i policëve të vrarë nga lista e pjesëtarëve të vrarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në listën e civilëve të vrarë pas vendosjes së forcave të

KFOR-it në Kosovë dhe mungesa e humbjeve të “paramilitarëve” mundësojnë ndriçimin e shifrave të publikuara nga Qeveria e re e Serbisë për 709 “civilë” të vrarë dhe 1002 “civilë” të rrëmbyer apo të zhdukur pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së KFOR-it në Kosovë.¹



“Paramilitarë” të armatosur, në tesha civile, së bashku me policë, pranë tre civilëve shqiptarë të ekzekutuar në Fushë Kosovë

Mund të vazhdoj edhe me rastet tjera të manipulimit por, thelbi mbetet i njëjtë: prezantimi i vrasjeve të pjesëtarëve të forcave policore, ushtarake “paramilitare” dhe të aparateve tjera të dhunës shtetërore serbe si “viktima civile”. Por, do të mjaftohem edhe me një rast të fundit të kësaj natyre.

Më 6 nëntor 1998, mediat serbe njoftuan se në këtë ditë, në orën 11, në fshatin Dubravë të Komunës së Rahovecit, “në territorin e kontrolluar nga terroristët e UÇK-së ishin zhdukur dy serbë: Ilija Vujošević-i dhe Dejan Djetlov-i.² Më 9 nëntor u publikuan fotografitë e tyre të vrarë!

¹ Vepra e cituar, Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji, Shih tabelën në: <http://www.arhiva.srbija.gov.rs/vesti/2002-05/25/326656.html>

² Vepra e cituar, Злочини албанских терориста 1995-1998, Приштина, Јанар 1999, f. 174-177



*Policët serbë Ilija Vujošević-i dhe Dejan Djetlov-i të vrarë
në “veshje civile”*

Pas spekulimeve të shumta që i bënë mediat serbe publikimit të fotografive të dy serbëve të vrarë, në veshje civile, në botimin e janarit të vitit 1999, në atë të vitit 2000 dhe atë të vitit 2001, Shërbimi Sekret Serb pranon se fjala ishte për “dy punonjës të Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Prishtinës, të cilët ishin vrarë në detyrë ‘humanitare’. Ata kishin qenë duke furnizuar me ushqim njësitë e forcave policore që luftonin me terroristët shqiptarë.”¹

Nuk mund ta di se sa vetë e kanë lexuar njoftimin e mëvonshëm që nuk bëhej fjalë për civilë të vrarë por për pjesëtarë të forcave policore të Stacionit Policor të Prishtinës, të vrarë në Komunën e Rahovecit rreth 60 km larg nga vendi i punës. Ajo që është e sigurt ka të bëjë me faktin e pamohueshëm që shpërndarja e këtyre fotove në mediat serbe, e shoqëruar me propagandën

¹ *Злочини албанских терориста 1995-1998*, f. 174-175 dhe Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f.559

tjetër, ka pasur efekte të mëdha në krijimin e opinionit se “UÇK-ja vriste civilë”.

Krahas manipulimit me listat e pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pjesëtarëve të Armatës Jugosllave, të “paramilitarëve” dhe të civilëve të përkatësisë etnike serbe, malazeze dhe të grupeve të tjera etnike, nuk mungoi as manipulimi i qeverisë serbe me civilët e vrarë shqiptarë.

Shembujt e lartpërmendur janë argumente të mjaftueshme për të nxjerrë në dritë faktin se politika e regjimit të Milošević-it dhe e pasardhësve të tij ndryshojnë kohën dhe datat e vrasjeve të policëve, ushtarëve dhe “paramilitarëve” serbë dhe i transferojnë në listat e civilëve të vrarë pas përfundimit të luftës.

Këtë praktikë manipulimi, të aplikuar nga regjimi i Milošević-it, Dick Marty përpiqet t’ua veshë shqiptarëve të Kosovës. Pa u mbështetur në asnjë provë, me paturpësinë më të rëndë shpif se gjoja shqiptarët i fshehin vrasësit e familjarëve të tyre për të përfituar materialisht duke i deklaruar se janë vrarë gjatë luftës!

Të shohim listën e civilëve shqiptarë të vrarë, vrasjen e të cilëve regjimi i Milošević-it, pasardhësit e Milošević-it dhe kumbarët e sajimeve të këtyre regjimeve ia atribuojnë “terroristëve të UÇK-së”.

Po filloj me rastin e vrasjes së Fehmi Aganit.

Për ata që nuk e njohin këtë personalitet të shquar të fushës intelektuale dhe të skenës politike të Kosovës, po i informoj se Fehmi Agani ishte profesor i Universitetit të Prishtinës dhe njëri nga sociologët më të shquar të ish-Federatës Jugosllave. Pas braktisjes së sistemit njëpartiak në Jugosllavi, ai, së bashku me Ibrahim Rugovën, u angazhua në themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) dhe që nga themelimi i saj ishte nënkryetar i kësaj partie politike. Krahas angazhimeve në skenën politike të Kosovës, ai u shqua edhe në mbrojtjen e interesave të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Përveç kësaj, vlen të theksohet se, që nga negociatat e para që u zhvilluan në fillim të viteve nëntëdhjetë mes Kosovës dhe Serbisë për gjetjen e një zgjidhjeje

politike, e deri në Konferencën e Rambujesë, Fehmi Agani përfaqësonte delegacionin shqiptar të Kosovës.

Edhe pse e vërteta e plotë për vrasjen e tij dihet prej kohësh, propaganda e mbeturinave të regjimit të Milošević-it dhe ata që janë angazhuar në kumbarinë e sajimeve të Shërbimit Sekret Serb, vazhdojnë t'ia atribuojnë këtë vrasje “terroristëve të UÇK-së”.

Të gjithë ata që kanë dashur ta dinë të vërtetën e plotë rreth këtij rasti, kanë pasur mundësi të mësojnë se Fehmi Agani u arrestua nga policia serbe më 6 maj 1999, në prani të familjarëve të tij dhe shumë qytetarëve të tjerë. Me qëllim që kjo vrasje të mos paraqitej si vrasje e përgatitur nga strukturat e larta shtetërore, menjëherë pas vrasjes së Fehmi Aganit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, që ende kontrollohej nga regjimi i Milošević-it, ngriti kallëzim penal kundër policëve serbë Predrag Nikolić-it dhe Zoran Dzeletović-it.

Ndriçimi i këtij rasti iu besua gjykatëses hetuese Danica Marinković-it, të cilën lexuesi e njeh nga rastet e shumta që ju besuan më parë. Ishte e njëjta gjykatëse që u implikua në montimin e procesit gjyqësor kundër vëllezërve Mazreku; e njëjta gjykatëse të cilës i ishte besuar të “ndriçonte” se në Reçak “nuk ishin vrarë civilë shqiptarë”, por, gjoja ushtarë të UÇK-së¹; e njëjta gjykatëse të cilës iu besuan shumë lëndë kur duhet të dëshmohej se thëniet e zyrtarëve të Beogradit ishin të “vërteta”!

Si edhe në rastet tjera, qëndrimi i Danica Marinković-it ishte i njëjtë: faji ishte i shqiptarëve! Kjo gjykatëse i liroi policët serbë, Predrag Nikolić-in dhe Zoran Dzeletović-in, me arsyetimin se “e kishin kryer punën e tyre ndershmërisht.”²

Se sa “ndershmërisht” e kishin kryer punën e tyre policët serbë, dëshmon humanistja e njohur serbe, Nataša Kandić-i. Në shkrimin e titulluar «E vërteta shqetësuese»³ ajo tregoi se “të njëjtën ditë kur kishin vrarë Fehmi Aganin, më 6 maj 1999, në hekurudhën Lipjan-Fushë Kosovë, të njëjtët policë i vranë edhe

¹ Temë e trajtuar në Kapitullin e Tretë të Pjesës së Parë.

² Nataša Kandić, artikulli i cituar, «Uznemiravajuca istina»

³ Shkrimi i cituar më lartë

pesë anëtarë të familjes Blakqori: Miradijen (50 vjeç), Fehmiun (60 vjeç) Labinotin (14 vjeç), Mehmetin (56 vjeç) dhe gruan e tij, Sabilen (50 vjeç). Edhe për këto vrasje u ngrit kallëzim penal kundër Predrag Nikolić-it, Zoran Dzeletović-it dhe një polici tjetër të stacionit policor të Fushë Kosovës. Pastaj i tërë dokumentacioni u bart në Serbi ose u asgjësua.”¹

Meqë policët serbë i “kishin kryer ndershëmrisht” vrasjet dhe gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i, e kishte “ndriçuar ndershëmrisht” këtë krim, zyrtarët e lartë të Shërbimit Sekret Serb, në botimin e vitit 2003 të «Librit të Bardhë»², në faqen 22, ia atribuojnë UÇK-së vrasjen e Fehmi Aganit!

Cilën “të vërtetë të plotë” dëshirojnë të “zbulojnë” Dick Marty dhe të gjithë ata që u angazhuan në kumbarinë e sajimeve të Shërbimit Sekret Serb? Të vërtetën e Danica Marinković-it apo faktin se dorasit e këtij krimi të shëmtuar janë policët serbë: Predrag Nikolić-i dhe Zoran Dzeletović-i, të cilët nuk bënë asnjë ditë burg për krimet e kryera?

Realisht Dick Marty-t dhe bashkëmendimtarëve të tij nuk u intereson e vërteta as për vrasjen e Fehmi Aganit e as e vërteta për vrasjet tjera. Sikur Dick Marty dhe ithtarët e sajimeve serbe të kishin qenë të interesuar të dinin të “vërtetën e plotë”, ata kanë pasur mundësi të informohen edhe për vrasjen e avokatit të njohur shqiptar të Kosovës, Bajram Kelmendit dhe të dy djemve të tij, Kushtrimit 18 vjeç dhe Kastriotit 31 vjeç. Madje, vetëm duke u bazuar në informatat e organizatave serbe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të kishin mësuar të vërtetën e plotë se familja e avokatit shqiptar, që dyshohej se i kishte dhënë Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dëshmi për krimet serbe në Kosovë, u keqtrajtua në sy të fëmijëve dhe pas keqtrajtimit që iu bënë Bajramit, Kastriotit dhe Kushtrimit, “policia serbe i kishte

¹ Po aty

² Vlada Srbije: vepra e cituar, *Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji*, f.22

thënë Kastriotit që t'i puthte fëmijët e vet për t'u dhënë lamtumirën e fundit!"¹ Ata u ekzekutuan më 24 mars 1999!

Por jo! Atyre nuk u intereson kjo e vërtetë! Atyre u intereson e "vërteta" e Danica Marinković-it që i kualifikon kriminelët serbë si "punonjës që e kanë kryer punën e tyre ndershmerisht" dhe si "humanë", sepse i kishin mundësuar Kastriotit t'i puthte fëmijët e vet para se ta vrisnin!

Renditja e Bajram Kelmendit dhe dy djemve të tij, Kastriotit dhe Kushtrimit, në numrat 237, 238 dhe 239 të listës së civilëve të vrarë e që Shërbimi Sekret Serb ia vesh UÇK-së bëhet me shpresën dhe bindjen se shumica dërrmuese e atyre që i lexojnë botimet në gjuhën angleze² apo frënge të "librave të bardhë" nuk e dinë se cilët janë këta persona.

Edhe pse emrat e tyre figurojnë nga fundi i listës, unë i përmenda në fillim me qëllim që lexuesi ta kuptojë më mirë kontekstin e rrëfimit të humanistes serbe, Nataša Kandić-it, që po sjell në vijim.

Në shkrimin e cituar më lart «E vërteta shqetësues», drejtuesja e Fondit për të Drejtën Humanitare në Serbi përshkruan rrethanat e vështira me të cilat ishte ballafaquar në një rast në Kosovë.

"Gjatë bombardimeve të NATO-s"- shkruan Nataša Kandić-i "kur kam qëndruar në Kosovë, jam frikuar më shumë nga policia serbe, nga formacionet paramilitare dhe nga mbrojtësit e serbëve siç ishte gjykatësja Danica Marinković-i (...) Në heshtjen që mbretëronte në Serbi dhe në Kosovë, secili që do të mundahej të ndihmonte shqiptarët do të shpallej armik, spiun dhe tradhtar. Më 27 maj 1999, në ditën kur u shpall aktakuza kundër Milošević-it, policia më ndaloi në postblokun e Lipjanit³. Isha nisur për në Prizren që t'i dërgoja gruan dhe fëmijën e kryeredaktorit të gazetës

¹ E-Novine, «Ciljana ubistva, uklanjanje tela, silovanja»
<http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/84243-Ciljana-ubistva-uklanjanje-tela-silovanja.html>

² Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f. 921-922

³ Qytet në Kosovë

«Koha Ditore». Shoferin tim e mbajtën ndaras nga ne nën kërcënimin se do ta vrisnin si çdo njërin tjetër që fliste anglisht. Kur u thashë se ku isha duke shkuar dhe arsyet pse isha duke shkuar, ata filluan të bërtasin, të më quajnë spiune, tradhtarë... Më kërcënuan se do të më akuzonin për spiunim. Më frikësonin se do të më përpinte terri dhe se do ta shpallnin se isha zhdukur në territorin e UÇK-së... U thashë se mund të më merrnin, siç bënin edhe me shqiptarët, por nuk do të heshtja për atë që bëhej në Kosovë.”¹ “U thashë: Keni vrrarë Fehmi Aganin, keni vrrarë Bajram Kelmendin dhe djemtë e tij, i keni vrrarë fshatarët, gratë dhe fëmijët...”²

Fatmirësisht, Nataša Kandić-i është gjallë dhe shpëtoi nga një ekzekutim i mundshëm! Në të kundërtën ajo do të figuronte në listën e civilëve të vrrarë nga UÇK-ja dhe nuk përjashtohet hipoteza që gjykatësja hetuese, Danica Marinković-i, t'i kishte “zbuluar vrasësit” në mesin e “terroristëve shqiptarë”!

Sikur “ta kishte përpirë terri Nataša Kandić-in dhe të ishte zhdukur në territorin e UÇK-së” lexuesi mund ta imagjinojë se çka do të kishin shkruar Dick Marty, Carla Del Ponte, Christophe Châtelot-ja, Renaud Girard-i, Regis Debray-ja, Bo Adami, Jürgen Elsässer-i, Patrick Barriot-i, John Laughland-i, Serge Halimi, Jean-Marie Lepen-i, Dominique Vidal-i, Bernard Lugan-i, Dominique Venner-i, Philippe Conrad-i, Jean-Arnauld Derens-i, Pierre Péan-i, Xavier Raufer-i dhe të gjithë ata që për shkak të verbimit të tyre ideologjik me «antiamerikanizëm» u angazhuan në kumbarinë e stigmatizimit të UÇK-së.

Fatmirësisht është gjallë! Them fatmirësisht, jo vetëm për faktin se listës së civilëve të vrrarë që ia vishnin UÇK-së do t'i shtohet edhe një emër, jo vetëm për faktin se kjo humaniste e përmasave botërore dhe Fondi për të Drejtën Humanitare që

¹ Nataša Kandić, artikulli i cituar, «Uznemiravajuca istina» (E vërteta shqetësuese)

² Danas, «Sada sam neka druga, meni draža osoba» (Tani jam një person tjetër, më e dashur)

http://www.danas.rs/dodaci/vikend/sada_sam_neka_druga_meni_draza_osoba.26.html?news_id=255622#sthash.7b6AU8qo.dpuf

drejtohet prej saj ka dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh në ndriçimin e një pjese të asaj që ka ndodhur në këtë pjesë të Evropës, por, sidomos për faktin se një njeri i pafajshëm i ka shpëtuar vrasjes.

Po vazhdoj me listën.

Në të njëjtën ditë kur u vra Bajram Kelmendi dhe djemtë e tij, forcat policore serbe vranë profesorin e Universitetit të Prishtinës, Latif Berishën, që në atë kohë ishte Kryetar i LDK-së për qytetin e Mitrovicës. Po ashtu, në të njëjtën kohë u ekzekutua Agim Hajrizi, cili ishte Kryetar i Kuvendit të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Agim Hajrizi u vra së bashku me nënën e vet, Nazmien dhe me djalin e tij Ilirin, i cili ende nuk i kishte mbushur 13 vjeç.

Të gjithë ata që kanë qenë të interesuar ta dinë “të vërtetën e plotë” kanë pasur mundësi të informohen se për vrasjet e lartpërmendura u ngrit kallëzim penal kundër policit serb Nenad Pavićević-it.

Ky kriminel nuk u paraqit në seancën gjyqësore në procesin kundër tij dhe “në mungesë gjykata e dënoi me 20 vjet burg.”¹ Jo vetëm që mungoi ditën e gjyqimit, por, Nenad Pavićević-i nuk vuajti asnjë ditë dënim. Ai mungon edhe në burg!

Edhe pas dënimit të Nenad Pavićević-it për këto vrasje, emrat e tyre figurojnë në listën e civilëve që pretendohet se i ka vrarë UÇK-ja².

Mospranimi i sajimeve serbe për t’ia veshur UÇK-së krimet e kryera me urdhër të Shërbimit Sekret Serb interpretohet nga Dick Marty dhe kumbarët e lartpërmendur si “mungesë e vullnetit politik për të ndriçuar të vërtetën për këto ngjarje”!

¹ Blic, «Oružje kupovano od policije i vojske»
http://www.blic.rs/stara_arhiva/hronika/25048/Oruzje-kupovano-od-policije-i-vojske

² Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f. 921, Numrat rendor 232, 233, 234 dhe 235

Për ç'mungesë vullneti politik flet Dick Marty në raportin e tij? Vullnetin që të pranohet gënjeshtër për realitet dhe të humben gjurmët e kriminelëve të vërtetë?!

Pesëmbëdhjetë vjet pas kryerjes së krimeve në Mitrovicë, EULEX-i arrestoi Oliver Ivanović-in, liderin e Iniciativës Qytetare Serbe SDP-së¹, i cili vazhdimisht akuzonte UÇK-në për vrasjen e civilëve, sidomos të atyre që i shpallnin si “besnikë ndaj Republikës së Serbisë”!

Ky lider politik serb gjatë luftës në Kosovë ishte komandant i Stacionit Policor në Mitrovicë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Oliver Ivanović-i, në bashkëpunim me policët Dragolub Delibašić-in, Ilija Vujačić-in, Nebojša Vujačić-in dhe Aleksandar Lazović-in kishin dëshmuar “vullnetin e tyre politik” të ekzekutojnë Fatmir Mustafën, Skender Paqaradën, Avni Abazin, Mehmet Sefarin, Isa Mustafën, Xhemshit Smajlin, Behxhet Ferizin, Mentor Mehanën dhe Shefki Kosumin².

Akuza e Dick Marty-t për “mungesë vullneti politik nga ana e autoriteteve shqiptare dhe atyre të Kosovës” është akuzë e kopjuar nga politikanët e llojit të Oliver Ivanović-i, të cilët kishin “vullnet politik” që të vrisnin civilë të pafajshëm dhe të kërkonin “vullnet politik” për zbulimin e vrasësve “në mesin e UÇK-së”!

Në kapitullin kushtuar Konferencës së Rambujesë lexuesi pati mundësi të njëjhej me rritjen e intensitetit të krimeve kundër civilëve shqiptarë dhe akuzat zyrtare se prapa këtyre vrasjeve gjoja qëndronin “terroristët shqiptarë”.

Në listën e publikuar në botimin e vitit 2000 të «Librit të Bardhë», nga numri rendor 170 e deri në numrin rendor 231 u

¹ SDP akronim i Sloboda, Demokracija, Pravda (Liri, Demokraci, Drejtësi)

² Albeu, «Ja krimet për të cilat akuzohet Ivanović»

<http://www.albeu.com/kosove/ja-krimet-per-te-cilat-dyshohet-ivanoviq/139665/>

Le Figaro, «Kosovo/crimes de guerre: un dirigeant arrêté», 28.01.2014

[http://www.lefigaro.fr/flash-actu/2014/01/28/97001-](http://www.lefigaro.fr/flash-actu/2014/01/28/97001-20140128FILWWW00292-kosovocrimes-de-guerre-un-dirigeant-arrete.php)

[20140128FILWWW00292-kosovocrimes-de-guerre-un-dirigeant-arrete.php](http://www.lefigaro.fr/flash-actu/2014/01/28/97001-20140128FILWWW00292-kosovocrimes-de-guerre-un-dirigeant-arrete.php)

përfshinë të gjithë civilët shqiptarë të vrarë gjatë kësaj periudhe që u cilësuan nga propaganda serbe si “shqiptarë besnikë ndaj Republikës së Serbisë të vrarë nga UÇK-ja”. Aty janë edhe Sebahate Zukaj (17 vjeçare), Vlora Humolli (18 vjeçare), Agon Ajeti (20 vjeç), Xhemajl Smaçi (20 vjeç), Driton Loku (20 vjeç) djali i veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Gafurr Lokut, Adriana Abdullahu (23 vjeçare), aktorja e re e teatrit, dhe shumë të rinj të tjerë që nuk kishin as moshë për ta dëshmuar “besnikërinë e tyre ndaj Republikës së Serbisë”.

Vrasja e civilëve nga Shërbimi Sekret Serb në funksion të stigmatizimit të UÇK-së si organizatë terroriste që gjoja i “vret shqiptarët besnikë ndaj Republikës së Serbisë” paraqet një krim të dyfishtë, sepse kjo formë përdhos kujtimin për viktimat e dhunës serbe.

Të shpallet Fehmi Agani si “shqiptar besnikë ndaj Republikës së Serbisë”, ky profesori i Universitetit të Prishtinës, nënkryetar i LDK-së dhe përfaqësues i Delegacionit shqiptar të Kosovës në Konferencën e Rambujesë; të shpallet Gafurr Loku si “shqiptar besnik ndaj Republikës së Serbisë”, ky veprimtar i çështjes kombëtare shqiptare, të cilin pushteti i ish Jugosllavisë e kishin përndjekur tërë jetën dhe që vuajti 8 vjet e gjysmë burg për shkak të angazhimit për të drejtat kombëtare shqiptare¹; të shpallen Agim Hajrizi, Latif Berisha, Bajram Kelmendi dhe shumë veprimtarë të tjerë të çështjes shqiptare se gjoja ishin “shqiptarë besnikë ndaj Republikës së Serbisë” është përpjekje për të përdhosur dhe vrarë edhe veprimtarinë e tyre për çlirimin e Kosovës.

Por përpiluesit e listave të këtilla dhe shpërndarja e tyre në qarqet politike, diplomatike dhe mediatike janë nisur nga parimi se janë të rrallë lexuesit e huaj që e dinë se cilët janë Fehmi Agani, Gafurr Loku, Agim Hajrizi, Latif Berisha, Bajram Kelmendi apo cilido qoftë civil i vrarë shqiptar që figuron në këtë listë si i vrarë nga UÇK-ja. Për shumicën absolute të lexuesve të këtyre listave emrat janë të panjohur siç janë të panjohura edhe rrethanat e

¹ Më 21 janar 1973 u dënua me 5 vjet burg, ndërsa më 16 gusht 1982, u dënua me 3 vjet e 6 muaj burg.

vrasjeve të tyre. Dhe në këtë kontekst nuk përjashtohet mundësia që dikush, në mungesë të informatave të sakta, të bjerë pre e propagandës serbe. Por, një gjë e tillë nuk mund të thuhet për kumbarët e llojit të Dick Marty-t. Atyre nuk u intereson e vërteta! Atyre u intereson të “gjejnë prova” që do të arsyetonin dyshimet se “amerikanët kishin mbështetur grupet mafioze dhe kriminale në Kosovë, për të krijuar pretekstin e ndërhyrjes në Evropë”!

Në këtë përpjekje për të “gjetur provat e nevojshme” për krimet që i visheshin UÇK-së, Dick Marty-i falënderon¹ vetëm Prokurorin special për krime lufte në Beograd, i cili i ka ofruar bashkëpunimin dhe gatishmërinë e nevojshme. Puna e UNMIK-ut, Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe sidomos e shqiptarëve është zhgënjyese për Dick Marty-n! Krahas revoltës që shpreh për “mungesën e bashkëpunimit të autoriteteve kosovare dhe shqiptare në gjetjen e fatit të serbëve të zhdukur” ai fajëson edhe “popullatën e Kosovës që nuk ka dhënë informata mbi varrezat masive ku janë groposur viktimat serbe.”²

Varreza masive të civilëve serbë të vrarë?! Hipokrizi e llojit të vet!

Në listën përfundimtare të publikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë në muajin mars të vitit 2000, për tërë periudhën nga 1 janari i vitit 1998 e deri më 10 qershor 1999 ishin vrarë 75 civilë serbë! Për të gjitha rastet tregohet vendi i vrasjes dhe atyre që u intereson mund t’i vizitojnë edhe varrezat e tyre.

Në këtë libër propagandistik të regjimit të Milošević-it nuk flitet në asnjë rast për varreza masive. Edhe për 100 civilët e vrarë, që “nuk kishin mundur të identifikohen”, por që e dinin se gjoja i kishin vrarë “terroristët e UÇK-së”, përmenden emrat e vendeve ku janë gjetur kufomat dhe në asnjë rast nuk përmendet ekzistimi i varrezave masive!

Të propagandohet për “varreza masive të civilëve serbë”, siç bën Dick Marty në raportin e lartpërmendur, është më shumë se

¹ Raporti, paragrafi 18

² Raporti, paragrafi 14, shënimi 8

gënjeshtër: është përpjekje për t'u treguar më ekstremist se ekstremistët e propagandës së regjimit të Milošević-it.

Sikur t'u interesonte të shihnin të vërtetën e plotë të këtyre listave ata do të kishin mundur të konstatonin se diçka nuk është në rregull me këto lista. Edhe pa i njohur personat e këtyre listave, numrat rendorë 261, 262 dhe 263 ngjallin dyshim te çdo lexues i vëmendshëm. I njëjti person për të cilin pretendohet se ishte vrarë nga UÇK-ja në numrin rendor 261 paraqitet si Fljora Shabani, ndërsa në numrat rendorë 262 dhe 263 ky person paraqitet si Flore Shabani!

Data e vrasjes dhe vendi i vrasjes është i njëjtë. Mungesa e vitit të lindjes në të tri rastet, duhej të ngjallte dyshime sepse, për rastet tjera publikohet, së paku, vitit i lindjes!

261. Fljora Šabani from the village of Vlaštica (Gnjilane). Killed on 1 May 1999 in this village.

262. Flore Šabani from the village of Vlaštica (Gnjilane). Killed on 1 May 1999 in this village.

263. Flore Šabani from the village of Vlaštica (Gnjilane). She was killed on 1 May 1999 in this village.

264. Nadjija Bunjaku (1927) – from Gnjilane. Killed on 7 May 1999 at about 01:30 a.m. in Gnjilane.

265. Ahmet Kokolari (1925) – from Štimlje. Killed on 10 May 1999 in Štimlje at his house.

266. Ismailj Ademi (1916) – from the village of Košare (Uroševac). Killed on 14 May 1999 at his home, together with his wife, Fatima.

267. Fatima Ademi (1918) – from the village of Košare (Uroševac). Killed on 14 May 1999 at her home, together with her husband Ismailj.

268. Hasan Ademi (1909) – from the village of Košare (Uroševac). Killed on 14 May 1999 at his home together with Ismailj and Fatima Ademi.

269. Rahim Rahmoni (1928) – from the village of Jerli Sadovina (Vitina). Killed on 16 May 1999 at about 12:50 p.m. in this village.

Lista e civilëve shqiptarë që pretendohen se janë vrarë nga UÇK-ja¹

Sikur t'u kishte interesuar e vërteta e plotë, ata do të kishin shkuar në fshatin Vlaštica, toponim serb për fshatin Llashticë të Komunës së Gjilanit, dhe të kishin pyetur për vrasjen e këtij personi. Për ta gjetur këtë fshat nuk do ta kishin pasur aspak të

¹ Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, vepra e cituar, *Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija*, f.923

vështirë sepse në tërë Kosovën ka vetëm një fshat që mban toponimin Vlastice (Llashticë). Sikur ta kishin bërë një gjë të tillë atëherë do të kishin mësuar të vërtetën mbi masakrën që ndodhi në këtë fshat më 30 prill 1999 dhe do të ishin informuar se prapa emrave Fljora Shabani dhe Flore Shabani qëndron vajza 13 vjeçare, Vlora Shabani!

Secilit që i ka interesuar të mësojë se çka kishte ndodhur në këtë fshat, ka pasur mundësi të njihet me detajet e tragjedisë që përjetuan banorët e Llashticës.

Dy javë pasi forcat serbe vranë Ali Selimin, Enver Murselin, Ymer Rashitin, Lulzim Musliun, Rukije Ramushin, Habibe Ramushin, Nezir Ramushin, Xhyzide Hasanin dhe Lirim Shabanin¹, më 30 prill 1999 filloi akti i dytë i tragjedisë në këtë fshat.

Gjatë sulmeve të kësaj dite banorët e Llashticës që kishin mbetur pa ikur nga fshati u detyruan nga forcat serbe të tubohen në shtëpi dhe u ekzekutuan. Me këtë rast u vranë Hysen Hyseni, Ajshe Hyseni, Fazli Hyseni, Arife Hyseni, Driton Hyseni, Mirije Hyseni, Blerim Halili, Rifat Shabani, Selami Shabani, Zijavere Shabani, Fisnik Shabani, Sylejman Ibishi dhe Xhavit Berisha.

Pas ekzekutimit të fshatarëve, forcat serbe u vunë zjarrin shtëpive ku ishin kufomat me qëllim që të fshihnin gjurmët. Pasi i dogjën, shtëpitë u rrafshuan me buldozer. Nga këto operacione “u dogjën 123 shtëpi dhe 137 objekte ndihmëse. U plaçkitën 90 traktorë, 120 moto kultivatorë, 3 autokombajna, 3 kombibusa, një kamion, 130 vetura dhe 680 kafshë.”²

Nga kjo tragjedi, nëpër zjarrin dhe tymin e shtëpive dhe të kufomave që digjeshin, të plagosur rëndë sa edhe forcat serbe i morën për të vdekur, arritën të shpëtojnë Vlora Shabani, Deli Hyseni, Drita Hyseni, Ymer Ibishi dhe Nehat Shabani.

¹ Vrasja kishte ndodhur më 13 prill 1999

Shih: <http://botasot.info/kosova/289507/deli-hyseni-deshmitari-qe-i-pa-te-gjitha-krimet/>

² Po aty



Vlora Shabani, e mbijetuara¹ në fshatin Llashticë

Vlora Shabani, kjo vajzë 13 vjeçare, nuk kishte vdekur! Ajo u mbijetoi plagëve dhe është dëshmitare e gjallë e tmerrit kur u vranë, në praninë e saj, babai, Selamiu (mësues i fshatit), nëna e saj Zijaverja, vëllai, Fisniku, që ishte vetëm 3 vjeçar dhe gjyshi i saj, Rifati.

Sikur të kishin qenë të interesuar, ata do ta kishin mësuar të vërtetën e plotë për këtë vajzë që figuron në listën e civilëve të vrarë që i vishen UÇK-së. Do ta kishin kuptuar edhe arsyen e vërtetë pse në botimin e vitit 2001 u fshi emri i saj dhe në listën e “viktimave të terroristëve shqiptarë” nuk figurojnë as Fljora Shabani e as Flore Shabani!

Kushdo që do të kishte zbuluar të vërtetën e plotë për këtë rast, do të kishte vazhduar me emrat tjerë që vijojnë në këtë listë. Kjo do t'i kishte sjellë te e vërteta tjetër. Naxhije Bunjaku (Nadjija Bunjaku në transkriptimin anglisht), në numrin rendor 264, e moshës 72 vjeçare, e vrarë më 7 maj 1999 në Gjilan, u vra nga forcat “paramilitare” serbe.

Para agimit të ditës së 7 majit 1999, në 01h30, Predrag Jan-ković-i, Dušan Panajotović-i dhe Zoran Stević-i, që konsiderohe-shin si pjesëtarë të grupeve “paramilitare” serbe, hynë në shtëpinë

¹ Në faqen e majtë të Vlorës shihen gjurmët e njërës nga plagët me plumb

e familjes Bunjaku dhe kërkuan djalin e vetëm të kësaj familje, Shkëlzen Bunjakun. Naxhija u përpoq t'i pengonte “paramilitarët” që të mos hynin në dhomën ku ishin fëmijët e Shkëlzenit. Meqë nuk e gjetën Shkëlzenin, “paramilitarët” ekzekutuan nënën e tij.

Në Prokurorinë e Gjilanit, që ende ishte nën kontrollin e regjimit të Milošević-it, kjo vrasje u regjistrua më 15 maj të po të njëjtit vit (dosja KI. 13/99). Predrag Janković-i, Dušan Panajotović-i dhe Zoran Stević-i u arrestuan dhe kundër tyre u ngrit aktakuzë për veprën penale të vrasjes (Aktakuza P.P.16/99).

Pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, Prokuroria serbe për krime lufte heshti plotësisht edhe mbi këtë krim.

Sikur të kishin qenë të interesuar të dinë të vërtetën e plotë për Ahmet Kokollarin¹, 74 vjeçar, i ekzekutuar nga forcat serbe në shtëpinë tij, për Ismajl Ademin², 83 vjeçar, invalid i paralizuar, që nuk kishte pranuar të largohet nga fshati, gruan e tij, Fatimen³, 81 vjeçare që qëndroi pranë burrit të paralizuar dhe Hasan Ademin⁴, 90 vjeçar, do të kishin kuptuar se të gjithë u ekzekutuan sepse nuk kishin pranuar të largoheshin nga Kosova. Do të kishin kuptuar se Rrahim Rrahmani⁵, 71 vjeçar, nuk ishte nga fshati Sodovinë e Jerlive të Komunës së Vitisë por nga fshati Vërban i kësaj Komune. Edhe ky civil shqiptar u vra para shtëpisë së tij në kuadër të operacioneve për spastrimin etnik të Kosovës.

Por atyre nuk u intereson e vërteta sepse kjo e vërtetë çon te përgjegjësia e atyre që janë në dijeni të kriminelëve të vërtetë që i kryen krimet në Kosovë e ndaj të cilëve nuk u ndërmor asnjë masë ndëshkuese. Një përgjegjësi e veçantë bie mbi Prokurorinë serbe për krimet e luftës.

Kjo gjë lihet në heshtje, sepse në të kundërtën Dick Marty, Clint Williamson-i dhe të ngjashëm si ta nuk do të kishin mundur ta lavdëronin Prokurorinë serbe për krime lufte, e cila u paskësh ndihmuar për të ndriçuar krimet e “terroristëve shqiptarë”.

¹ Në numrin rendor 265

² Në numrin rendor 286

³ Në numrin rendor 287

⁴ Në numrin rendor 288

⁵ Në numrin rendor 289

Të lavdërohet Prokuroria serbe për krime lufte për ndihmën që ka dhënë në ndriçimin e pretendimeve të Dick Marty-t është hipokrizi e pashembullt.

Është e njëjta prokurori që i prezantoi opinionit publik serb “dëshmitarin e mbrojtur, ish ushtarin e UÇK-së, i cili pohonte se ia kishte nxjerrë serbit zemrën me bajonetë kallashnikovi dhe e kishin dërguar zemrën në aeroportin e Rinasit për t’ia dorëzuar një tregtari turk që ta shiste për klientët që paguanin më shumë”!

Siç e pamë më lart, përpjekja për të manipuluar me këtë “dëshmitar” në emisionin televiziv «Anatomia e krimit» nxori në shesh «budallallëkun e sajimeve» të Prokurorisë serbe kundër udhëheqësve të UÇK-së;

Është e njëjta prokurori që pezulloi aktakuzën kundër Goran Radosavljević Gurit, komandantit të Qendrës Mësimore të Petrovo Selo-s ku u ekzekutuan vëllezërit Bytyqi¹ dhe që e përpiloi aktakuzën kundër Sreten Popović-it, Miloš Stojanović-it, Aleksandar Nikolić-it dhe Dejan Stamenković-it në atë formë që gjykata t’i shpallte të pafajshëm për vrasjen e vëllezërve Bytyqi;

E njëjta prokurori që nuk mbështeti padinë e Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë kundër gazetarëve të Radio Televizionit të Beogradit, të Radio Televizionit të Novi Sadit, si dhe kundër gazetarëve të gazetave “Politika”, “Večernje Novosti” dhe të gjithë atyre që gjatë shpërbërjes së Federatës Jugosllave u vunë në shërbim të propagandës luftënxitëse;

E njëjta prokurori e cila jo vetëm nuk e përfilli padinë e Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Serbisë kundër Milovan Dracun-in, për manipulimin me «Krematorin e Kleçkës» me anë të “intervistës” me Bekim Mazrekun². Madje Zëvendës Prokurori i Prokurorisë serbe për krime lufte, Bruno Vekarić-i u shfaq në ekranet televizive në rastin e “dëshmitarit të mbrojtur për trafikimin me organe njerëzore”.

¹ Rasti u trajtua gjerësisht në Kapitullin e Tretë të Pjesës së Parë.

² Tërësia e padisë së Shoqatës së Gazetarëve të pavarur mund të konsultohet në këtë faqe interneti: <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=875112&print=yes>

Lavdërimi i Prokurorisë serbe për krime lufte për “ndihmën” që ka dhënë Dick Marty-t dhe Clint Williamson-it është tepër domethënës për “anshmërinë” e burimeve të informacionit ku ishin mbështetur raportuesi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për përpilimin e raportit për trafikim të organeve njerëzore në Kosovë dhe prokurori që ishte ngarkuar t’i ndriçojë pretendimet e këtij raporti.

Në vend që Prokuroria serbe për krime lufte të përpilonte akuzat kundër kriminelëve që kishin kryer krime lufte në Kosovë, kjo prokurori “u ndihmonte” Dick Marty-t, Clint Williamson-it dhe prokurorëve që ishin ngarkuar të ndiqnin krimet e UÇK-së!

Në mungesë të veprimeve të Prokurorisë serbe për krime lufte, Fondi për të Drejtën Humanitare në Beograd është duke bërë përpjekje të sjellë drejtësinë në vend.

Është Fondi për të Drejtën Humanitare, i cili “më 8 mars 2013 dorëzoi padi penale kundër shtatë personave për krime lufte kundër popullsisë civile në Pejë. Më 26 mars 1999 në këtë qytet forcat serbe kishin vrarë 74 civilë shqiptarë, në mesin e të cilëve katër gra.”¹

Më 14 mars 2013, Fondi për të Drejtën Humanitare dorëzoi padinë penale kundër një personi që ishte identifikuar se kishte vrarë dy civilë shqiptarë në fshatin Krushë të Vogël. Në padi theksohet se nga data 25 deri më 28 mars forcat Serbe kishin vrarë 660 civilë shqiptarë, prej të cilëve 318 ende konsiderohen si të zhdukur².

Më 4 qershor 2013, Fondi për të Drejtën Humanitare dorëzoi padi kundër shumë pjesëtarëve të Armatës Jugosllave të identifikuar se më 12 maj 1999 kishin vrarë tre civilë shqiptarë. Në padi theksohet se gajtë muajit maj 1999 në qytetin e Pejës ishin vrarë 219 civilë shqiptarë në “mesin e të cilëve 42 gra dhe 12 të mitur”³

¹ <http://www.hlc-rdc.org/?p=22643>

² <http://www.hlc-rdc.org/?p=22679>

³ <http://www.hlc-rdc.org/?p=23090>

Më 18 qershor 2013, Fondi për të Drejtën Humanitare dorëzoi padi penale kundër katër pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, të cilët ishin identifikuar se kishin vrarë nëntë civilë shqiptarë në rrethin e Vushtrrisë. Në padi theksohet se në këtë komunë forcat serbe kishin vrarë 403 civilë shqiptarë, prej të cilëve 58 gra dhe 10 të mitur¹.

Nuk do vazhdoj me paditë tjera që janë bërë qoftë nga Fondi për të Drejtën Humanitare të Serbisë, qoftë nga organizata tjera. Ajo që vlen të theksohet në këtë kontekst ka të bëjë me faktin se Prokuroria serbe për krime lufte nuk e kreu funksionin e saj. Përkundrazi, me veprimet e veta që janë rezultat i funksionimit me logjikën e vjetër është bërë pengesë e madhe për ngadhënjimin e drejtësisë.

Po e përsëris! Lavdërimi që i bëjnë Dick Marty dhe Clint Williamson-i prokurorisë serbe, që nuk ngre aktakuza për ekzekutorët e drejtpërdrejtë të vrasjeve në Kosovë, por, që merret me sajimet e trashëguara nga regjimi i vjetër, është hipokrizi e kulluar!

Por, ka edhe më keq! Siç do ta shohim më poshtë, veprimi i Maurizio Salustro-s, ish shefit të Departamentit për Krime lufte në Kosovë, është skandaloz!

¹ <http://www.hlc-rdc.org/?p=23342>

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Që nga ardhja e tij në Kosovë, fillimisht në kuadër të UNMIK-ut e më vonë në kuadër të EULEX-it, prokurori italian Maurizio Salustro nuk ngriti asnjë aktakuzë të vetme kundër kriminelëve serbë që kishin kryer krime në Kosovë. Të gjitha ndjekjet dhe paditë i orientoi kundër udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Nuk po i përmend të gjitha proceset që ngriti ky prokuror kundër udhëheqësve të disa zonave operative të UÇK-së. Po kufizohem vetëm në periudhën pas miratimit të Raportit të Dick Marty-t nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës më 25 janar 2011. Ky vendim e mobilizoi prokurorin Maurizio Salustro si asnjë prokuror tjetër më parë.

Një muaj pas miratimit të raportit të Dick Marty-t, në mars të vitit 2011, i ngarkuar nga EULEX-it si shef i Departamentit për Krime lufte në Kosovë, Maurizio Salustro urdhëroi arrestimin e Fatmir Limajt dhe nëntë luftëtarëve të Zonës Operative të Pashtrikut të UÇK-së.

Për ata që nuk e njohin Fatmir Limajn po sjell shkurtimisht disa të dhëna. Ai është njëri ndër komandantët më të njohur të UÇK-së dhe pas përfundimit të luftës ishte njëri ndër themeluesit e Partisë Demokratike të Kosovës, nënkryetar i saj dhe Shef i Grupit Parlamentar i kësaj partie në Kuvendin e Kosovës.

Më 17 shkurt 2003 Kryeprokurorja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte, ngriti aktakuzë kundër Fatmir Limajt¹. Në kohën kur u bë publike aktakuza kundër tij, Fatmir Limaj ndodhej në vizitë private në Slloveni. Ai u dorëzua te autoritetet sllovene dhe kërkoi ta shoqëronin për në Hagë, i gatshëm të ballafaqohej me drejtësinë ndërkombëtare.

¹ Për procesin kundër Fatmir Limajt shih më hollësisht: UN, ICTY, Limaj et al. (IT-03-66)
<http://www.icty.org/case/limaj/4>

Procesi gjyqësor kundër tij, i mbështetur në akuza të përpiluara në bazë të burimeve serbe, filloi më 15 nëntor 2004 dhe pas një viti shqyrtimi të kësaj lënde, më 30 nëntor 2005, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë e shpalli Fatmir Limajn të pafajshëm. Më 27 shtator 2007 Dhoma e Apelit hodhi poshtë ankesën që bëri Carla Del Ponte ndaj këtij vendimi dhe konfirmoi pafajësinë e Fatmir Limajt.

Fatmir Limaj u kthye i lirë në Kosovë pak kohë para se Carla Del Ponte ta botonte librin e saj, nga i cili kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës shkoqitën përmendjen e pretendimeve për trafikim me organet njerëzore.

Edhe pse asnjëherë nuk kishte qenë i sistemuar në Zonën Operative të Drenicës, në librin e Carla Del Pontes dhe në Raportin e Dick Marty-t¹ Fatmir Limaj figuron si njëri nga anëtarët e «Grupit të Drenicës»! Kjo e pavërtetë ishte publikuar në “librat e bardhë” të Shërbimit Sekret Serb shumë vite para se të botohej libri i Carla Del Pontes apo Raporti i Dick Marty-t.

Paraqitja e Fatmir Limajt² nga Carla Del Ponte, Dick Marty dhe nga shumë kumbarë të tjerë të sajimeve të Shërbimit Sekret Serb si pjesëtar i «Grupit të Drenicës» dëshmon për “plagjiaturën” që këta autorë kanë bërë nga burimet “sekrete” serbe të shpërndara publikisht.

Duke u mbështetur ekskluzivisht në burimet serbe dhe “dëshmitarët” e ofruar nga Prokuroria serbe për krime lufte, më 25 gusht 2011 Maurizio Salustro ngriti aktakuzën kundër Fatmir Limajt, Nexhmi Krasniqit, Naser Krasniqit, Naser Shalës, Sabit Shalës, Refi Mazrekut, Arben Krasniqit, Shaban Shalës, Behlul Limajt dhe Besim Shurdhajt.

Procesi gjyqësor kundër këtyre dhjetë pjesëtarëve të UÇK-së filloi më 11 nëntor 2011 dhe pasi u shoshitën të gjitha provat e

¹ Raporti i Dick Marty-t, paragrafët 25, 68 dhe 72

² E njëjta gjë vlen edhe për Xhavit Halitin dhe shumë personalitete tjera të UÇK-së që nuk kanë qenë pjesëtarë të strukturave të Zonës Operative të Drenicës e që nga Shërbimi Sekret i Serbisë klasifikohen në këtë zonë dhe kjo e pavërtetë shpërndahet edhe në shumë libra tjerë që i shqyrtova më lart.

ofruara nga të dyja palët, më 2 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e hodhi poshtë akuzën e Maurizio Salustros dhe të gjithë të akuzuarit u liruan si të pafajshëm¹.

Maurizio Salustro u ankua ndaj këtij vendimi dhe Gjykata Supreme e Kosovës, më 20 nëntor 2012, e ktheu këtë lëndë në rigjykim. Rigjykimi filloi më 13 prill 2013.

Ndërsa zhvillohej rigjykimi i dytë i Fatmir Limajt dhe i nëntë ushtarëve tjerë të UÇK-së, më 23 maj 2013 Gjykata Komunale e Mitrovicës lëshoi urdhër arrest kundër Sylejman Selimit, ish-Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që ishte ambasador i Kosovës në Tiranë, Sami Lushtakut, ish-Komandant i Zonës Operative të Drenicës, që ishte zgjedhur Kryetar i Komunës së Skenderajt në zgjedhjet e lira të vitit 2009, dhe pesë ushtarëve të kësaj zone operative: Sahit Jasharit, Jahir Demakut, Zeqir Demakut, Hysni Thaçit dhe Avni Zabelit².

Jo vetëm akuzat ndaj këtyre personaliteteve të shquara të UÇK-së por edhe emërtimi «Grupi i Drenicës» ishte marrë nga «Libri i Bardhë» që e trajtova më lart.

Fatkeqësisht, prezantimi i këtyre komandantëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së si të ishin pjesëtarë të një “grupi” dominoi në shkrimet dhe emisionet televizive që mbuluan këtë rast. Ky prezantim ka marrë përmasa aq të mëdha sa termi «Grupi i Drenicës» përdoret aq shpesh si të ishte një realitet e jo stigmatizim³ i sajuar nga Shërbimi Sekret Serb.

Gjykata e Apelit mori vendimin që shtatë pjesëtarët e lartpërmendur të UÇK-së të mbaheshin në arrest shtëpiak deri në fillimin e procesit gjyqësor. Edhe pse asnjë udhëheqës apo ushtar i UÇK-së nuk i iku ballafaqimit me drejtësinë, Maurizio Salustro u ankua kundër vendimit me arrest shtëpiak. Dëshironte t'i shilte të

¹ Telegrafi, «Kush është Salustro?»

<http://www.telegrafi.com/lajme/kush-eshte-salustro-2-34528.html>

² Radio Evropa e Lirë, «Arrestohet “Grupi i Drenicës”»

http://time.ikub.al/08408663ee/oc42db9c9fa4ecbf7152f04745cecdcb/Lajm_Arrestohet-Grupi-i-Drenices-.aspx
Shekulli online

³ Ky aspekt u trajtua në fillim të Pjesës së Dytë

burgosur! Gjykata e Apelit anuloi vendimin e mëparshëm dhe e shndërroi masën e arrestit shtëpiak në paraburgim.

Më 31 maj 2013 u arrestuan shtatë ish-pjesëtarët e UÇK-së dhe u dërguan në burgje për të plotësuar kërkesën e Maurizio Salustro-s¹.

Paralelisht me veprimet kundër ish-pjesëtarëve të Zonës Operative të Drenicës, Maurizio Salustro vazhdoi procesin e dytë gjyqësor kundër Fatmir Limajt dhe nëntë ushtarëve të Zonës Operative të Pashtrikut. Mirëpo, pas pesë muajsh, më 17 shtator 2013, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i hodhi përsëri poshtë akuzat e pabaza të Maurizio Salustro-s dhe i liroi si të pafajshëm Fatmir Limajn dhe nëntë ushtarët tjerë të UÇK-së².

Edhe ndaj këtij vendimi shefi i Departamentit për Krime lufte në Kosovë, Maurizio Salustro bëri ankesë dhe në momentet kur jam duke i shkruar këto rreshta, Gjykata e Apelit ende nuk ka vendosur lidhur me këtë ankesë.

Nga ana tjetër, më 6 dhjetor 2013 filloi gjykimi³ i Sylejman Selimit, Sami Lushtakut dhe pjesëtarëve të lartpërmendur të Zonës Operative të Drenicës.

Një muaj më vonë, më 9 janar 2014, Maurizio Salustro njoftoi se largohet nga funksioni i tij në Kosovë pa dhënë asnjë sqarim për angazhimet pas largimit nga Kosova. Tre muaj më vonë, të gjitha mediat njoftuan se ish-shef i Departamentit për krime lufte në Kosovë, Maurizio Salustro “ ishte punësuar në Beograd, si këshilltar në Prokurorinë serbe për krime lufte.”⁴

¹ Time, «Grupi i Drenicës pas hekurave, përfundon aksioni i EULEX-it»
http://time.ikub.al/08408663ee/62fa58ced7b41ed8155b3985927aa9e4/Lajm_Grupi-i-Drenices-pas-hekurave-perfundon-aksioni-i-ELUEX-it.aspx

² Bota Sot, «Shpallen të pafajshëm Limaj dhe të tjerët»
<http://botasot.info/kosova/241792/shpallen-te-pafajshem-limaj-dhe-te-tjeret-festohet-me-fishekzjarre/>

³ Time, «Nis gjyqi ndaj grupit të Drenicës»
http://time.ikub.al/fe5d5c1a7d/8bd707a8da26f2a8fc9022b1342aa7f1/Lajm_Nis-gjyqi-ndaj-grupit-te-Drenices.aspx
«Grupi i Drenicës deklarohet i pafajshëm»
http://time.ikub.al/fe5d5c1a7d/97ce4bff535683f82b88c46f73a51c70/Lajm_Fil-loi-seanca-degjimore-kunder-Grupit-te-Drenices.aspx

⁴ Koha, «Ish Kryeprokurori i EULEX-it punësohet në Beograd»,
<http://koha.net/?id=27&l=4422>

Nëse i hedhim një sy makinave kërkuese në internet rreth kësaj çështjeje do të shohim me qindra artikuj në të cilat shprehet revolta e Kosovës për këtë veprim të Salustro-s.

As Maurizio Salustro e as Prokuroria serbe për krime lufte nuk dhanë asnjë sqarim për muaj të tërë. Por, kur shpërtheu skandali¹ i korrupsionit në kuadër të EULEX-it dhe kur shefja e diplomacisë evropiane ngarkoi juristin francez Jean-Paul Jacqué që të hetojë² këtë skandal, Prokuroria serbe për krime lufte reagoi duke pohuar se “asnjë i dyshuar i EULEX-it nuk është punësuar në kuadër të kësaj prokurorie.”³

Cila është e vërteta për skandalin e korrupsionit dhe “punësimin” e Maurizio Salustro-s në Prokurorinë serbe për krime lufte mbetet të shihet. Por, ajo që dihet tashmë qëndron në faktin se, as Prokuroria serbe për krime lufte e as prokurorët ndërkombëtarë që erdhën në Kosovë, nuk kanë bërë asnjë hap për të çuar drejtësinë në vend.

Pesëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, familjarët e 1392 fëmijëve, të 1739 grave dhe të rreth 10000 civilëve shqiptarë të të gjitha moshave që u vranë gjatë zbatimit të politikës së gjenocidit në Kosovë presin ngadhënjimin e drejtësisë! Familjarët e 1657⁴ personave të cilët ende konsiderohen të zhdukur jetojnë në ankthin e përditshëm të zbulimit të rrethanave të zhdukjes së tyre.

Pesëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë 20.400 femra shqiptare, të përdhunuara në funksion të zbatimit të politikës së gjenocidit, presin dënimin e kriminelëve!

¹ Për korrupsionin në EULEX shih : «Scandale de corruption... »
<http://www.courrierinternational.com/article/2014/11/03/scandale-de-corruption-l-eulex-trop-proche-du-milieu-kosovar>

² RFI, « Kosovo: l'UE nomme un juriste français dans l'affaire Eulex » (Kosovë : BE emëron një jurist francez në aferën e EULEX-it)
<http://www.rfi.fr/europe/20141113-kosovo-ue-nomme-juriste-francais-affaire-eulex-corruption-jean-paul-jacque/>

³ Blic, « Vekarić: Osumnjičeni Euleksov tužilac nikada nije radio kod nas » (Të dyshuarit e EULEX-it nuk kanë punuar asnjëherë te ne)
<http://www.blic.rs/Vesti/Politika/456670/Vekaric-Osumnjiceni-Euleksov-tuzilac-nikada-nije-radio-kod-nas>

⁴ <http://koha.net/?id=27&l=33139>

Nuk mund ta di se cili do të jetë rezultati i hetimit të Bashkimit Evropian dhe nëse do të zbulohen prokurorët që janë korruptuar për të lënë në heshtje paditë kundër kriminelëve të vërtetë që kryen krimet më të përbindshme në Kosovë. Por, atë që mund ta them nga ajo që kemi parë deri tani del qartë se mosndëshkimi i kriminelëve për krimet e kryera është shndërruar në një rën nga pengesat e mbylljes së kapitullit më tragjik të dekadës së fundit të shekullit XX. Plagët e hapura nga lufta gjenocidare e regjimit të Milošević-it nuk mund të shërohen pa ndriçimin e plotë të të gjitha krimeve. Mbeturinat e regjimit të vjetër dhe kumbarët e nocioneve që stigmatizonin UÇK-në si “organizatë terroriste” janë bërë pengesa kryesore që të dalë në shesh e vërteta e plotë. Ajo e vërtetë për “listën e krimeve të bëra nga Shërbimi Sekret Serb kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë që do ta rrëzonte në gjuhë Serbinë.”¹

Gjunjëzimi i Serbisë së Milošević-it, logjika e të cilit ende mbizotëron në institucionet shtetërore, është kusht i domosdoshëm për ngadhënjimin e demokracisë në Serbi dhe do të hapte rrugën e pajtimit mes popujve.

Për këtë arsye, publikimi i listës së plotë të krimeve që Shërbimi Sekret i Serbisë i ka bërë kundër civilëve serbë, shqiptarë dhe pjesëtarëve të përkatësive tjera etnike, listës për të cilën fliste ish-Shefi i Shërbimit Sekret Serb, Radomir Marković-i, do të ndriçonte krimet që janë kryer në Kosovë. Sipas mendimit tim, hedhja dritë në këto krime të përbindshme do të përshpejtonte ngadhënjimin e drejtësisë sepse do të krijonte klimën e përgjithshme për domosdoshmërinë e ndëshkimit të kriminelëve të vërtetë. Publikimi i listave të vërteta të kryera me urdhër të Shtabit Strategjik të Milošević-it do të nxirrte në dritë gënjeshttrat e listave që ishin përpiluar në funksion të manipulimit me opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Jo vetëm kaq! Kjo do të kishte ndriçuar edhe punën e prokurorëve ndërkombëtarë që kanë ngritur aktakuza duke u mbështetur në burimet e këtij shtabi

¹ Shkrimi i cituar i gazetës Kurir, « Rade Marković dao nalog ... »

strategjik, pasojat e të cilit i mbajnë mbi kurrizin e tyre Ramush Haradinaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Sami Lushtaku dhe udhëheqës tjerë të UÇK-së.

Ndriçimi i plotë i këtyre ngjarjeve do të nxirrte në shesh motivet politike dhe ideologjike të krijimit të Gjykatës Speciale të Kosovës që do të merrej me pretendimet e propagandës serbe dhe të kumbarëve të tyre për krimet që gjoja kanë kryer udhëheqësit tjerë të UÇK-së.

Padrejtësia troket në dyert e Kosovës! Kjo u pa edhe nga Konferenca e Clint Williamson-it!

Pohimet e Kryeprokurorit Williamson se nuk kanë siguruar prova për trafikimin e organeve njerëzore, se gjatë hetimeve trevjeçare nuk siguruan as provat dhe as dëshmitarët që do të konfirmonin pretendimet për krimet e kryera nga ana e UÇK-së dhe imponimi i krijimit të një Gjykate Speciale për t'i gjykuar "krimet e UÇK-së" pa prova dhe pa dëshmitarë është dëshmi se padrejtësia troket fuqishëm në dyert e Kosovës!

Kosova dhe gjithë rajoni kanë nevojë për DREJTËSI! Po e përsëris se vetëm ndriçimi i plotë i krimeve të kryera dhe dënimi i kriminelëve të vërtetë do të krijonte premisat e nevojshme për pajtimin mes popujve dhe mbylljen e kapitullit më tragjik të shekullit XX-të.

Akuza kundër UÇK-së për vrasjen e civilëve të pafajshëm në Kosovë ka qenë dhe është objekt i propagandës së sajuar në "laboratorët" e Shtabit Strategjik të Milošević-it, ku Shërbimi Sekret Serb ishte shtylla operative e tij. Kjo propagandë u shpërnda falë historianëve e politologëve, filozofëve e sociologëve, gazetarëve e publicistëve, politikanëve dhe prokurorëve, të orientimit të djathtë e të majtë që u mobilizuan për ta "mbrojtur Evropën nga imperializmi amerikan". Si rezultat i kumbarisë së lartpërmendur sot me miliona faqe interneti, libra, artikuj dhe analiza stigmatizojnë UÇK-në si organizatë "terroriste" që ka vrarë civilë të pafajshëm.

Po e përfundoj këtë libër duke e përsëritur edhe një herë reagimin e Vuk Drašković-it, kryetarit të Lëvizjes së Ripërtërimitjes

Serbe, i cili, në kohën kur ndodhën një numër i madh krimesh ishte Zëvendës Kryeministër i Jugosllavisë dhe i ngarkuar të udhëhiqte marrëdhëniet me jashtë!

Pesëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës, i njëjti Vuk Drašković dëshmon:

“U vendos që Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të kryente një varg sulmesh terroriste të cilat duhej t’i visheshin UÇK-së. Qëllimi i këtyre sulmeve ishte që UÇK-ja të paraqitej në sytë e bashkësisë ndërkombëtare si organizatë terroriste (...) Sipas disa burimeve qeveritare të Serbisë, ish-Shefi i Sigurimit Shtetëror serb, Radomir Marković-i, informoi për masakrën në kafenenë «Panda» dhe u kërcënua se do ta rrëzojë në gjunjë Serbinë nëse e publikon listën e të gjitha krimeve që janë kryer nga Shërbimi i Sigurisë Shtetërore ndaj serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, por edhe ndaj serbëve dhe myslimanëve në Bosnje. Mendoj se Serbia është e gjunjëzuar për sa kohë jemi peng i kriminelëve që kanë kryer këto krime dhe për sa kohë e fshehim të vërtetën.”¹

Kjo dëshmi është domethënëse për të kuptuar pse drejtësia për krimet e kryera kundër civilëve të pafajshëm në Kosovë, në Bosnje dhe në Kroaci nuk shkoi në vend. Siç e pamë gjatë tërë këtij libri përmes “transferimeve të kuadrove” nga një drejtori në tjetrën, nga një sektor në tjetrin, nga një detashment në tjetrin dhe nga një ministri në tjetrën, kriminelët e ushtrisë, policisë dhe shërbimeve sekrete serbe arritën t’i ruajnë strukturat e regjimit të vjetër dhe t’i paraqesin si rezultat i “ndryshimeve pozitive në Beograd”.

Përkundër pretendimeve të Kryeministrit serb Aleksandar Vučić-it se gjoja e kanë nxjerrë Serbinë nga kthetrat e kriminelëve² realiteti tregon të kundërtën: Në vend të përgjegjësisë për gjenocidin e kryer nën komandën e tij, Lubiša Diković-i është Shef

¹ Kurir, artikulli i cituar, «Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu!» dhe

Kurir, «Rade Marković dao nalog da se ubiju srpska deca u Peći 1998?!»,

² E-Novine, «Srbiju smo oduzeli razbojnicima i vratili građanima» (Serbinë ua morëm kriminelëve dhe ia kthyem qytetarëve)

<http://www.e-novine.com/srbija/vesti/114337-Srbiju-smo-oduzeli-razbojnicima-vratili-graanima.html>

i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë serbe; koloneli i policisë serbe, Goran Radosavljević Guri pas kthimit nga Libia, ku kishte ikur për t'i shpëtuar dënimit për vrasjen e vëllezërve Bytyqi, njësoj si shumë kriminelë të tjerë u integrua në strukturat udhëheqëse të partisë që udhëheq Aleksandar Vučić-i.

Kjo formë funksionimi nuk ia “ktheu Serbinë qytetarëve të saj”, siç pretendon kryeministri serb Aleksandar Vučić-i, por vazhdon ta mbajë peng të kriminelëve. Në të njëjtën kohë ajo paraqet rrezik për të tashmen dhe të ardhmen e kësaj pjese të Ballkanit.

Në momentet kur jam duke përgatitur librin për botim, më 26 dhjetor 2014, në Prishtinë u arrestua një qytetar i Serbisë të cilit iu gjetën rreth 13 kg eksploziv.

Gazetat beogradase «Kurir»¹ dhe «Blic»² njoftuan se bëhej fjalë për Slobodan Gavrić-in, 46 vjeç, kuadër i Ministrisë së Bujqësisë të Serbisë, që jetonte në Novi Beograd së bashku me gruan e vet, punonjëse e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe dy fëmijët e tyre. Sipas po të njëjtave burime informative, ky kuadër i ministrisë së qeverisë së Aleksandar Vučić-it u arrestua në afërsi të Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë. Mediat spekulojnë se me këtë eksploziv ai kishte për qëllim të bënte atentat në Hotelin Grand, në Katedralen e Prishtinës e kështu me radhë.

¹ Kurir, «Zaplenjeno 13 kg eksploziva u Prištini : Slobodanu Gavriću mesec dana pritvora» (Në Prishtinë u kapën 13 kg eksploziv: një muaj paraburgim për Slobodan Gavrić-in)

<http://www.kurir.rs/crna-hronika/zaplenjeno-13-kg-eksploziva-u-pristini-slobodanu-gavricu-mesec-dana-privvora-clanak-1647072>

² Blic, «OTKRIVAMO Šta se krije iza hapšenja Srbina "bombaša" u Prištini» (Zbulojmë: Çka fshihet prapa arrestimit të serbit “bombahdhës” në Prishtinë) <http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/522571/OTKRIVAMO-Sta-se-krije-iza-hapšenja-Srbina-bombasa-u-Pristini>

Mbetet të shihet se cili do të jetë rezultati përfundimtar i hetimeve rreth këtij rasti. Atë që mund të them në këtë moment ka të bëjë me faktin se arrestimi i Slobodan Gavrić-it shpëtoi jetë njerëzish të pafajshëm, të cilët, si zakonisht, do t'i visheshin “terroristëve shqiptarë”!

Bibliografi e pjesshme

Tërësia e referencave bibliografike figuron në fusnotat e librit.
Të gjitha burimet e internetit që i kam shfrytëzuar në këtë libër ishin të konsultueshme për publikun deri më 10 dhjetor 2014, datë kur bëra verifikimin e fundit.

- Anne-Sophie Paquez, La politique de la France au Kosovo était-elle "gaulliste" ?
Institut européen de l'Université de Genève, euryopa vol. 19-2003, f. 163
Libëri i plotë mund të shihet edhe në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Gjenevës,
<http://www.unige.ch/gsi/files/4914/0351/6343/paquez.pdf>,
konsultimin i fundit 15 nëntor 2014
- Bernard Adam, La gurre du Kosovo, Eclairage et comanitaire, Genève du conflit- Les acteurs, L'intervention de l'OTAN, Edition Grip, 1999, f. 179
- Bernard Comte, Le génocide nazi et les négationnistes, teksti integral në:
<http://www.phdn.org/negation/comte/IA.html>
- Carla Del Ponte, La traque, les criminels de guerre et moi, Editions Heloise d'Ormesson, botimi frengjisht, tetor 2009, f. 649
- Christophe Chiclet, Bernard Ravenel, Kosovo : le piège, L'Harmattan, 2000, f. 287
- Céline Bardet Une femme contre les criminels de guerre Edition du Toucan, Paris, mars 2011, f.247
- Dejan Lučić, Tajne Albanske Mafije, Zrenjanin, 2000, f. 361
- Dominique Lecompte, Quai des ombres- Vingt ans au service des morts, Edition Fayard, 2012, f. 244
- Florence Hartmann, Paix et châtement, Flammarion, 2007, f. 319
- Florence Hartmann, Milosevic, la diagonale du fou, Denoël, 2002, f. 644
- Frédéric Saillot «Racak: De l'utilité des massacres, (Tome 2), L'Harmattan, 2010, f. 218
- Gilbert Achcar, La nouvelle Gurre froide, Le monde après le Kosovo, PUF, 1999, f. 110
- Henry Rousso, Le syndrome de Vichy (1944-1987, Le Seuil, coll. « xxe siècle », Paris, f.383
- Historical Revisionism – International and Independent Scientific Historical Research <http://vho.org/Intro/GB/index.html>
- Jean-Arnauld Derens, Le piège du Kosovo, Editions Non Lieu, 2008, f. 380
- Jean-Arnauld Derens et Cathrine Samary, Les 100 portes des Conflits Yougoslaves, Les Éditions de l'Atelier, Paris, 2000, f.427
- Jean Jacob, Le retour de l'ordre nouveau, Librairie Droz, Genève, 2000, f.270
- Jean-Louis Dufour, Les crises internationales du Pékin (1900) au Kosovo (1999), Editions Complexe, 2000, f.304

- Jean-Marie Boisdefeu, Controverse sur l'extermination des juifs pas les Allemands, teksti integral në:
http://archive.org/stream/LaControverseSurLexterminationDesJuifsParLesAllemands/bdf2_djvu.txt
- Joël Hubrecht, Kosovo 1981-1989-1999-2001, Etablir les faits, Editions Esprit, 2001, f. 176
- Jürgen Elsässer, La RFA dans la guerre au Kosovo, Chronique d'une Manipulation, L'Harmattan, 2002, f. 262
- Marc Waller, Shtetësia e kontestuar, Administrimi Ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi, Botues KOHA, qershor 2011, f. 559
- Marc Weller, Negotiating the final status for Kosovo, f.95
in: www.iss.europa.eu/uploads/media/cp114.pdf
- Michel Collon, Monopoly - l'OTAN à la conquête du monde, Editions Epo, Bruxelles, 2000, f.247
- Milena Dieckhoff, L'individu dans les relations internationales : Le cas du médiateur Martti Ahtisaari, L'Harmattan, 2012, f. 178
- Milovan Drecun, Drugi Kosovski Boj, Beograd, 2013, f.392
- Nathalie Clayer-it, Aux origines du nationalisme albanais, Editions KARTHALA, Paris, 2007, f.794
- Nicodème Ruhashyankiko: Study of the question of the prevention and punishment of the crime of genocide, United Nations Economic and Social Council, 1978, f. 107
- Noam Chomsky, Le Nouvel Humanisme militaire, leçons du Kosovo, Cahier libret, 2000, f.296
- Oliver Jens Schmitt, Kosova- Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike, Botimi shqip, KOHA, 2012, Prishtinë, f. 309
- Patrick Barriot, Les diables sont déchainés: chronique des temps deshumanisants, Editions l'Age d'Homme, 2000, f.226
- Pierre Péan, Kosovo : une guerre «juste» pour un Etat mafieux, Fayard, 2013, f.458
- Pierre Vidal-Naquet, Les assassins de la mémoire
teksti integral në: <http://www.anti-rev.org/textes/VidalNaquet87c/>
- Regis Debray, L'Emprise, Gallimard, 2000, f. 160
- Serge Halimi & Dominique Vidal & Henri Maler, «L'Opinion ça se travaille...», Médias&le « guerres justes » : Kosovo, Afghanistan, Irak, Agon, 2006, f.222
- Tim Judah, Kosova, Luftë dhe hakmarrje, KOHA, Tiranë, 2002, f.406
- Thomas Benages, La Convention por la Prévention et la Repression du Crime de Génocide à l'épreuve du Tribunal Pénal International por l'Ex-Yougoslavie, f.346
teksti integral në: <http://tel.archives-ouvertes.fr/docs/00/66/25/79/PDF/2005CLF10281.pdf>
- Vladan Vljaković, VOJNA TAJNA, 2 Deo, f. 221, Botues: Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji
Tekstin integral e gjeni në faqen e internetit:

<http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Vojna%20Tajna%20-%202%20Deo.pdf>

Yves Tomic, L'État du monde 2000, La Découverte, Paris, 1999

Xavier Raufer-in dhe Stéphane Quéré, La mafia albanaise - Une menace pour l'Europe, Editions Favre, Lausanne, 2000, f. 143

«Librat e Bardhë» të botuara në emër të Qeverisë së Jugosllavisë ose të Qeverisë së Serbisë

Бела књига: Тероризам Албанских сепаратиста на Косову и Метохији, Ministria e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Beograd, shtator 1998, f.125

versioni elektronik: <http://www.srpskapolitika.com/Izdvajamo/bela-knjiga/knjiga-1.html>

Terrorisme in Kosovo and Metohija and Albania- WHITE BOOK, Federal Ministry of Foreign Affairs, Belgrade, septembre 1998, f.218

Le terrorisme au Kosovo et en Metohie et en Albanie (Livre Blanc), Ministère Fédéral des Affaires Etrangères, Belgrade, septembre 1998, f. 226

Злочини албанских терориста 1995-1998, Приштина, januar 1999, f. 241

Terrorist acts of Albanian terrorist groups in Kosovo and Metohija : documents and evidence 1 January 1998 - 10 June 1999, III, Part One & Part Two, Belgrade : Federal Republic of Yugoslavia, Federal Ministry of Foreign Affairs, 2000, p. 1023

Vlada Republike Srbije, Žrtve albanskog terorizma na Kosovu i Metohiji (Ubijena, oteta i nestala lica, januar 1998 - novembar 2001), Beograd, Novembar 2001, f. 361

<http://www.arhiva.srbija.gov.rs/vesti/2002-05/25/326656.html>

Vlada Srbije: Bela knjiga o albanskom terorizmu

Albanski terorizam i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji, 2003, f. 189

<http://sorryserbia.com/wp/belaknjiga.pdf>

Albanian terrorism and organized crime in Kosovo and Metohija,

BIA (Security Information Agency), Belgrade, September 2003

<http://www.kosovo.net/albterrorism.html>

Raporte :

Raport i Dick Marty-t, Traitement inhumain de personnes et trafic illicite d'organes humains au Kosovo, Rapport i i miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

KFOR, SECRET Rei USA KFOR and NATO. J2 SPECIAL PROJECTS, Mars 2004

<http://www.mafialand.de/Members/juergen/pdf/kosovo%20-%20Haliti%20Xhavit.pdf>

BND Kosovo Feb 2005 vs Vertraulich

<http://fr.scribd.com/doc/22922472/Bnd-Kosovo-Feb-2005-vs-Vertraulich>

Tërësia e të gjitha seancave gjyqësore në procesin gjyqësor kundër Slobodan Milošević-it

Kalendar suđenja u predmetu Slobodan Milošević (IT-02-54) - "Kosovo, Hrvatska i Bosna i Hercegovina" dhe

Lista svedoka Pretresnog veća u predmetu Slobodan Milošević (IT-02-54) - "Kosovo, Hrvatska i Bosna i Hercegovina"

http://www.hlc-rdc.org/Transkripti/Milosevic/_Milosevic.html

Konsultimi i fundit më 16 nëntor 2014

Revistat:

Confluence Méditerranée, No 30, Été 1999, Editions l'Harmattan, f. 203

ESISC (European Strategic Intelligence and Security Center)

Pierre ARNOLD, « Kosovo: une république en kit- Quel crédit accorder à la classe politique kosovare? »

http://www.esisc.org/upload/publications/analyses/kosovo-une-republique-en-kit-quel-credit-accorder-a-la-classe-politique-kosovare/KOSOVO%20_%20UNE%20REPUBLIQUE%20EN%20KIT.pdf

La revue internationale et stratégique, Nr. 36, Hiver 1999-2000, sous la direction de Pascal Boniface, « Kosovo: bilan et perspectives », PUF, f. 176

La Revue Internationale des Sciences sociales, décembre 2002

Semelin Jacques, « Du massacre au processus génocidaire »

<https://www.unitar.org/ny/sites/unitar.org/ny/files/procgenocid.pdf>

Les Cahiers du Journalisme, Renaud de la Brosse, « La couverture médiatique de la guerre au Kosovo ou le journalisme impossible », qershor 2000, no 7, f.196-210

Revue l'Arche, Yves TERNON, « La problématique du négationnisme », maj 2003 shih :

<http://www.imprescriptible.fr/dossiers/ternon/negationnisme>

Revue Syndikat

Serge Halimi, « Entretien avec la revue Syndikat », octobri 2000

[http://www.homme-](http://www.homme-moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html)

[moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html](http://www.homme-moderne.org/societe/media/halimi/opinion/syndikat.html)

Faqet e Internetit

OKB, <http://www.un.org/fr/>

OSBE, <http://www.osce.org>

NATO, <http://www.nato.int>

Organizata për Bashkëpunim Islamik, <http://www.oic-oci.org/oicv2/home/?lan=en>

Këshilli i Evropës, <http://www.coe.int/fr/web/portal/home>

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës,

<http://assembly.coe.int/nw/Home-FR.asp>

Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë,

<http://www.tpij.org/sid/135>

Gjykata Ndërko mbëtare e Drejtësisë, <http://www.icj-cij.org/homepage/index.php?&lang=fr>
Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, <http://www.hlc-rcd.org/?cat=289>
Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi,
http://www.helsinki.org.rs/serbian/index_s.html
Human Rights Watch
Gornje Obrinje: Massacre in the forest
<http://www.hrw.org/reports/1999/kosovo/Obrinje6-02.htm>
International Commission on Missing Persons,
<http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2008/02/batajnica-2001-alb.pdf>,
International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia IT-02-54-R77.5
http://www.icty.org/x/cases/contempt_hartmann/cis/fr/cis_hartmann_fr.pdf
ONU, TPIY, Hartmann (IT-02-54-R77.5)
http://www.tpiy.org/case/contempt_hartmann/27

Associated Press

Melissa Eddy, «Trail of Bodies Tells Kosovo Tale», AP-NY-01-16-99 1718EST
<http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 3)
Melissa Eddy, «Serb Forces Fire on Kosovo Village», AP-NY-01-17-99 0844EST
<http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 8)
Melissa Eddy «Serb Forces Attack Albanian Village», AP-NY-01-18-99 0846EST
<http://www.srpska-mreza.com/sirius/KLA-Racak.html> (shkrimi me numër rendor 10)

Atac France

Cathrine Samary, «Kosovo 1999-2009, Quelques mensonges de la pseudo gurre humanitare»
<http://france.attac.org/archives/spip.php?article9880>

BBC

«Montenegro declares independence»,
<http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/5043462.stm>

Bruxelles 2

«Un Américain chef de la task force d'enquête à Eulex Kosovo» (Një amerikan në krye të task forcës hetuese të Eulex-it në Kosovë), 29 gusht 2011
<http://www.bruxelles2.eu/2011/08/29/un-america-in-chef-de-la-task-force-denquete-a-eulex-kosovo.html>

Esprit Européen

«Michel Collon, l'anti-désinformateur»

http://www.esprit-europeen.fr/perspectives_desintox_collon.html

Libération

AFP, «Les Serbes prennent l'ONU en otage pour faire cesser les raids », 27 mai 1995

http://www.liberation.fr/evenement/1995/05/27/les-serbes-prennent-l-onu-en-otage-pour-faire-cesser-les-raids_132202

Didier François, «Les pourparlers de Rambouillet arrivent à leur date-butoir. L'heure de vérité pour le Kosovo . Faute d'un accord de paix entre Serbes et Kosovars avant samedi midi, l'Otan pourrait lancer ses frappes aériennes»

http://www.liberation.fr/evenement/1999/02/20/les-pourparlers-de-rambouillet-arrivent-a-leur-date-butoir-l-heure-de-verite-pour-le-kosovo-faute-d-_265478

Helène Despïc-Popovic: «Kosovo : un accord sans signataires. Ni Albanais ni Serbes ne semblent disposés à s'entendre à la veille de l'échéance», 19.02.1999

http://www.liberation.fr/monde/1999/02/19/kosovo-un-accord-sans-signataires-ni-albanais-ni-serbes-ne-sont-disposes-a-s-entendre-a-la-veill_265414

Helène Despïc-Popovic, «Le huis clos de Rambouillet. En deux semaines, les deux délégations ont peu avancé», 20.02.1999

http://www.liberation.fr/evenement/1999/02/20/le-huis-clos-de-rambouillet-en-deux-semaines-les-deux-delegations-ont-peu-avance_265491

Helène Despïc-Popovic, Escalade des menaces sur Belgrade . Les vérificateurs de l'OSCE sont évacués du Kosovo, 20 Mars 1999

http://www.liberation.fr/monde/1999/03/20/escalade-des-menaces-sur-belgrade-les-verificateurs-de-l-osce-sont-evacues-du-kosovo_268049

Helène Despïc-Popovic, «Slavko Curuvija, l'homme qui en disait trop. Assassiné dimanche à Belgrade, ce journaliste d'opposition avait longtemps fréquenté l'entourage de Milosevic», 15 avril 1999

http://www.liberation.fr/evenement/1999/04/15/slavko-curuvija-l-homme-qui-en-disait-trop-assassine-dimanche-a-belgrade-ce-journaliste-d-opposition_271296

Lilian Alemagna, «Il faut briser le tyran pour l'empêcher de briser la révolution» (Intervistè me Jean-Luc Mélenchon-in)

http://www.liberation.fr/monde/2011/03/21/il-faut-briser-le-tyran-pour-l-empacher-de-briser-la-revolution_723004

Marc Semo, «Charniers de la purification en Serbie» , 3 juillet 2001

http://www.liberation.fr/evenement/2001/07/03/charniers-de-la-purification-en-serbie_370266

Miroslav Filipović, «Que ceux qui ont commis ces atrocités soient jugés pour leurs crimes- Témoignages d'officiers recueillis par Miroslav Filipovic», 24.06.2000

http://www.liberation.fr/monde/2000/06/24/que-ceux-qui-ont-commis-ces-atrocites-soient-juges-pour-leurs-crimes_328448

Pierre Hazan , «Nous étions sûrs de tous mourir. Des habitants de Racak racontent les dix heures de massacre», 18.01.1999.

http://www.liberation.fr/evenement/1999/01/18/nous-etions-surs-de-tous-mourir-des-habitants-de-racak-racontent-les-dix-heures-de-massacre_261409

Pierre Hazan, «Massacre de Racak: récit d'un témoin clé. Arrivé après la tuerie, il dément la thèse d'une mise en scène», 27 Janvier, 1999 ,
http://www.liberation.fr/monde/1999/01/27/-_262191

Le Figaro

Renaud Girard, «Nuages noirs sur un massacre», 20/01.1999

Thomas Vampouille, «Le premier ministre du Kosovo accusé de trafic d'organes», 15.12.2010

<http://www.lefigaro.fr/international/2010/12/15/01003-20101215ARTFIG00604-le-premier-ministre-du-kosovo-accuse-de-traffic-d-organes.php?pagination=6>

Le monde

«Vuk Draskovic nommé vice-premier ministre de la RFY», 20.01.1999

http://www.lemonde.fr/archives/article/1999/01/20/vuk-draskovic-nomme-vice-premier-ministre-de-la-rfy_3532258_1819218.html

Christophe Châtelot, «Les morts de Racak ont-ils vraiment été massacrés froidement ? » 21.01.1999 , <http://www.srpska-mreza.com/ddj/Racak/Articles/LeMonde990121.html>

Régis Debray, «Lettre d'un voyageur au président de la République», 13 maj 1999 .

«Vaclav Havel : "Moi aussi je me sens albanais "» (artikull me pagesë)

http://www.lemonde.fr/cgi-bin/ACHATS/acheter.cgi?offre=ARCHIVES&type_item=ART_ARCH_30J&objet_id=20689

«Serbes et Albanais divisés sur le plan Ahtisaari», 03.02.2007

http://www.lemonde.fr/europe/article/2007/02/03/serbes-et-albanais-divises-sur-le-plan-ahtisaari_863211_3214.html

Le monde diplomatique (Les archives du journal 1954-2012 en DVD-ROM)

Amnon Kapeliouk, «Le Kosovo vu d'Israël», Mai 1999

Antoine Sanguinetti «Seuls les Etats-Unis... », Juillet 1999

Christophe Chiclet «La Macédoine en danger d'éclatement», Janvier 1999

Dominique Vidal, «Kosovo, l'assourdissant silence», Janvier 2001

Ignacio Ramonet, «Kosovo», Février 1999

Ignacio Ramonet «Le gâchis», Mai 1999

Ignacio Ramonet, «Nouvel ordre global», Juin 1999

Jacky Mamou, «Au nom de l'humanitaire», Juin 1999

Jean-Arnault Dérens et Sébastien Nouvel «Le Kosovo entre massacres et marchandages», Avril 1998

Jean-Arnault Dérens, «Destabilisations en chaîne», Mai 1999

Jean-Arnault Dérens, «Adieu au Kosovo multiethnique», Mars 2000
 Jean-Arnault Dérens, «Le précédent contesté de l'intervention au Kosovo»,
 Février 2003
 Jean-Arnault Dérens, «Au Kosovo, un intenable statu quo», Décembre 2003
 Jean-Arnault Dérens et Laurent Geslin, Rêves dangereux d'une « Grande
 Albanie », Juillet 2006
 Jean-Arnault Dérens, «La dernière pièce du puzzle balkanique», Mars 2007
 Jean-Arnault Dérens, «Les propositions contestées des Nations unies-
 Indépendance du Kosovo, une bombe à retardement», Mars 2007
 Jean-Arnault Dérens, Kosovo : l'indépendance, et après ?, Février 2008
 Jean-Arnault Dérens et Laurent Geslin, «Entre Pristina et Tirana, l'autoroute
 de la 'Grande Albanie' ?», Maj 2009
 Jean-Arnault Dérens, «Trafic d'organes au Kosovo : un rapport accablant»,
 janvier 2011
 Noam Chomsky, «Au Kosovo, il y avait une autre solution», Mars 2000
 Paul-Marie de La Gorce, «Négociations en trompe-l'œil», Juin 1999
 Paul-Marie de La Gorce, «Le sud-est de l'Europe sous l'emprise de l'OTAN»,
 Mars 2000
 Paul-Marie de La Gorce, «Histoire secrète des négociations de Rambouillet»,
 Mai 1999
 Régis Debray, «Une machine de guerre», Juin 1999
 Robert Fisk, «Mensonges de guerre au Kosovo», Aout 1999
 Serge Halimi, «Quand le doigt montre la Lune», Mai 1999
 Serge Halimi, «Journalisme en uniforme (suite)», Mai 1999
 Thomas Hofnung «Le régime serbe à l'épreuve de la guerre», Avril 1999
 Tommaso Di Francesco «Pour une paix à l'irlandaise au Kosovo», Novembre
 1998

Le nouvel Economiste

«Balkans, Boucherie et bidonnages», 15 shkurt 2011,
<http://www.lenouveleconomiste.fr/balkans-boucherie-et-bidonnages-9201/>

Le nouvel observateur

«Indépendance, Kosovo»
 Le président serbe Boris Tadic dissout le parlement - 13 mars 2008
<http://actu-monde.nouvelobs.com/independance-kosovo.html>
 «Kosovo : les réactions-21 février 2008»
<http://actu-monde.nouvelobs.com/independance-kosovo.html>

Le Temps

Florence Hartmann, «Carla Del Ponte e les rumeurs de trafic d'organes au
 Kosovo», 16.04. 2008
http://www.letemps.ch/Page/Uuid/db652f96-aa10-11dd-bf59-ad3d6140ad87/Carla_Del_Ponte_et_les_rumeurs_de_trafic_dorganes_au_Kosovo

Les courriers des Balkans

IWPR, «Kosovo : de nouveaux témoignages confirment les crémations de corps à Surdulica», 26 prill 2005

<http://balkans.courriers.info/article5399.html>

«Serbie: Appel pour la libération immédiate de Miroslav Filipovic (FIDH/OMCT)», 27-07-2000

[http://archives.rezo.net/archives/courrier-](http://archives.rezo.net/archives/courrier-balkans.mbox/TJPYWZ7HT4BWA62QGF6KFAOBSPBOUYU/)

[balkans.mbox/TJPYWZ7HT4BWA62QGF6KFAOBSPBOUYU/](http://archives.rezo.net/archives/courrier-balkans.mbox/TJPYWZ7HT4BWA62QGF6KFAOBSPBOUYU/)

Natasa Kandic, «Kosovo : les services secrets serbes ont couvert les crimes de guerre», 30.12.2004

<http://balkans.courriers.info/article4945.html>

Mondialisation

Domenico Lasurdo, «Industrie du mensonge et guerre impérialiste»

<http://www.mondialisation.ca/industrie-du-mensonge-et-guerre-imperialiste/5349478?print=1>

Louis Magnin, «Le “massacre” serbe de Racak n’a jamais eu lieu»

në: <http://www.mondialisation.ca/le-massacre-serbe-de-racak-n-a-jamais-eu-lieu/12232>

Nouvel Observateur

«Kosovo, ce paradis de la mafia, Un entretien avec Xavier Raufer» (Intervistë me Xavier Raufer-in), 16.02. 2000

Résistances,

« Nationalistes serbes soutenus par l'extrême droite belge»

<http://www.resistances.be/nation07.html>

Réseau voltaire

Dick Marty : « L'indépendance du Kosovo n'a pas été décidée à Pristina », entretien avec Silvia Cattori

<http://www.voltairenet.org/article155903.html>

Jürgen Elsässer, L'indépendance du Kosovo est la mèche d'un baril de poudre

<http://www.voltairenet.org/article155095.html>

«L'UÇK, une armée kosovare sous encadrement allemand»

<http://www.voltairenet.org/article615.html>

SWISSINFO

«Le Kosovo est un cas particulier» (Kosova një rast i veçantë), 11 mars 2008

<http://www.swissinfo.ch/fre/-le-kosovo-est-un-cas-particulier-/6488070>

Le Temps

Florence Hartmann, «Carla Del Ponte e les rumeurs de trafic d'organes au Kosovo», 16.04. 2008

http://www.letemps.ch/Page/Uuid/db652f96-aa10-11dd-bf59-ad3d6140ad87/Carla_Del_Ponte_et_les_rumeurs_de_trafic_dorganes_au_Kosovo

Video:

KOSOVO NWO OCCUPATION,

<http://www.youtube.com/watch?v=5BjZVM8r4a4>

Video: «La bataille de Vukovar»,

<http://www.youtube.com/watch?v=055RFNUHCjA>

Radio Televizija Srbije

Cirilica - Joca Jovanovic, Zoran Petrovic, Slavko Nikic 4/7

<http://www.youtube.com/watch?v=ID1k3TKVfQo>

Slavko Nikic - «Emisija Secanja 1/2»

<http://www.youtube.com/watch?v=9XZcv3-A5nM>

Radio Televizija Srbije

«Račak - Laži i istine», <http://www.youtube.com/watch?v=RH2LB-n3RpI>

INA.FR, «Le nouvel affront de Milosevic»,

<http://www.youtube.com/watch?v=gv1yB7O7Jpk>

INA.FR, «La menace de l'OTAN»,

<http://www.youtube.com/watch?v=55AaRkvace8>

Vimeo, «Proglasenje nezavisnosti Crne Gore», 03.06. 2006

<http://vimeo.com/67519137>

TV Mreza - Slučaj Dikovic (Tv Mreza-Rasti Dikovic)

<http://www.youtube.com/watch?v=rj1GPyhKGos&list=UUKDo3onD-oKCYs8DVlDd-eg&index=8&feature=plcp>

Shpallja - Deklarata e Pavarësis së Kosovës

http://www.youtube.com/watch?v=aSdout_wP9s

Novak Djokovic- «Kosovo je srce Srbije»

http://www.youtube.com/watch?v=iKSrOg_pcvU

Paljenje Američke Ambasade u Beogradu

<http://www.youtube.com/watch?v=YcNCLyhyEFs>

Radio Televizija Srbije

- «Anatomia zlocina-Trgovina organima srba sa Kosmeta», 10.09.2012

http://www.youtube.com/watch?v=yYgj4JH-_Ag

France 24, «L'ancien général serbe Ratko Mladic a été arrêté»

<http://www.france24.com/fr/20110526-serbie-bosnie-herzegovine-tadic-arrestation-ratko-mladic-srebrenica-sarajevo-tpiy-crimes-guerre/>

Euronews, «Srebrenica: hommage aux victimes du 13 juillet 1995», 13.07.2013

(<http://fr.euronews.com/2013/07/13/srebrenica-hommage-aux-victimes-du-13-juillet-1995>)

Dailymotion

Serge Halimi, «Les médias pendant la guerre du Kosovo (1/3)»

http://www.dailymotion.com/video/x4crrr_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

Serge Halimi, «Les médias pendant la guerre du Kosovo (2/3)»

http://www.dailymotion.com/video/x4crvk_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

Serge Halimi, «Les médias pendant la guerre du Kosovo (3/3)»

http://www.dailymotion.com/video/x4crvk_les-medias-pendant-la-guerre-du-kos_news

Radio Courtoisie

Emission du « Libre Journal de Serge de Beketch », « Le vol du Kosovo. Avec Bernard Lugan, Dominique Venner et Philippe Conrad », 07.04.1999
<http://www.ekouter.net/le-vol-du-kosovo-avec-bernard-lugan-dominique-venner-et-philippe-conrad-sur-radio-courtoisie-253>

Radio Peščanik

« Govore: Miljenko Dereta, Vesna Pešić i Nikola Samardžić », 15.09.2006
<http://pescanik.net/2006/09/tangent-a-srca/>

Artikuj nga shtypi serb në internet

B92

Nataša Kandić, « Uznemiravajuća istina » 8 mars 2002
<http://www.b92.net/feedback/misljenja/kandic/print-kandic.html>
« Sloboda za Miroslava Filipovića »
<http://www.b92.net/mediji/filipovic1.phtml>
« Šta donosi predlog novog ustava Srbije »
http://www.b92.net/info/dokumenti/index.php?nav_id=213697
« Vlajko Stojiljković pucao sebi u glavu »
http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2002&mm=04&dd=11&nav_id=58055

Blic

Ivana M. Jasnić, « Goran Radosavljević Guri: Tači preti praznom puškom », 14.04.2013
<http://www.blic.rs/Vesti/Politika/377538/Goran-Radosavljevic-Guri-Taci-preti-praznom-puskom>
Tanjug, Beta, « Vlada predložila raspuštanje Skupštine », 10 mars 2008
<http://www.blic.rs/Vesti/Politika/33477/Vlada-predlozila-raspustanje-Skupstine/print>
Tanjug, « Vučić: MI6 nije učestvovao u ubistvu srpskih mladića u Peći », 14.01.2014
<http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/434579/Vucic-MI6-nije-ucestvovao-u-ubistvu-srpskih-mladica-u-Peci>
Tanjug, « Vukčević očekuje reakciju međunarodnog tima i Vilijamsona », 13.09.2012
<http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/342578/Vukcevic-ocekuje-reakciju-medjunarodnog-tima-i-Vilijamsona>
Tanjug, « Vukčević očekuje reakciju međunarodnog tima i Vilijamsona », 13.09.2012
<http://www.blic.rs/Vesti/Hronika/342578/Vukcevic-ocekuje-reakciju-medjunarodnog-tima-i-Vilijamsona>

E-novine

Priredile e-novine, «Medicinski i pravni stručnjaci osporavaju Vukčevićeve dokaze - Svedočenje o vađenju organa je budalaština», 14.09.2012
<http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/71372-Svedoenje-vaenju-organa-budalatina.html>

Priredile e-novine, «Kako je Srbija ubijala žene, decu i starce», 24.09.2010,
<http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/40863-Kako-Srbija-ubijala-ene-decu-starce.html>

Žarko Radoje. «Slučaj Brajović»,
<http://www.e-novine.com/index.php?news=19158>

Bojan Tončić, «Korumpiran tužilac za ratne zločine?», 10.03.2011
<http://www.e-novine.com/srbija/srbija-tema/45565-Korumpiran-tuilac-ratne-zloine.html>

Fond za Humanitarno Pravo

«Svedočenje Slobodana Stojanovića (1): Pravili su lampe od albanskih lobanja»

ně: <http://www.hlc-rdc.org/?p=25433>

«Svedočenje Slobodana Stojanovića (2): Ubijali su decu, žene, starce, čobane, ovce» ně: <http://www.hlc-rdc.org/?p=25448>

Fondacija Slavko Ćuruvija,

Aleksandar Tijanić i Slavko Ćuruvija, Pismo Predsedniku: «Šta je sledeće, Miloševiću?» Beograd, 19 tetor 1998,
<http://www.slavkocuruvijafondacija.rs/sta-je-sledece-milosevicu-tekst-zbog-kojeg-je-zabranjen-evropljanin/>

Glas Javnosti

Ekila Glasa Javnosti, «Svedočenje Bekima Mazreku»,
<http://www.glas-javnosti.rs/clanak/glas-javnosti-20-04-2008/krematorijum-u-klecki>

Ekila Glasa Javnosti «Del Ponteova pred srpskim tužilaštvom»
<http://www.glas-javnosti.rs/node/17467/print>

Miroslav Antić, «Tela masakrirali psi!» (Trupat i masakruan qentë) ně :
<http://www.mail-archive.com/sim@antic.org/msg15483.html>

S. Kraljević, «General-pukovnik Nebojša Pavković uručio, Odlikovanja u Trećoj armiji»
<http://arhiva.glas-javnosti.rs/arhiva/1999/04/28/glavne-vesti.html>

Index

«Albanska mafija kupila Ahtisaarijev plan za Kosovo»
<http://www.index.hr/vijesti/clanak/albanska-mafija-kupila-ahtisaarijev-plan-za-kosovo/351638.aspx>

Kurir

«Priznao krivicu: Vlastimir Đorđević se izvinio žrtvama na Kosovu »,
<http://www.kurir-info.rs/priznao-krivicu-vlastimir-dordevic-se-izvinio-zrtvama-na-kosovu-clanak-787765>

- «Tužilac Vilijamson stiže kod Vukčevića», 12.09.2012
<http://www.naslovi.net/2012-09-12/kurir/tuzilac-vilijamson-stize-kod-vukcevica/3850263>
- «Tužilac Euleksa Vilijamson uskoro u Beogradu», 12.09.2012
<http://www.naslovi.net/2012-09-12/mondo/tuzilac-euleksa-vilijamson-uskoro-u-beogradu/3849173>
- «Uvod Za Pogrom Srba: Britanska služba MI6 ubila srpske dečake u Peći?!»
<http://www.naslovi.net/2014-01-08/kurir/uvod-za-pogrom-srba-britanska-sluzba-mi6-ubila-srpske-decake-u-peci/8512586>
- «Priznao krivicu: Vlastimir Đorđević se izvinio žrtvama na Kosovu », 13 maj 2013
<http://www.kurir-info.rs/priznao-krivicu-vlastimir-dordevic-se-izvinio-zrtvama-na-kosovu-clanak-787765>
- «Vuk Drašković: Milošević naredio Radetu i Legiji da ubiju srpsku decu!»
<http://www.kurir-info.rs/vuk-draskovic-milosevic-naredio-radetu-i-legiji-da-ubiju-srpsku-decu-clanak-1185359>
- «Rade Marković dao nalog da se ubiju srpska deca u Peći 1998?!», 17.01.2014
<http://www.kurir-info.rs/rade-markovic-dao-nalog-da-se-ubiju-srpska-deca-u-peci-1998-clanak-1182597>

Nedeljnik

- «Engleska služba M-6 najverovatno ubila dečake u Peći»
<http://www.nedeljnik.co.rs/sr/dnevni-magazin/nedeljnik-saznaje-engleska-sluzba-m-6-najverovatnije-ubila-decake-u-peci>

Novosti,

- Tatjana Tagirov, «Budalaštine Tužilaštva za ratne zločine», 24.09. 2012
<http://arhiva.novosti.com/2012/09/budalastine-tuzilastva-za-ratne-zlocine/>

Politika,

- Agencia, «Reč je data, dok živimo - Kosovo je Srbija», 21.02.2008
<http://www.politika.rs/rubrike/Politika/RECH-JE-DATA-DOK-ZIVIMO-KOSOVO-JE-SRBIJA.lt.html>
- Biljana Baković, «Za trgovinu organima Beograd saznao pre devet godina», 02.01.2011
<http://www.politika.rs/rubrike/Hronika/Za-trgovinu-organima-Beograd-saznao-pre-devet-godina.lt.html>
- D. Čarnić, «Guri u bekstvo »,14.02.2007,
<http://www.politika.rs/rubrike/Hronika/t19752.lt.html>
- Tanjug, «LDP: Na referendum izašlo 49,7 odsto»
<http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Referendum/t10734.lt.html>
- Tanjug, «Ustav potvrđen: "Za" glasalo 51,4 odsto birača»,
<http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Referendum/t10734.lt.html>
- Toma Todorović, «Zločinci iz Klečke nisu na Kosovu», 03.09.2010

<http://www.politika.rs/rubrike/Hronika/Zlocinci-iz-Klecke-nisu-na-Kosovu.lt.html>

Živojin Radočević, «Ko je ubio moje dete», 14.12.2013

<http://www.politika.rs/rubrike/Drustvo/Ko-je-ubio-moje-dete.lt.html>

Press

Tanjug, «Radisavljević: Ulemek neće imati nikakve privilegije zbog svedočenja», 15.01.2014

<http://www.pressonline.rs/info/hronika/297131/radisavljevic-ulemek-neze-imati-nikakve-privilegije-zbog-svedocenja.html>

Tanjug «Legija je otkrio ko je ubio Slavka Čuruviju!», 14.01.2014

<http://www.pressonline.rs/info/hronika/297014/legija-je-otkrio-ko-je-ubio-slavka-curuviju.html>

Ekipi i Gazetës, «Skandalozno otkriće Nemačke obaveštaine službe BND»

<http://www.pressonline.rs/info/politika/14102/albanci-kupili-ahtisarija.html>

Radijo-televizija Srbije

«Vučić: Država je ubila Čuruviju», 29.12.2013

<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/1482926/Vu%C4%8Di%C4%87%3A+Dr%C5%BEava+je+ubila+%C4%86uruviju.html>

«Đorđević: Izvršavao sam nalog Vlajka Stojiljkovića »

<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/135/Hronika/70187/%C4%90or%C4%91evi%C4%87%3A+Izvr%C5%A1avao+sam+nalog+Vlajka+Stojiljkovi%C4%87a.html>

«Milovan Drecun u SNS-u

»<http://www.rts.rs/page/stories/sr/story/9/Politika/922260/Milovan+Drecun+u+SNS-u+.html>

Večernje novosti

Đorđe Jevtić, «Kako JUL kaže» artikull i aktualizuar 20.02.2004

http://www.novosti.rs/dodatni_sadrzaj/clanci.119.html:276454-Kako-JUL-kaze-dhe

Tanjug, «Imamo svedoka o uzimanju organa», 09.09.2012

<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/dosije/aktuelno.292.html:396228-Imamo-svedoka-o-uzimanju-organa>

Miloš Antić, «Dželiti sa Klečke», 01.03.2008

<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/dosije/aktuelno.292.html:211412-Dzelati-sa-Klecke>

V. Vuksanović, «SLUČAJ RAČAK PET GODINA POSLE ...»

<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.69.html:154641-SLU268AJ-RA268AK-PET-GODINA-POSLE-INSCENIRANOG-MASAKRA--Laz-u-sluzbi-tomahavka---4>

Z. Uskoković, «Laž za NATO bombe», 16.01.2009

<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/aktuelno.292.html:230221-Laz-za---NATO-bombe>

Z.U-N.B., «Slučaj Čuruvija: I ubice su mrtve, », 24.01.2011

<http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/hronika/aktuelno.291.html:316438-Slucaj-Curuvija-I-ubice-su-mrtve>

Vesti

J.L.Petković, B.Simonović, «Masakr dece je srpska sramota», 21.01.2014
<http://www.vesti-online.com/Vesti/Srbija/375876/Masakr-dece-je-srpska-sramota>

Vestinet

«Britanska služba MI6 ubila srpske dečake u Peći, da isprovocira pogrom Srba i rat», 08.01.2014
<http://www.vestinet.rs/u-fokusu/britanska-sluzba-mi6-ubila-srpske-decake-u-peci-da-isprovocira-pogrom-srba-i-rat>

Vreme

Dejan Anastasijević, «Večni plamen», 09.10.2003
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=354426>

Dragoslav Grujić, «Lik i Delo-Zoran Stanković»,
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=306212>

Jovan Dulović, «Kako su uklanjani tragovi zločina, gde su završili leševi iz hladnjače, da li je postojala "Dubina 1"» 31 Maj 2001,
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=235705>

Milena Pavlović, «Ko su pregovarči», 13 shkurt 1999
http://www.vreme.com/arhiva_html/434/3.html

Miloš Vasić, «Privatni nihilizam i ideološke fikcije»,
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=323038>

Miloš Vasić, «Pokušaj Ubistva Dejana Anastasijevića i njegove porodice», 15.04.2007
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=495476>

Miloš Vasić, «Kasapljenje i medicina», 04.10.2012
<http://www.vreme.com/cms/view.php?id=1075917>

Zoran Nikolić, «Kontrolisano krvarenje», 26. 12. 1998
http://www.vreme.com/arhiva_html/427/3.html

Srbin Info

«ШОКАНТНО: Британска тајна служба МИ6 убила српске дечаке у Пећи»
<http://srbin.info/2014/01/08/sokantno-britanska-tajna-sluzba-mi6-ubila-srpske-decake-u-peci-video/>

Svedok

«Ekskluzivno: Prof. dr Goran Kronja, Sumnjam da su otetim Srbima na Kosovu, nelegalno uzimani (i prodavani) organi»
<http://www.svedok.rs/index.asp?show=75508>

Svet

«DA SE NE ZABORAVI: Ovi mladići su ubijeni pre 14 godina u Peći, krivci nikada nisu nađeni!»

<http://www.smedia.rs/spress/vest/2090/Srpski-mladici-ubijeni-u-kaficu-Panda-Kosovo-Ubijeni-srpski-mladici-Zlocin-u-Pandi-DA-SE-NE-ZABORAVI-Ovi-mladici-su-ubijeni-pre-14-godina-u-Peci-krivci-nikada-nisu-nadjeni-VIDEO.html>

«Krvavi pir: Deceniju i po od stravičnog masakra u Peći još uvek se ne zna ko su ubice šestorice mladića », 13.12.2013

<http://www.svet.rs/hronika/krvavi-pir-deceniju-i-po-od-stravicnog-masakra-u-peci-jos-uvek-se-ne-zna-ko-su-ubice-sestorice-mladica>

Artikuj nga shtypi serb

JEDINSTVO, 04/02/1999

«Dijalog-uslov postizanja mira»
«Zaštiti kulturne i istorijske spomenike»

JEDINSTVO, 08/02/1999

«Rugova u društvu terorista»
«Poginula tri civila»

JEDINSTVO, 10/02/1999

«Zatraženo potpisavanje deset principa Kontakt grupe»
«Strane trupe - ni pod kakvim uslovima»
«Razgovori o kriminalitetu»
«Poznate konture političkog dogovora»
«Albanska delegacija prekršila pravila»
«Nema specijalnih odnosa»
«Funksionalnija nastava»
«Formiraju se lokalna obezbeđenja»
«Rambuže vodi sporazumu»
«Do rešenja na miran način»
«Faktor stabilnosti»
«Kvalitetno izvršeni zadaci»
«Treći ski-fest Srbije»
«Porodice preuzele leševe»
«U opciji tri varijante»
«Podrška Kurejšiju»
«SRJ će obezbediti mir»
«Nezapamćen potez u svetskoj diplomatiji»
«Oživeti privredne potencijale grada»
«Osuđeni napadi»
«Branislav Skulić mučen, pa ubijen»

« "Eksperti" u zasedi»

«Kosmet objekat stranih ambicija»

JEDINSTVO, 19/02/1999

«Podrška aktivnostima državne delegacije»
«Postignut napredak»
«Razgovorima do konačnog sporazuma»
«Neosnovani pritisci»
«Za pregovore bez pritisaka»
«Pretnje nas neće uplašiti»
« "Nećemo dozvoliti da dirnu Kosovo"»
«Otmice se nastavljaju»
«Najdublje poštavanja državnoj politici»
«Osuđeni teroristi»
«Kosmet-svetinja Srbije»
«Rasvetliti sudbinu otetih lica»
«Pretnje agresijom podstiču terorizam»
«Oštra osuda najnovijih terorističkih napada»
«Za zajednički život»
«Na Kosmetu ima mesta za sve»
«Kosmet vitalno nacionalno pitanje»
«Verujemo u Vašu reč»
JEDINSTVO, 20-21/02/1999
«Branićemo otačbinu»
«Napad na helikopter MUP-a»
«Ne damo Kosmet ni po cenu bombardovajna»
«Intenzivna aktivnost»
«Flagrantno kršenje Povele UN»
«Odlučnos u odbrani zemlje»

- «Živadin Jovanović čestitao Papandreu»
- «Isključiti sve pokušaje primene sile»
- «Nerazumliv postupak»
- «Za očuvanje suvereniteta»
- «Osuda pretnji»
- «Ne - agresivnim pritiscima»
- «Branićemo temelje srbske države»
- «Nasrtaj na integritet SRJ»
- «U Rambujeu se brani država»
- «Bez ucena i pritiska»
- «Protiv pretnji silom i ucena»
- «Do rešenja mirnim putem»
- «Ne dozvoliti dolazak NATO trupa»
- «Ubijen Marjan Jović»
- «Srbi odlučni da ostanu»
- «Demonstracije Srba»
- «“OVK” – teroristička organizacija»
- «Identifikovan Miljaim Morina»
- «Pronađen muški leš»
- «Pobediće politika nacionalne ravnopravnosti»
- «Ažuran rad»
- «Visok nivo osposobljenosti»
- «“Principi” okupacije»
- «Neprihvatljive pretnje NATO – a»
- «Ko će deci vratiti oca?»
- «Odsećeni od sveta»
- «Teoristi ne miruju»
- «Život se normalizuje»
- «Srbski đaci ne pohađaju nastavu»
- JEDINSTVO, 24/02/1999**
- «Još jedam pokušaj Medicinsko pritiska»
- «Značajan napredak u političkom rešenju»
- «Proterani sa ogništva»
- «Teroristi izigravaju komandante»
- «Demačiju “sva ovlašćenja”»
- «Značajan napredak u Rambujeu»
- «Ranjeno pet policajaca»
- «Ranjen fotoreporter AP-a Srđan Ilić»
- «Albanci odložili rešenje»
- «Autonomija Kosmeta u okviru Srbije»
- «Međunarodni posrednici proturaju papire»
- «Primena sile “apsolutno neprihvatljiva”»
- «Zabrinutost zbog Kosmeta»
- «Podrška integritetu»
- «Ubeđivanje ili dogovor»
- «Autonomija u skladu sa Ustavom Srbije»
- «Kosmet-u Srbiji»
- «Zaštita nacionalnih interesa i integriteta»
- «Sprečiti dolazak NATO snaga»
- «Obrana od svih napada»
- «Za dugoročni mir»
- «Neizvesna sudbina otetih Srba»
- JEDINSTVO, 04/03/1999**
- «Razgovorom i mirom do trajne stabilizacije»
- «Čvrsto jedinstvo rukovodstva i naroda»
- «Nova manipulacija»
- «Pospešiti razvoj»
- «Zatvorske kazne teroristima»
- «Sahranjen Dobrivoje Šavelić»
- «Protiv medijskih manipulacija»
- «Strani vojnici nisu potrebni»
- «Međunarodni posrednici uz albansku delegaciju»
- «Jedinstveno protiv lociranja NATO trupa»
- «Meci dolaze s Qiqavice»
- «Promena kategorizacije učesnika rata»
- «Ne stranim trupama»
- «Poginuo vodnik Goran Mirjačić»
- JEDINSTVO, 16/03/1999**
- «Spremni smo za fer sporazum»
- «Povratka još nema»
- «Nema povređenih»
- «Opredeljenje za političko rešenje»
- «Razmena mišljenja»
- «Izveršiti pritisak na albansku delegaciju»

«Stanje nikad teže»
«Za pravedan sporazum»
«Otišao patriota»
«Banditi se razbežali»
«Otišao patriota»
«Povređeni se oporavljaju»
«Živimo u svetu bez duše»
«Osloboditi kidnapovanu trudnicu»
«Spremni smo da odbranimo Kosmet»
«Pronađena tela dvojice Albanaca»
«Ugasilo se poslednje srbsko ognjište»
«Uđbenici na romskom jeziku»
«Hrvati u tzv. OVK»
«Hapšenje mafijaša Princa Dobrašija»
«Etničko čišćenje sela podno Qiqavice»

JEDINSTVO, 19/03/1999

«Nametanje rešenja neprihvatljivo»
«Naša delegacija potpisala Politički sporazum»
«Poginuo vojnik Vladimir Markovic»
«Pismo Volebeku»
«Kidnapovan Radoslav Vičentievic»
«Snajperom na lojalne Albance»
«Posebne katedre na albanskom»
«Placevi za opstanag»
«Zbunjujuća formulacija»
«Ratfelderof bosanski recept»
«Podrška državnom rukovodstvu»
«Ne postoji politički sporazum»

POLITIKA 08/02/1999

«Na predlog državne delegacije svih učesnici skupa osudili teroristički napad u Prištini»
«Skupa u prilog mira na Kosovu i Metohiji»
«Usvojena Svesrpska deklaracija»
«Razgovaraće se isključivo o stepenu autonomije»
«Zona zabrane letova iznad Rambujea»

«Insistiramo na apsolutnoj jednakosti svih na Kosmetu»
«Kukov zahtev kosmetskim Albancima»
«Na Kosmet otputovalo 14 verifikatora iz Češke»
«Naša državna delegacija u Rambujeu odbraniti mir, suverenitet i teritorijalni integritet Srbije i SRJ»
«Ohrabrujući početak razgovora u Francuskoj»
«Svenarodno jedinstvo je najbolja platforma za razgovore»
«Srbija pruža sva prava nacionalnim manjinama»
«Osuda terorističkog napada na trgovinsku radnju»
«Atak na slobodu dostojanstvo građana Prištine»
«Nada u pozitivne rezultate razgovora»
«Stradalo 14 osoba»
«Albanija tone u antisrpsku histeriju»
«Međunarodna zajednica u dugogodišnjoj krizi na postoru bivše SFRJ nije bila objektivna»
«Vitalne interese branićemo pred svima i na svakom mestu»

POLITIKA 10/02/1999

«Vedrin i Kuk odlučni da utiču na napredak razgovora»
«Iritirajući ekstremni zahtevi seperatista»
«Ne raspravlja se o vojnim garantijama»
«Moskva uzdrža prema izhitrenom sastanku Kontakt grupe»
«Evropljani daju prioritet Kontakt grupi i OEBS-u»
«Rim i Moskva veruju u uspeh razgovora u Rambujeu»
«Pregovori u Francuskoj, terorizam na Kosmetu»
«Sredine oktobra 470 teroristički»

- «Razmatrano stanje u kriminalitetu, posebno u vezi sa terorizmom i seperatizmom»
- «Branislav Skulić mučen pa ubijen»
- «Lokalno obezbeđenje u svim naseljima»
- «Početni rezultati ohrabruju»
- «Manipulacije glasila na albanskom jeziku»
- «Delegacije nisu preterano srećne»
- «Strane trupe na Kosovu»
- «Nezavisnost ne dolazi u obzir»
- «U zamku razgovaramo i mnogo radimo»
- «Alkohol ispod dejtonskog nivoa»
- «SAD kritikuju Rusiju»
- «Patrijarh danas sa Širakom»
- «Kolektiv na samoodbrana»
- «Danas primopredaja tela iz Račka»
- «Identifikovan Branislav Sekulić»
- «Podvrda i od advokata»
- «Teroristi pokrali samohranu majku»
- «Milosevići napustili Rakoš»
- «Sahranjen Ranko Lazarević»
- «Lokalno obezbeđenje ubrzo i u Vučitrnu»
- «Na stolu Ustav, izbori...»
- «Vašington: Posao napreduje»
- «Zašto nema primirja»
- «Albanci još ništa nisu prihvatili»
- «Zaključci Kontakt grupe temelj sporazuma»
- «Pregovori teški ali ipak napreduju»
- «Kosovo na dnevnom redu»
- «Ne plašite se Miloševića»
- «Za uspeh pariskih pregovora»
- «Rodbina preuzela 20 tela»
- «Sahranjen vojnik»
- «Identifikovano telo Srbina»
- POLITIKA, 19/02/1999**
- «Podrška Ruske Dume Srbiji i SR Jugoslaviji»
- «Milutinović u Parizu»
- «Jelcin protiv vojne pretnje NATO-a Jugoslaviji»
- «Pritisци protiv Srbije i Jugoslavije bez osnova»
- «Šta mediji kriju o Kosmetu»
- «Kad bi vlade Španije, Francuske i Britanije... »
- «Rusija i Nemačka protiv primene sile u Evropi»
- «Bi-Bi-Si: Ekstremni Albanci ne daju oružje»
- «Srbija i SRJ garant mira na Kosmetu»
- «Nedelo na videlo»
- «Škole bez srpskih đaka»
- «Opljačkan pet srpskih kuća»
- «Rodbina kidnapovanih Srba uputila pismo Kontakt grupi»
- «Misiji OEBS uručen spisak sa imenima otetih»
- POLITIKA 19/02/1999**
- «Nemojte da pravite pogrešan izbor»
- «Milošević neće zaustaviti NATO trupe»
- «Hil ponovo u Beograda»
- «Ne damo da dirate Kosovo»
- «Diplomate odlaze»
- «“Tomahavci” poleću sa nosača u Mediteranu»
- «Raste pesimizam u redovima “OVK” »
- «Osuđeno 8 terorista»
- «Taqi i Demaqi se sastaju u Ljubljani»
- «Nećemo se razoružati»
- «Policajci prate radnički autobus»
- «“Pitajte Krasniqija za sudbinu otetih Srba” »
- «Opljačkali srbske kuće u selu Drvare»
- «Režim neće preživeti poraz»
- «Protiv strani trupe»
- «Milošević mora da ode ako dođe NATO»
- «Vlada složna-NATO neće doći»
- «Klintonе, ne diraj u Kosovo»

- «Nisu razgovarali u poslednje vreme»
«Alijansa ne dolazi u obzir»
«Akcija može početi veoma brzo»
«Ključna tema NATO trupe»
«SAD prete bombrdovanjem sa 250 aviona»
«“OVK” trazhi garanciju NATO»
«Naši se u Rambujeu inzvanredno drže»
«Mora još puno toga da se ispuni»
«U koliko pregovori propadnu, KVM odlazi»
«Šešelj: SRS protiv bilo čijih trupa na Kosovu»
«Branićemo se od agresora»
«Izolacija ili Evropa»
«Nema uslovljavanja o sastavu snaga»
«Rasvetlite sudbinu 123 oteta srbina»
«Osuđeno sedmoro albanaca»
«Teroisti plačkali u dervarama»
POLITIKA 20-21/1999
«Milošević odbio susret s Hilom»
«Blizu rešenja - ishod neizvestan»
«Moskva za silu ako odluče UN»
«SAD ignorišu upozorenje Moskve»
«Ne damo Kosovo po cenu bombardovanja»
«Ako Srbi napuste pregovore u Rambujeu uslediće vazdušni udari»
«NATO neće odma napasti Srbiju»
«Poslednja verzija plana za Kosovo neće se menjati»
«Intervencija bi ojačala Miloševića»
«Tompus mira»
«Pretnja građanima , a ne Miloševiću»
«Drašković: Trebamo razmisliti»
«ND: Kompromis a ne nasilje»
«DS: Milošević se krije»
«SD: Odlučujući dan»
«SRJ će štititi suverenitet»
«Apel UNHCR za autobuske linije»
- «Za sada nema odlaska»
«Oslobođeno troje Srba»
« “Nije bilo nikakve vežbe već povratak sa odmora “ »
«KVM radi normalno , ali spremna i za evakuaciju»
«Bolnici potrebna krv»
«Presuda za 15 Albanaca»
«Preteći leci po selima»
«Identifikovan Miljaim Morina»
«Zapad evakuše ambasade iz SRJ»
«Strane vojske ne mogu birati vlast u našoj zemlji»
«Milošević odbio susret sa Hillom»
«Ne damo Kosovo ni po cenu bombardovanja»
«Utvrđenje izmene u korist Srbije»
«Vojni aneks nepovoljan po Albance»
«Ipak dvodoma skupština»
«Nema automatskog napada na Srbiju»
«Od Srbije se traži bezuzlovna kapitulacija»
«Vedrin, Kuk i Olbrajt danas u Beogradu?»
«Pripremiti odbranu»
«Moskva se načelno ne protiviti upotrebi sile»
«Taqi optužuje međunarodne posrednike»
«Petrić optimista»
«Jugoslavia će čvrsto braniti suverenitet»
«Pregovori zabrinjavaju»
«Bombarderi B-52 spremni za napade»
«Vašington juče dobio Jelcinovo pismo»
«Žao mi je ako vas bombarduju»
«Sa agresorom kao i uvek do sada»
«Sve se može dogovoriti»
«Miting mira za Kosovo»
«Bombe ne grade mir»
«Autonomija uz strane garante»

« Ruski dobrovoljci spremni za NATO »

« Alijanca stiže i nepozvana »

« Osuđeno 15 Albanaca »

« Napadnut helikopter »

« Ubijen Srbin »

Večernje novosti, 08/02/1999

« Stradali nedužni »

« Kosovo-duša Srbije »

« Samo autonomija »

« Vojnici da, bombe ne »

« Mir moguć bez oružja »

« Albanija pretnja miru »

« Početak ohrabruje »

« Krenuli verifikatori »

« Dijalog preko posrednika »

« Miniranje razgovora »

« Podlo na civile »

« Sobe bez telefona »

« Avioni izuzetno »

« Odbrana vitalnih interesa »

« Stručna pomoć za akcije »

« Bombama protiv dogovora o Kosmetu »

« “Pokažite hrabrost, ostvarite mir” »

« Atak na mir »

« Appel za postizanje mira »

« Privremena zabrana letova iznad Rambujea »

« Zvanično uručen plan Kontakt grupe »

« Pregovarači zatvoreni dok ne postignu sporazum »

Večernje novosti, 10/02/1999

« Makaze za SRJ »

« Lažno distanciranje »

« Počast za patrijarha »

« Teroristi miniraju pregovore »

« Na liniji budnosti »

« Vuku Parizu »

« Preuzeta tela »

« Nije lako ali ide »

« Razgovori do dogovora »

« Pišite konstruktivno »

« Zarazni primeri »

« Svi da potpišu »

« Prvi rezime u Subotu »

Večernje novosti, 19.02.1999

« I Remi matirao Vokera »

« Ima nade za Rambuje »

« Mir bez alijanse »

« Is fabrikovan Račak »

« Nema vojnog sporazuma »

« Terorizam pretil »

« Branice dezhavu »

« Molba za otete »

« Poznati i otmičari »

« Ne damo Kosmet »

« Ubijen Morina »

« Opljačkane kuće »

« Odbačen predlog »

« Solana optimista »

« Nije ni zva »

« Šiptari se plaše sučeljavanja »

« Dalje prste od Kosmeta »

« Vratite nam sinove »

« Jeftić gladije »

« Priključili se teroristima »

Večernje novosti, 20/02/1999

« Srbiji sva pomoć »

« Poštovati Povelju »

« Spremni za sporazum »

« Podrška pregovorima »

« “Prihvatljivi minimum” »

« Hici na Helikopter »

« Muka ih zbližila »

« Ubijen Jović »

« Leš na drumu »

« Zatvor za sve »

« A sad-Kvar na vezama ! »

« Jelcin ipak pisao »

Večernje novosti, 24/02/1999

« Pet pitanja , jedan odgovor »

« Bombe i “bombone” »

« Samo po principima »

« Dogovor bez potpisa »

« Potpaluju novi rat »

« Primena sile neprihvatljiva »

« Korisni direktni razgovori »

« Klinton omekšao »

« Hrabro u odbranu »

« Ranjena petorica policajaca »

«Režija “katastrofe” »
«Sporazum za sve»
«Protiv razoružanja»
«Uobičajna gotovost»
«Manite se bombi »
«Gde li je taj Kosmet»
«Makedonija – baza NATO»

Večernje novosti, 04/03/1999

«Nametanje rešenja»
«Svi u odbranu»
«Uz pomoć SAD»
«Niska prevara»
«Spremni za sporazum»
«Poginuo Goran Mirijačić»
«Načelnik sa vojnicima»
«Jedinice ispod limita»
«Sahranjen Šavelić»
«Holbruk na Balkanu»
«Diktatura “Demokratije” »

Večernje novosti, 16/03/1999

«Teroristi gube tlo»
«Ciljevi zločinaca»
«Voker odlazi ? »
«Pomažu teroristima»
«Osuda sločina»
«Ubijena četvorica Albanaca»
«Silom NATO»
«Napadi na vojsku»
«Pojačali gotovost»
«ZNG uz ”OVK” »
«Počasti za poručnika»
«Nema Referenduma»
«Šiptari odlažu potpis»
«Isključena primena»
«I Srbe pod zaštitu»
«Još jedan pritisak »
«Tirana kroji malu balkana»

Večernje novosti, 19/03/1999

«Iza Rante politika»
«Sumnjiv izveštaj»
«Nametanje rešenja»
«Ponavlja se Rambuje »
«Ne damo slobodu»
«Ubijen vojnik»
«Otet Vičentijević»
«Kilibarda bez imuniteta»

« “Sporazum” diktat “trojke” »
« Pauza pred rasplet »
«Političko rešenje»
«Rusi nisu ravnodušni»
«Šta će NATO u Srbiji»
«Američka čestitka»
«Iščekivanje»
«Igra na Tačija»
«Kosmet nema cenu»
«Diplomatija ili bombe? »
Nedeljnih Telegraf,
10/02/1999
«Milošević i amerikanci tajno pripremaju plan: Kosovu nezavisnost, Republika Srbska u Jugoslaviji»
«Kraljevski husari spremaju se za Kosovo»
«U Vašingtonskim kuloarima govori se o trampki Kosova za Republiku Srpsku»
«Počele pripreme za slanje ne više od 30.000 vojnika»
«Velikom rokadom rugova gurnut u čošak, Tači na centru»
«Konspirativno ime “Guja”, Mentor “Veliki Ujak” »
«Očajna organizacija, mrtav gradić i apsolutna tajnovitost»
«Supa od bundeve, torta opera i manje alkohola nego u Dejtonu»
«Patrijarh Pavle u Parizu»
«Međunarodnu pomoć»
«Mašta ponovo radi, kao kad je smišljano ime “verifikatori” »
«Voker je Krasnićija, Buju i Sulju iz šumu doveo na aerodrom»

Danas, 04/02/1999

«Obe strane traže svih 2000 verifikatora»

Danas, 09/02/1999

«Krajem sedmice sastanak Kontakt grupe u Rambujeu»
«Teški pregovori iza kapija zamka»
«Albanci traže dokument o prekidu vatre»

«Tajna iz zamka»
 «Priprema za razmestanje vojnih snaga»
 «Rambuže pod opsadom»
 «Zaslađivanje sporazuma, zagorčavanje odbijanja»
 «Milošević poslao najlojalnije ljude»
 «Ponovićemo Irak, ako se nastavi sa ubijanjem»
 «Svi smo na istom zadatku»
 «Pronađena tela pet ubijenih osoba»
 «“Zmija” šef, “Veliki ujak” vrhovni komandant»
 «Opasnost sa mirovnih proces»
 «Pariski samit kao u srednjem veku»
 «Poslednji tango u Parizu»
 «Kraj prodaje voska za uši»

Ekspres-Politika, 10/02/1999

«Razgovori će trajati dok se ne postigne dogovor»
 «Strane trupe na Kosmetu – ni pod kakvim uslovima»

Ekspres-Politika, 19/02/1999

«Podrška Dume Srbiji i SRJ»
 «Milan Milutinović otputovao u Parizu»
 «Nećemo dozvoliti da pipnu Kosovo»

Ekspres-Politika, 19/02/1999/

«Evropa odbacuje mogućnost vazдушnih udara na Srbiju»
 «Neophodnost korišćenja dijaloga»
 «Od Rambuže zavisi budućnost Evropa»
 «Optimizam u Rambužu»
 «Oplačkano pet srbskih kuća»
 «Neophodan dodatni impuls»
 «“Rambuže- stepenica ka nezavisnosti Kosmeta”»
 «Škole bez srbskih đaka»

Ekspres-Politika, 20/02/1999

«Pokušaj upada stranih trupa biće akt agresije»
 «Nećemo dati Kosmet ni po cenu bombardovanja»

«Imamo snagu i spremnost da sami sprovedemo sporazum»
 «Jedinstveni u odbrani zemlje»
 «Opšte protivljenje stranoj vojnoj misiji»
 «Napad na helikopter MUP-a»
 «Teroristi ubili Marjana Jovića»
 «Autonomija za Kosmet samo u okviru Srbije»
 «Isključite sve pokušaje da se primeni sila prema SRJ»
 «Ne treba ići na američkom povocu»
 «OEBS hteo da zataška paklenu napravu “OVK”»
 «“Belgijska vojska nije motivisana”»
 «Vojvodina-najbolji primer»
 «Susret skriven od očiju javnosti»
 «Odlučni u odbrani svoje otačbine»
 «Odlučno protiv stranih trupa»
 «Olbrajtova opasna za planetu»
 Ekspres-Politika, 24/02/1999
 «Nasavak sledi 15.marta u Francuskoj»
 «Ranjeno pet policajaca»
 «Bez sporazuma o vojnim snagama»
 «Naša delegacija nastupala sa pozicija pravde i istine»
 «Moralno izlovati petu kolonu»
 «Prijava protiv Kilibarde»
 «U ime prava sile nameću nam rat»
 «Sporazum ne uključuje referendum»
 «Teroristi opstruišu razgovore»
 «Pretnje su udarac i na međunarodno prav....»
 «Parlamentarci kod Stojkovića»
 «Grad u večitom dimu»
 «Niko odgovoran neće sukob s VJ»
 «Neko namerno želi zlo Srbiji»
 «Zna se šta Kosovo nije, a ne zna se šta jeste»
 «Poplašen komandat»
 «Nastavak pregovora 15.marta»
 «Na referendumu, strane trupe u razmatranju»

- «Referendum podelio tim, Demačiju
sva ovlašćenja »
- «Prekid produžava agoniju Srbije»
- «U rat hrabo i junački»
- «Rusija preti prekidom odnosa s
NATO»
- «U Bukošu ranjeno pet policajaca»
- «Radnici “oteti greškom “ »
- «Hag neće da bude zanemaren»
- «KVM uložio protest Beogradu»
- «Makedonija odbija da bude tranzit
za NATO»
- «Neko od početka želi da pregovori
propadnu»
- «Ne zanemaruje Tribunal»
- «Predstoji ratna psihoza »
- «Pusti bombe, daj zejtina ... »
- «Opstrukcija pregovora»
- «Bombardovanje vodi u otvoren rat»
- Ekspres-Politika, 04/03/1999**
- «Inscenirana TV predstava»
- «Deset principa»
- «Instruktaža iz Vašingtona»
- «Trikovi SAD»
- «Osuda pretnji SRJ»
- «Blajtove izjave direktna podrška
akcijama terorista»
- «Neće se dozvoliti dolazak stranih
trupa»
- «Prevodioci u ulozi isbeglica»
- «Građani Srema odlučni u odbrani
Kosmeta»
- Zvanično posmatrači, a nezvanično
servis “OVK” »
- “Domovina zove” na šferc droge i
teror»
- «NATO neće na Kosmet bez
saglasnosti SRJ»
- «Poruka Olbrajtovoj da ohladi
glavu»
- «Banditi hteli koridor za pojačanje iz
Makedonie»
- «Još dve žrtve terorista»
- «Kosovska Mitrovica»
- Ekspres-Politika, 16/03/1999
- «Vojska razbila zasedu i naterala
napadaće u beg»
- «Naša delegacija daje pismene
primedbe i predloge, na zahtev
kopredsednika Vedrinai Kuka»
- «Prednje “izdajnicima” najavile
bombaške napade»
- Ekspres-Politika, 19/03/1999
- «Prevara u režiji SAD, albanski
seperatisti potpisali svoj sporazum,
delegacija Vlade Republike Srbije
potpisala politički sporazum o
samoupravi na Kosmetu»
- «Velika prevara u režiji SAD,
albanski seperatisti potpisali svog
sporazum, delegacija Vlade
Republike Srbije stavila potpis na
politički sporazum o samoupravi
na Kosmetu»
- « “Parafinska rukavica” jeste dokaz»
- «Nečista posla Helene Rante»
- «Teroristi ubili vojnika»
- «Otet Radosav Vičentijević»
- «Kolone kidišu na SRJ uz vatrenu
podršku iz Albanije»
- POLITIKA, 21/02/1999**
- «Rusija ima pravo da pomogne
SRJ»
- «Podelenja Kontakt grupa»
- «Primakov: Dalji koraci samo uz
pristanak Jugoslavije»
- «Klinton odgovorio na Jelcinovo
pismo o Kosmetu»
- « “OVK” tipična teroristička
organizacija»
- «Obnova kuća u opštini Klina»
- «Ubijena braća Zoran i Radovan
Mihajlović»
- «Ranjeni supružnici Dragica i Milić
Garić»
- «Sahranjen Marjan Jović, žrtva
albanskih terorista»
- «Teror nad sunarodnicima»
- «Protest građana u Leposaviću»
- «Pokušaj pripajanja Kosmeta
Albaniji»

«Protiv preporuke Anana»
«Podrška rukovodstvu SRJ i Srbije»
«Učinili smo sve za mirno političko
rešenje kosmetskog problema»
«Želimo da sačuvamo svoju vekovnu
teritoriju i svoj narod»
«Za mirno rešenje krize na Kosmetu,
protiv pretnji i pritisaka»
«Istrajati u pronalaznju mirnog
rešenja za Kosmet»

POLITIKA, 24/02/1999

«Kosovo: sporazum iz Rambujea,
zaključci kopredsednika odobreni
od strane ministara»
Nasta vak sledi 15 . marta u
Francuskoj»
«Uprkos sporazumu delegacija
kosmetskih albanaca traži i NATO
u referendum»
«Ipak napredak u Rambujeu»
«Na redu druga faza»
«Podrška integritetu SRJ i Srbije»
«Ni reč o vazдушnim udarima»
«Neko je pokušao da izmeni tekst
predloga političkog sporazuma
Kontakt grupe»
«Nemačko udruženje osuđuje
NATO»
«Nesloga među albancima»
«Ohrabrujući napredak»
«Protiv odluke bugarske vlade»
«Nastavak rasgovora najbolje
rešenje»
«Ranjeni fotoreporter AP oseća se
dobro»
«Demaqi dobio od štaba terorista
sva ovlašćenja»
«Američke trupe nemaju šta da traže
na Kosovu»
«Ranjeno pet policajaca»
«Novi pokušaj medicinskog pritiska
albanskih seperatista»
«Dugogodišni teroristi na čelu
“OVK” »
«Na poziv Solane i Olbrajtove
Demaqi u Ljubljani»

«Vašington nanosi štetu alijansi»
«Od svih nas se traži da u ratu, ako
nam bude namenut , poredimo»
«Jednonacionalni autobusi»
«Svedočanstva na šiptarskom »
«Sporazum o Kosovu uslovno
prihvaćen»
«Nema slobode za Albance»
«Bio bi to Vijetnam usred Evrope»
«Primena sille nedopustiva»
«KVM trazhi vojno prisustvo »
«Klark garantuje bezbetnost»
«Neka se ne zovu vojska , već
naoruzhani posmatrači »
«Moskva će i vojno pomoći»
«Zaradili 20.000 maraka uz pomoć
policajca»
«Ranjeno pet policajaca i
fotoreporter AP»
«Krivična prijava protiv Kilibarde»
«Norvežani nas ne napuštaju»
«Mečava na Kosovu»
«Razgovori su složeni – nema mesta
razočarenju»
«Premijer Pandeli Majko o
razgovorima u Rambujeu»
«Srbska strana – glavni krivac»
«I delegacija albanije u Rambujeu»
«Kombinovani napad srbski snaga
protiv nekoliko sela»
«Okršaj blizu sela pantina i
okraštica»

POLITIKA, 04/03/1999

«Beograd protiv ali moraće da
prihvati»
«Srbija prihvata sve osim NATO»
«Ojdanić na Kosovu»
«Nikako referendum»
«Kosovo već podeljeno na zone»
«NATO stiže samo na poziv
Beograda»
«Netačne tvrdnje o prekomernosti»
«Smena, a ne ostavka»
«Srbima pet kantoma»
«Sprečiti teror medija»

«Opasnost od odbijanja sporazuma»
 «Albanci potpisuju»
 «Niko nas neće razoružati»
 «Nema razdora među teroristima»
 «Poginuo vodnik Goran Mirajčić»
 «Pronađen leš kod Orahovca»
 «Identifikovana dva Albanaca»
 «Albanski teroristi zulomom hoće da saplaše narod»
 «Komandant NATO se sastaje sa teroristima, Olbrajtova pokazuje sve sveću nervozu, Holbruk dolazi u Beograd, » «Amerikanci savesnici separatista»
 «Kosmet najflagrantniji primer etničkog čišćenja»
 «Potpis samo na precizan sporazum»
 «Uništene sdravstvene ambulante u Likovcu i Qirezu»
 «Srbski kanotni na Kosovu »
 «Veći pritisak na Beograd»
 «Holbruk umesto Oldbrajtove»
 «Mali ustupak za veliki gubitak»
 «Ćavoški: Bez napretka»
 «Sporazum na Internetu»
 «Izveštaj uskoro u Hagu i Prishtini»
 «Policije i vojske manje od limita»
 «Podrška teroru i zulumu»
 «Poginuo vodnik Goran Mirjačić»
 «Bez Srba ostalo 90 mešovutih sela»
 «Vođe "OVK" Iz Srbičkih sela»
 «Ubijena dva Albanca»
 «I dalje se protiv e razoružanju»
 «Bombardovanje "OVK" nije na spisku»
 «Banditska taktika»
POLITIKA, 16/03/1999
 «Finski patolozi u ime EU : u Račku nije bilo masakra»
 «Naša delegacija daje pismene primedbe i predloge , na zahtev kopredsednika Vedrina i Kuka»
 «Kosovski Albanci uputili pismo , potpisa još nema»

«Vojska i policija na meti terorista»
 «Pronađena tela dva oteta Albanca Rahman Morinaj i Šaban Ramđaj mučeni pa ubijeni»
 «Vidmar osudio terorizam , čeka zvanične nalaze o počiniocima»
 «Klinton ponovio pretnje Srbima»
 «Rusija nije nagovarala Jugoslaviju da prihvati vojno prisustvo»
 «Poziv za spas kulturnog nasleđa na Kosmetu»
 «Vračanjem prezimena protiv asimilacije»
POLITIKA, 16/03/1999
 «Odvojeni razgovori za dve delegacije»
 «Igra do poslednjeg trenutka»
 «Trupe isključivo na zahtev SRJ»
 «Albanci spremni da potpišu sporazum»
 «Samo nemoj , nemoj po glavi... »
 «Gotovo svi dogovori propadali»
 «Ohrabriču Miloševića»
 «Ranjeni oficir i dva vojnika»
 «Albanci sa Kosova koče povratak Srba »
 «Ilegalno prebacivali Albance»
 «Predati dokazi o teroristima OVK»
 «Provera obtužbi»
 «Albanci potpisuju sporazum»
 «Bez razgovora o trupama»
 «Potpis ili napad NATO»
 «Može naoružavanje KVM»
 «Diplomate još čekaju»
 «Deset godina bez kupca»
 «Bez Srba s Kosmeta nema rešenja krize»
 «Ubijena dvojica zemljoradnika»
 «Teroristički napadi duž puta Priština-Podujevo»
 «Kafanski sileđija komandant "OVK"»
 «Uhapšeni šverceri "ilegalaca" s Kosova»
 «Izveštaj Finaca sutra u Prishtini»
 «Nema vesti o otetima»

«Zatvor za kidnapere»
 «Oteta trudnica»
 «I pored represije, nećemo se pokoravati»
POLITIKA, 19/03/1999
 «Velika prevara u režiji SAD, albanski seperatisti potpisali svoj sporazum, delegacija Vlade Republike Srbije stavila potpis na politički sporazum o samoupravi na Kosmetu.»
 «Odluka o daljoj sudbini razgovora danas»
 «Važnost konstruktivnog pristupa»
 «Dobro samo političko rešenje»
 «Diplomatska inicijativa za političko rešenje na Kosmetu»
 «Amerikanci ukazuju počasti gerilcima»
 «NATO ne sme da postane policija u Evropi»
 «U terorističkom napadu poginuo vojnik»
 «Satvorene škole na srbskom jeziku»
 «Kidnapovam Radosav Vičentijević»
 «Prodajnom izložbom knjiga pomažu porodice poginulih i ranjenih milicionara na Kosmetu»
 «Zašto Finci nisu koristili pouzdaniju metodu folije»
 «Patolozi u senci politike»
 «Ubijeni u selu Račak bili su nauružani i pucali su pred smrt»

POLITIKA, 19/03/1999
 «Ivanov: potpišite»
 «Milošević čeka i procenjuje»
 «Beograd upoznat sa dokumento»
 «NATO mora da bira "između dva zla"»

«Albanci potpisali, ultimatum Srbima»
 «Samo politička opcija dobra»
 «Rubin i ranije imao odnose sa Taćijem»
 «Zasad nema evakuacije s Kosova»
 «Gde su tatini sinovi?»
 «Ubijen vojnik, drugi teško ranjen»
 «Teroristi ga pretukli i oteli»
 «Osuđeno petoro terorista»
 «Poginuo vojnik, jedan ranjen»
 «Oteta trudnica pobacila»
 «KVM na oprezu»
 «Još nema vesti o vojniku Mitroviću»
 «Izveštaj Rante ravan nuli»
 «Poginula dvojca rudara»
 «Identifikovana i treća žrtva»
 «Albanci potpisali, Srbima rok do srede»
 «Dačić: Izdržati pritiske»
 «Šešel: Pregovori propali»
 «GSS: Neko želi novi boj»
 «Majorski: Srbi su dobili dokument u feburara»
 «Slediti put 1300 kaplara»
 «Prijateljske veze»
 «Ako se Milošević ne urazumi- NATO spreman za napad»
 «Režim nije ispravio greške komunista»
 «Verska kontakt grupa za Kosovo»
NIN, 18/02/1999
 «Crna rupa ili Evropa»
 «Marinci se spremaju»
 «"Niko ne treba da se plaši"»
 «Rusi i Rambuje»
 «Koji sporazum?»
 «Nove nedoumice»
 «Žene u crvenom»

